

Xhevat Hasani

# Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit



SHBPK 2013



**Xhevat Hasani**

**Një jetë në shërbim të lirisë  
kushtuar Naser Hanit**

**Redaktor**

Ibish Neziri

**Recensues**

Nuri Bexheti

**Lektor**

Sadri Feti

**Faqosja**

Skënder Hajdari

**Ribotim**

Sponzorues i ribotimit **Ibni Kica**

Xhevat Hasani

# Një jetë në shërbim të lirisë

kushtuar Naser Hanit



Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës  
Prishtinë 2013





1958-2001

“Edhe njëqind jetë po t`i kisha të gjitha për  
një Shqipëri të bashkuar do t`i jipja”





<b>Parathënie .....</b>	<b>13</b>
-------------------------	-----------

<b>I. Biografia familjare e personale dhe ambienti ku është lindur e rritur Naser Hani .....</b>	<b>15</b>
--	-----------

■ Trungu familjar dhe farefisi .....	15
■ Familja e ngushtë .....	17
■ Ambienti ku ishte lindur e rritur .....	18
■ “Familja e Madhe” e shokëve dhe e miqve .....	19
■ Dy shokë e miq të veçantë .....	20

<b>II. Përjetimet e Naserit si fillorist .....</b>	<b>22</b>
--	-----------

■ Çunaku misionar! .....	22
■ Teoria e „tre fiseve!“ .....	23
■ Fisi i parë: Posedues pushtetesh dhe parash .....	24
■ Fisi i dytë: Mezi kishte mbijetuar me bujqësi, blegtori e kurbet .....	27
■ Fisi i tretë: Përtej mbijetesës me shkopin e lypësisë në dorë .....	30
■ Ritual i pritjes para zyrave .....	32

<b>III. Naser Hani gjatë viteve të gjimnazit .....</b>	<b>37</b>
--	-----------

■ Duke ia kërkuar jetës kuptimësinë .....	37
■ Përballë realitetit të hidhur .....	40
■ M'atë anë kishte qenë Shqipëria .....	42

<b>IV. Naser Hani gjatë viteve të studimeve në Prishtinë .....</b>	<b>43</b>
--	-----------

■ Në Kosovë si në një “botë tjetër!” .....	43
■ Një botë me qasje e pjesëmarrje institucionale edhe të shqiptarëve..	52
■ Kosova, si një “mësonjëtorë” për të gjithë .....	54
■ Adhurim-besimi ndaj Shqipërisë .....	60
■ Kosova një oazë paqeje dhe lufte! .....	69

<b>V. Me ngjarjet e “Pranverës së Madhe” të vitit 1981 .....</b>	<b>75</b>
--	-----------

■ Si kishin ndodhur ngjarjet e mars-prillit të vitit 1981 .....	75
■ Si kishte ndodhur protesta “spontane” e 11 marsit .....	75
■ Si kishte ndodhur demonstrata e 26 marsit .....	77
■ Si kishte ndodhur demonstrata 1 prillit .....	83
■ Si kishte ndodhur demonstrata e 2 prillit .....	87
■ Demonstratat e 3 prillit .....	95
■ Naser Hani në burgun hetues të Ohrit .....	98
■ Shqipëria “Besnikja e Kosovës!” .....	106

<b>VI. Me lëvizjen studentore për Republikën e Kosovës .....</b>	<b>112</b>
--	------------

■ Një qelizë aktive e lëvizjes studentore .....	112
■ Tiparet kryesore të lëvizjes studentore .....	119

<b>VII. Disa ngjarje në jetën private të Naserit.....</b>	<b>125</b>
■ Jetë të harruara e të humbura.....	125
■ Ekonomist i diplomuar .....	126
■ Në kurbet në Kroaci .....	126
■ Martesa dhe ardhja e fëmijëve .....	127
■ Nëpunës i Këshillit Ekzekutiv.....	127
<b>VIII. Me përpjekjet e fundit për shpëtimin e Kosovës.....</b>	<b>129</b>
■ Kosova midis luftës dhe vdekjes! .....	129
■ Demonstrata masive në nëntorin e vitit 1988 .....	130
■ Katërshtja antishqiptare e Kosovës .....	133
■ Grevat e urisë në shkurtin e vitit 1989 .....	134
<b>IX. Pezullimi i autonomisë së Kosovës në marsin e vitit 1989.....</b>	<b>137</b>
■ Ndryshime kushtetuese me kallashnikovë e tanke! .....	137
■ Demonstrata e 23 marsit e vitit 1989.....	139
■ Me “ushtrinë e madhe” të solidaritetit gjithëpopullor .....	140
<b>X. Duke e keqkuptuar dhe keqpërdorur demokracinë .....</b>	<b>143</b>
■ Demokracia me dhëmbë! .....	143
■ Shqiptarët ishin “ngrënë” nëpër gazeta e Serbia i kishte kryer punët e veta .....	146
■ Kishte vendosur të kthehej në Maqedoni .....	151
<b>XI. Kthimi nga Kosova në Maqedoni dhe egzili në Austri .....</b>	<b>154</b>
■ Në vitet e para të pavarësimit të Maqedonisë .....	154
■ Në krye të Maqedonisë “mashtruesi plak!” .....	157
■ Midis veprimtarish të shumëfishta .....	158
■ Në “vorbullën” e organizimit politiko-territorial .....	161
<b>XII. Veprimtaria e Naserit gjatë viteve të egzilit .....</b>	<b>162</b>
■ Në vitet e para të qëndrimit në Austri .....	162
■ “Liri, demokraci, pa shqiptarët s'ka Maqedoni!” .....	167
■ Lajme të këqija nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria .....	170
■ Në vitet e kthesës drejt luftës dhe lirisë! .....	175
■ Me Luftën Çlirimtare të Kosovës .....	180
■ Shqipëria prapavijë shtetërore e Luftës Çlirimtare të Kosovës .....	183
■ Kishte dashur t'i bashkohej UÇK-së.....	188
<b>XIII. Kthimi i fundit nga Austria në Maqedoni .....</b>	<b>191</b>
■ Kthimi i fundit si provokim i shumëfishtë .....	191
■ “Zgjedhje të lira” me „xhaketa të fryra...!” .....	195
■ Kishte vazhduar të jetonte me fatet e Kosovës .....	200
■ Në Qendrën sociale të Strugës.....	204
■ Vizita e parë në Kosovën e lirë.....	207
<b>XIV. Me Luftën çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni.....</b>	<b>211</b>
■ Në mbështetje të UÇK-ës në Maqedoni.....	211

■ Kupa që ishte dashur të derdhej...!	212
■ Duke i analizuar mundësitë e vrasjes së tij	214
<b>XV. Vrasja e Naser Hanit me atentat të fshehtë</b>	<b>217</b>
■ Për t'i minuar bisedimet për paqe.....	217
■ Si kishte ndodhur vrasja dhe kush qëndronte pas saj	222
■ Ministria dhe ministri që s'kishin pasur si ta hetonin veten.....	225
<b>XVI. Reagimet publike lidhur me vrasjen e Naser Hanit.....</b>	<b>229</b>
■ Vrasje që ishte pritur me shqetësim.....	229
■ Shkrime në mediat shqiptare	230
■ Shkrime të përkthyer nga mediat ndërkombëtare	237
■ Shkrime të përkthyer nga gjuha angleze:	237
■ Shkrime të përkthyer nga gjuha gjermane:	244
■ Shkrime të përkthyer nga gjuha italiane	245
■ Shkrim i përkthyer nga gjuha spanjolle	246
■ Shkrim i përkthyer nga gjuha holandeze	246
■ Shkrimet origjinale të medieve ndërkombëtare	247
■ Shkrimet origjinale në gjuhën angleze:	247
■ Shkrimet origjinale në gjuhën gjermane:	253
■ Shkrimet origjinale në gjuhën italiane:	254
■ Shkrim origjinal në gjuhën spanjolle	255
■ Shkrim origjinal në gjuhën holandeze	256
<b>XVII. Kapitulli përmbyllës</b>	<b>257</b>
■ Lajmi që më tronditi pa masë	257
■ Libri të cilin e “shkrova” për një natë!	258
■ Epitaf mbi varr!	259
■ Lamtumirë!	259
<b>XVIII. Copëza kujtimesh nga disa shokë të Naser Hanit</b>	<b>260</b>
■ Mehmet Bislimi.....	260
■ Kolë Staka	262
■ Xhevdet Nasufi	262
■ Xhavit Haliti	267
■ Avni Kica	269
■ Ibni Kica, Dashmir Kaba, Imit Istrefi, Qashif Hani.....	270
■ Abdullah Abdullahu	272
■ Halit Naxhaku	274
■ Ylber Hasani, Fadil Tutuli, Jani Koçi, Liri Ramadani	275
■ Ibrahim Bekteshi	277
■ Një këngë për Naser Hanin.....	278
<b>Fjala e redaktorit</b>	<b>280</b>
<b>Fjala e recensuesit.....</b>	<b>283</b>



## Parathënie

Lexues të nderuar!

Ky libër i kushtohet veprimtarit nga fshati Veleshtë i Strugës, Naser Hanit, të cilin e njoha për herë të parë në verën e vitit 1993 në Vjenë të Austrisë, ku ai ishte vendosur për shkak të përndjekjes politike nga Maqedonia e kohës së Kiro Gligorovit.

Unë jam njëri nga shokët e viteve të fundit të jetës së Naser Hanit. Që nga viti 1993 e deri më 2001, kur ai u vra tinëzisht nga shërbimi sekret i Maqedonisë, kemi pasur takime dhe biseda të shumta politike, të cilat, duke i pasur parasysh veprimet e zeza të pushtetmbajtësve serbë, maqedonë, malazez e të tjerë ndaj shqiptarëve gjithandej, kanë qenë pothuajse gjithnjë të zymta.

Te Naser Hani e gjeta njeriun e përkushtuar për popullin dhe atdheun e tij. Ai u mor gjatë tërë jetës së tij, si me çështjen e Kosovës, ashtu edhe me çështjen e shqiptarëve në Maqedoni. Përkushtimi i tij atdhetar i ka fillet që nga koha kur kishte qenë gjimnazist dhe vazhdoi si i tillë gjatë viteve të studimeve në Prishtinë, dhe më pas edhe në vitet e mërgimit në Austri dhe deri në fund të jetës së tij.

Natyra e gjallë, korrektësia, toleranca, vendosmëria dhe gatishmëria e vazhdueshme për të vepruar në të mirë të çështjes shqiptare, kanë paraqitur tiparet kryesore të Naser Hanit, si njeri, shqiptar dhe atdhetar. Qasjet e tij shoqërore dhe mirësia ndaj të tjerëve, kanë bërë që ai gjatë gjithë jetës së tij të ishte i rrethuar nga shokë e miq të shumtë, të cilët i ka dashur më shumë se veten. Duke qenë i tillë, Naseri mbeti për shumëkënd njëri nga shokët dhe miqtë e rrallë, i cili shokëve dhe miqve të idealit kombëtar, kur kishte dy mollë, nuk u jepte vetëm mollën më të madhe, por të dy mollët, duke mos ndalur asgjë për veten e tij.

Me mendësinë politike që kishte dhe me qasjet jopretenduese për veten e tij,

ai lëvizjes çlirimtare shqiptare në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare të mbetura në kuadër të ish-Jugosllavisë ia ka shtuar vazhdimisht radhët me veprimtarë të rinj. Qëllimi përfundimtar i Naser Hanit ka qenë bashkimi i shkallë-shkallshëm kombëtar i shqiptarëve në një shtet të vetëm, në një Shqipëri optimale me të gjitha viset me shumicë shqiptare në Ballkan.

Portreti prej atdhetari dhe idealisti të pathyeshëm dhe sidomos fundi tragjik i jetës së tij, kanë qenë shtysat kryesore që më kanë nxitur ta shkruaj këtë libër për Naser Hanin.

Sa i përket veprimtarisë politiko-patriotike të Naser Hanit, ajo në masë të madhe mbështetet në bisedat e drejtpërdrejta që kam pasur me të dhe me një pjesë të familjarëve dhe të shokëve të tij. Jam i vetëdijshëm se lidhur me jetën dhe veprën e Naser Hanit ka mbetur diçka edhe pa u thënë. Shpresoj se nëse në të ardhmen ky libër do të ribotohet, do ta plotësoj atë edhe me të dhëna të tjera.

Sa i përket zbardhjes së vrasjes së Naser Hanit nga strukturat e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë, jam mbështetur si në biografinë e tij të mbushur me përndjekje politike, ashtu edhe në informacionin e veçantë të publikuar me rastin e vrasjes së tij, duke mos i përjashtuar këtu edhe njoftimet gojore të familjarëve dhe të bashkëveprimtarëve të tij nga Veleshta dhe më gjerë.

Si veprimtaria patriotike ashtu edhe vrasja e Naser Hanit janë trajtuar në kontestin e ngjarjeve madhore të ndodhura që nga vitet e '70 e deri në fund të viteve të '90 të shekullit të kaluar në Kosovë, në Maqedoni dhe viset e tjera shqiptare.... I jam qasur në këtë mënyrë jetës dhe veprës së Naser Hanit, sepse ajo ka ecur paralelisht dhe si pjesë përbërëse e ngjarjeve të tilla madhore, kur shqiptarët në Kosovë e vise të tjera, për realizimin e të drejtave të tyre legjitime, bënë luftë politike të shoqëruar me demonstrata masive dhe me forma të tjera të qëndresës aktive, ndërkohë që në kapërcyellin e shekujve të njëzetë/njëzetënjë, bënë edhe tri luftëra çlirimtare të suksesshme.

Do të jam i lumtur nëse ia kam arritur që nëpërmjet të këtij libri, t'ua kam sjellë sa më të plotë figurën e Naser Hanit gjeneratave të tanishme dhe atyre që do të vijjnë.

Zürich, janar, 2013

Autori

## **I. Biografia familjare e personale dhe ambienti ku është lindur e rritur Naser Hani**

### **■ Trngu familjar dhe farefisi**

Naser Hani ka lindur më 15 gusht të vitit 1958 në fshatin Veleshtë të rrethit të Strugës në Maqedoni. Në këtë fshat kishte lëshuar rrënjë ndër shekuj trngu i tij familjar. Aty i kishte pasur stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit dhe farefisën e gjerë prej dhjetëra familjesh që bartin mbiemrin Hani.

Është për t'u theksuar se të parët e Naserit, si nga i ati, ashtu edhe nga e ëma, ishin shquar për urtësi, ndershmëri dhe atdhedashuri, virtyte këto të cilat ishin përcjellë brez pas brezi deri te Naser Hani.

### **Familja prindore**

I ati dhe e ëma, dy vëllezër dhe dy motra kishin paraqitur familjen prindërore të Naser Hanit. Më i vogli në mesin e vëllezërve dhe motrave kishte qenë Naseri.

Kishin qenë harmonia, puna, sjellja e mirë, dëshira për arsimim, dashuria për kombin dhe për Shqipërinë, ato që e kishin karakterizuar familjen prindore të Naserit.

Kishin qenë virtytet dhe botëkuptimet e tilla ato që e kishin bërë të nderuar e të respektuar familjen Hani në Veleshtë dhe në rrethinën e Strugës.

Nga vëllezërit dhe motrat Hani janë krijuar tani më përfundimisht pesë familje. Familjet e dy vëllezërve dhe familja e ngushtë e Naserit jetojnë në Strugë, kurse familjet e të dy motrave jetojnë në Prishtinë.

### **Prindërit**

**Jashar Hani** ka qenë i ati i Naserit. Ai do të shquhej që herët si arsimdashës e lirisdashës për popullin e tij. Jeta e kishte brumosur Jashar Hanin, si me dashuri e dhembshuri ndaj popullit të tij të shumëvujtur, ashtu edhe me urrejtje e

ashpërsi ndaj shovinistëve maqedonë e jugosllavë, të cilët kishin ushtruar padrejtësi mbi shqiptarët gjithandej Jugosllavisë.

Në formimin e tillë të Jashar Hanit kishte ndikuar edhe personaliteti i antifashistit të njohur nga Peza e Shqipërisë. Kishte qenë ai Myslym Peza, i cili për shkak të përndjekjeve nga ana e mbretit Zog, kishte bërë jetën e ilegalit në Veleshtë të Strugës deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, te një kushëri i Jashar Hanit. Kështu, ajo që Jashar Hanit i kishte mbetur përgjithnjë në kujtesë, kishte qenë thënia e Myslym Pezës të njohur si “Babë Myslimi” se: “Vetëm me penë e pushkë do të çlirohej e bashkohej Shqipëria një ditë! Tjetër rrugë s'ka!”

I frymëzuar nga ide të tilla, Jashar Hani, gjatë gjithë jetës kishte pasur ideal arsimimin e fëmijëve të tij, jo vetëm të djemve, por edhe të vajzave, të cilat kishin qenë asokohe nga të parat vajza të rrethit të Strugës të cilat ishin arsimuar deri në Prishtinë. E kishte bërë këtë Jashar Hani, jo vetëm për të mirën e vajzave të tij, por edhe për të ndikuar me shembullin e tij te familjet tjera shqiptare, të cilat kishin qenë të gatshme t'i arsimonin djemtë, por jo edhe vajzat.

Këtij ideali, Jashar Hani i kishte mbetur besnik derisa kishte vdekur në vitin 1974. Por, para se të vdiste, ai e kishte lënë një amanet: „Të ma kujdesni Naserin se është më i vogli, është shumë i pasherr e mund ta marrë ndokush në qafë...!”.

**Mazllumshahe Hani** ishte e ëma e Naserit. Edhe ajo, si shumica e nënave shqiptare të atyre kohëve, aq sa kishte qenë e urtë dhe e dhembshur, po aq kishte qenë e vuajtur dhe e ndrojtur. Nuk kishte qenë pasja, por kishte qenë këshilla e mirë dhe dashuria prej nëne, ato, me të cilat ajo i kishte ushqyer gjatë gjithë jetës fëmijët e saj.

Gjatë vitit 1982 kur Naseri ishte burgosur për shkak të pjesëmarrjes së tij në demonstrata në Prishtinë, ajo ishte mërzhitur shumë. E mjera nënë, derisa Naseri kishte qenë në burg, ishte ngritur shpeshherë natën nga shtrati, kishte ecur nëpër dhomë, pastaj kishte dalë në oborr, kishte shikuar nga dera e shtëpisë, dhe ishte kthyer e dëshpëruar në dhomën e saj. S'ishte brengosur vetëm për Naserin, por ishte brengosur për të gjithë të rinjtë shqiptarë, të cilët ndër ato vite kishin qenë burgjeve gjithandej Jugosllavisë. Dhjetëra prej tyre ishin vvarë, qindra të tjerë ishin plagosur dhe mijëra të tjerë ishin burgosur. Të gjithë kanë nënë e babë, i kishte thënë ajo vetes me pikëllim.

Nga ana tjetër, kishin qenë edhe ecejaket e Naserit dhe ardhje-vajtjet e shumta të shokëve të tij, ato të cilat nënën e Naserit gjatë tërë viteve të '80 e kishin mbajtur në frikë e ankth. Kjo sepse ecejaket, ardhje-vajtjet dhe kontaktet e tilla, të voglit të saj mund t'ia hanin kokën, kurse asaj mund t'i sillnin gjëmen! Sa herë që ajo ishte futur në dhomën e pritjes, ku kishin qenë shokët e Naserit, ata e kishin ndërruar temën e bisedës. Duke dalë sa më shpejt nga dhoma për të



mos i penguar ata, ajo i ishte lutur Zotit: „Ruaji, o Zot, të mos u ndodhë gjë në shtëpinë time, se bota ka për t'na e qitë namin e zi!”.

Kishte qenë viti 1991 kur Nënë Mazllumshahja, e ndodhur midis brengash, vuajtjesh e sëmundjesh, i kishte mbyllur sytë përgjithmonë.

## Vëllezërit dhe motrat

Naser Hani kishte dy vëllezër e dy motra. Vëllai i madh, **Berati**, tanimë i vdekur, kishte kryer shkollën e mesme ekonomike; vëllai i dytë, **Vibari**, kishte kryer fakultetin ekonomik; motra e madhe, **Mirëdita**, kishte kryer shkollën e lartë pedagogjike, kurse motra e vogël, **Lunikja**, kishte kryer fakultetin juridik.

Kishin qenë vitet e '70 të shekullit të njëzetë kur vëllezërit e motrat Hani, ishin arsimuar dhe kishin shpresuar se “Ditë të mira paskëtaj do vinë...!”. Kishin shpresuar kësisoj, sepse tanimë edhe një pjesë e mirë e rinisë shqiptare nga Maqedonia kishte filluar të arsimohej në të vetmin universitet në gjuhën shqipe në Kosovë. Dhe kishin shpresuar kësisoj sepse tanimë ata edhe vetë ishin bërë pjesë e lëvizjes më të re kombëtare dhe kulturore të shqiptarëve në Jugosllavi. Entuziazmi dhe shpresat e tilla të tyre ishin bartur pa dyshim edhe te vëllai i vogël, Naseri, i cili gjatë viteve të '70 kishte qenë gjimnazist dhe i kishte filluar studimet në Prishtinë.

Kështu, të gjitha kujtimet e mira të vëllezërve dhe motrave Hani, lidhen me vitet e '70 e të '80 të shekullit të kaluar, ndër të tjera edhe pse kujtimet e atyre viteve, atyre u lidhën ngushtësisht me Naserin: Me rritën dhe frymëzimin e tij djaloshtar, me veprimtarinë e tij politiko-patriotike brenda lëvizjes studentore, të shoqëruar me përndjekje, burgosje dhe rreziqe, por edhe me arritje e fitore, të cilat ata i kishin përjetuar me krenari.

## ■ Familja e ngushtë

### Bashkëshortja

**Florentina Hani** është bashkëshortja e Naser Hanit, që ai e thërriste shkurt “Tina”. Ajo duke qenë bijë e Beqir Berishës, e një ish-të burgosuri politik nga Tetova, që si nxënëse e shkollës së mesme ishte brumosur me ide liridashëse.

Naseri dhe Florentina ishin njohur në Prishtinë. Ajo kishte studiuar sociologjinë, kurse ai ekonominë. Kishin qenë fillimisht shokë e miq. Më pas ishin dashuruar dyfish. Me dashurinë për njëri-tjetrin dhe me dashurinë e të dyve për atdheun e copëtuar padrejtësisht. Kishin qenë këto dashuritë e dyfishta të atyre kohëve, tanimë të papërsëritshme për shumëçka.

Ardhja e fëmijëve në jetë i kishte gëzuar pa masë që të dy. Por, edhe mbi gëzimin e tillë kishin rënduar rreziqet, që mund t'i vinin Naserit nga sigurimi i shtetit në Kosovë e në Maqedoni.

Kishin qenë rreziqet e tilla ato të cilat kishin bërë që Naseri të ishte arratisur në Austri në vitin 1993, ku kishte qëndruar për pesë vjet me radhë.

## **Fëmijët**

**Lynkesta, Jashari dhe Era** janë tre fëmijët e Naser Hanit. Dashuria e Naserit për fëmijët e tij ka qenë e veçantë, sepse duke qenë ai i mërguar për pesë vjet me radhë në Austri, nuk e kishte parë dhe shijuar fëmijërinë e tyre.

Këta janë fëmijët pa fëmijëri të Naser Hanit, sepse shovinistët maqedonë ua prenë atyre gëzimet dhe ëndrrat fëmijërore që në moshë të njomë...!

## **■ Ambienti ku ishte lindur e rritur**

**Veleshta** është fshati i lindjes së Naser Hanit, njëri nga fshatrat më të mëdhenj të shqiptarëve në Maqedoni. Fshati ka aktualisht rreth shtatë mijë banorë, dhe me rritën e tij pothuajse i është bashkangjitur Strugës.

Por, Veleshtën, më shumë se madhësia, e kishin bërë të njohur njerëzit e saj të virtytshëm dhe trima. Kanë qenë e janë këta veleshtarët të dashur e zemërgjerë deri në pa kufi, po të jesh i mirë e zemërbardhë, por edhe të ashpër deri në pafundësi, po të jesh i keq e hileqar. Mbi të gjitha, ata kanë qenë e janë mikpritës që “fikën por nuk koritën!”. Duke qenë të tillë, ata kanë qenë e kanë mbetur një strehë e sigurt për shumëkënd që ia ka dashur e ia do të mirën vendit, ashtu siç kanë qenë e janë edhe një ferr i vërtetë për armiq e tradhtarë. Cuba, në kuptimin e mirë të kësaj fjale, kanë qenë dhe janë veleshtarët. Por, jo vetëm cuba, por edhe përparimdashës. Kështu, në Veleshtë mund të gjelesh: shkrimtarë, poet, profesorë, mjekë, politikanë, sportistë, zanatlinj etj.

Edhe Naser Hani i ka pasur të skalitura brenda karakterit të tij virtytet më të mira të veleshtarëve, të cilët i ka dashur aq shumë, sepse kishin qenë të mirë, por kishte dashur t'i bënte edhe më të mirë. Duke i sqaruar vazhdimisht e për gjithçka, ai, ishte përpjekur që ta orientonte andej nga duhej shpirtin e zjarrtë të veleshtarëve: Drejt dijes, dritës dhe lirisë!

Për Naserin nuk ka pasur veleshtarë të këqij! Ai i kishte dashur e respektuar të gjithë. I kishte mbajtur pranë vetes edhe ata veleshtarë, të cilët pa fajin e tyre kishin pasur edhe ndonjë ves. Naseri ishte përpjekur vazhdimisht që nëpërmjet të sqarimit politik dhe frymëzimit patriotik, veleshtarëve të tij t'ua ruante unitetin e brendshëm, tek i cili shpeshherë iu ka “zënë sharra në gozhdë”

shovinistëve maqedonë. Naseri kishte dashur para së gjithash që veleshtarët e tij “as të mos tutën e as të mos ngutën!”. Por derisa “mostutën” ata e kishin pasur të lindur, “mosngutjen” ua kishte mësuar vetë ai.

**Qyteti i Strugës** -Duke qenë Veleshta fare pranë Strugës, Naseri që herët i kishte shijuar bukuritë e këtij qyteti buzë liqenit të Ohrit, që struganët i thonë liqeni i Strugës.

Nëpër rrugët e kalldrëmta të këtij qyteti, Naser Hani i kishte kaluar vitet më të bukura të djalërisë së tij, kur kishte qenë gjimnazist. Kishte qenë kjo arsyeja pse Naseri menjëherë pas Veleshtës, Strugën e kishte perceptuar si vendlindjen e tij të dytë. Dhe kishin qenë pikërisht kujtimet e tij për Strugën që nga koha e djalërisë, ato të cilat kishin bërë që ai në dy-tri vitet e fundit të jetës të ishte vendosur me familje në këtë qytet.

Vetë banorët e qytetit, pa i llogaritur ata të fshatrave përreth, përmbi 50% janë shqiptarë, që do të thotë shumë më pak se dikur para Luftës së Dytë Botërore, kur ata kishin qenë kryesisht shqiptarë. Kështu kishte ndodhur sepse pas LDB-së, me qëllim të prishjes së strukturës etnike të vendbanimeve të shqiptarëve, edhe në këtë qytet ishin sjellë maqedonë nga pjesët lindore të vendit, të cilët në kuptimin e plotë të fjalës kanë qenë kolonistë.

Në fakt, Struga piktoreske të gjithëve u pëlqen pa masë. Kështu, edhe ardhacakët maqedonë e duan atë fort, aq fort sa që ata me kohë edhe kanë krijuar një thënie të veçantë për të: „**Kao Struga nema druga!**“, që do të thotë se „Si Struga tjetër s’ka!“.

Pikërisht në mjedise të tilla çfarë njeriut mund t’i ofrojnë vetëm Veleshta dhe Struga, Naser Hani i kishte kaluar vitet e fëmijërisë dhe të rinisë së hershme, kur ai me hovin e tij djaloshar kishte dashur që me një hop t’i kapërcente edhe malet!

Në kujtesën e Naserit kishin mbetur të paharrueshme sidomos mbrëmjet e bukura strugane, kur rrezet e hënës, të përziera me drita neonesh dhe me puhiza erërash që kishin fryrë nga liqeni, i ishin përplasur aq ëmbël e këndshëm për gjoks e fytyrë.

Natyrisht, ai, asokohe as që kishte mundur ta merrte me mend, se pas njëzet e ca vjetësh po në këtë qytet do të vinte një mbrëmje tjetër, jo më e mbarsur me lirikë natyrore, por me tragjiken e tij.

## ■ **“Familja e Madhe” e shokëve dhe e miqve**

Të shkruash për biografinë personale të Naser Hanit dhe të mos i përmendësh shokët dhe miqtë e tij të idealit çlirimtar, kjo do të ishte më shumë se një gabim, sepse ai nuk ishte rritur e ngritur vetëm brenda familjes së tij prindërore, por edhe brenda “familjes së madhe” të shokëve dhe të miqve të shumtë, me të cilët

ishite lidhur që si djalë i ri dhe kishte mbetur i lidhur deri në fund të jetës së tij.

Naseri që si fëmijë e djalë i ri kishte ditur të kultivonte shoqëri e miqësi me bashkëmoshatarët e tij nga Veleshta e fshatrat përreth. Me këta shokë ai e kishte bashkuar që herët veprimtarin e tij për të mirën e Kosovës dhe të shqiptarëve në Maqedoni. Sa më shumë që ishte rritur dhe ngritur politikisht, aq më shumë i kishte parapëlqyer shokët me dell patriotik.

Një vend me rëndësi në jetën e tij kanë zënë shokët e studimeve në Prishtinë. Me këta shokë ai e kishte bashkuar veprimtarinë e tij politike të pranverës së vitit 1981 dhe të viteve në vazhdim.

Një kategori tjetër e shokëve dhe e miqve të Naserit me të cilët ai kishte gjetur gjuhë të përbashkët, kishin qenë ata të vendit të punës në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës.

Gjatë viteve 1993-1998 të mërgimit në Austri, Naseri ishte njohur me shokë të cilët s'i kishte njohur më parë. Me këta shokë ai u angazhua në përkrahje të Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe të UÇK-së.

Gjatë viteve të luftës çlirimtare në Kosovë Naseri njohu shokë e miq të ri edhe në Zvicër, me të cilët ai e bashkoi përkrahjen e tij për UÇK-në.

Dhe së fundi, Naseri gjatë viteve të 90' të shekullit të kaluar kishte bërë shokë e miq të shumtë edhe në Shqipëri.

Kështu, harta e shokëve dhe e miqve të tij kishte përkruar me hartën e të gjitha trojeve etnike shqiptare.

## ■ Dy shokë e miq të veçantë

**Bardhyl Mahmuti**, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare, i diplomuar në lëmin e shkencave politike në Universitetin e Lozanës dhe ish-zëdhënës politik i UÇK-së, për Naserin më shumë se mik shtëpie (vëllai i bashkëshortes) kishte qenë dhe kishte mbetur shok i idealit çlirimtar.

Duke filluar që nga viti 1981 e deri në vitin 2001, Bardhyli dhe Naseri s'ishin ndalur asnjëherë së vepruari në të mirë të realizimit të të drejtave të shqiptarëve gjithandej Jugosllavisë, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

Meqë ishin përndjekur nga shërbimet sekrete serbe e maqedone për shkak të veprimtarisë tyre politike, që të dy ishin detyruar të mërgonin jashtë vendit, Bardhyli në Zvicër e Naseri në Austri.

**Agni Dika**, profesor në Fakultetin teknik në Universitetin e Prishtinës, nuk ka qenë vetëm dhëndri i Naserit, por edhe një shok e vëlla i mirë i tij. Profesor

Dika i ishte gjendur Naserit pranë si për ditë të mira, ashtu edhe për ditë të këqija.

Ai dhe bashkëshortja e tij, motra e Naserit, Lunikja, kishin pritur e përcjellur në banesën e tyre në Prishtinë shumë shokë të Naserit, duke filluar që nga viti 1981 dhe për vite të tëra në vazhdim.

Edhe gjatë viteve kur Naseri kishte qenë i mërguar në Austri, ata e kishin vizituar Naserin së pakut dy-tri herë në vit. I kishin sjellë atij ngrohtësi, kurajë dhe shpresë, duke i thënë se bashkëshorten dhe fëmijët i kishte mirë etj.

## II. Përjetimet e Naserit si fillorist

### ■ Çunaku misionar!

Naser Hani në vjeshtën e vitit 1965 ishte gjendur në bankat e klasës së parë të shkollës fillore të fshatit Veleshtë.

I gjallë dhe plot kureshtje, ai, i kishte thithur aty për aty të gjitha ato që kishin thënë mësuesit. Falë kësaj zgjuarsie, ai, nuk kishte qëndruar shumë me kokë mbi libra. Përkundrazi, pjesa më e madhe e kohës i kishte ikur duke lozur me shokë në oborrin e shkollës, në rrugicat e fshatit dhe duke u larë buzë liqenit. Po kështu duke “lozur” me shokë në të mirë të popullit të tij të shtypur atij do t'i kalonte edhe tërë jeta.

Te ai ishte vërejtur, para së gjithash, natyra prej “çunaku misionar!”. Edhe sheqerkat i kishte ndarë me shokët e tij, kurse në rast zënkash në shkollë ai ishte pozicionuar gjithnjë në krahun e të pafajshmit dhe të dobëtit. I tillë, si një misionar i çështjes kombëtare do të mbetej ai pastaj deri në fund të jetës së tij.

Në shpirtin e filloristit Naser Hani ishte mbjellë që herët aq shumë dashuri e dhembshuri, si për njerëzit, ashtu edhe për natyrën. Dashuria e dhembshuria pastaj e kishin përcjellë gjatë gjithë jetës. Derisa te dashuria për njerëzit e kishte gjetur dashurinë ndaj popullit të tij, te dashuria për natyrën e kishte gjetur dashurinë ndaj atdheut të tij të copëtuar padrejtësisht në gjashtë pjesë!

### Duke e “përgjuar” të atin dhe dajën

Shpirti kureshtar kishte bërë që Naseri për të gjitha ato që kishte parë e dëgjuar në rrugë e në shkollë, t'u shtronte pyetje vëllezërve, motrave, të atit dhe sidomos dajë Karimanit, i cili e kishte dashur aq shumë.

Pikërisht kureshtja e tillë e tepruar për moshën që kishte pasur, kishte bërë që i ati dhe dajë Karimani të mos flisnin në prani të tij për tema të ndjeshme me karakter politik, sepse duke qenë ai fëmijë mund të fliste jashtë shtëpisë,

dhe kështoj ata mund ta pësonin nga regjimi në fuqi. Kishte qenë kjo arsyeja pse ata derisa kishin biseduar deri natën vonë i kishin thënë Naserit: “Shko tani të flesh se je i vogël, se s’janë këto punë për ty!”, ndërkohë që ai duke qenë tre-katëmbëdhjetë vjeç, tani më ishte rritur e kishte filluar të ndihej i madh.

Por, pikërisht thënia e tillë “shko të flesh se je i vogël”, atë e kishte bërë edhe më shumë kureshtar. Ishte shtirë në shtrat dhe duke u bërë sikur e kishte zënë gjumi, i kishte dëgjuar kështoj të gjitha ato që kishin thënë i ati dhe dajë Karimani.

### ■ Teoria e „tre fiseve!“

Ato që e kishin provokuar më së shumti mendjen e njomë dhe kureshtare të filloristit Naser Hani, kishin qenë dallimet e shumta midis njerëzish në bazë gjuhësh, veshjesh, detyrash, profesioneesh, religjioneesh, traditash dhe sjelljesh, të cilat ai i kishte vërejtur sidomos kur kishte shkuar me të atin ditëve të pazarit në qytetin e Strugës.

Duke i vërejtur dallimet e lartpërmendura atij i ishte dukur se dallimi kryesor, që e kishte vënë kufirin midis njerëzve kishte qenë ai gjuhësor. I ishte dukur kështu sepse, derisa njerëzit e njëres gjuhë, p.sh. ata të gjuhës maqedone, kishin jetuar shumë më mirë dhe kishin udhëhequr me gjithçka, njerëzit e gjuhëve të tjera, duke përfshirë këtu edhe ata të gjuhës së tij shqipe, pos që kishin jetuar shumë më keq, edhe s’i kishte pyetur kush për asgjë.

### Duke i perceptuar kombet si fise

Filloristit Naser Hani të gjitha dallimet e tilla midis njerëzish, i ishin përfutur përfundimisht, si dallime midis fisesh, me ç’rast secili fis kishte pasur ato të tijat, që nuk i kishte fisi tjetër.

Por, ajo që s’kishte arritur ta kuptonte kishte qenë pyetja: “Pse njerëzit e njërit fis e të njëres gjuhë i kishin të gjitha të mirat, kurse njerëzit e fiseve dhe të gjuhëve të tjera e kishin pasur çdo gjë me pakicë! “O Zot, po si qenka kjo botë!”, i kishte thënë vetes shumë herë.

Kishin qenë dallimet e tilla midis njerëzish brenda mjedisit të njëjtë jetësor, ato të cilat kishin rezultuar me atë “Teorinë e tre fiseve!”, të cilën ai, duke qenë i mërguar në Austri, na e tregonte duke qeshur me veten e tij.

## ■ Fisi i parë: Posedues pushtetesh dhe parash

### **Pushteti dhe paraja kishin shkuar bashkë**

Filloristi Naser Hani kishte kuptuar me kohë se raportet midis “fisesh”, vareshin kryesisht nga fakti se cili prej tyre kishte qenë posedues pushtetesh dhe parash, cili prej tyre i kishte për vete vetëm mallrat bujqësore e blegtorale, dhe së fundi cili prej tyre ishte vetëm posedues samarësh mbi shpinë!

Analiza e tillë, atij i kishte rezultuar se në Maqedoni posedues pushtetesh dhe parash kishin qenë kryesisht qytetarët e “fisit maqedon”, posedues mallrash bujqësore e blegtorale kishin qenë qytetarët e “fisit shqiptar”, kurse posedues samarësh mbi shpinë kishin qenë qytetarët hamej të “fisit rom”.

Duke i analizuar raportet e tilla midis “fisesh”, ai kishte kuptuar se pushteti dhe paraja kishin shkuar bashkë. Ai që e kishte pasur pushtetin e kishte edhe paranë. Ai që e kishte pasur paranë e kishte edhe pushtetin. Të tillë, me pushtet edhe me para, kishin qenë vetëm “qytetarët e fisit maqedon”, të cilët ai i kishte konsideruar “qytetar të fisit të parë”, kjo edhe për vetë faktin se ata edhe me emërtimin e tyre “maqedonë”, ishin të vetmit që ishin identifikuar me emrin e Maqedonisë.

Nga ana tjetër dallimet midis “fiseve” ishin varur edhe nga mënyra se kush, si e kishte fituar paranë.

Kështu, derisa qytetarët e fisit të parë maqedon, paranë e kishin fituar lehtë e me bollëk, duke punuar kryesisht me rroga mujore nëpër zyra, shkolla, spitale, fabrika, stacione policore e kazerma ushtarake, “qytetarët e fisit të dytë shqiptar”, paranë e kishin fituar me pakicë e me vështirësi të mëdha. Prodhimet e tyre bujqësore dhe blegtorale ishin shitur fare lirë, ndërkohë që ata për t’i fituar ato ishte dashur ta gërryenin tokën deri edhe me thonj. Kështu, qytetarët e fisit të dytë, shqiptarët, me paratë e pakta të fituara nga shitja e prodhimeve të tyre, mezi se kishin mundur të blinin qoftë edhe një palë këpucë ose një këmishë të prodhuara nëpër fabrika, në të cilat kishin punuar me rroga mujore të majme kryesisht qytetarët e fisit të parë maqedon.

Por, edhe më keq se shqiptarët, me paranë e kishin pasur punën “qytetarët e fisit të tretë”, romët e ngratë, të cilët kishin qenë të detyruar të punonin tërë ditën me samare mbi shpinë e me karroca në duar si hamej, për të fituar ndonjë qindarkë sa për t’i ushqyer tufat e kalamajve që kishin pasur.

### **Njerëz zyrash, shkresash, lapsash e letrash**

Naseri i vogël kishte vërejtur që asokohe se qytetarët e fisit të parë maqedon, përveç posedues parash e pushtetesh, kishin qenë edhe njerëz zyrash, shkresash, vulash e letrash!



Ata, në cilësinë e ofiqarëve të kishin bërë dokumente personale e familjare, në cilësinë e mjekëve të kishin bërë receta, në cilësinë e gjykatësve të kishin bërë gjëmën duke të prerë gjoba, në cilësinë e mësuesve të kishin bërë nota, në cilësinë e policëve të kishin dhënë ndonjë shkop gome etj.

Thënë shkurt, Naseri kishte vërejtur se qytetarët e fisit të parë maqedon i kishin pasur të gjitha në duart e tyre të buta, saqë “mos e bëftë Zoti e të ishte zënë me ta...!”.

### **Njerëz uniformash e çizmesh të rënda**

Më tej, filloristi Naser Hani kishte vërejtur se qytetarët e fisit të parë maqedon, kishin qenë të vetmit qytetarë që kishin bartur uniforma. Kjo kishte qenë kështu, sepse vetëm qytetarët e këtij fisi kishin qenë policë ordererë, oficerë doganash dhe oficerë të armatës.

Kështu, qytetarët e fisit maqedon, të mbërthyer në uniforma me shenja të veçanta, dhe të pajisur me revole në brez dhe me çizme të rënda, kishin ecur “kapedançe” duke rrapëlluar mbi rrugët e kalldrëmta të Strugës. Ata, kështu sikur kishin dashur t’u tregonin qytetarëve të fiseve tjera, se ata ishin të zotët e vendit, se ata kishin mundësi që secilin prej tyre ta vinin nën pranga, ta syrgjynosnin burgjeve, dhe bile edhe t’ia këpusnin kokën pa i dhënë askujt asnjë llogari!

Kështu, Naserit i ishte dukur se asokohe në Maqedoni, menjëherë pas Zotit të Madh në qiell, kishin qenë “zotat e vegjël” në tokë, të veshur me uniforma, të cilëve njeriu ishte dashur t’u drejtohej çuditërisht vetëm me “shokë!”

### **Njerëz gazmorë të veshur „allafrënga!“**

Qytetarët e fisit të parë maqedon, ndonëse në raport me qytetarët e fiseve të tjera, ishin sjellë me mosdashje, refuzim dhe shpërfillje, midis tyre ishin sjellë krejtësisht ndryshe. Përgjatë rrugës qendrore të Strugës kishin qeshur e kishin folur dhe kishin bërë shaka me njëri-tjetrin.

Burrat ishin parë të veshur “allafrënga” me rroba kate e me kravata, me fytyra të rruara e me këmbës të bardha. Gratë dhe vajzat e tyre ishin parë po ashtu të veshura “allafrënga”. Ato ishin parë, sidomos verave të nxehta, me funde e dekolte të holla, nën petët e të cilave u ishin dukur edhe “mishtë e bardhë!”. Duke ecur rrugëve të kalldrëmta plot gaz e hare, ato kishin bërë që të gumëzhinte e tërë Struga, sa nga taka-tukat e këpucëve të tyre me taka të larta, aq edhe nga ato “taka-vakat” e të folurës së tyre melodioze në gjuhën maqedone.

Por, fare pranë zotërinjve, zonjave dhe zonjushave të fisit të parë maqedon, nëpër të njëjtat rrugë të qytetit kishin ecur kryesisht të heshtur e të zymtë qytetarët e fiseve dhe të gjuhëve të tjera, të cilët, jo vetëm se ishin veshur

dosido, por edhe nga gojët e tyre të shkrumbuara, më shumë se fjalë, kishin nxjerrë gjëmë e ofshama, sikur ata t'i kishin ardhur kësaj bote me zor!

Kishin qenë jetët e tilla të privilegjuara të qytetarëve të fisit të parë maqedon, ato të cilat asokohe ishin admiruar aq shumë nga jetë-shkretët e fiseve të tjera, sa që atyre s'u kishte mbetur tjetër veçse që t'i drejtoheshin të madhit Zot, duke i thënë: “O Zot, kur na bëre pse s'na hodhe edhe neve në “kopenë” e tyre!”.

## **Pamja e fytyrave dhe e duarve**

Por në Maqedoni edhe pamja e fytyrave dhe e duarve kishin folur shumë se kush cilit fis i kishte takuar, se kush sa pushtet e dinjitet kishte pasur.

Kështu, derisa qytetarët e fisit të parë maqedon kishin rrezatuar gëzim dhe hare me fytyrat e tyre të pispillosura e të parfumosura, qytetarët e fiseve të tjera dhe, në veçanti, ata të fisit shqiptar, kishin reflektuar vuajtje dhe gjëmë me fytyrat e tyre të vërenjëtura dhe të parruara...

Nga ana tjetër, në Maqedoninë e atyre kohëve edhe pamjet e duarve kishin folur se kush çka kishte qenë. Sa më duarbutë që kishte qenë, aq më shumë pushtet e dinjitet kishte pasur në atë vend, siç kishte qenë rasti me qytetarët e fisit të parë, dhe e kundërta, sa më shumë kallo të kishte pasur në duar, aq më pak pushtet e dinjitet do të kishte pasur në atë vend, siç kishte qenë rasti me qytetarët e fisit të dytë, shqiptarët dhe qytetarët e fiseve tjera.

Kështu, derisa në duart e buta si simite të qytetarëve maqedonë ishin përqendruar pushteti, shteti dhe paraja, në duart plot kallo të qytetarëve shqiptarë, jo vetëm që s'kishte pasur shtet e pushtet, por kishin qenë pikërisht shteti dhe pushteti që ata i kishte urreyer, përndjekur, torturuar dhe burgosur për hiçgjë.

Duke e lidhur kësisoj gjendjen e vështirë të shqiptarëve me kallot e duarve, Naseri i mërguar në Austri do të tallej duke thënë: “E po mos të thotë kush se fatet e njerëzve nuk mund të lexohen në shuplakat e duarve...!”.

## **Fëmija sundimtar!**

Ajo që i kishte mbetur në kujtesë Naserit nga vitet e fëmijërisë tij, kishte qenë portreti donkishotesk i “fëmijës sundimtar!”. Portreti i tillë kishte të bënte me faktin se dallimet midis të rriturve të fiseve të ndryshme ishin bartur edhe te fëmijët e tyre.

Kështu, kishte qenë vetë pozita shoqërore dhe baza materiale më e mirë e prindërve maqedonë, që kishin krijuar te fëmijët e tyre njëfarë mendjemadhësie e mburraveclëku qesharak. Një pjesë e fëmijëve të tillë maqedonë, duke i imituar prindërit e tyre pushtetarë dhe antishqiptarë, ishin sjellë nëpër shkolla ndaj fëmijëve shqiptarë si “sundimtarë të vegjël!"; i kishin ngacmuar, përtallur

dhe urdhëruar ata, si dhe u ishin drejtuar me nofkën “shiftarqino!” etj.

Nga ana tjetër, edhe pozita shoqërore dhe baza materiale e spostuar e prindërve shqiptarë ishte reflektuar të fëmijët e tyre. Kësisoj, fëmijët shqiptarë, duke qenë të veshur e të mbathur dosido, duke pasur çanta të qepura me gjilpërë nga nënat e tyre, dhe duke pasur më pak libra, fletore dhe lapsa, ishin ndierë inferiorë kundruall bashkëmoshatarëve të tyre maqedonë.

## ■ Fisi i dytë: Mezi kishte mbijetuar me bujqësi, blegtori e kurbet

### Duke u marrë me qe, dhënë e dhi nëpër Maqedoni

Menjëherë pas qytetarëve të fisit të parë maqedon në mendësinë e filloristit Naser Hani kishin zënë vend qytetarët e fisit të dytë, shqiptarët, të cilëve u kishte takuar edhe vetë.

Qytetarët e fisit të dytë, për dallim nga ata të fisit të parë, jo vetëm që s'kishin qenë njerëz zyrash, shkresash, vulash e letrash, por kishin qenë në masë të madhe edhe analfabetë e gjysmanalfabetë, të cilët duke e gërryer tokën me mjete primitive për bukën e gojës, duke u marrë me bujqësi, blegtori, me qe, dhënë e dhi nëpër Maqedoni, si dhe duke bërë punë nga më të rëndat gjithandej Jugosllavisë, mezi se kishin mbijetuar.

Kishte qenë mbijetesa ajo që kishte bërë që fëmijët e fisit të dytë shqiptar, në kohën kur ishte dashur që t'i ndiqnin mësimet nëpër shkolla, kishin qenë të detyruar që ta ruanin bagëtinë bjeshkëve e fushave. Kishin qenë këto arsye pse një pjesë e tyre kishin munguar nëpër shkolla, kishin mësuar pak e aspak, duke u bërë gjysmanalfabetë.

### Edhe kush kishte bërë pjesë brenda fisit të dytë

Filloristi Naser Hani, brenda fisit të dytë shqiptar i kishte renditur asokohe edhe disa fise të tjera të vogla, siç kishin qenë: turqit, myslimanët, goranët e torbeshët. I ati i kishte thënë se edhe ata deri para 70-të apo 80-të vjetësh kishin qenë të fisit shqiptar, por me kohë vendin e gjuhës shqipe te një pjesë e tyre e kishte zënë turqishtja e te pjesa tjetër maqedonishtja, sepse ashtu e kishte dashur politika!

Por, Naser Hani i kishte renditur asokohe qytetarët e fiseve të lartpërmendura brenda fisit të dytë shqiptar, jo aq shumë për shkak të prejardhjes së tyre shqiptare, të cilën ai as që e kishte kuptuar tamam, por kryesisht për shkak të veshjeve, traditave e sjelljeve të tyre të njëjta apo të përafërta me ato të shqiptarëve.

## Në kthetrat e mbijetesës

Kishin qenë kthetrat e mbijetesës ato të cilat qytetarëve të fisit të dytë shqiptar u kishin dhënë pamje të jashtme dhe sjellje të veçanta. Kishin qenë ecjet e burrave shqiptarë si nëpër dallgë e stuhi, si dhe fytyrat e tyre të ngrysur, ato që kishin bërë që ata të dukeshin të ashpër dhe agresivë. Kishin qenë gjendjet me mllafe e me strese, ato, të cilat ata, duke mos i zbrazur mbi pushtetarët maqedonë, i kishin zbrazur midis tyre, duke u zënë me njëri-tjetrin për hiçgjë.

Për të gjitha këto Naseri thoshte se “njeriun nuk e ndryshon asgjë më shumë se mbijetesa!”.

## Të veshur „allashqiptarçe!”

Por, përveç ndryshimeve të imponuara nga mbijetesa, shqiptarët ishin dukur të veçantë edhe për shkak të veshjes së tyre tradicionale „allashqiptarçe!”.

Kështu, shumica e burrave shqiptarë dhe e burrave të fiseve të ngjashme me ta, kishin bartur asokohe qeleshe të bardha në kokë dhe ishin veshur me guna e tirq të leshtë. Shumica e grave dhe e vajzave shqiptare kishin bartur xhubleta tradicionale plot ngjyra dhe zbukurime.

Por, veshja e këtillë tradicionale e shqiptarëve më shumë se me traditën, kishte të bënte asokohe me koston e saj më të lirë. Kështu, qytetarët fisit të dytë, shqiptarët, së pakut veshjen e tyre tradicionale duke e prodhuar vetë, s’e kishin blerë nëpër dyqane me kosto të shtrenjtë.

Kishte qenë veshja e tillë tradicionale e shqiptarëve, ajo që ishte përqeshur jo rrallëherë nga një pjesë e qytetarëve të fisit të parë maqedon.

## Të urryer skajshmërisht

Por, ajo që e kishte provokuar më së shumti filloristin Naser Hani, kishte qenë urrejtja e fisit të tij nga ana e fisit të parë maqedon.

Kishte qenë ajo një mosdashje dhe urrejtje aq e egër, aq e dukshme, aq e përditshme dhe aq e rutinuar, sa që Naserit i ishte dukur sikur qytetarët e fisit të tij edhe në këtë botë s’kishin ardhur për asgjë tjetër, veçse për të qenë të urryer nga qytetarët pushtetarë të fisit tjetër!

Natyrisht se për moshën që kishte, ai s’e kishte pasur të qartë, përse gjithë ajo urrejtje ndaj fisit të tij, ç’faj kishte bërë fisi i tij për të qenë i urryer skajshmërisht!

Kështu, vetëm më vonë, kur ishte rritur, ai e kishte kuptuar pse shqiptarët ishin urryer aq shumë nga pushtetarët maqedonë.

Kishte qenë urrejtja e tillë e cila kishte bërë që pleqtë shqiptarë të lodhur nga hallet e jetës të ishin shprehur se: “Ne shqiptarët jemi popull i nëmur!”. “Po kush i paska namur kaq shumë shqiptarët!”, e kishte pyetur veten shumë herë Naseri i vogël!

## **Të akuzuar e të torturuar**

Nga ana tjetër pikërisht gjatë viteve të fëmijërisë së Naserit, shqiptarët në Maqedoni ishin akuzuar e torturuar për shumëçka.

Menjëherë pas LDB-së policia maqedone u kishte kërkuar atyre për rezervat e shtetit drithë e mish (kafshë për mish) më shumë seç ata kishin pasur realisht. Për t'i plotësuar nevojat e shtetit ata ishte dashur të vuanin urie. Shqiptarët për një fjalë goje ishin vlerësuar si armiq të shtetit, ishin marrë në pyetje dhe ishin torturuar nga organet përndjekëse. Vetëm më vonë ai e kishte kuptuar se akuzat dhe torturat e tilla kishin pasur si qëllim të fundit shpërnguljen e shqiptarëve nga Maqedonia.

Duke dëgjuar për skena të tilla të trishta, Naseri i kishte thënë vetes shpeshherë: “Po sa taksirat paska qenë me lindë shqiptar!”.

## **Duke bërë kurbet gjithandej Jugosllavisë**

Kishte qenë mbijetesa ajo që kishte bërë që dhjetëra mijëra shqiptarë nga Maqedonia, për t'i mbajtur familjet e tyre me bukë e me kripë, të bënin kurbet gjithandej Jugosllavisë, kuptohet duke bërë punë fizike nga më të rëndat, të cilat pjesëtarët e kombeve të tjera i bënin pak e hiç.

Kështu, minierat jugosllave ishin mbushur asokohe me shqiptarë. E njëjta gjë kishte vlejtur edhe për resorin e ndërtimtarisë, për resorin e hapjes dhe të ndërtimit të rrugëve dhe të hekurudhave gjithandej vendit.

Kësisoj, të gjitha punët e rënda nëpër qytetet kryesore jugosllave, siç kishte qenë Beogradi, Zagrebi, Sarajeva, Lubjana, Titogradi, Novisadi dhe qytete të tjera, ishin bërë nga “gladiatorët” shqiptarë.

Punët e tilla të rënda për shqiptarët kishin paraqitur “fronte të vërteta lufte”, jo vetëm për të mbijetuar, por edhe për të mos u shpërngulur pothuajse të gjithë, asokohe, në Republikën e Turqisë.

## **Duke ikur për në Turqi**

Kishin qenë dhuna etnike dhe mbijetesa ato të cilat kishin bërë që midis viteve të '50 dhe të '60 të shekullit të njëzetë, dhjetëra mijëra shqiptarë për të shpëtuar nga ferri dhe tmerri me emrin Maqedoni, të ishin vendosur në Turqi, ku banorët vendës i kishin përtallur duke i quajtur “arnaut<sup>1</sup> bozaxhi<sup>2</sup>”, siç ishte quajtur edhe një këngë popullore e bërë asokohe për shqiptarët në Turqi.

Skenat tragjike të ndarjes së familjeve shqiptare nga të afërmit e tyre me rastin e shpërnguljes për në Turqi, për cilat Naseri kishte dëgjuar nga të tjerët,

---

<sup>1</sup> Arnaut - emërtim në gjuhën turke për shqiptarët

<sup>2</sup> Bozaxhi - sipas pjesë së njohur si “bozë” të cilën e kanë prodhuar fillimisht shqiptarët.

i kishin mbetur atij në kujtesë përgjithnjë. Ishte ndarë vëllai prej vëllait, motra prej motrës, miku prej mikut, shoku prej shokut, shpirti prej tokës!

### **Një grusht shqiptarësh të punësuar**

Naseri gjatë kohës sa kishte qenë fillorist kishte vërejtur se pushtetarët maqedonë kishin punësuar një grusht të vogël shqiptarësh, si mësues, nëpunës të gjendjes civile, roje pylli, tagrambledhës, pastrues shkollash e spitalesh.

Por, derisa një pjesë e të punësuarve të tillë shqiptarë ishin përpjekur t'i ndihmonin shqiptarët, një pjesë tjetër e tyre as që kishin dashur të dinin se ishin shqiptarë. Këta të fundit, njësoj si edhe nëpunësit maqedonë, duke u nxjerrë qëllimisht telashe palëve shqiptare, i kishin detyruar ato që t'u jepnin ryshfete.

## **■ Fisi i tretë: Përtej mbijetesës me shkopin e lypësisë në dorë**

### **Të lënë në mëshirën e fatit**

Fare në fund të tabelës së filloristit Naser Hani ishin renditur “qytetarët e fisit të tretë” të përkatësisë rome, të cilët maqedonët i quanin „ciganite“, kurse shqiptarët „gjiptër“.

Derisa maqedonët kishin jetuar e shqiptarët kishin mbijetuar, romët e gJORë me samare mbi shpinë e me shkopin e lypësisë në dorë, mezi se kishin tejmbijetuar. Të lënë në mëshirën e fatit, shumica e romëve as lindjet e as vdekjet e tyre s'i kishin regjistruar, s'kishin pasur, madje as dokumente identifikimi. Fëmijët e romëve s'i kishin ndjekur as shkollat fillore. Të gjithë romët kishin qenë analfabetë dhe të varfër skajshmërisht.

Pushtetarët maqedonë kishin dashur që duke i lënë romët pa asnjë përkujdesje brenda jetës së tyre mizerabël, ata të iknin nga Maqedonia e të vendoseshin në pjesë të tjera të Jugosllavisë.

Kështu, përveç Zotit në qiell dhe lëmoshëdhënësve në tokë, me romët askush tjetër s'ishte marrë.

### **Pa shtëpi, pa varre e pa katandi**

Por, Naserit i kishte bërë përshtypje sidomos pjesa nomade e fisit të romëve. Ata, jo vetëm që nuk kishin vendbanime të caktuara, shtëpi e katandi, por siç ishte thënë, s'kishin pasur as edhe varre të caktuara, sepse i kishin varrosur të dashurit e tyre kudo që i kishte gjetur vdekja.

Romet nomadë pasurinë e vetme që kishin pasur asokohe kishin qenë tufat e kalamajve, një tendë fushore, një qerre e drunjte, një arushë e vogël me hallkë

në hundë, dhe një kalë të bërë kockë e lëkurë!

### **Duke fushuar plot gaz e hare**

Naserit dhe fëmijëve tjerë të fshatit u kishin sjellë aq shumë gëzim e hare sidomos fushimet e romëve nomadë buzë liqenit të Strugës ose buzë brigjeve të Drinit të Zi, si gjatë pranverave të hershme, ashtu edhe gjatë vjeshtave të vona, kur ishin mbledhur bereqetet. Kishin qenë fëmijët barkcullakë të romëve nomadë, të cilët duke lozur shpatijeve e brigjeve të lumenjve ishin dukur sikur të kishin qenë fëmijët më të lumtur në botë, kishte qenë qerrja e drunjtë e romëve e mbuluar me mushama, arusha e vogël e lidhur me kapistall, si dhe kali i bërë kockë e lëkurë duke kullotur në një pllajë, ato që Naserit i kishin bërë përshtypje të veçantë.

Ai, si edhe shumë fëmijë të tjerë, ishin kënaqur sidomos, duke e shikuar arushën e vogël, e cila duke u ngritur vertikalisht në këmbët e saj të pasme, kishte kërcyer me takt derisa gratë rome u kishin rënë defeve. Kishte qenë ai një cirk aq i natyrshëm që ishte dhënë asokohe edhe nëpër rrugicat e Veleshtës.

Në të vërtetë fushimet e tilla të romëve nomadë kishin të bënin me sigurimin e ekzistencës së tyre të vështirë.

Kështu, derisa burrat nomadë kishin fituar ndonjë qindarkë duke i kallajisur enët nëpër familjet shqiptare, gratë nomade kishin fituar po ashtu ndonjë qindarkë, ose ndonjë strajcë me grurë apo me miell, duke ua lexuar grave shqiptare fatet apo mosfatet në shuplakat e duarve.

Kishte qenë vetë buka, që romët nomadë e kishin fituar kryesisht nga shqiptarët, ajo që kishte bërë që ata ta kishin folur gjuhën shqipe ashtu çuditshëm, duke i dhënë asaj theksin e gjuhës së tyre.

Pas ndonjë jave fushimi në brigjet e liqenit apo në brigjet e Drinit të Zi, duke fituar ndonjë qindarkë ose ndonjë thes me grurë apo me misër, romët nomadë ishin zhdukur papritmas në drejtime të panjohura, duke lënë pas vetës mungesën e tyre, sidomos në mesin e fëmijëve, që ishin mësuar me ta.

### **Me samare mbi shpinë!**

Nga ana tjetër, kishin qenë romët urbanë, të cilët për dallim nga vëllezërit e tyre nomadë, kishin ca shtëpi-kasolle diku në periferi të Strugës, ashtu të ndërtuara me qerpiçë dhe të mbuluara pjesërisht me kartuça e pjesërisht me llamarinë.

Duke qenë shumica e tyre hamej, ata, me samare e barra të rënda mbi shpinë, ose me karroca të ngarkuara në duar, ishin endur tërë ditën rrugëve të kalldrëmta të qytetit të Strugës për të fituar ndonjë qindarkë, kryesisht nga qytetarët e fisit maqedon, të cilët duke qenë të kamur i kishin angazhuar ata që

t'ua bartnin plaçkat e blera nëpër shitore, t'ua çanin e sharronin drutë e dimrit, t'ua hapnin ndonjë kanal, t'ua rregullonin oborret e shtëpive etj.

Meqë romët urbanë e kishin fituar bukën e tyre kryesisht nga qytetarët maqedonë, kjo kishte bërë që pjesa e madhe e tyre ta kishte folur gjuhën maqedone, kuptohet duke i dhënë asaj theksin e gjuhës së tyre.

## **Me shkopin e lypësisë në dorë!**

Por, kur romëve urbanë dhe nomadë u ishin sosur rezervat ushqimore, siç kishte ndodhur zakonisht në stinën e dimrit, ata ishin të detyruar që ta ushtronin zanatin e lypësisë me shkop në dorë!

Zanatin e lypësisë e kishin ushtruar sidomos gratë rome, të cilat edhe në ditët më të acarta të dimrit me ngrica e borë, ishin detyruar që të shkonin nga fshati në fshat e nga dera në derë, duke kërkuar lëmoshë, në radhë të parë, ndonjë copë bukë sa për të mos u vdekur nga uria kalamajtë e shumtë.

Aq shumë thënie lutëse, prekëse dhe uruese, kishin ditur të thurnin ato gra për lëmoshëdhënësit e tyre të mundshëm, sa që ato ishin dukur si poetesha e prozatore të fateve të tyre tragjike! Arti i tillë i trishtë s'kishte qenë tjetër veçse fjalori i tyre tragjik, të cilin ato e kishin ritualizuar për t'i prekur shpirtrat e të kamurve, që ata t'ua falnin ndonjë qindarkë, ndonjë rrobë trupi, apo ndonjë copë bukë të thatë.

Duke pasur parasysh se familjet shqiptare të shumtën e herëve s'i kishin kthyer me duar bosh nga dyert e tyre lypsaret rome, kjo kishte bërë që për këto skamnore familjet shqiptare të paraqitnin asokohe shpresën e fundit për t'i kapërcyer dimrat e ftohtë pa vdekur urie.

## **■ Rituali i pritjes para zyrave**

### **Me gishtin e bërë nyjë e me veshët e bërë curril!**

Edhe rituali tragjikomik i pritjeve të gjata të palëve jomaqedone, dhe sidomos të palëve shqiptare, para dyerve të zyrave në të cilat kishin punuar atëherë kryesisht nëpunësit maqedonë, Naserit i kishte mbetur si një kujtim tjetër i hidhur nga fëmijëria e tij.

Deri në vitet e '60 e të '70 të shekullit të njëzetë, palët shqiptare për ta marrë qoftë edhe një dokument të thjeshtë personal, familjar apo pronësor, ishte dashur që të prisnin para dyerve të zyrave “me gishtin tregues të bërë nyjë dhe me veshët e bërë curril!”.

Me gishtin e bërë nyjë, sepse palët shqiptare duke i njohur reagimet e egra



dhe refuzuese të nëpunësve maqedonë, para se të trokisnin në dyert e zyrave ishin hamendësuar një kohë derisa e merrnin guximin për të trokitur.

Dhe me veshët e bërë curril, sepse pasi që ata kishin trokitur në dyert e zyrave, ishin munduar që të dëgjonin sa më mirë, nëse atyre nëpunësit maqedonë u kishin thënë ose jo “hyr!”

Në të vërtetë, nëpunësit maqedonë, duke e ditur se palët që kishin trokitur kujdesshëm në dyert e zyrave të tyre ishin palë shqiptare, ata me t'i dëgjuar trokitjet e tyre, ose kishin heshtur për një kohë pa thënë asgjë, ose edhe kur kishin thënë “hyr”, këtë e kishin bërë qëllimisht më zë ulët që palët shqiptare t'i vinin në dilemë, nëse e kishin dëgjuar ose jo këtë urdhër!

Kur palët shqiptare e kishin dëgjuar urdhrin “hyr”, të thënë me zë të ulët, ato ishin hamendësuar nëse këtë urdhër vërtet e kishin dëgjuar apo u kishin bërë veshët. Nëpunësit maqedonë, duke e ditur pikërisht mëdyshjen e tillë, me të hyrë palët shqiptare në zyra u kishin thënë atyre, “kthehuni prapë, kush u tha që të hyni brenda!” Me këtë rast palët shqiptare sërish e kishin bërë gishtin tregues një për të trokitur në dyert e zyrave për herë të dytë, dhe sërish i kishin bërë veshët curril për ta dëgjuar më mirë urdhrin “hyr”.

### **“Hiqe kësulën, o plakush!”**

Shqiptarët me të hyrë në zyrat e pushtetarëve maqedonë ishte dashur të bënin së pakut dy veprime automatike. E para, t'i përshëndetnin nëpunësit maqedonë në gjuhën e tyre me një **“Dobar den”**, dhe e dyta, t'i hiqnin nga koka kësulat e tyre tradicionale.

Derisa me veprimin e parë ata ishin përpjekur që t'i merrnin me të mirë nëpunësit maqedonë, që ata t'u kryenin atyre punë pa u nxjerrë telashe burokratike, veprimin e dytë, atë të heqjes së kësulave, sipas një rregulle të pashkruar të atyre kohëve e kishin të detyruar, sepse, siç ishte thënë, asokohe, në tërë vendin nuk kishte guxuar askush që të mbante çfarëdo kapele në kokë para fotografisë së shokut Tito, e cila qëndronte varur në murin ballor të secilës zyre. Në të kundërtën, mbajtja e çfarëdo kapele para fotografisë së Titos nëpër zyra, sidomos kur në Maqedoni e kishin bërë shqiptarët, nga nëpunësit maqedonë ishte interpretuar si një mosdashje dhe mospërfillje e tyre ndaj figurës së Titos, dhe për rrjedhojë këto palë ata i nxirrnin jashtë zyrave duke i sharë e fyer.

Por, derisa të rinjtë dhe të rriturit zbatimin e veprimeve të tilla se kishin harruar asnjëherë, kishin qenë pleqtë e lodhur e të hutuar shqiptarë, të cilët nga lodhja e hutia kishin harruar t'i hiqnin nga koka kësulat e tyre të bardha kur ishin futur nëpër zyra. Kishin qenë harresat e tilla ato të cilat ishin bërë shkas që

nëpunësit maqedonë të grindeshin me ata pleqë shqiptarë, duke u thënë: **“Ama skinji kapa starçe!”**, që do të thoshte “Ama, hiqe kësulën plakush!”. Kishte qenë vërejtja e tillë e nëpunësve maqedonë, që si një pickim gjarpri, kishte bërë që pleqtë e ngratë t’i hiqnin nga koka kësulat e tyre me shpejtësi të madhe, dhe duke i bërë grumbulluq kishin futur nëpër xhepa.

### **“Ik, mbeturinë, se do ta thërras policinë!”**

Por edhe kur palët shqiptare ishin futur nëpër zyra duke i zbatuar të dy veprimet e përmendura më lartë, një pjesë e nëpunësve maqedonë i kishin provokuar sërish me sjellje indiferente, mosdashëse e refuzuese.

Kështu, ata, jo vetëm që nuk ua kishin kthyer përshëndetjen me **“Dobar den”** palëve shqiptare, por duke i mbajtur sytë ashtu kot mbi shkresat e shumta mbi tavolinë, kishin heshtur për një kohë pa u thënë atyre qoftë edhe një fjalë! Dhe vetëm pas disa minutash, duke i ngritur sytë ashtu si me përtesë nga “punët e shumta”, u ishin drejtuar palëve shqiptare papritmas duke thënë: **“A shto sakash!”**, që do të thoshte “E po çfarë do!”, pyetje kjo e cila për nga toni dhe mënyra se si ishte thënë, nuk kishte tingëlluar ndryshe veçse si: “Për ç’dreq më ke ardhur këtu!”. Dhe, ende për pa e treguar tamam pala shqiptare se çfarë kishte dashur, nëpunësi maqedon i ishte drejtuar asaj sërish me mospërfillje duke i thënë: **“A shto zboruvash çoveqe, ja te ne razbiram!”**, që do të thoshte: “Po çfarë thua, o njeri, unë s’po të marr vesh!”, gjë që nuk kishte tingëlluar ndryshe veçse si një: “Ik e mos më çaj by..., se unë as që dua të të shohë me sy!”.

Kur palët shqiptare e kishin ngritur zërin kundër sjelljeve të tilla, nëpunësit maqedonë, pa një e pa dy, i kishin kërcënuar duke u thënë: **“Begaj xhubre, shiftarqino, qe go vikam milicijata!”**, që do të thoshte: “Ik plehurinë, shiftarëqinë, se do ta thërras policinë!”. Dhe kur ishte përmendur policia, atëherë gjithçka kishte marrë fund, sepse palët shqiptare përveçse u ishin frikësuar ndëshkimeve policore, ato edhe e kishin kuptuar për të kryer punë ishte dashur që nëpunësve maqedonë t’u jepnin ryshfete.

Por, edhe për të dhënë ryshfete palët shqiptare s’e kishin pasur të lehtë, sepse nëpunësit maqedonë tentimet e tyre për të dhënë ryshfete, fare lehtë kishin mundur t’ua kthenin në vepra penale të dënueshme. Për të mos ndodhur kjo, palët shqiptare ishin detyruar, që nëpunësve maqedonë t’u jepnin ryshfete me dorëzani, përkatësisht nëpërmjet të shokëve dhe miqve të tyre të ngushtë.

### **Me “thirrje urgjente të besueshmërisë së lartë” në dorë**

Por rituali i pritjes së palëve shqiptare para zyrave ishte edhe më tragjikomik, kur shqiptarët me thirrje të titulluara si „urgjente“ dhe të „besueshmërisë së lartë“ në

dorë, duhej të paraqiteshin në zyrat e Sekretariatit të Punëve të Brendshme (SPB-së<sup>3</sup>) të Strugës, përkatësisht në zyrat e Sigurimit të Brendshëm të Shtetit (UDB-së).

Pritja para zyrave të UDB-së për palët shqiptare nuk ishte tragjike, vetëm pse dyert e zyrave të tilla, duke qenë veshura nga jashtë e nga brenda me njëfarë meshini të kuq e të butë, kishin bërë që si trokitjet e tyre nga jashtë, ashtu edhe urdhri “hyr”, i dhënë nga brenda, ishin dëgjuar pak, por edhe pse shqiptarët në ato zyra nuk ishin ftuar për probleme dosido, por ishin thirr për probleme me prapaskena të rrezikshme.

Prapaskenat e tilla të rrezikshme të sigurimit të shtetit, duke filluar që nga e ashtuquajtura Luftë Nacional-Çlirimtare e Jugosllavisë midis viteve 1940-1945 e deri në vitet e '70 të shekullit të kaluar, për shqiptarët kishin kundërmuar frikë, shantazh, kërcënim, përndjekje dhe dënim. Kundërmimet e tilla kishin bërë që shqiptarët sa herë që kishin marrë thirrje “urgjente” të “besueshmërisë së lartë”, s'kishin mundur të flenë për net të tëra!

Në të vërtetë, prapa thirrjeve të tilla të “besueshmërisë së lartë”, kishte qëndruar vetë pabesia e shtetit dhe intrigat e tij ndaj shqiptarëve. Shteti kishte mundur asokohe t'i akuzonte shqiptarët rrejshëm, sikur ata kishin bërë këtë apo atë gjë kundër tij, t'i etiketonte si armiq dhe për rrjedhojë t'i torturonte, hetonte, burgoste dhe po të donte edhe t'i vriste pa bërë asnjë faj.

Në raste të veçanta sigurimi i shtetit, duke i shantazhuar shqiptarët nëpërmjet të ndonjë gabimi, të cilin ai sigurim ua kishte montuar vetë, i kishte detyruar që të punonin kundër popullit të tyre në Maqedoni dhe kundër vendit të tyre amë, Shqipërisë.

## “Kuti tjetër” i ritualit me palët maqedone

Por, nëpunësit maqedonë kësisoj ishin sjellë me palët shqiptare dhe jo me palët maqedone, të cilat duke i konsideruar për të “vetat” i kishin trajtuar krejtësisht ndryshe.

---

<sup>3</sup> **SPB- Sekretariati i Punëve të Brendshme** i pranishëm në çdo komunë të ish-Jugosllavisë. SPB-ët komunale kanë qenë të vendosura kryesisht në ndërtesa trekatëshe, kurse në afërsi të tyre kanë qenë gjykatat dhe burgjet komunale. Në katin e parë të ndërtesave të **SPB-së** kanë qenë **zyrat e administrates**, të dedikuara për lëshimin e letërnjoftimeve dhe të pasaportave të qytetarëve; në katin e dytë kanë qenë **zyrat e policisë ordinere**, të dedikuara për ndjekjen e kimit ordiner, kurse në katin e tretë kanë qenë **zyrat e UDB-së, përkatësisht zyrat e Sigurimit të Brendshëm të Shtetit**, të dedikuara për përndjekje të kimit të organizuar dhe për përndjekje politike të kundërshtarëve të regjimit, dhe zyrat e **“Mbrotjes Popullore”**, të dedikuara për organizimin e mbrotjes territoriale, për rekrutimin e ushtarëve të rinj dhe për përpilimin e karakteristikave të tyre politike.

Në nivel të Jugosllavisë ka ekzistuar **Sekretariati Federativ i Punëve të Brendshme**, në nivel të republikave kanë ekzistuar **Sekretariatet Republikane të Punëve të Brendshme**, kurse në nivel të krahinave kanë ekzistuar **Sekretariatet Krahinore të Punëve të Brendshme** për Kosovën dhe Vojvodinën.

Kështu, palët maqedone jo vetëm që nuk kishin pritur para dyerve të zyrave, por ato ishin futur nëpër zyra si në shtëpi të vet.

Ndonëse heqja e kapelës me rastin e hyrjes nëpër zyra kishte qenë e detyrueshme për të gjithë, nëpunësit maqedonë nuk kishin reaguar ashpër kur këtë kusht se kishin plotësuar palët maqedone. Asnjë grindje e këtyre nëpunësve me palët maqedone s' ishte dëgjuar ndonjëherë. Përkundrazi, midis tyre dhe palëve maqedone ishin dëgjuar vetëm përshëndetje takuese “Zdravo, Zdravo!”, që do të thoshte: “Shëndet, Shëndet!”, dhe përshëndetje lamtumirëse “Dovigjenja, Dovigjenja!”, që do të thoshte: “Mirupafshim, Mirupafshim!”

Kishte qenë ky “kuti tjetër” i ritualit, që nëpunësit maqedonë e kishin përdorur për t'i favorizuar qytetarët e etnisë së vet.

### **III. Naser Hani gjatë viteve të gjimnazit**

#### **■ Duke ia kërkuar jetës kuptimësinë**

##### **Djaloshi shtatrritur e zeshkan**

Në vjeshtë të vitit 1973 Naser Hani kishte qenë në bankat e gjimnazit të Strugës. Përgjatë katër vjetëve të gjimnazit ai kishte marrë pamjen e një djaloshi shtatrritur e zeshkan, me natyrë të gjallë të mbarsur me gëzim e hare.

Mbrëmjeve bënte shëtitje me shokët e tij përgjatë rrugëve të kalldrërta të Strugës, ulej me ta në ndonjë lokal për të pirë diçka, për të biseduar e bërë shaka. Të shtunave e të dielave kishte luajtur futboll. Gjatë pushimeve të verës shpesh notonte duke u larë në liqe.

Duke qenë i lëvizshëm dhe komunikativ shihej gjithkund e gjithkah. Vëllai më i madh, Vibari, e merrte herë-herë për ndonjë ditë në Prishtinë. Kur kthehej në Strugë, ai u tregonte plot entuziazëm shokëve e shoqeve të klasës se çfarë kishte parë e përjetuar në Kosovë dhe sa mirë ishte të jesh student në Prishtinë.

E tillë, e gëzuar dhe e hareshme, kishte qenë asokohe pamja e jashtme e Naserit, por “pamja e brendshme” e tij kishte qenë ndryshe. Ajo kishte treguar se ai, si edhe shumë të tjerë, do t'i kundërviheshin realitetit të hidhur për shqiptarët gjithandej, e sidomos në Maqedoni.

##### **Duke e përpunuar teorinë e “tre fiseve”**

Meqë, vitet e gjimnazit kishin rezultuar me pjekuri të mëtejme të Naserit, ai, teorinë e tij fëmijërore të „tre fiseve“ tani e kishte interpretuar ndryshe, si “teori të shtypjes etnike”, që pushtetarët maqedonë e kishin ushtruar ndaj qytetarëve të tjerë, në radhë të parë ndaj shqiptarëve.

Edhe në aspektin emërtues ai teorinë e tij e kishte veshur me terminologji përkatëse. Kështu, shprehjen „fis“ tani e kishte zëvendësuar me shprehjen etni,

komb; shprehjen „dallime midis fisesh”, e kishte zëvendësuar me shprehjen “dallime ndëretnike”; shprehjen “urrejtje e pushtetarëve ndaj fiseve tjera”, e kishte zëvendësuar me shprehjen “urrejtje shoviniste e pushtetarëve maqedonë ndaj kombeve të tjera” e kështu me radhë.

Ndonëse, aspekti klasor i konceptit të teorisë së “tre fiseve”, me kalimin e viteve te Naseri kishte ardhur duke u zbehur, kurse ai kombëtar duke u sforcuar, megjithatë, ai, s'kishte hequr dorë edhe nga aspekti klasor, sepse shqiptarët në Maqedoni nuk ishin shtypur vetëm në aspektin kombëtar, por edhe në aspektin shoqëror, duke u trajtuar si qytetar të klasës së dytë.

### **Duke vëzhguar, dëgjuar e lexuar shumëçka**

Duke qenë gjimnazist Naseri kishte shënuar hapa të rinj në formimin e tij njerëzor, kombëtar dhe politik. Kjo ishte arritur duke e vëzhguar ai përditshmërinë me shtypje etnike, si dhe duke dëgjuar për shtypjen etnike të shqiptarëve nga të tjerët, nga vëllezërit e motrat, nga i ati e dajë Karimani, dhe nga ndonjëri prej arsimitarëve të tij etj.

Më tej, në ngritjen e tij kombëtare dhe politike kishte ndikuar edhe dëgjimi i emisioneve të caktuara politiko-historike të emetuara nga Radio-Kukësi dhe Radio-Tirana, dëgjimi i të cilave kishte qenë asokohe i ndaluar për shqiptarët në Jugosllavi dhe sidomos për shqiptarët në Republikën e Maqedonisë.

Duke vëzhguar, dëgjuar e lexuar shumëçka asokohe ishin ngritur kombëtarisht e politikisht shumë nxënës të shkollave të mesme në gjuhën shqipe, jo vetëm në Kosovë ku shqiptarët ishin shumicë dhe gëzonin diçka më shumë të drejta, por edhe në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore ku shqiptarët ishin konsideruar pakicë dhe kishin fare pak të drejta.

### **Duke u vetëdijësuar kombëtarisht**

Naser Hani që si gjimnazist e kishte krijuar njëfarë “relievi” kombëtar gjeografiko-historiko-politik, nëpërmjet të cilit ia kishte sqaruar vetes shumë gjëra: Prej ku e deri ku ishin shtrirë shqiptarët territorialisht deri një shekull më parë; sa shumë ishin rrudhur e copëtuar trojet e tyre tani një shekull më pas; cilat kishin qenë luftërat ballkanike e botërore të njëqind vjetëve të fundit, të cilat fqinjët ballkanikë i kishin shfrytëzuar për t'ua grabitur shqiptarëve mbi dy të tretat e trojeve të tyre; cilat kishin qenë të ashtuquajturat “Konferenca Ndërkombëtare të Paqes”, që i kishin përligjur grabitjet e tilla të trojeve të shqiptarëve; cilat kishin qenë Fuqitë e Mëdha të kohës që e kishin përcaktuar fatin e tillë tragjik të kombit shqiptar; cilat kishin qenë valët e spastrimeve etnike të ushtruara ndaj shqiptarëve në shekullin e fundit; kush i kishte orkestruar e kush i kishte zbatuar spastrimet e

tilla etnike, dhe cilat kishin qenë synimet përfundimtare të tyre etj.

Duke ia sqaruar vetes këto pyetje, ai kishte arritur në disa përfundime: E para, kombit të tij i kishin ardhur të gjitha fatkeqësitë nga padrejtësitë e Fuqive të Mëdha; e dyta, vendet fqinje ballkanike i kishin ndarë midis tyre trojet e shqiptarëve me ndihmën e Fuqive të Mëdha; e treta, shqiptarët ishte dashur që ta shtronin për zgjidhje rishtazi çështjen e tyre kombëtare të pazgjidhur.

## **Gjimnazi si medium propagandues**

Gjimnazi i Strugës kishte qenë asokohe mediumi kryesor ku Naseri i kishte shpalosur ato që kishte mësuar, lexuar, dëgjuar dhe analizuar, lidhur me historinë, padrejtësitë politike dhe vuajtjet e shqiptarëve, si në të kaluarën, ashtu edhe gjatë viteve të '70, kur ai ishte gjimnazist.

Të gjitha këto i kishte biseduar me bashkëmoshatarë të tij, kurse ata bisedat e tilla i kishin bartur spontanisht më tej në rrethe të tjera. Në të vërtetë, kësaj kishte filluar edhe veprimtaria e tij politike në formën e një propagande gojore në mesin e moshatarëve të tij në gjimnazin e Strugës.

Por, me kalimin e kohës Naseri ishte afruar më shumë me disa nga shokët e shoqet e tij, që, ndryshe nga të tjerët, i ishin dukur më të përkushtuar kombëtarisht. Kështu, midis tij dhe shokëve të tillë sikur ishte krijuar njëfarë si “shoqërimi e grupimi politik”.

Në të vërtetë, në sajë të “shoqërimeve politike” midis nxënësish të shkollave të mesme dhe midis studentësh, që në vitet e '70 ishin krijuar “grupime ilegale” pak a shumë të organizuara, që kishin shpërndarë afishe e trakte me përmbajtje politike në Kosovë, Maqedoni e gjithandej.

## **Duke ia gjetur jetës kuptimësinë**

Duke e parë realitetin e hidhur të shqiptarëve në Maqedoni, ku ata as dokumentet personale s'i kishin të shkruara në gjuhën dhe alfabetin e tyre, Naser Hani kishte menduar shpeshherë se ç'kuptim kishte jeta e shqiptarëve brenda këtij vendi me emrin Maqedoni, dhe nëse shqiptari në këtë vend ishte dashur të mjaftohej vetëm me një copë bukë e me një kulm të shtrembër mbi kokë, apo ai duhej të ngritej e të luftonte për barazi e liri!

Duke ia kërkuar jetës kuptimësinë ai e kishte gjetur atë vetëm te lufta për barazi dhe liri! Në të kundërtën, sipas tij, jeta as që ia vlente të jetohej!

## **Fat historik për të gjithë shqiptarët**

Fakti se shumica e të rinjve shqiptarë të viteve të viteve të '70 gjithandej trojeve të tyre etnike, kuptimësinë e jetëve të tyre e kishin gjetur te arsimimi

dhe lufta për liri kombëtare dhe barazi shoqërore, për Naserin s'kishte paraqitur jetët, pos fatit historik për të gjithë shqiptarët në Ballkan.

Naser Hani, kishte qenë vetëm njëri prej atyre mijëra djemve e vajzave të atyre viteve, të cilët duke e ndërjer shtypjen mbi popullin e tyre, duke u arsimuar nëpër shkollë të mesme e deri në Universitetin e Prishtinës, si dhe duke qenë të influencuar nga propaganda kombëtare e shtetit amë, jetëve të tyre ua kishin gjetur kuptimësinë duke i vënë ato në shërbim të çështjes shqiptare.

Për të gjitha këto Naseri ishte ndier me fat që jetonte në vitet e ndryshmeve të mëdha, të ringjalljes së vetëdijes kombëtare në mesin e shqiptarëve, siç kishin qenë vitet e '70 dhe, më pas, edhe ato të '80 të shekullit të kaluar.

## ■ Përballë realitetit të hidhur

### Në kërkim të rrugëzgjidhjeve

Realiteti i hidhur brenda të cilit ishin gjendur të gjithë shqiptarët në Jugosllavi dhe sidomos ata në Maqedoni, kishte bërë që edhe Naseri të mendonte për rrugët e mundshme të daljes nga realiteti i tillë. Por, derisa konstatimet i ishin dukur të lehta, rrugëzgjidhjet i ishin dukur të vështira. Para tyre ai ishte ndier shumë herë i vogël dhe i pafuqishëm.

Duke menduar për rrugëzgjidhjet e mundshme, ai shpesh kishte rënë në monologë me veten. Sa vështirë është për të ndryshuar diçka në këtë të shkretën Maqedoni! Ndonëse gati gjysma e popullatës është shqiptare, megjithatë, ajo funksionon sikur të ishte vetëm e maqedonëve! Shiko emërtimet e rrugëve, të gjitha të shkruara në alfabetin cirilik e në gjuhën maqedone; shiko mbishkrimet e institucioneve dhe emërtimet e shkollave, sërish të gjitha në alfabetin cirilik e në gjuhën maqedone; hyr nëpër zyra, duhet folur vetëm maqedonisht, sepse vetëm maqedonishtja është gjuhë zyrtare; shiko dokumentet tua personale, të gjitha të dhënat janë të shkruara në alfabetin cirilik dhe të deformuara sipas gjuhës maqedone; shiko pushtetarët, gjyqtarët, policët e ushtarakët, përveç një grushti të vogël shqiptarësh, të gjithë janë maqedonë; shiko kush gërryen token dhe bënë punë nga më të rëndat për të mbijetuar, kryesisht shqiptarët; shiko kush përndiqet, torturohet e burgoset politikisht, sërish shqiptarët; shiko kush largohet më së shumti nga vendi duke shkuar si fuqi punëtore në vendet e Evropës perëndimore, shqiptarët...!

Duke e shikuar këtë e atë, monologjet e tilla të Naserit me veten s'kishin pasur fund asnjëherë!



## **Duke i shijuar „liritë” e Titos!**

Migrimin e dhjetëra mijëra shqiptarëve në fund të viteve të '60 dhe përgjatë viteve të '70 të shekullit të kaluar, duke u vendosur ata si fuqi punëtore në disa vende të Evropës Perëndimore, Naser Hani e kishte konsideruar një spastrim të ri etnik të tyre, të orkestruar nga ana e Jugosllavisë. Kështu ndodhte sepse, sipas tij, Jugosllavia, në trojet shqiptare kishte bërë qëllimisht investime më të pakta ekonomike se në secilën pjesë tjetër të Jugosllavisë, në mënyrë që shqiptarët të detyroheshin që nga papunësia dhe varfëria të punësoheshin jashtë vendit dhe kështu edhe t'ua lironin të tjerëve hapësirën e tyre etnike dhe jetësore.

Por, derisa Naseri dhe shokët e tij e kishin kuptuar migrimin e tillë të shqiptarëve si spastrim etnik, një pjesë e shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni e gjetkë në Jugosllavi, migrimin e tillë e kishin kuptuar si një dhuratë për ta nga ana e Titos, i cili ua kishte bërë të mundur të kishin pasaporta e të punësoheshin edhe jashtë vendit. Shqiptarët e tillë, jo vetëm se nuk i kishin kuptuar “liritë me gjemba” të Titos, por edhe e lavdëronin atë për të “mirat e shumta” që ai kishte kurdisur për ta.

I dëshpëruar për shkak të qëndrimeve të këtilla të disa shqiptarëve, Naseri kishte menduar se e keqja nuk u kishte ardhur shqiptarëve vetëm nga Jugosllavia dhe Titoja, por edhe nga vetvetja, përkatësisht nga shkurtpmësia e tyre politike.

Nga ana tjetër, për Naserin kishte qenë shqetësues edhe fakti se shqiptarët paranë e tyre të fituar me mund të madh nëpër botë, në vend që ta investonin për dije dhe liri, e shpenzonin kryesisht për të bërë shtëpi të mëdha dhe luksoze, për të blerë makina të shtrenjta, për të bërë ceremoni e dasma të kushtueshme, dhe për t'u blerë grave të tyre stoli ari të shumta.

## **Vdekja e babait**

Derisa ishte gjimnazist Naseri ishte përballur edhe me vdekjen e babait. Ndonëse vdekja e tij i kishte goditur të gjithë, ajo e kishte goditur më shumë Naserin, sepse ai, përveçse kishte qenë më i vogli, edhe ishte i lidhur më shumë emocionalisht me të.

Idetë e babait të tij për liri dhe emancipim të shqiptarëve, Naseri pas vdekjes së tij i kishte propaganduar edhe më shumë në mjediset e gjimnazit, ndërkohë që agjentët lokalë të sigurimit të shtetit kishin filluar tashmë t'i hidhnin në letër rreshtat e parë për të. Një dosje e re ishte hapur... N.H...

## ■ M'atë anë kishte qenë Shqipëria

### Fare pranë e shumë larg!

M'atë anë, fare pranë Strugës, përtej pikës kufitare të Qafë Thanës, kishte qenë vendi amë i shqiptarëve, Shqipëria, të cilës Fuqitë e Mëdha të Evropës nëpërmjet të katër-pesë konferencave ndërkombëtare të paqes, që nga viti 1878 e këtij ia kishin shkëputur mbi dy të tretat e viseve të saj, duke ua falur ato vendeve fqinje ballkanike: Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Por Shqipëria, Naserit aq sa i ishte dukur fare pranë, po aq i ishte dukur edhe shumë larg, sepse ajo tanimë kishte kohë që ia kishte “vënë shulin derës!”. Mbase kështu atë më shumë se Partia e Punës e kishte mësuar vetë historia dhe pabesitë e botës ndaj saj. Por, për Naserin dhe bashkëmendimtarët e tij kishte qenë e rëndësishme se në këtë botë, megjithatë, kishte mbetur një copë Shqipëri, e cila sado e vogël, e vetmuar dhe e sakatosur nga padrejtësitë, prapë kishte hedhur helm e zjarr kundër Titos dhe Jugosllavisë.

### Peizazh vjeshtor

Kishte qenë korriku i vitit 1977 kur gjimnazistët e Strugës ishin bërë gati për ta festuar të papërsëritshmen mbrëmje të maturës. Pikërisht për këtë mbrëmje shumica e djemve dhe e vajzave maturante kishin blerë kate rrobash e kostume. Edhe Naseri ishte gëzuar, kishte folur, qeshur e kënduar me shokët dhe shoqet e klasës. Edhe ai, së pakut në raste festash, e kishte parë jetën si një livadh me lule...

Kishte qenë vjeshta e atij viti kur Naseri ishte dashur të shkonte në Prishtinë për të studiuar. Dielli kishte filluar të vakej e gjethi të thahej. Pasditeve kishin fryrë puhizat vjeshtore, të cilat, pasi që kishin valëvitur lehtas ujërat e liqenit, ishin përplasur ledhatueshëm edhe për fytyrat e njoma të djemve e vajzave maturante të Strugës.

Ndarja me Strugën brenda atij peizazhi të bukur e të ngrohtë vjeshtor, Naserit i ishte dukur si një peizazh lamtumirës, në radhë të parë, me t'atin që i kishte vdekur, me t'ëmën që i ishte plakur e lodhur, dhe me vetë fëmijërinë dhe djalërinë e tij, të cilat po i iknin në pa kthim. Për të gjitha këto peizazhi i asaj vjeshte Naserin e kishte bërë melankolik, sepse ai e dinte se kohët ndodhin vetëm njëherë, ikin e s'kthehen më kurrë!

Kishin qenë këto vitet e gjimnazit që Naser Hanin e kishin mbushur aq shumë me hov djaloshar, me ndjenja kombëtare dhe shpresa për të ardhmen.

## **IV. Naser Hani gjatë viteve të studimeve në Prishtinë**

### **■ Në Kosovë si në një “botë tjetër!”**

#### **Kosova oazë e vetme ku gjenin prehje të gjithë shqiptarët**

Vjeshta e vitit 1977 Naser Hanin e kishte gjetur në vitin e parë të Fakultetit ekonomik të Universitetit të Kosovës në Prishtinë.

Indodhur brenda mjedisit kulturor shqiptar dhe në mesin e mijëra studentëve, ai e kishte përjetuar Kosovën si një “botë tjetër”, shumë më shqiptare, më të fortë e më të ngrohtë, se ajo “bota e akullt” brenda të cilës gjendeshin shqiptarët në Maqedoni.

Por, Kosovën e kishin bërë të tillë, në radhë të parë, të drejtat e shqiptarëve, të cilat, ndonëse kishin qenë më të pakta se të drejtat e popujve tjerë të Jugosllavisë, megjithatë, ishin shumë më të mëdha se të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore.

Dhe Kosovën e kishte bërë si një botë tjetër sidomos Universiteti i saj në Prishtinë, që, duke qenë i vetmi universitet, që kishte funksionuar edhe në gjuhën shqipe, kishte mbledhur rreth vetes ashtu siç mblidhen bletët rreth amzës, mijëra djem dhe vajza nga të gjitha trojet shqiptare në Jugosllavi.

I gjendur brenda luzmës së tillë studentore, plot zhurmë, gaz e hare, Naser Hani e kishte përjetuar Kosovën si një Shqipëri të dytë, dhe si “oazën e vetme” ku gjenin prehje të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

#### **Djepi i vetëm i dijes dhe i lirisë!**

Mjedis i këndshëm studentor në Prishtinë, Naser Hanit, aq sa i kishte shkaktuar gëzim e kënaqësi, po aq i kishte shkaktuar edhe keqardhje dhe pikëllim për fatin jo të mirë të shumë maturantëve shqiptarë në Maqedoni, pjesa më e madhe e të cilëve, në pamundësi për të studiuar e punuar, kishte marrë

rrugët e kurbetit, si brenda ashtu edhe jashtë Jugosllavisë. Kjo ndodhte, sepse Maqedonia, e banuar pothuajse përgjysmë me shqiptarë, kishte dy universitete në gjuhën maqedone, por nuk kishte universitet në gjuhën shqipe.

Edhe pjesa e madhe e maurantëve shqiptarë në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore e kishte fatin e njëjtë, sepse edhe rinia shqiptare e këtyre viseve i kishte marrë rrugët e botës; ata të Malit të Zi duke u vendosur kryesisht në Amerikë, kurse ata të Kosovës Lindore - në vendet Evropës perëndimore.

Kishin qenë këto arsytet pse Naseri Universitetin e Kosovës në gjuhën shqipe në Prishtinë e kishte përjetuar si “djepin e vetëm” të dijes dhe të lirisë për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

### **Ndjenja e shumësisë së të vetëve**

I gjendur në mesin e mijëra studentëve shqiptarë të Universitetit të Kosovës në Prishtinë, Naseri për herë të parë ishte ndier të kishte qenë brenda “shumësisë së të vetëve!”.

Ndjenja e tillë e kishte përcjellë si një ogur i mirë kudo që ishte ndodhur, në sallat e ligjëratave, në bibliotekë, në rrugë e kudo tjetër. Ajo e mbushte me shpresë, siguri e besim. E kënaqte sidomos gumëzhima e zërave të studentëve në holin e Fakultetit Ekonomik, ku dikush e kishte përshëndetur, dikush e kishte ftuar në bufe për të pirë diçka bashkë etj. Me shokët e tij studentë të fakultetit të njëjtë mund të bisedonte lirshëm për gjithçka, të qeshte e bënte shaka me ta sikur t'i kishte pasur shokë që herët.

Sidomos mbrëmjeve kur ishte gjendur në shëtitoren qendrore e Prishtinës në mesin e qindra djemve e vajzave nga të gjitha viset shqiptare, ndjenja e të qenit në mesin e të vetëve ia krijonte atë aromën e një atdheu të lirë, të cilin ai dhe shumë studentë të tjerë e kishin ëndërruar që ta kishin një ditë. Duke u kthyer i ngazëllyer e plot shpresë nga shëtitorja për në banesën e tij, ai i kishte thënë vetes: E sheh, edhe ti e ke shumësinë tënde! Edhe ti i ke zërat e shumtë që flasin në gjuhën tënde! Edhe për ty ka një copë tokë e një copë nënqiell ku t'i prehesh, frymëzohesh dhe ngritësh....!

E kishte përjetuar kësisoj shumësinë e të vetëve në Kosovë, sepse në Maqedoni shumësia e tij shqiptare, duke qenë e shtypur, e përbuzur dhe e urreyer, ishte sjellë e heshtur dhe e ndrojtur, aq sa ajo edhe në gjysmën perëndimore të vendit ku shqiptarët kishin qenë shumicë, kishte figuruar në përditshmëri si të ishte pakicë.

Por edhe në qytetet me shumicë shqiptare në Mal të Zi, si në Ulqin, në Tivar e Tuz, ashtu edhe në qytetet me shumicë shqiptare në Kosovën Lindore, si në Preshevë, Medvegje e në Bujanoc, shqiptarët duke qenë të shtypur dhe të

urryer etnikisht, e mbanin të heshtur e të pazë shumësinë e tyre. Së pakut kështu ia kishin përshkruar Naserit asokohe gjendjen e shqiptarëve në ato vise, studentët shqiptarë nga Mali i Zi dhe Kosova Lindore, të cilët kishin ardhur për të studiuar në Prishtinë.

## **Komunikim më i lirë gjatë përditshmërisë**

Njëri nga segmentet e “botës tjetër”, të cilën Naseri e kishte gjetur në Kosovë, ishte ai i komunikimit më të lirshëm midis shqiptarëve gjatë përditshmërisë.

Kështu, në Kosovë njeriu mund të komunikonte më lehtë edhe me një fytyrë të njohur publike, me një profesor apo akademik, me një publicist apo shkrimtar, me një politikan apo me një zyrtar, dhe së fundi edhe me një komandant policie, nëse e kishte kërkuar nevoja. Ishte kështu, sepse kuadrot e tilla duke qenë shqiptare s’kishin si t’i iknin komunikimit me pjesëtarët e popullit të tyre, ashtu siç edhe figurat e tilla maqedone nuk i iknin komunikimit me pjesëtarët e popullit të tyre, dhe kjo do të ishte krejtësisht në rregull sikur ata të komunikonin kësisoj edhe me shqiptarët.

Më tej, shqiptarët në Kosovë në mjediset e tyre familjare, në ndeja me shokë e miq, kuptohet në rrethe të besueshme, s’kishin aq shumë frikë që ta thonin një fjalë të keqe për Serbinë e Jugosllavinë, apo një fjalë kritike për udhëheqësit politikë të Kosovës e të Jugosllavisë. Kështu kishte ndodhur, jo pse në Kosovë s’kishin qenë të dënueshme shprehjet negative në adresë të pushtetit dhe pushtetarëve, por sepse liberalizimet të cilat kishin ndodhur gjithandej Jugosllavisë pas aprovimit të kushtetutës së vitit 1974, e kishin përfshirë në njëfarë mase edhe Kosovën, por jo edhe viset shqiptare jashtë Kosovës.

Komunikimit të tillë më të lirë të shqiptarëve në Kosovë i kishte paraprirë natyrisht edhe vetë statusi politikë i Kosovës, përkatësisht autonomia e saj ca më e përparuar e vitit 1974, zbatimi i së cilës kishte bërë të mundur që pjesëmarrja e shqiptarëve në strukturat politike e shtetërore të Kosovës të ishte e konsiderueshme, dhe për rrjedhojë edhe përndjekja politike e shqiptarëve për një fjalë goje të ishte më e amortizuar.

Por, komunikimit më të lirë të shqiptarëve në Kosovë i kishte kontribuar edhe vetë ngritja e vetëdijes kombëtare në mesin e shqiptarëve, e cila duke pasur Kosova universitet ishte më e lartë se vetëdija kombëtare e shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore.

Duke e shijuar komunikimin e tillë në Kosovë, Naserit s’kishte si mos t’i shkonte mendja te denoncimet dhe ndëshkimet e atypëratyshme të shqiptarëve në Maqedoni edhe për fjalën më të vogël kritike në adresë të politikave antishqiptare që ishin ushtruar kundër tyre. Brenda një mjedisi të tillë,

shqiptarët në Maqedoni s' guxonin as midis tyre që të lëshonin ndonjë fjalë të "pa kripë!"

Puna kishte shkuar aq larg saqë në Maqedoni edhe komunikimi në gjuhën shqipe gjatë përditshmërisë në mjedise publike kishte qenë i ndrojtur e i cunguar, sepse për palën maqedone komunikimi i tillë ishte i padëshiruar. Kështu, shqiptarët edhe në mjedise të qyteteve ku ata ishin shumicë, komunikimin me njëri-tjetrin në gjuhën shqipe e kishin bërë disi si me ndrojtje e më zë të ulët. Kur ata hynin nëpër shitore për të blerë ndonjë gjë, ishte dashur që shitësve që kishin qenë kryesisht maqedonë, t'u drejtoheshin vetëm në gjuhën maqedone. Në të kundërtën, kur shqiptarët u ishin drejtuar shitësve në gjuhën shqipe, ata kishin reaguar zëshëm duke u thënë: "S' po ju kuptojmë fare se çfarë doni! Po ku jetoni ju, more? A e dini ju se jetoni në Maqedoni! Flisni në gjuhën maqedone, që t'ju kuptojnë të gjithë!", kishin reaguar ata me zemërim.

Për të gjitha këto dhe për vetë faktin se në Maqedoni vetëm gjuha maqedone kishte qenë gjuhë zyrtare, shqiptarët kishin filluar me kohë që në fjalorin e shqipes së tyre të futnin fjalë dhe shprehje të gjuhës maqedone. Kështu, kur ata kishin dashur të thonin "pa tjetër", kishin përdorur fjalën "**mora**" të maqedonishtes; kur kishin dashur të thonin "njësoj", kishin përdorur fjalën maqedone "**isto**"; kur kishin dashur të thonin "gjithnjë" kishin përdorur fjalën "**stallno**" maqedonisht etj.

## **Komunikim edhe për tema të ndjeshme politike**

Sidomos guximi për të komunikuar e debatuar edhe për tema të ndjeshme politike në mesin e rinisë studentore në Prishtinë, kishte bërë që Naseri ta përjetonte Kosovën si një "botë të re dhe të ndritur", e cila do të bënte dritë edhe mbi "botët e vjetra e të zymta" të shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore. Meqë edhe në Kosovë komunikimi kritik për tema të ndjeshme politike ishte i ndëshkueshëm, kjo kishte bërë që komunikimi i tillë të ndodhte jopublikisht në rrethe të besueshme, si nëpër konvikte të studenteve dhe në mjedise private të shqiptarëve. E, megjithatë, edhe në Kosovë dikush herë pas here e kishte pësuar nga komunikimi i tillë, ishte hetuar e dënuar me disa muaj me burg etj.

Siç tregonte Naseri, temat e ndjeshme politike, që ishin trajtuar më së shumti gjatë viteve të '70 në mesin e studentëve nëpër konvikte dhe në banesat e tyre private kishin të bënin: me padrejtësinë e mbetjes së Kosovës dhe të viseve të saj edhe pas LDB-së në kuadër të Jugosllavisë; me vendimet e Mbledhjes së Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës të mbajtur në kapërcyellin e viteve 1943/1944 në fshatin Bujan të Shqipërisë, ku ishte vendosur që Kosova dhe

viset tjera shqiptare në Jugosllavi pas LDB-së t'i ktheheshin Shqipërisë; me përpjekjet e Titos gjatë e pas LDB-së që edhe Shqipërinë, si një republikë të shtatë t'ia bashkangjiste Jugosllavisë; me përkufizimin kushtetues të shumicës shqiptare edhe në kushtetutën e vitit 1974 të Kosovës dhe të Jugosllavisë si kombësi (pakicë) dhe me përkufizimin e pakicave serbe e malazeze në Kosovë si kombe (shumica kombëtare); me format e shtypjes etnike dhe të gjenocidit të ushtruara ndaj shqiptarëve edhe në Jugosllavinë federative, të cilat kishin pasuar me spastrime të reja etnike; me shfrytëzimin ekonomik që i ishte bërë Kosovës (sidomos minierës së Trepçës) nga ana e Serbisë dhe Jugosllavisë; me lënien e Kosovës dhe të viseve të saj në prapambetje ekonomike, sociale e kulturore, për shkak të investimeve të pakta që kishte bërë federata jugosllave në viset e shqiptarëve; me statusin politik jo të barabartë të Kosovës dhe të shqiptarëve në krahasim me statusin politik të popujve tjerë në pjesë të tjera të Jugosllavisë; me shtypjen etnike ekstreme që ishte ushtruar sidomos ndaj shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, të Malit të Zi dhe në Kosovën Lindore në jug të Serbisë, si dhe me dëshirën përfundimtare të shqiptarëve që ata me viset e tyre t'i bashkangjiteshin herëdokur Shqipërisë etj.

Për studentët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore, bisedat e tilla me ndjeshmëri të madhe politike, kishin qenë diçka e re dhe gati të pabesueshme. Guximi i studentëve nga Kosova për t'i prekur edhe temat e tilla, atyre u kishte dhënë shpresë dhe kurajo, se edhe të drejtat e shqiptarëve në viset e tyre do të përmirësoheshin një ditë. Duke i vlerësuar bisedat e tilla si shpresëdhënëse, ata, i kishin bartur ato edhe në vendlindjet e tyre, duke i kontribuar kështu ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve gjithandej. Por, ata edhe i kishin pësuar nga bisedat e tilla, sepse në vendlindjet e tyre ishin përndjekur dhe ishin dënuar me burgje.

Naseri kishte qenë pjesë e pandashme e bisedave dhe e debateve të tilla në mesin e studentëve, me ç'rast ai u kishte folur atyre shumë herë për gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Maqedoni.

### **Një provë e dështuar!**

Meqë shqiptarët në Kosovë, me gjithë përndjekjet dhe ndëshkimet, guxonin që të flisnin kundër politikave antishqiptare serbe e jugosllave, kurse shqiptarët në Maqedoni nuk kishin guxim as që t'i shtronin kërkesat e tyre të përditshmërisë në gjuhën shqipe para nëpunësve dhe zyrtarëve maqedonë, kjo kishte bërë që Naseri të mendonte se vetë shqiptarët, me mosguximin e tyre i ndihmonin komunikimit të kufizuar në gjuhën shqipe në viset e tyre në Maqedoni.

I revoltuar me “mosguximin” e tillë të shqiptarëve, Naseri iu kishte sugjeruar

studentëve nga Maqedonia që ishin me studime në Prishtinë, që ata sa herë që do të ktheheshin në vendlindjet e tyre në Maqedoni, për nevojat e tyre të përditshmërisë t'u drejtoheshin si palë edhe maqedonëve në gjuhën shqipe, duke filluar që nga shitësit e dyqaneve e deri te nëpunësit e zyrave. E kishte marrë këtë nismë, sepse kishte menduar se kështu edhe zyrtarët dhe qytetarët maqedonë, me kalimin e kohëve do të mësoheshin që ta akceptonin komunikimin e shqiptarëve në gjuhën e tyre. Duke qenë nismëtar i iniciativës së tillë, ai e kishte parë të nevojshme që ta bënte vetë provën e parë të komunikimit shqip në Maqedoni.

Kështu, një ditë të bukur pranvere kur Naseri nga Prishtina kishte arritur në Shkup, në stacionin qendror të autobusëve, i ishte drejtuar biletëshitëses maqedone në gjuhën shqipe, duke ia kërkuar asaj një biletë autobusi për në Strugë. Por biletëshitësja me ta dëgjuar kërkesën e Naserit në gjuhën shqipe kishte reaguar me mlllef e britmë: **“Pa çoveçe ja te ne razbiram!”**, që do të thoshte “Njëri, unë s'po të kuptoj!”. Kur Naseri i kishte thënë asaj maqedonisht se “Ti duhet t'u shërbesh palëve në gjuhët e tyre amtare”, ajo ia kishte kthyer atij duke i thënë me zemërim: **”Nemoj me zboruvash na toa jazik!”**, që do të thoshte “Mos më fol në atë gjuhë!”, për ta përçmuar gjuhën shqipe.

Meqë Naseri ia kishte ngulur sytë plot urrejtje e zemërim biletëshitëses së tillë, ajo e kishte ngritur edhe më tepër zërin me kërcënim: “Ç'më shikon ashtu? Apo nuk e di se në Maqedoni flitet maqedonisht!? Mos do ta thërrasë policinë?”, kishte shtuar ajo. Kërcënimi me polici kishte bërë që Naserit t'i vlonin trutë. Deri sa ai ishte matur që sportelin, prapa të cilit ishte biletëshitësja maqedone, ta godiste me grusht, një shqiptar i moshuar dhe i panjohur e kishte kapur për krahu duke i thënë: “Ik, o bir, se e blej unë biletën për ty! Largohu, o djalë, prej saj, se këtu i thonë Shkup e jo Prishtinë!” ...

Derisa autobusi me udhëtarë kishte gjarpëruar kodrave e maleve drejt Kërçovës për të arritur në Strugë, Naserit herë e ishin kujtuar fjalët fyese e kërcënuese të biletëshitëses maqedone, e herë fjalët e urta të njeriut të mirë e të panjohur. Duke qenë në monolog me veten, kishte menduar: Po kur një biletëshitëse maqedone merr guxim për t'u sjellë kështu me një shqiptar, atëherë si do të sillleshin nëpunësit e zyrave, udhëheqësit e komunave, policët, gjykatësit e mjekët maqedonë, nëse shqiptarët do t'u drejtoheshin në gjuhën shqipe! Katastrofë! katastrofë!, kishte murmuritur ai ndër dhëmbë.

Derisa autobusi i ishte afruar qytetit të Strugës, ai i kishte thënë vetes: “Eh, liri, e shkreta liri, që nuk je vetëm drekë e darkë, që nuk je vetëm oborr e shtëpi, por je shumë më tepër se kaq...!”

Përfundimi: Prova kishte dështuar plotësisht!



## Në botën e librave dhe të gazetave në gjuhën shqipe

Bota e librave dhe e gazetave të shumta në gjuhën shqipe, kishte paraqitur segmentin tjetër të rëndësishëm të “botës së re”, të cilën Naseri e kishte gjetur në Kosovë. Derisa nëpër libraritë e qyteteve të Kosovës, përveç librave shkollore, studimore e shkencore në gjuhën shqipe, kishte edhe libra me karakter historiografik e artistik, të botuar në Prishtinë e në Tiranë, në libraritë e qyteteve me shumicë shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovë Lindore, përveç librave të shkollës fillore dhe të mesme, libra të tjerë në gjuhën shqipe nuk kishte fare.

Po kështu ishte puna edhe për gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe, sepse derisa në kiosqet e Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës, krahas gazetave në gjuhën serbe kishte edhe gazeta e revista në gjuhën shqipe, në kiosqet e qyteteve shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovë Lindore, brenda një sërë gazetash e revistash në gjuhën serbe e maqedone, mezi se ishte dukur vetëm gazeta e përditshme e Kosovës “Rilindja”, kurse në Maqedoni edhe “Flaka e Vllaznimit”.

Ose derisa në bibliotekat e Kosovës, përveç librave në gjuhën serbe, kishte edhe libra e romane të shumta në gjuhën shqipe, në bibliotekat publike në Maqedoni, s’kishte pasur, qoftë edhe një libër të vetëm në gjuhën shqipe.

Duke pasur libra të ndryshëm në gjuhën shqipe në Kosovë, edhe studentët e atyre viteve aq sa kishin lexuar libra përkatëse të studimeve, po aq kishin lexuar edhe libra me përmbajtje historike, politike, shoqërore, letrare e artistike, siç kishin qenë p. sh: librat kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Lëvizjes Kaçake të Shqiptarëve në Kosovë; dy vëllimet e mëdha të Historisë së Popullit Shqiptar, të botuara në Tiranë; krijimtaria politike, artistike dhe patriotike e rilindësve shqiptarë, romanët, dramat dhe përmbledhjet me poezi të autorëve nga Kosova dhe të një pjese të autorëve nga Shqipëria etj.

Botën e tillë të librave studentët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore, e kishin bartur asokohe me vete edhe në viset e tyre. Ata sa herë që ishin kthyer në vendlindjet e tyre, ishin ngarkuar me libra në gjuhën shqipe, që ua kishin dhënë të tjerëve për t’i lexuar.

Por, në Maqedoni, siç tregonte Naseri, shqiptarët herë pas here ishin marrë në pyetje nga organet e sigurimit të shtetit, jo vetëm për shkak të posedimit të literaturës historiko-artistike të botuar në Tiranë dhe që me rrugë legale kishte arritur në Kosovë, por edhe për shkak të posedimit të literaturës së tillë të botuar në Prishtinë.

## **Kishte edhe libra të ndaluar**

Por, në Kosovën e viteve '70 të shekullit të kaluar kishte edhe libra të ndaluar! Librat e tillë me përmbajtje historiko-politike, të botuar në Shqipëri, ishin sjellë asokohe nga kurbetçinjtë shqiptarë me punë jashtë vendit me rrugë ilegale në Kosovë. Meqë posedimi dhe leximi i librave të tillë konsiderohej vepër armiqësore e dënueshme, ato ishin lexuar ilegalisht nga studentët dhe nxënësit e shumtë, duke u bartur dorë më dorë.

Në librat e tillë të ndaluar kishte akuza të drejtpërdrejta ndaj Jugosllavisë, Titos dhe Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë për ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë, për ushtrim të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Më tej, në librat e tillë ishte përshkruar shtypja etnike, masakrimet dhe përzëniet e shqiptarëve nga trojet e tyre, duke filluar që nga Kongresi i Berlinit e kështu deri te Jugosllavia e Titos. Të tillë ishin p.sh: librat e Ajet Haxhiut, të Shaban Brahës dhe të Sylejman Krasniqit, autorë këta shqiptarë nga Kosova, që jetonin në Shqipëri. Por, nga librat e ndaluar, nga organet e sigurimit të shtetit, më të rrezikshme ishin konsideruar librat e Enver Hoxhës, që qarkullonin po ashtu dorë më dorë nëpër Kosovë.

Edhe Naseri, si shumë studentë të tjerë, kishte lexuar libra të ndaluar, të cilat i kishte përcjellë te studentë të tjerë, kurse këta të fundit te të tjerët e kështu me radhë. Edhe ai si shumë studentë të tjerë kishte sjellë libra të ndaluar nga Prishtina në Strugë e rrethinë, duke i shpërndarë ato në duar të besueshme. Asokohe as që i kishte shkuar ndërmend se do të vinte një ditë, pas shumë vitesh, kur edhe ai vetë do të “kthehej” në një libër!

## **Një botë me emërtime edhe në gjuhën shqipe**

Edhe emërtimet dhe mbishkrimet në gjuhën shqipe të rrugëve dhe të institucioneve, për Naserin kishin paraqitur po ashtu një pjesë të “botës tjetër”, që ai e kishte gjetur në Kosovë. Emërtimet dhe mbishkrimet edhe në gjuhën shqipe, u kishin dhënë mjediseve të qyteteve të Kosovës edhe identitet shqiptar, kurse shqiptarëve u kishin dhënë ndjenjën se edhe ata e kishin një shtëpi të tyre në këtë vend.

Mjedisi i Kosovës me shumësi shqiptare, me komunikim më të lirë ndërshtetërisht, me libra, gazeta, me emërtime e mbishkrime edhe në gjuhën shqipe e me shumëçka tjetër, i kishte bërë që studentët e ardhur për të studiuar nga Maqedonia dhe viset e tjera shqiptare ta përjetonin Prishtinën si shtëpi të tyre, sepse në viset e tyre të gjitha emërtimet dhe mbishkrimet ishin vetëm në gjuhën serbe e maqedone. Aq shumë të serbizuara e të maqedonizuara kishin qenë mjediset publike të qyteteve të tyre, sa që shqiptarët ndjeheshin në to sikur të jetonin në një vend të huaj.

Kjo ishte arsyeja pse Naseri, Kosovën e kishte përjetuar si një “simfoni”, që tingëllonte edhe në gjuhën e popullit të tij, ndërsa Maqedoninë e përjetonte si një “mozaik” të shtruar vetëm me qirilikë, dhe si një “simfoni”, që kishte ditur të tingëllonte vetëm maqedonisht, sikur atje të mos kishte pasur fare shqiptarë. Dhe si ta përjetonte ndryshe ai Maqedoninë, kur edhe në viset e banuara me shumicë shqiptare, të gjitha institucionet shtetërore, shoqërore, kulturore, arsimore, shëndetësore, ekonomike, urbanistike e deri edhe dyqanet e vogla private të shqiptarëve, ishin emërtuar me mbishkrime vetëm në gjuhën maqedone dhe vetëm në alfabetin qirilikë.

Por, administrata monoetnike maqedone edhe emërtimet e vendeve në natyrë, si ato të bjeshkëve, të fushave, të maleve, të majave, të luginave, të liqeneve e të lumenjve, që në Maqedoninë perëndimore kishin qenë burimisht të emërtuara në gjuhën shqipe, i kishte pagëzuar në gjuhën maqedone. Edhe emërtimet e pronave të paluajtshme të shqiptarëve (të arave dhe të livadheve etj.) në gjuhën shqipe, administrata maqedone i kishte deformuar e tjetërsuar po ashtu, duke iu dhënë trajta të gjuhës maqedone.

Dhe së fundi, në Maqedoni, deri në vitin 1970, administrata maqedone një pjesë të shqiptarëve ua kishte lëshuar edhe kartat e identitetit me mbiemra të deformuar, duke iu shtuar atyre prapashtesat e mbiemrave maqedonë si: ski/ska, oski/oska, ovski/ovska, ov/ova etj. Puna kishte shkuar deri aty, sa që kjo administratë edhe partizanes shqiptare të LDB-së nga Dibra, Ibe Palikuçi, ia kishte deformuar mbiemrin në “Palikuça”, që në gjuhën maqedone do të thoshte “Shtëpidjegje”, kjo sikur Ibe Palikuçi të kishte qenë një piromane e cila ua ka djegur shtëpitë të tjerëve.

## **Një botë pa nofka, urrejtje dhe përcmime**

“Bota tjetër” që Naseri e kishte gjetur në Kosovë kishte të bënte edhe me mospërdorimin e nofkave fyese dhe përtallëse për shqiptarët. Meqë shqiptarët në Kosovë ishin pothuajse shumicë absolute, dhe pasi që Kosova gëzonte autonomi të zgjeruar, pjesëtarët e pakicës serbe dhe malazeze, nuk u drejtoheshin shqiptarëve së pakut publikisht me nofka fyese.

Por nofka fyese për shqiptarët kishte asokohe gjithandej Jugosllavisë. Kështu, në Serbi, shqiptarët i quanin “shiftari”, në Bosnje “shokovi”, në Kroaci “shipci”, kurse në Maqedoni “shiftarqino”, “shiftarite” dhe “Kalimero!”. Nofka e fundit kishte të bënte me krahasimin që maqedonët i kishin bërë kësulës së bardhë të shqiptarëve me çufkën e bardhë në kokën e shpendit të zi mesdhetar të quajtur “Kalimero”. Por derisa popujt e tjerë të Jugosllavisë i kishin emërtuar shqiptarët me nofka fyese, kryesisht prapa shpine, maqedonët ishin të vetmit që i fyenin shqiptarët me nofka para syve!

Por, në Maqedoni shqiptarët ishin fyer e përçmuar edhe në mënyra të tjera, si p.sh: me shikime përbuzëse, me injorim, me shpërfillje, me shmangie, me qëndrim të ftohtë ndaj tyre, si dhe në mënyra të tjera vështirë të përshkueshme, nëpërmjet të cilave një pjesë jo fort e vogël e popullatës maqedone u ishte qasur shqiptarëve.

Për të gjitha këto, Naseri, shqiptarët në Maqedoni i shihte si në një geto masive në gjysmën perëndimore të vendit, të cilës ndër të tjera i nxihej jeta edhe me fyerje e nofka...!

## ■ Një botë me qasje e pjesëmarrje institucionale edhe të shqiptarëve

Qasja dhe pjesëmarrja pothuajse optimale e shqiptarëve në jetën institucionale, politike e kulturore të Kosovës, për Naserin paraqitte segmentin më të rëndësishëm të “botës tjetër”, të cilën e kishte gjetur në Kosovë.

Kishin qenë në radhë të parë **institucionet arsimoro-kulturore** të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të arsimit të lartë, brenda të cilave jo vetëm për shqiptarët nga Kosova, por edhe për ata nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore kishte pasur qasje dhe pjesëmarrje. Kështu rreth një e treta e studentëve shqiptarë të Universitetit të Kosovës kishte qenë nga viset shqiptare jashtë Kosovës, ndërkohë që edhe shumë kuadro të këtyre viseve ishin punësuar në Kosovë.

Por, Naserin aq sa e kishte gëzuar qasja dhe pjesëmarrja e tillë e shqiptarëve nga Maqedonia në institucionet arsimoro-kulturore të Kosovës, po aq e kishte shqetësuar mospjesëmarrja e tyre në institucionet e tilla në Maqedoni. Në Maqedoni në institucione arsimore e kulturore shqiptarë kishte pasur pak e hiç, kurse në institucionet e tilla ekzistuese në gjuhën maqedone, qasjes dhe pjesëmarrjes së shqiptarëve u ishte vënë edhe stopi institucional.

Kështu, p. sh: Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e Maqedonisë, kishte deklaruar që numri i studentëve nga radhët e pakicave kombëtare (duke përfshirë edhe shqiptarët që ishin shumicë) që ishin pranuar në Universitetin e Shkupit dhe të Manastirit për çdo vit, të mos ishte më i madh se 5%. Kufizimi i tillë kishte bërë që në të dy universitetet në gjuhën maqedone, të ishte pranuar vetëm një numër simbolik i shqiptarëve për çdo vit të ri akademik. Meqë vendimi i tillë deklarativ i Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë kishte qenë antiligjor, ai as që ishte kthyer ndonjëherë në ligj dhe për rrjedhojë as që ishte botuar në gazetën zyrtare, por ishte zbatuar thjesht si vendim deklarativ i asaj

Ministrie, ndërkohë që shqiptarët në Maqedoni, vendimin e tillë antiligjor, as që kishin ditur e as që kishin pasur guxim që ta kundërshtonin ligjërisht. Kështu, i vetmi reagim kundër vendimit të tillë arbitrar të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës së Maqedonisë kishin qenë shkrimet e bëra në shtypin ditor të Kosovës.

Edhe në sferën e **administratës publike** shqiptarët në Kosovë, me gjithë favorizimin e lehtë të serbëve e të malazezve në punësim, kishin pasur qasje dhe pjesëmarrje pothuajse optimale, kurse gjuha shqipe, krahas gjuhës serbe, kishte qenë po ashtu zyrtare, dhe për rrjedhojë edhe administrata publike kishte funksionuar edhe në gjuhën shqipe.

Por, në Maqedoni çështja ishte ndryshe. Atje edhe në vendbanimet me shumicë shqiptare, në organet e administratës publike ishin punësuar kryesisht maqedonët dhe tek-tuk ndonjë shqiptar, kurse gjuhë zyrtare ishte vetëm gjuha maqedone, dhe për rrjedhojë edhe administrata kishte funksionuar vetëm në këtë gjuhë.

Më tej, kishin qenë **institucionet politike e shtetërore** të Kosovës, në të cilat, sidomos pas aprovimit të kushtetutës së vitit 1974, kishte pasur qasje dhe pjesëmarrje pothuajse optimale edhe për shqiptarët. Kështu, si brenda strukturave udhëheqëse të Lidhjes Komuniste të Kosovës (LKK-së), ashtu edhe brenda strukturave qeveritare të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës (KEK), me gjithë pjesëmarrjen deri diku të favorizuar të pjesëtarëve të pakicës serbe e malazeze, qasja dhe pjesëmarrja e shqiptarëve kishte qenë e madhe, duke qenë ata edhe në poste kryesore udhëheqëse. Fatkeqësisht pjesëmarrja e tillë e shqiptarëve nëpër institucione politike dhe shtetërore të Kosovës, nuk ishte shoqëruar edhe me fuqi vendimmarrëse proporcionale të tyre, sepse pjesëtarëve të pakicës serbe e malazeze me poste të larta në këto institucione, disi në mënyrë të “padukshme”, u kishte ecur fjala më shumë se shqiptarëve.

Por, në Maqedoni kishte qenë ndryshe. Atje qasja dhe pjesëmarrja shqiptarëve në institucione politike dhe shtetërore kishte qenë tejet e pakët e simbolike, dhe për rrjedhojë shqiptarët pothuajse tërësisht kishin qenë të përjashtuar nga jeta institucionale politike.

Dhe, së fundi, në Kosovë edhe në **institucionet e rendit publik dhe të sigurisë shtetërore**, siç kishte qenë Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme të Kosovës dhe degët e tij në secilën komunë, shqiptarët sidomos pas aprovimit të kushtetutës së vitit 1974, me gjithë pjesëmarrjen deri diku të favorizuar të pjesëtarëve të pakicës serbe e malazeze të cilët në këto struktura kishin mbetur me shumicë nga e kaluara, edhe shqiptarët kishin pasur qasje dhe pjesëmarrje pothuajse optimale. Por, në këto institucione fuqia vendimmarrëse

e shqiptarëve kishte qenë edhe më vogël se në institucionet tjera të përmendura më lart.

Meqë sidomos brenda institucioneve të rendit publik dhe sigurisë shtetërore në Maqedoni, shqiptarët kishin vetëm pjesëmarrje simbolike, kjo dëshmonte se ato ishin krijuar në baza monoetnike maqedone. Vetë monoetniciteti i tillë dëshmonte se këto institucione nuk kishin mision parësor ruajtjen e rendit dhe të sigurisë së republikës së Maqedonisë nga ndonjë ndërhyrje e jashtme, por përndjekjen politike të shqiptarëve, në mënyrë që ata ta braktisnin sa më shumë Maqedoninë. Me fjalë të tjera, institucionet e sigurisë shtetërore të Maqedonisë, shqiptarët nuk i kishin objekt partneriteti për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë së vendit, por i kishin objekt pune, përkatësisht përndjekjeje, duke filluar që nga LDB-ja e në vitet në vazhdim.

Puna kishte shkuar deri aty sa që shqiptarët në Maqedoni, si askund tjetër në Jugosllavi, ishin të detyruar, që qoftë edhe për një ditë qëndrimi në shtëpitë e tyre të shokëve dhe miqve nga Kosova, t'i paraqitnin ata pranë policive lokale si mysafirë, sepse mosparaqitja e vizitorëve nga Kosova kishte pasuar me ndëshkime.

## ■ Kosova, si një “mësonjëtorë” për të gjithë

### Mjedisi i ngrohtë dhe gjithintegrues

Emëruesi i përbashkët i “botës tjetër”, të cilën Naseri e kishte gjetur në Kosovë, ishte mjedisi gjithintegrues i Kosovës për gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

Institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore; botimet e ndryshme historike, letrare dhe artistike; shoqëritë kulturoro-artistike; klubet letrare e sportive; mijëra studentë të të gjitha viseve, si dhe një shtresë e re intelektualësh, ishin ato që marrë së bashku e kishin kthyer Kosovën e viteve të '70 në një mjedis gjithintegrues dhe në një “mësonjëtorë” për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

Ishin kontaktet e gjalla midis shqiptarëve të të gjitha viseve në Kosovë, ato që i kishin shkrirë midis tyre “akujt” e mosnjohjes, të paragjyqimeve, të ndarjeve krahinore dhe administrative. Kontaktet e tilla e kishin çuar përpara homogjenizimin e mirëfilltë kombëtar të shqiptarëve, kurse hapësirën e tyre etnike e kishin bërë të kapshme për të gjithë.

### Punësimi dhe mbetja në Kosovë

Për Naserin ishin shqetësuese synimet e strukturave politike maqedone, që mjedisin e tillë gjithintegrues për shqiptarët në Kosovë ta shfrytëzonin për

qëllimet e tyre të mbrapshta. Për t'ia arritur këtij qëllimi ishte angazhuar deri edhe lozha më e ulët e aparatçikëve maqedonë, siç kishin qenë nëpunësit e gjendjes civile dhe të administratave komunale. Këta nëpunës sa herë studentët shqiptarë, që studionin në Kosovë, kishin nevojë ta merrnin ndonjë dokument zyrtar në komunat përkatëse, u nxirrnin atyre pengesa burokratike. Kjo bëhej me qëllim, që këta studentë, duke e përjetuar Maqedoninë si një ferr, të vendoseshin përgjithmonë në Kosovë.

Kur këta studentët, kishin kërkuar që t'u lëshoheshin certifikatat e lindjes dhe dokumentet tjera personale në alfabetin latin të gjuhës shqipe, dhe sidomos kur ata kishin kërkuar që nga mbiemrat e tyre t'u hiqeshin prapashtesat e mbiemrave maqedonë, nëpunësit maqedonë kishin uluritur kundër tyre, duke u thënë: “A jeni në vete, more, ju shqiptarët!”; “A mendoni se çfarë po kërkonit! Po emrat dhe mbiemrat tuaj janë shkruar e do të shkruhen vetëm në alfabetin qirilikë, dhe vetëm ashtu siç i kanë deklaruar prindërit tuaj në librat e amzës!”; “Shkoni e merruni vesh me prindërit tuaj dhe mos na çani kokën neve këtu! Në të kundërtën, a e dini ju se puna e emrave dhe e mbiemrave në Maqedoni është e rregulluar me ligj!”, “Po ku jetoni ju, more të shkretë! Mos ju jetoni në Shqipëri dhe si njihni ligjet dhe rregullat në fuqi!”, “A e dini ju, se kërkesat tuaja vijnë në kundërshtim me ligjin!”, “Dhe kush vjen në kundërshtim ligjin bën vepër penale, hetohet dhe dënohet!”, “Do të bënit mirë që me këso mendsh të mos ktheheni fare në Maqedoni sepse do ta pësoni rëndë”, kishin porositur ata me zemërim.

Nga ana tjetër Ministria e Arsimit dhe e Kulturës së Maqedonisë, me qëllim që kuadrot shqiptare nga Maqedonia të mbeteshin përgjithmonë në Kosovë, në vitet e '70 të shekullit të kaluar kishte marrë vendim që diplomat e fituara në Universitetin Kosovës në Prishtinë të mos njiheshin në republikën e Maqedonisë. Kësisoj pjesa më e madhe e rinjve shqiptarë nga Maqedonia, të diplomuar në Kosovë, në pamundësi që të punësoheshin në Maqedoni, ishin punësuar dhe kishin mbetur në Kosovë. Edhe vendimi i tillë deklarativ i Ministrisë së Arsimit në Maqedoni, duke qenë antiligjor, as që ishte kthyer në ligj dhe për rrjedhojë as nuk ishte botuar në gazetën zyrtare të Maqedonisë, por ishte zbatuar si vendim deklarativ. Kështu, kishte ndodhur paradoksi i madh i mosnjohjes së diplomave të fituara në një pjesë të Jugosllavisë (në Kosovë) nga një pjesë tjetër e Jugosllavisë (në Maqedoni). Për paradoksin e tillë ishte shkruar asokohe edhe në gazetatat e Kosovës. Shkrimet e tilla nëpër gazeta ishin i vetmi reagim ndaj padrejtësisë së tillë, sepse shqiptarët në Maqedoni këtij veprimi **antiligjor** të Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë as që ia kishin mësyre.

Ngjashëm kishte ndodhur edhe më të rinjtë shqiptarë nga Mali i Zi dhe Kosova

Lindore të diplomuar në Kosovë, të cilët në pamundësi që të punësoheshin në vendlindjet e tyre për shkaqe të njëjta si në Maqedoni, ishin punësuar dhe kishin mbetur në Kosovë. Por, punësimi dhe mbetja në Kosovë s'kishte qenë tjetër veçse një spastrim etnik i shqiptarëve të arsimuar nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore.

Duke i analizuar prapësitë e tilla të strukturave institucionale maqedone, serbe e malazeze ndaj shqiptarëve, Naserit i ishte kujtuar shpesh ai vargu rebelues i Migjenit: “Oh si nuk kam një grusht të fort, e malit që s'bzanë mu n'zemër t'ja njesh...!”

### **Duke i ndarë së bashku fatet e këqija të historisë**

Kishin qenë fatet e këqija historike të të gjithë shqiptarëve, dhe sidomos të shqiptarëve në Jugosllavi, ato të cilat gjatë viteve të '70 i kishin ndarë së bashku studentët e të gjitha viseve shqiptare në Prishtinë.

Duke i ndarë së bashku fatkeqësitë plot dhunë, padrejtësi, shtypje dhe spastrime etnike të shqiptarëve në Kosovë e vise të tjera, studentët shqiptarë të atyre viteve e kishin kthyer Universitetin e Kosovës në një “kuvend gjithëpopullor”, ku ndër të tjera ishte biseduar edhe për atë se çfarë ishte dashur të bënin shqiptarët për t'i korrigjuar fatet e tilla të këqija.

Dhe ata, as që kishin pasur vend më të mirë se Kosovën për të biseduar për gjëra të tilla.

Ishte vetë pozita më e mirë politike e Kosovës, vetë universiteti në gjuhën shqipe në Prishtinë, dhe vetë historia e Kosovës me luftëra e kryengritje për liri, ato që e kishin kthyer Kosovën e viteve të '70 në oazën e vetme ku shqiptarët e mbetur në Jugosllavi kishin mundur t'i ndanin fatet e tyre me njëri-tjetrin.

Kishin qenë këto arsyt pse studentët e ardhur nga viset shqiptare jashtë Kosovës e kishin përjetuar Kosovën e viteve të '70 si shtëpi të tyre, si një copë atdhe dhe si një shkollë të luftërave për liri. Pikërisht për këto arsye ata ishin në gjendje që më parë se për të drejtat e shqiptarëve në viset e tyre jashtë Kosovës, të angazhoheshin e të sakrifikoheshin për të drejtat e Kosovës. Kështu ndodhte, sepse, sa më e fortë dhe më e mëvetësishme të ishte Kosova, aq më të fortë e më të mëvetësishëm do të ishin të gjithë shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi.

Shumë nga këta studentë, përfshi këtu edhe Naser Hanin, duke u përpjekur që Kosova të kishte një status politik më të mirë, ishin përndjekur politikisht, ishin dënuar dhe burgosur, duke bërë së bashku mijëra vjet burgu gjithandej Jugosllavisë.



## **Duke mësuar nëpërmjet krahasimeve të shumta**

Studentët e viteve të '70 kishin mësuar shumë, sidomos duke i krahasuar të drejtat minimale të shqiptarëve me të drejtat maksimale të popujve të tjerë të Jugosllavisë. Krahasimet e tilla flisnin qartë se shumësia e përbashkët kombëtare e shqiptarëve në Jugosllavi, për nga madhësia kishte qenë për disa qindra banorë më e madhe se shumësia kombëtare boshnjako-myslimane dhe sllovene, duke e zënë ajo kësioj vendin e tretë me radhë brenda Jugosllavisë, gjë që ishte pajtuar edhe me të dhënat statistikore të regjistrimit të popullatës në vitin 1981.

Kështu, të dhënat statistikore të atyre kohëve dëshmonin se, shumësia e përbashkët kombëtare e shqiptarëve në Jugosllavi, ishte një fish më e madhe se shumësia e përbashkët kombëtare maqedone, dhe tre fish më e madhe se shumësia kombëtare malazeze. Por derisa maqedonët dhe malazeztë i gëzonin republikat e tyre kombëtare brenda Jugosllavisë, shqiptarëve, përkatësisht Kosovës ku jetonte pjesa më e madhe e tyre, mezi se i ishte njohur statusi i krahinës autonome në kuadër të Serbisë dhe Jugosllavisë. Derisa Mali i Zi, duke qenë shtet i pavarur që nga Kongresi i Berlinit e këtej, dhe të drejtën për të qenë republikë brenda Jugosllavisë së Titos në njëfarë mënyre e kishte trashëguar, maqedonët, duke mos pasur shtet të vetin paraprakisht, të drejtën që ta kishin republikën e tyre e kishin arritur për herë të parë pas LDB-së, e drejtë kjo që s'u ishte dhënë shqiptarëve në Kosovë.

Edhe Naseri, duke marrë pjesë në debatet e tilla krahasimore në mesin e studentëve, u kishte kontribuar atyre me krahasimet e tij. Kështu, ai ishte shprehur se edhe malazezve që ishin vetëm pak më shumë se shqiptarët në Maqedoni, Jugosllavia ua kishte njohur statusin e republikës së Malit të Zi, kurse Kosovës, ku numri i shqiptarëve ishte rreth dy herë e gjysmë më i madh se numri i malazezve, Jugosllavia mezi se ia kishte njohur statusin e një autonomie krahinore.

## **Për shkaqe politike dhe raciste**

Në të vërtetë, shqiptarët e mbetur në Jugosllavi kushtin e madhësisë për t'u përkufizuar si komb shumicë në krahasim me maqedonët dhe malazeztë e kishin plotësuar e tejkaluar, por ata siç shprehej edhe Naseri, vetëm për shkaqe politike dhe raciste nuk përkufizoheshin si komb, por vetëm si kombësi (pakicë - minoritet).

Për shkaqe politike, sepse po të ishin përkufizuar shqiptarët në Kosovë si komb, edhe ata sipas ligjeve kushtetuese në fuqi do ta kishin të drejtën ta kenë republikën e tyre kombëtare të Kosovës, si kombet e tjera të Jugosllavisë. Po të ishin përkufizuar shqiptarët në Kosovë si komb, edhe shqiptarët në Maqedoni,

në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore ishte dashur të përkufizoheshin e të trajtofshin si komb, siç kishte ndodhur me pakicat serbe e malazeze në Kosovë, të cilat duke u bazuar në ekzistimin e kombit serb në Serbi dhe të kombit malazez e në Mal të Zi, ishin përkufizuar e trajtuar si kombe shumicë.

Dhe për shkaqe raciste sepse e drejta e përkufizimit si komb dhe për rrjedhojë edhe e drejta e posedimit të republikës kombëtare brenda vendit, s'u ishte njohur vetëm shqiptarëve sepse duke ata qenë të origjinës ilire, ishin i vetmi populli me origjinë joslave në Jugosllavi.

Kishin qenë padrejtësitë e tilla ato të cilat më vonë gjatë viteve të '80 e kishin nxitur rininë studentore që të kërkonte nga Jugosllavia, që ajo t'ia njihte Kosovës statusin e republikës së barabartë me kombet tjera.

### **Kolonizimi i viseve shqiptare me “egejca”**

Tema tjetër të cilën Naseri e kishte diskutuar në mesin e studentëve në Prishtinë, kishte qenë ajo e kolonizimit të viseve shqiptare në Maqedoni me “maqedonë të Egjeut”, të njohur si “egejca!”. Kështu, ai u kishte treguar shokëve të tij studentë se Jugosllavia gjatë viteve 1977/1978, mijëra “egejca” të cilët pas LDB-së për shkak të përndjekjes së tyre nga monarkofashistët grekë kishin ikur nga Maqedonia e Egjeut në Greqi dhe ishin vendosur në Rusi, i kishte sjellë në Maqedoni duke i vendosur ata kryesisht në Manastir, Ohër, Kërçovë e Strugë dhe pjesërisht në Gostivar e në Tetovë, në mënyrë që kësisoji duke i kolonizuar me “egejca” qytetet e lartpërmendura me shumicë shqiptare, përqindja e maqedonëve në këto qytete të rritej, kurse përqindja e shqiptarëve të zvogëlohej.

### **Kolonizimi i viseve shqiptare nga brenda**

Nga ana tjetër, Naseri kishte diskutuar në mesin e studentëve në Prishtinë edhe për kolonizimin e qyteteve shqiptare nga brenda Maqedonisë me popullatë maqedone.

Kështu, në qytetin e Shkupit, i cili pas LDB-së kishte qenë i banuar me rreth 90% shqiptarë, klasat pushtetare maqedone, duke filluar që nga viti 1945 e deri në vitin 1970, kishin sjellë në mënyrë të organizuar rreth 250 mijë maqedonë nga gjysma lindore e Maqedonisë. Më tej, ai u kishte treguar atyre se edhe në qytetet e tjera me shumicë shqiptare në Maqedoni, pas LDB-së ishin sjellë mijëra maqedonë nga gjysma lindore e vendit, ndërkohë që mijëra shqiptarë ishin detyruar të shpërnguleshin në Turqi. Të gjitha këto ishin bërë që të prishej struktura etnodemografike e qyteteve me shumicë shqiptare.

Naseri, kolonizimin e tillë nga brenda vendit e konsideronte shumë më të rrezikshëm se kolonizimin e bërë nga jashtë vendit. Kjo sepse kur është fjala për kolonizimin e bërë nga jashtë, vendi kolonizues duke qenë në distancë

gjeografike me vendin në të cilin sjell kolonizatorë, ai viset e kolonizuara prej tij nuk mund që t'ia aneksoj vetës. Por kur është fjala për kolonizimin nga brenda vendit, procesi i kolonizimit automatikisht shoqërohet me procesin e aneksimit të viseve të etnisë së shtypur nga ana e etnisë shtypëse në pushtet. Për të tilla, të rrezikshme, i konsideronte Naseri kolonizimet e viseve të Kosovës dhe të Kosovës Lindore me serbë, të viseve shqiptare në Maqedoninë perëndimore me maqedonë, të viseve shqiptare në Mal të Zi me malazez, dhe të viseve shqiptare të Çamërisë me grek.

### **Konvertimi i shqiptarëve ortodoksë në maqedonë**

Tema tjetër e veçantë për të cilën Naseri u kishte folur shokëve të tij studentë në Prishtinë, ishte ajo e konvertimit të shqiptarëve ortodoksë në maqedonë. Kështu, ai i kishte njoftuar ata se si klasat politike maqedone, në dy dekadat e para pas LDB-së kishin arritur që të gjithë shqiptarët ortodoksë në qytetin e Ohrit dhe të Manastirit t'i konvertonin në maqedonë, si nëpërmjet presioneve, ashtu edhe nëpërmjet të favoreve.

Me tej, ai i kishte njoftuar shokët e tij studentë se si klasat politike maqedone, në dy dhjetëvjetëshat e parë pas LDB-së i kishin konvertuar (asimiluar) në maqedonë edhe shqiptarët e krahinës së Rekës (13 fshatra), si nëpërmjet presioneve ashtu edhe nëpërmjet të favoreve që këto klasa politike ua kishin bërë shqiptarëve ortodoks të kësaj krahine.

Dhe ai u kishte folur shokëve të tij edhe për Josif Bagerin, njërin nga rilindësit shqiptarë, i cili kishte qenë nga krahina e Rekës, dhe që kishte vepruar në kuadër të kolonisë shqiptare në Sofje të Bullgarisë. Josif Bageri pas kthimit nga Bullgaria në Maqedoni, për shkak të veprimtarisë së tij pro çështjes shqiptare, ishte përndjekur nga çetat bullgaro-maqedone, me ç'rast ai ishte detyruar që në moshë të thyer të vendosej në Prishtinë, ku edhe kishte vdekur.

### **Gjërat duhej ndryshuar rrënjësisht!**

Duke i krahasuar të drejtat e plota të shumësisve kombëtare sllave, me të drejtat e mohuara e të cinguara të shqiptarëve, pjesa më e politizuar e studentëve shqiptarë të atyre kohëve kishte menduar, se kishte ardhur koha për t'i ndryshuar gjërat rrënjësisht! Rrënjësisht, por çka e si?

Disa kishin menduar që statusi i Kosovës ishte dashur të avancohej nga ai i krahinës autonome në atë republikës, kurse statusi politik i shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore duhej të ishte i ngjashëm me statusin politik aktual të shqiptarëve në Kosovë. Studentë të tjerë kishin thënë se Republikës së ardhshme të Kosovës duhej t'i bashkangjiteshin të gjitha viset

shqiptare në Jugosllavi. Të tjerët ishin shprehur se Kosova me të gjitha viset e shqiptare, duhej të hidhej në kryengritje të armatosur për t'iu bashkangjitur Shqipërisë. Dhe, së fundi, ishte edhe një dorë e vogël studentësh, që, duke qenë mediokër apo të frymëzuar nga prindërit e tyre me patriotizëm jugosllav, nuk ishin marrë fare me gjëra të tilla.

Në pamje të parë ishte dukur se brenda bisedave të tilla të studentëve nuk thuhej asgjë e re, sepse, tanimë që nga LDB-ja e këtej ishin krijuar disa organizata e grupime politike ilegale, përfshirë këtu edhe ato të viteve të '70, që në programet e tyre i kishin opcionet e tilla të zgjidhjes së çështjes shqiptare në Jugosllavi, kurse në demonstratat studentore të vitit 1968 ishte dëgjuar tashmë edhe kërkesa politike për bërjen e Kosovës Republikë.

Por, Naseri vlerësonte se në bisedat e tilla të viteve të '70, megjithatë kishte diçka të re. Në mos asgjë tjetër, e re ishte koha kur ato ishin bërë. Në një kohë kur më zgjidhja e çështjes shqiptare nuk ishte vetëm çështje e grupeve të vogla ilegale, por kishte filluar të bëhej edhe çështje e rinisë shqiptare brenda e jashtë Kosovës; në një kohë kur edhe shqiptarët në Jugosllavi nuk ishin më ata që kishin qenë dikur, shumica analfabetë e të varfër skajshmërisht, dhe në një kohë kur edhe m'atë anë kufirit kishte një Shqipëri tjetër, më të përparuar, më të ngritur, më të kamur dhe mbi të gjitha më të fortë ushtarakisht.

I frymëzuar nga bisedat e tilla, Naseri ishte ndier i gatshëm t'u bashkohej atyre studentëve që ishin shprehur se: "Gjërat duhej ndryshuar rrënjësisht!". Duke menduar kështu atij i ishin kujtuar herë pas here vargjet e fuqishme të Asdrenit: "Asgjë nuk duam nuk, veç armë e ca bukë...!"

Meqë shqiptarët në Jugosllavi kishin shënuar tanimë ngritje arsimore, kulturore dhe kombëtare, dhe meqë ata e kishin Shqipërinë më të fortë ushtarakisht, e cila po i kundërvihej Jugosllavisë politikisht, këto kishin bërë që edhe Naseri si mijëra të rinj të tjerë të kishte shpresuar se për shqiptarët: "Ditë të mira paskëtaj vijnë...Lum kush t'rronjë...!". Ishin këto vargjet shpresdhënëse të Naim Frashërit, të cilat ai i kishte shkruar në një kohë tjetër, kur për Shqipërinë dhe shqiptarët kishte pasur pak shpresë.

## ■ Adhurim-besimi ndaj Shqipërisë

### Duke i ndarë fatet me vendin amë, Shqipërinë

Ajo që ua shëronte plagët të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi kishte qenë vendi i tyre amë, Shqipëria. Asokohe vetëm ajo i kishte bërë publike vuajtjet dhe padrejtësitë e ushtruara ndaj tyre, e kishte demaskuar Titon dhe Jugosllavinë,

dhe u kishte dhënë shqiptarëve zëmër e kurajo që të luftonin për të drejtat e tyre.

Në fund të fundit, vetë ekzistimi i Shqipërisë si shtet i pavarur dhe i konsoliduar politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht, shqiptarët në viset e tyre në Jugosllavi i kishte bërë me peshë. Ata duke e pasur Shqipërinë nuk ishin ndier jetim, por ishin ndier krenar që ishin shqiptarë. Rëndësinë e ekzistimit të Shqipërisë për fatet e shqiptarëve në Jugosllavi, s'ë kishte kuptuar askush më mirë se rinia studentore në Prishtinë. Ajo e kishte të qartë se pa Shqipëri, jo vetëm që s'do të kishte Kosovë me autonomi e me universitet, por pothuajse të gjithë shqiptarët do të spastroheshin etnikisht nga ana e shovinistëve serbo-maqedono-malazez që në dekadën e parë pas LDB-së.

Duke e patur parasysh rëndësinë e tillë të Shqipërisë, rinia e atyre viteve s'kishte dashur që atë ta implikonte ushtarakisht kundër Jugosllavisë para kohe e për hiçgjë, por kishte dashur që ta ruante dhe ta kishte të fortë e më të fortë, që ajo kur ta donte puna ta thoshte fjalën e saj edhe me pushkë e me top!

Kishte qenë rëndësia e tillë e ekzistimit të Shqipërisë ajo që Naser Hanit ia kishte kujtuar atë thënien e moçme të pleqve të urtë të Kosovës, të cilët sa herë që Ballkanin e kishin përfshirë flakët e luftës, ishin shprehur: “Ruje, o Zot, Shqypninë...!”

## **Në Kosovë e kishte gjetur edhe Shqipërinë**

Në Kosovë Naseri, ndër të tjera, e kishte “gjetur” edhe Shqipërinë, e cila sidomos nga rinia, ishte adhuruar përgjithësisht. Përkushtimi ndaj Shqipërisë ishte pjesë e pandashme e frymëzimit patriotik, që e kishte përfshirë rininë e Kosovës gjatë viteve të '70 të shekullit të njëzetë.

Kishte qenë prania për vite të tëra e shumë profesorëve të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Kosovës; prania e herëpashershme e një numri punonjësish shkencorë nga Tirana në Prishtinë, si dhe prania e artistëve të filmit, të dramës, të folklorit dhe të arteve nga Shqipëria, ato që kishin bërë që Naseri në Kosovë ta kishte “gjetur” edhe Shqipërinë. Nga ana tjetër, prania e herëpashershme në Shqipëri e kuadrove të ndryshme nga Kosova, si akademikë, profesorë, mjekë, historianë, gjuhëtarë, mbledhës të folklorit e të tjerë, si dhe vizitat disaditore të grupeve të studentëve nga Kosova në Shqipëri, e kishin “bartur” asokohe edhe Kosovën në Shqipëri. Kështu, Shqipëria, në vitet e '70 të shekullit të kaluar kishte qenë më shumë se kurrë në Kosovë, dhe Kosova më shumë se kurrë në Shqipëri, dhe për rrjedhojë edhe komunikimi ndërvëllezëror shqiptaro-shqiptar s'kishte ndodhur asnjëherë më parë më shumë se në ato vite.

Duke pasur Kosova universitet në gjuhën shqipe dhe akademi të shkencave dhe

të artëve, kryeqyteti i saj, Prishtina, ishte asokohe pika kryesore e vendtakimeve dhe e komunikimeve gjithëshqiptare, sepse në Prishtinë ishin mbledhur përfaqësuesit më të denjë të të gjitha “botëve” shqiptare: Studentët nga Kosova, nga Maqedonia, Mali i Zi e Kosova Lindore dhe pedagogët e tyre nga Shqipëria. Ndonëse Kosova për shkak të rrethanave të lartpërmendura, kishte paraqitur pikën kyçe të komunikimit shqiptaro-shqiptar, megjithatë, Shqipëria, duke qenë vendi amë i të gjithë shqiptarëve kishte paraqitur referencën kryesore të komunikimeve të tilla. Duke qenë shtet dhe duke treguar përkushtim të veçantë ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, Shqipëria i kishte përthithur të gjitha “botët” e copëtuara të shqiptarëve, duke i bërë ato bashkë dhe një në shumë aspekte.

Pikërisht për këtë arsye edhe komunikimi shqiptaro-shqiptar i viteve të '70, kishte rezultuar me përkushtimin e pashoq të shqiptarëve në Kosovë e vise të tjera shqiptare ndaj vendit amë, Shqipërisë. Edhe Naseri Hani ishte njëri prej studentëve të shumtë, brenda të cilit ishin valëvitur si erëra “botët” shqiptare të atyre viteve në krye me Shqipërinë.

### **Bashkimi gjuhësor e shpirtëror i shqiptarëve**

Adhurimi dhe besimi i shqiptarëve në Kosovë e vise të saj ndaj Shqipërisë, kishte paraqitur një fitore madhore për të gjithë shqiptarët. Kjo jo pse adhurim-besimi i tillë ndaj Shqipërisë po ndodhte për herë të parë, por sepse ai gjatë viteve të '70 për shumëçka ishte i veçantë: ishte më masiv se kurrë më parë, në qendër të tij ishte rinia, pjesa më vitale e shqiptarëve, dhe sepse ai kishte rezultuar me bashkim gjuhësor, kulturor e shpirtëror të kombit shqiptar.

Bashkimit gjuhësor e shpirtëror të shqiptarëve i kishin kontribuar edhe disa ngjarje madhore, të cilat në fund të viteve të '60 dhe në fillim të viteve të '70 kishin ndodhur në Kosovë dhe në Shqipëri, siç kishte qenë: mbajtja në vitin 1968 në Prishtinë e një simpoziumi shkencor kushtuar Skënderbeut, heroit kombëtar të të gjithë shqiptarëve, rithemelimi i Institutit Albanologjik të Prishtinës (më 1968), Konsulta gjuhësore në Prishtinë (1968), hapja e Universitetit të Kosovës në Prishtinë në vitin 1970, mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe në vitin 1972 në Tiranë, etj. Por Shqipëria i kishte kontribuar bashkimit kulturor e shpirtëror të kombit shqiptarë, në vitet e '70 edhe me literaturën e saj historiografike e artistike, e cila ishte përdorur edhe në Kosovë, si dhe me emisionet radiofonike e televizive me karakter kombëtar, historik e politikë, të cilat ishin parë e dëgjuar edhe nga shqiptarët në Jugosllavi.

Bashkimit kulturor e shpirtëror të kombit shqiptar, i kishin kontribuar asokohe, para së gjithash, vetë shqiptarët në Kosovë dhe viseve të tjera, që me qëndresën e tyre të vazhdueshme e kishin synuar bashkimin kombëtar edhe

nëpërmjet normave të njësuara gjuhësore e kulturore. Për Naserin unifikimi i gjuhës letrare shqipe kishte paraqitur etapën e parë të bashkimit kombëtar të shqiptarëve në një Shqipëri optimale, as të vogël e as të madhe. Duke i parë gjërat kështoj, ai, idetë e bashkimit të shkallë-shkallshëm kombëtar i kishte bartur gjithandej dhe sidomos në mesin e shqiptarëve në Maqedoni.

## **Politikat largpamëse të brendshme dhe të jashtme**

Kishin qenë në radhë të parë politikat largpamëse të brendshme e të jashtme të Shqipërisë në raport me veten e saj, dhe me shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi, ato të cilat e kishin bërë atë të adhurueshme dhe të besueshme për rininë studentore dhe masat popullore gjithandej Kosovës me vise. Politikat e tilla të Shqipërisë, i kishin shërbyer në planin aktual konsolidimit dhe forcimit të kombit shqiptar, kurse në planin afatmesëm dhe afatgjatë do t'i shërbenin bashkimit kombëtar të gjithë shqiptarëve brenda një Shqipërie natyrale.

## **Politikat e jashtme**

Shqipëria nëpërmjet të **politikave të saj të jashtme** kishte qenë vazhdimisht në mbështetje të të drejtave të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në Jugosllavi.

Duke e kërkuar realizimin e të drejtave legjitime të shqiptarëve, Shqipëria e kishte akuzuar vazhdimisht Jugosllavinë për ushtrim të gjenocidit dhe të spastrimit etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre. Pikërisht për këtë arsye Shqipëria, jo vetëm që s'kishte pasur asnjëherë marrëdhënie të mira politike me Jugosllavinë, por edhe marrëdhëniet ndërshtetërore i kishte kryesisht të acaruara dhe të ngrira.

Është për t'u theksuar se marrëdhëniet e mira të Shqipërisë me Rusinë midis viteve 1947-1955, nuk kishin qenë të mira vetëm pse Rusia kishte qenë komuniste, por në radhë të parë sepse Rusia kishte qenë asokohe e vetmja superfuqi botërore, e cila Jugosllavisë dhe Titos ia kishte treguar grushtin. Por, me të vdekur Stalini në vitin 1953 dhe të ardhur në krye të Rusisë Krushqovi, i cili që në vitin 1955 ishte afruar me Titon dhe Jugosllavinë, Shqipëria duke filluar që nga viti 1955 i kishte prishur gradualisht marrëdhëniet e saj me Rusinë, duke u dhënë fund atyre në vitin 1961.

Duhet theksuar po ashtu se edhe marrëdhëniet e mira të Shqipërisë me Kinën midis viteve 1961-1978, s'kishin qenë të mira vetëm pse Kina kishte qenë komuniste, por, në radhë të parë sepse brenda atyre viteve Kina ishte e vetmja superfuqi botërore, e cila kishte bërë politik të jashtme antijugosllave. Por, kur në verën e vitit 1978 Kinën e kishte vizituar Titoja, dhe kur Kina e kishte kthyer

kursin e politikës së jashtme drejt miqësisë me Jugosllavinë, Shqipëria i kishte prishur marrëdhëniet me Kinën po atë vit.

Kështu, prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me Rusinë në vitin 1961, dhe prishja e marrëdhënieve të saj me Kinën në vitin 1978, s'kishin ndodhur vetëm për shkaqe ideologjike siç ishte thënë e vazhdon të thuhet, por, pikërisht sepse këto dy superfuqi ishin bërë me kohë "mikesha" të Titos dhe të Jugosllavisë, përkatësisht të armikes së përjetshme të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në trojet e tyre në Jugosllavi. Në të vërtetë, sikur prishja e marrëdhënieve me Kinën të ishte bërë vetëm për shkaqe ideologjike, ajo do të kishte ndodhur jo në vitin 1978 kur Titoja e vizitoi Kinën, por që në vitin 1972 kur Kinën e kishte vizituar presidenti Nikson, përkatësisht "kreu i imperializmit amerikan", siç shprehej Shqipëria e asaj kohe.

Vetë akti i largimit të bazës ushtarake ruse nga Pasha Limani, duke u ndeshur me atë rast ballë për ballë Shqipëria e vogël me Rusinë e madhe, kishte bërë që rinia e Kosovës me vish, jo vetëm të kishte adhurim e besim ndaj një Shqipërie të tillë, por edhe të motivohej që edhe ajo në të ardhmen t'i largonte nga Kosova dhe viset e saj ushtritë serbo-maqedono-malazeze në të njëjtën mënyrë.

Nga ana tjetër, Shqipëria pikërisht pse s'ishte pajtuar me mbetjen e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, ajo kishte qenë vendi i vetëm që në vitin 1975 nuk e kishte nënshkruar aktin final të Konferencës së Helsinkut për njohjen reciproke të kufijve ekzistues midis shteteve të Evropës.

Duke pasur parasysh se politikat e tilla të jashtme të Shqipërisë ishin hartuar nga Enver Hoxha, shqiptarët në Kosovë e vise të tjera kishin ushqyer adhurim dhe besim të madh ndaj tij.

## **Politikat e brendshme**

Nga ana tjetër kishin qenë **politikat e brendshme** të Shqipërisë, ato të cilat kishin rezultuar po ashtu me rritjen e adhurimit dhe të besimit të shqiptarëve në Kosovë e gjetkë ndaj saj.

Kishin qenë vetë arritjet e Shqipërisë në të gjitha fushat e jetës: Në bujqësi, në arsim, në kulturë, në shëndetësi, në ndërtimin e veprave madhore hidroenergjetike, siç kishin qenë hidrocentralet e kaskadës së Drinit, dhe në ndërtimin e veprave madhore industriale, siç kishte qenë Metalurgjiku i Elbasanit, ato të cilat marrë së bashku në mesin e shqiptarëve në Jugosllavi e kishin rritur besimin ndaj një Shqipërie të tillë, e cila duke i rritur kapacitetet e saj zhvillimore, i kishte rritur njëkohësisht edhe kapacitetet e saj mbrojtëse.

Kishin qenë sidomos strategjitë, parimet, taktikat, pajisjet teknike, armatimet, fortifikimet dhe vetë numri i madh i ushtarëve që kishte pasur Shqipëria e asokohshme, ato të cilat kishin bërë që shqiptarët në Kosovë e vise



të saj të ushqenin ndaj Shqipërisë besimin më të madh të mundshëm, sepse ata e vetëkuptonin se një Shqipëri e tillë e fortifikuar dhe e militarizuar, në situata kritike do t'i mbronte edhe ushtarakisht shqiptarët në Jugosllavi. Këto ishin arsyt pse të gjitha arritjet që ishin shënuar asokohe në Shqipëri, rinia studentore e Kosovës me vise nuk i kishte konsideruar vetëm si arritje të Shqipërisë, por edhe si arritje të gjithë shqiptarëve në Ballkan.

Për të gjitha këto, politikat e jashtme dhe të brendshme të Shqipërisë, gjatë viteve të '70 të shekullit të njëzetë ishin futur aq thellë në mendjet dhe zemrat e rinisë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e në Kosovë Lindore, sa që ajo rini kushdo që ta kishte prekur Shqipërinë kishte qenë e gatshme të hidhej në flakë!

Natyrisht se Shqipëria adhurimin e tillë të shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi nuk i kishte pasur gratis, por kishte merituar e fituar duke punuar paraprakisht për dekada të tëra.

### **Marrja e Kosovës në konsideratë**

Preokupimi i Shqipërisë për Kosovën nuk kishte paraqitur vetëm një respekt të veçantë ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, por ishte edhe një tregues se Shqipëria nuk kishte hequr dorë nga Kosova dhe viset e saj.

Format e këtij preokupimi të shtetit shqiptar ishin në atë kohë të shumta.

Kështu, në fushën e botimeve me karakter historiko-politik në Shqipëri, Kosovës i ishte dhënë vendi i merituar që ajo kishte luajtur gjatë kthesave madhore historike të kombit shqiptar, si p. sh: gjatë viteve 1878-1881 të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, gjatë përpjekjeve për pavarësimin e Shqipërisë midis viteve 1908-1912, si dhe gjatë kthesave tjera historike të rëndësishme.

Në Shqipëri ishte ngritur lart emri dhe vepra atdhetare e figurave madhore të Kosovës, si p. sh: figura e Ymer Prizrenit, Sylejman Vokshit, Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Idriz Seferit, Haxhi Zekës, Ali Pashë Gucisë, Dedë Gjo Lulit, Jakup Ferrit, Azem Bejtës dhe e figurave të tjera.

Në Shqipëri, në rrethin e Tropojës dhe fare pranë Kosovës, ishte ngritur qyteza të cilës i ishte vënë emri i atdhetarit nga Kosova, Bajram Currit, të cilin shteti shqiptar e kishte shpallur edhe hero i popullit, si dhe ia kishte ngritur shtatoren në qytetën me emrin e tij.

Në qytetin e Vlorës, në shtëpinë muze ku me 1912 ishte shpallur pavarësia e Shqipërisë dhe ishte ngritur flamuri kombëtar, ishte ekspozuar xhamadani i shqyer nga plumbat i trimit legjendar nga Kosova, Isa Boletinit, të cilit edhe i ishte ngritur shtatorja në sheshin qendror të qytetit të Shkodrës.

Në Shqipëri, diku ishte ngritur obelisku kushtuar luftëtares së paepur nga Kosova, Shote Galica; diku tjetër ishte vendosur busti i atdhetarit nga Kosova,

Hasan Prishtina; diku me emrin e Ali Kelmendit, një atdhetari tjetër nga Kosova, ishte emërtuar një kombinat etj.

Në Shqipëri për Kosovën dhe luftërat e saj për liri ishin shkruar libra historiografikë, romane e përmbledhje poezish, ishin bërë drama televizive e radiodrama, ishin thurur këngë e recitale etj.

Në vitin 1978, me rastin e manifestimit qendror kushtuar njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Tiranë, në krah të Enver Hoxhës ishte ulur kundërkomunisti nga Kosova, Demë Ali Pozhari, i cili gjatë viteve të LDB-së kishte luftuar kundër forcave çetnike serbe të veshura si partizan, që i ishin sulur Kosovës asokohe me tërë egërsinë e tyre.

Mbi të gjitha, siç ishte folur asokohe brenda qarqesh të besueshme në Prishtinë e gjetkë, në Shqipëri ishin bërë investime jo vetëm për mbrojtjen Shqipërisë, por edhe për mbrojtjen e Kosovës me vise të saj në raste të veçanta etj.

Kishin qenë format e tilla të brengosjes për Kosovën me vise, ato që në mesin e rinisë shqiptare të përqendruar në Prishtinë e kishin shtuar pa masë përkushtimin ndaj Shqipërisë.

Edhe Naseri, si shumë studentë të tjerë të asaj kohe, e kishte adhuruar Shqipërinë pa masë, dhe ashtu si shokët e tij të shumtë, kishte qenë i gatshëm që të flijohej për Shqipërinë.

## **Komunikim i gjallë shqiptaro-shqiptar**

Komunikimi midis shqiptarëve nga Kosova edhe viset e saj me shqiptarët nga vendi amë, i cili kishte filluar të ndodhte në vitin 1968 dhe kishte vazhduar përgjatë viteve të '70, për Naserin kishte paraqitur një risi tjetër të rrallë, të cilën ai e kishte gjetur në Kosovë. Komunikimi i tillë nuk kishte qenë thjesht një shtrëngim duarsh, por një komunikim midis duarsh të trupit të njëjtë, ku dora më e sprovuar (Shqipëria) e kishte ndihmuar dorën tjetër më pak të sprovuar (Kosovën), dhe te dyja bashkë e kishin ndihmuar njëra-tjetrën drejt qëllimit të përbashkët.

**Komunikimi student-pedagog**, i cili kishte ndodhur midis viteve 1974-1981, kishte paraqitur asokohe komunikimin më masiv të mundshëm midis mijëra studentëve nga Kosova e viset e saj me qindra profesorë (pedagogë) nga Shqipëria, të cilët kishin ligjruar për vite të tëra në Universitetin e Kosovës në Prishtinë. Kishin qenë pedagogët nga Shqipëria, ata, të cilët me punën e tyre të palodhur, me përgatitjet profesionale që kishin fituar nëpër vende të huaja, si dhe me sjelljet e tyre prej shoku e mikut ndaj secilit student, kishin mbjellë në mesin e studentëve në Kosovë aq shumë dashuri e respekt, si për veten e tyre, ashtu dhe për Shqipërinë.

Duke mos e pasur kompleksin e profesorëve të mëdhenj, pedagogët nga Shqipëria ishin takuar me studentët e tyre edhe gjatë kohës së lirë. Edhe Naseri kishte pasur rastin që të bënte një copë udhë përgjatë bulevardit qendror të Prishtinës me ndonjërin nga pedagogët nga Shqipëria. Kishte dashur të bisedonte me ta për vuajtjet e shqiptarëve në Maqedoni, por kishte nguruar sepse prapa krahëve të pedagogëve nga Shqipëria kishin bërë “shëtitje” edhe agjentët e UDB-së.

**Komunikimi me artistët e vendit amë** i të rinjve nga Kosova e viset tjera shqiptare, paraqitte formën tjetër të komunikimit të gjallë, që ndodhte në Kosovën e viteve të '70. Forma e tillë e komunikimit të të rinjve me artistët e arteve pamore, të grupeve teatrore dhe folklorike nga Shqipëria, kishte rezultuar asokohe me adhurim të zjarrtë, si ndaj artistëve, ashtu edhe ndaj vetë Shqipërisë. Kështu, studentët shqiptarë nëpër sallat e shfaqjeve në të cilat kishin performuar artistët nga Shqipëria, nga adhurimi i madh për ta dhe për Shqipërinë i kishin djegur edhe këmishat! Pas shfaqjeve të tilla një mori djemsh e vajzash kishin pritur para dyerve të sallave të shfaqjeve për t'u takuar me ndonjërin nga artistët e vendit amë, për t'u njohur e për të bërë me ta një copë udhë bashkë.

Natyrisht se edhe Naseri kishte shkuar asokohe nga shfaqja në shfaqje, ishte emocionuar, ishte kënaqur, ishte frymëzuar. Pas shfaqjeve edhe ai ishte takuar me artistë nga Shqipëria, u kishte treguar atyre se ishte nga Struga, u kishte thënë se Shqipëria nëpërmjet grupeve të tilla teatrore e folklorike, po u jepte shqiptarëve në Kosovë frymëzim, gjallëri, shpresë, kurajo dhe Shqipëri!

**Komunikimi nëpërmjet vizitave disaditore** që kishin bërë në Shqipëri grupe studentësh e profesorësh nga Universiteti i Kosovës, kishte ndikuar po ashtu që në Kosovë e gjetskë të ishte rritur përkushtimi ndaj Shqipërisë.

Sidomos grupet e studentëve që e kishin vizituar Shqipërinë i kishin bartur përshtypjet e tyre në mesin e studentëve të tjerë. U kishin folur atyre për vizitat që kishin bërë duke filluar që nga Shkodra në veri e deri në Gjirokastrë në jug të Shqipërisë. U kishin treguar për muzetë, teatrot, operën e baletin dhe ekspozitat që kishin vizituar. U kishin treguar për hidrocentralet, uzinat dhe fabrikat që kishin parë, dhe për relievet e bukura të bregdetit shqiptar me brezare pemësh radhë-radhë, ashtu siç u kishin treguar edhe për librat që kishin blerë, për fotografitë që kishin bërë, dhe, mbi të gjitha, për respektin që u ishte bërë. Disa nga studentët që e kishin vizituar asokohe Shqipërinë dhe që kishin folur për të arriturat e saj, ishin marrë në biseda informative nga ana e shërbimit sekret jugosllav, dhe ishin kërcënuar së po të vazhdonin ta lavdëronin Shqipërinë do të hetoheshin e dënoheshin një ditë.

**Qasje dhe mendësi të reja** ishin bartur në Kosovë e vise të saj nga komunikimi

i tillë i gjallë shqiptaro-shqiptarë i viteve të '70, të cilat ua kishin zënë vendin qasjeve dhe mendësive të vjetra: kanunore, krahinore, patriarkale dhe feudale.

Kështu, në Kosovë vendin e dialekteve kishte filluar ta zinte gjuha letrare shqipe e njësuar; sedrat krahinore kishin filluar të shkriheshin brenda tërësisë kombëtare shqiptare; Kosova dhe viset e saj ishin shikuar si pjesë e pandashme e tërësisë tokësore e cila i ishte shkëputur padrejtësisht Shqipërisë; atdhetarët, heronjtë dhe dëshmorët e rënë nëpër luftëra ishin shikuar, jo vetëm si vlera të krahinave të caktuara, por, në radhë të parë, si vlera të përbashkëta të kombit shqiptar; rinia shqiptare kishte filluar t'u kundërvihet mentaliteteve të vjetra lidhur me hakmarrjen dhe gjakmarrjen, martesat e imponuara me shkuari, si dhe lidhur me dallimet gjinore sipas mendësisë: djemtë në shkolla e vajzat në shtëpi!.

## **Me sy e vesh kah Shqipëria!**

Kishte qenë forma e komunikimit audio-vizual e shqiptarëve në Kosovë e gjetkë me vendin e tyre amë, Shqipërinë, ajo që i kishte mbajtur shqiptarët gjatë viteve të '70 dhe më pas edhe gjatë viteve të '80, me shpinë të kthyer nga Jugosllavia dhe me sy e vesh të kthyer kah Shqipëria! Para se gjithash kishte qenë evokimi historik, politik dhe patriotik, në formën e mesazhit verbal, letrar, artistik, filmik, dramatik e folklorik, ai që, duke u bartur në mesin e shqiptarëve në Kosovë e vise të saj nëpërmjet të mjetëve të komunikimit masiv të Shqipërisë, kishte trokitur pandërprerë në ndërgjegjen e tyre kombëtare, ashtu si një orë e kurdisur dhe si një zë i fuqishëm i vendit amë, që qëndronte në krah të tyre për çdo situatë e rrethanë.

Shqipëria nëpërmjet komunikimit të tillë audiovizual ua kishte bërë të qartë shqiptarëve në Jugosllavi: se shumë vise shqiptare në veri dhe në jug, Kongresi i Berlinit i vitit 1978 ua kishte dhënë Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë; se Konferenca e Ambasadorëve në Londër e mbajtur pas Luftërave Ballkanike në vitin 1913 edhe vise të tjera shqiptare në veri e në jug ua kishte lënë Mbretërisë së Serbisë, të Malit të Zi dhe të Greqisë; se Konferenca e Versajë-Parisit e mbajtur pas Luftës së Parë Botërore në vitet 1918/1920, kishte dashur që edhe Shqipërinë e vitit 1913 ta shuante nga faqja e dheut, përkatësisht kishte dashur që gjysmën e saj veriore t'ia aneksonte Mbretërisë-Serbo-Kroato-Slllovene të porsakrijuar, kurse gjysmën e saj jugore t'ia aneksonte Greqisë; se Konferenca e Paqes e Parisit e mbajtur pas Luftës së Dytë Botërore në vitin 1946, duke i përligjur aneksimet e viseve shqiptare të bëra nga Kongresi i Berlinit dhe nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, sërish e kishte lënë Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore në kuadër të Jugosllavisë.

Më tej, Shqipëria, nëpërmjet të komunikimit audiovizual, ua kishte përkujtuar shqiptarëve në Jugosllavi luftërat dhe kryengritjet e shumta që të parët e tyre kishin bërë në mbrojtje të integritet territorial të Shqipërisë, duke filluar që nga vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri gjatë LDB-së, ashtu siç ua kishte përkujtuar atyre edhe masakrat dhe shpërnguljet masive, të ushtruara mbi ta nga ana e pushtetarëve serbë, malazez, maqedono-bullgarë dhe jugosllavë, sërish duke filluar që nga Kongresi i Berlinit e deri gjatë e pas LDB-së. Pikërisht, rikujtimi i tillë i historisë shqiptarët në Kosovë e vise të saj, i kishte frymëzuar e motivuar që ata në momentin më të përshtatshëm historik, me luftëra çlirimtare si të të parëve të tyre, të shkëputeshin nga kthetrat e Jugosllavisë dhe t'i bashkoheshin Shqipërisë.

Nëpërmjet emetimit radiofonik të artikujve me karakter politiko-historik, Shqipëria ua kishte ligjëruar shqiptarëve në Kosovë e vise të tjera, ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha në dëm të viseve të tyre, bashkë me strategjitë dhe taktikat aneksioniste të vendeve fqinje ballkanike. Kjo bëhej sigurisht me qëllim që shqiptarët në Jugosllavi, duke nxjerrë sa më shumë mësim nga historitë e kaluara, të dinin t'i parashikonin edhe në të ardhmen strategjitë dhe taktikat antishqiptare të armiqve të njëjtë. Nëpërmjet emetimit të filmave dhe të dramave televizive të cilat i trajtonin luftërat dhe ngjarjet historike të ndodhura në Kosovë e në vise shqiptare, Shqipëria e atyre kohëve ua mësonte shqiptarëve në Kosovë e gjetkë edhe rrugët e lirisë.

Kishin qenë emisionet e tilla ato që kishin bërë që shumë studentë të Universitetit të Kosovës të ishin drejtuar me sy e vesh kah Shqipëria! Ata e kishin dëgjuar me mendje, me shpirt e me zemër zërin e saj, i kishin dëgjuar me përkushtim sidomos fjalimet e Enver Hoxhës, të cilin e konsideronin udhëheqësin e të gjithë shqiptarëve në Ballkan.

Naser Hani dhe studentë të tjerë, duke e kuptuar komunikimin audiovizual të Shqipërisë me Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi si frymëzimdhënës dhe porosilënës, kishin menduar se çfarë duhej të bëhej që frymëzimet dhe porositë e tilla të ktheheshin në detyra konkrete për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi.

## ■ Kosova një oazë paqeje dhe lufte!

### Kosova në anën tjetër të medaljes

Pas rreth tre vjetësh qëndrimi në Prishtinë Naser Hani ia kishte parë Kosovës edhe atë “anën tjetër të medaljes”, e cila kishte folur se Kosova edhe në vitet e

'70, kur ajo kishte pasur autonomi të zgjeruar, megjithatë kishte qenë sërish e diskriminuar. Vetë format e diskriminimit politik dhe ekonomik kishin folur se Kosova nuk ishte vetëm një "oazë paqeje", ashtu, siç i ishte dukur Naserit fillimisht, por ajo do të mund të kthehej edhe një "oazë lufte" nëse një ditë rinia studentore e Kosovës do të ngritej kundër formave të tilla të diskriminimit, kurse Serbia dhe Jugosllavia do t'i kundërviheshin asaj egërsisht me të gjitha mjetet në dispozitim.

### **Format e diskriminimit politik dhe ekonomik**

Rinia studentore e viteve të '70 të gjitha format e diskriminimit të Kosovës dhe të shqiptarëve i kishte debatuar dhe analizuar një për një, si dhe ishte matur shumë herë që të ngrihej kundër tyre publikisht.

**Diskriminimi politik** i Kosovës kishte qenë kryekëput me natyrë kushtetuese, sepse edhe kushtetuta më e mirë jugosllave, siç kishte qenë ajo e vitit 1974, Kosovën në vend që ta kishte përkufizuar si republikë në vetë, e trajtonte si një krahinë autonome në kuadër të Serbisë e të Jugosllavisë; po kjo kushtetutë, në vend që shqiptarët e Kosovës t'i përkufizonte si komb (shumicë), siç ishin realisht, i trajtonte si kombësi (pakicë- minoritet), ndërkohë që pakicat serbe e malazeze i trajtonte paradoksisht si kombe. Vetë përkufizimi i shqiptarëve si kombësi s'ishte bërë rastësisht, por qëllimisht, sepse sipas legjislacionit në fuqi vetëm popujt e përkufizuar si kombe kishin të drejtë t'i kishin republikat e tyre kombëtare në Jugosllavi.

Meqë shqiptarët në Kosovë ishin trajtuar si pakicë, kjo kishte bërë që edhe shqiptarët në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore të konsideroheshin minoritete, për të qenë ata këssoj edhe të diskriminuar politikisht se shqiptarët në Kosovë.

**Diskriminimi ekonomik** i Kosovës së viteve të 70' kishte qenë pasojë e drejtpërdrejtë e diskriminimit të saj politiko-kushtetues.

Duke qenë Kosova edhe pjesë e Serbisë edhe pjesë e federatës jugosllave, Jugosllavia i kishte shitur mineralet e Kosovës për të paguar këste të borxheve të jashtme; minierën e Trepçës, të pasur me plumb, zink, ar e argjend e kishte vënë si hipotekë për të thithur kredi të reja nga bankat ndërkombëtare; rezervat e thëngjillit në Kastriot (asokohe Obiliq) ishin shfrytëzuar egërsisht për t'i furnizuar me rrymë edhe pjesët tjera të Jugosllavisë etj.

Nga ana tjetër, Kosova dhe shqiptarët ishin diskriminuar nga federata jugosllave edhe duke bërë ajo investime më të pakta ekonomike në Kosovë. Kjo kishte ndikuar që Kosova të jetë regjioni më i prapambetur dhe më i varfër i Jugosllavisë. Rrethanat e tilla me diskriminim ekonomik kishin bërë

që shqiptarët të iknin nga Kosova për të gjetur punë në vende të ndryshme të Evropës.

Investime, akoma më të vogla ekonomike se në Kosovë, ishin bërë në viset shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore në jug të Serbisë. Kuptohet, me qëllim që edhe shqiptarët e këtyre viseve të spastroheshin etnikisht, duke u punësuar jashtë vendit.

## **Duke i favorizuar serbët dhe malazeztë diskriminoheshin shqiptarët**

Nga ana tjetër shqiptarët në Kosovë ishin “diskriminuar negativisht” edhe nëpërmjet të “diskriminimit pozitiv” të serbëve dhe të malazezve në të gjitha fushat e jetës.

Kështu, ndonëse sipas të të ashtuquajturit “çelës nacional”, pjesëmarrja e të gjitha popullatave në të gjitha fushat e jetës, duhej të bëhej në përputhshmëri me përqindjen e tyre brenda popullatës së gjithëmbarshme të Kosovës, megjithatë, “çelësi” i tillë nacional i drejtë në parim, zbatohet shtrembër në praktikë, duke i favorizuar kështu serbët dhe malazeztë dhe duke i defavorizuar shqiptarët në të gjitha fushat e jetës.

Në radhë të parë ishte e ashtuquajtura “**politik kadrovike**”, e cila në kundërshtim me “çelësin” e lartpërmendur nacional, lejonte që në posedim të pakicës serbe e malazeze, që së bashku, sipas regjistrimit të popullatës në vitin 1971, përbënin rreth 15% të popullatës së gjithëmbarshme, të ishin rreth 30% e posteve kryesore politike, shtetërore, administrative dhe shoqërore të Kosovës. Favorizimi i tillë i pakicës serbe dhe malazeze e kishte zvogëluar udhëheqjen dhe administrimin e Kosovës nga ana e shumicës shqiptare, e cila kishte përbërë rreth 80% të popullatës së gjithëmbarshme.

E njëjta gjë ndodhte edhe me të ashtuquajturën “**politikë e punësimit**”, sepse pjesëtarëve të pakicës serbe dhe malazeze, sërish në kundërshtim me të ashtuquajturin “çelës nacional”, u ishin dhënë rreth 30% e vendeve të punës. Kështu, vetë statistikat zyrtare të atyre kohëve kishin bërë të ditur, se në Kosovë kishte qenë i punësuar çdo i treti apo i katërti serb e malazez, që do të thoshte secili kryefamiljar. Dhe të njëjtat statistika bënin të ditur se në Kosovë kishte qenë i punësuar çdo i 14-ti shqiptarë, që do të thoshte çdo i treti apo i katërti kryefamiljar. Kështu, tërë papunësia, e cila në Kosovë ishte tri herë më e madhe se në pjesët tjera të Jugosllavisë, kishte rënduar njëanshmërisht vetëm mbi shqiptarët.

Edhe e ashtuquajtura “**politik e banimit**” në kundërshtim flagrant me “**çelësin nacional**” e kishte favorizuar pakicën serbe e malazeze në masë të

konsiderueshme, sepse rreth 40% e banesave shoqërore kishin qenë në posedim të pakicave të tilla kombëtare. Kjo kishte bërë që shqiptarët në masë të madhe, duke bërë kursime ekstreme, t'i ndërtonin shtëpitë e tyre private.

Dhe, së fundi, serbët dhe malazezët në Kosovë ishin diskriminuar pozitivisht edhe nëpërmjet të së ashtuquajturës **“politikë arsimore”**, sepse rreth 30% e studentëve të rinj, që pranoreshin çdo vit në Universitetin e Kosovës ishin serbë e malazez, përqindje kjo shumë më e madhe se përqindja e serbëve dhe e malazezve në Kosovë.

Por, politikat e lartpërmendura ishin edhe më diskriminuese për shqiptarët në gjysmën perëndimore të Maqedonisë, në pjesën juglindore të Malit të Zi, dhe në Kosovën Lindore në jug të Serbisë, vise këto ku ata ishin shumicë. Shqiptarët në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore, pothuajse s'kishin qenë fare hisedarë të politikave kadrovike, të punësimit, të banimit e të arsimit të lartë. Ata ishin pothuajse të përjashtuar nga të gjitha fushat e jetës, duke paraqitur kështu popullatat më të shtypura në kontinentin e Evropës.

### **Kosova me qytetarë të ndarë në klasa**

Ndonëse autonomia e Kosovës e vitit 1974 hendeqet etnike dhe klasore të kohëve të kaluara midis shqiptarëve, në njërën anë, dhe serbëve e malazezve, në anën tjetër, në njëfarë mase i kishte rrafshuar, megjithatë, hendeqet e tilla nuk ishin zhdukur.

Kishin qenë format e diskriminimit negativ të shqiptarëve dhe të diskriminimit pozitiv të serbëve dhe të malazezve, ato që shoqërinë e Kosovës e kishin bërë edhe gjatë viteve të '70 shoqëri me klasa në baza etnike. Në njërën anë ishin qytetarët e klasës së parë, serbët e malazezët, kurse në anën tjetër ishin qytetarët e klasës së dytë, shqiptarët, por edhe myslimano-boshnjakët, turqit dhe romët.

Ndarja e tillë etnoklasore kishte bërë që qytetarët serbë dhe malazez, në krahasim me shqiptarët, të ishin më të veshur me pushtet, që atyre më shumë se shqiptarëve t'u kishte ardhur era vendimmarrje, dhe për rrjedhojë edhe kërcënim e frikë për të tjerët. Kjo ishte arsyeja pse midis shqiptarëve ishte thënë asokohe se, “për me t'marrë vesh shqiptari, duhet t'i flasësh serbisht!”.

### **Jetë më të urbanizuar dhe të qytetëruar**

Sidomos favorizimet që u ishin bërë serbëve dhe malazezve në punësim dhe në banim, kishin ndikuar që ata të jetonin kryesisht në qytete dhe qyteza, duke bërë kështu jetë më të rregullt, më të kultivuar e më të urbanizuar se të gjithë të tjerët.



Vetë jeta e tillë e qytetarëve serbë e malazez, kishte bërë që ata në pamje të parë të ishin dukur si qytetarë të klasës të parë. E kundërta ndodhte me shqiptarët. Ata duke bërë kryesisht jetë të vështirë rurale, duke qenë më pak të punësuar dhe më pak të kamur, që në pamje të parë ishin dukur vetvetiu si qytetarë të klasës së dytë.

## **Me etiketa dhe akuza në xhep!**

Shqiptarët në Kosovë diskriminoheshin edhe nëpërmjet të lirisë që serbo-malazeztë kishin për t'i akuzuar dhe etiketuar shqiptarët si nacionalistë, sa herë që ata i kërkonin të drejtat e tyre. Ishte vetë origjina sllave dhe mbrojtja joparimore e serbëve dhe e malazezve të Kosovës nga republika e Serbisë dhe e Malit të Zi, ato që i kishin pozicionuar ata ndaj shqiptarëve si “ujku me qengjin” në përrallën e La Fontenit.

Kështu, sa herë që shqiptarët ishin shprehur kundër punësimit të favorizuar të serbëve e malazezve në kundërshtim me të ashtuquajturin “çelës nacional”, ose sa herë që ata ishin shprehur kundër dhënies së favorizuar të banesave shoqërore serbëve e malazezve, këta të fundit etiketat dhe akuzat politike kundër shqiptarëve i mbanin të gatshme në xhep! Kështu, akuza e “nacionalizmit shqiptar”, duke filluar që nga LDB-ja e deri në vitet e '70, herë më shumë e herë më pak, s'kishte pushuar së përdoruri kundër shqiptarëve, por akuza për nacionalizmin serb e malazez s' ishte dëgjuar asnjëherë, kjo sikur të gjithë serbët e malazezët e Kosovës të kishin qenë engjëj me fletë!

Por, akuza e “nacionalizmit shqiptar” ishte keqpërdorur edhe më shumë për t'i etiketuar shqiptarët në Maqedoni. Shqiptarët në Maqedoni shiheshin si nacionalistë edhe kur i drejtoheshin ndonjë nëpunësi të ndonjë zyreje në gjuhën shqipe, edhe kur kishin folur ndonjë fjalë të mirë për Shqipërinë, edhe kur ata fëmijët e tyre i kishin pagëzuar me emra tipik iliro-shqiptarë, si p.sh: Gentian, Agron, Teutë, Shqipe, Liridon etj.

## **Shjellje shpërfillëse dhe injoruese ndaj shqiptarëve**

Ndjenja e të qenit qytetarë të klasit të parë bashkë me ndjenjën e të qenit me “shpinë të fortë” nga ana e Serbisë dhe e Malit të Zi, kishin bërë që serbët e malazeztë në Kosovë të silleshin me shpërfillje e injorim me shqiptarët edhe gjatë viteve të '70.

Serbët e malazeztë rrinin të distancuar me shqiptarët, komunikonin me ta shkurt e pak dhe atë e bënin vetëm në gjuhën serbe. Ata nuk u thonin shqiptarëve as “mirëdita” në gjuhën shqipe. Nëpërmjet qëndrimit të tillë, serbët dhe malazeztë sikur kishin dashur t'u tregonin shqiptarëve, se ata qëndronin

më lartë në shumë aspekte, si origjinë, gjuhë, religjion, kulturë e edukatë, dhe se me shqiptarët s'i lidhte asgjë tjetër, përveç fatkeqësisë së të jetuarit bashkë. Edhe kur shqiptarët kishin dashur që me serbët e malazeztë të ndanin diçka nga përditshmëria, nga hallet e jetës dhe aktualiteti, ata u ishin përgjigjur atyre me ftohtësi e indifferencë. Kësisoj, njëfarë afrimi i serbëve e malazezve me shqiptarët kishte ndodhur asokohe në fshatrat e përziera etnikisht, në mesin e anëtarëve të lidhjes komuniste dhe tek-tuk në mesin e të rinjve.

### **Rinia studentore e Kosovës do të reagonte një ditë**

Kishin qenë format e tilla diskriminimit politik dhe ekonomik të përmendura më lart, dhe kishin qenë sjelljet akuzuese dhe injoruese të serbëve dhe të malazezeve ndaj shqiptarëve, ato kundër të cilave një ditë do të ngritej rinia studentore e Kosovës e përqendruar në Prishtinë, kurse Serbia duke iu kundërvënë Kosovës me të gjitha egërsitë, do ta kthente atë nga një **“oazë paqeje”** në një **“oazë lufte”** për liri!

Kjo kishte qenë **“ana tjetër e medaljes”**, të cilën Naseri si dhe shumë studentë të tjerë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore, ia kishin parë Kosovë pas ndonjë vit qëndrimi në Prishtinë.

## **V. Me ngjarjet e “Pranverës së Madhe” të vitit 1981**

### **■ Si kishin ndodhur ngjarjet e mars-prillit të vitit 1981**

Naser Hani duke qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i demonstratave të marsit dhe të prillit të vitit 1981, ai, gjatë viteve të mërgimit në Austri u kthehej atyre shpeshherë nëpërmjet të kujtimit të tij të përmallshëm. Duke i përshkruar ato njëra pas tjetrës me të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre edhe ne iu ktheheshim atyre me kujtimet tona.

Në shenjë respekti për Naser Hanin dhe për hir të lexuesve të gjeneratave të reja, të cilët ngjarjet e “Pranverës së Madhe” të vitit 1981 nuk i kanë parë e përjetuar drejtpërdrejtë, më poshtë po përpieqem që t’i përshkruaj ato ashtu siç i kishte përjetuar dhe siç i evokonte Naseri.

### **■ Si kishte ndodhur protesta “spontane” e 11 marsit**

#### **Protesta e filluar në mensë kishte vazhduar në rrugë**

Siç rrëfente Naseri, në mbrëmjen e 11 marsit, në mensën e studentëve në Prishtinë, një grup studentësh të pakënaqur me ushqimin dhe pritjet e gjata në radhë, kishte filluar të fjalosej zëshëm me personelin e mensës, dhe në shenjë revolte kishte përplasur për dysheme tabakatë e ushqimit dhe tavolinat e bukës. Në mesin e tollovisë së krijuar ky grup studentësh kishte filluar të thërriste zëshëm: “Duam kushte!”, “Duam kushte!”. Studentë të tjerë i ishin bashkangjitur menjëherë thirrjeve të tilla. Më pas grupi i studentëve të revoltuar, të cilëve u ishte bashkangjitur edhe Naseri, kishte thirrur “po dalim në rrugë!”

Kështu, te udhëkryqi pranë mensës së studentëve ishin tubuar shumë shpejt rreth dy-tre qind studentë, në mesin e të cilëve Naseri e kishte parë edhe Musli e Bajram Kosumin dhe disa studentë të tjerë, të cilët i kishte njohur më parë.

Ky kishte qenë momenti kur protesta e filluar në mensë kishte dalë në rrugë.

### **Protestë që ishte kthyer në demonstratë**

Pas pak te udhëkryqi afër mensës studentët ishin bërë kolonë, dhe duke thirrur kryesisht “Duam kushte!”, “Duam kushte!” dhe ndonjëherë edhe “Kosova Republikë!”, kishin marshuar drejt qendrës së qytetit, duke i dhënë kësioj protestës formën e demonstratës. Duke parakaluar përmes sheshit qendror të Prishtinës, në të dy anët e të cilit kishin qenë institucionet kryesore politike dhe shtetërore të Kosovës, kolona e studentëve i kishte theksuar edhe më zëshëm kërkesat e saj në pamje të parë me natyrë sociale. Pas përballjes me forcat policore në qendër të qytetit, një pjesë e studentëve ishte shpërndarë nëpër rrugë dytësore, kurse pjesa e kishte vazhduar përgjatë rrugës në dalje të Prishtinës. Duke parakaluar para Fakultetit filozofik edhe kjo pjesë e studentëve ishte ndeshur me forca policore dhe ishte shpërndarë gjithandej. Më pas pjesa më entuziaste e studentëve në mesin e të cilëve edhe Naser Hani, ishte mbledhur sërish te udhëkryqi afër mensës së studentëve ku kishte qëndruar deri vonë në mbrëmjen e 11 marsit.

### **Protestë me pak publicitet**

Protestë-demonstratës së 11 marsit nuk iu dha ndonjë publicitet i veçantë. Vetëm pas dy ditësh në mjetet informimit u dha një lajm i shkurtër. Përfärsisht ishte thënë se “Në mbrëmjen e 11 marsit një grup i vogël i të rinjve në Prishtinë e ka prishur rendin dhe qetësinë publike!”

Lidhjen Komuniste e Kosovës protesta e 11 marsit e kishte zënë fare të papërgatitur. Ndonëse Komiteti Krahinor i LKK-së ishte marrë me vlerësimin e protestës së 11 marsit duke i dhënë asaj karakter „spontan“ e „social“, megjithatë, ajo publikisht ishte deklaruar fare pak.

Duke mos i dhënë protestës së 11 marsit publicitet të madh, LKK-ja ishte përpjekur që jehona e saj në mesin e studentëve të ishte sa më e vogël.

### **Arrestime e burgosje të reja**

Forcat e rendit në krahasim me dhunën ekstreme që ishte ushtruar kundër demonstruesve në demonstratat e mëvonshme, ndaj protestuesve të 11 marsit ishin treguar pak a shumë të matura, kurse ato të shërbimit të sigurimit të shtetit ishin mjaftuar vetëm me identifikimin e fytyrave kryesore të asaj proteste.

Në ditët në vazhdim studentët që kishin rënë më së shumti në sy gjatë protestës së 11 marsit ishin bastisur dhe arrestuar, kurse pas ndonjë jave apo muaji ishin nxjerrë para gjykatave dhe ishin dënuar me burgje afatgjata.

Përfundimisht, nëpërmjet të protestë-demonstratës së 11 marsit, studentët dhe pushteti ia kishin treguar për herë të parë “dhëmbët” njëri-tjetrit!

### **Protestë që i inkurajonte shqiptarët**

Ndonëse protesta e 11 marsit kishte qenë e veshur kryesisht me kërkesa sociale, dhe asaj nuk i ishte dhënë ndonjë publicitet i madh, megjithatë, jehona e saj ishte përhapur me të madhe. Protesta e 11 marsit ishte “lexuar” nga masat popullore e studentore si një “protestë provë” me “karakter social”, pas të cilës do të pasonin protesta e demonstrata të tjera me karakter politik. Brenda kuptimësisë së tillë protesta e 11 marsit i kishte inkurajuar të gjithë shqiptarët që të ngriteshin për realizimin e të drejtave të tyre kombëtare dhe politike njëkohësisht.

Nga ana tjetër, edhe vetë fakti se protesta e 11 marsit kishte qenë protesta e parë që kishte ndodhur në Jugosllavi pas vdekjes së Titos, kishte bërë që jehona e saj t'i kalonte kufijtë e Kosovës, duke u përhapur gjithandej Jugosllavisë dhe përtej saj.

### **■ Si kishte ndodhur demonstrata e 26 marsit**

#### **Stafetës së Titos i ishte prerë rruga në Prishtinë!**

Një ditë para se të ndodhte demonstrata studentore e 26 marsit e vitit 1981 në Prishtinë, kishte ndodhur demonstrata e 25 marsit në Prizren, në të cilën, ndër të tjera, ishte dëgjuar edhe kërkesa “Kosova Republikë!”. Por, meqë demonstrata e 26 marsit e në Prishtinë kishte qenë masovike, kjo kishte bërë që jehona e demonstratës së Prizrenit të kalonte në heshtje. Sipas Naserit, studentët kishin vendosur që të demonstironin me 26 mars në Prishtinë me kërkesën politike “Kosova Republikë”, ndër të tjera edhe për vetë faktin se atë ditë nëpër Prishtinë do të parakalonte stafeta e Titos. Kësisoj ata kishin dashur t'i tregonin opinionit jugosllav, se shqiptarët nuk pajtoheshin me statusin politik të Kosovës si krahinë autonome brenda republikës së Serbisë dhe brenda Jugosllavisë, status ky i cili Kosovës i ishte përcaktuar nga Titoja dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë.

Derisa Titoja kishte qenë gjallë, ai, për çdo 25 maj në ditëlindjen e tij, që ishte shpallur festë shtetërore e njohur si “Dita e rinisë”, stafetën e tillë pasi që ajo për dy-tre muaj kishte kaluar dorë më dorë nga të rinjtë gjithandej Jugosllavisë, e kishte marrë vetë në dorëzim, kuptohet ashtu i veshur gjithnjë me uniformën e bardhë të marshallit dhe i kurdisur si pasha bashkë me klubin e tij në tribunën festive të vendosur në stadiumin e madh të futbollit në Beograd të mbushur

me të rinj. Por në vitin 1981, në mungesë të Titos që kishte vdekur para një viti, ishte vendosur që stafeta e Titos, më 25 maj t'i dorëzohej Kryetarit të Rinisë së Jugosllavisë në prani të presidencës tetanëtarëshe jugosllave, edhe ajo e kapardisur në stilin e Titos në tribunën festive në stadiumin e madh të Beogradit.

Kështu më 26 mars të vitit 1981 edhe udhëheqësit kryesorë të Kosovës ishin bërë gati që stafetën e Titos, e cila atë ditë do të parakalonte nëpër Prishtinë, ta prinin me “faqe të bardhë”, duke mbajtur fjalime të rastit në tribunën festive të vendosur para Komitetit Krahinor të LKK-së. Por, meqë përafërsisht në të njëjtën kohë kishte filluar edhe demonstrata e studentëve, kjo kishte bërë që manifestimi kushtuar stafetës së Titos të ishte përfunduar para kohe. Kësisoj, kishte ndodhur që dikush për herë të parë t'ia prente rrugën stafetës së Titos! Dhe kjo kishte ndodhur në Kosovë, aty ku “peri kishte qenë më i hollë...!”

### **Qarku rrugor i demonstratës**

Më 26 mars studentët e Qendrës Konviktore të Prishtinës me flamuj kombëtar dhe me parulla të shkruara të ngritura lart, pas përballjes me forcat policore në sheshin midis konvikteve, ishin paraqitur te udhëkryqi afër mensës së tyre, aty ku kishte filluar edhe protesta e 11 marsit. Më pas ata ishin bërë kolonë dhe kishin vazhduar duke brohoritur “Kosova Republikë” përposhtë rrugës kryesore para Institutit Albanologjik. Te udhëkryqi tjetër i radhës, ata ishin kthyer rrugës tjetër kryesore në të djathtë, duke parakaluar kësijoj para Fakultetit filozofik dhe duke vazhduar drejt sheshit qendror të Prishtinës.

Pjesa tjetër e vogël e studentëve ishte përpjekur që të marshonte përposhtë rrugës tjetër kryesore midis lagjes Ulpiana dhe Qendrës Klinike universitare. Por kjo pjesë e studentëve duke qenë e vogël dhe duke u ndeshur me forca të shumta policore këtij qëllimi nuk ia kishte arritur. Kështu, demonstrata e 26 marsit ishte zhvilluar kryesisht në qarkun rrugor të përmendur më lartë me pikënisje te udhëkryqi afër mensës së studentëve.

Studentët duke parakaluar në sheshin qendror të Prishtinës ishin ndaluar enkas para Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës për ta theksuar zëshëm kërkesën politike “Kosova Republikë!”, e cila ishte pasuar edhe kërkesa e parulla të tjera, si “Trepça puno Beogradi ndërto!”, “Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë!”, “Lironi shokët tonë nga burgjet!”, “Jemi shqiptarë, s' jemi jugosllavë!”, “Jemi komb, s' jemi kombësi!”, “Kosova është e jona!” etj.

Meqë në sheshin qendror të Prishtinës kishte ndodhur intervenimi i ashpër policor kolona e studentëve ishte ndarë në dy pjesë. Njëra pjesë ishte detyruar që të shpërndahej brenda hapësirës rreth e rrotull Bibliotekës Universitare

të Kosovës. Pjesa tjetër kishte vazhduar të demonstronte mëtej duke arritur të udhëkryqi tjetër anash Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, ku ishte kthyer në të djathtë rrugës tjetër kryesore duke arritur kështu atje ku ishte nisur, të udhëkryqi i parë, afër mensës së studentëve. Kështu me 26 mars studentët nga intervenimi i forcave policore disa herë ishin shpërndarë e disa herë ishin bashkuar duke demonstruar sërish në qendër të Prishtinës.

### **Pjesëmarrëse kishin qenë edhe vajzat**

Për dalim nga protestë-demonstrata e 11 marsit, në të cilën pjesëmarrje të vajzave pothuajse s'kishte pasur fare, në demonstratën e 26 marsit pjesëmarrja e vajzave studente kishte qenë e konsiderueshme. Derisa një pjesë e tyre kishte demonstruar rrugëve bashkë me djemtë, pjesa tjetër e tyre kishte demonstruar brenda hapësirës midis konvikteve, duke thirrur kërkesa e parulla e njëjta politike. Meqë policia në sheshin midis konvikteve atyre u kishte hedhur gaz lotsjellës, ato ishin futur brenda konviktit të vajzave, që ishte pranë rrugës kryesore. Meqë ato kishin vazhduar të demonstrosnin edhe mbi pullazin e rrafshët të konviktit të tyre, duke thirrur “Kosova Republikë” dhe duke kënduar këngë patriotike, policia u kishte hedhur bomba lotsjellësi edhe mbi pullazin e konviktit, si dhe në dhomat e gjumit nëpërmjet dritareve.

Kënga që ato e kishin kënduar mbi pullazin e konviktit më 26 mars, kishte qenë ajo kushtuar betejës së Kaçanikut të vitit 1912, kur forcat shqiptare të udhëhequra nga Isa Boletini dhe Idriz Seferi, ua kishin zënë pritën ushtrive turke në të dy anët e grykës së Kaçanikut. Kështu, ato kishin kënduar: **“Kaçanik shkëmb e gur, digjesh vritesh për flamur. Për flamurin e Skënderit luftojnë djemtë e Idriz Seferit...!”** etj. Kënga e tillë aludonte qartë se shqiptarët do të luftonin edhe kundër ushtrive serbe e jugosllave, ashtu siç kishin luftuar të parët e tyre kundër ushtrive turke në vitin 1912.

### **Qindra forca policore u ishin kundërvënë studentëve**

Më 26 mars të vitit 1981 ishin angazhuar qindra forca policore dhe dhjetëra agjentë të sigurimit të shtetit për t'iu kundërvënë demonstratës së studentëve.

Kështu, sidomos brenda qarkut rrugor të demonstratës me pikënisje të udhëkryqi afër mensës së studentëve, kolona e studentëve ishte përballur disa herë me forcat policore të Policisë së Kosovës, brenda të cilës kishte edhe serbë e malazez. Derisa një pjesë e policisë i kishte goditur studentët me shqelma e shkopinj gome, pjesa tjetër e saj u kishte hedhur atyre nga distanca bomba me gaz lotsjellës. Disa studentë që kishin rënë më shumë në sy, policia i kishte arrestuar nëpër rrugë, duke i futur dhunshëm nëpër makinat e tyre “xhipsa”,

ndërkohë që masa studentore kishte arritur që disa prej tyre t'i shpëtonte duke ia shkëputur policisë nga duart.

Nga ana tjetër, rreth e rrotull kolonës së studentëve ishin sjellë dhjetëra agjentë civilë të sigurimit shtetëror, disa prej të cilëve njiheshin tashmë nga studentët. Detyra e tyre ishte deshifrimi i studentëve organizatorë dhe prijës së demonstratës së 26 marsit, në mënyrë që më pas ata të arrestoheshin, të hetoheshin dhe të dënoheshin me burgje. Agjentëve të cilët ishin parë me aparate fotografike në dorë, studentët ua kishin thyer ato. E megjithatë, demonstrata e 26 marsit ishte fotografuar e inçizuar nga distanca, mbase nga pullazet e ndërtesave të larta pranë rrugëve kryesore të Prishtinës.

### **Përleshje trup me trup!**

Në një moment kur kolona e studentore ishte gjendur para udhëkryqit në afërsi të Fakultetit filozofik dhe kishte tentuar për t'u kthyer rrugës tjetër kryesore në të djathtë, për t'u futur pastaj në qendër të qytetit, ajo ishte ndodhur para kordonit të policisë speciale të Kosovës me qendër në Hajvali. Një togë i kësaj policie duke u rreshtuar horizontalisht ua kishte zënë pritën studentëve pikërisht te ky udhëkryq. Në çastin kritik kur midis kolonës së studentëve dhe kordonit policor kishin mbetur vetëm pak metra, të dy palët ishin ndalur në vend për disa sekonda, mbase për ta matur me sy njëra-tjetrën. Në këtë moment edhe studentët e kishin konsoliduar radhën e tyre të parë, duke i larguar prej saj vajzat dhe djemtë më të dobët fizikisht. Pas këtij momenti midis të dy palëve kishte ndodhur përleshja trup me trup! Njëri prej atyre djemve që ishte futur brenda radhës së parë të studentëve kishte qenë edhe Naser Hani.

Por, derisa pala studentore, kishte rezistuar me grushte, pala tjetër, ajo policore, ishte kundërpërgjigjur me goditje me shkopinj gome, me kondakë pushkësh e me shqelma me çizme të rënda. Pasi që përleshja e tillë kishte zgjatur disa minuta, kordoni policor duke u gjendur i rrethuar nga të gjitha anët me studentë kishte lëshuar pe.

### **Prishtina ishte bërë tym e mjegull!**

Me 26 mars Prishtina ishte bërë tym e mjegull. Gjatë tërë ditës ajo kishte oshti nga brohorimat studentore, nga zërat e sirenavë të makinave policore dhe të autoambulancave, si dhe nga thirrjet kërcënuese të policisë me megafona. Sidomos në sheshin qendër të Prishtinës dhe në sheshin midis konvikteve, si dhe nëpër rrugët kryesor të qytetit, ishin ngritur shtëllungat e dendura dhe të zeza të gazit lotsjellës. Aq shumë lotsjellës ishte hedhur atë ditë në Prishtinë, sa që qytetarët që i kishin banesat pranë rrugëve kryesore ishin detyruar t'i mbyllnin dritaret.



Duke filluar që nga 26 marsi i vitit 1981 në qarkun rrugor të përmendur më lartë kishin ndodhur pothuajse të gjitha demonstratat deri në vitin 1991. Brenda këtij qarku rrugor kërkesa politike “Kosova Republikë” ishte thirrur me miliona herë, si nga masat studentore, ashtu dhe nga masat popullore për dhjetë vjet me radhë. Sidomos ky qark rrugor ishte kthyer me qindra herë në arenë përleshjesh midis demonstruesve dhe policisë. Brenda tij ishin vrarë qindra e ishin lënduar e plagosur mijëra demonstrues shqiptarë. Qarku i tillë rrugor ishte shkelur shumë herë me çizme të rënda, me makina policore, xhipsa dhe pizgauerë, si dhe me tanke të ushtrisë jugosllave.

Duke filluar që nga 26 marsi sheshi qendror i Prishtinës kishte uluritur shumë herë nga breshëritë e armëve automatike të skuadrave policore, dhe nga zhurmat e tmerrshme të avionëve luftarakë të ushtrisë jugosllave, që kishin fluturuar fare ulët mbi Prishtinë. Kështu kishte ndodhur deri në pranverën e vitit 1991, kur qëndresa aktive për realizimin e Republikës së Kosovës kishte filluar të merrte fund.

Për të gjitha këto Naser Hani këtë qark rrugorë e kishte përjetuar si një teatër antik pa shkallarë, brenda të cilit ishin luajtur për vite me radhë qindra drama çnjerëzore, njëra më tragjike se tjera. Ai, si edhe shumë studentë të tjerë, kishte qenë shpesh “aktor” i dramave të tilla, që ishin luajtur pikërisht brenda këtij qarku rrugor të Prishtinës.

## **Në mbrëmje demonstrata kishte marrë fund**

Vetëm aty rreth mbrëmjes, kur studentët kishin menduar se ia kishin arritur qëllimit, demonstrata e 26 marsit kishte marrë fund.

Në rrugët ku ishte demonstruar gjatë ditës kishin mbetur si relike lufte dhera, gurë, këpucë, copa të shqyera rrobash etj. Nëpër rrugë s' ishte parë asnjë njeri, sepse ishte shpallur menjëherë ora policore.

Kështu, asaj mbrëmje vetëm policia me makinat e saj kishte qarkulluar lirshëm nëpër Prishtinë. Menjëherë pas tyre liri të pakufizuar kishin gëzuar qentë endacakë. Ata duke u endur llastueshëm në grupe të vogla u kishin marrë erë mbetjeve nëpër rrugë.

Derisa nga horizonti po binte ngadalë muzgu pranveror, Prishtina pa asnjë njeri nëpër rrugë ishte dukur si e shkretë.

## **Akuza për nacionalizëm dhe irredentizëm**

Në lajmet e fundit të mbrëmjes së 26 marsit, demonstrata e asaj dite ishte vlerësuar si veprimtari nacionaliste dhe armiqësore e studentëve shqiptarë e orientuar kundër rendit kushtetues të Jugosllavisë, bashkim-vëllazërimit

etj. Në ditët në vijim në televizionin e Prishtinës ishte njoftuar se Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, demonstratën e 26 marsit e kishte vlerësuar si veprimtari të nacionalistëve dhe irredentiste shqiptarë. Edhe në lajmet qendrore të Beogradit ishte bërë e njohur se Lidhja Komuniste e Serbisë dhe e Jugosllavisë, demonstratën e 26 marsit e kishin vlerësuar si veprimtari të nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptarë, të drejtuar kundër vëllazërim-bashkimit, vetëqeverisjes socialiste dhe rendit kushtetues të Jugosllavisë.

Duke filluar që nga demonstrata e 26 marsit të vitit 1981, akuza për nacionalizëm dhe irredentizëm, shqiptarëve s'u ishte hequr deri në vitin 1991. Ndërkaq, gjatë atyre viteve të tri lidhjet e lartpërmendura komuniste kishin hedhur kundër shqiptarëve edhe akuza të tjera shumë të rënda. Nga 26 marsi i vitit 1981 në ndërtesën e Komitetit Krahinor të LKK-së ishin mbajtur qindra mbledhje maratonike, të nxehta dhe urgjente, në të cilat ishin dënuar demonstratat e shqiptarëve dhe kërkesa e tyre për ta bërë Kosovën Republikë.

Nga ajo ditë e vitit 1981 te tri lidhjet komuniste të përmendura bashkë edhe me lidhjet komuniste të republikave tjera, kishin gjëmuar shumë herë së bashku si në kor kundër shqiptarëve, kishin nxjerrë shumë herë akuza të rënda e më të rënda ndaj tyre, e kishin vënë Kosovën shumë herë nën masa të jashtëzakonshme ushtarako-police etj.

## **Ishin arrestuar e burgosur dhjetëra studentë**

Si pasojë e vlerësimeve të tilla, që në mbrëmjen e 26 marsit dhe në ditët në vazhdim ishin bastisur dhe arrestuar dhjetëra studentë, për të cilët mendohej se ishin organizatorë të demonstratës së 26 marsit. Ishte arrestuar edhe studenti Ali Lajqi, i cili kishte qenë në ballë të demonstratës së 26 marsit dhe disa të tjerë. Pas hetimeve nëpër burgje hetuese këta studentë ishin nxjerrë para gjykatave dhe ishin dënuar me nga dhjetë e pesëmbëdhjetë vjet burg. Një pjesë tjetër e studentëve, e cila ishte kërkuar nga policia për t'u arrestuar, ishte larguar nga Prishtina, duke u vendosur në familje të sigurta gjithandej nëpër Kosovë e deri në Maqedoni.

Kështu, nga 26 marsi i vitit 1981, bastisjet, arrestimet dhe dënimet me nga dhjetë e pesëmbëdhjetë vjet burg, për "veprimtari armiqësore" të anëtarësisë së organizatave politike ilegale, shumica e të cilëve kishin qenë studentë, të ish-të burgosurve politikë dhe të veprimtarëve të tjerë të çështjes kombëtare, s'ishin ndalur as pas vitit 1991 kur qëndresa aktive për realizimin e Republikës së Kosovës kishte marrë fund. Dënime të tilla u ishin dhënë shqiptarëve deri në prag të Luftës Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998/1999.

## **Jehona e demonstratës së 26 marsit**

Jehona e demonstratës së 26 marsit ishte përhapur shumë shpejt gjithandej trojeve shqiptare. Kërkesa studentore për t'ia njohur Jugosllavia Kosovës statusin e republikës ishte mirëpritur nga të gjithë shqiptarët. Guximi i rinisë studentore ishte kthyer shumë shpejt në guxim të masave popullore, që edhe ato bashkë me studentët të demonstronin për kauzën e njëjtë.

Kundër demonstratës së 26 marsit dhe kërkesës “Kosova Republikë” ishte shprehur vetëm një numër i vogël shqiptarësh. Disa nga frika se çfarë do të mund të pasonte, disa ngase s'kishin qenë brenda rrjedhave të kohës, disa sepse kishin qenë përfitues të sistemit, disa pse ishin naivë, dhe disa sepse kishin qenë të frymëzuar me patriotizëm jugosllav.

Por, jehona e demonstratës së 26 marsit ishte përhapur shumë shpejt edhe gjithandej Jugosllavisë. Atyre që menjëherë kishte filluar t'u ndizej koka kundër shqiptarëve, kishin qenë shovinistët serbë, maqedonë e malazez brenda e jashtë lidhjeve komuniste të republikave të tyre.

Dhe së fundi, demonstrata e 26 marsit kishte pasur edhe jehonë ndërkombëtare. Televizionet dhe radiot e vendeve të ndryshme, Kosovën e pas 26 marsit e kishin lajm dite. Gazetat prestigjioze botërore botonin për herë të parë artikuj për Kosovën dhe shqiptarët.

## **■ Si kishte ndodhur demonstrata 1 prillit**

### **Demonstrata kishte filluar midis konvikteve**

Si rrëfente Naseri, në mëngjesin e 1 prillit të vitit 1981, studentët me flamuj kombëtarë dhe me parulla politike në duar, ishin tubuar sërish në hapësirën midis konvikteve. Ata kishin pasur për qëllim që si më 26 mars të dilnin nëpër rrugët kryesore të Prishtinës për të demonstruar, por kordoni policor i pajisur me mjete mbrojtëse dhe armatime, kësaj radhe në numër më të madh se me 26 mars, ua kishte zënë pritën në dalje të konvikteve. Pas pak në sheshin midis konvikteve ishin paraqitur disa nga figurat politike kryesore të Kosovës, të cilët kishin ardhur për herë të parë pas shumë vitesh për të biseduar me studentët, përkatësisht për t'i qetësuar e për t'i lutur që mos të demonstronin.

Derisa midis studentëve dhe figurave të tilla politike ishte zhvilluar një debat i ashpër, masa studentore në sheshin midis konvikteve kishte filluar tashme të demonstronte, duke thirrur zëshëm “Kosova Republikë” etj. Në ndërkohë në sheshin midis konvikteve kishin ardhur edhe studentë të tjerë, të cilët kishin banuar nëpër banesa private gjithandej Prishtinës. Njëri prej tyre kishte qenë

edhe Naser Hani me disa shokë të tij. Kësisoj në sheshin midis konvikteve ishin tubuar më shumë studentë se me 26 mars.

Figurat politike që kishin ardhur për t'i qetësuar studentët, duke e parë se përpjekjet e tyre ishin të kota dhe të vonuara, tanimë e kishin lëshuar sheshin midis konvikteve.

### **Para përleshjes “akti i pajtimit!”**

Për studentët kishte qenë e qartë se për të dalë te udhëkryqi i parë afër mensës, dhe për të demonstruar tutje drejtë qendrës së Prishtinës, ata ishte dashur që paraprakisht të përlesheshin me kordonin policor në dalje të konvikteve. Meqë përleshjeve të tilla frontale me policinë s'u ishte ditur fundi, disa djem dhe vajza të dashuruar, të cilët ndërkohë ishin prishur, duke e përqafuar njëri-tjetrin, disa prej tyre për herë të fundit, ishin pajtuar.

Duke e kujtuar mëngjesin e 1 prillit të vitit 1981 bashkë me aktin e tillë të pajtimit, Naseri edhe pas shumë vitesh thoshte plot nostalgji: “E tillë kishte qenë rinia e asaj kohe, tanimë për shumëçka e papërsëritshme....!”.

### **Dalja te qarku rrugor i demonstratës**

Studentët pas shpartallimit të kordonit policor kishin arritur të dilnin te udhëkryqi afër mensës së tyre. Prej këtij momenti demonstrata kishte vazhduar brenda të njëjtit qark rrugor si në demonstratën e 26 marsit.

Demonstrata e 1 prillit kishte filluar me thirrjet “Kosova Republikë”, dhe me këngën që ia kishin filluar vajzat: **”Besa besë, besën ta kam dhanë, për Kosovën jetën du me dhanë...!”**. Kënga e tillë ishte kënduar pastaj shumë herë edhe në demonstratat e viteve në vazhdim. Në momentin kur studentët ishin gjendur në sheshin kryesor të Prishtinës, ata, si edhe më 26 mars ishin ndalur enkas para Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste, në mënyrë që pikërisht para këtij institucioni t'i brohorisnin me tërë fuqinë e tyre kërkesat politike, në radhë të parë kërkesën “Kosova Republikë” dhe pas saj edhe parullat e kërkesat tjera si edhe me 26 mars.

Në një moment derisa sheshi qendror i Prishtinës kishte qenë përplot me demonstrues, një student i veshur si punëtor me një kaçketë në kokë, për të mos e njohur agjentët e sigurimit të shtetit, ishte ngjitur në njërin nga drunjat dekorativë të sheshit dhe i ishte drejtuar masës me megafon, duke e inkurajuar atë që të demonstronte vazhdimisht derisa Jugosllavia një ditë t'ia njihte Kosovës të drejtën për të qenë republikë. Më vonë ishte marrë vesh se ai kishte qenë njëri prej pishtarëve të ngjarjeve të Kosovës të vitit 1981, Hydajet Hyseni, i cili më pas ishte arrestuar dhe ishte dënuar me pesëmbëdhjetë vjet burg.

## **Pjesëmarrja e vajzave**

Pjesëmarrja e vajzave studente në demonstratën e 1 prillit kishte qenë më e madhe në demonstratën e 26 marsit. Sërish një pjesë e tyre kishte demonstruar bashkë me djemtë nëpër rrugë. Pjesa tjetër e mbetur në konvikte si edhe me 26 mars kishte demonstruar mbi pullazin e rrafshët të konviktit të tyre, duke thirrur “Kosova Republikë” dhe duke e kënduar këngën për betejën e Grykës së Kaçanikut. Por, policia edhe më shumë se më 26 mars u kishte hedhur atyre nga distanca bomba me gaz lotsjellës, si mbi pullazin e konviktit, ashtu dhe në dhomat e gjumit nga dritaret.

## **Dhunë e egër policore**

Ato që e dallonin demonstratën e 1 prillit nga ajo e 26 marsit, kishte të bënte me pjesëmarrjen shumë më të madh të studentëve; me bashkëngjitjen e një pjese të nxënësve të shkollave të mesme radhëve të studentëve; me angazhimin e një numri më të madh policësh për t'iu kundërvënë demonstratës; me dhunën policore e cila kishte qenë më e egër se më 26 mars, dhe me tendencën e policëve serbë e malazez për t'i sharë banalisht e për t'i rrahur brutalisht vajzat demonstrante.

Kur studentët kishin demonstruar para institucioneve kryesore politike e shtetërore në qendër të Prishtinës, dhuna policore kundër tyre e kishte arritur kulmin. Me qëllim të shpërndarjes së demonstratës policia me makina e me tanke policore, ishte futur me shpejtësi të madhe disa herë mespërmes studentëve, duke lënduar secilën herë ndonjërin prej tyre. Kështu, më 1 prill autoambulancat e ndihmës së shpejtë kishin transportuar në qendrën klinike shumë më tepër studentë të lënduar se më 26 mars. Kolona e studentëve demonstrues ishte shkëputur disa herë nga dhuna e ashpër policore, por duke u futur pjesët e saj në hapësirën brenda qarkut rrugor të demonstratës rreth e rrotull bibliotekës universitare dhe nëpër rrugë e rrugica dytësore, ajo sërish ishte bashkuar dhe kishte demonstruar në qendër të Prishtinës.

Për dallim nga demonstrata e 26 marsit, gjatë demonstratës së 1 prillit përpjekjet e policisë për arrestimin e studentëve nëpër rrugë kishin qenë shumë më të shpeshta dhe më këmbëngulëse. Skena të tmerrshme ishin parë sidomos kur studentë të caktuar, në njërin anë i kishte tërhequr policia për t'i arrestuar, e në anën tjetër i kishte tërhequr turma studentore për t'i shpëtuar. Skena edhe më të tmerrshme ishin parë me rastin e përleshjeve trup më trup midis studentëve dhe kordonëve policorë, të cilat më 1 prill kishin ndodhur më shpesh se më 26 mars.

Por edhe studentët kësaj radhe e kishin goditur policinë me gurë e gjësende

të forta më shumë se më 26 mars. Kështu, atë ditë ishte lënduar edhe një numër i vogël policësh.

### **Atmosferë lufte në Prishtinë**

Kishin qenë breshëritë e armëve, brohorimat e demonstruesve, zërat e sirenave të makinave policore dhe të autoambulancave, dhe thirrjet kërcënuese të policisë me megafona, ato që bashkë me tymnajat e lotsjellësit në qendër të qytetit dhe në qendrën konviktore, i kishin dhënë Prishtinës atmosferë lufte!

Në mbrëmje derisa dielli në të perënduar me rrezet e fundit ende i praronte lagjet kodrinore Prishtinës, demonstrata e 1 prillit kishte marrë fund. Policia duke thirrur trishtueshëm me megafona nëpër rrugët kryesore të Prishtinës edhe në mbrëmjen e 1 prillit e kishte shpallur orën policore.

Kështu, edhe në mbrëmjen e 1 prillit “ngadhënjimtarët” e vetëm që lëviznin lirshëm rrugëve të Prishtinës ishin policia dhe qentë endacakë.

### **Alarm gjithandej Jugosllavisë!**

Lajmet e mbrëmjes të televizionit të Prishtinës kishin paraqitur skenat e përlshjes së studentëve me policinë. Televizioni qendror i Jugosllavisë në Beograd duke paraqitur skena të njëjta, kishte raportuar se nacionalizimi dhe irredentizmi shqiptarë në Kosovë kishte marrë hov. Figura politike të Serbisë e të Jugosllavisë ishin shprehur ashpër e me kërcënim kundër të ashtuquajturit nacionalizëm dhe irredentizëm shqiptar, të cilin kishin thënë se do ta luftonin të gjithë së bashku. Shqiptarët gjithandej Kosovës i kishin përjetuar të gjitha këto me indinjatë e zemërim.

Kështu, skenat e demonstratës së 1 prillit e kishin alarmuar tërë Jugosllavinë. Opinioni publik jugosllav kishte parë për herë të parë demonstrata aq masive dhe përlshje aq të ashpra midis të rinjve dhe policisë. Shumëkush kishte menduar se në Kosovë do të luftohej shumë shpejt edhe me armë! Edhe në qendër të Zagrebit në vitin 1972 ishte demonstruar, por jo si në Prishtinë. Kishin demonstruar asokohe vetëm disa qindra kroatë, të cilët ishin shpërndarë posa kishte intervenuar policia.

### **Një natë me shqetësime të mëdha**

Nata midis 1 e 2 prillit për Prishtinën kishte qenë një natë plot shqetësime dhe ankthe. Të shqetësuar ishin studentët, që nesër do të demonstrosnin sërish, të shqetësuar ishin qytetarët e thjeshtë shqiptarë, që i kishte përfshirë vala e revoltës, dhe të shqetësuar ishin punëtorët e termocentraleve të Kastriotit (asokohe të Obiliqit), që kishin tentuar të marshonin drejt Prishtinës për t'iu

bashkuar demonstratës, por që ishin ndaluar nga qindra forca policore, duke ua zënë pritën te porta kryesore.

Por në natën midis 1 e 2 prillit të shqetësuar ishin edhe strukturat policore dhe ato të sigurimit të shtetit. Strukturat e tilla mbase tërë natën kishin hartuar plane të reja, më efektive e më të detajuara, për t'iu kundërvënë studentëve, nëse ata nesër do të demonstironin përsëri. Ato kishin hartuar mbase tërë natën lista të reja të studentëve që duhej të arrestoheshin. Atyre u ishte rritur aq shumë vëllimi i punës, sa që ishin ndier të pakta e të pafuqishme para situatës së krijuar.

Natën midis 1 e 2 prillit edhe midis Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Kosovës, dhe Ministrive të Punëve të Brendshme të Serbisë e Jugosllavisë, ishin shkëmbyer shumë depeshe sekrete, praulla, kode e numra të veçantë. Nga ministritë e tilla në Beograd mbase ishin nisur drejt Kosovës shumë inspektorë të lartë të sigurimit shtetëror serb e jugosllav. Secili prej tyre e kishte pasur misionin e vet.

## ■ Si kishte ndodhur demonstrata e 2 prillit

### Demonstratë me mijëra pjesëmarrës

Në mëngjesin e 2 prillit të vitit 1981 kolona e studentëve sërish me flamuj kombëtarë dhe parulla të shkruara të ngritura lart, pasi ishte përleshur me kordonin policor në dalje të konvikteve, kishte filluar të zdirgjej rrugës kryesore drejt qendrës së Prishtinës. Studentët e bërë kolonë ashtu si edhe më 26 mars e më 1 prill, kishin thirrur sërish “Kosova Republikë” bashkë me parullat tjera si “Republikë Kushtetutë - ja me hatër ja me luftë” etj.

Derisa kolona e studentëve kishte parakaluar nëpër sheshin qendror të qytetit, asaj animë më shumë se më 1 prill i ishin bashkangjitur nxënës të shkollave të mesme dhe qytetarë të tjerë. Në orët e paradites demonstratës i ishin bashkangjitur edhe mijëra punëtorë shqiptarë të termocentraleve të Kastriotit (asokohe të Obiliqit). Kështu, demonstrata e 2 prillit ishte kthyer shumë shpejt në demonstratë të madhe me mijëra pjesëmarrës. Meqë numri i demonstruesve gjatë ditës kishte ardhur vazhdimisht duke u rritur, më 2 prill ishte demonstruar jo vetëm brenda qarkut rrugor të demonstratave të kaluara, dhe jo vetëm në sheshin qendror të Prishtinës, por pothuajse edhe në të gjitha pjesët dhe rrugët e qytetit.

Kështu më 2 prill kolonat e demonstruesve kishin marshuar në disa qarqe rrugore të Prishtinës. Një pjesë e studentëve ishte nisur nga konviktet dhe kishte zbritur përgjatë rrugës kryesore midis Qendrës Klinike dhe lagjes Ulpiana të Prishtinës deri te rrethi i parë rrugor, ku sërish ishin kthyer në të djathtë, duke

vazhduar rrugës kryesore drejt sheshit qendror të qytetit ku ishin takuar me demonstrues të tjerë. Kolona të tjera demonstruesish kishin marshuar edhe nga periferia veriore e qytetit pranë Medresesë “Alaudin”, duke vazhduar rrugës përpjetë drejt sheshit qendror të Prishtinës, ku ishin takuar me demonstrues të tjerë. Dhe së fundi, më 2 prill ishte demonstruar edhe nëpër rrugët dytësore gjithandej lagjeve të Prishtinës, si në “Kodrën e Diellit”, në “Dragodan”, në “Lagjen e Muhaxhirëve”, dhe sidomos në “Lagjen e Vranjevcit”, të cilës më vonë i ishte dhënë emri “Kodra e trimave!”, sepse ajo lagje më shumë se lagjet e tjera u ishte kundërvënë forcave policore gjatë demonstratave të prillit.

## **Dhunë policore e planifikuar**

Meqë demonstrata e 2 prillit kishte qenë tejet masive, kjo kishte bërë që policia me të gjitha kapacitetet të ishte angazhuar sipas planit të saj operativ për ta penguar e shpartalluar atë.

Kështu, pjesa më madhe e policisë e cila kishte qenë rrugëve dhe trotuareve në këmbë, kishte pasur për detyrë që duke i goditur demonstruesit me shkopinj gome e me kondakë pushkësh; duke u hedhur atyre sa më shumë gaz lotsjellës; duke arrestuar sa më shumë studentë të cilët i kishin prirë demonstratës, si dhe duke shtënë me breshëri armësh mbi kokat e demonstruesve, kësaj radhe edhe duke i vrarë disa prej tyre, ta shpartallonte demonstratën e 2 prillit. Pjesa tjetër, më e vogël e policisë, kishte pasur për detyrë që, duke u futur me makinat dhe tanket e saj policore furishëm mëspërmasë demonstruesve në qendër të Prishtinës, t'i ndante atë në shumë grupe të vogla dhe kështu ta shpartallonte demonstratën. Kësaj radhe policia për t'i shpërndarë demonstruesit kishte vënë në përdorim edhe automjete me topa uji, të cilët së bashku me makinat policore ishin futur po ashtu përmes demonstruesve, duke hedhur mbi trupat e tyre ujë me shtypje të madhe deri në përplasje. Dhe pjesa tjetër e policisë së specializuar së bashku me agjentët më të sprovuar të sigurimit shtetëror, duke qëndruar mbi pullazet e rrafshëta të ndërtesave të larta, kishte pasur për detyrë që ta vrojtonte dhe ta inçizonte me kamera demonstratën e 2 prillit, si dhe, sipas urdhrit të eporëve, edhe të shtinte me snajper mbi demonstrues të caktuar.

Dhe sikur të mos kishin mjaftuar të gjitha këto me 2 prill mbi Prishtinë ishin ngritur disa helikopterë të policisë për ta vrojtuar e demonstratën nga lart, ndërkohë që disa herë me radhë dy avionë “Mig” të ushtrisë jugosllave, duke zbritur rrëpishëm njëri pas tjetrit plot zhurmë e trishtim si nga maja e qiellit, kishin ulëritur duke fluturuar fare ulët mbi Prishtinë, dhe pastaj duke iu afruar lagjes kodrinore të Vranjevcit ishin ngritur thikë përpjetë, për të rrëshqitur sërish rrëpishëm pas ndonjë gjysmë ore mbi qytet.



## **Pakica policore serbe e malazeze kishte marrë hak!**

Derisa shumica shqiptare e policisë së Kosovës në njëfarë mase ishte përmbajtur në përdorimin e dhunës, pakica policore serbe e malazeze së bashku edhe me ndonjë polic të “verbër” shqiptar, kishin shfrytëzuar rastin të merrnin hak! Ata me tërë fuqinë e tyre i kishin goditur demonstruesit shqiptarë kudo që i kishin hasur e parë. Mbi kokat e demonstruesve kishin hedhur pandërprerë lotsjellës dhe shumë herë kishin shtënë me breshëri automatikësh. Duke vepruar kësioj policët serbë e malazez ishin dëgjuar shumë herë duke i sharë banalisht demonstruesit në gjuhën serbe...!

Në një moment një grup policësh serbo-malazez pranë udhëkryqit afër mensës së studentëve kishte rrethuar një grup vajzash demonstrante, dhe duke iu rënë atyre deri edhe me shqelma barkut u kishin thënë: „Kështu duhet bërë juve, hë nënën, që të mos lindni më kurrë nacionalistë shqiptarë!“. Skena e tillë e rrahjes së vajzave e kishte nxitur një grup studentësh militantë, midis të cilëve kishte qenë edhe Naser Hani, që të shkëputeshin për një çast nga kolona e demonstruesve dhe t'u hidhnin policëve serbo-malazez një breshëri gurësh nga distanca. Kështu ishte vepruar në mënyrë që policët të hutoheshin, kurse vajzat e rrethuara ta shfrytëzonin rastin dhe të iknin. Dhe vetëm kur vajzat e rrethuara kishin ikur, grupi i studentëve militantë ishte futur sërish në turmën e madhe të demonstruesve.

Pasioni i sëmurë e policëve serbë e malazez për t'i rrahur dhe për t'i sharë banalisht vajzat shqiptare u kishte rënë në sy edhe policëve shqiptarë.

## **Gjendje lufte në Prishtinë!**

Përleshjet e shpeshta të demonstruesve trup me trup me policinë; thirrjet e demonstruesve gjithandej “Kosova Republikë”; futja e makinave policore dhe automjeteve me topa uji në mesin e demonstruesve; breshëritë e armëve bashkë me thirrjet kërcënuese të policisë me megafona; sirenat e makinave policore dhe të autoambulancave, së bashku edhe me zhurmat e helikopterëve dhe të avionëve “Mig”, kishin krijuar gjendje lufte në Prishtinë.

Më 2 prill studentët, tani më të sprovuar me bombat e lotsjellësit, i kishin kapur ato me duar dhe ende pa pëlcitur ua kishin hedhur prapa policisë. Por, fatkeqësisht, ato u kishin pëlcitur atyre ndonjëherë në duar, me ç'rast disa studentë ishin lënduar duke e humbur ndonjë gisht. Në pasditen e 2 prillit edhe Naseri kishte qenë në rrezik kur disa policë e kishin tërhequr drejt makinës për ta arrestuar. Por në sajë të zhdërvjelltësisë së tij dhe të demonstruesve, që e kishin tërhequr në anën e kundërt, ai kishte shpëtuar.

## **Demonstrata masive gjithandej Kosovës e jashtë saj**

Por për shkak të jehonës së madhe që kishte pasur demonstrata e 1 prillit në Prishtinë, me 2 prill ishte demonstruar nga rinia dhe masat popullore edhe në qytetet tjera kryesore të Kosovës, kurse në ditët në vazhdim edhe në qytetet me shumicë shqiptare në Maqedoni, në Preshevë e deri në Ulqin. Kësisoj, demonstratat e prillit kishin përfshirë tërë hapësirën etnike të shqiptarëve në Jugosllavi.

Kështu, duke filluar nga 2 prill i vitit 1981 e deri në vitin 1991, Prishtina dhe qytetet tjera kryesore të Kosovës ishin kthyer me dhjetëra herë në arena lufte midis demonstruesve shqiptarë duarthatë, dhe forcave policore serbe e jugosllave të armatosura deri në dhëmbë. Për rrjedhojë gjatë demonstratave të prillit tërë Kosovës i kishte ardhur era luftë!

## **Në Prishtinë dhe qytete të tjera ishte derdhur gjak**

Në mesditën e 2 prillit agjenti serb i sigurimit të shtetit, Delibashiq, duke parë se si dy demonstrues u kishin hipur ekskavatorëve, të cilët për shkak të një defekti rrugor kishin qenë aty prej disa ditësh, dhe ishin nisur me ta drejt tankeve të cilat kishin marshuar në drejtimin e kundërt, nga dritarja e shtëpisë së tij afër mensës së studentëve kishte shti me qifte duke e vrarë njërin prej tyre.

Po më 2 prill policia serbe kishte dashur që ta arrestonte me çdo kusht një student i cili kishte qenë në kolonën e demonstruesve në rrugën midis lagjes Ulpiana dhe Qendrës Klinike të Prishtinës. Ai student për t'i shpëtuar arrestimit të tij ishte shkëputur nga kolona e demonstruesve dhe kishte ikur duke u futur midis ndërtesave të spitaleve të Qendrës Klinike, ndërkohë që policia e kishte ndjekur nga pas derisa e kishte vrarë në lëndinën prapa Klinikës Gjinekologjike. Dramën e tillë të vrasjes së atij studentit e kishin parë me sytë e tyre personeli mjekësor bashkë me motrat medicinale shqiptare, të cilët ishin tmerruar e revoltuar aq shumë nga ai akt barbar. Por, vrasja e studentit prapa Klinikës Gjinekologjike e kishte revoltuar deri në kulm sidomos drejtoreshën e kësaj klinike, profesoreshë Sadete Mekulin, e cila, duke mos mundur të përmbahej, kishte reaguuar ashpër duke e akuzuar rëndë regjimin serb të Beogradit. Meqë akuzat e tilla të saj i kishin dëgjuar edhe mjekët dhe motrat serbe të klinikës, ajo pastaj ishte kritikuar e kërcënuar nga organizata bazë e lidhjes komuniste të klinikës, kurse shtypi i Beogradit e kishte akuzuar bashkë me të shoqin, akademik Esat Mekulin, si nxitës të nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar etj.

Por, më 2 prill policia kishte vrarë në Prishtinë dhe në disa qytete të tjera të Kosovës edhe demonstrues të tjerë. Kësisoj, për dallim nga demonstrata e 26 marsit dhe e 1 prillit, demonstrata e 2 prillit ishte përgjakur! Në Prishtinë dhe gjithandej nëpër Kosovë kishin rënë dëshmorët e parë të Republikës!

Duke filluar nga 2 prilli i vitit 1981 e deri në vitin 1991, pothuajse të gjitha demonstratat e shqiptarëve ishin përgjakur nga forcat e policisë. Brenda kësaj periudhe kohore policia serbe e jugosllave kishte vlarë me armë zjarri qindra demonstrues shqiptarë, shumica të rinj e studentë.

Kështu, siç shprehej edhe Naser Hani, duke filluar nga 2 prilli i vitit 1981, për policinë serbe dhe ushtrinë jugosllave kishte filluar “stina e lejuar” për gjuetinë e shqiptarëve!

## **Roli i shumëfishtë i vajzave**

Në demonstratën e 2 prillit kishte spikatur edhe më shumë roli i shumëfishtë i vajzave studente dhe i vajzave të shkollave të mesme të kryeqytetit.

Kështu, derisa një pjesë e vajzave kishte demonstruar bashkë me djemtë, pjesa tjetër e tyre, e cila kishte mbetur e bllokuar brenda konviktit të tyre, u kishte hedhur demonstruesve nga dritaret parulla të shkruara rishtazi nëpër çarçafë. Ato edhe më 2 prill mbi pullazin e rrafshët të konviktit të tyre kishin thirrur “Kosova Republikë”, si dhe e kishin kënduar sërish këngën për betejën e Kaçanikut si edhe më parë etj. Nga ana tjetër, kishin qenë vajzat e shkollave të mesme, një pjesë e të cilave duke u shtirë sikur s’kishin të bënin me demonstratën, ishin endur nga rruga në rrugë, duke i lidhur midis tyre kolonat e shkaputura të demonstruesve. Vajza tjera të shkollave të mesme, duke qëndruar nëpër ballkone të ndërtesave të larta pranë rrugëve kryesore të kryeqytetit, i kishin paralajmëruar demonstruesit për rreziqet nga policia prapa shpine.

Por, sidomos vajzat e mbetura në konviktin e tyre e kishin pësuar keq, kur në pasditen e 2 prillit një turmë policësh serbë e malazez bashkë me ndonjë polic shqiptar mendjeshkretë, ishte futur në konviktin e tyre për t’i torturuar ato ekstremisht. Policët e tillë i kishin goditur vajzat nëpër dhomat e tyre me shkopinj gome e me shqelma, i kishin tërhequr zvarrë për flokësh korridoreve, duke ua sharë atyre me të gjallë e me të vdekur. Dhomat e demoluara, rrobat e shqyera dhe flokët e tyre të shkulura të mbetur korridoreve të konviktit, kishin qenë dëshmi e tmerrshme që kishte treguar se ç’kishin përjetuar ato vajza.

## **Roli i qytetarëve shqiptarë**

Në demonstratën e 2 prillit kishte spikatur edhe roli i qytetarëve të thjeshtë shqiptarë të kryeqytetit. Derisa pjesa e madhe e tyre kishte demonstruar bashkë me studentë e punëtorë, pjesa tjetër i kishte ndihmuar demonstruesit në mënyra të ndryshme. Turmat e rrezikuara të demonstruesve ata i kishin futur nëpër oborret e shtëpive të tyre dyert e të cilave i kishin lënë qëllimisht hapur, u kishin dhënë atyre të hanin e të pinin, kurse të lënduarve ua kishin lidhur plagët etj. Nën at e

moshuara prishtinase pasditeve të 1, e 2 prillit kishin dalë rrugëve të Prishtinës me shishe me ujë e me copa kuleçsh në duar, për t'ua dhënë ato demonstruesve të etur e të uritur. Dhe jo vetëm kuleç e ujë, por ato u kishin dhënë demonstruesve edhe kokrra qepësh të qëruara, për ta neutralizuar me erën e tyre efektin e gazit lotsjellës. Kishin qenë sidomos qytetarët shqiptarë të lagjeve të varfra periferike të Prishtinës, siç kishin qenë p. sh: ata të “Kodrës së Vranjevcit” (më pas “Kodra e Trimave”), të cilët gjatë dhe pas demonstratave të prillit të vitit 1981, i kishin kthyer shtëpitë e tyre në strehë të sigurta për ilegalët.

### **Roli i qytetarëve serbë e malazez**

Nga ana tjetër, në demonstratat e prillit kishte rënë sy edhe roli provokativ dhe i ulët i qytetarëve serbë e malazez të Prishtinës ndaj demonstruesve shqiptarë. Kështu, një pjesë e tyre duke qëndruar në ballkone dhe dritare të banesave të tyre pranë rrugëve kryesore, kishin hedhur nga lart gjësende të forta si vazo lulesh e të tjera mbi kolonat e demonstruesve me qëllim që t'i lëndonin ata. Një pjesë tjetër e tyre u ishte drejtuar demonstruesve shqiptarë me fjalë poshtëruese e fyese, duke iu thënë: „Po ç'farë kërkon ju “shiftari”, kur ne ju kemi mësuar deri edhe si t'i shartoni pemët...!”. Të tillët sa herë që policia e kishte rrethuar ndonjë grup demonstrantësh, kishin lëshuar thirrje ataviste si: „Udri, udri, majku mu...!“ (“Bjeruni, bjeruni, hë nënën...!”).

### **Buzëmbërme e trishtë**

Buzëmbërmeja e 2 prillit kishte rënë trishtueshëm mbi Prishtinë. Të tillë e kishin bërë atë buzëmbërme sidomos vrasjet e demonstruesve bashkë me mbetjet e shumta të demonstratës së asaj dite. Gjithandej rrugëve të Prishtinës ishin parë shkopinj, shufra të metalta, kanaçe lotsjellësi, gurë, dhëra, këpucë, copa rrobash, pika gjaku dhe flokë të shkulura vajzash. Midis mbetjeve të tilla, diku në pika të panjohura të qytetit, kishin qenë edhe gjësendet e demonstruesve të vvarë. Mbase ndonjë orë dore, mbase ndonjë këpucë, mbase ndonjë copë e këmishave apo xhaketa të tyre bashkë me pellgun e gjakut mbi asfalt.

Qendra konviktove e studentëve ishte dukur krejt e shkretë. Në dritaret e konvikteve s'ishte parë asnjë dritë. Në sheshin midis konvikteve s'ishte dëgjuar as edhe një zë, as edhe një zhurmë. Studentët, me të përfunduar demonstrata e 2 prillit, as që ishin kthyer më nëpër konvikte. Një pjesë e tyre ishte vendosur te shokët e shoqet e tyre nga Prishtina; një pjesë ishte vendosur nëpër banesat private të studentëve gjithandej lagjeve të Prishtinës; një pjesë ishte nisur në këmbë rrugë e pa rrugë drejt qyteteve dhe fshatrave të tyre, ku i kishin pasur shtëpitë dhe familjet. Studentët s'ishin ndier më aspak të sigurt për të banuar në

konvikte, ku policia kishte mundur t'i arrestonte në çdo kohë.

Nëpër rrugët e qytetit s'ishte parë sërish asnjë njeri i gjallë. Vetëm policia me makinat e saj kishte qarkulluar lirshëm. Duke thirrur trishtueshëm me megafona ajo e kishte shpallur sërish orën policore. Nën syprinën e argjendit të rrezeve të kuqërremta të diellit në të perënduar, kishte qenë Prishtina e 2 prillit e rënë në heshtje dhe në zi!

### **Natë e revoltës dhe e pendesës së madhe**

Nata midis 2 e 3 prillit kishte qenë nata më e pagjumë që kishte pasur ndonjëherë Prishtina dhe e tërë Kosova. Atë natë pak shqiptarë kishin fjetur. Dhuna e egër policore e ushtruar më 1 prill dhe vrasjet e bëra me armë zjarri më 2 prill, kishin qenë ato të cilat i kishin lënë pa gjumë pothuajse të gjithë shqiptarët. Ajo natë e kishte bërë të pakthyeshme kërkesën e shqiptarëve për ta bërë Kosovën Republikë! Atë natë shqiptarëve zemra ua kishte rrahur me shumë se kurrë gjokset dhe brinjët. Ajo natë e kishte ndryshuar aq shumë psikologjinë e një populli të tërë!

Mbase për një pjesë të shqiptarëve me poste politike dhe brenda strukturave të rendit dhe të sigurimit të shtetit, si dhe për një pjesë të vogël të intelektualëve shqiptarë projugosllavë, nata midis 2 e 3 prillit kishte qenë “nata e pendesës së madhe!”. Mbase këta e kishin kuptuar atë natë, se shqiptarët në Jugosllavi s'kishin qenë të barabartë, por kishin qenë jetimë, dhe se parullat si ajo e “barazisë midis kombeve kombësive” të vendit dhe ato të ngjashme me të, s'kishin qenë tjetër, veçse iluzion dhe mashtrim!

### **Natë e mllëfit dhe e urrejtjes**

Por, nata midis 2 e 3 prillit mbase për një pjesë fare të vogël të shqiptarëve kishte paraqitur natën e mllëfit dhe urrejtjes së pafund kundër popullit të tyre. E tillë kishte qenë një pjesë e krerëve politikë të Kosovës, një pjesë e agentëve të sprovuar të sigurimit të shtetit, një pjesë e policëve shqiptarë të “verbër” në aspektin kombëtar, dhe mbase edhe një pjesë e vogël e gjoja intelektualëve, të lidhur me fije të dukshme e të padukshme me Serbinë.

Mbase pjesa më e verbër e agentëve shqiptarë të sigurimit të shtetit, bashkë me kolegët e tyre serbë e malazez, natën midis 2 e 3 prillit kishin shfryrë aq shumë së bashku kundër rinisë shqiptare studentore. Mbase ata tërë natën e kishin kaluar duke shikuar përmbi një mori dosjesh të hedhura mbi tavolinë. Por, cilën dosje ta shikonin më parë! Dosjet kishin qenë shumë e ata kishin qenë pak! Natën midis 2 e 3 prillit këta agentë e kishin kaluar duke i krahasuar fotografitë e demonstruesve të 26 marsit me ato të 1 e 2 prillit për të gjetur

ndonjë lidhshmëri midis tyre. Mbase shqetësimi më i madh i tyre kishte të bënte me faktin se, ndonëse ata kishin arrestuar e burgosur tanimë shumë studentë të dyshuar si organizatorë të demonstratës së 26 marsit dhe të 1 prillit, megjithatë, në Prishtinë ishte demonstruar edhe më 2 prill, dhe kjo u kishte treguar atyre se ata nuk i kishin zbuluar ende organizatorët e vërtetë të demonstratave.

Ata kishin menduar kësisoj, sepse s'kishin arritur të kuptonin, se secila demonstratë e ndodhur më parë, kishte krijuar organizatorë të ri për demonstratën tjetër. Duke mos e kuptuar këtë gjë ata mbase kishin menduar se kishin të bënë me një organizim aq të perfeksionuar e aq perfid, saqë organizatorët e vërtetë të demonstratave as që kishin marrë pjesë në demonstrata për të mos u zbuluar kurrë. Duke menduar kësisoj, agjentët e sigurimit të shtetit në ndonjërin nga pauzat e natës, duke pirë kafe e duhan i kishin shprehur dyshimet e tyre, në mos arkitektja e një organizimi kaq perfid kishte qenë Shqipëria. Duke dyshuar kësisoj, ndonjëri nga agjentët shqiptarë do t'i ketë thënë shefit të tij serb: Krejt sherrin e ka ai "derri i madh" në Tiranë që s'pushon ditë e natë me propagandë! Mbase kolegu i tij serb do t'i ketë thënë atij me ironi: Mos e ofendo ashtu atë "derrin e madh" në Tiranë! A di ti se ai ka thënë se nëse dikush e sulmon Jugosllavinë nga jashtë, ai dhe vendi i tij do të janë në anë tonë, në krah të "popujve vëllezër jugosllavë!". Mbase kolegu i tij shqiptarë për t'u bërë më katolik se papa, kolegut të serb do t'i ketë thënë se: Ai "derri i madh" mezi po pret që ta sulmojë dikush Jugosllavinë nga jashtë, në mënyrë që bashkë me këta rrugaçët e tij që po demonstrojnë rrugëve, t'ia shkëpusë Kosovën Jugosllavisë dhe t'ia bashkojë Shqipërisë! Mbase kolegu i tij serb i është përgjigjur duke i thënë: Mirë, mirë koleg, t'i lëmë llafet tani dhe t'i kthemi punës se dita e nesërme po na pret...!

Këta agjentë kishin menduar se arkitektja e demonstratave në Prishtinë e gjithandej kishte qenë Shqipëria, sepse s'kishin arritur të kuptonin, se Shqipëria, ndonëse kishte ndikuar në ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, megjithatë, ajo s'ua kishte organizuar e diktuar atyre asnjëherë veprimet.

## **Natë e vlerësimeve dhe e vendimeve tragjike**

Edhe te tri lidhjet komuniste, ajo e Kosovës, e Serbisë dhe e Jugosllavisë, në natën midis 2 e 3 prillit s'kishin bërë gjumë. Kishte qenë tanimë nata e tretë me radhë që këto lidhje kishin vazhduar me mbledhjet e tyre urgjente dhe maratonike, për të dalë me një vlerësim të përbashkët lidhur me demonstratat e ndodhura në Prishtinë e gjithandej nëpër Kosovë. Lidhja Komuniste e Serbisë (LKS-së), kishte kërkuar që ngjarjet e ndodhura në Kosovë të vlerësoheshin edhe si kundërrevolucionare. Më tej, ajo kishte drejtuar kritika edhe më ashpra kundër Lidhjes Komuniste të Kosovës.

Mbase kritikata e tilla e kishin shtyrë Mahmut Bakallin, që pas demonstratave të prillit të jepte dorëheqje nga posti i kryetarit të Komitetit Krahinor të LKK-së.

Gjithsesi se në natën midis 2 e 3 prillit edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë e të Jugosllavisë ishte bërë pak gjumë. Mbase atë natë në këto ministri ishin mbajtur mbledhje urgjente dhe maratonike, dhe ishin dërguar shumë depeshe sekrete brenda e jashtë vendit me korrier të caktuar e post diplomatike. Mbase atë natë në këto ministri ishin ndarë shumë detyra speciale, mbase gjithsesi ishin nisur për në Kosovë sërish shumë inspektorë të lartë me misione të caktuara.

Sigurisht se edhe Ministria e Mbrojtjes Popullore të Jugosllavisë në natën midis 2 e 3 prillit ishte marrë shumë më seriozisht me Kosovën: me topografinë e saj, me kufirin me Shqipërinë, me pikat strategjike të Kosovës, me rininë studentore dhe me popullin shqiptar. Para se gjithash atë natë kjo ministri së bashku me Kryesinë e Jugosllavisë kishte marrë një vendim tragjik: vënien e Kosovës në shtetrrëhim!

## ■ Demonstratat e 3 prillit

Më 3 prill s'ishte demonstruar më në Prishtinë, por ishin bërë protesta demonstruese në disa qyteza të Kosovës, në të cilat s'ishte demonstruar më 1 e 2 prill. Demonstratat e tilla në vendbanime të vogla e kishin shënuar fundin e ciklit të demonstratave të mars-prillit të vitit 1981. Kështu, në mëngjesin e 3 prillit që kishte qenë i ngrysur, studentët s'ishin paraqitur më te udhëkryqi afër mensës për të marshuar pastaj drejt qendrës së qytetit... Prishtina s'kishte oshtirë më as nga brohorimat e studentëve, as nga sirenat e makinave policore dhe as nga breshëritë e armëve. Nëpër rrugët e Prishtinës ishin parë fare pak njerëz. Punëtorët e pastrimit të qytetit kishin filluar që pa asnjë vullnet t'i largonin mbetjet e demonstratës së 2 prillit. Tek-tuk ishte parë ndonjë xhips policie duke qarkulluar nëpër qytet.

Vetë zërat e ngjirur të njerëzve kishin folur se ata në mëngjesin e 3 prillit ishin zgjuar pas një natë të llahtarshme pa gjumë. Gjithçka ishte dukur sikur kishte funksionuar mendueshëm e më përtesë. Edhe muret e ndërtesave ishin dukur si të përfjetura. Një zbrazëti e madhe ishte krijuar gjithandej Prishtinës. Gjithçka kishte ngjarë me atë heshtjen pa betejës!

## Kolona e tankeve në Prishtinë

Por në mëngjesin e 3 prillit si për ta zëvendësuar kolonën e munguar të studentëve demonstrues, në kodrinën e Veternikut në jug të Prishtinës ishte paraqitur një kolonë tjetër, ajo e tankeve të ushtrisë jugosllave, e cila me zhurmat

e saj të hekurta kishte zbritur drejt qendrës së qytetit. Në kupolat e hapura të tankeve që parakalonin mes për mes Prishtinës, ishin parë ushtarët jugosllavë me fytyra të ngrysurat e me helmata në kokë, si dhe me duar në këmbëzat e mitralozave të montuar mbi tanke si në pozicion lufte. Pas marshimit të zhurmshtëm kolona e tankeve kishte vazhduar drejt daljes veriore të Prishtinës ku kishte qenë kazerma e ushtrisë jugosllave me emrin e Marshal Titos.

Në ndërkohë edhe më 3 prill mbi Prishtinë kishin rrëshqitur aq ulët me shpejtësi të madhe dy avionë “Mig” të ushtrisë jugosllave, sa që nga zhurmat e tyre kishin plasaritur edhe xhamat e dritareve të shtëpive. Avionët të tjerë ishin lëshuar fare ulët edhe mbi qytetet tjera të Kosovës. E tërë kjo dëshmonte se ushtria jugosllave po ushtronte luftë psikologjike ndaj shqiptarëve.

## **Akuza për kundërrevolucion**

Në lajmet e mbrëmjes së 5 prillit televizioni i Prishtinës dhe ai Beogradit, kishin njoftuar se te tri Lidhjet Komuniste, ajo e Jugosllavisë, e Serbisë dhe e Kosovës, demonstratat e prillit i kishin vlerësuar edhe si kundërrevolucionare, të drejtura kundër rendit kushtetues dhe integritetit territorial të Jugosllavisë, me qëllim të krijimit të Shqipërisë së Madhe. Akuza për kundërrevolucion kishte qenë akuza më e rëndë brenda sistemit kushtetueso-juridik të Jugosllavisë, sepse shteti kishte të drejtë që kundërrevolucionin ta shtypte me të gjitha mjetet në disponim, duke përfshirë edhe përdorimin e armëve dhe të ushtrisë. Duke filluar që nga 3 prilli i vitit 1981 edhe akuza për kundërrevolucion s’u ishte hequr më shqiptarëve deri në vitin 1991. Në emër të akuzës për kundërrevolucion ishin ushtruar ndaj shqiptarëve forma të dhunës nga më të ndryshmet, përfshirë edhe vrasjet me armë zjarri për dhjetë vjet me radhë.

Në lajmet e mbrëmjes së 2 e 3 prillit edhe gjuha e spikerëve, e korrespondentëve dhe e komentatorëve serbë të televizionit të Beogradit ishte ashpërsuar. Lidhja Komuniste e Kosovës ishte kritikuar për anim dhe oportunizëm ndaj nacionalizmit shqiptarë, kurse Shqipëria ishte akuzuar si indoktrinuese e rinisë së Kosovës me nacionalizëm dhe irredentizëm. Dhe në lajmet e fundit të mbrëmjes së 3 prillit televizioni i Prishtinës, ndër të tjera kishte njoftuar se për shkak të situatës së krijuar, Universiteti i Kosovës do mbyllej për dy javë, kurse kënga kushtuar kryengritjes shqiptare të vitit 1912 te gryka e Kaçanikut, ishte shpallur e dënueshme dhe e ndaluar!

## **Kosova në shtettrëhim**

Lajmet e fundit të mbrëmjes së 3 prillit kishin përfunduar me njoftimin e bërë nga televizioni i Beogradit dhe i Prishtinës, se për shkak të ngjarjeve



kundërrevolucionare, në Kosovë ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme, që me fjalë të tjera do të thoshte se Kosova ishte vënë në shtetrrethim. Kishte qenë vendosja e orëve policore, futja e tankeve nëpër sheshet e qyteteve, lëvizjet e njësisve të blinduara të ushtrisë jugosllave gjithandej në terren, si dhe vetë fluturimi i ulët i avionëve ushtarakë jugosllavë mbi qytetet Kosovës, ato që, marrë së bashku, dëshmonin vetë se Kosova ishte vënë në shtetrrethim klasik.

Duke filluar që nga demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 e deri në vitin 1991, si dhe më pastaj, deri te vitet e luftës çlirimtare 1997-1999, Kosova ishte vënë me dhjetëra herë në shtetrrethim.

### **Jehona e demonstratave të prillit**

Jehona e demonstratave të 1, 2 e 3 prillit tanimë ishte përhapur gjithandej Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore në jug të Serbisë. Ngjarjet e marsit dhe prillit ishin futur në secilën familje shqiptare. Ato ishin bërë të gjithkundshme e të gjithkahshme. Ato ishin përjetuar si një “besëlidhje e re” midis shqiptarëve të të gjitha viseve, që ata me demonstrata dhe mosdëgjueshmëri qytetare të mos ndaleshin derisa Kosovës t’i njihej statusi i Republikës. Vet rinia shqiptare në formën e propagandës verbale jehonën e demonstratave të marsit dhe të prillit e kishte shpërndarë gjithandej Kosovës me vise. Puna kishte shkuar deri aty sa që disa nga të rinjtë shqiptarë, baballarëve të tyre, të ”ngatërruar për interesa te vogla egoiste me patriotizëm jugosllav”, u kishin thënë: “O ndërroni rrugë, o ju m’atë anë, e ne n’këtë anë...!”

Por jehona e demonstratave të marsit dhe prillit ishte shpërndarë edhe gjithandej popujve të Jugosllavisë, të cilët për shkak të dezinformatave dhe shpifjeve të Beogradit s’e kishin kuptuar saktësisht, nëse shqiptarët kishin kërkuar që Kosova të ishte një republikë brenda Jugosllavisë, apo kishin kërkuar që Kosova t’i bashkohej Shqipërisë. Për ta bindur opinionin jugosllav sikur gjoja shqiptarët Republikën e mundshme të Kosovës kishin dashur t’ia bashkonin Shqipërisë, televizioni i Beogradit e kishte përsëritur vazhdimisht skenën filmike kur një student në sheshin midis konvikteve, e kishte hequr nga shtylla e elektrikut flamurin jugosllav dhe në vend të tij e kishte vendosur flamurin kombëtar shqiptar, të cilin mediat serbe e prezantonin qëllimisht si flamur shtetëror të Shqipërisë.

Dhe, së fundi, ngjarjet e mars-prillit të vitit 1981 kishin pasur jehonë të madhe edhe brenda opinionit ndërkombëtar. Sidomos në mbremjen e 2 e 3 prillit kishte pak radio e televizione ndërkombëtare, që s’ishin marrë me paraqitjen e skenave të demonstratave në Prishtinë e gjithandej nëpër Kosovë e jashtë saj. Kështu, Kosova ato ditë kishte qenë vërtet “mbretëresha e lajmit”

ndërkombëtar. Meqë televizionet dhe shtypi i vendeve perëndimore kishin bërë informim të paanshëm dhe objektiv lidhur me demonstratat e marsit dhe të prillit, këtë shqiptarët e përjetonin si një njëllë për krahe të këtyre vendeve ndaj tyre, për krahe kjo e cila duke qenë vetëm mediale, s'kishte qenë shumë e sigurt.

## **Impakt që e kishte vulosur jetën e tij**

Si të tilla, plot shpresë për ardhmëri, i kishte jetuar e përjetuar edhe Naser Hani demonstratat e pranverës së vitit 1981. Duke qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i tyre, edhe ai si shumë të tjerë ishte goditur e kishte marrë lëndime trupore. Por lëndimet trupore s'kishin qenë asgjë para mundësisë që edhe ai të arrestohej e të burgosej për vite të tëra, sepse tanimë kishte rënë sy të organeve të përndjekjes. Për t'iu shmangur arrestimit dhe burgosjes së mundshme, dhe për t'i dhënë edhe provimet e fundit para diplomimit, ai pas demonstratave të marsit e të prillit ishte izoluar duke qëndruar herë në Prishtinë e herë në Strugë. Por organet e përndjekjes shtetërore kishin qenë gjithandej. Ato për t'i arrestuar e burgosur demonstruesit e caktuar kishin bashkëpunuar më shumë se kurrë në mes tyre.

Ngjarjet e marsit dhe të prillit të vitit 1981 për Naserin kishin qenë aq shumë influencuese, sa që me impaktin e tyre pastaj ishte vulosur tërë jeta e tij. Kështu ai mbeti gjatë gjithë jetës demonstrues, klithës dhe thirrës për të drejtat e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

## **■ Naser Hani në burgun hetues të Ohrit**

### **Arrestimi dhe burgosja**

Në tetorin e vitit 1982 ishin arrestuar e burgosur shumë studentë shqiptarë nga Maqedonia, të cilët kishin marrë pjesë në demonstratat e pranverës së vitit 1981. Në mesin e të arrestuarve dhe të të burgosurve kishte qenë edhe Naser Hani, Dashmir Kaba, Avni Kica dhe disa studentë e veprimtarë tjerë nga Veleshta, rrethi i Strugës dhe i Ohrit.

Naseri ishte arrestuar dhe burgosur në Prishtinë, por më pas e kishin transferuar në burgun e Ohrit në Maqedoni. UDB-*ashët* shqiptarë të burgut të Prishtinës, duke ia dhënë lajmin se do të transferohej në burgun e Ohrit i kishin thënë, se veprat armiqësore të cilat s'i kishte pranuar para tyre, tani do t'i pranonte për bukuri para hetuesve maqedonë. Por, Naseri u ishte përgjigjur atyre, se për vepra të pabëra s'kishte çfarë të pranonte as në Prishtinë e as në Ohër. “Do ta shohim, do ta shohim...!”, i kishin thënë ata me ironi... Kësisoj edhe Naseri, si shumë të

tjerë, u ishte nënshtruar asokohe hetimeve brutale, intriguese dhe shantazhuese të hetuesve maqedonë të sigurimit të shtetit në burgun e Ohrit. Por, në sajë të vendosmërisë dhe kokëfortësisë që kishte treguar gjatë hetimeve, ai ishte liruar nga burgu pas dy muajsh për mungesë të fakteve. Në të kundërtën, ai, kishte mundur të dënohej me burg për vite të tëra, duke u bërë kësioj edhe shkas për burgosjen e të tjerëve, shokëve të tij, për të cilët ishte pyetur aq shumë.

### **Në mes pyetjesh provokative dhe intriguese**

Në burgun hetues të Ohrit Naseri kishte kaluar përmes pyetjesh provokative dhe intriguese të hetuesve maqedonë të shoqëruara edhe me forma të ndryshme të dhunës. Qëllimi i fundit i hetuesve maqedonë kishte qenë krijimi artificial i një grupi të ri “nacionalistësh e irredentistësh” nga studentët e Veleshtës dhe të rrethit të Strugës, të cilët gjoja kishin pasur dorë në organizimin e demonstratave të pranverës së vitit 1981 në Prishtinë. Hetuesit si provë materiale për akuzat të cilat Naserit ia kishin vënë në ngarkim, ndër të tjera kishin përdorur edhe fotografitë e demonstratave të 26 marsit dhe të 1 e 2 prill në Prishtinë, në të cilat ai ishte parë si pjesëmarrës i demonstratave. Duke u nisur nga prova e tillë materiale hetuesit i kishin shtruar atij shumë pyetje, jo vetëm për veten e tij, por edhe për shumë studentë të tjerë, dhe jo vetëm për veprime për të cilat ai i kishte bërë por edhe për veprime të cilat ishte dyshuar se i kishte bërë.

Kësioj e kishin pyetur pse kishte marrë pjesë në demonstratat e mars-prillit; kush e kishte ftuar që të merrte pjesë në demonstrata; pse ishte shoqëruar e takuar aq shpesh me njërin e me tjetrin; pse në banesën e tij në Prishtinë kishte ardhur njëri apo tjetri studentë; cilat kishin qenë bisedat e tij politike me studentë e shokë të tillë; cili grup ilegal e kishte pasur fjalën kryesore në organizimin demonstratave; kush e kishte dhënë idenë për ta kërkuar bërjen e Kosovës Republikë, dhe, mbi të gjitha, e kishin pyetur se cilit grup ilegal i kishte takuar ai vetë etj.

### **Në mes taktikash mashtruese e shantazhuese**

Ndonëse koha e qëndrimit në burg kishte qenë e shkurtër (vetëm dy muaj), megjithatë, Naseri kishte mësuar shumë lidhur taktikat mashtruese e shantazhuese, që kishin përdorur hetuesit maqedonë ndaj tij dhe ndaj të hetuarve të tjerë shqiptarë.

Njëra nga taktikat e tilla të hetuesve kishte qenë edhe ajo e **nxjerrjes së të hetuarit para aktit të kryer**, duke u shtirë sikur ata veç i dinin të gjitha ato të cilat i kishte bërë i hetuari. Kështu ata i kishin thënë Naserit se i kishin ditur të gjitha ato që ai dhe shokët e tij kishin bërë, dhe e vetmja gjë që ishte

pritur nga ia, kishte qenë pohimi i veprave të tilla, sepse siç ishin shprehur hetuesit maqedonë, nëse ai do të tregohet i sinqertë dhe do t'i pranonte veprat në ngarkim, do të kalonte më lehtë! Në të kundërtën do të kalbej burgjeve! Me fjalë të tjera, hetuesit maqedonë të gjitha pyetjet lidhur me veprat penale që ia ngarkonin Naserit, nuk i shtronin si vepra të supozuara, por si vepra të kryera faktikisht, të cilat gjoja ata i kishin ditur të gjitha! Naseri tregonte se ndonjëherë të hetuarit shqiptarë, duke besuar se hetuesit i kishin ditur vërtet të gjitha, ishin bërë pre e sugjerimeve të tilla mashtruese, dhe për rrjedhojë, duke i pranuar veprimet e bëra ishin nxjerrë para gjykatave dhe kishin marrë dënime të rënda.

Taktika tjetër mashtruese e hetuesve maqedonë ndaj të hetuarve shqiptarë kishte pasur të bënte me **gënjeshtren e bërë në emër të shokëve të tyre**. Kështu, hetuesit maqedonë i kishin thënë Naserit se ai kot po e sakrifikonte veten, duke i mohuar veprat në ngarkim, sepse filan shoku e filan shoku i tij në proceset e tyre hetimore, veprat e tilla veç i kishin pohuar tanimë si dëshmi. Naseri thoshte se taktika e tillë në formën e gënjeshtres kishte qenë e rrezikshme, kur të hetuarit pa përvojë duke besuar se shokët e tyre vërtet i kishin pohuar veprat e bëra bashkarisht, i kishin pohuar ato dhe kësisoj e kishin ngarkuar veten dhe shokët e tyre, të cilët s'kishin dëshmuar asgjë. Mashtrimi i tillë kishte bërë që pastaj të hetuarit të cilët kishin qenë shokë më parë tani t'akuzonin njëri-tjetrin për tradhtar. Pikërisht këtë e kishte dëshiruar sigurimi shtetëror maqedon.

Naseri tregonte se një taktikë tjetër e hetuesve maqedonë kishte qenë **sajimi i skenarëve të veprave penale**, duke i kombinuar e lidhur ata ndër vete të gjitha ato pohime që të hetuarit e tyre i kishin thënë veç e veç, duke i konsideruar si të parëndësishme. Kur skenarët e tillë të sajua nga pohimet e “parëndësishme” të të hetuarve, kishin përkuar pak a shumë me veprimtaritë e tyre kryera faktikisht, kjo kishte bërë që të hetuarit t'i pranonin ato, dhe kësisoj të dënoheshin me burgime të gjata si “grup armiqësor” etj.

## **Në mes të hetuesve idiotë dhe “humanistë!”**

Në rastet kur hetuesve torturat fizike e psikike të ushtruara ndaj të hetuarve të caktuar s'u kishin dhënë asnjë rezultat, këta hetues i kishin angazhuar kolegët e tyre në rolin e “hetuesve humanistë!”. Këta të fundit kishin pasur për detyrë, që ato të “vërteta” që kolegët e tyre s'kishin arritur t'i nxirrnin me tortura, këta t'i nxirrnin me të mirë e me mashtrim! Kështu, Hetuesit e tillë “humanistë”, duke e luajtur rolin e njerëzve të mirë dhe rolin e të paditurve, ishin futur nëpër dhomat e të hetuarve të kolegëve të tyre, dhe duke iu drejtuar gjoja me keqardhje e zemërim iu kishin thënë: “Kush janë ata idiotë që ju kanë

torturuar kaq shumë!"; "A janë ata njerëz apo janë kafshë!", kurse për t'i bindur të hetuarit se ata vërtet kishin qenë të drejtë dhe në anën e tyre, edhe u kishin thënë: "Shkruani, ja lapsin dhe letrën!"; "Shkruani deklaratat tuaja kundër atyre idiotëve që ju kanë torturuar kaq shumë!", "Paditeni ata për tejkalim detyre!"; "Ne do t'ju përkeqësojmë!" etj.

Herën tjetër hetuesit e tillë "humanistë", duke menduar se e kishin arritur besimin e të hetuarve, u kishin propozuar atyre që të pranonin, siç ishin shprehur ata, "së pakut diçka nga veprat në ngarkim", sepse po të vepronin kështu nuk do të dënoheshin për vepra penale, por do të dënoheshin për kundërvajtje dhe do të liroheshin shumë shpejt nga burgjet. Për të pranuar "së pakut diçka" hetuesit e tillë "humanistë" u kishin ofruar të hetuarve edhe "ndihmë juridike", duke ua dhënë atyre për t'i nënshkruar deklaratat e gatshme "lehtësuese" të përgatitura prej tyre, brenda të cilave me fjalor mashtrues ishin cekur si të pohuara të gjitha veprat në ngarkim. Nënshkrimi i deklaratave të tilla "lehtësuese" nga ana e të hetuarve pa përvojë, kishte bërë që pastaj ata të akuzoheshin për vepra penale dhe të dënoheshin për vite të tëra me burg.

Kështu, kishte ndodhur që agjentët e sigurimit të shtetit për të hetuarit që i kishin pasur drejtpërdrejt në ngarkim, të kishin luajtur rolin e hetuesve idiotë, kurse për të hetuarit e kolegeve të tyre të kishin luajtur rolin e "hetuesve humanistë", dhe e kundërta, duke i ndërruar ata këto role vazhdimisht. Naseri, pas daljes nga burgu ia kishte sqaruar taktikat e tilla mashtruese të agjentëve të sigurimit të shtetit, sidomos asaj pjese shokëve të tij, për të cilët ekzistonte mundësia që të hetoheshin e të burgoseshin një ditë.

## **Në mes fyerjesh, sharjesh e kërcënimesh**

Siç tregonte Naseri dhe shumë ish-të burgosur të tjerë, sidomos kur agjentët e sigurimit të shtetit jugosllav kishin qenë serbë, maqedonë, malazez, të hetuarit shqiptarë të cilët i kishin mohuar kategorikisht akuzat e pabazuara ndaj tyre, përveçse i kishin torturuar fizikisht e psikikisht edhe i kishin ofenduar, sharë e kërcënuar njëkohësisht. Kështu, ata duke i torturuar fizikisht të hetuarit e tyre i kishin quajtur me zemërim "kafshë!", "majmun!", "qen!", "kriminel" etj., kurse në raste të veçanta u kishin sharë atyre deri edhe "nënë shqiptare!"

Më tej këta hetues të hetuarit e tyre shqiptarë i kishin provokuar dhe ofenduar edhe në emër të Shqipërisë, duke u thënë: "Ju e doni Shqipërinë, hë nënën ...!"; "Ju e doni Enver Hoxhën...!"; "Jetoni si më mirë në Jugosllavi e lehni si qen për Shqipëri!"; "Por ne edhe atë dëshirë do t'ua plotësojmë!"; "Një ditë do t'ju nxjerrim të gjithëve tej "Bjeshkëve të Nëmura" në Shqipëri!"; "Pastaj bashkë me ata "shiftarët" e Shqipërisë do t'u hedhim në detin Adriatik!"; "A e dini more

ju kokëshkretë, se Jugosllavia mund ta okupojë Shqipërinë për dy ditë!” - e të tjera e të tjera... Meqë Naseri kishte dëgjuar më parë për sharje, fyerje dhe kërcënime të tilla, ai ato i kishte pritur pa i bërë ndonjë përshtypje të veçantë.

## **Në mes të torturave trupore dhe psikike**

Kur pyetjet intriguese e shantazhuese bashkë me taktikat mashtruese dhe torturat trupore, hetuesve të sigurimit të shtetit s'u kishin dhënë rezultatet e dëshiruara, ata përdornin ndaj të hetuarve “seanca speciale” të kombinuara me dhunë trupore dhe psikike ekstreme. Torturat të tilla ishin bërë kryesisht në orët e vona të pasmesnatës në dhomat e caktuara për hetime, duke mos i përjashtuar këtu edhe rastet kur ato ishin bërë edhe gjatë ditës në dhomat njëshe të të hetuarve të izoluar. Hetimet e tilla me dhunë ekstreme trupore dhe psikike, jo rastësisht kishin qenë të përnatshme dhe për javë të tëra, në mënyrë që kësisoj edhe të hetuarit më të vendosur dhe më rezistent të thyeshin me trup dhe me shpirt, dhe për rrjedhojë t'i pranonin veprat penale në ngarkim pa marrë parasysh nëse ato i kishin bërë ose jo. Fillimisht pohimi i veprave në ngarkim ishte provuar të nxirrej me luftë psikologjike, duke i frikësuar hetuesit të hetuarit e tyre me zërat e trishtueshëm të të hetuarve të tjerë, zëra këta të cilët ishin inçizuar në manjetofoon në kulmin e ushtrimit të torturave trupore. Kështu, hetuesit u kishin thënë të hetuarve, nëse nuk i pranoni veprat penale që keni bërë e njëjta gjë ju pret edhe juve.

Kur lufta e tillë psikologjike s'kishte bërë punë, hetuesit fillonin me tortura trupore ekstreme. Ata i kishin **goditur të hetuarit e tyre me shkopinj gome shputave të duarve dhe të këmbëve**, një lloj torture kjo e njohur si torturë turko-aziatike të cilën UDB-ja e kishte përdorur të shumtën e rasteve. Gjatë zbatimit të kësaj torture ata të hetuarit, siç thamë edhe më lart, i kishin sharë, fyer e kërcënuar. Tortura e tillë me pushime të shkurtra ishte përsëritur disa herë me radhë brenda të njëjtës seancë torturuese duke zgjatur ajo deri tre orë. Ndërprerja e saj ishte kushtëzuar me pranimin e veprave në ngarkim. Pas torturës së tillë të hetuarit as që kishin mundur më të qëndronin në këmbët e tyre, prandaj në fund të seancës gardianët e burgut i kishin tërhequr e bartur ata duke i vendosur në dhomat e tyre njëshe të izolimit.

Kur të hetuarit nga goditjet e tilla fizike kishin kaluar në **gjendje transi duke mos ndier më as dhimbje as frikë**, ata kishin filluar që t'u kundërviheshin hetuesve të tyre fizikisht. I kishin goditur trupat e hetueseve me trupat e tyre të mpirë dhe me grushte të lidhura në fytyrë, si dhe duke ua sharë edhe ata atyre me nënë e me babë! Në këso rastesh hetuesit e nevrikosur i kishin goditur viktimat e tyre për orë të tëra gjithandej trupit me shkopinj, me shqelma dhe gjësende të forta, derisa të hetuarit e tyre ishin alivanosur dhe ishin rrëzuar në dysHEME.

Kur viktimat e tyre të alivanosura ishte dukur sikur po vdisnin, hetuesit u kishin hedhur atyre mbi fytyrë e trup kova me ujë të ftoftë për t'i ringjallur.

Pikërisht për shkak të ushtrimit të torturave të tilla Naseri ka mbajtur dimër e verë çorape të trasha, sepse sidomos kur prishej moti ai ndiente dhimbje të forta në shputat e këmbëve.

## **Dy tortura të veçanta!**

Njëra nga torturat e veçanta që agjentët maqedonë të sigurimit të shtetit e kishin përdorur ndaj të hetuarve shqiptarë, kishte qenë **detyrimi për orë të tëra të qëndronin vertikalisht në këmbë**. Ndërprerja e qëndrimit të tillë ishte kushtëzuar me pranimin e akuzave në ngarkim, në të kundërtën ndërprerja e qëndrimit të tillë nga ana e të hetuarve pa pranimin e akuzave në ngarkim, ishte ndëshkuar me tortura trupore të përshkruara më lartë. Torturës së tillë i ishte nënshtruar shumë herë edhe Naseri. Hetuesit maqedonë e kishin lidhur për muri me qëndrim vertikal për tri ditë me radhë, derisa gjaku i grumbulluar në shputat e këmbëve i kishte shpërthyer mbi këpucë të cilat ishin çarë nga këmbët e ënjtura!

Tortura tjetër e veçantë të cilës i ishte nënshtruar Naseri kishte qenë psikike. Hetuesit maqedonë në njërin nga muret e dhomës hetuese e kishin vizatuar me shkurtesë një kalë, dhe i kishin thënë Naserit se “po t’i hipësh këtij kali të vizatur në mur, ti do të lirohesh menjëherë nga burgu!” Duke qeshur me zë të lartë ata e kishin pyetur Naserin me tallje: “A e din ti se kur ke për të dalë nga burgu!”, dhe pastaj vetë ishin përgjigjur me ironi dhe cinizëm: “Vetëm kur t’i hipësh këtij kalit të vizatuar në mur...!”, i kishin thënë duke qeshur me zë të lartë e duke pirë raki “Mastikë!”. Derisa hetuesit maqedonë kishin lozur kësisoji me Naserin, ai, duke i shikuar ata me përbuzje dhe urrejtje kishte menduar: “Do të jepja gjithçka që unë të isha së pakut për një çast duarlibër, kurse ju, duarlidhur si unë...!” Nga Naseri dhe nga të burgosurit e tjerë politikë kam dëgjuar edhe për forma të tjera të torturave të ushtruara ndaj tyre, por ato nuk e shoh të arsyeshme që t’i përshkruaj në këtë libër.

## **Dy muaj në vetmi**

Meqë Naseri për dy muaj sa kishte qenë në burgun e Ohrit kishte qenë vazhdimisht nën hetime, ai atë kohë e kishte kaluar në vetmi, në dhomën e tij njëshe, të cilën e quante “vetmore”, ku s’kishte pasur hapësirë më të madhe se 3-4 metra katror. Nga një dritare e vogël diku 20 me 20 centimetra të kryqëzuar nga jashtë me hekura, kishte hyrë aq pak dritë në “vetmoren” e tij, saqë e kishte pasur të vështirë të kuptonte se kur ishte ditë e kur natë. Duke qenë i privuar nga çdo kontakt dhe duke mos pasur as orë dore, të cilën ia

kishin marrë hetuesit maqedonë, ai, pothuajse e kishte humbur edhe kuptimin e kohës. Ndonëse humbja e kuptimit për kohën kishte qenë e keqja më e vogël, megjithatë, edhe ajo kishte qenë një lloj torture. Kështu, vetëm kur gardianët e burgut ia jepnin tabakanë e ushqimit për vrimën e vogël të derës, ai mund ta kuptonte se kur brenda ditës ishte mëngjes, mesditë apo mbrëmje.

Por, Naseri ishte përgatitur shpirtërisht që edhe me kushtin e qëndrimit për vite të tëra në vetmi, të mos pranonte asgjë që do të bëhej shkas për arrestimin dhe burgosjen e shokëve të tij, për të cilët ishte pyetur intensivisht nga hetuesit maqedonë.

### **Duke triumfuar mbi veten e tij**

Hetuesit maqedonë, kishin dashur Naserin së bashku me disa shokë të tij, me të cilët ai kishte kaluar edhe net të tëra pa gjumë duke bërë biseda politike, t'i shpallnin si një “grup armiqësor” të veçantë, i cili, sipas tyre, kishte marrë pjesë në organizimin e demonstratave të pranverës së vitit 1981. Ndjenja e keqe se dikush do të mund ta pësonte nga ato që ai do të thoshte gjatë hetimeve, kishte bërë që Naseri të gjente fuqi për të triumfuar mbi veten e tij, sepse ai një jetë me turp as që kishte mundur ta paramendonte! Duke mos thënë asgjë penalizuese as për veten e as për shokët për të cilët ishte pyetur vazhdimisht, ai pas dy muajsh ishte liruar nga burgu.

Pohimin e hetuesve maqedonë se Naseri i kishte takuar një grupi ilegal, ai e kishte refuzuar kategorikisht së pakut për dy arsye. E para, sepse edhe sikur ai vërtet t'i kishte takuar ndonjë grupi ilegal, këtë edhe me çmimin e jetës s'do ta pranonte, sepse pastaj para shokëve të grupit ilegal do të ndjehej tradhtar! Dhe e dyta, sepse ndonëse praktikisht kishte bashkëvepruar me individ të grupeve ilegale, megjithatë nuk i kishte takuar formalisht asnjë grupi. Kësisoj, të vetmen gjë që Naseri e kishte pranuar kishte qenë pjesëmarrja e tij në demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 në Prishtinë, por jo në cilësinë e organizatorit, por të pjesëmarrësit të rëndomtë. Në fund të fundit, pjesëmarrjen e tij në demonstratat e pranverës së vitit 1981, ai, as që kishte mundur ta mohonte, sepse ajo ishte parë edhe në fotografitë që ia kishin treguar hetuesit maqedonë.

Siç tregon edhe njëri nga shokët e Naserit, Dashmir Kaba, i cili ishte hetuar paralelisht me Naserin në burgun e Ohrit, hetimet ndaj Naserit kishin qenë të veçanta. Kjo ndër të tjera edhe pse Naseri duke qenë shumë komunikativ dhe duke kultivuar vazhdimisht “miqësi politike” me shumë studentë të cilët tani kishin rënë burgjeve, kjo kishte bërë që emri i tij të kishte figuruar në shumë dosje, gjë që e kishte bërë atë tejet të dyshimtë.



## **Lirimi nga burgu**

Në fund të hetimeve gardianët e burgut e kishin çuar Naserin te gjykatësi hetues në ndërtesën aty pranë.

Gjatë seancës së gjykimit, gjykatësi i kishte shtruar atij pyetje të ngjashme me ato të hetuesve. Por, Naseri përveç pjesëmarrjes “spontane” në demonstratat e marsit dhe të prillit në Prishtinë, të gjitha pyetjeve tjera u ishte përgjigjur negativisht. Në mungesë të provave materiale për ta gjykuar për vepra penale, gjykatësi e kishte liruar nga burgu. Lirimin nga burgu me “faqe të bardhë”, pa e dëmtuar askënd, Naseri e kishte përjetuar si një fitore mbi fashizmin maqedon!

Kur gardianët e kishin kthyer në burg për t'i marrë ai gjësendet e tij, para se ta lëshonte burgun, hetuesit maqedonë që e kishin torturuar dy muaj rresht i kishin thënë: “Kësaj here do dalësh nga burgu në sajë të kokëfortësisë, por ne aspak s'mërzitemi për këtë punë, sepse e dimë se ti me këto mend që ke, do të vish sërish te ne! Herën tjetër do të flasim ndryshe...!”

## **Pas burgut ecejake Strugë-Prishtinë**

Pas gëzimit të parë të liritimit nga burgu me faqe të bardhë, Naseri kishte rënë në dëshpërim. Bastisjet, arrestimet, burgosjet, gjykimet dhe dënimet me shumë vite burg të të rinjve shqiptarë kishin vazhduar gjithandej në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Shumë grupe studentësh duhej të dilnin para gjykatave dhe të dënoheshin për vite të tëra me burgje të rënda. Kësisoj edhe lirimi i tij nga burgu në një kohë kur të tjerët po binin burgjeve vazhdimisht, e kishte humbur tanimë rëndësinë dhe kuptimin.

Për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata dhe hetimeve të zhvilluara, UDB-ja lokale e Strugës Naserit ia kishte konfiskuar pasaportën, si dhe e kishte mbajtur në vëzhgim të mëtejshëm. Ishte liruar nga burgu, por s'dinte çfarë të bënte. S'kishte dashur asesi të rrinte dhe të shikonte se çfarë po ndodhte... Kështu, kishte filluar të bënte ecejake në relacionin Strugë-Prishtinë. Kishte qëndruar për ndonjë ditë në Prishtinë te motra, Lunikja dhe dhëndri, Agni Dika dhe ishte kthyer në Strugë. Kishte qëndruar ndonjë ditë në Strugë dhe ishte kthyer sërish në Prishtinë. Shpirti askund vend si kishte zënë. Dëshpërimi kishte filluar t'i zbutej vetëm kur ai kishte filluar sërish të merrej me punët e tij të “vogla” në të mirë të çështjes së Kosovës.

## ■ Shqipëria “Besnikja e Kosovës!”

### **Ndihmë politike me prapavijë shtetërore**

Dashuria dhe besimi i shqiptarëve në Kosovë e vise të tjera shqiptare të krijuara ndaj Shqipërisë gjatë viteve të '70 e kishin arritur kulmin gjatë viteve të '80. Kështu ndodhte, sepse, ashtu siç edhe ishte pritur, Shqipëria kishte qenë i vetmi vend në botë që e kishte mbështetur zyrtarisht kërkesën politike për bërjen e Kosovës Republikë, si një e drejtë legjitime e shqiptarëve. Përkrahja dhe mbështetja nga ana e Shqipërisë për lëvizjen studentore e populllore të viteve të '80, nuk përfaqësonte vetëm një ndihmë politike dhe morale të pashoqe, por edhe një prapavijë të fortë dhe një faktor sigurie me prapaskenë shtetërore, e cila kishte bërë që edhe shqiptarët të ishin ndier me shpinë të fortë.

Në të kundërtën, siç gjykonte edhe Naser Hani, palës jugosllave, do t'i mjaftonte, qoftë edhe qëndrimi indiferent i Shqipërisë ndaj ngjarjeve të Kosovës, që ajo lëvizjen studentore të viteve të '80 ta kishte mbytur që në fillimet e saj. Kishin qenë këto arsyt pse Naseri, Shqipërinë e viteve të '80, e kishte përjetuar ndër të tjera edhe si “besniken e Kosovës!”

### **Mbështetja përmes mjeteve informative**

Nëpërmjet mjeteve të saj të informimit masiv, Shqipëria e kishte shfaqur përkrahjen dhe brengën e saj zyrtare për Kosovën gjatë tërë viteve të '80. Nëpërmjet të përfaqësive të saj diplomatike dhe valëve të fuqishme të Radio-Tiranës, ajo e kishte njoftuar opinionin ndërkombëtar në shumë gjuhë të botës lidhur me kërkesën e drejtë të shqiptarëve për Republikën e Kosovës, si dhe për terrorin shtetëror jugosllav që ushtrohej ndaj tyre.

Për ta inkurajuar lëvizjen studentore dhe populllore për Republikën e Kosovës, Shqipëria i kishte njoftuar vazhdimisht shqiptarët edhe me të dhënat e shtypit botëror lidhur me ngjarjet në Kosovë, duke sjellë kësisoj në mesin e tyre edhe simpatitë e para ndërkombëtare për Kosovën dhe çështjen e saj. Kështu, Shqipëria për të cilën flitet se kishte qenë e tejideologjizuar, kur ishte fjala për Kosovën nuk hezitonte që asaj t'i a përcillte vetë simpatitë e vendeve të ndryshme kapitaliste të Evropës dhe të Amerikës.

Me emisionet me karakter historik, politik, letrar e artistik të emetuara në mjetet e informimit, Shqipëria e kishte bartur sidomos gjatë viteve të '80 në mesin e shqiptarëve në Kosovë e gjetkë frymën e saj inkurajuese, revolucionare dhe atdhetare. Pikërisht për këto qëllime në televizionin shqiptar, sidomos gjatë atyre viteve ishin dhënë drama televizive dhe filma artistikë, pjesa më e madhe e të cilave trajtonin luftërat dhe kryengritjet e shqiptarëve në Kosovë e gjetkë,

për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe të tërësisë territoriale të Shqipërisë. E tillë kishte qenë drama televizive “Gërsheti i luftërave”, kushtuar luftërave të çetës së Azem e Shote Galica në krahinën e Drenicës kundër forcave serbe midis dy luftërave botërore. E tillë kishte qenë drama televizive “Epoka para gjyqit”, kushtuar gjykimit të padrejtë që Porta e Lartë e Stambollit u kishte bërë dy krerëve kryesor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Avdyl Frashërit dhe Sylejman Vokshit. Dhe e tillë kishte qenë drama televizive “Dy krisma në Paris”, kushtuar patriotit Avni Rrustemi, delegatit të Kosovës në Kongresin e Lushnjes, i cili në vitin 1920 në Konferencën e Paqes së Parisit e kishte vrarë Esat Pashë Toptanin, sepse ai “pjesën e tij të Shqipërisë” ia kishte besuar dhe lënë amanet Serbisë, etj.

Por i tillë kishte qenë edhe filmi “Nëntori i dytë” kushtuar ngritjes së flamurit kombëtar dhe pavarësisht të Shqipërisë me 28 nëntor të vitit 1912 nga ana e Ismail Qemajlit në Vlorë, me ç'rast ishin vënë në qendër të vëmendjes edhe luftërat dhe përpjekjet e Kosovës të udhëhequra nga Isa Boletini për pavarësimin e Shqipërisë. I tillë kishte qenë edhe filmi “Flaka e maleve” me tematikë nga luftërat e vitit 1911 të Malësisë së Madhe të udhëhequra nga Dedë Gjo Luli kundër ushtrive turke e malazeze në prag të pavarësisht të Shqipërisë. Përmbajtje të theksuar atdhetare kishte edhe filmi “Liri a vdekje”, kushtuar luftërave të çetës së Qerqiz Topullit kundër forcave turke e greke në jug të Shqipërisë etj.

## **Në luftë mediale me Jugosllavinë**

Gjatë tërë viteve të '80 midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ndër të tjera, ishte zhvilluar edhe lufta mediale nëpërmjet të teknologjive informative për kohën të sofistikuara dhe të kushtueshme. Jugosllavia në kufijtë e saj me Shqipërinë gjatë viteve të '80, kishte vendosur mjete teknologjike të sofistikuara, për t'i penguar valët e televizionit shqiptar dhe të radiove të Shqipërisë në Kosovë dhe vise të saj. Krejt kjo ishte bërë me qëllim që të pamundësohej mbështetja e Shqipërisë për shqiptarët nëpërmjet të mjeteve audiovizuale. Por, edhe Shqipëria për t'iu kundërvënë Jugosllavisë, kishte vendosur mjete teknologjike informative përforcuese të sofistikuara pranë kufijve të saj me Kosovën dhe viset e saj, me qëllim që mbështetja e saj morale dhe politike të bartej sa më mirë në mesin e shqiptarëve, gjë që s'kishte qenë pak e kushtueshme për të.

Kështu, edhe përkundër pengesave teknologjike nga ana jugosllave, në saje të investimeve teknologjike që kishte bërë Shqipëria, ishte bërë e mundur që radiot e Shqipërisë të ishin dëgjuar në Kosovë dhe gjithandej pa asnjë pengesë, kurse televizioni shqiptarë ndonëse me pengesa megjithatë në shumë vise të Kosovës ishte parë. Për t'i dëgjuar fjalimet e udhëheqësve kryesor të Shqipërisë lidhur me ngjarjet e Kosovës, si dhe për t'i shikuar manifestimet e ndryshme me rastin e

festave në televizionin shqiptar, shumë studentë ishin vendosur në data të caktuara të shokët e shoqet e tyre në ato vendbanime, të cilat duke qenë pranë kufijve të Kosovës me Shqipërinë, televizioni shqiptar ishte kapur më mirë.

### **Mbështetja me anë të shkrimeve e të botimeve**

Por, gjatë viteve të '80, inkurajuese dhe frymëzuese për rininë e Kosovës me vise, kishin qenë edhe botimet në Tiranë, të cilat kishin pasur për temë kryesore atë pjesë të historisë së kombit shqiptarë, që kishte ndodhur dhe po ndodhte edhe aktualisht në Kosovë e vise të saj të mbetura në Jugosllavi. Të tilla ishin romanët e Sylejman Krasniqit, dhe shkrimet e Ajet Haxhiut e të Shaban Brahës kushtuar luftërave të Kosovës që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e këtej. I tillë kishte qenë edhe romani i Kadaresë “Krushqit e ngrirë”, kushtuar ngjarjeve të viteve të '80 në Kosovë. Më tej për t'i marrë në konsideratë intelektualët shqiptarë të Kosovës, të cilët kishin bërë shkrime polemizuese me eksponentët e shovinizmit serb, shkrimet e tyre në vitin 1990 ishin botuar Tiranë në formën e një libri të veçantë me titull: “Ç' thonë e ç'kërkojnë Kosovarët”, i cili me rrugë ilegale kishte arritur edhe në Kosovë.

Nga ana tjetër, me ndikim shumë të madh kishte qenë asokohe sidomos libri i Enver Hoxhës “Titistët”, i cili përvese ishte lexuar pjesë-pjesë në radiot e Shqipërisë, edhe ishte futur në Kosovë me rrugë ilegale. Brenda librit të tillë ai kishte dhënë fakte rrëqethëse, për ndërhyrjet flagrante të Jugosllavisë në punët e brendshme të Shqipërisë. Në atë libër ishin denoncuar të gjitha planet dhe intrigat e Titos dhe të politikës jugosllave, për ta gllabëruar Shqipërinë që gjatë viteve të LDB-së dhe më vonë. Përmbajtja e atij libri, e bënte atë porosilënës për shqiptarët në Jugosllavi, që ata krahas përpjekjeve për realizimin e të drejtave të tyre, të ishin syçelë dhe të kujdesshëm e mos binin në kurthat e rrezikshme të pasardhësve të Titos. Duke qenë i tillë, ai libër, që tanimë duket i harruar, asokohe ishte quajtur “libër testament” për shqiptarët.

### **E kishte mbrojtur Kosovën edhe duke e mbrojtur veten e saj**

Shqipëria gjatë viteve të '80 e kishte mbrojtur Kosovën edhe duke e mbrojtur veten e saj nga Jugosllavia, e cila i kishte intensifikuar veprimet e saj kundër Shqipërisë. Jugosllavia gjatë viteve të '80, jo rastësisht kishte ushtruar provokime e kërcënime ndaj Shqipërisë, sepse ajo kishte dashur që Shqipëria, duke u ndier e rrezikuar për veten e saj, të hiqte dorë nga përkrahja që u jepte shqiptarëve në Kosovë. Por në fakt ndodhte e kundërta. Sa më shumë që Jugosllavia e kishte shqetësuar Shqipërinë, ajo edhe më shumë e kishte shtuar përkrahjen e saj për shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi. Shqipëria për ta mbrojtur veten,

rrjedhimisht edhe Kosovën, nga kërcënimet ushtarake jugosllave pranë kufijve të saj, gjatë viteve të '80 kërcënimeve të tilla u ishte përgjigjur me gatishmëri ushtarake të vazhdueshme, gjë që s'kishte qenë pak e kushtueshme për të. Kështu, midis Shqipërisë e Jugosllavisë asokohe ishin shkëmbyer polemika me tone kërcënuese, si edhe nota kundërshtuese diplomatike etj.

Për të gjitha këto Naser Hani mendonte se historia e ngjarjeve të viteve të '80 në Kosovë, as nuk do të mund të mund të merrej me mend pa Shqipërinë, pa marrë parasysh ngjyrimet politike të atyre kohëve. Më tej, Naseri mendonte se njeriu do të duhej të ishte shumë shpirtlig, që, për nevoja të politikave ditore, egoiste dhe karrieriste, ta mohojë përkrahjen e tillë të Shqipërisë dhënë Kosovës asokohe, si dhe ta mohojë sidomos rolin e Enver Hoxhës, i cili duke qenë në krye të piramidës udhëheqëse të Shqipërisë, e kishte urdhëruar dhe miratuar ndihmën e tillë të Shqipërisë ndaj Kosovës.

### **Përkrahje e sigurt dhe e besueshme**

Meqë asokohe bota ishte ende e ndarë në dy blloqe kryesore Amerikë-Rusi, kurse te dy superfuqitë e tilla s'i kishin futur duart në sferat e interesit të njëra-tjetrës, si dhe duke pasur parasysh se Jugosllavia në fillim të viteve të '80 njëfarë mase kishte qenë ende e autoritetshme, këto kishin bërë që as një shtet të mos ishte pozicionuar zyrtarisht pro çështjes së Kosovës. Brenda rrethanave të tilla Shqipëria duke mos qenë nën ombrellën e asnjërës superfuqi, si dhe duke pasur parasysh se çështja e Kosovës kishte qenë njëkohësisht edhe çështje e saj, ajo kishte qenë shteti i vetëm në botë që ishte pozicionuar hapur dhe zyrtarisht pro kërkesës së shqiptarëve për bërjen e Kosovës Republikë brenda Jugosllavisë. Meqë përkrahja e Shqipërisë kishte qenë ndihmë dhe përkrahje e vendit amë, ajo ishte përjetuar në Kosovë si një ndihmë dhe përkrahje e veçantë, e sigurt dhe e besueshme, gjë që kishte bërë që shqiptarët në Kosovë e gjetiu të mos ishin ndier të vetmuar në përballjet e tyre me shovinistët serbo-maqedonomalazez. Kështu, adhurimi dhe besimi që kishin pasur rinia dhe masat popullore shqiptare në Kosovë e gjetkë ndaj Shqipërisë që në vitet e '70, tani në vitet e '80 të ishte rritur edhe më shumë, pikërisht sepse ndihma e Shqipërisë dhënë Kosovës kishte qenë sa reale aq edhe e sigurt. Ajo as s' ishte retorike, as ideologjike dhe as folklorike, siç shprehen tani disa shqiptarë rreth 30-të vjet më vonë, por kishte qenë ndihmë politike e morale konkrete dhe reale, me mundësi të ofrimit edhe të ndihmës së fundit, asaj të ndërhyrjes ushtarake kundër Jugosllavisë, nëse kjo e fundit do të ndërmernte hapa shfarosës ndaj shqiptarëve në Kosovë e vise tjera shqiptare të mbetura në Jugosllavi.

Meqë pas rënies së socializmit në shkallë botërore në skenën politike shqiptare

kishin dalë edhe parti, grupe dhe individë, të cilët Shqipërinë e atyre kohëve e e paraqitnin, jo si mbrojtëse, por si kundërshtare të interesave të shqiptarëve në Jugosllavi, Naseri Hani propozonte që të tillëve t'u thuhej, se: “ Shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi kishin qenë me fat, që duke e “keqkuptuar” Shqipërinë e atyre kohëve si besnike dhe të përkushtuar ndaj tyre, çështjen e Kosovës me vise e kanë çuar përpara deri te luftërat çlirimtare!”

## **Në Shqipëri ishin bërë edhe teprime e gabime!**

Naser Hani me gjithë adhurimin që kishte për Shqipërinë e asaj kohe dhe për vetë Enver Hoxhën, duke u bazuar në ato që ishin thënë e dëgjuar pas viteve të '90, thoshte se “në Shqipëri janë bërë edhe teprime e gabime”.

Gabimet dhe teprimet e tilla ai i lidhte, në radhë të parë, me “luftën e klasave”, e cila në rrethanat brenda të cilave ishte gjendur Shqipëria, kishte qenë më e ashpër se në disa vende tjera socialiste. Lufta e tillë e klasave kishte shkaktuar prishje të marrëdhënieve familjare, të lidhjeve shoqërore, miqësore e martesore midis qytetarëve shqiptarë në përmasa pak a shumë të mëdha. Në Shqipëri, kur një anëtar i familjes kishte bërë ndonjë gabim apo faj me natyrë politike, nuk e kishte pësuar vetëm i akuzuari apo i dënuari, por sipas rastit e kishin pësuar edhe anëtarët tjerë të familjes së ngushtë dhe të gjerë, edhe pse ata vet realisht s'kishin bërë ndonjë gabim apo faj, gjë që ka rezultuar me vuajtje shpirtërore e nervore të shumëkujt.

Meqë në Shqipëri në funksion të ruajtjes së pavarësisë së vendit ishin bërë investime të mëdha në fushën e mbrojtjes, kjo kishte bërë që standardi jetësor i qytetarëve, sado që ishte rritur në krahasim me të kaluarën, megjithatë, ai kishte mbetur modest dhe i ulët. Meqë Shqipëria kryesisht për shkak të parandalimit të ndërhyrjeve antishqiptare greke dhe jugosllave për dekada të tëra i kishte mbyllur kufijtë e saj, kjo kishte bërë që shumica e qytetarëve të saj të mos kishin pasur dokument udhëtimi dhe mos të kishin dalë jashtë vendit qoftë edhe njëherë të vetme.

Më tej, kishte qenë historia e tmerrshme e copëtimeve dhe e aneksimeve të trojeve të Shqipërisë vendeve fqinje ballkanike me “bekimin” e Fuqive të Mëdha të Evropës, të Turqisë dhe të Rusisë, ato të cilat e kishin shtyrë Shqipërinë kah izolimi dhe pozicionimi i ashpër ndaj vendeve të Evropës perëndimore, Amerikës dhe Rusisë. Naseri mendonte se historia do të gjykojë nëse për marrëdhëniet jo të mira të Shqipërisë socialiste me vendet e Evropës perëndimore dhe me SHBA-të kishte qenë fajtorë vetë Shqipëria, apo fajtorë kishin qenë këto vende të cilat synimet e tyre të mira apo të këqija ndaj Shqipërisë, ishin përpjekur t'i realizonin nëpërmjet Greqisë e Jugosllavisë, vende këto të cilat kishin qenë dhe

kishin mbetur armike të përbetuara të Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Kështu, për mijëra veprimtarë të çështjes kombëtare në Kosovë e gjithandej, edhe diktatura e proletariatit me shtrëngimet, gabimet dhe teprimet e saj, në Shqipëri nuk është zbatuar vetëm për shkaqe ideologjike komuniste, siç thuan sot ata shqiptarë të cilët demokracinë kuptojnë domosdoshmërisht edhe si antikomunizëm, por është zbatuar edhe për shkaqe sigurie të shtetit më të vogël në Evropë, me vakum historik më të madh në zhvillimin e saj se cilido vend tjetër, dhe me rrezikshmëri më të lartë për ndërhyrje të jashtme deri në copëtimin e saj. Brenda rrethanave të tilla në Shqipëri janë sakrifikuar të drejtat e njeriut (të individit) për hir të sigurisë dhe ekzistencës kombëtare dhe shtetërore të Shqipërisë.

Faza e tillë e mbarsur me rrezikshmëri të larta për Shqipërinë, në masë të konsiderueshme ka përfunduar në fund të viteve të '90 me rrëzimin e “Murit të Berlinit”, kur më Rusia agresive e spostuar ekonomikisht e politikisht nuk ishte superfuqi, kurse SHBA-të dhe vendet e fuqishme të Evropës patën hapësirë për ta instaluar demokracinë dhe ekonomin e tregut pothuajse në tërë botën. Brenda rrethanave të tilla i ka qeshur fati edhe shqiptarëve si komb edhe Shqipërisë si shtet, nëse shqiptarët do të din ta mirëpërdorin ekonomin e tregut dhe demokracinë.

Duke i pasur parasysh rrethanat reale dhe konkrete brenda të cilës është gjendur Shqipëria e periudhës socialiste, gabimet dhe teprimet e ndodhura asokohe brenda saj, duke qenë të kushtëzuara kryesisht nga rrethanat e lartpërmendura, ato sado që janë për keqardhje dhe korrigjim shoqërorë, megjithatë, jo vetëm Naser Hanin por edhe mijëra shqiptarë të tjerë në Kosovë e gjetkë, nuk i kanë bindur se Shqipëria e atyre kohëve ka bërë politika antikombëtare në raport me vetën e saj, dhe aq më pak në raport me Kosovën dhe viset e tjera shqiptarëve të mbetura në Jugosllavi.

## **VI. Me lëvizjen studentore për Republikën e Kosovës**

### **■ Një qelizë aktive e lëvizjes studentore**

#### **Naseri i punëve të “vogla!”**

Naseri si edhe shumë studentë të tjerë kishte qenë një “qelizë” aktive e Lëvizjes Studentore të viteve të '80 për Republikën e Kosovës, të cilës i ishte bashkangjitur që në fillimet e saj. Derisa fliste për lëvizjen studentore të atyre viteve ai nuk dëshironte të fliste për veten, duke thënë se “edhe unë i kam bërë ca punë të vogla!”. Por, cilat kishin qenë në të vërtetë punët e tij të vogla brenda lëvizjes studentore të viteve të '80 do të shohim më poshtë.

#### **Pjesëmarrës i demonstratave**

Ai kishte qenë, në radhë të parë, pjesëmarrës i pothuajse të gjitha demonstratave të ndodhura midis viteve 1981-1991, si dhe kishte zhvilluar një sërë aktiviteteve të tjera në të mirë të realizimit të Republikës së Kosovës. Ai derisa ishte i mërguar në Austri i kujtonte demonstratat e atyre viteve me pietet të madh. Ndjehej krenar që kishte qenë pjesëmarrës i tyre. Bashkë me demonstratat ai i kujtonte edhe rrethanat e atyre viteve, përçarjet e organeve të dhunës policore ndaj studentëve dhe ndaj të gjithë shqiptarëve, ashtu siç i kujtonte edhe shokët dhe shoqet e tij me të cilët kishte bashkëvepruar.

Por, derisa veprimtaria e tyre i kishte bërë mirë çështjes së Kosovës, ajo nuk i kishte bërë mirë studimeve të tij. Duke u marrë intensivisht me rrjedhjen e ngjarjeve, studimet i kishte lënë me një anë. Në të vërtetë, për shumë studentë të atyre viteve çështja e bërjes së Kosovës Republikës ishte bërë parësore dhe ishte kthyer si në një “profesion” të tyre, kurse çështja e studimeve kishte mbetur si një “hobi”, që ata e kishin ushtruar si diçka të dorës së dytë. Por, megjithatë, studentët e asaj kohe edhe kishin mësuar, prandaj pjesa e madhe e tyre, me



gjithë burgjet e përjetuara, më pas i kishte vazhduar studimet.

Vazhdimin e studimeve pas viteve të kaluara nëpër burgje e kishte të vështirë sidomos ajo pjesë e studentëve, të cilët gjykatat përveçse i kishin dënuar me burgje edhe u kishin ndaluar paraprakisht të drejtën e studimit të mëtejshëm. Por edhe këta, pas ndonjë viti i kishin vazhduar studimet në Universitetin e Kosovës, sa herë që dikush nga administrata e fakulteteve, duke e bërë “një sy qorr e një vesh shurdhë”, ua kishte dhënë atyre indeksin e studentit. Kur kjo punë s’kishte shkuar në Kosovë, ata i kishin vazhduar studimet në Universitetin Zagrebit dhe të Sarajevës, ku as që i kishte pyetur kush nëse e kishin ose jo të drejtën e studimit.

### **Bartës i mesazhit për Republikën e Kosovës**

Por t’i kthehemi sërish veprimtarisë të Naserit në kuadër të lëvizjes studentore për Republikën e Kosovës. Njëri nga aktivitetet e tij politike kishte qenë edhe bartja e mesazhit për realizimin e Republikës së Kosovës me qëndresë aktive, me protesta e demonstrime. Për ta bartur mesazhin e tillë, ai gjatë viteve të ‘80 ishte bërë i gjithkundshëm e i gjithkahshëm. Me njërën këmbë kishte qenë në Prishtinë e me tjetrën në Strugë! Kishte vepruar në dy fronte: Edhe në Kosovë edhe në Maqedoni për çështjen dhe qëllimin e njëjtë.

Por edhe shumë studentë të tjerë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova Lindore, kishin vepruar asokohe si Naseri në dy fronte. Edhe në Kosovë edhe në trojet e tyre jashtë Kosovës. Krejt kjo bëhej me qëllim që për Republikën e Kosovës të demonstrohej, jo vetëm nëpër qytetet e Kosovës, por edhe në Shkup, në Kumanovë, në Tetovë, në Gostivar, në Kërçovë, në Strugë e në Dibër në Maqedoni; edhe në Ulqin, në Tivar e në Tuz në Mal të Zi, dhe edhe në Preshevë, në Medvegjë e në Bujanoc në Kosovën Lindore.

### **Strehë e sigurt për ilegalët**

Puna tjetër që Naseri e kryente për lëvizjen studentore të viteve ‘80, kishte të bënte me strehimin e ilegalëve nga Kosova në shtëpinë e tij, në Veleshtë afër Strugës.

Kështu, në shtëpinë e tij dhe në shtëpitë e shokëve të tij kishin kaluar herë javë e herë muaj të tërë disa studentë të rrezikuar, të cilët Naseri i kishte shokë e miq. Ilegalët e tillë pasi që kishin qëndruar për një kohë në shtëpinë e Naserit, ose ishin kthyer në Kosovë për ta vazhduar veprimtarinë, ose, kur kishin qenë shumë të rrezikuar, e kishin kaluar kufirin në këmbë te Struga dhe kishin dalë në Shqipëri, dhe nga Shqipëria pastaj ishin vendosur në ndonjë vend të Evropës perëndimore. Por, nuk kishte qenë e lehtë të mbaheshin ilegalë nga Kosova në

Maqedoni, dhe aq më pak të mbaheshin ilegalë në familjen e Naserit Hanit, e cila kishte rënë në sy para organeve maqedone si përkrahëse e Kosovës. E megjithatë, në sajë të kujdesit të Naserit dhe të tjerëve, të gjithë ilegalët e Kosovës që ishin strehuar në shtëpinë e tij, ditët e tyre të vështira i kishin kaluar pa një therrë në këmbë! Se çfarë kujdesi kishte treguar Naseri dhe familja e tij për ilegalët nga Kosova, këtë më mirë se askush tjetër e kanë ditur vetë ilegalët.

### **Bartës i ndihmave për të burgosurit politikë**

Naseri ishte bërë pjesë e lëvizjes studentore të viteve të '80 edhe nëpërmjet të mbledhjes së ndihmave financiare në Strugë e rrethinë, për familjarët e të burgosurve politikë gjithandej nëpër Kosovë. Por, Naseri dhe shokët e tij nga Veleshta, si Tahir Hani e të tjerë, nuk i kishin ndihmuar vetëm familjarët e të burgosurve që i kishin njohur e i kishin shokë, por edhe familjarët e të burgosurve që s'i kishin njohur më parë.

Veprimtaria e tillë e bartjes dhe e shpërndarjes së ndihmave për familjet e të burgosurve politikë për Naserin kishte pasur rëndësi të dyfishtë, sepse nëpërmjet saj, ai, njërën anë, i kishte ndihmuar familjet e të burgosurve politikë, e, në anën tjetër, ishte njohur vazhdimisht me shokë e miq të ri, duke mbetur kështu gjithnjë brenda rrjedhave aktuale të të gjitha ngjarjeve që kishin ndodhur në Kosovë.

### **Kultivues i miqësisve të reja**

Në të mirë të çështjes së Kosovës me vise Naseri gjatë tërë viteve të '80 kishte kultivuar shoqëri e miqësi të reja me studentë e veprimtarë të shumtë të çështjes kombëtare. Pjesa më e madhe e tyre kishin qenë nga Kosova dhe nga Maqedonia, duke mos i përjashtuar këtu edhe shokët e miqtë e tij nga Mali i Zi dhe Kosova Lindore. Kishin qenë përpjekjet e viteve të '80 ato të cilat Naserin e kishin bërë shokë e mik të ngushtë sidomos me Bardhyl Mahmutin, Xhavit Halitin, Sabit Veselin, Mehmet Bislimin, Ramadan Avdiun, Shemsi Sylën etj. Por, gjatë atyre viteve Naseri kishte bërë shokë e miq edhe jashtë radhëve të studentëve, duke filluar që nga njerëzit e thjeshtë e deri te disa kuadro me arsimim të lartë të krahinave të ndryshme shqiptare, duke e krijuar kështu një rrjet miqsh e shokësh të cilët pothuajse e kishin mbuluar tërë hapësirën etnike të shqiptarëve në Jugosllavi.

Shpirti i tij bardhë dhe i pa hile ka qenë shumë lehtë i lexueshëm, sepse ai bardhësinë e shpirtit s'ia ka fshehur askujt. Të gjithë ata shqiptarë që u kishte rrahur zemra për drejtësi e liri, Naseri i ka konsideruar shokë e miq të tij edhe kur ata nuk i ka njohur nga afër. Me mjeshtërinë e tij të durimit ai ka "gdhendur"

kombëtarisht dhe politikisht secilin shqiptarë të ndershëm e fisnik që e kishte njohur gjatë jetës së tij. Kështu, Nëse dikush ka ditur jo vetëm të gjej shokë të mirë por edhe të “ndërtojë” shokë e miq, ai ka qenë Naser Hani. Edhe pas shumë vitesh derisa ishte i mërguar në Austri, ai shokët e tij të viteve të '80 i ka kujtuar me respekt e nostalgji, për të gjitha ato që kishin bërë bashkë gjatë viteve të rinisë.

Karakteristike kishte qenë se Naseri s'i kishte thënë jo edhe shoqërimit të tij me ndonjë studentë, i cili për momentin s'kishte qenë i orientuar drejt politikisht. Duke mos qenë refuzues dhe duke mos u sjell egërsisht, ai kishte ndikuar që edhe studentët e tillë të ishin bërë pjesë e lëvizjes studentore për Republikën e Kosovës. Në këtë aspekt ai ka qenë një misionar i vërtet.

### **Duke “lidhur e zgjidhur nyja!”**

I përfshirë brenda lëvizjes studentore të atyre viteve Naseri kishte vepruar si një misionar i palodhur e fjalëpakë. Ngado që kishte lëvizur kishte “lidhur e zgjidhur nyja!”

Kishte “lidhur nyja” duke i njohur dhe lidhur midis tyre shokë e miq të përkushtuar kombëtarisht të krahinave e të viseve të ndryshme, me qëllim që ata të bashkëvepronin për ta çuar përpara çështjen e Kosovës.

Kishte “zgjidhur nyja” sa herë që ai me shpirtin e tij konstruktiv kishte krijuar harmoni vëllazërore në mesin e shokëve të tij, dhe ndonjëherë edhe duke zgjidhur ndonjë mosmarrëveshje apo keqkuptim të vogël në mesin e tyre.

Duke “lidhur e zgjidhur nyja”, ai, ishte bërë njëri nga “katalizatorët” e shumë që kishte pasur lëvizja studentore e viteve të '80.

Karakteristike kishte qenë se Naseri kur kishte ndodhur që dy shokë të tij për një arsye apo një tjetër ishin hidhëruar mes veti, ai u kishte përcjellë atyre mesazhe pozitive të njëri-tjetrit, edhe pse ata realisht mesazhe të tilla për njëri-tjetrin s'kishin bërë. Natyrisht se këtë ai e kishte bërë me qëllim që ata të pajtoheshin sa më shpejt dhe të vepronin më tej së bashku për çështjen e Kosovës.

### **Ripërtëritës i radhëve**

Midis viteve 1984-1988 kur lëvizja studentore brenda rrethanave të krijuara pak a shumë kishte rënë në “armëpushim”, Naseri kishte punuar për përtëritjen radhëve të saj me veprimtarë të rinj. Kjo ishte e nevojshme sidomos ndër ato vite kur pjesa më e madhe e anëtarësisë së grupeve ilegale kishte qenë burgjeve ose kishte mërguar jashtë vendit. Por “armëpushimi” i tillë i lëvizjes studentore ndër ato vite s'kishte ndodhur vetëm në mungesë veprimtarësh, por edhe pse

pikërisht në ato vite lidhjet komuniste serbe, maqedone e malazeze, ishin tërbuar e përçartuar aq shumë kundër Kosovës dhe shqiptarëve. Këto “lidhje” kishin dashur që gjithçka që ishte arritur në Kosovë ta zhbënin e ta rrënonin brenda natës. Në radhë të parë kishin dashur që Kosovës t’ia hiqnin autonominë e vitit 1974, dhe t’ia mbyllnin asaj universitetin në gjuhën shqipe.

Për këto arsye, lëvizja studentore, për t’ia zgjatur jetën autonomisë së Kosovës dhe universitetit në gjuhën shqipe, si dhe për të fituar kohë për kundërpërgjigje, me vetëdije nuk i kishte fryrë shumë zjarrit. Kështu, ajo midis viteve 1984-1988 nuk kishte demonstruar rrugëve, por ishte mjaftuar me hedhjen e trakteve e afisheve natën nëpër qytete e fshatra, si dhe me përtëritjen e radhëve të saj me veprimtarë të rinj, për t’iu kundërpërgjigjur sërish në momentin e duhur Serbisë dhe Jugosllavisë.

Kur ishte parë se me gjithë “armëpushimin” e tillë të viteve 1984-1988, shovinistët serbo-maqedono-malazez s’kishin pasur të ndalur kundër Kosovës dhe shqiptarëve, lëvizja studentore, së bashku me minatorët dhe masat e gjëra popullore, ishte ngritur sërish midis viteve 1988-1991, duke demonstruar gjithandej Kosovës si për ruajtjen e autonomisë ekzistuese, ashtu edhe bërjen e Kosovës Republikë.

### **Shumëfishues i afisheve dhe trakteve**

Një segment tjetër me të cilin Naseri i ishte bashkuar lëvizjes studentore të atyre viteve, kishte qenë edhe shumëfishimi i afisheve dhe trakteve të grupeve ilegale me mjetet teknike të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, ku ai midis viteve 1986-1990 kishte punuar. Afishet dhe traktet e tilla ishin hedhur natën gjithandej Kosovës me vise kryesisht nga “Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK-ja)”, me ç’rast ishte kërkuar nga masat studentore e popullore që të vazhdohej qëndresa aktive me demonstrime dhe me mosdëgjueshmëri të ndryshme qytetare.

Nga ana tjetër, derisa kishte punuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, Naseri kishte nxjerrë jashtë këtij institucioni edhe raporte sekrete të Këshillit Ekzekutiv të Serbisë dhe të Jugosllavisë drejtuar Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, në të cilat ishin kërkuar masa shtërnguese gjoja për luftimin e kundërrevolucionit në Kosovë. Me raportet e tilla ai i kishte njoftuar shokët e tij të ilegales, në mënyrë që ata të dinin paraprakisht se çfarë po i kanosej Kosovës.

### **Natyra prej veprimtari e studenti**

Naser Hani gjatë tërë viteve të ‘80 i kishte mbetur besnik i lëvizjes studentore për realizimin e Republikës së Kosovës me qëndresë aktive. Kështu edhe kur ai i kishte kryer studimet në vitin 1983, edhe kur ishte punësuar në Këshillin

Ekzekutiv të Kosovës në vitin 1986, te ai s' ishte vërejtur asnjë ndryshim. Si gjithnjë kishte mbetur i interesuar për gjithçka që kishte të bënte me Kosovën, kishte mbetur i lëvizshëm dhe entuziast si edhe më parë, ishte veshur me “gjinse” e jaka të shkurtra si në kohën e studimeve, ishte treguar i gatshëm për të vepruar në të mirë të Kosovës, si dhe kishte mbetur i afërt, i dashur dhe i thjeshtë me secilin krejt larg të qenit të tij intelektual apo nëpunës. E tëra kishte folur se brenda tij natyra prej veprimtari dhe studenti ishte vulosur aq shumë, sa që ai i tillë mbeti deri në fund të jetës së tij të këputur përgjysmë.

### **Sa herë ishin vrarë të tjerët ishte ndier i vrarë edhe vetë**

Sa herë që nga forcat policore serbe e jugosllave gjatë viteve të '80 ishin vrarë studentët apo veprimtarët e tjerë të çështjes shqiptare, Naseri pa marrë parasysh nëse ata i kishte njohur ose jo personalisht, ishte ndier edhe vetë i varë!

Ishte ndier edhe vetë i vrarë kur në janarin e vitit 1984 nga forcat policore dhe UDB-ske, në lagjen “Kodra e Trimave” të Prishtinës ishin vrarë veprimtarët ilegale Rexhep Mala e Nuhi Berisha. I vrarë ishte ndier edhe kur në vitin 1985 në burgun Qendror të Beogradit ishte vrarë me tortura veprimtari tjetër i ilegales, Zija Shemsiu. I vrarë ishte ndier sidomos kur në nëntor të vitit 1989 në luftime e sipër me forcat policore ishin vrarë studentët e ilegales Fahri Fazliu e Afrim Zhitia në lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë, të cilët ai kishte pasur shokë.

Duke qenë i tillë, një atdhetar i përkushtuar dhe i dhembshur, Naseri ishte vrarë shumë herë para se të ishte vrarë realisht.

### **Koka i ishte mbushur me “viq”-ër e me “iq”-ër!**

Naseri duke qenë njëra nga qelizat aktive të lëvizjes studentore të viteve të '80 ishte interesuar për gjithçka. Kështu, në mbamendjen e tij ishin regjistruar për vite të tëra lloj-lloj skenash e tablloshë njëra më tragjike se tjetra, ashtu siç ishin regjistruar edhe shumë skena e tablo madhështore të qëndresës studentore e popullore për bërjen e Republikës së Kosovës. Në mbamendjen e tij gjatë atyre viteve ishin fiksuar edhe shumë vendimmarrje tragjike ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, nga ana e institucioneve më të larta politike e shtetërore jugosllave, përfshirë këtu edhe vendimmarrjet antishqiptare të institucioneve politike e shtetërore të tri republikave jugore të vendit, të cilat Naseri i quante “Republika shqiptarështypëse!”

Por, gjatë atyre viteve atij i ishte mbushur koka edhe me lloj-lloj deklaratash, fyerjesh, sharjesh dhe kërcënimesh që u ishin bërë shqiptarëve nga figura të shumta politike, akademike, ushtarake dhe kishtarë serbe, maqedone e malazeze. Bashkë me deklaratat dhe sharje-fyerjet e tilla, atij i ishte mbushur

koka edhe me lloj-lloj mbiembrash të autorëve të tyre, të cilët kur ishin të serbëve dhe të malazezve kishin mbaruar kryesisht me “viq” e me “iq”, kurse kur kishin qenë të maqedonëve kishin mbaruar me “ov”, “oski” e “ovski” etj. Me fjalë të tjera, në mbamendjen e Naserit ishte regjistruar asokohe, si kronika e zezë e egërsive shoviniste kundër shqiptarëve, ashtu edhe ajo e ndritura e lëvizjes studentore dhe popullore për realizimin e Republikës së Kosovës me qëndresë aktive.

### **Gjithnjë me “sy mbi vetulla...!”**

Kishte qenë veprimtaria e lëvizjes studentore dhe e masave punëtore e popullore në të mirë të Republikës së Kosovës, ajo që Naserin e kishte mbajtur me “sy mbi vetulla!”, plot vullnet, optimizëm e shpresë, gjithnjë të palodhur e të pandalshëm për ta dhënë edhe ai kontributin e tij. Kishin qenë shpresat e atyre viteve ato të cilat me “sy mbi vetulla” e kishin mbajtur një popull të tërë, duke demonstruar e qëndruar për realizimin e Republikës së Kosovës.

Aq shpresëmëdha kishin qenë ato vite saqë shqiptarët edhe vrasjet e djemve dhe vajzave të tyre nga policitë serbe e jugosllave, s'i kishin pritur vetëm me dhembje e pikëllim, por edhe me një krenari të ligjshme, sepse djemtë dhe vajzat e tyre s'ishin vrarë duke bërë punë të liga, por duke i dalë zot Kosovës. Të gjitha këto Naserin e kishin bërë krenar dhe të lumtur që ishte shqiptar.

### **Asnjëherë hakmarrës e shovinist**

Naseri asnjëherë gjatë jetës së tij nuk e ka ushqyer veten me ndjenja shoviniste dhe hakmarrëse. Kështu, sado që masat popullore serbe, maqedone e malazeze, kishin qenë të përfshira nga ndjenja antishqiptare shoviniste, ai, megjithatë, s'ia kishte lejuar asnjëherë vetes që t'i urrente ato anësi, dhe aq më pak e kishte dëshiruar vrasjen e tyre nga ana e shqiptarëve për shkak hakmarrëse. Të vetmen “hakmarrje” që e njihte Naseri, ishte njohja nga këta popuj e të drejtave kombëtare dhe njerëzore të shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore.

Për Naserin hakmarrja dhe shovinizmi ishin gjithnjë mësimet të këqija dhe doktrina primitive. Pikërisht duke i konsideruar hakmarrjen dhe shovinizmin për të tilla, ai ato s'ua kishte preferuar asnjëherë shqiptarëve. Të vetmen urrejtje dhe hakmarrje që e kishte njohur Naseri, kishte qenë urrejtja dhe hakmarrja ndaj klasave politike shoviniste serbe, malazeze e maqedone. Të vetmen luftë që Naseri ia kishte preferuar shqiptarëve ka qenë lufta e drejtë për liri kundër klasave politike, ushtrive e policive përkatëse serbo-maqedono-malazeze, pa dufë shoviniste dhe hakmarrëse ndaj popujve fqinjë.

Por, jo vetëm Naseri si individ, por tërë lëvizja studentore e viteve të '80, s'e

kishte ushqyer asnjëherë veten me ndjenja hakmarrëse dhe shoviniste. Kësisoj në asnjërin nga demonstratat e shumta studentore e gjithëpopullore të shqiptarëve në Kosovë e jashtë saj, s'ishte dëgjuar qoftë edhe një thirrje e vetme kundër serbëve, maqedonëve apo malazezve, edhe pse këta të fundit në protestat e tyre të mbajtura në Fushë-Kosovë, në Shkup, Podgoricë (asokohe Titograd) dhe në Beograd, kishin thirrur deri edhe “vdekje shqiptarëve!” etj.

### **Çdo gjë e bënte me përkushtim**

Naseri tërë veprimtarin e tij e kishte bërë me ndershmëri e përkushtim. Ai çdo gjë që kishte bërë e kishte konsideruar detyrë - obligim. Çdo gjë që kishte pasur e kishte ndarë me shokë e miq. Asnjëherë para askujt s'ishte paraqitur me të madh. Në bisedat që kishte bërë me të tjerët më shumë kishte dëgjuar seç kishte folur. Respektin dhe dashurinë për shokët e idealit çlirimtar e kishte virtyt të vulosur brenda tij. Për shokë e miq të përkushtuar kombëtarisht ishte në gjendje ta sakrifikonte edhe veten. Duke qenë modest, duke mos e marrë fjalën nëpër tubime para masave popullore, dhe duke mos bërë artikuj nëpër gazeta, edhe mendësia e tij politike në njëfarë mase ka mbetur anonime dhe e heshtur. I tillë, i ndershëm, modest dhe i përkushtuar, Naseri mbeti deri në fund të jetës së tij të shkurtër.

### **■ Tiparet kryesore të lëvizjes studentore**

Duke i evokuar kujtimet e tij të viteve të '80 gjatë kohës sa ishte në mërgim, Naseri ia përshkruante lëvizjes studentore të atyre viteve edhe tiparet dhe karakteristikat e saj kryesore si më poshtë.

### **Lëvizje samiiste, majtiste dhe romantiko-patriotike**

Për Naserin Lëvizja studentore e viteve të '80 kishte qenë kombëtarisht **samiiste**, sepse bërja e Kosovës republikë për të s'përfaqësonte tjetër, veçse një hap paraprak drejt bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, nëse Jugosllavia do të shpartallohej një ditë.

Në aspektin politik, lëvizjen studentore ai e kishte perceptuar kryesisht si **majtiste** dhe revolucionare. Brenda tiparit të tillë rinia e atyre viteve e kishte gjetur qëndresën aktive, për realizimin e Republikës së Kosovës me demonstrime dhe me mosdëgjueshmëri qytetare të ndryshme.

Në rrafshin kulturor e shpirtëror, ai, lëvizjen studentore të atyre viteve e kishte perceptuar si një lëvizje **romantiko-patriotike**. Derisa nëpërmjet të rrafshit patriotik, rinia e atyre viteve luftën e saj për bërjen e Kosovës Republikë e kishte veshur me “petkun” historik të luftërave të shqiptarëve ndër shekuj për liri e

mëvetësi, nëpërmjet të rrafshit romantik, ajo luftën për bërjen e Kosovës Republikë e kishte veshur me “petkun” lirik naimian, duke e parë Kosovën e lirë si livadh me lule!

Te tri tiparet e tilla kryesore të lëvizjes studentore të viteve të '80, jo vetëm që nuk kishin qenë në kundërshtim me njëra-tjetrën, por edhe e kishin plotësuar dhe fuqizuar njëra-tjetrën plotësisht. Kështu, derisa tipari “samiist” e kishte synuar bashkimin kombëtar të shqiptarëve, tipari majtist dhe revolucionar e kishte fuqizuar qëndresën aktive, ndërkohë që tipari romantik- naimian i kishte dhënë gjithçkaje kolorit dhe aromë bukurie e lirie.

### **Lëvizje autoktone me burimësi të brendshme**

Karakteristika tjetër kryesore e lëvizjes studentore të viteve të '80 kishte qenë burimësia e saj autoktone e brendshme. Si idenë për Kosovën republikë, ashtu edhe qëndresën aktive për realizimin e saj, ajo s'i kishte pasur të imponuara e të importuara nga jashtë, por të lindura dhe të brumosura brenda vetes. Naseri konsideronte se ishte pikërisht burimësia e tillë e brendshme, ajo që kërkesën e lëvizjes studentore për bërjen e Kosovës Republikë e bënte legjitime dhe të pakontestueshme, jo vetëm para opinionit ndërkombëtar, por edhe para një pjese të konsiderueshme të opinionit jugosllav.

Palajugosllavepërt'iamohuar pikërisht legjitimitetin dhe pakontestueshmërinë lëvizjes studentore shqiptare dhe kërkesës së saj për bërjen e Kosovës Republikë, ishte përpjekur që nëpërmjet të 1001 shpifjeve dhe dezinformatave ta nxirrte atë si një lëvizje të imponuar e të importuar nga jashtë. Kështu, sipas palës jugosllave, si kërkesat politike, ashtu edhe vetë lëvizja studentore e viteve të '80, s'kishin lindur si nevojë e brendshme e shqiptarëve, por ishin nxitur dhe organizuar nga jashtë, në radhë të parë nga Shqipëria, por edhe nga migracioni shqiptar nëpër botë, si dhe nga armiqet e tjerë të jashtëm të Jugosllavisë.

Me fjalë të tjera, sipas palës jugosllave, vetëm Jugosllavia s'e kishte pasur asnjë faj lidhur me ngjarjet e Kosovës të viteve të '80! Por, për fat të keq të kësaj pale, shpifjet dhe dezinformatat e saj s'kishin pasur jetë të gjatë. Kjo sepse si opinioni ndërkombëtar, ashtu edhe opinioni i brendshëm kroato-boshnjako-sllloven, e kishin kuptuar shpejt se kërkesa për Kosovën Republikë, kishte lindur brenda shqiptarëve si një nevojë e mirëfilltë dhe si një e drejtë e tyre legjitime.

### **Lëvizje studentore me karakter gjithëpërfshirës**

Meqë kërkesa studentore për bërjen e Kosovës Republikë përfaqësonte emëruesin e përbashkët politik të gjithë shqiptarëve, edhe lëvizja studentore e viteve të '80 ishte përkrahur, jo vetëm nga shqiptarët në Kosovë e vise të



të tjera, por edhe nga vendi amë, Shqipëria, si dhe nga emigracioni shqiptar nëpër botë. Përkrahja e tillë i kishte dhënë lëvizjes studentore për Republikën e Kosovës karakter gjithëpopullor, gjithështrësor e gjithëshqiptar. Aq unifikuese kishte qenë kërkesa për bërjen e Kosovës Republikë, sa që ajo kishte triumfuar mbi të gjitha dallimet midis shqiptarëve, qofshin ato krahinore, dialektikore, ideologjike, fetare, gjinore, moshore, kulturore e tradicionale.

Kështu, uniteti i shqiptarëve që ishte arritur gjatë viteve të '80, përfaqësonte unitetin më të pashembullt brenda historisë së shkruar të kombit shqiptar. Brenda atyre viteve të gjithë shqiptarët, si asnjëherë më parë, kishin folur me një zë, kishin marrë frymë njësoj, dhe kishin goditur bashkarisht në dy nga pikat kryesore të kthesës së historisë: në atë të mëvetësimit të Kosovës - shtet republikan, dhe më pas, nëse Jugosllavia do të shkatërrohej, edhe në atë të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

### **Lëvizje studentore e qëndresës aktive**

Pas protestave dhe demonstratave të pranverës së vitit 1981, lëvizja studentore nuk kishte qenë vetëm një lëvizje ëndërrimtare e liridashëse si në vitet e '70, por kishte qenë edhe një lëvizje e veprimeve konkrete: e hartimit të kërkesave të caktuara politike, e organizimit të protestave dhe të demonstratave dhe të mosdëgjueshmërive të shumta qytetare. Format e tilla të veprimit e kishin kthyer atë tani nga një lëvizje ëndërrimtare e liridashëse, në një lëvizje studentore të qëndresës aktive, e cila si e tillë kishte vazhduar të mbetej deri në vitin 1991, kur vendin e saj kishin filluar ta zinin partitë politike pas lejimit të pluralizmit politik në Jugosllavi.

Vetë përballja e suksesshme me Jugosllavinë dhe me treshen e saj shoviniste, siç kishte qenë Republika e Serbisë, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi, e kishte bërë lëvizjen studentore të viteve '80 prijatë të denjë të aspiratave politike të shqiptarëve ndër ato vite.

### **Lëvizje studentore me bazë organizative horizontale**

Lëvizja studentore e viteve të '80 nuk kishte një organizim qendror me hierarki vertikale, por një bazë të gjerë organizative horizontale, pjesërisht ilegale dhe pjesërisht gjysmilegeale. Meqë në Jugosllavinë e asaj kohe, të jetë përndjekëse ndaj shqiptarëve, një organizim qendror me hierarki vertikale, i cili duke qenë një dhe i vetëm, edhe sikur të krijohej, shumë shpejt do të kapej dhe do të asgjësohej, organizimi i lëvizjes studentore me bazë të gjerë horizontale objektivisht kishte ofruar veprimtari më afatgjatë.

Organizimi me bazë të gjerë horizontale, duke qenë i përbërë nga dhjeta

organizata ilegale formale e joformale dhe nga qindra grupime të vogla politike ilegale e gjysm ilegale të mëvetësishme gjithandej Kosovës me vise, objektivisht kishte qenë më pak i kapshëm dhe më pak i asgjësueshëm. Kështu, derisa organet e përndjekjes ishin marrë me zbulimin dhe kapjen e një pjese të organizimit të tillë në një pjesë të Kosovës, pjesët e tjera të atij organizimi kishin vazhduar të vepronin në pjesë të tjera të Kosovës.

Duke pasur parasysh se brenda organizimit të tillë me bazë të gjerë horizontale, asnjëra nga organizatat ilegale të atyre kohëve s'e kishte primatin udhëheqës dhe vendimmarrës, kjo kishte bërë që edhe organet e përndjekjes jugosllave të mos e dinin asnjëherë saktësisht, nëse zinxhirin e tillë organizues të lëvizjes studentore e kishin goditur në kokë apo në bisht!

Më tej, organizimi i tillë me bazë të gjerë horizontale e kishte bërë të mundshme edhe ripërtëritjen e shpejtë të lëvizjes studentore të atyre viteve me veprimtarë të rinj, të cilët me vullnetin e tyre dhe pa pengesa hierarkike ishin angazhuar për organizimin e demonstratave gjithandej Kosovës dhe viseve tjera shqiptare të mbetura në Jugosllavi. Kishte qenë pikërisht ripërtëritja e tillë e shpejtë e radhëve të lëvizjes studentore me veprimtarë të rinj, ajo që kishte bërë të mundur që për realizimin e Republikës së Kosovës të demonstrohej edhe kur anëtarësia e shumë organizatave dhe grupeve ilegale kishte qenë burgjeve. Për të gjitha këto, kapja e herëpashershme e organizatave ilegale dhe dënimi i anëtarësisë së tyre, kryesisht studentore, me nga 10-të e 15-të vjet burg, nuk e kishte paraqitur asnjëherë fundin veprimtarisë së lëvizjes studentore për Republikën e Kosovës.

Duke e pasur parasysh bazën e gjerë horizontale dhe laryshinë organizative ilegale të lëvizjes studentore për realizimin e Republikës së Kosovës, Naser Hani s' ishte pajtuar as me ata që ishin shprehur se ngjarjet e viteve të '80 kishin ndodhur spontanisht e pa ndonjë organizim të mirëfilltë, e as me ata që ishin shprehur se ato kishin pasur një organizim të përkryer e të përqendruar, duke ia përshkruar organizimin e tillë organizatave ilegale ku ata vetë kishin milituar.

## **Lëvizje studentore e skicave, e hartave dhe e portreteve**

Lëvizja studentore e viteve të '80 kishte qenë, ndër të tjera, edhe lëvizje e skicave, e hartave dhe e portreteve.

Studentët e atyre viteve kishin skicuar harta në copa letrash. Ja Shqipëria, ja Kosova, ja viset shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi, në Kosovën Lindore...! Ja Çamëria, ja Sanxhaku, ja Presheva, Bujanoci e Medvegja...! "Bëje po munde...!", i kishin thënë ata njëri-tjetrit. Studentë të tjerë me prirje për të pikturuar kishin bërë tablo luftërash plot klithma e thirrje për t'u ngritur shqiptarët për t'u çliruar. Me tablo të tilla ata i kishin veshur muret e dhomave të tyre.

Disa studentë kishin bërë skica vizatimore, ku i kishin paraqitur studentët demonstrues me laps, me pushkë e flamurë kombëtarë në duar. Të tilla skica vizatimore ishin botuar asokohe në faqet e shtypit të ilegales brenda e jashtë vendit. Studentë të tjerë kishin portretuar luftëtarë e heronj luftërash të vdekur e të gjallë. Portreti i Skënderbeut, i Abdylit, i Samiut, i Naimit, i Idriz Seferit, i Isa Boletinit dhe i Adem Demaçit, gjatë viteve të '70 e të '80 kishin zënë vend nëpër muret e dhomave të tyre të vogla e të ngushta.

### **Projektues të luftës për çlirim e bashkim kombëtar**

Disa studentë kishin bërë në copa letrash plane e skica e luftërash për çlirim e bashkim kombëtar. Kaq ushtarë do të kishte Kosova me viset e saj në Jugosllavi! Kaq ushtarë, oficerë e armë ka Shqipëria! Këto vende e këto maja të Kosovës paraqesin pika strategjike! Këtej do të futeshin ushtritë serbe e jugosllave! Këtej do të futeshin njësitë tankiste armike! Këtej do të futeshin forcat shqiptare! Këtë rrugë duhet minuar, këtë urë duhet hedhur në erë!, i kishin thënë ata njëri-tjetrit me mendësi ushtarake për aq sa e kishin.

Duke qenë nga Struga, skica e plane të tjera lufte kishte prezantuar Naser Hani. Këtu është pika kufitare e "Qafë-Thanës" me Shqipërinë! Këtu është "Mali i Thatë" midis Shqipërisë dhe viseve shqiptare në Maqedoni! Këtu ka një ultësirë, këtu ka një majë! Këtu është liqeni i Perespës dhe i Ohrit, mund të lëvizet edhe me varka! Këtu mund të hyhet e këtu mund të dilet, u kishte thënë ai shokëve të tij studentë. Të tjera skica e plane lufte kishin bërë studentët nga Mali i Zi. Të gjitha këto, ata i kishin bërë në planin parandalues nëse Jugosllavia do të ndërmernte hapa për shfarosjen totale të shqiptarëve. Në të kundërtën, ata s'kishin qenë aventurierë për ta rrezikuar edhe Kosovën edhe Shqipërinë. Duke mos qenë aventurierë, ata, ia kishin mësyre realizimit të Republikës së Kosovës brenda Jugosllavisë, me rezistencë e qendresë aktive, dhe jo me luftë të armatosur.

### **Një hallkë paraprijëse e Luftërave Çlirimtare**

Për të gjitha këto lëvizja studentore e viteve të '80 kishte qenë një hallkë paraprijëse e të tri luftërave çlirimtare të shqiptarëve, të ndodhura njëra pas tjetrës në fund të shekullit të njëzetë dhe në fillim të shekullit të njëzetënjës: të Luftës Çlirimtare të Kosovës të realizuar midis viteve 1998-1999, të Luftës Çlirimtare të Preshevës, Bujanocit e të Medvegjës të vitit 2000, dhe Luftës Çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni të vitit 2001.

Vetë fakti se në krye të luftërave çlirimtare ishin pishtarët e lëvizjes studentore të viteve të '80, kishte folur qartë se një hallkë paraprijëse e luftërave të tilla kishte qenë lëvizja studentore e atyre kohëve, e cila me kalimin e viteve ishte

shndërruar në lëvizje ushtarake për çlirimin e Kosovës dhe të viseve shqiptare në Maqedoninë perëndimore dhe në Kosovën Lindore. Nga ana tjetër, edhe fakti se mosha mesatare e shumicës së ushtarëve të ushtrive çlirimtare të shqiptarëve kishte qenë midis 20 e 30 vjeç, fliste qartë se luftërat e tilla i kishin bërë fëmijët e viteve të '80, të cilët e kishin marrë frymëzimin e tyre luftarak nga lëvizja studentore e atyre viteve.

Por “baballarët politikë të kombit”, siç shprehej edhe Naser Hani, edhe gjatë luftërave të fundit çlirimtare të shqiptarëve, sërish si edhe shumë herë gjatë historisë kishin rënë para bijve të tyre çlirimtarë si “idhuj pa krena!”, duke u pozicionuar kundër tyre për hir të karrierave politike, në mos edhe për shkaqe të tjera...!

Si të tillë e kishte parë, përjetuar dhe interpretuar Naseri lëvizjen studentore të viteve të '80, të cilën ai e kishte përqafuar me tërë qenien e tij.

## VII. Disa ngjarje në jetën private të Naserit

### ■ Jetë të harruara e të humbura

Pjesa më e madhe e të rinjëve të viteve të '80 jetët e tyre private e familjare i kanë pasur të harruara e të humbura! Ata pjesën më të madhe të kohës, të gëzimeve e të sukseseve, të hidhërimeve dhe të dështimeve, i lidhnin me fatin e Kosovës. Nga ky rregull s'ka bërë përjashtim as Naser Hani.

Një pjesë e të rinjve si Naseri, vitet më të bukura të rinisë i kishin kaluar gjithandej burgjeve, duke i lënë kësisoj me një anë jetët e tyre private e familjare bashkë me shkollat dhe studimet e filluara. Pjesa tjetër e të rinjve, që ishte arratisur jashtë vendit për shkak të përndjekjeve, ishte marrë vazhdimisht me aktivitete politike lidhur me çështjen e Kosovës, duke i harruar edhe ata kësisoj jetët e tyre private e familjare. Shumica e tyre, ndonëse jetonin në vende të zhvilluara, s'kishin bërë për veten e tyre asnjë pasuri. Edhe pjesa e të rinjve që kishin dalë në ndërkohë nga burgjet, ishin marrë sërish me çështjen e Kosovës, duke mbetur kësisoj sërish të distancuar nga jetët e tyre individuale dhe familjare. Si të parët, ashtu edhe të dytët dhe të tretët, nuk i kishin parë për shumë vite familjarët, prindërit, motrat, vëllezërit, ose nëse kishin qenë të martuar, nuk i kishin parë për vite të tëra gratë dhe fëmijët e tyre ...

Brenda rrethanave të tilla të rinjtë e viteve të '80 kishin shënuar suksese në rrafshin politik e kombëtar, por jo edhe në atë personal e familjar. Në vitet kur ata ishte dashur t'i përkushtoheshin vetes dhe familjeve të tyre, kishin shpërndarë trakte e afishe, kishin bërë jetë ilegalesh, kishin bërë demonstrata, ishin përndjekur, ishin burgosur, ishin lënduar, ishin plagosur dhe një pjesë e tyre edhe ishte vrarë. Me fjalë të tjera, të rinjtë e atyre viteve, duke bërë jetë të përqendruara politike në shërbim të çështjes kombëtare, bënë jetë të shpërqendruara personale dhe familjare.

Kështu i kishte kaluar vitet e '80 edhe Naser Hani, i cili gjatë atyre viteve ishte diplomuar, ishte martuar dhe për një kohë edhe ishte punësuar.

## ■ Ekonomist i diplomuar

Njëra nga ngjarjet me rëndësi në jetën private të Naserit kishte qenë edhe diplomimi i tij në fakultetin ekonomik diku në fund të vitit 1983. Meqë ai para se të burgosej i kishte pasur të dëgjua të gjitha vitet e studimeve, ai kishte diplomuar duke i dhënë provimet e fundit që i kishin mbetur pa dhënë para se të burgosej në tetorin e vitit 1982.

Në radhë të parë kishin qenë realitetet e hidhura brenda të cilave ishin ndodhur shqiptarët, ato, të cilat Naserit ia kishin mbytur secilën sukses individual e familjar, secilën fitore e secilin gëzim të jetës. Duke i patur parasysh rrethanat e tilla, ai diplomimit tij në Fakultetin Ekonomik i ishte gëzuar fare pak, ndër të tjera edhe për vet faktin se duke qenë shumë shokë të tij ende nëpër burgje, ai edhe s'kishte pasur se me kë ta ndante këtë gëzim. Pastaj, si t'i gëzohej diplomimit të tij kur Ministria e Arsimit dhe e Kulturës së Maqedonisë, kuadrove shqiptare të diplomuara në Universitetin e Kosovës në Prishtinë as që ua kishte njohur diplomat, krejt kjo me qëllim që ato kuadro duke u punësuar në Kosovë të mos ktheheshin në Maqedoni.

Për të gjitha këto, Naserit, akti i diplomimit, pas një gëzimi të vogël fillestar, i ishte kthyer më pas në dëshpërim. Vetëm familjarët e tij, sidomos motra Lunikja, ishin gëzuar shumë për diplomimin e tij. Por edhe gëzimi i tyre ishte i përzier me frikë, sepse të gjithë e kishin ditur se Naseri s'do të ndalej në rrugën që e kishte filluar në pranverën e vitit 1981.

## ■ Në kurbet në Kroaci

Meqë Naserin për shkak se kishte qenë i burgosur politik asnjë organizatë punuese s'e kishte marrë në punë, ai gjatë vitit 1984 kishte bërë një vit kurbetit në Kroaci. Në të vërtetë, ai edhe kishte nevojë që për një kohë të ndodhej sa më larg hafijeve të UDB-së së Kosovës e të Maqedonisë, që ia kishin nuhatur për vite të tëra lëvizjet nga Struga në Prishtinë dhe anasjelltas. Por UDB-ja ishte e pranishme gjithkund, por në Kroaci e Slloveni, ajo nuk ishte aq shumë antishqiptare dhe aq shumë autoritare, siç ishte në republikat jugore të vendit: në Serbi, në Maqedoni e Mal të Zi dhe sidomos në Kosovë.

Kështu, Naseri në Zagreb për rreth një vit kishte bërë punë të rënda fizike, ishte ushqyer dosido dhe kishte banuar në baraka së bashku me kurbetçarët tjerë shqiptarë. Kishte qenë shpirti i pastër dhe sjellja dashamirëse e Naserit ndaj secilit, ato që kishin bërë që rreth tij të ishte mbledhur një pjesë e punëtorisë shqiptare në Kroaci. Për t'u kuptuar sa më mirë me punëtorët, ai kishte biseduar me ta rreth çështjes së Kosovës në gjuhën e thjeshtë të popullit, duke u ikur

shprehjeve që ata s'i kishin kuptuar.

Por gjatë qëndrimit në Kroaci, Naseri, kishte mbajtur kontakte edhe me ndonjë kroat, të cilët i kishte sqaruar lidhur me kërkesën politike të shqiptarëve për Kosovën Republikë brenda Jugosllavisë dhe jo jashtë saj, siç kishin propaganduar qëllimisht qarqet politike e propagandistike serbo-maqedono-malazeze. Për kroatët me të cilët kishte komunikuar Naseri, shqiptarët kishin të drejtë ta kishin republikën e tyre, por me kusht që ajo të ishte brenda Jugosllavisë.

## ■ Martesa dhe ardhja e fëmijëve

Pas një viti kurbet në Kroaci, Naseri në vitin 1985 ishte kthyer në Kosovë, kësaj radhe me një shëndet ca më të mirë, me xhepa pak më të trashë, si dhe me duar me kallo nga puna fizike që kishte bërë, të cilat ai jo vetëm që nuk ia kishte fshehur kujt, por disave edhe ua kishte ekspozuar qëllimisht.

Por, kthimit të Naserit pas një viti nga Kroacia nuk i ishin gëzuar vetëm motrat e vëllezërit e tij, por i ishte gëzuar edhe një vajzë. Ishte ajo një shoqe e tij e idealit çlirimtar, një studente e sociologjisë nga Tetova, Florentina, motra e Bardhyl Mahmutit, me të cilën ishin martuar në vitin 1986, ashtu thjesht pa bërë dasmë të madhe, vetëm me praninë e anëtarëve të familjeve të tyre të ngushta. Kush kishte dashur “dasma” të mëdha, ato asokohe i kishte pasur para hundësh! Me mijëra “dasmorë” kishin marshuar rrugëve të qyteteve të Kosovës, me flamuj kombëtarë në duar dhe me kërkesën politike “Kosova republikë” në gojë. Naseri dhe Florentina kishin qenë shumë herë “dasmorë” të dasmave të tilla të mëdha, duke marshuar midis mijëra djemve e vajzave të Kosovës dhe të viseve të saj.

Kur ishin martuar të dy kishin qenë të rinj dhe të arsimuar, të dy kishin bërë herë pas here jetë prej ilegalësh, por të dy kishin qenë edhe zemërthyer për shokët e shoqet e tyre që ishin ende burgjeve, ose ishin vrrarë në demonstratat e atyre viteve. Me kalimin e viteve u kishin ardhur edhe ato tri gëzimet e mëdha dhe ndoshta të vetmet në jetën e tyre të përbashkët. Fillimisht u kishte ardhur gëzimi parë, vajza Lynkesta, pastaj gëzimi i dytë, djali Jashari, dhe në fund u kishte ardhur edhe gëzimi i tretë, vajza Era. Natyrisht, se ata që u kishin ardhur për t'i përgëzuar, fëmijëve sipas traditës u kishin dëshiruar “jetë të gjatë” dhe që të “rriteshin me nënë e me babë!”. Por në kundërshtim me urimet e tilla, ata fëmijë ishte dashur që të rriteshin pa njërin prind...!

## ■ Nëpunës i Këshillit Ekzekutiv

Aty kah fundi i vitit 1986 Naseri me ndihmën e disa miqve kishte arritur

që të punësohej si bashkëpunëtor profesional në Sekretariatin për Ekonomi dhe Financa pranë Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Meqë kishte pasur biografi politike jo të mirë, ata që e kishin pranuar në punë, si zotëri Kolë Staka dhe ndonjë tjetër, për veten e tyre kishin marrë përgjegjësi. Kishin dëgjuar se Naseri, duke mos i dhënë kush punë në Kosovë kishte bërë kurbet në Kroaci, u kishte ardhur keq dhe kishin thënë: “Ta marrim në punë, pra le të dalë ku të dalë!”. Pa dyshim se edhe motra e Naserit, Lunikja, dhe vëllai i Naserit, Vibari, duke qenë të punësuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, kishin ndërhyrë te kolegët e tyre që ata ta praninin Naserin në punë në këtë institucion.

Duke pasur parasysh se numri i të përndjekurve politikë gjatë viteve të '80 në Kosovë ishte rritur vazhdimisht, edhe organet e sigurimit të shtetit as që kishin mundur t'i regjistronin të gjitha lëvizjet e tyre. Kështu, mbase edhe punësimi i Naserit në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, organeve të sigurimit të shtetit ose s'u kishte rënë në vesh, ose ata duke u treguar oportun e kishin heshtur këtë punë, sepse tanimë edhe një pjesë e shqiptarëve të punësuar në organet e sigurimit, e kishte pasur të qartë se për shovinistët serbë të gjithë shqiptarët kishin qenë armiq, përfshirë edhe vetë ata.

Në sajë të sjelljes së mirë, Naseri edhe brenda Këshillit Ekzekutiv të Kosovës kishte gjetur miq e shokë të përkushtuar kombëtarisht, gjë që atij i kishte krijuar siguri për ta ndihmuar lëvizjen studentore për Republikën e Kosovës edhe nga vendi i punës. Njëri prej shokëve të vendit të punës me të cilin Naseri ishte afruar më shumë kishte qenë Kolë Staka.

Këto kishin qenë katër-pesë ngjarjet kryesore në jetën private të Naser Hanit, të cilat ai i kishte vërejtur e s'i kishte vërejtur, i kishte prekur e s'i kishte prekur, duke i ikur ato kësisoj në pa kthim!



## VIII. Me përpjekjet e fundit për shpëtimin e Kosovës

### ■ Kosova midis luftës dhe vdekjes!

#### **Kosova ishte ngritur sërish si një “Ulkonjë e plagosur!”**

Pas eliminimit nga skena politike jugosllave e kundërshtarëve politik të Millosheviqit, dhe pas ardhjes së Rrahman Morinës në krye të LKK-së në vjeshtë të vitit 1988, rreziku i pezullimit të autonomisë së Kosovës ishte bërë evident. Brenda rrethanave të tilla Kosova ishte gjendur midis luftës dhe vdekjes! Por ajo sërish si shumë herë të tjera edhe kësaj here e kishte zgjedhur luftën, e cila kësaj radhe kishte qenë e dyfishtë. Në njërin anë kishte qenë lufta për bërjen e Kosovës Republikë, e, në anën tjetër, lufta për mbrojtjen e autonomisë ekzistuese të Kosovës. Lufta e tillë e dyfishtë kishte bërë që Kosova, duke filluar nga nëntori i vitit 1988 e deri në pranverën e vitit 1991, të ishte ngritur sërish në këmbë si një “Ulkonjë e plagosur” ndër vite, për t’u përballur sërish me Serbinë dhe Jugosllavinë për ta shpëtuar veten e saj.

Qëndresën e pashembullt që tregoi Kosova midis viteve 1988-1991, Naser Hani e vlerësonte si **fazën e tretë ofensive** të qëndresës aktive të saj, të filluar nga rinia studentore dhe masat popullore që nga viti 1981 e këtej. Naseri si edhe shumë të tjerë brenda viteve 1988-1989 u ishte bashkangjitur përpjekjeve të fundit të Kosovës për shpëtimin e saj nga kthetrat e Serbisë. Kështu, në kujtesën e tij sidomos ngjarjet e viteve 1988-1991 kishin zënë vend si një kapitull i veçantë, të cilit ai i kthehej herë pas here edhe gjatë viteve të mërgimit në Austri si më poshtë.

#### **Shqiptarët i kishin thënë “Jo” Serbisë**

Shqiptarët gjatë vitit 1988 në mbledhjet e organizuara nga ana e Lidhjes Socialiste të Kosovës lidhur me ndryshimet kushtetuese, i kishin thënë

masovikisht “Jo” Serbisë! Ata gjithandej ishin deklaruar haptas se kishin qenë kundër aprovimit të propozimeve kushtetuese të Kuvendit të Serbisë në kushtetutën e Kosovës, sepse ndryshimet e tilla do ta linin Kosovën pa autonomi. Naser Hani pas orarit të punës kishte marrë pjesë në mbledhje të shumta në lagjet e Prishtinës të organizuara nga Lidhja Socialiste e Kosovës, në të cilat ishte diskutuar lidhur me ndryshimet më të reja kushtetuese. Për t’i inkurajuar qytetarët e thjeshtë ai në mbledhjet e tilla ishte deklaruar vet i pari kundër ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë.

Deri në nëntorin e vitit 1988 paralelisht me popullin autonominë ekzistuese të Kosovës e kishin mbrojtur edhe institucionet kryesore politike e shtetërore të Kosovës, bashkë figurat politike kryesore të këtyre institucioneve, përfshi këtu edhe anëtarët e Komisionit Kushtetues të Kosovës në krye me profesor Kurtesh Salihun. Kësisoj, “Jo”-ja e tillë deri në nëntorin e atij viti kishte qenë edhe gjithëpopullore edhe gjithinstitucionale, kurse zërat e shqiptarëve të kategorisë së Halit Tërnavcit, të Tefik Lluginjtë e të ndonjë tjetri, të cilët lidhur me ndryshimet kushtetuese i kishin thënë “Po” Serbisë, kishin qenë të vetmuar e të pakët, sado që Serbia zërat e tillë i kishte ngritur në kupë të qiellit.

Por, pas ardhjes së Rrahman Morinës në krye të Komitetit Krahinor të LKK-së në nëntorin e vitit 1988, masat popullore shqiptare në mbrojtje të autonomisë ekzistuese të Kosovës gjithnjë e më shumë kishin mbetur të vetmuara. Ato tani nuk e kishin më mbështetjen nga institucionet kryesore të Kosovës dhe figurat politike kryesore, përfshirë këtu edhe Komisionin Kushtetues të Kosovës, gjë kishte bërë që edhe zërat e kategorisë së shqiptarëve si Halit Tërnavci, Tefik Lluginjtë, Faik Jashari e të ndonjë tjetri të ishin dëgjuar gjithnjë e më shumë.

Kështu, pas nëntorit të vitit 1988 në Kosovë kishte filluar të frynte një “erë tjetër”, sepse Serbia “drurit” të cilin s’kishte mundur ta çante për vite të tëra, tani ia kishte gjetur “ilaçin”: Pykën e vet!

## ■ Demonstrata masive në nëntorin e vitit 1988

Me 17 nëntor të vitit 1988 nga miniera e Trepçës ishin nisur drejt Prishtinës në këmbë qindra minatorë për të demonstruar në mbrojtje të autonomisë ekzistuese të Kosovës, e cila tani me ardhjen e Rrahman Morinës në krye të LKK-së vërtet ishte rrezikuar. Me t’u dëgjuar lajmi se minatorët e Trepçës ishin nisur drejt Prishtinës, rinia studentore dhe ajo e shkollave të mesme kishte filluar të demonstronte në Prishtinë, me ç’rast demonstratës i ishin bashkuar edhe shumë punëtorë dhe qytetarë të thjeshtë.

Duke filluar që nga 17 nëntori e deri më 23 nëntor të vitit 1988, në ato ditë

me riga shiu nga të gjitha viset e Kosovës kishin udhëtuar drejt Prishtinës, një pjesë e tyre edhe në këmbë, burra, gra, të rinj dhe fëmijë për ta thënë edhe njëherë fjalën e tyre për fatin e Kosovës, nëpërmjet të një demonstrimi paqësor e gjithëpopullor. Por, meqë autonomia e Kosovës tani më ishte rrezikuar seriozisht, kjo kishte bërë në demonstratat e nëntorit të vitit 1988, kërkesa për bërjen e “Kosovës Republikë” të kombinohej me kërkesën për mbrojtjen e autonomisë ekzistuese të Kosovës.

Edhe Naseri në mbërmmjet e atyre ditëve kur kishte filluar të binte terri, dhe kur mundësia për ta njohur agjentët e sigurimit të shtetit kishte qenë e vogël, u ishte bashkuar radhëve të demonstruesve bashkë me shokët e tij të pranverës së vitit 1981, si me Mehmet Bislimin e me të tjerë. Mbase ai asaj demonstrate i ishte bashkangjitur sepse refleksi i pjesëmarrjes nëpër demonstrata tanimë i ishte bërë një mësim i përsëritur, edhe pse duke qenë ai nëpunës i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës s’ do të duhej t’i bashkohej demonstratës, por do të duhej që ta ruante veten për ta ndihmuar edhe më tej rezistencën gjithëstudentore e gjithëpopullore nga vendi i punës ku kishte qenë.

Meqë Serbia s’kishte ushtruar presion ndaj forcave të rendit të Kosovës për përdorimin e dhunës policore ndaj demonstruesve, kjo kishte bërë që demonstratat e nëntorit të vitit 1988 të kishin kaluar pa dhunë, gjë që e kishte befasuar shumëkënd. Por, siç sqaronte Naseri, Serbia s’kishte kërkuar kësaj radhe që të ushtrohej dhunë policore ndaj demonstruesve, sepse ajo tanimë duke e ndryshuar skenën politike të Kosovës, të Vojvodinës, të Malit të Zi dhe të vetë Kryesisë së Jugosllavisë në dobi të saj, i kishte krijuar parakushtet që Kosovës t’ia pezullonte autonominë, dhe për rrjedhojë s’kishte dashur që nëpërmjet të ushtrimit të dhunës të provokonte edhe më tej turbullira masive në Kosovë, të cilat do të mund t’ia prishnin asaj punët e qitura në “terezi!”.

## **Kapitullimi i Kryesisë së Jugosllavisë para Serbisë**

Në janarin e vitit 1989, Kryesia e Jugosllavisë kishte kapitulluar para Serbisë, sepse ajo, ndonëse me rastin e ndryshimeve kushtetuese në kushtetutën federative, Kosovës dhe Vojvodinës ia kishte ruajtur elementin federativ, megjithatë, ajo duke e dhënë pëlqimin e saj për fillimin e ndryshimeve kushtetuese të kërkuara nga Kuvendi i Serbisë, si dhe duke mbajtur qëndrim indiferent ndaj përpjekjeve antikushtetuese të Serbisë, kësaj të fundit ia kishte dhënë shansin që ajo Kosovës dhe Vojvodinës t’ia pezullonte autonominë e vitit 1974.

Nga ana tjetër, Kryesia e Jugosllavisë e krijuar pas rrëzimit të Qeverisë së Vojvodinës, të Kosovës dhe të Malit të Zi, nën trysinë e Serbisë më 26

shkurt të vitit 1989, e kishte dhënë pëlqimin e saj që në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë të shqyrtohej propozimi i Serbisë për vendosjen e Kosovës në gjendje të jashtëzakonshme, përkatësisht nën shtettrrethim ushtarako-polikor, gjë që i kishte kontribuar po ashtu pezullimit të autonomisë së Kosovës. Ky kishte qenë **grushti i parë** i rëndë që i ishte dhënë autonomisë së Kosovës nga ana e Kryesisë së Jugosllavisë.

Naseri, duke qenë nëpunës i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës dhe për rrjedhojë edhe duke qenë afër burimit të informacionit, i kishte paralajmëruar vazhdimisht shokët e tij ilegales në kuadër të LPRK-së, se çfarë do të mund të ndodhte me autonominë e Kosovës në ditët në vazhdim.

### **Kapitulli i Kuvendit të Jugosllavisë para Serbisë**

Më 1 mars të vitit 1989 në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë ishte hedhur në votim para deputeteve të këtij kuvendi aprovimi i pëlqimit të Kryesisë së Jugosllavisë për vënien e Kosovës nën masa të jashtëzakonshme. Meqë në Kuvendin e Jugosllavisë në sajë të “çelësit nacional” diçka më shumë se gjysma e deputeteve kishin qenë sllovenë, kroatë, boshnjakë, vojvodinas dhe shqiptarë, edhe aprovimi i pëlqimit të Kryesisë jugosllave për vënien e Kosovës nën masa të jashtëzakonshme kishte mundur të dështonte.

Por ishte Lllazar Mojsovi, anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë nga Maqedonia, ai që nëpërmjet të një dezinformate mashtruese kishte ndikuar që votimi për vënien e Kosovës nën masa të jashtëzakonshme të mos dështonte. Mojsovi, duke e marr fjalën në foltoren e Kuvendit të Jugosllavisë me dy-tri faqe letër në dorë, kishte deklaruar se në ato letra e kishte, siç ishte shprehur, “Planin e Shtabit Kryesor të Kundërrevolucionit në Kosovë”, sipas të cilit shkëputja e Kosovës nga Jugosllavia ishte planifikuar të ndodhte në tri faza. Duke dezinformuar kësisoji, ai u ishte drejtuar deputetëve të Kuvendit të Jugosllavisë, që ata për ta ruajtur integritetin e vendit të votonin pro aprovimit të vendosjes së masave të jashtëzakonshme në Kosovë. Deputetët e Kuvendit të Jugosllavisë, duke e besuar dezinformatën e tillë të Mojsovit si të vërtetë, e kishin marrë vendimin me shumicë votash që Kosova të vihej nën masa të jashtëzakonshme, gjë që Serbisë ia kishte lehtësuar punën që Kosovës t’ia pezullonte autonominë. Votimi i tillë pro vënies së Kosovës nën masa të jashtëzakonshme kishte qenë **grushti i dytë i rëndë** që i ishte dhënë autonomisë së Kosovës, kësaj radhe nga ana e Kuvendit të Jugosllavisë.

Në të vërtetë, Mojsovi, siç thoshte Naseri, duke bërë intriga kundër Kosovës në Kuvendin e Jugosllavisë, më shumë se hallin e Serbisë e kishte pasur hallin e asaj Kosovës tjetër në gjysmën perëndimore të Maqedonisë.

## ■ Katërshja antishqiptare e Kosovës

Pas kapitullimit të Kryesisë së Jugosllavisë dhe të Kryesisë së Kuvendit Federativ para Serbisë, kjo e fundit kishte ushtruar presion ekstrem ndaj institucioneve shtetërore të Kosovës që edhe ato ta jepnin pëlqimin e tyre për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës sipas kërkesave të kuvendit të Serbisë.

Për t'ia arritur këtij qëllimi Serbia e kishte angazhuar katërshen e saj antishqiptare, siç ishin: Rahman Morina, Kryetar i Komitetit të LKK-së, Hysamedin Azemi Kryetar i Komitetit Komunal të LKK-së për Prishtinën, Ali Shukria anëtarë i Kryesisë së KQ të LKJ-së, dhe Sinan Hasani ish-anëtarë i Kryesisë së Jugosllavisë nga Kosova. Katërshja e tillë sidomos gjatë janar-shkurtit dhe fillim-marsit të vitit 1989 e kishte intensifikuar veprimtarinë e saj antishqiptare, duke ushtruar presion të hapur ndaj institucioneve kryesore të Kosovës, që ato ta jepnin pëlqimin e tyre për aprovimin e ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë. Nuk ka dyshim, se katërshja e tillë kishte ushtruar presion edhe ndaj Komisionit Kushtetues të Kosovës, që edhe ai të deklarohet se ndryshimet kushtetuese të kërkuara nga Serbia nuk e dëmtonin autonominë e Kosovës.

Emëruesi i përbashkët i katërshes së tillë kishte qenë deklarimi i saj kombëtar, jo si shqiptar, por si jugosllav, gjë që edhe sipas legjislacionit të asokohshëm jugosllav në fuqi, ajo s'kishte pasur të drejtë ta përfaqësonte Kosovën e banuar me rreth 90% me shqiptarë. Një karakteristikë tjetër e tyre kishte qenë se tre prej tyre s'kishin qenë të martuar me shqiptarë. Rahman Morina dhe Sinan Hasani gratë i kishin serbe, kurse Ali Shukria gruan e kushte malazeze. Por më shoviniste dhe më mafioze kishte qenë gruaja e Rahman Morinës, e njohur në publik si “Buba Morina”. Ajo si për të gjallë të burrit të saj, ashtu edhe pas vdekjes së tij, kishte nxjerrë nga goja lloj-lloj fyerjesh e shpifjesh kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Nga interesimet që ishin bërë për Hysamedin Azemin, kishte rezultuar se ai ishte nga Mitrovica, nga në familje me origjinë të dyshimtë, e cila që herët kishte punuar për interesat e Serbisë. Ishte thënë po ashtu se Hysamedini kishte katër vëllezër, por secili prej tyre e kishte një mbiemër tjetër.

Ali Shukria, të cilin studentet e kishin quajtur “Shpirtkazma”, i kishte kërcënuar shqiptarët deri edhe me bukën e gojës! Në një mbledhje të KQ të LKJ-së ai ishte shprehur se, “shqiptarët vetëm mungesa e bukës do t'i shtrojnë...!”. “Vetëm kur shqiptarëve t'u mungojë buka problemet do të zgjidhën allaminut!”, ishte shprehur ai.

Nga ana tjetër, Sinan Hasani, të cilin studentët e kishin quajtur “Drakulla”, kishte ushtruar trysni edhe në mesin e akademikëve dhe intelektualëve, që ata të deklaroheshin pro aprovimit të kërkesave kushtetuese të Serbisë.

Duke e ndier vetën për jugosllav, siç ishte deklaruar edhe zyrtarisht, ai ishte pozicionuar ndaj Shqipërisë si një antishqiptar i përbetuar. Nga që e urrente shumë Enver Hoxhën, e kishte quajtur atë “edh i zgjebosur!”, ndërkohë që “Zëri i Popullit”, “Drakullën” e kishte quajtur “Qen i Beogradit!”. Rahman Morina, të cilin studentët e kishin quajtur “Oxhakxhiu”, duke e parë se shqiptarët me gjithë represionin e ushtruar ndaj tyre, jo vetëm se nuk ishin shtruar e dorëzuar, por edhe kërkonin që ai të largohej nga “balli i oxhakut”, ndër të tjera, ishte shprehur duke thënë se “Një dreq i madh asht këtu n’Kosovë!”. Dhe mu ia dreq, si duket, ia hëngri kokën atij vetë!

### ■ Grevat e urisë në shkurtin e vitit 1989

Pikërisht për t’ia ndalur turrin katërshes së lartpërmendur dhe për t’i mbështetur institucionet kryesore të Kosovës, përveç Lidhjes Komuniste të Kosovës e cila ishte në duart e Rahman Morinës, që ato të mos dorëzoheshin para presioneve të Serbisë dhe të katërshes së tillë, më 20 shkurt të vitit 1989 rreth 1500 minatorë të Trepçës në Stan Tërg afër Mitrovicës ishin futur në grevë urie në horizontin e fundit të minierës, duke e kushtëzuar daljen e tyre nga zgafella e minierës me mosprekjen e autonomisë ekzistuese së Kosovës, dhe me dorëheqjen nga postet politike të treshes antishqiptare: Rahman Morina, Hysamedin Azemi dhe Ali Shukria, sepse Sinan Hasani duke qenë tanimë i pensionuar s’kishte pasur asnjë post.

Paralelisht me grevën e minatorëve me kërkesa të njëjta kishin hyrë në grevë urie edhe rreth 1000 studentët të Universitetit të Prishtinës në palestrën e sporteve afër mensës së studentëve. Në grevë urie ishin futur tashmë edhe minatorët e minierave të tjera të Kosovës, si dhe punëtorët e pothuajse të gjitha fabrikave, siç kishte qenë edhe Fabrika e gomës “Ballkan” në Therandë (asokohe Suharekë), e cila kishte rreth dy mijë punëtorë. Kështu, me kushtin e mosprekjes së autonomisë ekzistuese të Kosovës, dhe me kushtin e largimit nga postet politike të Rahman Morinës, Hysamedin Azemit dhe Ali Shukrisë, në shkurtin e atij viti ishin organizuar greva të mëdha urie, të cilat e kishin bllokuar pothuajse tërë jetën ekonomike të Kosovës. Asokohe, siç tregonte Naseri, studentë të caktuar të ilegales për t’i koordinuar sa më mirë veprimet midis minatorëve dhe studentëve, kishin vënë lidhje me minatorët e Trepçës, kuptohet jo duke u paraqitur si përfaqësues të ilegales, por duke u paraqitur thjesht si studentë. Por, kjo punë s’kishte qenë e lehtë, si për shkak të largësisë, ashtu edhe për shkak të përndjekjes dhe rrethanave tjera të ndërlikuara.

Meqë grevat e tilla kishin pasur jehonë të madhe ndërkombëtare, duke e

komprometuar rëndë Serbinë dhe Jugosllavinë, në Kosovë kishte ardhur edhe Kryetari i Kryesisë së LKJ-së, kroati Stipe Shuvar, për të biseduar drejtpërdrejtë me minatorët e Trepçës në zgafellë, përkatësisht që t'i bindte ata ta ndërprisnin grevën... Por, bashkë me Shuvarin kishte ardhur në Kosovë edhe Millosheviqi, i cili i shoqëruar nga Rrahman Morina dhe Sinan Hasani kishte bërë një takim pune në Elektroekonominë e Kosovës, me ç'rast ai kishte folur sërish për krijimin e "Serbisë Unike" me anë të ndryshimeve më të reja kushtetuese. Nga ana tjetër, kishte qenë edhe gjenerali serb, Petar Graçanin, i cili kishte kërkuar që të ndërpriteshin menjëherë grevat e urisë në Kosovë, sepse, siç ishte shprehur ai, humbjet ekonomike që do të pasonin prej tyre do ta përkeqësonin jetesën e popullit. Por, Graçanini kishte "harruar" të thoshte se sa do të përkeqësohej jeta e shqiptarëve nëse Kosovës do t'i pezullohej autonomia, siç kërkonte Serbia.

Meqë grevat e shkurtit s'ishin ndërprerë as me lutje e as me kërcënime, në ditën e tetë të grevave, përkatësisht me 27 shkurt të vitit 1989, në mjetet e informimit ishte dhënë lajmi, se treshja Morina-Azemi-Shukria i kishin dhënë dorëheqjet nga postet e tyre politike. Kjo kishte bërë që minatorët e Trepçës të rraskapitur e lodhur për vdekje ta kishin ndërprerë grevën e urisë, duke dalë nga horizonti i nëntë i minierës pas tetë ditësh. Pas ndërprerjes së grevës nga ana e minatorëve ishin ndërprerë edhe të gjitha grevat tjera gjithandej Kosovës. Por dorëheqjet e treshes Morina-Azemi-Shukria kishin qenë vetëm mashtrim, sepse dueti Morina-Shukria pas ndërprerjes së grevave i kishin tërhequr dorëheqjet e tyre dhe kishin vazhduar sërish të ushtronin presione të shumta kundër institucioneve kryesore të Kosovës, që ato ta jepnin pëlqimin e tyre për aprovimin e amendamenteve kushtetuese të Serbisë në kushtetutën e Kosovës.

Naserit me ta dëgjuar lajmin e dorëheqjes së treshes së tillë antishqiptare, i kishte shkuar mendja se ato kishin qenë një mashtrim sa për t'i ndërprerë grevat e shkurtit gjithandej Kosovës. Më saktë, ai kishte menduar se Serbia tani në vend të treshes së dorëhequr, do ta vendoste një treshë tjetër antishqiptare... Duke menduar kështu ai kishte shkuar në palestrën sportive, për t'i influencuar studentët që ata të mos nguteshin për ta ndërprerë grevën e urisë, sepse dorëheqjet e kumtuara të treshes antishqiptare mund të ishin një mashtrim, por s'kishte pasur sukses.

Sipas Naserit, Serbia edhe gjatë grevave të shkurtit të vitit 1989, ashtu si edhe me rastin e demonstratave të nëntorit të vitit 1988, nuk kishte përdorur dhunë policore ndaj grevistëve shqiptarë, sepse ajo s'kishte dashur të provokonte në Kosovë turbullira të mëtejshme masive, të cilat asaj mund t'ia bënin të dështueshme të gjitha parakushtet që ajo i kishte plotësuar për ta pezulluar autonominë e Kosovës.

Naseri, grevat e shkurtit të vitit 1989 i kishte konsideruar, jo vetëm si një formë të re të qëndresës aktive, por edhe si një “shuplakë” tjetër që rinia dhe punëtorja e Kosovës ia kishte dhënë Serbisë dhe Jugosllavisë para se Kosovës t'i ishte pezulluar autonomia e vitit 1974.

## Gjunjëzimi i krerëve kryesor të Kosovës para Serbisë

Duke filluar që nga 28 shkurti e deri më 15 mars të vitit 1989, Serbia kishte ushtruar presion ndaj krerëve kryesor të Kosovës, që ata në emër të institucioneve që kishin udhëhequr ta jepnin pëlqimin e tyre për aprovimin e ndryshimeve kushtetuese të Serbisë brenda kushtetutës më të re të Kosovës. Duke pasur frikë për kokat e tyre këta krerë të Kosovës e kishin dhënë pëlqimin e tillë, duke rënë kësisoj në gjunjë para Serbisë dhe Millosheviqit, si dhe duke e lënë kësisoj Kosovën nën mëshirën e fatit.

E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me anëtarët e Komisionit Kushtetues të Kosovës, të cilët duke filluar që nga 28 shkurti e deri më 23 mars të vitit 1989 kishin kapitulluar para presionit të Serbisë, duke deklaruar se “ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Serbia në thelb nuk e kishin rrezikuar autonominë e Kosovës të vitit 1974!” etj. Më tej, anëtarët e Komisionit Kushtetues të Kosovës bashkë me krerët e Lidhjes Socialiste të Kosovës kishin kapitulluar para Serbisë edhe duke lejuar, që kategoria e “shqiptarëve” si Tefik Llugiqi t'i falsifikonte procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura gjatë diskutimit popullor të ndryshimeve kushtetuese. Kësisoj, derisa në procesverbalet e vërteta ishte shkruar se shqiptarët nuk ishin pajtuar me ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë, në procesverbalet e falsifikuara ishte shkruar e kundërta... Gjunjëzimi i tillë i institucioneve dhe i Komisionit Kushtetues të Kosovës para Serbisë, për Naserin kishte paraqitur **grushtin e tretë** me radhë që i ishte dhënë autonomisë së Kosovës nga vet institucionet e Kosovës.

Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto vetëm disa ditë para se të mbahej mbledhja vendimtare e Kuvendit të Kosovës, lidhur me votimin pro ose kundër kërkesave kushtetuese të Serbisë, Kosova me bekimin e Kuvendit Federativ të Jugosllavisë ishte vënë nën masa të jashtëzakonshme të shtetrrrethimit klasik, gjë që kishte rezultuar me sjelljen në Kosovë të trupave ushtarake shtesë, të artillerisë së rëndë dhe të armatime, siç ishte thënë “për ta ruajtur rendin dhe sigurinë publike në Kosovë!”.

Pas veprimeve të tilla zinxhirore deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës kishin qenë shpresa e fundit e shqiptarëve, që ata me shumicë votash t'i refuzonin ndryshimet kushtetuese të kërkuara nga Serbia, dhe kësisoj t'ia shpëtonin Kosovës autonominë ekzistuese të vitit 1974.



## **IX. Pezullimi i autonomisë së Kosovës në marsin e vitit 1989**

### **■ Ndryshime kushtetuese me kallashnikovë e tanke!**

Më 23 mars të vitit 1989, duke qenë Kosova nën shtetrrrethim klasik ushtarako-polikor, ishte mbajtur mbledhja vendimtare e Kuvendit të Kosovës, në të cilën propozimet kushtetuese të Kuvendit të Serbisë ishin hedhur për votim. Për të ushtruar sa më shumë frikë e kërcënim ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe ndaj deputetëve shqiptarë në veçanti, në rrugët dytësore të cilat lidheshin me sheshin qendror të Prishtinës ku ishte ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, ishin parë dhjetëra policë të armatosur me kallashnikovë dhe disa tanke policore duke qëndruar në gatishmëri. Pamjet e tilla dëshmonin se ndryshimet kushtetuese të asaj dite ndër të tjera do të bëheshin edhe nën diktatin e kallashnikovëve dhe të tankeve!

Duke e parë autonominë e Kosovës si shumë të rrezikuar, Naser Hani, deri dy-tri ditë para mbledhjes vendimtare të Kuvendit të Kosovës më 23 mars, ishte përpjekur që t'ua mbushte mendjen disa intelektualëve të komunave të ndryshme të Kosovës me banim në Prishtinë, që ata t'i mbështetnin dhe inkurajonin deputetet shqiptarë të komunave të tyre, që ata më 23 mars të votonin kundër ndryshimeve kushtetuese të imponuara nga Serbia. Por tani më ishte bërë vonë. Frika e kishte bërë punën e saj. Intelektualët s'i kishin pasur në qejf burgjet! Sa për mirësjellje ata i kishin thënë Naserit: “Mirë do të mundohe mi të bëjmë diçka!”. Për t'i inkurajuar deputetët shqiptarë, Naseri me 23 mars ishte përpjekur që të futej edhe brenda në sallën e Kuvendit, e cila kishte qenë pjesë e ndërtesës së Këshillit Ekzekutiv të Kosovës ku ai kishte punuar.

### **Ndryshime kushtetuese me mashtrime e falsifikime**

Më 23 mars të vitit 1989 në sallën e Kuvendit të Kosovës, përveç deputetëve të Kuvendit të Kosovës ishin futur edhe shumë “miq” të ftuar nga kryetari i Kuvendit

të Kosovës, serbi Vukashin Jokanoviq. Kështu, përveç figurave kryesore politike të Kosovës dhe të Serbisë, të cilat ishin ulur në radhën e parë të karrigeve të Kuvendit, në sallë ishin parë edhe shumë persona të tjerë të panjohur. Të tillët ishin futur në sallën e Kuvendit të Kosovës në cilësinë e kameramanëve, të korrespondentëve dhe të gazetarëve të medieve audiovizuale dhe të shkruara të Beogradit, gjoja për ta regjistruar mbledhjen “historike” të Kuvendit të Kosovës, në të cilën sipas tyre ishte dashur të aprovohejshin kërkesat kushtetuese të Kuvendit të Serbisë në Kushtetutën e Kosovës. Siç ishte marrë vesh më vonë, pjesa e madhe e “kameramanëve”, “korrespondentëve” dhe e “gazetarëve” të tillë, kishin qenë kryesisht agjentë serbë të sigurimit të shtetit të Serbisë dhe pjesërisht agjentë të sigurimit të shtetit në Kosovë.

Kur kryetari i kuvendit, Vukashin Jokanoviq, u ishte drejtuar deputetëve me pyetjen se: “Kush është për aprovimin e ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë”, pro aprovimit të ndryshimeve të tilla kushtetuese përveç deputetëve serbë e malazez, të cilët kishin qenë pakicë, kishin votuar edhe “miqtë” e lartpërmendur të Vukashin Jokanoviqit: “kameramanët”, “korrespondentët” dhe “gazetarët” e shumë të Beogradit. Të tillët për të figuruar para opinionit publik si deputetë ishin ulur qëllimisht në radhët e karrigeve të deputetëve në sallë. Votimi i përbashkët i deputetëve serbë e malazez me “miqtë” e shumë të Vukashin Jokanoviqit, kishte krijuar përshtypjen sikur shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, kishin votuar pro aprovimit të ndryshimeve kushtetuese sipas kërkesave të Serbisë.

Kur Jokanoviqi kishte pyetur se: “Kush është kundër ndryshimeve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë”, vetëm dymbëdhjetë deputetë shqiptarë kishin pasur guximin t’i ngritin gishtat lart. Pjesa tjetër e tyre rreth njëqind këtë guxim se kishte pasur, edhe pse ajo as pro e as kundër aprovimit të ndryshimeve kushtetuese të Serbisë në Kushtetutën e Kosovës nuk kishte votuar.

Meqë Jokanoviqi qëllimisht s’kishte pyetur se: A ka deputetë të cilit gjatë votimit kanë abstenuar, kjo i kishte mjaftuar atij që të deklaronte se: “Kuvendi i Kosovës me shumicë votash i ka aprovuar ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë”, duke u pezulluar dhe shfuqizuar kështu që atë ditë autonomia ekzistuese e Kosovës.

## **Grushti përfundimtar**

Më 23 mars të vitit 1989 autonomisë së Kosovës i ishte dhënë edhe **grushti i katërt përfundimtar**, kryesisht nga Serbia, përkatësisht nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, serbi Vukashin Jokanoviq dhe “miqtë” e tij nga Beogradi, të cilët kishin votuar si të kishin qenë deputetë, dhe pjesërisht edhe nga deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës me mosguximin e tyre për të votuar kundër ndryshimeve

kushtetuese të imponuara nga Serbia, dhe fatkeqësisht edhe nga kryetari i Komisionit kushtetues të Kosovës, Kurtesh Salihu, i cili ende pa filluar votimi në sallë ishte shprehur se ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë, nuk e dëmtojnë esencën e autonomisë së Kosovës sipas kushtetutës së vitit 1974.

Të nesërmen, më 24 mars, në fotografinë e faqes së parë të gazetës “Rilindja”, ku ishte paraqitur një pamje nga votimi i djeshëm në Kuvendin e Kosovës, me gishta të ngritur lart duke votuar ishin parë, përveç deputetëve serbë e malazez, edhe “miqtë” e shumtë të Jokanoviqit të ardhur nga Beogradi, ashtu siç ishte parë me gishta të ngritur lart duke votuar edhe njëfarë Mehmet Ajeti, i cili s’kishte qenë fare deputet. Njerëzit ishin çuditur kur kishin dëgjuar të thuhej se Mehmet Ajeti kishte qenë njëri nga katër vëllezërit e Hysamedin Azemit me mbiemër tjetër.

## ■ Demonstrata e 23 marsit e vitit 1989

Më 23 mars të vitit 1989 mbledhja vendimtare e Kuvendit të Kosovës kishte filluar diku në orën 9-të të paradites. Shumë shqiptarë gjithandej Prishtinës e Kosovës e kishin ndjekur seancën e Kuvendit të Kosovës në televizion ose në radio. Diku nga ora 11-të e paradites ishte dhënë lajmi i kobshëm, se Kuvendi i Kosovës me shumicë votash i kishte aprovuar ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Serbisë! Menjëherë pas lajmit të tillë dhe ende pa përfunduar mbledhja e Kuvendit, në sheshin qendror të qytetit para Kuvendit kishte filluar të dilte rinia studentore dhe ajo e shkollave të mesme të Prishtinës. Kur numri i tyre kishte arritur në disa qindra, ata kishin filluar të demonstironin kundër vendimmarrjes së tillë makabër në Kuvendin e Kosovës.

Por, edhe forcat policore serbe ishin përgjigjur aty për aty, duke vlarë me armë zjarri dhjetëra studentë demonstrues. Kësisoj, regjimi serb vetëm një orë pasi që në Kuvendin e Kosovës ishin “aprovuar” ndryshimet kushtetuese të Serbisë në dëm të autonomisë së Kosovës e kishte përgjakur Kosovën aty për aty, ndër të tjera edhe për vetë faktin se ky regjim tani që autonomia e Kosovës veç ishte pezulluar, as që kishte pasur më ndonjë arsye që kundër demonstruesve shqiptarë të mos i përdorte edhe armët.

Përdorimi i armëve menjëherë pas pezullimit të autonomisë së Kosovës kishte treguar qartë, pse Serbia nuk e kishte bërë një gjë të tillë gjatë demonstratave gjithëpopullore të nëntorit të vitit 1988, dhe gjatë grevave të studentëve në Prishtinë dhe të minatorëve në Stan Terg, në shkurtin të vitit 1989! Po për çka tjetër veçse për të mos shkaktuar turbullira masive të mëtejme në Kosovë, të cilat asaj do të mund t’ia nxirrnin binarësh parapërgatitjet për pezullimin e autonomisë së Kosovës.

Demonstrata studentore e 23 marsit kishte filluar para Kuvendit të Kosovës, por për shkak të dhunës policore deri edhe me vrasje, ajo ishte detyruar që të vazhdonte përposhtë rrugës drejt Medresesë, në veri të Prishtinës, duke përfunduar rrënzë lagjes “Kodra e Trimave”, ku kishte qenë hekurudha, dhe ku pas mbarimit të demonstratës bashkë me gjësendet e mbetura të demonstruesve, ishin parë edhe pellgjet e gjakut të demonstrueseve të vrarë.

Sipas Naserit demonstrata studentore e 23 marsit e kishte pasur rëndësinë e saj, sepse ajo ia kishte bërë të qartë opinionit ndërkombëtar, se pezullimi i autonomisë së Kosovës ishte bërë në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar. Por edhe Serbia, pas kësaj demonstrate e kishte të qartë se nuk i kishte kryer punët me shqiptarët!

Duke filluar që nga marsi dhe maji e deri në dhjetorin e vitit 1989, shqiptarët kishin demonstruar gjithandej Kosovës kundër pezullimit të autonomisë së Kosovës... Demonstratat e tilla të vitit 1989 ishin organizuar kryesisht nga LPRK-ja.

## ■ Me “ushtrinë e madhe” të solidaritetit gjithëpopullor

Por në fillim të viteve të '90 shqiptarët bëmvave makabre të regjimit serb në Kosovë i ishin kundërvënë edhe me “ushtrinë e madhe” të solidaritetit gjithëpopullor. Brenda kësaj “ushtrie të madhe” kishin zënë vend shumë mjekë të cilët miqve, fqinjëve dhe shokëve të tyre u kishin bërë shërbime shëndetësore falas në mjediset e tyre familjare ose në ardinaca private. Kishin qenë sidomos mijëra familje shqiptare, të cilët duke qenë më të kamura, brenda aksionit të njohur si “Familja ndihmon familjen” kishin ndihmuar për një, dy apo tre vjet me radhë me një donacion prej 100 markash gjermane mijëra familje të varfra minatorësh të Minierës të Trepçës dhe të minierave të tjera të Kosovës, si dhe kishin zënë vend edhe shërbimet e tjera të ndryshme të përditshmërisë që shqiptarët ia kishin bërë falas njëri-tjetrit reciprokisht.

Meqë brenda solidaritetit të tillë ndërshtqiptar ishin përfshirë jo vetëm shqiptarët e Kosovës, por edhe shqiptarët në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore, Naseri solidaritetit të tillë i ishte gëzuar dyfish: edhe si solidaritet i mirëfilltë, edhe si afrim e bashkim shpirtëror i të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi. Duke pasur parasysh se Naseri që nga viti 1981 e këtj kishte mbledhur ndihma financiare në Strugë e rrethinë, të cilat ua kishte shpërndarë familjeve të të burgosurve politikë në Kosovë, ai brenda solidaritetit të tillë ndërshtqiptar e kishte pasur “hisen” e tij të veçantë.

## **Shqiptarët me improvizime s'mund të jetojnë përgjithmonë**

Nga ana tjetër, Naseri e kishte pasur të qartë se shqiptarët me sistem arsimor e shëndetësor të improvizuar dhe me solidaritet gjithëpopullor, do të mund të mbijetonin për një kohë por jo përgjithmonë, dhe aq më pak do të mund ta pavarësonin Kosovën.

Bile, përkundrazi, ai kishte menduar se jetesa e tillë me ndërvarësi po të vazhdonte për kohë të gjatë, ajo do të mund t'u kthehej shqiptarëve në një mësim kundërproduktiv, që ata kësaj, në sajë të ndërvarësisë reciproke, të vazhdonin të jetonin në robëri. Kishte shpresuar se klasa e re politike e Kosovës vitet e tilla të mbijetesës së shqiptarëve nëpërmjet të improvizimeve të ndryshme dhe solidaritetit gjithëpopullor, do të dinte t'i përdorte si kohë të vlefshme për konsolidimin e shqiptarëve për t'iu kundërpërgjigjur ata Serbisë deri edhe me luftë të armatosur, siç kishin bërë sllovenët, dhe siç po bënin në fillim të viteve të '90 edhe kroatët dhe siç bënë më vonë edhe boshnjakët. Mirëpo, shpresa e tillë kishte qenë e kotë, sepse, siç thotë edhe fjala popullore, “dita e mirë shihet që në mëngjes”, kurse klasa e re politike e Kosovës që në fillimet e saj kishte treguar se s'kishte qenë e tillë. Përkundrazi, ajo kishte dashur që jeta e improvizuar e shqiptarëve të Kosovës të zgjaste sa më shumë, sepse ajo vetë s' ishte as e ditur, as e motivuar edhe as e përkushtuar për të ndërmarrë ndonjë hap tjetër, jo vetëm në fillim të viteve të '90 por as edhe më vonë.

## **Demonstratat e fundit të rinisë nëpër Kosovë**

Duke filluar që nga janar-shkurti i vitit 1990 dhe deri në fund të vitit 1991, në Kosovë ishin bërë demonstrata sporadike, me ç'rast rinia e populli kishin vazhduar t'a ngritnin zërin, si kundër pezullimit të autonomisë së Kosovës, ashtu edhe për bërjen e Kosovës Republikë. Këto ishin demonstratat e fundit që kishin ndodhur në frymën e pranverës së madhe të vitit 1981, e cila kishte filluar dhe po mbaronte me demonstrata nëpër rrugë, kishte filluar dhe po mbaronte me burgosje, plagosje e vrasje, duke e hapur një faqe të re të historisë për Kosovën dhe kombin shqiptar në përgjithësi.

Pranvera e madhe e vitit 1981 i kishte dhënë Kosovës “emër e mbiemër” para opinionit ndërkombëtar për dhjetë vjet me radhë; i kishte treguar botës se në Kosovë jetonin rreth 2 milionë shqiptarë, të cilët kërkonin që Kosovës t'i njihej statusi i republikës. Mbi të gjitha, pranvera e madhe e vitit 1981 i kishte bashkuar të gjithë shqiptarët në hapësirën e tyre etnike në Ballkan, bashkë me diasporën shqiptare disamilionshe nëpër botë. Në sajë të pranverës së madhe të vitit 1981 dhe të qëndresës aktive dhjetëvjeçare, edhe partitë politike shqiptare të porsakrijuara s' ishte dashur që çdo gjë ta fillonin nga e para. Bota e dinte tashmë se ku ishte

Kosova dhe çfarë kërkonte ajo nga Jugosllavia e Serbia për vite të tëra. Shtypi botëror ishte marrë tashmë me mijëra herë me Kosovën dhe kërkesën e saj për t'u bërë një republikë e barabartë me republikat tjera të Jugosllavisë. Figura politike ndërkombëtare kishin bërë herë pas here deklarata pozitive për Kosovën. Kosova kishte dalë nga anonimiteti njëherë e përgjithmonë. Të gjitha arritjet e tilla ishin fryte të qëndresës aktive, të cilën rinia dhe populli shqiptar në Kosovë dhe viseve të tjera i kishin paguar shumë shtrenjtë.

## **X. Duke e keqkuptuar dhe keqpërdorur demokracinë**

### **■ Demokracia me dhëmbë!**

Brenda viteve 1988-1989 ishte dukur sikur edhe mbi Ballkanin e trazuar do të fryenin së shpejti erërat e “trëndafilta të demokracisë!”. Të tilla erëra ishte dukur sikur do të frynin edhe mbi qiellin e turbullt të Jugosllavisë, dhe brenda saj edhe mbi qiellin me re të dendura të Kosovës së vogël! Shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi mezi se kishin pritur që të frynin mbi Kosovë erërat e ngrohta të demokracisë, sepse, siç u kishin premtuar krerët e partive shqiptare të porsakrijtura, tani në epokën e demokracisë edhe problemet moçme dhe të reja me Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, nuk do t'i zgjidhnin më si moti me shpatë e me shtizë, por me rrugë paqësore e me dialog demokratik!

Kësisoj, kishin shpresuar dhe besuar shqiptarët asokohe për epokën e demokracisë, e cila sapo kishte filluar të lindë, por ashtu siç dielli i lëshon rrezet tij të argjendta mbi borën e bardhë të një mëngjesi të ftohtë dimëror, dhe kur varfanjaku i gjorë mashtrohet e del jashtë sa për t'i ngrohur kockat, por meqë “dielli i del të jetë me dhëmbë”, ai, i dëshpëruar futët sërish në kasollen e tij! Se demokracia s'kishte qenë vetëm dialog demokratik, shqiptarët e kishin kuptuar sidomos gjatë viteve 1998/1999 të Luftës Çlirimtare të Kosovës, kur ata për ta shkëputur Kosovën nga Serbia kishin qenë të detyruar që të luftonin edhe me armë!

Duke pasur parasysh se pikërisht vendet e demokracive të mëdha perëndimore e kishin përkrahur Luftën Çlirimtare të Kosovës, kjo tregonte qartë se demokracia s'e kishte përjashtuar as qëndresën aktive të cilën shqiptarët e kishin ushtruar për një dekadë, dhe as luftën e armatosur, të cilën ata për ta shkëputur Kosovën nga Serbia ishte dashur ta bënin gjatë viteve 1998/1999. Kështu, vetëm krerët e klasës së re politike të Kosovës, duke e keqkuptuar dhe keqpërdorur demokracinë, në emër të saj e kishin eliminuar nga rendi i ditës qëndresën aktive me demonstrata dhe mosdëgjueshmëri qytetare dhe sidomos

luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës, prej të cilës ata kishin ikur si “djalli prej temjanit!”.

## **Të kthyer me shpinë nga rezistenca aktive**

Pikërisht duke e kuptuar demokracinë si një Eldorado<sup>4</sup> dhe si një “perpetuum mobile” që ec vet, shumica e shqiptarëve në fillim të viteve të '90 ia kishin kthyer shpinën rezistencës aktive (qëndresës aktive) të ushtruar midis viteve 1981-1991. Dhe jo vetëm se ia kishin kthyer shpinën, por duke besuar se në epokën e demokracisë edhe çështja e Kosovës do të zgjidhej me dialog demokratik, siç u kishin thënë atyre partitë shqiptare të porsakrijtura, ata qëndresën aktive e kishin konsideruar edhe si diçka të panevojshme dhe të gabuar nëpërmjet të së cilës i kishin “djegur kot duart”, ndërkohë që “mashën” (demokracinë) e kishin pasur fare pranë, por që për fat të keq s'e kishin ditur.

Se kush kishin qenë ata që shqiptarëve ua kishin “djegur kot duart” për dhjetë vjet me radhë që nga viti 1981-1991, këtë shqiptarëve ua kishte treguar që nga viti 1991 e këtej, një kategori politikanësh, historianësh, publicistësh dhe gazetarësh shqiptarë kryesisht në Kosovë dhe pjesërisht edhe në Shqipëri. Sipas të tillëve, shqiptarëve ua kishin “djegur duart”, jo vetëm pa nevojë, por edhe qëllimisht, kreatorët e qëndresës aktive të viteve të '80 për realizimin e Republikës së Kosovës, duke demonstruar e duke ushtruar mosdëgjueshmëri qytetare ndaj Jugosllavisë dhe tri republikave të saj jugore, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Më tej sipas kësaj kategorie shqiptarësh, pishtarët e kërkesës politike “Kosova Republikë”, duke qenë një pjesë e tyre spiunë të sigurimit shtetëror të Jugosllavisë (UDB-së) dhe spiunë të sigurimit shtetëror të Shqipërisë, në marrëveshje paraprake me te dy sigurimet shtetërore të të dy vendeve, duke filluar që pranvera e vitit 1981 dhe për vite të tëra në vazhdim, kërkesën politike Kosova Republikë e kishin shpikur me qëllim, që Jugosllavisë dhe tri republikave të saj, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, t'ua jepnin shansin që Kosovës t'ia pezullonin autonominë e vitit 1974 dhe që t'i dëmtonin shqiptarët sa më shumë, duke i burgosur, torturuar, plagosur e vvarë në emër të nacionalizmit, të irredentizmit dhe të kundërrevolucionit në Kosovë.

Më tej kjo kategori shqiptarësh pohonte pa asnjë argument relevant se të gjitha këto dëme u ishin bërë shqiptarëve ngase Enver Hoxha, duke qenë ai komunist dhe antikombëtar, jo vetëm që e kishte lënë Kosovën dhe viset e saj në Jugosllavi, por që nga LDB-ja e këtej edhe kishte kolaboruar fshehurazi

<sup>4</sup> Eldorado - paraqet emrin e një vendi të pasur me ar dhe argjend në Amerikën jugore. Eldorado u quajt fillimisht një njeri i ardhur në këtë vend nga Spanja, pastaj kështu u quajt një qytet dhe së fundi i tërë vendi. Popullata indigjene e Eldorados quhet Manoa.



me Titon, që bashkë me të t'u jepnin fund shqiptarëve në Kosovë dhe vise të saj. Kështu, puna kishte shkuar deri aty sa që kjo kategori shqiptarësh kishte deklaruar se Shqipëria i kishte përkrahur ngjarjet e viteve të '80 të Kosovës së bashku me kërkesën për bërjen e Kosovës Republikë, pikërisht për t'ua futur shqiptarëve në Kosovë kokën në gërsërët e Jugosllavisë....!

## **Të akuzuar, të përndjekur dhe të dënuar dyfishë**

Nëpërmjet të propagandës së tillë qëndresa aktive e viteve të '80 bashkë me mijëra ish-të burgosur politikë dhe anëtarë të organizatave ilegale, të cilët kishin qenë kreatorët e saj, tani në fillim të viteve të '90 dhe në vazhdim, në masë të konsiderueshme ishin veshur me petkun ideologjik komunist, dhe për më keq edhe të tradhtisë dhe të spiunimit në dëm të shqiptarëve...! Puna kishte shkuar deri aty, sa që në fund të viteve të '90 një gazetar e kishte akuzuar edhe Adem Demaçin si “të kuq” dhe si komunist në shërbim të Serbisë...! Për ta mbytur përfundimisht qëndresën aktive të viteve të '80, kategoria e lartpërmendur e historianëve, publicistëve, gazetarëve dhe e bataçqinjve të shumtë, ish-të burgosurit politikë i kishin quajtur në kuptimin e tradhtisë marksistë-leninistë, stalinistë, enveristë, spiunë të Serbisë, por çuditërisht s'i kishin quajtur asnjëherë titistë, sepse kur kishte ardhur puna të titizmi, ata, këtu e kishin vetë “mizën nën kapuç!”.

Propaganda e tillë natyrisht se i kishte revoltuar pa masë mijëra ish-të burgosur politikë bashkë me mijëra përkrahës të tyre gjithandej Kosovës dhe viseve të saj. Ata ishin çuditur me smirën, urrejtjen, shpifjen dhe intrigën që kategoria e tillë e shqiptarëve kishte qenë në gjendje të kundërshtonte tyre me vetëdije edhe përkundër gjithë atyre sakrificave që ata kishin bërë për Kosovën. Brenda rrethanave të tilla, ata, ishin ndier të akuzuar, të përndjekur dhe të dënuar dyfish: Edhe nga regjimi serb edhe nga kategoria e tillë e shqiptarëve - në emër të demokracisë!

Ndonëse pjesa dërrmuese e shqiptarëve nuk i kishte akceptuar etiketat e lartpërmendura ndaj ish-të burgosurve politikë dhe ndaj anëtarësisë së grupeve ilegale, megjithatë, kishte hequr dorë nga qëndresa e mëtëjshme aktive për Republikën e Kosovës. Ata e kishin bërë këtë, sepse partitë e posakrijuara politike i kishin bindur, se duke e përkrahur me fjalë demokracinë; duke e veshur deri edhe qëndresën e tyre aktive me ngjyrimë ideologjike për të figuruar si kundërkomunistë; duke krijuar sa më shumë parti të reja të emërtuara si “demokratike”, dhe duke e shprehur vullnetin e tyre plebishitar, Kosova do ta fitonte statusin e republikës pa pasur nevojë për qëndresë aktive dhe, aq më pak, për luftë të armatosur çlirimtare.

## **“Përveç zgjidhjes paqësore alternative tjetër s’ka!”**

Pas braktisjes së qëndresës aktive, skenën politike të Kosovës, duke filluar që nga viti 1991 e këtej, e kishin zënë zërat e mekur të krerëve të partive politike, petitionet e ndryshme dhe ndezjet e qirinjve, bashkë me mbledhjet e pafundme të degëve të partive politike gjithandej: Nëpër shtëpi private, restorante, kisha e xhamia, ndërkohë që ishin shënuar edhe ecejaket e para të liderëve të Kosovës në Evropë e Amerikë. Shqiptarët duke i parë format e tilla të mefshta të veprimeve të partive politike si alfa dhe omega e krejt asaj që ishte dashur të bëhej për t’u bërë Kosova Republikë, ata edhe sintagmën e klasës së re politike sipas të cilës “çështja e Kosovës do të zgjidhet vetëm me rrugë paqësore dhe alternative tjetër s’ka!”, tanimë e kishin kthyer në një thënie profetike, hiç më pak se të zbritur nga qielli!

Por, me thënien e tillë, ish-të burgosurit politikë, anëtarësia e organizatave ilegale dhe shumë veprimtarë të çështjes shqiptare s’ishin pajtuar plotësishtë. Derisa arritjen e të drejtave të shqiptarëve me “rrugë paqësore dhe me dialog demokratik”, ata e kishin marrë si diçka të dëshirueshme dhe të mirëfilltë për të gjithë, pjesën tjetër të asaj thënie “se alternative tjetër s’ka” e kishin perceptuar si një dogmë dhe utopi të llojit të vet.

Sipas Naserit, të thoje se me Serbinë duhet t’i zgjidhim problemet vetëm me dialog demokratik dhe alternative tjetër s’ka, kishte qenë njësoj sikur të thuhej se me Serbinë s’duam t’i zgjidhim problemet asnjëherë.

## **■ Shqiptarët ishin “ngrënë” nëpër gazeta e Serbia i kishte kryer punët e veta**

Ajo që u kishte sjellë demokracia shqiptarëve aty nga fundi i viteve të ‘80 dhe në fillim të viteve të ‘90 kishin qenë: Pluralizmi politik, me ç’rast atyre u ishte lejuar krijimi i partive politike jashtë Lidhjes Komuniste të Kosovës e të Jugosllavisë, kishte qenë liria e shprehjes dhe e mendimit, kryesisht midis vetë shqiptarëve, sepse në raport me Serbinë liria e tillë kishte mbetur mjaft e kufizuar, e ndaluar dhe sipas rastit edhe e dënueshme, si dhe kishin qenë rreth 26 gazeta e revista të ndryshme, botimi i të cilave, me ndonjë pengesë të vogël nga regjimi serb, ishte lejuar. Të gjitha dhuratat e tilla të demokracisë, sikur shqiptarët të mos i kishin keqkuptuar, keqinterpretuar dhe keqpërdorur, do të përfaqësonin arritje të reja, të cilat ata s’i kishin pasur më parë, derisa në pushtet kishte qenë, Lidhja Komuniste e Kosovës, përkatësisht e Jugosllavisë si parti e vetme.

Por, shqiptarët duke menduar se bota demokratike duhej të ishte doemos edhe kundërkomuniste, ata për t’ia mbushur mendjen Evropës dhe Amerikës

se kishin qenë kundërkomunistë të regjur dhe demokratë të flaktë, në radhë të parë e kishin keqpërdorur shprehjen e mendimit të lirë, duke iu sulur njëri-tjetrit nëpër gazeta me lloj-lloj akuzash e etiketash ideologjike, dhe për rrjedhojë edhe duke u armiqësuar e përçarë me midis tyre, në një kohë kur ata me shumë se kurrë kishin nevojë për unitet.

Por derisa shqiptarët ishin “ngrënë” nëpër gazeta duke e etiketuar njëri-tjetrin me akuza ideologjike, Serbia i kishte kryer punët e veta. Pas pezullimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, kishte vazhduar me largimin e mbi 90% të shqiptarëve nga vendet e punës dhe me mbylljen e institucioneve të saj kryesore.

## **Lufta për pushtet pa pasur shtet!**

Krerët e partive politike shqiptare të krijuara në fund të viteve të '80 dhe në fillim të viteve të '90, duke besuar se Kosova do të bëhej republikë nëpërmjet të dialogut demokratik dhe të trysnive që vendet e demokracive të mëdha botërore do të ushtronin ndaj Serbisë, kishin gjetur kohë komode për ta filluar luftën për marrjen e pushtetit pa e pasur ende shtetin. Për krerët e tillë të partive politike, sa i përket marrjes së pushtetit e vetmja opozitë kishte qenë anëtarësia e organizatave ilegale dhe mijëra ish-të burgosur politikë, të cilët për vite të të tëra ishin përpjekur që nëpërmjet të qëndresës aktive ta bënin Kosovën republikë, dhe që për arritjen e qëllimit të tillë s'e kishin përjashtuar as luftën e armatosur. Me fjalë të tjera këta krerë të partive politike kishin harruar se për ta marr pushtetin në Kosovë e kishin opozitë Serbinë.

Frika se shtresa e ish-të burgosurve politikë dhe e anëtarësisë së organizatave ilegale do të mund ta merrte pushtetin në Kosovë, kishte bërë që shumica e krerëve të partive politike të atyre kohëve, ta luftonin politikisht pikërisht këtë shtresë. Për t'ia mohuar, zhvlerësuar dhe për t'ia thyer kësaj shtrese bagazhin e saj kombëtar të krijuar për shumë vite me shumë vuajtje e rreziqe, pinjollët e krerëve të partive politike i ishin sulur asaj me lloj-lloj etiketash në radhë të parë ideologjike.

## **Në njërën anë “enveristët” e në anën tjetër “titistët”**

Lufta për pushtet pa pasur shtet e partive politike të posakrijuara, që në fillim i kishte përçarë e ndarë shqiptarët në “enveristë” dhe “titistë”.

Kështu, në njërën anë kishin qenë pinjollët e klasës së re politike të Kosovës, të cilët pishtarët e pranverës së madhe të vitit 1981 dhe mijëra ish-të burgosur politikë, i kishin etiketuar nëpër gazeta si të “kuq”, si “komunistë”, “enveristë”, dhe së fundi edhe si spiunë ideologjikë të Serbisë e të Rusisë, kurse, në anën tjetër, kishte qenë anëtarësia e organizatave ilegale, pishtarët e pranverës së madhe të vitit 1981 dhe mijëra ish-të burgosurit politikë, të cilët partitë politike

shqiptare të porsakrijua i kishin konsideruar si “pjellë” e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, kurse krerët e tyre si “komunistë” të tipit “titistë” dhe një pjesë të tyre edhe si “spiunë të Serbisë”. Përfundimisht, në sajë të etiketimeve të tilla reciproke të dy palët kishin “dëshmuar” për njëra-tjetrën se kishin qenë komunistë “titistë” ose “enveristë”, dhe të dy palët kishin “dëshmuar” për njëra-tjetrën se kishin qenë spiunë të Serbisë, ndërkohë që asnjëra palë s’kishte marrë përgjegjësi për fjalën e shkruar, sepse pushteti s’kishte qenë në duart e tyre, por kishte qenë në duart e Serbisë.

Në të vërtetë ish-të burgosurit politikë dhe anëtarësia e grupeve ilegale, luftën e tillë me etiketa ideologjike, jo vetëm që nuk e kishin filluar të parët, por ata edhe gjatë gjithë viteve të ‘80, kur kishte pasur Shqipëri socialiste me udhëheqje komuniste, e cila i kishte përkrahur, nuk kishin demonstruar me parulla e kërkesa komuniste, por me parulla e kërkesa kombëtare, siç ka qenë vetë kërkesa Kosova Republikë. Por tani që socializmi dhe komunizmi kishin dështuar gjithandej, dhe kur më ishte pritur që Kosovën ta ndihmonin vendet e demokracive perëndimore, atyre as që u kishte shkuar ndërmend që simpatitë e vendeve të tilla ndaj Kosovës t’i rrënonin duke bërë kërkesa ideologjike ose duke e quajtur veten komunistë.

Kështu, pinjollët e pseudo-demokracisë nuk e kishin patur asnjë arsye të shëndoshë që t’ia fillonin të parët etiketimin e ish-të burgosurve politikë dhe të anëtarësisë së grupeve ilegale me etiketa ideologjike komuniste. Përkundrazi, ata kishin pasur arsye të shëndosha që kategorinë e ish-të burgosurve politikë ta përgëzonin për qëndrimin e tyre të mençur politik të mosekspozimit të ideve komuniste e majtiste, si gjatë viteve të ‘80, ashtu edhe në fillim dhe në vazhdim të viteve të ‘90. Por pinjollët e demokracisë së rrejshme kështu do të vepronin sikur ata të ishin konstruktivë, kombbashkues e kombpajtues. Por duke mos qenë të tillë, për ta lufta me etiketa ideologjike kishte qenë një shans i mirë për t’i përçarë shqiptarët.

### **Shqiptarët brenda “luftës së ftoftë!”**

Për Naserin dhe shumëkënd “lufta” e cila ishte zhvilluar me etiketa ideologjike, në fillim të viteve të ‘90 dhe për fat të keq edhe gjatë viteve në vazhdim deri te Lufta Çlirimtare të Kosovës, kishte marrë përmasa të një “luftime të ftoftë!” midis shqiptarëve, e cila kishte qenë sa e dëmshme, aq edhe e pakuptimtë.

Kështu, shqiptarët në vend që mos të “silleshin kah gropa e ujkut”, duke u marrë me komunizmin të cilin s’e kishte dashur bota, ata kishin hedhur mbi shpatullat e tyre të brishta aq shumë “dhe ideologjik”, sa që Evropa dhe Amerika, sikur të kishin punuar me mendësitë e tyre, ishte dashur që shqiptarët

t'i përpinin nga faqja e dheut, për ta çrrënjësuar kësisoj njëherë e mirë “strofkën” e komunizmit nga kjo botë!

Aq e ulët, primitive, fëmijërore, mesquine dhe përçarëse kishte qenë lufta e tillë me etiketa ideologjike në mesin e shqiptarëve, saqë Naseri dhe shumëkush tjetër e kishin ndier vetën më keq se kur kishin qenë burgjeve. Frika në mos një ditë “lufta e tillë e ftoftë” midis shqiptarëve e provokuar nga pinjollët e pseudo-demokracisë do të kthehej në “luftë të nxehtë!”, me ç'rast shqiptarët do t'i jepnin vetes fund, kishte bërë që Naseri të ishte ndier më i torturuar se dikur në burgun e Ohrit.

### **Ishin kapur pas komunizmit si “qorri pas pleshtit!”**

Duke i analizuar akuzat e tilla destruktive të shqiptarëve me njëri-tjetrin nëpër gazeta, Naseri, shpesh kishte pyetur veten: Pse ishin kapur shqiptarët pas komunizmit si “qorri pas pleshtit!”. Po çka ka lidhje nëse ish-të burgosurit politikë dhe anëtarësia e shumë grupeve ilegale kanë pasur ose jo bindje të caktuara politike, kur ata kanë bërë aq shumë për Kosovën, duke e sakrifikuar edhe veten e tyre. Po s'ka aspak rëndësi nëse macja është e zezë apo e kuqe, por me rëndësi është nëse ajo gjuan apo nuk gjuan minj, i kishte thënë ai vetes me mllef e trishtim.

Po ç'kanë shqiptarët që hedhin aq shumë dhe ideologjik, mbi shpatullat e tyre duke u marrë më komunizmin! Po sa rëndësi ka për Amerikën dhe Evropën komunizmi ose kundërkomunizmi i një populli të vogël siç janë shqiptarët, kur komunizmi tanimë ka dështuar në Rusi dhe në gjitha vendet e Evropës Lindore. Vërtet, a kaq shumë kanë lojtur mendsh shqiptarët sa të mendojnë se janë kërthiza e botës! Dhe se fundi ai e kishte pyetur veten, a dinë këta kalemxhinjtë tanë se në fund të fundit edhe Evropa dhe Amerika s'e kanë të anatemuar as socializmin e as komunizmin, se në këto vende ka edhe parti socialiste, të cilat herë pas here në koalicion me parti të tjera janë në pushtet, dhe se në këto vende ka edhe parti komuniste legale!

### **Krejt ndryshe e kishte kuptuar demokracinë**

Naseri dhe shumë shokë e miq të tij e kishin kuptuar krejt ndryshe demokracinë! Ata demokracinë e kishin kuptuar duke filluar që nga vetë domethënia e fjalës “demokrates” e cila do të thoshte “sundim i popullit”, që në rastin konkret të Kosovës do të thoshte që populli shumicë shqiptarë ta sundonte, udhëhiqte dhe ta drejtonte veten në tokën e tij të Kosovës dhe në viset tjera shqiptare në Jugosllavi. Por, për ta sunduar e drejtuar veten shqiptarët ishte dashur fillimisht t'i çlironin trojet e tyre nga sundimtarët, nga regjimet serbo-maqedono-

malazeze me të gjitha mjetet, duke filluar që nga dialogu demokratik e duke vazhduar te qëndresa aktive paqësore, dhe së fundi duke mos e përjashtuar edhe luftën e armatosur, dhe jo të thuhej apriori se “çështja e Kosovës do të zgjidhej vetëm me rrugë paqësore dhe alternativë tjetër s'ka!”, siç ishte shprehur klasa e re politike e Kosovës.

Më tej, Naseri e kishte kuptuar demokracinë edhe si mundësi e bartjes së dijeve, teknologjive dhe përvojave të vendeve demokratike të zhvilluara në Kosovë, në Shqipëri e gjithandej hapësirës etnike shqiptare në Ballkan, në mënyrë që shqiptarët ta kapërcenin sa më shpejt vakumin historik në zhvillimin e tyre, dhe jo të polemizonin ditë e natë së kush kishte qenë më pak apo më shumë komunist, se kush ishte bërë tani më pak apo më shumë demokrat etj. Mbi të gjitha Naseri e kishte kuptuar demokracinë si qasje konstruktive ndaj secilit fenomen, duke e synuar vazhdimisht gjetjen e marrëveshjes nëpërmjet kompromisit për gjithçka. Por shqiptarët, pikërisht duke polemizuar me njëri-tjetrin i kishin vënë kazmën marrëveshjeve dhe kompromiseve të mundshme. Duke i besuar marrëveshjeve dhe kompromiseve demokratike, ai i ishte gëzuar krijimit të partive politike të shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore. Por kishin qenë thashethemnajat, urrejtjet, xhelozitë, bërrylat, egoizmat, karrierizmit, polemikat e trishta dhe kakofonia boshe brenda dhe midis partive, ato të cilat e kishin dëshpëruar atë shumë.

Duke i besuar demokracisë së mirëfilltë, ai kishte besuar se demokracitë e mëdha do ta ndihmonin çlirimin e Kosovës, por s'kishte besuar asnjëherë se kjo do të ndodhte pa iu përvesh çlirimit të Kosovës vetë shqiptarët.

### **Askënd se kishte sharë dhe ofenduar**

Naser Hani, duke i analizuar situatat e tilla, ndonëse asokohe ishte mllëfosur me shumëkënd, megjithatë, ai, për të mos iu fryrë përçarjeve midis shqiptarëve, dhe për të mos u bërë “mish” për gazeta, asnjëherë me askënd s'kishte polemizuar, asnjëherë s'ishte dëgjuar prej tij qoftë edhe një sharje banale në adresë të kujtdoqoftë, dhe as njëherë s'e kishte quajtur ndokënd tradhtar, ndonëse e kishte ditur mirë se kush çka ishte e çka kishte qenë.

Edukata e tij familjare me kalimin e viteve i ishte kthyer në kulturë politike në raport me kundërshtarët e shumtë me të cilët e kishte ndeshur koha. Kështu, ai më parë e kishte preferuar një veprim konkret e të vogël në të mirë të çështjes së Kosovës, sesa një polemikë, një sharje apo një ofendim.

## ■ Kishte vendosur të kthehej në Maqedoni

### Po ikte nga Kosova, po ku po shkonte...!

Në gushtin e vitit 1990 Serbia ia kishte mbyllur Kosovës institucionet kryesore, siç kishte qenë Kuvendi i Kosovës, Kryesia e Kosovës dhe Këshilli Ekzekutiv i Kosovës, me ç'rast ishin përjashtuar nga puna të gjithë shqiptarët, të cilët kishin punuar më parë në këto institucione. Kështu, që nga gushti i atij viti edhe Naseri kishte qenë i përjashtuar nga puna. Por, mbetja pa punë kishte qenë e keqja më e vogël kundruall të keqes së madhe, të mbylljes në mënyrë arbitrare të institucioneve kryesore të Kosovës, gjë që fliste qartë se Serbia tani kishte dashur që Kosovën ta shuante plotësisht edhe si nocion gjeografik, historik dhe politik.

Brenda rrethanave të tilla Naseri kishte vendosur që të kthehej në Maqedoni, në fshatin e tij të lindjes, në Veleshtë afër Strugës.

Kthimi në Maqedoni ia kishte kujtuar atij ardhjen në Prishtinë para shumë vitesh për të studiuar. Ai asokohe kishte ardhur në Prishtinë plot gëzim, kurse tani do të ikte nga Prishtina plot hidhërim. Ai dikur kishte ikur nga Maqedonia me shtypje ekstreme të shqiptarëve, në mjedisin e Kosovës, ku të drejtat e shqiptarëve, ndonëse s'kishin qenë të plota, megjithatë kishin qenë më të avancuara se kudo tjetër në Jugosllavi. Kësaj radhe, ai pas pezullimit të autonomisë së Kosovës, po ikte nga një mjedis me shtypje etnike ekstreme të shqiptarëve, siç ishte bërë Kosova, në një mjedis po ashtu me shtypje etnike ekstreme të shqiptarëve, siç kishte qenë e kishte mbetur Maqedonia.

Ndonëse e kishte ditur se ai do të lëvizte sërish në relacionin Strugë - Prishtinë dhe anasjelltas, megjithatë, kësaj radhe i ishte dukur sikur nga Kosova dhe Prishtina po shkulej përgjithmonë. Në Kosovë i kishte lënë rreth pesëmbëdhjetë vjet, sa të bukura aq edhe krenare të jetës së tij. Kosova e kishte burrëruar, e kishte ngritur, e kishte bërë ekonomist, e kishte punësuar, e kishte përleshur, e kishte burgosur, e kishte sprovuar, e kishte nxjerrë fitimtar, si dhe e kishte gëzuar dhe dëshpëruar një mijë herë. Prishtina ia kishte dhënë gëzimin rinor, sheshi qendror i saj e kishte kënaqur sa herë që kishte shëtitur me shokë, pastaj ai shesh e kishte vënë në sprovë, duke demonstruar dhe duke u përleshur shumë herë me forcat policore serbe e jugosllave. Prishtina ia kishte dhënë atij edhe shoqen e jetës dhe gëzimin e parë, vajzën Lynkestën, zërin, të qeshurat dhe fjalët e para të saj.

Kur kishte ikur nga Struga për të studiuar në Prishtinë e kishte mbërthyer pikëllimi i ndarjes nga Struga, nga puhizat e liqenit aty pranë, nga shokët dhe shoqet e gjimnazit dhe, para se gjithash, nga familjarët e tij. Tani që po ikte nga Prishtina për t'u vendosur në fshatin e tij pranë Strugës e kishte mbërthyer

pikëllimi për Prishtinën, për shokët dhe shoqet idealit çlirimtar, dhe sidomos për ata që s'ishin më ndër të gjallët! Deri kur kështu, ngjitje-këputje, këputje-ngjitje e askund vend mos me zënë! Deri kur do të jetë kështu për ne shqiptarët, e kishte pyetur vetën Naseri me pikëllim!

Po ikte nga Kosova, po ku po shkonte! Atje ku po shkonte po e priste sërish përballja! Atje ku po shkonte i thonin Maqedoni, që edhe po ta quaje “Ferri i Dantës”, do të ishte pak. Në atë ferr ishte një pjesë e popullit të tij. Nga ferri në ferr!, i kishte thënë vetes me dëshpërim! Atje ku po kthehej edhe Shkupit ishte dashur t'i thuhej në gjuhën maqedone “Skopje!”. Atje shqiptari shtypej më keq se emigranti! Atje kishte qenë i burgosur në burgun e Ohrit, ishte hetuar dhe ishte torturuar, sepse kishte marrë pjesë në demonstratat e pranverës së vitit 1981 në Prishtinë. Atje akuzoheshin shqiptarët për nacionalistë edhe nëse nëse nëse festat e tyre familjare nuk këndonin maqedonisht, por këndonin shqip!

## **E kishte humbur edhe Shqipërinë**

Dikur në Kosovë e kishte gjetur edhe Shqipërinë! Tani që po ikte nga Kosova e kishte humbur edhe Shqipërinë! Ndryshimet demokratike në Shqipëri kishin filluar me djegie, shkatërrime dhe grabitje. Ishin shkatërruar shumë shkolla, institucione, fabrika, kooperativa dhe ishin hedhur në ajër deri edhe ura. Opozita demokratike kishte deklaruar se komunizmit do t'ia bënte varrin sa Shqipëria! Nëse e tërë Shqipëria do të kthehej në varr, kujt do t'i shërbente demokracia! A ndërtohet demokracia mbi një varrezë masive sa Shqipëria, e kishte pyetur veten ai. Shqipëria mund të bëhet nesër edhe më mirë seç ka qenë, por tani që ajo më shumë se kurrë i ishte dashur Kosovës, po digjej e fundosej. Urrejtje, mllëfe, kërcënime, shpifje e denigrime midis shqiptarëve gjithandej Shqipërisë. Turbullira, demonstrata, rrëzime, thirrje kundër gjithçkaje që ishte arritur. Të gjithë kundër të gjithëve! Sa keq! Sa keq! Tmerr!...

Para se gjithash, ai s'kishte mundur ta kuptonte se si në të njëjtën ditë të 2 korrikut të vitit 1990, kur në Kosovë ishte shpallur deklarata kushtetuese, në Shqipëri mijëra të rinj shqiptarë u ishin vërsulur ambasadave huaja për të ikur jashtë vendit, duke i dhënë Shqipërisë një goditje të rëndë si shtet e si vend, pikërisht kur ajo i duhej më shumë se kurrë Kosovës. Naseri e kishte pyetur veten shpesh nëse ndodhja e këtyre dy ngjarjeve në ditën e njëjtë kishte qenë rastësi, apo dikush kishte punuar paraprakisht që duke u shënuar një fitore në Kosovë, të shënohej një humbje në Shqipëri! Më tej ai e kishte pyetur veten se cila Shqipëri tani do ta mbronte Kosovën, kur ata që kishin qenë ose do të ishin ushtarë të saj, tani po përgjakeshin duke u ngjitur nëpër kangjelet e hekurta të ambasadave të huaja, sepse s'po e donin Shqipërinë e lënë më Kosovën.



Duke u marrë me “rastësinë” e ndodhjes së dy ngjarjeve kontradiktore më 2 korrik të vitit 1990, Naserit mendja i kishte shkuar te gazeta sllovene “Mlladina”, në të cilën aty kah fundi i vitit 1989 ishte botuar një dokument sekret i shërbimeve sekrete ushtarake serbo-jugosllave, sipas të cilit këto shërbime e kishin përgatitur planin për destabilizimin e brendshëm të Shqipërisë, pikërisht ashtu siç po destabilizohej Shqipëria, me demonstrata, me rrëmuja, me djegie dhe tek-tuk edhe me vrasje e krime.

### **Mirupafshim në Kosovën e lirë...!**

Pezullimi i autonomisë së Kosovës në marsin e vitit 1989 i kishte hapur rrugë Serbisë për të kositur gjithçka që deri atëherë ishte arritur në Kosovë. Brenda rrethanave kur më të rinjtë shqiptarë s'kishin as shkollë, as punë e as luftë për liri, kishte filluar edhe ikja e tyre masive për në vendet e Evropës Perëndimore. Por, jo vetëm të rinjtë, por edhe familje të tëra shqiptare, duke mbetur pa punë dhe ekzistencë minimale, u kishin hipur autobusëve në drejtim të vendeve të ndryshme për të kërkuar azil.

Kështu, kishte filluar spastrimi etnik i shqiptarëve heshturazi e spontanisht, tamam ashtu siç kishte dashur Serbia.

Karakteristike kishte qenë se ata që po iknin nga Kosova në drejtim të vendeve të panjohura, atyre që mbeteshin në Kosovë dhe që kishin dalë t'i përcillnin te stacionet e autobusëve u kishin thënë: “Mirupafshim në Kosovën e lirë!”. Duke e dëgjuar lamtumirën e tillë Naseri e kishte pyetur veten domosdoshmërisht: Po kush do t'ua çlironte shqiptarëve vendin e tyre, që ata pas disa vitesh të shiheshin në Kosovën e lirë! O tempora, o mores!

### **Cilën “lamtumirë” do t'ia linte Kosovës!**

Ishte një ditë e bukur shtatori e vitit 1990 kur Naseri kishte dalë te parku i Gërmisë në periferi të Prishtinës. Sa pak e kishte vizituar ai atë park për pesëmbëdhjetë vjet sa kishte qëndruar në Prishtinë. Po kujt i kishte rënë ndërmend të dalë te parku i Gërmisë! Aq shumë demonstrata, përpjekje e tronditje kishte pasur për gjithë ato vite në Prishtinë.

Edhe atë ditë mërzia dhe pikëllimi e kishin nxjerrë atë te parku i Gërmisë. Kishte dashur të ishte vetëm, të mendonte e ta pyeste veten: Ku ishte dje, ku je sot e ku do të jesh nesër? Kishte dashur ta pyeste veten cilën lamtumirë do t'ia linte ai Kosovës! Mos edhe ai do t'i thoshte asaj “mirupafshim në liri...!”. Të nesërmen Naseri s'do të ishte më në Kosovë. Do të shkonte në Veleshtë...Me vete do ta merrte edhe brengën e Kosovës bashkë me borxhin e madh ndaj saj!

## **XI. Kthimi nga Kosova në Maqedoni dhe egzili në Austri**

### **■ Në vitet e para të pavarësimit të Maqedonisë**

Fundi i viti 1990 Naserin e kishte gjetur të kthyer në Veleshtën e tij pranë Strugës piktoreske. Ky kthim, ndonëse i pritshëm, megjithatë, kishte qenë provokues për të! Në njëërën anë, ai ishte ndeshur me kujtimet e bukura të fëmijërisë dhe djalërisë, kurse, në anën tjetër, kishte rreth pesëmbëdhjetë vjet që kishte jetuar në Kosovë, ku ishte bërë “kosovar!”.

Kështu, ai shumë shpejt e kishte kuptuar se shpirti i tij kishte mbetur si i varur diku midis Prishtinës dhe Strugës. Prandaj, kishte filluar sërish si në kohën e studimeve me ecejaket e tij Strugë-Prishtinë dhe anasjelltas. Në Prishtinë e kishte vizituar motrën Lunikën dhe dhëndrin Agniun, pastaj ishte takuar me shokë, të cilët tanimë i kishin kryer vitet e burgjeve, kishte biseduar me ta dhe ishte kthyer në Strugë.

Por, Struga s'ia ofronte më ato që ia kishte ofruar dikur. Jo, Struga s'kishte ndryshuar gjë. Ajo kishte mbetur ashtu siç kishte qenë. Edhe rruga qendrore e shtruar me pllaka guri aty kishte qenë. Edhe dyqanet në të dy anët e trotuareve s'kishin lëvizur vendit. Edhe liqeni kishte qenë aty të këmbët e Strugës si dikur, por valëvitjet e qeta dhe puhizat e tij të lehta s'i bënin më përshtypje si dikur. Rrënimin e autonomisë së Kosovës dhe mbylljen e universitetit në gjuhën shqipe në Prishtinë, Naseri i kishte përjetuar si dy humbje të mëdha, të cilat nuk mund të kompensoheshin me asgjë, as me bukuritë e Strugës e me asçka tjetër.

### **Midis brengash të shumta**

Brenga më e madhe e Naser Hanit në fillim të viteve të '90 kishte qenë Kosova. Regjimi serb Kosovën e kishte vënë nën masa të dhunshme. Ishte mbyllur Universiteti në gjuhën shqipe, ishin larguar nga vendet e punës pothuajse të gjithë shqiptarët, përfshirë këtu edhe kuadrot e larta të institucioneve të dorës së parë, ishte mbyllur televizioni i Prishtinës në gjuhën shqipe, dhe nuk botohej

më as gazeta e përditshme “Rilindja” etj.

Nga ana tjetër, derisa shqiptarët ishin shpërngulur me të madhe, duke u vendosur si azilkërkues në vende të ndryshme të Evropës perëndimore, Serbia kishte sjellë në Kosovë shumë kuadro serbe të të gjitha fushave për të udhëhequr me gjithçka. Me fjalë të tjera, Serbia kishte dashur që ta kolonizonte Kosovën fillimisht me kuadro serbe e pastaj edhe me popullatë. Kjo kishte bërë që Naser Hani dhe shumë të tjerë si ai të ishin brengosur pa masë, sepse po të spastrohej Kosova në masë të madhe nga shqiptarët dhe po kolonizohej nga serbët, bashkë me Kosovën do ta pësonin të gjithë shqiptarët të mbetur në ish-Jugosllavi.

Brenga tjetër e madhe e Naserit kishte të bënte me Shqipërinë. Gjatë viteve 1991/1992 kur Shqipëria i kishte hapur kufijtë, shërbimet sekrete serbe dhe maqedone kishin futur në Shqipëri një numër shqiptarësh, të cilët kishin për mision “demokratizimin”, në të vërtetë “flakërimin” e Shqipërisë. Të tillët duke e sharë Partinë e Punës dhe Enver Hoxhën, i kishin nxitur demokratët kundër ish-komunistëve dhe kundër gjithçkaje që ishte arritur në Shqipëri. Të njëjtit, duke u thënë ish-komunistëve se demokratët po e digjin Shqipërinë para syve të tyre, i kishin nxitur ata kundër demokratëve. Disa prej shqiptarëve të tillë, oficerët e shërbimit sekret të ushtrisë serbe, për t’i marrë në konsideratë i kishin përcjellë deri buzë kufirit me Shqipërinë. Misioni i kësaj kategorie shqiptarësh kishte qenë përçarja e shqiptarëve drejt luftës qytetare dhe zbulimi i sekreteve të fundit ushtarake që kishte pasur Shqipëria. Duke pasur parasysh se duke e pësuar Shqipëria e pësonte edhe më keq Kosova, dhe bashkë këto të dyja do ta pësonin edhe shqiptarët në Maqedoni e gjithandej, Naser Hani dhe shumë të tjerë si ai ishin bërë të luanin menç!

Brenga tjetër po ashtu e madhe e Naserit kishte të bënte me rrethanat brenda të cilave ishin gjendur shqiptarët në Maqedoni. Vetë zgjedhjet e para të lira, që ishin mbajtur në dhjetorin e vitit 1990, tregonin qartë se shqiptarët edhe në Maqedoninë, e cila ishte pritur të pavarësohej, do të trajtoheshin si pakicë kombëtare dhe si qytetarë të dorës së dytë. Vetë motoja “Maqedonia e maqedonëve”, të cilën e kishte përdorur blloku i partive politike maqedone gjatë fushatës zgjedhore të vitit 1990, tregonte se partitë maqedone dhe udhëheqësit e tyre, Maqedoninë nuk e shihnin edhe si atdhe të shqiptarëve, por vetëm si atdhe të maqedonëve. Qasja e tillë e bllokut politik maqedonë i kishte përjashtuar shqiptarët nga e drejta e shtetformimit dhe e posedimit të Maqedonisë. Krejt kjo kishte ndodhur në një kohë kur shqiptarët në Maqedoni, me një Shqipëri tani më të bërë “lesh e li” dhe me një Kosovë nën Serbi, vështirë se do t’ia dilnin që në Maqedoninë, e cila së shpejti do të ishte e pavarur, t’i siguronin të drejtat e tyre legjitime të shumicës etnike.

Dhe brenga tjetër po ashtu e madhe, e Naserit gjatë vitit 1991, kishte të bënte me mundësinë që Serbia e Millosheviqit ta sulmonte ushtarakisht Maqedoninë me rastin e shpalljes së pavarësisë së saj, me ç'rast shqiptarët do ta pësonin keq, sepse maqedonët do t'i ripërtërinin miqësitë e vjetra me Serbinë, dhe së bashku me serbët do mund t'u suleshin shqiptarëve, ashtu siç u ishin sulur atyre bashkarisht që nga Kongresi i Berlinit e deri në prag të LDB-së.

### **Pavarësimi i “papritur” i Maqedonisë**

Shtatori i vitit 1991 e kishte gjetur Maqedoninë me pavarësi të shpallur, e cila ishte dukur sikur kishte ndodhur papritmas, por që s'kishte qenë ashtu, sepse presidenti Kiro Gligorov kishte punuar për pavarësimin e vendit që nga vitet 1989-1990.

Derisa shpallja e pavarësisë së Sllovenisë dhe e Kroacisë në qershor të vitit 1991, ishte shoqëruar me sulme të ushtrisë serbo-jugosllave kundër Sllovenisë dhe Kroacisë, edhe pavarësimi i Maqedonisë ishte pritur të shoqërohej me sulme të ushtrisë serbe ndaj Maqedonisë. Por, Serbia me rastin e shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë kishte bërë një përjashtim. Ajo disa muaj para se Maqedonia ta shpallte pavarësinë i kishte lëshuar kazermat ushtarake në Maqedoni, duke hequr kësioj dorë “vullnetarisht” nga Maqedonia, përkatësisht nga “Serbia Jugore” (serbisht “**Juzhna Serbia**”) e dikurshme.

Naseri mendonte se Serbia s'e kishte sulmuar Maqedoninë, sepse po ta bënte këtë, ajo e kishte ditur se do të konfrontohej me nëntë milionë bullgarë dhe një milion maqedonë, me ç'rast do ta humbte shansin që kufijtë e “Serbisë së Madhe” t'i zgjeronte drejt Bosnjës e Kroacisë, ku kishte regjione të banuara me serbë.

### **U kishin dështuar te dy “nënat”...!**

Sipas Naserit kishin qenë të vetmit shqiptarët në trojet e tyre në Maqedoni, ata të cilët ishte dashur dhe kishin pasur të drejtë që ta kontestonin pavarësimin e Maqedonisë. Maqedonia e pavarur shqiptarët i konsideronte pakicë (maqedonisht “**malcinstvo**”), i kishte lënë ata jashtë shtetformësisë së Maqedonisë, gjuha shqipe s'ishte sërish gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedone, shqiptarët kishin mbetur jashtë institucioneve, dhe para së gjithash, shqiptarëve s'u lejohej arsimimi i lartë në gjuhën e tyre.

Por, për ta kontestuar shqiptarët pavarësimin e një Maqedonie të tillë, ata ishte dashur që ta kishin mbështetjen e vendit amë, Shqipërisë, dhe pse jo edhe mbështetjen e Kosovës. Por, për fat të keq të shqiptarëve në Maqedoni, pikërisht kur ata ishte dashur ta kontestonin pavarësimin Maqedonisë, atyre u

kishin dështuar te dy “nënat!”. Si “nëna Shqipëri” e cila për shkak të problemeve të brendshme e kishte njohur Maqedoninë pa e kushtëzuar atë me njohjen e të drejtave të shqiptarëve, ashtu edhe “nëna Kosovë” e cila, ndonëse vetë kishte gjëmuar nën Serbi, nëpërmjet të një deklarate të Ibrahim Rugovës e kishte njohur pavarësinë e Maqedonisë.

### **Për t'i dalë vetes zot...**

Të dëshpëruar nga te dy “nënat” dhe të injoruar nga bota, shqiptarët në Maqedoni kishin menduar t'i dëlnin zot vetvetes me mundësitë e veta.

Kështu, edhe ata gjatë viteve 1990/1991 i kishin krijuar partitë e tyre politike, në mesin e të cilave më e madhja kishte qenë Partia për Prosperitet Demokratik (PPD-ja), degën e të cilës për Strugën e kishte themeluar Naser Hani bashkë me shokët e tij si Tahir Hani, Shpend Vinca, Qashif Hani, Ibni Kica, Dashmir Kaba, Gëzim Kaleci, Baki Kaba, Xheladin Kica, Garip Kaba, Avni Kica, Ibrahim Bekteshi, Mendih Qyra, Aziz Pollozhani e të tjerë, duke mos marrë ai vetë ndonjë post udhëheqës.

Më tej, shqiptarët në Maqedoni për t'i dalë vetes zot kishin menduar, që në Maqedoninë perëndimore, të banuar dendur me shqiptarë, ta shpallnin një lloj autonomie politiko-territoriale të Iliridës, për realizimin e së cilës ishin angazhuar midis viteve 1991-1993. Dhe për t'i dalë vetes zot ata kishin menduar edhe për luftën e armatosur, të cilën s'do ta dëshironin, por që do të mund t'u imponohej.

Lidhur me faktorizimin e shqiptarëve në Maqedonin e pavarur, e cila në raport me shqiptarët s'kishte ndryshuar aspak, Naseri kishte bashkëpunuar edhe me Halit Naxhakun, Xhevat Ademin, Fadil Bajramin e të tjerë. Për këtë qëllim ai asokohe ishte konsultuar edhe me ish-të burgosurit politikë të Strugës me rrethinë, si me Kadri Labunishtën, Kadri Pollozhinin e Shefit Iljazin, ndaj të cilëve kishte pasur respekt të veçantë.

### **■ Në krye të Maqedonisë “mashtuesi plak!”**

Në fillim të viteve të '90 dhe për vite me radhë në krye të Maqedonisë kishte qenë “mashtuesi plak e dinak”, siç e quante Naseri presidentin maqedon, Kiro Gligorov.

Në dy-tri vjetët e para pas pavarësimit të Maqedonisë, presidenti Kiro Gligorov, një ish-nxënës dhe ish-mik i ngushtë i Titos, për shkaqe politiko-taktike e për të fituar kohë ua kishte bërë shqiptarëve rrafsh! Kështu, çfarëdo kërkesash që kërret e partive politike shqiptare kishin shtruar para tij, ai duke u shtirë si babaxhan të gjitha kërkesat ua kishte miratuar atyre duke iu

thënë: **“Ako bre sinko ako, sve ke bidne koga ke bide vreme...!”**, që do të thoshte: “Po, bre djalo, po, të gjitha do të bëhen kur të vijë koha...!”, që interpretuar objektivisht do të thoshte “prit gomar se po del bar!”. Me të tilla premtime mashtruese Gligorovi i kishte mbajtur shqiptarët midis viteve 1990-1993 të qetë e të urtë, derisa Maqedonia e kishte aprovuar kushtetutën monoetnike maqedone, dhe i kishte konsoliduar mekanizmat monoetnikë maqedonë të dhunës shtetërore. Por, se çfarë kushtetute dhe institucione kishte krijuar ai, tanimë në vitin 1993 ishte bërë vonë për ta pyetur atë shqiptarët.

Naseri mendonte se shqiptarët ishte dashur që të reagonin optimalisht për të drejtat e tyre gjatë viteve 1990/1991, kur Maqedonia kishte qenë ende një vend „popullor“ i dy shumicave kombëtare, shqiptare dhe maqedone, dhe kur asnjëra prej tyre s'kishte pasur ndonjë forcë serioze ushtarako-policore për ta mposhtur tjetrën, duke e futur kësioj Maqedoninë që asokohe brenda agjendave të korrekturave ndërkombëtare.

### **“Kokat e çelikta...!”**

Ata që në vitet e para pas pavarësimit të Maqedonisë i kishin prishur punë Gligorovit kishin qenë VMRO-*istët* brenda të djathtës maqedone, të cilët duke u shprehur egërsisht e pa asnjë takt kundër shqiptarëve, ua kishin treguar atyre që në fillim të viteve të '90 të gjitha padrejtësitë që po u bëheshin e do t'u bëheshin edhe në Maqedoninë e pavarur. Me qasjet e tilla të VMRO-*istëve* ndaj shqiptarëve s'ishte pajtuar Gligorovi, i cili e përfaqësonte të majtën maqedone, dhe që nuk dëshironte që së paku për ndonjë vit, derisa ai t'i konsolidonte institucionet monoetnike maqedone, shqiptarëve t'ua tregonte “dhëmbët!”.

Kishte qenë moskuptimi i tillë ai që kishte bërë që midis VMRO-*istëve* dhe Gligorovit të kishin ndodhur zënka edhe para krerëve të partive politike shqiptare. Kishin qenë zënkat e tilla ato të cilat kishin bërë që Gligorovi VMRO-*istët* probullgarë t'i quante herë pas here “koka të çelikta!”, për të mos i quajtur “koka të trasha!”, siç i ka konsideruar ai ata realisht. Në të vërtetë VMRO-*istët* e kishin urryer shumë presidentin Gligorov, sepse duke qenë ai përfaqësues i të majtës maqedone nuk kishte qenë probullgarë. Kështu, Naseri mendonte dhe besonte se kishin qenë pikërisht VMRO-*istët*, ata të cilët në vitin 1994 e kishin bërë atentatin e pasuksesshëm kundër Gligorovit, duke i vënë atij eksploziv nën makinë.

### **■ Midis veprimtarish të shumëfishta**

Midis viteve 1990-1993 Naseri ishte marrë me veprimtari të shumëfishta. Ai me shokët e tij nga Veleshta dhe fshatrat përreth kishte vazhduar të

mbilidhte ndihma financiare për familjet e të burgosurve politikë nga Kosova, në grumbullimin dhe shpërndarjen e të cilave ishin angazhuar asokohe me të madhe edhe motra e Naserit, Lunikja dhe dhëndri Agni Dika në Prishtinë. Gjatë atyre viteve ai kishte vazhduar me rolin e tij prej “katalizatori”, duke u munduar t’i përmirësonte marrëdhëniet, si midis degëve të partive shqiptare të porsakrijuara në Maqedoni, ashtu edhe midis shokësh të ilegales. Më tej, gjatë atyre viteve Naseri ishte bërë edhe pjesë e një organizimi politiko-territorial të shqiptarëve në Maqedoni, veprimtari kjo e cila duke pasur edhe karakter mbrojtës dhe ushtarak, ai ishte përpjekur ta bënte duke e “mbuluar” atë me veprimtaritë të tjera më pak të rrezikshme të përmendura më lartë.

Kishin qenë angazhimet e tilla ato që e kishin kthyer sërish Naserin në një “merimangë” si dikur gjatë viteve të studimeve në Prishtinë. Kësisoji, ai, herë ishte parë në Strugë dhe në qytetet e tjera shqiptare në Maqedoni, herë në Kosovë, në Prishtinë e gjithandej. Ishte ditur se kur kishte dalë nga shtëpia, por s’ishte ditur se kur do të kthehej, ose nëse do të kthehej fare në shtëpi...!

### **Veleshta e mosdëgjueshmërive të shumta**

Gjatë viteve 1990-1993 Velesha kishte paraqitur fshatin e mosdëgjueshmërive qytetare të ndryshme dhe të shumta. Veleshtarët temperamentë nga natyra e kishin vlarë frikën nga pushtetmbajtësit maqedonë dhe strukturat e tyre të rendit dhe të përndjekjes politike. Policët maqedonë, që ishin mësuar për dekada të tëra që shqiptarët t’u bindeshin si të ishin skllav, i kishin përjetuar vështirë mosbindjet dhe mosdëgjueshmëritë e veleshtarëve, të cilët tani kishin marrë edhe formën e polemikave dhe të kërcënime të ndërsjella. Duke i pasur parasysh deklaratat antishqiptare të politikanëve maqedonë, si të krahut të majtë, ashtu edhe të krahut të djathtë, si dhe duke i pasuar parasysh synimet policisë maqedone për t’i nënshtruar sidomos veleshtarët, ata gjatë viteve 1992/1993 ndër të tjera edhe i kishin vendosur rojat e tyre të natës në hyrje e dalje të Veleshtës.

Për mosbindjet dhe krenarinë e veleshtarëve kishin dëgjuar edhe eksponentët kryesorë të partive politike maqedone, të cilët nënshtrimin e Veleshtës nga ana e tyre e kishin zënë në gojë edhe gjatë zgjedhjeve elektorale, për të marrë kësisoj sa më shumë vota nga elektorati maqedonë i indoktrinuar me antishqiptarizëm. Kështu, kishte ndodhur që njëri prej eksponentëve kryesorë të partisë së djathtë maqedone të VMRO-së, Ljubpço Georgieveski, për t’i provokuar dhe për t’i testuar veleshtarët kishte deklaruar se ai me simpatizantët e tij në mbrëmjen e 2 gushtit të vitit 1992, do të parakalonte me “kalë të bardhë” pikërisht nëpër Veleshtë për të arritur në fshatin Tashmorishtë të banuar me maqedonë, në

të cilin çdo vit në mbrëmjen e 2 gushtit ishin ndezur zjarre, ishin hequr valle, ishte ngrënë meze, ishte pi raki dhe ishin kënduar këngë patriotike probullgare, për ta kujtuar “Kryengritjen Maqedone të Ilindenit”, e cila kishte ndodhur më 3 gusht të vitit 1903.

Siç tregonte Naseri, në mbrëmjen e 2 gushtit të vitit 1992 një llavë maqedonësh militantë të partisë së VMRO-së, pa praninë e Georgievskit, duke kënduar e duke pirë raki “mastika” i ishin afruar Veleshtës për t’i rënë mespërmes dhe për të dalë te fshati Tashmoronishtë ku do të festohej “allabullgarçe” deri nesër në mëngjes. Por në hyrje të Veleshtës ata ishin pritur nga shumë djem e burra veleshtarë, në mesin e të cilëve kishte qenë edhe Naseri, të cilët VMRO-istëve të tillë ua kishin thënë se “për të kaluar nëpër Veleshtë së pari duhet të kaloni mbi trupat tonë!”. Ndonëse me këtë rast ishin nxehur gjakrat nga te dy anët, megjithatë, militantët e tillë të Ljubčo Georgievskit, duke e parë “sa kishte qenë sahati”, kishin ndërruar rrugë duke kaluar në Tashmoronishtë nëpërmjet një fshati tjetër.

### **Krijimi i institucioneve monoetnike maqedone**

Midis viteve 1990-1993 ishte krijuar Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë në baza monoetnike maqedone. Rreth 90% e djemve shqiptarë as që ishin obliguar nga kjo ministri për ta kryer shërbimin ushtarak, kurse pjesa e vogël e tyre, e cila ishte obliguar ta kryente këtë shërbim, ishte bërë sa për ta fshehur monoetnicitetin e ushtrisë maqedone para faktorit ndërkombëtar. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë dhe të Shërbimit Informativ të Maqedonisë. Te dy këto ministri monoetnike maqedone, vetëm në resorët e të tyre të dorës së tretë kishin përfshirë nga një grusht shqiptarësh, sërish vetëm sa për ta “mbuluar” monoetnicitetin e tyre para faktorit ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, qeveria maqedone për t’u krijuar shqiptarëve përshtypje të rrejshme, sikur statusi i tyre politik në Maqedoninë e pavarur kishte ndryshuar rrënjësisht për të mirë, kishte vënë katër-pesë shqiptarë në postin e ministrave në ministrinë dytësore të Maqedonisë, siç kishte qenë ajo për çështje sociale etj. Por duke pasur parasysh se 99% e personelit të ministrive të tilla kishin qenë maqedonë, ministrat shqiptarë të vetmuar brenda ministrive të tilla, se kishin paraqitur as 1%-in e pjesëmarrjes së shqiptarëve në këto ministri. Me fjalë të tjera, Maqedonia e pavarur në raport me shqiptarët kishte mbetur po ajo Maqedoni, që kishte qenë edhe në kuadër të ish-Jugosllavisë.



## ■ Në “vorbullën” e organizimit politiko-territorial

Naseri tregonte se organizimi politiko-territorial i shqiptarëve në Maqedoni midis viteve 1991-1993, kishte lindur si një kundërpërgjigje e shqiptarëve ndaj krijimit të institucioneve politike dhe shtetërore në baza monoetnike maqedone. Maqedonia mekanizmat e tillë sikur t'i kishte bërë për ta mbrojtur vendin nga ndonjë agresion i jashtëm, ajo do t'i kishte bërë ato duke i inkadruar brenda tyre edhe shqiptarët, kurse bërja e tyre në baza monoetnike maqedone kishte dëshmuar se ato ishin bërë të tilla për t'iu kundërvënë shqiptarëve, nëse ata do të ngriteshin për realizimin e të drejtave të tyre me çdo kusht. Kjo ishte arsyeja pse organizimi politiko-territorial vetanë i shqiptarëve, kishte lindur asokohe si një masë preventive e shqiptarëve për t'u mbrojtur nga sulmet e mundshme të mekanizmave ushtarako-policor monoetnik të palës maqedone. Siç u përmend edhe më lart, brenda organizimit të tillë vetanë të shqiptarëve ishte kyçur edhe Naser Hani, duke marrë ai kompetenca të dorës së parë për Strugën me rrethinë.

Naseri thoshte se në fillim të viteve të '90 pala maqedone dhe ajo shqiptare ia kishin ditur të gjitha fshehtësitë njëra-tjetrës, por meqë asnjëra palë s'ishte aq e fuqishme për ta mposhtur tjetrën, te dy palët tregonin “tolerancë” duke heshtur. Por, meqë aty nga gjysma e dytë e vitit 1993 pala maqedone i kishte konsoliduar mjaftueshëm mekanizmat e saj ushtarako-policor monoetnik, ajo papritmas e kishte angazhuar policinë dhe shërbimin sekret maqedon, për t'i arrestuar të gjithë ata shqiptarë të cilët ishin bërë pjesë e organizimit politiko-territorial të shqiptarëve, duke rënë kështu ai organizim si të kishte qenë një kullë prej letre!

## Egzili në Austri

Kishte qenë kjo arsyeja pse gjatë gjysmës së dytë të vitit 1993 në Maqedoni ishin përndjekur, arrestuar dhe burgosur sidomos ata shqiptarë të cilët brenda organizimit të tyre politiko-territorial kishin marrë detyra të caktuara në kuadër të segmentit të mbrojtjes së atij organizimi. Njëri prej të përndjekurve të tillë kishte qenë edhe Naser Hani, i cili pasi që kishte kuptuar se shërbimi sekret maqedon kishte bërë plane për ta eliminuar fshehurazi fizikisht, ishte detyruar që të arratisesh në Austri. Ajo që Naserin pas ikjes në Austri e kishte bërë të ndihej mirë, ishte fakti se ai shënimet e tij lidhur me organizimin politiko-territorial për Strugën me rrethinë, për shkaqe preventive nuk ia kishte dhënë askujt, as eporëve të tij, gjë që e kishte bërë të pamundshëm përndjekjen e shqiptarëve të tjerë, që kishin bashkëpunuar me të.

## **XII. Veprimtaria e Naserit gjatë viteve të egzilit**

### **■ Në vitet e para të qëndrimit në Austri**

Sa më kujtohet, ka qenë fundi i verës ose fillimi i vjeshtës së vitit 1993, kur Naseri për shkak të përndjekjes politike në Maqedoni ishte arratisur në Austri. Ishte vendosur fillimisht te një kushëri i tij, kurse më vonë e kishte banesën e vet, diku në lagjen (gjermanisht “Bezirk-un”) e 17 të qytetit të Vjenës, të cilën ia kishte ofruar bashkëvendësi tij, Hashim Istrefi mbase me një çmim më të lirë. Por kishte qenë korrektësia dhe krenaria e tij, ato që kishin bërë që Naseri pas disa muajsh qëndrimi në Austri, ta kishte shitur copën e vetme të tokës që kishte në Veleshtë, në mënyrë që të jetonte e të vepronte në mirë të çështjes shqiptare pa iu bërë barrë askujt.

Meqë gjatë ditës e deri vonë në mbrëmje kishte qenë gjithandej duke komunikuar e shkëmbyer mendime me të tjerë për çështjen e Kosovës, ai e bënte pothuajse vetëm gjumin në banesën e tij. Kështu, ishte përpjekur të vinte kontakte të reja, të krijonte një rreth shokësh e miqsh me të cilët pastaj do vepronte edhe në Austri politikisht.

Në fakt më shumë se për fatin e tij personal apo familjar, Naseri ishte mërzhitur asokohe për fatin jo të mirë të popullit të tij shqiptarë pa asnjë perspektivë! Tërë ditën kishte pirë kafe e duan!

### **Njohja e parë me Naserin**

Për ardhjen e Naserit në Vjenë mësova nga vëllai im, Ylber Hasani, me insistimin e të cilit vendosëm që t'i bënim atij një vizitë. Meqë nuk e gjetëm në banesë, u kthyem, por në të kthyer u takuam me të në rrugë.

Ajo që më ra në sy menjëherë ishte natyra e tij e afërt, e dashur dhe e gëzuar. Pasi që u përqaftua me vëllain tim, Ylberin, më përqafoi edhe mua sikur të më kishte njohur prej vitesh. Tjetra, që po ashtu më ra në sy ishte gjallëria dhe vitaliteti i tij, bashkë me atë të qeshurën dhe humorin karakteristik që kishte.

Meqë atij dhe vëllait tim, Ylberit, u kishte pëlqyer muhabeti, unë u kënaqa tek i dëgjoja duke i thënë ata njëri-tjetrit “byrazer!”. Pasi që pimë së bashku nga një kafe dhe biseduam me Naserin, ne u nisëm për në banesën tonë. Në të kthyer Ylberi më tha, “shiko, bacë, kemi pasur e kemi shumë shokë të mirë, por si Naseri pak ka!”. “Mos u ngut - i thashë, - se është ende herët për ta vlerësuar!”. “Jo, - më tha Ylberi, - të garantoj se Naseri është një shok që vështirë mund t'i gjendet shoku!”.

Duke qenë korrekt, i përkushtuar kombëtarisht dhe besnik, Naseri me kalimin e kohës u bë edhe shoku im. Takimet tona shoqërore dhe me karakter politik, vazhduan pastaj për rreth tetë vjet me radhë, deri në fund të jetës së tij.

### **Takim me dr. Imer Imerin**

Pas dy-tre muajsh për arsye të njëjtë si të Naserit ishte arratisur nga Maqedonia në Austri edhe doktor Imer Imeri, i cili, më sa më kujtohet, kishte pasur asokohe postin e ministrit të Shëndetësisë. Policia maqedone dr. Imerin kishte dashur ta arrestonte, dhe meqë se kishte gjetur në shtëpi e kishte kërkuar në ambasadën turke në Shkup, duke dyshuar se ai në këtë ambasadë kishte kërkuar azil politik. Së bashku me Naserin shkua për ta vizituar dr. Imerin te një vendas i tij, me ç'rast unë e pashë atë pas rreth njëzet vjetësh, që kur ai kishte qenë studentë i Fakultetit të mjekësisë në Prishtinë. Meqë para se t'i fillonte studimet dr. Imeri kishte bërë shtatë-tetë vjet burg politik, ai ishte studenti më i moshuar i gjeneratës sonë. Pas diplomimit në Fakultetin e mjekësisë në Prishtinë ishte vendosur në fshatin e tij të lindjes, në Qegran afër Gostivarit, dhe që nga ajo kohë se kisha parë më asnjëherë.

Pasi që dr. Imeri dhe Naseri biseduan në katër sy në dhomën tjetër për rreth një orë dhe u kthyen në dhomën e ndejës, ndjeva dhembje për doktor Imerin, sepse duke qenë ai rreth dhjetë vjet më i vjetër se unë, e mora me mend se sa vështirë do ta kishte që t'i përballonte rrugët e botës që kishte marrë, ndërkohë që e kaluara e tij nëpër burgje dhe aktiviteti i tij politik intensiv e kishin lodhur e plakur më shumë seç kishte pasur moshë.

Duke pasur parasysh se presidenti Gligorov për shqiptarët të cilët kishin qenë pjesë e organizimit politiko-territorial të përmendur më lartë kishte bërë njëfarë amnistie jozyrtare, kjo kishte bërë që dr. Imer Imeri pas një muaj qëndrimi në Austri të ishte kthyer në Maqedoni. S'ka dyshim se Gligorovi amnistinë e tillë e kishte bërë duke qenë edhe i mençur edhe dinak, sepse ai dinte se tejndjekja e shqiptarëve një ditë do të mund të çonte në kryengritjen e tyre, dhe kësioj Maqedonia e tij do të merrte fund... Por derisa dr. Imer Imeri ishte kthyer në Maqedoni, Naseri s'e kishte marrë një hap të tillë, sepse ai i kishte punët ndryshe...!

## Duke i kërkuar Kosovës “argatë” të ri!

Por, se me çka ishte marrë Naseri në vitet e para në Austri, përgjigjja më e shkurtër kishte qenë: Me gjithçka dhe me asçka! Me gjithçka, sepse në kërkim të shëmbëlltyrës së shokëve të dikurshëm të idealit çlirimtar, s'ishte ndalur duke i rënë Vjenës kryq e tërthor, dhe me asçka sepse koha kur ai kishte dashur t'i gjente Kosovës “argatë” të ri, kishte qenë aq e ligë saqë atij s'i kishte ofruar as minimumin e pritur.

U ishte afruar studentëve shqiptarë që kishin studiuar në Vjenë, por jo të gjithëve u kishte rrahur zemra aty ku i kishte rrahur atij. U ishte afruar punëtorëve, por ata të lodhur nga punët e rënda që kishin bërë, as që kishin pasur nge të merreshin me politikë. Në këto rrethana, Naseri, ishte mallëngjyer aq shumë, duke i kujtuar shokët e shoqet e tij të vitit 1981, të cilët s'po i gjente më askund. I dëshpëruar skajshmërisht kishte menduar se tanimë idealizmës së tij të dikurshme i kishin perënduar yjet njëherë e përgjithmonë...

Dhe si të mos t'ishte dëshpëruar kur te stacioni jugor i Vjenës (gjermanisht „Südbanhof“), pranë autobusëve, të cilët kishin marrë udhë drejt Kosovës dhe Maqedonisë, i kishte parë mërgimtarët shqiptarë me torba në krah, brenda të cilave ata kishin pasur edhe cigare Marlboro dhe çokollata, jo për të afërmit e tyre në Kosovë apo në Maqedoni, por për t'ua dhënë ato policisë serbe e maqedone që të kalonin sa më lehtë nëpër kufij. Skenat e tilla e kishin bërë që ai ta pyeste veten shumë herë: “Ky popull që policinë e armikut e mban me cigare e çokollata, dhe kur kthehet nga atdheu gajasët duke treguar si gjoja ia ka hedhur policisë serbe e maqedone, vërtet, a e ka ndërmend që ta çlirojë ndonjëherë vendin e vet...!”.

## Rikthim në fëmijëri

Brenda rrethanave të tilla kishin qenë kujtimet e fëmijërisë, ato që Naserin e kishin kthyer shpeshherë të Veleshta e tij e dashur dhe e shtrenjtë, te shtëpia e moçme ku kishte lindur, te dhoma e pritjes, te vatra, te oxhaku, te rrugicat tërë baltë e gurë të fshatit, te shkolla e vogël, te rrapet shekullorë, te fushëzat e kodrinat përreth, dhe gjithandej kah ai kishte lozur e bredhur dikur.

Por, mbase bashkë me mjediset idilike të fshatit, kujtesës së Naserit gjatë viteve të mërgimit i ishin kthyer edhe njerëzit e atyre kohëve, ashtu si portrete të zbehta të atyre që janë dhe të atyre që s'janë më. Kujtesës së tij i ishte kthyer mbase edhe portreti i babait, i nënës, i dajë Karimanit, i shokëve të bankës, i mësueses së parë, i drejtorit të shkollës etj. Dhe jo vetëm portretet, por bashkë me to kujtesës së tij i ishin kthyer edhe ngjarjet e atyre kohëve: dasmat, krismat, këngët, vallet, gjëmat, vdekjet e vajet!

Të gjitha këto s'do të kishin ndoshta asnjë vlerë sikur ai të kishte jetuar i lirë në vendlindjen e tij. Por, duke qenë i mërguar në një vend të huaj, ato i ishin kthyer atij si vlera të çmueshme, dhe si copëza jete të shkëputura brenda një filmi të gjatë bardhë e zi.

Por, gjatë viteve të migrimit në Austri kujtesës së Naserit i ishte kthyer padyshim edhe Struga.

Kujtimi ndonjëherë i ishte lidhur me liqenin aty pranë te këmbët e Strugës, në të cilin ai si fëmijë dhe djalë ri ishte larë shumë herë me shokë. Por kujtimin të tij i ishte kthyer edhe rruga qendrore e qytetit të Strugës, e shtruar me pllaka guri dhe me dyqane të shumta në të dy anët e saj, siç kishin qenë kafenetë e vogla, ëmbëltorët, argendaritë, rrobaqepësitë, flokëprerësit, fotodyqanët e të tjera.

Herën tjetër, mbase kujtimi i ishte lidhur edhe me rrugicat e kalldrëmta të lagjeve të qytetit, të cilat duke u shkëputur nga rruga qendrore me pllaka guri, ishin shpërndarë gjithandej deri para portave të shtëpive strugane me oborre të pastra e me lule. Kishin qenë këto rrugicat që ai i kishte shkelur dikur plot gëzim e vullnet për jetë. Por kohët kishin ndryshuar dhe tani ai kishte vite që s'i kishte shkelur më ato... Ishte arratisur e degdisur në një vend të huaj, sepse ashtu kishin dashur të tjerët...!

Por, kujtimin për Strugën s'kishte mundur t'i ikte as Drini i Zi, lumi i cili me ato urëzat e tij të njëpasnjëshme si samare mbi shpinë lëshon një copë shtrat nëpër Strugë. Duke kaluar dikur mbrëmjeve verore plot freski pranë këtij lumi, ai, brenda fantazisë së tij djaloshare e kishte projektuar krejtësisht ndryshe jetën. Ndoshta si një livadh me lule, dhe mbase si një luftë për liri...!

Dhe, kujtimi për Strugën s'kishte mundur të mos i lidhej edhe me shokët e shoqet e dikurshme të gimnazit, me arsimtarët dhe me njerëzit e mirë të këtij qyteti, me sjelljet e tyre të mrekullueshme dhe sidomos me atë të folurën e bukur të gjuhës shqipe. Të gjitha këto dhe shumëçka tjetër që lidhej me Strugën, kishin bërë që Naseri gjatë viteve të mërgimit ta kujtonte atë me mallëngjim.

Menjëherë pas Strugës, Naseri e kishte dashur Korçën, sepse ajo si për nga planimetria e rrugicat e kalldrëmta, si për nga sjellja e qytetaria, ashtu edhe për nga shtëpitë me oborre të pastra e me lule, kishte ngjarë aq shumë me Strugën. Duke e krahasuar Strugën me Korçën, ai ishte shprehur se “Bota ka një Paris të madh, kurse ne shqiptarët kemi dy Parisë të vegjël!”.

## **Studimet pasuniversitare të lëna përgjysmë**

Pas një vit qëndrimi në Austri kur në njëfarë mase e kishte mësuar gjuhën gjermane, Naseri i kishte regjistruar studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik të Vjenës, me shpresë se duke mësuar gjëra të reja do ta gjente veten,

kurse, duke bërë edhe ndonjë mik austriak, do ta ndihmonte edhe çështjen e Kosovës. Kësisoj, derisa ditën e kalonte duke lexuar në bibliotekën universitare, mbremjet i kalonte sërish gjithandej, duke u takuar me veleshtarë dhe me shqiptarë të tjerë, më qëllim që t'i motivonte ata sa më shumë kombëtarisht. Por, Naseri asokohe kishte udhëtuar herë pas here për në Zvicër për t'u takuar me shokun dhe mikun e tij, Bardhyl Mahmutin, dhe me bashkëfshatarët e tij nga Veleshta për t'i pasur ata pranë vetes, në mënyrë që kur ta donte puna ata ta jepnim kontributin e tyre për çështjen e Kosovës.

Kishin qenë angazhimet e tilla rreth çështjes së Kosovës, ato të cilat kishin bërë që studimet pasuniversitare t'i mbeteshin të lëna përgjysmë. Kjo kishte dëshmuar se ai nuk mund të ikte nga fati i tij i marrjes me çështjen e Kosovës...

### **Një grusht shokësh e miqsh**

Me kalimin e kohës Naseri kishte gjetur në Vjenë një grusht shokësh të përkushtuar kombëtarisht, të cilët kishin qenë të gatshëm që të sakrifikonin shumëçka për Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovën Lindore. Me të gjithë këta shokë, ai ishte përpjekur që ta kthente në Vjenë pranverën tanimë të largët të vitit 1981. Një pjesë e tyre kishin qenë anëtarë të LPK-së, të degës për Austrinë, një pjesë kishin qenë studentë, pjesa tjetër ishin disa veprimtarë të përndjekur të cilët ishin vendosur në Vjenë, por që marrë së bashku s'kishin qenë as njëzet.

Asokohe kur lufta çlirimtare e Kosovës ishte dukur të ishte ende e largët, ai s'e kishte ditur se njëri prej shokëve që e kishte gjetur në Vjenë, Hashim Thaçi, pas disa vitesh do të ishte drejtor i Drejtorisë Politike i UÇK-së, se tjetri, Nuri Bexheti, do të ishte njëri nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, kurse Mustafë Abazi do të ishte ushtar i UÇK-së i cili do të vritej pas luftës nga shpërthimi i një mine me rastin e zhvarrosjes së shqiptarëve të masakruara nga forcat serbe në fshatin Lubeniç. Më tej, gjatë qëndrimit në Austri Naseri ishte njohur dhe shoqëruar edhe me profesorin e Fakultetit teknik të Universitetit të Prishtinës, Salem Lepajën, i cili gjatë atyre viteve kishte qenë me punë në Vjenë, dhe me të cilin kishte këmbyer pikëpamje të përbashkëta politike.

### **"Lulja e mërgimit!"**

Me sa më kujtohet ishte maji i vitit 1994 kur unë pas dy vjetësh mërgimi vendosa të shkoja për një dy javë në Maqedoni, përkatësisht në Strugë për t'u takuar me fëmijët dhe bashkëshorten. Para se të niseshja i thashë Naserit se doja ta vizitoja familjen e tij. "Mirë, më tha Naseri - gjëje kushërinin tim, Tahir Hanin, dhe shko me të në Veleshtë te shtëpia ime". Ashtu edhe bëra, në Strugë

e gjeta Tahir Hanin dhe bashkë me të, me gruan dhe fëmijët e mi u gjenda në Veshhtë, ku na priti aq miqësisht bashkëshortja e Naserit, Florentina.

Meqë disa muaj pasi që Naseri ishte arratisur në Austri i kishte lindur edhe fëmija i tretë, vajza, të cilës ia kishin vënë emrin Era, e fotografova foshnjën e vogël dhe kur u ktheva në Vjenë fotografinë e saj i dhashë Naserit duke i thënë se: “ta kam sjellë një dhuratë nga vendlindja, emrin e ka Era!”. Naseri e mori fotografinë e vajzës së vogël në dorë, e shikoi atë dhe nga mallëngjimi për të voglën e tij e quajti atë “Lulja e mërgimit!”.

### ■ “Liri, demokraci, pa shqiptarët s’ka Maqedoni!”

Diku në majin të vitit 1995 Naseri e kishte marrë iniciativën që para ambasadës maqedone në Vjenë, e cila ishte hapur para disa muajsh, të bëhej një demonstratë me qëllim të sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar lidhur gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Maqedoni. Për t’ia arritur këtij qëllimi ai e kërkoi ndihmën time dhe të Abdullah Abdullahut asokohe anëtarë LPK-së për degën e Austrisë. Vendosëm që demonstrata të mbahej më 11 qershor të atij viti në emër të LPK-së, por me pjesëmarrje të të gjithë shqiptarëve, pa dallime partiake apo krahinore.

Më pas, te tre së bashku e hartuam edhe një fletëpromemorie me kërkesa politike, që do të lexohej në gjuhën shqipe para ambasadës maqedone, si dhe do t’u jepej qytetarëve vjenezë në gjuhën gjermane, të cilët do të tregonin interesim për demonstratën tonë. Në promemorie ishte shtruar kërkesa që Maqedonia t’i përkufizonte shqiptarët jo si pakicë, por si shumicë etnike, që shqiptarët të konsideroheshin popull shtetformues, që gjuha shqipe të ishte gjuhë zyrtare, që Universiteti i Tetovës të njihej dhe të financohej etj. ....

Promemorien e tillë, të përkthyer në gjuhën gjermane, e shumëfishoi Xhevat Balaj, i cili punonte në një shtypshkronjë në Vjenë. Ai e bëri edhe shumëfishimin në letër të flamurëve të vegjël kombëtarë, të cilët do t’i mbanin në duar demonstruesit. Kadrush Qollaku i përgatiti pankartat, duke i shkruar thëniet e caktuara në formën kërkesave politike në letra të mëdha, të cilat do të barteshin nga demonstruesit. Me që demonstrata do të mbahej në emër të LPK-së, u morëm vesh që kërkesat politike para masës së demonstruesëve kur do të arrinim para ambasadës maqedone t’i lexonte anëtarë i LPK-së, Abdullah Abdullahu, i cili në fund të fjalës së tij do të thërriste disa herë bashkë me masën e demonstruesëve: “Liri, demokraci, pa shqiptarët s’ka Maqedoni!”. Në të vërtetë thirrja e tillë ka qenë vetë motoja e demonstratës, të cilën po e organizonim bashkarisht. Naseri, që të ishte demonstrata e 11 qershorit të vitit 1995 sa më masive, fletëshpalljen

e saj e kishte vendosur gjithandej shoqatave shqiptare dhe gjithandej lokaleve të shqiptarëve në Vjenë. Ai deri një ditë para mbajtjes së demonstratës kishte lëvizur gjithandej për t'i njoftuar shqiptarët që të merrnin pjesë në demonstratë.

Për të qenë demonstrata sa më masive ne organizuam një mbledhje të përbashkët me të gjithë kryetarët e degëve të partive shqiptare të cilat ishin formuar në Vjenë. Në sajë të sjelljeve tona konstruktive dhe duke i tejkaluar mosmarrëveshjet e hershme midis degëve të partive të tjera dhe LPK-së, u arrit konsensusi që të gjithë shqiptarët të merrnin pjesë në demonstratë. Në gjetjen e konsensusit të tillë, me sjelljet e tij konstruktive ndihmoi sidomos kryetari i degës së LDK-së për Austrinë, Ibish Rugova.

Së fundi, për mbajtjen e rregullit gjatë demonstratës dhe për të treguar kulturë dhe edukatë para opinionit publik vjenez caktuam edhe disa kujdestarë, të cilët në krahun e djathtë do ta kishin shiritin e kuq me shkrimin “kujdestar!”. Edhe Naseri kërkoi që të ishte njëri nga kujdestarët e tillë. Më pas ai kishte mbajtur një takim me të gjithë kujdestarët e demonstratës, të cilët i kishte porositur që me rastin e demonstratës t'u luteshin demonstruesve, që mos të ecnin krahazi më shumë se tre veta, në mënyrë që kolona e demonstruesve të ishte sa më e gjatë. Kësisoj e kuptuam pse Naseri kishte kërkuar që të bëhej kujdestar.

Më 11 qershor të vitit 1995 në orën e caktuar te sheshi Schottentor në qytetin e Vjenës ishte mbledhur një masë e madhe e shqiptarëve për të marrë pjesë në demonstratë. Në ballë të kolonës së demonstruesve vendosëm të ishin dy personalitete të nderuara të kulturës shqiptare, shkrimtari Dritëro Agolli dhe pedagogu Bedri Dedja, të cilët ato ditë kishin qenë në Vjenë lidhur me organizimin e Kuvendit Gjithëkombëtar. Kështu, kolona e gjatë e demonstruesve filloi të lëvizte përpara drejt rrugës qendrore prej tre-katër kilometrash, njërën anë të së cilës policia e kishte rezervuar për demonstratën tonë. Derisa kolona kishte lëvizur përpara shumë qytetarë vjenez ishin ndalur të na shikonin se kush ishim dhe çfarë kërkonim, ndërkohë që kujdestarët e demonstratës ua jepnin atyre fletëpromemorien e përkthyer në gjuhën gjermane.

Naseri ishte gëzuar dhe emocionuar që demonstrata për të cilën ai e kishte marrë nismën fillestare, po ecte mirë. Në një moment ai gati me sy të përlotur m'u afrua duke më thënë, se demonstrata e sotme ia kishte kujtuar demonstratat e pranverës së vitit 1981 në Prishtinë në të cilat ai kishte marrë pjesë! Në një rast Naseri ma vendosi edhe mua në krah shiritin e kujdestarit. “Mbaje, më tha, që personeli i ambasadës maqedone mos të kuptojë se je njëri nga organizatorët e demonstratës, por sikur je një demonstrues i thjeshtë, të cilit i është dhënë puna e kujdestarit!”. Në atë moment ndjeva dhembje për Naserin, i cili gjithnjë i kishte ruajtur të tjerët më shumë se veten.



Pasi që kolona e demonstruesve e parakaloi nëpër rrugën qendrore të qytetit, policia vjeneze i priu asaj nëpër një rrugë dytësore drejt “bezirkut” të katërt të Vjenës, ku kishte qenë ambasada maqedone. Më në fund, kolona arriti te sheshi para ambasadës maqedone, në hyrje të së cilës policia e kishte vendosur gardhin e hekurt për shkaqe preventive.

Derisa Abdullah Abdullahu e lexonte para demonstruesve fletëpromemorian me kërkesa politike, dhe derisa ai së bashku me masën thirri disa herë “liri, demokraci, pa shqiptarët s’ka Maqedoni!”, pashë se nga ambasada maqedone dolën tre-katër veta të cilët m’u afruan duke u prezantuar si gazetarë. Njëri prej tyre e kishte pasur një kamerë në dorë. I thashë në gjuhën serbe: “Mos gabo të bësh inçizime se nuk të lejojmë!”. “Mirë, tha ai, nuk bëjmë inçizime, por na jepni një kopje në gjuhën gjermane të letrës që u lexua!”. Në këtë moment nuk e di pse u stepa dhe ngurova që agent-gazetarit maqedon t’ia jepja një kopje të fletëpromemories, edhe pse ajo u ishte drejtuar pikërisht institucioneve kryesore maqedone. Naseri duke e parë ngurrimin tim erdhi drejt meje duke më thënë: “Çfarë kërkojnë, doktor!”. Promemorian i thashë. “Jepja!” - më tha, duke shtuar se “këmbanat po bien për ta!”. “Këta janë të parët që duhet ta lexojnë!”. Pastaj i mori disa fletëpromemorie dhe ia lëshoi ato në dorë personelit të ambasadës maqedone, duke u thënë me zemërim: “Tani, ikni nga këtu...!”.

Meqë shqiptarët nga Maqedonia i kishin shprehur deri vonë kërkesat e tyre politike duke demonstruar jashtë vendit për çështjen e Kosovës, demonstrata e asaj dite kishte paraqitur demonstratën e parë të mbajtur jashtë vendit vetëm për të drejtat e tyre në Maqedoni. Natyrisht se kjo na gëzoi shumë që arritëm të bënim sadopak për shqiptarët në Maqedoni.

Një ditë më pas duke e pyetur veten pse isha stepur kur personeli i ambasadës maqedone ma kishte kërkuar kopjen e fletëpromemories së demonstratës, zbulova se unë në atë moment kisha jetuar me ngjarjet e dikurshme të Kosovës. Më ishte dukur sikur unë agentit të shërbimet sekret maqedon po ia jepja me dorën time një afishe apo një trakt, nga ato afishet dhe traktet, të cilat dikur para shumë vitesh ishin shpërndarë fshehurazi gjithandej Kosovës, dhe kësisoj më ishte dukur sikur po i denoncoja ata që dikur kishin shpërndarë fshehurazi afishe apo trakte të tilla...

## **Ishte bërë anëtar i PDSH-së**

Më sa më kujtohet Naseri në vitin 1995 duke qenë në Austri ishte bërë anëtar i Partisë Demokratike Shqiptare në Maqedoni (PDSH-së).

Kështu kishte vepruar, sepse derisa Partia për Prosperitet Demokratik (PPD-ja), e cila kishte qenë në koalicion qeveritar me të majtën maqedone, kishte

bërë përpjekje minimale për mbrojtjen e Universitetit të Tetovës në gjuhën shqipe, kurse PDSH-ja e cila ishte themeluar në vitin 1994 ishte dukur shumë më premtuese në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Kishte qenë kjo arsyeja pse edhe shokët e Naserit nga Veleshta dhe rrethina tani e kishin themeluar në Strugë degën e PDSH-së. Brenda rrethanave të tilla Naseri në kundërshtim me natyrën e tij të veprimtarit të lirë, tani ishte bërë anëtar i një partie të caktuar, siç kishte qenë PDSH-ja.

Fakti se PDSH-ja kishte qenë me orientim politik të djathtë kurse Naseri orientim politik të majtë, kishte folur qartë se për Naserin orientimi politik djathtë-majtë kishte qenë dytësor, kurse orientimi politik kombëtarë parësor.

## ■ Lajme të këqija nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria

### Shqiptarët midis krizash

Ato që Naserin dhe shumëkënd tjetër jashtë vendit e kishin brengosur, kishin qenë lajmet e këqija nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria, të cilat i kishin sjellë mërgimtarët shqiptarë, mediat e shkruara dhe ekranet televizive.

Nga ato që po dëgjonte nga mërgimtarët që shkonin e vinin rezultonte se shqiptarët në Kosovë i ishin dorëzuar fatit dhe rastësisë; se shumicës së tyre as që i kishte interesuar më çështja e Kosovës, sepse ata duke qenë të papunë ishin marrë me mbijetesën; një pjesë e tyre ishin bërë lojalë ndaj regjimit serb; se një pjesë e tyre ishte dhënë pas imoralitetit dhe veseve; se numri i të rinjve të varësuar nga drogat ishte rritur, kurse një pjesë e të rinjve ua kishin marrë edhe këngëve, si “s’më ha palla për kopalla!” dhe “lopët e mija ma t’mira n’katund!” etj.

Nga ana tjetër, edhe nga viset shqiptare në Maqedoni kishin ardhur lajme jo të mira. Pushtetmbajtësit maqedonë e kishin shpallur të ndaluar, jolegal dhe jolegjitim, Universitetin e Tetovës në gjuhën në shqipe, që e kishin themeluar dhe financuar vetë shqiptarët, ndërkohë që forcat policore maqedone ndërtesat private të këtij universiteti i kishte rrëzuar me ekskavator. Meqë me këtë rast shqiptarët kishin protestuar në mbroje të Universitetit të Tetovës, policia maqedone kishte ushtruar dhunë masive ndaj protestuesve, me ç’rast edhe e kishte vrarë një protestues shqiptar, baba i katër fëmijëve. Në vitin 1966 sidomos në Tetovë dhe në Kumanovë ishte përsëritur fenomeni i helmimit të nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme me gazëra helmuese si në pranverën e vitit 1990 në Kosovë.

Të gjitha këto kishin ndodhur një kohë kur në Kosovë, në Maqedoni dhe

visë të tjera shqiptare, në mesin e shqiptarëve kishin lulëzuar të gjitha llojet e krizave, të cilat kishin pasuar përfundimisht me shpërngulje të shqiptarëve në vende të ndryshme të Evropës perëndimore, në Amerikë, në Australi, në Kanada dhe një pjesë e vogël e tyre deri edhe në Zelandë të Re. Shpërnguljet e tilla kishin bërë që Naseri të mendonte se nëse ato do të vazhdonin kështu edhe disa vite, shqiptarët edhe në Kosovë dhe në Maqedoninë perëndimore, ku ata kishin qenë shumicë, do të mbeteshin pakica kombëtare dhe kjo do të thoshte fundi i tyre!

### **Lajme të këqija edhe nga Shqipëria**

Nga ana tjetër, lajme të këqija kishin ardhur edhe nga Shqipëria. Që nga viti 1992 deri më 1997 në pushtet kishte qenë pozita demokratike, e cila më shumë se me hallet e vërteta të Shqipërisë ishte marrë me të kaluarën, me ish-sistemin socialist tanimë të përfunduar, më ish-diktaturën komuniste, me Enver Hoxhën, me dënimet, me burgosjet dhe pushkatimet e asaj kohe. Kështu, në televizionin shqiptar ishin prezantuar gjithnjë “telat me gjemba” të burgut të Spaçit dhe të Burrelit, dhe një skenë pushkatimi e tre burrave dhe të një gruaje nga diktatura e komunizmit.

Por, meqë pozita demokratike e Shqipërisë ndër ato vite ishte marrë pak e hiç me vuajtjet e shqiptarëve në Kosovë e visë të saj në Jugosllavi, të cilat kishin qenë shumë më të mëdha se vuajtjet e shqiptarëve në Shqipëri, kjo të bënte të dyshojë se pozita demokratike ishte marrë me të kaluarën e Shqipërisë, në radhë të parë për ta identifikuar opozitën socialiste me diktaturën komuniste, në mënyrë që ajo të mbetej sa më gjatë në pushtet. Por, pa marrë parasysh se për çfarë qëllimesh pozita demokratike e Shqipërisë ishte marrë aq shumë me të kaluarën e Shqipërisë, dhe pa marrë parasysh vërtetësinë e të gjitha atyre që ishin thënë, një gjë ishte e qartë se marrja me të kaluarën në ato vite nuk i kishte bërë mirë Shqipërisë. Përkundrazi, ajo kishte futur urrejtje, smirë dhe dufe hakmarrëse midis shqiptarëve edhe ashtu të skamur, të frustruar dhe të papërmbytur. Mëtej, propaganda e tillë e shfrenuar ndaj të kaluarës në njëfarë mënyre i kishte bërë keq edhe Kosovës. Kjo sepse bota kishte mundur të mendonte se shtypja e shqiptarëve në Kosovë e visë të saj nga shovinistët serbo-maqedono-malazez, s'qenka asgjë para shtypjes që në Shqipëri paska ushtruar Enver Hoxha me parti, duke e zbritur kështu propagandën e tillë edhe “pazarin” e Kosovës para botës, e cila ishte pritur që ta ndihmonte Kosovën.

Meqë pozita demokratike e Shqipërisë në fillim të viteve të '90 kishte “harruar” të merrej me të kaluarën dhe të tanishmen e rëndë të shqiptarëve në Kosovë dhe viset e saj, kjo kishte bërë që shumë shqiptarë nga Kosova dhe

viset e saj të ishin ndier të braktisur nga Shqipëria, si dhe të kishin pyetur si është mundur që pozita e tillë e cila po ia përshkruante vetes 1001 të mira, t'i vajtonte vuajtjet e njëres gjysmë të kombit në Shqipëri, kurse vuajtjet e gjysmës tjetër të kombit në Kosovë e vise tjera të mbetura në ish-Jugosllavi as mos t'i zinte në gojë?! Në fakt, ata kishin dashur që në televizionin shqiptarë, krahas "telave me gjemba" të burgut të Burrelit dhe të Spaçit, të dëgjonin diçka edhe për "telat me gjemba" të burgut të Nishit, të Pozharevcit, të Goli Otokut, të Gospiqit, të Stara Gradishkës, të Idirzovës dhe të shumë burgjeve të tjera serbe e jugosllave, nëpër të cilat shqiptarët nga Kosova e viset e saj kishin bërë qindra mijëra vite burgje, ashtu siç kishin dashur të dëgjonin diçka edhe për dhjetëra mijëra shqiptarë të përndjekur, të vrarë me armë zjarri dhe të mbytur me tortura, nga ushtria, policia dhe UDB-ja serbojugosllave që nga LDB-ja e këtej.

Injorimi i tillë që klasa e re politike e Shqipërisë e vetëquajtur demokratike, i kishte bërë të kaluarës së shqiptarëve në Kosovë e vise tjera shqiptare, të mbetura deri në vitin 1991 në kuadër të Jugosllavisë, dhe më pas në kuadër të Serbisë, Maqedonisë dhe të Mali i Zi të pavarur, kishin bërë që shqiptarët e këtyre viseve, të ishin ndier për herë të parë, jo vetëm të papërkrahur dhe të pambështetur nga vendi i tyre amë, por edhe të brengosur për fatet vetë e Shqipërisë, e cila për shkak të luftës së verbët për pushtet midis dy partive kryesore, po çrregullohej dhe fundosej çdo ditë e më shumë.

Nga ana tjetër, për shkak të varfërisë ekonomike kishin ikur në fillim të viteve të '90 kryesisht në Greqi dhe Itali qindra mijëra shqiptarë nga Shqipëria, ndërkohë që sidomos në Itali, por edhe në Greqi, shumë femra shqiptare e kishin ushtruar prostitucionin, fenomen ky i cili s'ishte parë e dëgjuar më parë brenda kombit shqiptar. Krimi i organizuar, interesat individuale, klanore e partiake, korrupsioni, bandat, skafet, drogat, vrasjet bashkë me shërbimet sekrete të vendeve fqinje e kishin bërë Shqipërinë më keq se në kohën e Evlia Qelebisë! Kështu, ishte parë fare qartë se demokracia e re shqiptare kishte rrëshqitur në një anarki të rrezikshme në radhë të parë për vet Shqipërinë, por edhe për Kosovën dhe viset e saj që një Shqipërie të konsoliduar politikisht ia kishte pasuar nevojën më shumë se kurrë.

Brenda rrethanave të tilla, sidomos midis viteve 1995-1997, në sheshin Skënderbe në Tiranë ishte demonstruar për largimin e pozitës demokratike nga pushteti, jo vetëm nga opozita socialiste por edhe nga masat e popullit. Por, në sheshin Skënderbe ndër ato vite ishte demonstruar edhe nga vetë pozita demokratike kundër opozitës socialiste, gjë që ishte dëgjuar rrallë të kishte ndodhur në ndonjë vend tjetër. Kështu, sheshi Skënderbe në Tiranë ishte kthyer në një arenë demonstrimesh, sharjesh, fyerjesh dhe kërcënimesh nga të gjitha

palët, saqë ishte dukur sikur në Shqipëri ishin ngritur të gjithë kundër të gjithëve!

### **Shqipëria drejt zhbërjes së saj**

Por ato që ia kishin vënë flakën Shqipërisë kishin qenë firmat piramidale, funksionimi i të cilave kishte ndodhur duke qenë në pushtet pozita demokratike në krye me Salih Berishën. Për të përfituar nga kamatat e larta që kishin ofruar firmat e tilla, shqiptarët gjithandej Shqipërisë edhe lekët e fundit që kishin pasur, bashkë me paratë e shtëpive të shituara i kishin investuar në këto firma, duke mbetur më pas me gishta në gojë!

Kështu, në vitin 1997 masat popullore për shkak të humbjeve financiare që u kishin sjellë firmat piramidale, dhe për shkak të pakënaqësive politike e sociale, ishin konfrontuar me strukturat e pushtetit “demokratik” deri në atë shkallë, saqë ato në revoltë e sipër i kishin vënë zjarrin dhe kishin hedhur në erë gjithçka që u kishte dalë parasysh. I kishin shpërthyer depot e armëve, i kishin rrëmbyer kallashnikovët, municionet dhe eksplozivet, kishin shtënë me armë zjarri mu në sheshe të qyteteve, duke u vlarë shumë qytetarë shqiptarë gjithandej Shqipërisë. Nëpër rrugët e qyteteve kishin dalë tanket, policia dhe ushtria. Më keq se kaq, as që kishte mundur të ndodhte me Shqipërinë. Naser Hanin e kishte tmerruar sidomos një emision special i televizionit austriak lidhur me Shqipërinë, në të cilin analistët politikë ishin shprehur se, “ky vend po shkon drejt zhbërjes së tij si shtet!”. Më keq se kaq, ai as që kishte mundur të dëgjonte për Shqipërinë, vendin amë të gjithë shqiptarëve në botë.

E tëra kishte përfunduar me vënien e Shqipërisë nën një protektorat ndërkombëtar të përkohshëm, me organizimin e zgjedhjeve të lira sërish me turbullira, me rënien nga pushteti i pozitës demokratike, si dhe me ardhjen në pushtet të opozitës socialiste, me ç’rast edhe me ndihmën e faktorit ndërkombëtar Shqipëria në njëfarë mase ishte stabilizuar. Të gjitha këto kishin një kosto tejet të lartë për Shqipërinë, sepse ishin vlarë shumë njerëz, ishte dëmtuar shumë kapacitetet mbrojtëse të vendit, si dhe ishte rrënuar përfundimisht imazhi i Shqipërisë në botë.

Ngjarjet e tilla në Shqipëri shumë shqiptarë në Kosovë e vise të saj, jo vetëm se i kishin brengosur pa masë, por edhe i kishin trishtuar e tmerruar njëkohësisht.

### **“Fati” në fatkeqësi...!**

Ngjarjet e këqija, të cilat e kishin goditur Shqipërinë gjatë vitit 1997, kishin bërë që Naser Hani dhe mijëra shqiptarë të tjerë të përkushtuar kombëtarisht të luanin mendsh! Shumëkush e kishte pyetur veten: “Ç’po ndodh kështu me

Shqipërinë, pikërisht kur UÇK-ja kishte rreth një vit që e kishte filluar luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës!”.

Për Naserin ishte e çuditshme që tani po ndodhte për herë të dytë, që kur Kosova kishte shënuar ngritje, kësaj radhe me luftë të armatosur kundër Serbisë, Shqipëria të ishte turbulluar nga brenda si në vitin 1990, kur derisa me 2 korrik të atij viti Kosova e kishte shpallur deklaratën kushtetuese, në Shqipëri kishte ndodhur kaosi i futjes së të rinjve nëpër ambasadat e huaja. Duke i analizuar “rastësitë” dhe “koincidencat” e tilla, atij serish i kishte shkuar mendja te ndërhyrjet e mundshme të “nëntokave” të vendeve fqinje në punët e shqiptarëve.

Por fatkeqësitë e tilla që i kishin ndodhur Shqipërisë në vitin 1997 e kishin pasur së pakut një të mirë. Me armët që kishin rënë në duart e popullit, UÇK-ja ishte pajisur me armë dhe tanimë po shënonte suksese në luftimet e saj kundër forcave serbe në Kosovë. Kishte qenë ky “fati” në fatkeqësi i cili s’kishte pasur aspak nevojë të ndodhte, sikur Shqipëria të mos ishte katandisur deri në atë gjendje...

## **Në vizitë te Ramiz Alia**

Naser Hani si edhe shumë shqiptarë të tjerë nga Kosova e viset e saj, kishte ushqyer simpati dhe besim të veçantë ndaj personalitetit të Ramiz Alisë. Arsyet e këtij adhurim-besimi kishin qenë të shumta.

Ramiz Alia që si djalë i ri kishte luftuar me brigadat partizane të Shqipërisë për çlirimin e Kosovës dhe të Sanxhakut nga nazizmi gjerman, të cilin brigadat shqiptare e kishin ndjekur deri në Vishegrad dhe deri në Mitrovicë të Sermit në territorin jugosllav. Kjo ishte bërë, ndër të tjera, që Shqipëria në emër të luftës antifashiste të popullit shqiptar të kërkonte nga Jugosllavia, që në përputhje vendimet e Konferencës së Bujanit, të mbajtur në kapërcyellin e viteve 1943/1944, Kosova dhe viset tjera shqiptare t’i ktheheshin Shqipërisë.

Më tej, Ramiz Alia, duke qenë në krye të resorit të propagandës përgjatë katër dekadave të Shqipërisë socialiste, propagandën mediale të shtetit shqiptar e kishte vënë gjithnjë në funksion të ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe të mbështetjes së kërkesave politike të shqiptarëve në Kosovë e vise të tjera.

Ramiz Alia që gjatë vitit 1990 e kishte lejuar në Shqipëri pluralizmin partiak e fetar, duke i dhënë një shtytje përpara demokracisë në Shqipëri, kurse në sajë të urtësisë dhe largpamësisë së tij politike, edhe kalimi i Shqipërisë nga njëri sistem shoqëror në tjetrin ishte bërë pa tronditje të mëdha, siç kishte ndodhur në disa vende të tjera.

Ramiz Alia në vitin 1991 kishte bërë që Kuvendi Popullor i Shqipërisë ta njihnte zyrtarisht Republikën e Kosovës të shpallur në shtatorin e vitit 1990 në Kaçanik.

Ai një fjalën e tij të mbajtur në selinë e OKB-së në vitin 1991 kishte deklaruar,

se “Shqipëria bashkimin e dy Gjermaneve e konsideron një të drejtë legjitime të popullit gjerman”, duke aluduar kësisoji që vendet anëtare të OKB-ës edhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ta konsideronin po ashtu një të drejtë legjitime të popullit shqiptar.

Mëtej, Ramiz Alia gjatë vitit 1991 kishte lejuar që në Shqipëri të bënin ushtrime përgatitore për luftë grupet e para të të rinjëve shqiptarë nga Kosova, në mesin e të cilave kishte qenë edhe komandanti i parë i UÇK-së, Adem Jashari, duke e ndihmuar kësisoji paraprakisht themelimin UÇK-së, e cila me luftë të armatosur disa vite më vonë do t'i kundërvihej forcave serbe në Kosovë.

Pas ardhjes në pushtet të opozitës demokratike më marsin e vitit 1992, Ramiz Alia kishte qenë i pari dhe i vetmi politikan shqiptarë, i cili kundërshtarit të tij politik, Salih Berishës, ia kishte uruar fitoren. Por opozita demokratike me të ardhur në pushtet, kryesisht për shkaqe politike dhe hakmarrëse, Ramiz Alinë midis viteve 1992-1997 e kishte dënuar dhe e kishte mbajtur në burgje.

Kishin qenë këto arsytet pse Naseri së bashku me shokun e tij nga Shqipëria, juristin Jani Koçi, e kishin vizatur Ramiz Alinë në Tiranë kur ai ishte liruar nga burgju. Ato që Naserit i kishin bërë përshtypje gjatë takimit me Ramiz Alinë, kishte qenë ngrohtësia dhe thjeshtësia me të cilat ai i kishte pritur, urtësia e tij politike dhe qartësia e mendimeve, vitaliteti i tij trupor, mendor e shpirtëror, me gjithë moshën dhe tronditjet e mëdha nëpër të cilat kishte kaluar. Njohuritë dhe interesimi i Ramiz Alisë për Kosovën dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kosovë Lindore, dëshmonin se ai nuk ishte shkëputur aspak nga fati i Kosovës dhe i viseve saj.

Edhe presidenti Rugova së pakut njëherë gjatë vitit 1995 kur marrëdhëniet e tij me Salih Berishën ishin ftohur, në njërën nga konferencat e tij javore të shtypit kishte deklaruar se, “për Kosovën më së shumti ka kontribuar Ramiz Alia!”.

## ■ Në vitet e kthesës drejt luftës dhe lirisë!

### Shumëçka e kishte humbur kuptimësinë

Naser Hani vitet 1995/1996 ndër të tjera i kishte vlerësuar edhe si vite të kthesës së madhe të shqiptarëve në Kosovë e vise të saj drejt luftës dhe lirisë...

Për ta bërë shqiptarët kthesën e tillë kishte ndikuar mosmarrja në shqyrtim e çështjes Kosovës në Konferencën e Hagës, të mbajtur në kapërcyellin e viteve 1991/1992 dhe, sidomos, në konferencën e Dejtonit, të mbajtur në vitin 1995, pas ndodhjes së luftërave në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë. Mosmarrja në shqyrtim e çështjes së Kosovës në konferencat e tilla kishte qenë

e paradeteminuar me vet faktin se “Komisioni Këshillues i Banditerit” për ndarjen e ish-Jugosllavisë, të drejtën për shkëputje nga Jugosllavia ua kishte njohur vetëm gjashtë republikave të vendit, por jo edhe dy krahinave autonome të Jugosllavisë, siç kishte qenë Kosova dhe Vojvodina. Kjo kishte treguar qartë se Kosova nuk do të shkëputej nga ish-Jugosllavia, dhe se ajo në rastin më të mirë do ta gëzonte një autonomi duke mbetur pjesë e Serbisë. Në përputhje me realitetin e tillë ndërkombëtar për Kosovën që në fillim të viteve të '90 edhe Bashkimi Evropian edhe KSBE-ja nëpërmjet të Lordit Kerrington, ishin angazhuar Serbia t'ia njihte Kosovës një autonomi speciale, por Serbia as autonomi speciale s'kishte dashur t'i jepte Kosovës.

Realiteti i tillë i hidhur ndërkombëtar për Kosovën kishte bërë që tanimë edhe thëniet të përsëritura nga klasa politike e Kosovës, se “zgjidhja më e mirë për Kosovën do të ishte pavarësia e saj”, se “zgjedhja e çështjes së Kosovës do të bëhet me dialog demokratik dhe alternativë tjetër s'ka”, t'u kishte humbur kuptimësia e t'u kishte dalë boja. Por kush kishin qenë fajtorët e mostrajtimit të çështjes së Kosovës deri në Konferencën e Paqes së Dejtonit, për Naser Hanin dhe shumë veprimtarë të tjerë faji dhe fajtorët s'kishin qenë jetim!

Sipas tyre faj kishin pasur klasa politike e Kosovës së asaj kohe, e cila me komoditetin, mosseriozitetin me politikat e saj paqësore deri në gjumëvënie të masave popullore, faktorëve ndërkombëtar vendimmarrës s'ua kishte dhënë shansin, që ata çështjen e Kosovës ta trajtonin si një çështje të veçantë, duke ia njohur edhe Kosovës të drejtën e shkëputjes nga ish-Jugosllavia.

Ndonëse Qeveria e Kosovës e dalë nga zgjedhjet e “lira” të vitit 1992, përveç nga ana Shqipërisë, s'ishte njohur zyrtarisht nga asnjë vend tjetër i botës, dhe ndonëse ajo s'kishte themeluar më shumë se dy institucione, atë të presidencës në Kosovë dhe atë Qeverisë në Gjermani, megjithatë, deri në vitin 1995 ajo e kishte pasur rëndësinë e saj, sepse ishte prituri që ajo do ta përfaqësonte Kosovën dhe synimin e saj për t'u pavarësuar nga Serbia pikërisht në konferencat ndërkombëtare të sipërpërmendura.

Por tani që konferenca e Dejtonit Kosovën as që e kishte zënë në gojë, si zgjedhjet e “lira” të vitit 1992, si krijimi i qeverisë së Kosovës në egzil, ashtu edhe vizitat dhe pritjet që i ishin bërë presidentit Rugova në Amerikë dhe në disa vende të Evropës, duke mos u dukur në horizont asnjë zgjidhje serioze për Kosovën, e kishin humbur kuptimësinë dhe shkëlqimin e tyre të dikurshëm.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto tanimë rruga që ishte ndjekur për pavarësimin e Kosovës deri në prag të konferencës së Dejtonit ishte kuptuar si një bjerrje kohe. Kjo kishte qenë aq e vërtet saqë edhe njëri prej themeluesve të orëve të para të LDK-së, Mehmet Kraja, angazhimet politike joserioze dhe



të mefshta të LDK-së dhe të klasës politike të Kosovës ndër ato vite, i kishte vlerësuar si vite të humbura në librin e tij “Vite të humbura”.

### **Që mos t'i ikte Kosovës edhe “treni i fundit...”!**

Duke e analizuar realitetin e tillë në të cilin gjendej Kosova në vitin 1995 dhe në vazhdim, Naseri si edhe shumë shqiptarë të tjerë e kishte pyetur veten: Pse regjimi serb me disa pengesa të vogla e kishte “lejuar” mbajtjen e zgjedhjeve të “lira” gjatë vitit 1992 në Kosovë! Mos Serbia kishte planifikuar që duke mbetur shqiptarët me shpresë se ata kishin krijuar shtet, qeveri e president, të rrinin të qetë derisa një ditë ata në sajë të shpërnguljes së tyre nga Kosova të mbeteshin pakicë dhe kështu ajo t'i kryente punët me ta pa i përgjakur duart! Mos Serbia kishte planifikuar që shqiptarët duke bërë politika paqësore ta humbnin edhe shansin e fundit, atë luftës së armatosur, dhe për rrjedhojë Kosova duke mos u marrë në konsideratë në konferencat ndërkombëtare të lartpërmendura, mbetja e saj në kuadër të Serbisë bëhej në një akt i kryer!

Kishin qenë këto arsytet pse tani mijëra shqiptarë gjithandej Kosovës me vise, ishin bindur se kishte ardhur koha që klasa politike e Kosovës ta vinte në rend të ditës edhe alternativën tjetër, atë të luftës së armatosur. Por, meqë klasa politike e Kosovës sërisht kishte vazhduar me të vjetrën, kreatorët e qëndresës aktive të viteve të '80, tani të përkrahur edhe nga Lëvizja Studentore e viteve të '90, kishin vendosur që për çlirimin e Kosovës ta fillonin luftën e armatosur, në mënyrë që shqiptarëve të mos u ikte edhe “treni i fundit!”, sepse bota po merrej vetëm me fatin e atyre popujve Jugosllavisë, të cilët për bërjen e shteteve të tyre të pavarura kishin luftuar me Serbinë paraprakisht, dhe sepse shqiptarët as kishin më se çfarë të humbnin. Edhe nëse nuk do të luftonin, ata, Kosovën do ta humbnin nëpërmjet të shpërnguljeve të tyre nëpër botë, kurse nëse do luftonin e kishin shansin të fitonin. Por, edhe nëse s'do të fitonin së pakut nuk ta humbin Kosovën qqqarisht, duke i kaluar ata kufijtë e vendeve të Evropës perëndimore ilegalisht si zvarranikë, por do ta humbin me pushkë në dorë duke qëndruar vertikalisht, dhe së pakut diku në analet e historisë botërore do mbetej e shkruar, se shqiptarët për ta çliruar Kosovën nga Serbia i kishin përdorur të gjitha rrugët, përfshirë edhe luftën e armatosur, por s'ia kishin arritur qëllimit.

### **Shqiptarët kishin shanse të fitonin**

Duke e pasur parasysh se shqiptarët edhe kur s'e kishin pasur në anën e tyre qoftë edhe një aleat të vetëm, megjithatë, ata e kishin parë të arsyeshme që për bërjen e shtetit shqiptarë të bënin edhe luftë të armatosur, siç kishte ndodhur gjatë viteve 1878-1881 të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe gjatë viteve 1908-

1912 të pavarësimit të Shqipërisë, tani që dukej se në krah të tyre ishin renditur Amerika dhe deri diku edhe Evropa, ata kishin jo vetëm arsye për ta çliruar Kosovën edhe nëpërmjet të luftës së armatosur, por edhe kishin shumë më tepër shanse që të fitonin.

Vërtet, se shqiptarët në periudhën kohore midis Kongresit të Berlinit dhe Luftërave Ballkanike, kur ata kishin luftuar me armë kundër Perandorisë Osmane dhe shteteve fqinje ballanike kishin humbur dy të tretat e Shqipërisë Etnike, por shtrohet pyetja sa do të humbnin ata territore nëse brenda asaj periudhe kohore të mos u ishin kundërvënë me armë në dorë Perandorisë Osmane dhe shteteve fqinje ballkanike për krijimin e shtetit shqiptarë? Historia tanimë flet vet se sikur shqiptarët asokohe nuk do t'i kundërviheshin Perandorisë Osmane dhe vendeve ballkanike me luftë armatosur, ata s'do ta kishin as Shqipërinë e Ismail Qemajlit të vitit 1912 dhe kësajsoj do të mirrnin fund përgjithmonë.

Por, tani që sidomos Amerika ishte deklaruar pro çështjes së Kosovës, kurse Evropa në masë të konsiderueshme i kishte korrigjuar pikëpamjet e saj jo të mira ndaj shqiptarëve dhe Kosovës, të prisje duke e sositur humbjen e Kosovës nëpërmjet të shpërnguljeve masive të shqiptarëve në vende të ndryshme, siç kishte dashur të bënte klasa politike e Kosovës edhe pas vitit 1995, aq sa kishte qenë e mëkatshme po aq kishte qenë edhe e pafalshme.

Kishin qenë mendësitë e tilla politike të pjesës më atdhetare të rinisë së Kosovës dhe të kreatorëve të qëndresës aktive të viteve të '80, ato që midis viteve 1995/1996 e kishin bërë kthesën e madhe të shqiptarëve drejt luftës dhe lirisë!

## **Serbia midis “dy vijave të kuqe!”**

Siç dihet presidenti amerikan Bush (i vjetri) në vitin 1992 kishte deklaruar, se “Serbia e ka vinë e kuqe te Kosova”, duke e lidhur ai me këtë rast Kosovën me interesin nacional amerikanë, ndërkohë që të njëjtën gjë e kishte deklaruar edhe Presidenti Clinton në vitin 1995. Kështu, SHBA-të e kishin futur Serbinë midis “dy vijave të kuqe”, të cilat nuk kishin qenë tjetër veçse kërcënime të drejtuara Serbisë, se nëse ajo do ta sulmonte Kosovën duke ushtruar masakra dhe deportime masive të shqiptarëve, do të ndeshesh me intervenimin ushtarak amerikan.

Por, ashtu siç ecnin punët në Kosovë, Serbia as që kishte nevojë që t'i prekte “vijat e kuqe” që ia kishte vënë Amerika lidhur me Kosovën. Serbia vetëm pse shqiptarët e kishin ushtruar arsimin dhe shëndetësinë e tyre nëpër objekte private, ose pse ata kishin zgjedhur deputetë, qeveri e president, në një kohë që s'kishin aspak pushtet, as që kishte nevojë që t'i prekte “vijat e kuqe” në Kosovë. Brenda rrethanave të tilla Serbia ishte mjaftuar, duke i larguar pothuajse të

gjithë shqiptarët nga vendet e punës, duke ushtruar ndaj tyre shtypje etnike, përndjekje, burgosje dhe ndonjë vrasje, të mjaftueshme këto që ata të mos shihnin rrugë tjetër, përveç rrugëve të botës nëpër të cilat kishin marrë arratinë. Kështu, për Serbin as që kishte pasur rrugë më të mirë se kjo, për t'i qëruar hesapet me shqiptarët ashtu gradualisht e spontanisht dhe pa marrë asnjë përgjegjësi e asnjë ndëshkim.

Por kreatorët e qëndresës aktive të viteve të '80, “dy vijat e kuqe” të cilat Amerika ia kishte vënë Serbisë të Kosova, kishin filluar t'i shikonin edhe në prizmin tjetër, duke i konsideruar ato edhe si një sinjal i tërthortë i Amerikës për shqiptarët, se nëse ata donin të kishin një Kosovë të lirë dhe të pavarur, ishte dashur të bënin diçka më shumë për Kosovën. Dhe çfarë ishte dashur të bënin shqiptarët diçka më shumë për Kosovën, këtë e kishte treguar tërthorazi ambasadori amerikan në Beograd, kur atë gjatë në konferencë shtypi e kishte pyetur një gazetar, pse Kosova në konferencën e Dejtonit as që ishte përmendur! Ambasadori amerikanë me këtë rast ishte përgjigjur shkurt e qartë se: “Në Dejton janë ftuar vetëm ato vende dhe ata popuj që kanë luftuar!”. Përgjigja e tillë e ambasadorit amerikan lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të çështjes së Kosovës në Konferencën e Dejtonit, i kishte fajësuar tërthorazi edhe shqiptarët, të cilët duke mos luftuar kundër Serbisë për çlirimin e Kosovës, as që ia kishin dhënë shansin Amerikës dhe faktorëve tjerë ndërkombëtar që ata në atë konferencë ta trajtonin edhe çështjen e Kosovës.

Vërtet, se Amerika dhe Evropa krerëve të klasës politike të Kosovës ua kishin sugjeruar rrugën paqësore për t'i zgjidhur problemet me Serbinë, por Amerika dhe Evropa as Sllovenisë, as Kroacisë dhe as Bosnjës nuk ia kishin sugjeruar luftën e armatosur. Por meqë Serbia s'e kishte njohur rrugën e marrëveshjes dhe të dialogut, sllovenët, kroatët dhe boshnjakët ishin detyruar që t'i kapnin armët për çlirimin e republikave të tyre nga Serbia. Mbase Kosova duke qenë një rast tjetër në krahasim me Sllovenin, Kroacinë dhe Bosnjën, ajo kishte bërë mirë që deri në vitin 1995 nuk i ishte qasur çlirimit të Kosovës me luftë të armatosur. Por pas këtij viti dhe pas Konferencës së Dejtonit, shqiptarët s'kishin pasur më asnjë arsye që çlirimit të vendit të tyre të mos ia mësynin edhe me luftë të armatosur.

## **Fillimi i luftës së armatosur**

Duke i pasur parasysh rrethanat e lartpërmendura Ushtria Çlirimtare të Kosovës (UÇK-ja), e cila ishte themeluar e krijuar gradualisht midis viteve 1991-1993, në marsin e vitit 1996 ishte shfaqur zyrtarisht duke i marrë përsipër nëpërmjet komunikatave të Shtabit të saj të Përgjithshëm, sulmet guerile, të

cilat i kishte organizuar kundër policisë serbe nëpër stacionet policore gjithandej Kosovës. Ishte parë qartë se themeluesit e UÇK-së nuk ia kishin lejuar vetës, që shqiptarët duke i soditur “dy vijat e kuqe” që Amerika ia kishte vënë Serbisë të Kosova, të qëndronin në vend pa bërë asgjë, ndërkohë shanse të tilla historike, sidomos për shqiptarët, mund të ndodhnin njëherë në 100 vjet!

Kështu, marsi i vitit 1996 e kishte shënuar fillimin e luftës së armatosur për çlirimin e Kosovës.

Shqiptarët të cilët kishin pasur sy për ta lexuar dhe vesh për ta dëgjuar tiktakun e orës së historisë, fillimin e luftës së armatosur për çlirimin e Kosovës e kishin pritur me optimizëm dhe entuziazëm të madh. Dalja me aksione luftarake e UÇK-së për shumicën e shqiptarëve kishte paraqitur sihariqin më të madh të mundshëm, sepse UÇK-ja ishte shfaqur pas shumë vitesh durimi që kishin bërë shqiptarët në emër të politikës paqësore, duke mos iu kundërpërgjigjur bëmave të policisë serbe me asgjë.

Durimi i tillë i tepruar kishte ndikuar që shqiptarët ta kishin humbur aq shumë guximin dhe besimin në veten e tyre, sa që ata tani e kishin vështirë të besonin, se vërtet kishte shqiptarë që guxonin t’ia kthenin pushkën Serbisë. Skepticizmi i tillë bashkë me deklaratat destruktive të disa figurave politike të Kosovës kishin ndikuar që nga një pjesë e vogël e shqiptarëve të vihej në dyshim dalja në skenë e UÇK-së. Kësisoj nga kjo pjesë e shqiptarëve, ishte thënë se ata që po i sulmonin stacionet policore serbe kishin qenë bashkëpunëtorë të Serbisë, të cilët kishin dashur që t’ia jepnin asaj shkasin për ta bërë Kosovën “pluhur e hi” etj.

## ■ Me Luftën Çlirimtare të Kosovës

### Në përkrahje të UÇK-së dhe të fondit të saj

Lufta Çlirimtare e Kosovës Naser Hanin e kishte gjetur në Austri, ku ai me tërë qenien e tij ishte vënë në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) dhe të fondit të saj me emrin “Vendlindja thërret”.

Që në fillim të vitit 1996 kur UÇK-ja i kishte shpeshtuar sulmet e saj të armatosura kundër forcave policore serbe në Kosovë, Naser Hani së bashku me Abdullah Abdullahun, Januz Saliukën, Xhevat Balajn, Kadrush Qollakun dhe me të tjerë, e kishin themeluar dhe e kishin vënë në shërbim të UÇK-ës dhe të fondit të saj “Bashkësinë Shqiptare në Austri” me seli në Vjenë.

Mëtej, Naseri bashkë me studentët Fadil Tutuli, Ylber Hasani, Nuri Bexheti, Avni Sadria dhe Liri Ramadani e kishin themeluar dhe e kishin vënë në shërbim të UÇK-ës edhe “Shoqatën e studentëve shqiptarë në Austri”.

Dhe së fundi, Naseri e kishte themeluar dhe e kishte vënë në shërbim të UÇK-së edhe “Shoqatën e Veleshtarëve në Austri”.

Në shoqatat e sipërpërmendura, duke filluar nga viti 1996 e deri më 1999, ishin mbajtur shumë takime të përmasave të vogla e të mëdha me veprimtarë dhe me mërgimtarë shqiptarë të të gjitha viseve, të cilët i kishin dhënë ndihmat e tyre financiare në fondin “Vendlindja thërret”.

Naseri, ndonëse kishte qenë nismëtar i themelimit të shoqatave të tilla, ai vetë s'ishte bërë kryetar i asnjërës prej tyre. Kështu kishte vepruar, jo vetëm sepse ai s'kishte pasur asnjë pretendim për veten, por edhe pse kishte dashur të ishte sa më i lirë që të iniciohte edhe aksione të tjera të ngjashme në mbështetje të UÇK-së.

### **Në shërbim të UÇK-së edhe me veprimtarë të lirë**

Në propagandimin e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe të fondit “Vendlindja thërret”, ishte angazhuar në radhë të parë dega e LPK-së për Austrinë në krye me Xhevat Xhemailin, Shyqyri Bytyçin; Eset Beranin, Naser Osmanin e të tjerë, të cilët gjithandej Austrisë kishin mbajtur tubime me mërgimtarët shqiptarë. Por, e veçanta e Naserit ishte se ai në mbështetje të UÇK-së kishte bashkëvepruar edhe veprimtarë të lirë, siç kishin qenë ata të shoqatave të lartpërmendura si dhe me të tjerë jashtë shoqatave të tilla, siç kishin qenë p.sh: Bafti Alia, Jani Koçi, Nasuf Kamberi, Avdyl Gjoci dhe të tjerë.

Kështu, Naseri, gjatë viteve të luftës në Kosovë herë me shokë të LPK-së e herë me veprimtarë të lirë, kishte organizuar dhe kishte marrë pjesë në tubime me mërgimtarë nëpër të gjitha Landet (krahinat) e Austrisë.

### **Në përkrahje të UÇK-së edhe në Zvicër**

Nga ana tjetër, Naser Hani gjatë viteve 1996-1998 kishte qenë shumë herë në Zvicër. Me këtë rast ai ishte takuar me shumë veleshtarë, si me Ibni Kicën, Qashif Hanin dhe me të tjerë, duke bërë që edhe “Shoqata e Veleshtarëve në Zvicër” ta mbështeste UÇK-në dhe fondin “Vendlindja thërret”.

Gjatë vizitave të tij në Zvicër ai në të mirë të UÇK-së dhe të fondit “Vendlindja thërret” ishte takuar edhe me shokun dhe mikun e tij të vejetër, Bardhyl Mahmutin, i cili ishte përfaqësues politik i UÇK-së në Zvicër, ashtu siç ishte takuar edhe me shokë të tjerë të pranverës së madhe të vitit 1981, siç kishin qenë Xhavit Haliti, Sabit Veseli, Ramadan Avdiu, Mehmet Bislimi, Halit Naxhaku etj. Takime të veçanta ai kishte pasur edhe me kryetarin e Fondit “Vendlindja thërret”, Jashar Salihun, të cilin e kishte parë dikur para shumë vitesh në tribunën e pajtimit të gjaqeve të Verrat e Llukës në Kosovë. Jashar Salihun ai e kishte informuar shumë herë lidhur me ecurinë e fondit “Vendlindja

thërret” në Austri. Por, në Zvicër Naseri ishte njohur edhe me shokë të tjetër të cilët nuk i kishte njohur më parë, si me Xhavit Hoxhën, vëllain e dëshmorit Edmond Hoxha, me Ibish Nezirin, Gani Fetën dhe Salih Sadikun, të cilët po ashtu ishin vënë në shërbim të Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe të UÇK-së.

Dhe natyrisht se Naseri sa herë vinte në Zvicër më vizitonte edhe mua në qytetin e Cyrihut. Pasi qëndronte një ditë te unë dhe pasi që bisedonim për tema të ndryshme deri natën vonë, ai të nesërmen e merrte rrugën e kthimit për në Vjenë. Edhe sot më kujtohet kur, derisa treni në stacionin hekurudhor të Cyrihut nisej drejt Vjenës, ne e përshëndesnim njëri-tjetrin me dorë, me shpresë se do të takoheshin herën tjetër.

### **Tubime me pyetje provokative**

Përçarjet dhe paragjykimet që në mesin e shqiptarëve lidhur me UÇK-në i kishin futur një grusht gazetarësh e publicistësh destruktiv, nëpërmjet të artikujve të tyre të botuar në dy-tri gazeta në gjuhën shqipe, ishin reflektuar edhe në tubimet e organizuara kryesisht nga LPK-ja për përkrahjen e UÇK-së dhe të fondit “Vendlindja thërret”, të cilat ishin mbajtur me shqiptarët gjithandej Evropës perëndimore e deri në Amerikë.

Kështu, me qëllim të prishjes së tubimeve të tilla në përkrahje të UÇK-së, ishin paraqitur herë pas here edhe mërgimtarë, të cilët përfaqësuesve të fondit “Vendlindja thërret” u kishin shtruar pyetje të ndryshme provokative. Por, kundër individëve të tillë, ende pa reaguar kryesuesit e tubimeve, kishte reaguar ashpër masa e mërgimtarëve, e cila e kishte përkrahur UÇK-në pa asnjë rezervë. Kësisoj në mesin e mërgimtarëve të shumtë dhe provokatorëve të pakët ishin shkëmbyer fjalë të rënda dhe bile edhe kërcënime të ndërsjella. Për t’i evituar konfliktet dhe vrasjet e mundshme midis të pranishmëve, kryesuesit e tubimeve kishin ndërhyrë vazhdimisht për qetësimin e situatës. Në sajë të kujdesit të tillë në asnjë tubim të organizuar në përkrahje të UÇK-së, nuk ka ndodhur qoftë edhe një konflikt i vetëm fizik.

Edhe Naser Hanit i kishte rënë që në qytetin e Vjenës të ishte konfrontuar ashpër me dy gjoja politikanë shqiptarë, njëri nga Kosova e tjetri nga Maqedonia, të cilët kishin ardhur në Austri për ta denigruar UÇK-ën para mërgimtarëve me shpifje e fyerje nga më të ndyrat. Duke i njohur mirë se kush ishin këta “politikanë”, Naseri u kishte dhënë atyre përgjigjen e merituar. Por kur masa e mërgimtarëve kishte dashur që “politikanët” të tillë t’i sulmonte fizikisht, ai i kishte shpëtuar ata duke i qetësuar mërgimtarët.

## **“Loja” me një dezinformatë**

Gjatë vitit 1998 sidomos në Zvicër ishte përhapur dezinformata sipas të cilës zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, e kishte braktisur UÇK-në dhe ishte vendosur në Zvicër. Kështu, në tubimet e mbajtura në përkrahje të UÇK-së në Zvicër por edhe në vende të tjera, herë pas here ndonjëri nga pjesëmarrësit i kishte pyetur kryesuesit e tubimeve të tilla, se “A është e vërtetë se Jakup Krasniqi ka ikur nga Kosova dhe është vendosur në Zvicër, sepse po flitet se ai është parë qytetin e Cyrihut”? Në tubime të tjera mërgimtarë të tjerë e kishin shtruar po të njëjtën pyetje, duke thënë se Jakup Krasniqi ishte parë në Bernë, në Lozanë, në Gjenevë e kështu me radhë, ndërkohë që kryesuesit e tubimeve e kishin ditur qind për qind se Jakup Krasniqi ishte në Kosovë.

Duke e analizuar me Naserin këtë dezinformatë mendonim se atë fillimisht do ta ketë sajuar një bashkëpunëtor shqiptar i shërbimit sekret serb, i cili pastaj me telefon e ka bartur te dy-tre shqiptarë të tjetër pak a shumë kundërshtarë të UÇK-së, kurse këta të fundit pastaj e kanë bartur edhe më tej, dhe kështu duke qenë “lajmi” i tillë sensacional kishte marrë dhenë. S’ka dyshim se dezinformata e tillë kishte pasur për qëllim përhapjen e dëshpërimit në mesin e përkrahësve UÇK-së sikur gjoja ajo e kishte marrë tatëpjetën.

## **■ Shqipëria prapavijë shtetërore e Luftës Çlirimtare të Kosovës**

### **Mbështetje shtetërore dhe institucionale**

Kosova gjatë luftë çlirimtare e kishte Shqipërinë një prapavijë shtetërore me rëndësi kyçe. Qeveria shqiptare dhe institucionet e saj e kishin përkrahur Kosovën duke e përkrahur UÇK-ën: Moralisht, politikisht, profesionalisht, dhe për aq sa ishte e mundur për shkak të monitorimit ndërkombëtar, edhe me armatime e logjistikë. Siç tregonte edhe Naseri që gjatë viteve 1997/1998 kishte qenë herë pas here në Shqipëri, Presidenca, Kryeministria, Ministria e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ kombëtar, ishin vënë në funksion të luftës çlirimtare në Kosovës me të gjitha mjetet në disponim.

Lidhjet e para midis përfaqësuesve të UÇK-së dhe përfaqësuesve të SHBA-ve i kishte vënë kryesisht Ministria e Jashtme dhe Shërbimi Informativ i Shqipërisë, duke ia mundur kështu UÇK-së mbështetjen ndërkombëtare. Sidomos strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shërbimit Informativ u ishte dashur që t’i tejkalonin shumë barrierat ndërkombëtare për ta mbështetur UÇK-ën.

## **Mbështetje me gjithë vrojtimin ndërkombëtar**

Shqipëria, me gjithë pengesat ndërkombëtare që kishte pasur kishte lejuar që në territorin e saj të vendosej, të organizohej dhe të armatosej UÇK-ja, e cila duke i kaluar kufijtë verior të vendit ishte futur në Kosovë për t'i luftuar forcat ushtarako-police të Serbisë.

Gjeneral Kudusi Lama, asokohe komandat i divizionit të Kukësit dhe përgjegjës për vijën kufitare të Shqipërisë me Kosovën, e kishte mbështetur luftën çlirimtare dhe UÇK-ën edhe përtej të lejueshmes. Ai e kishte mbështetur sidomos luftën e Koshares me të gjitha mjetet që i dispononte divizioni i Kukësit. Duke qenë i përkushtuar me mish e me shpirt për çlirimin e Kosovës, gjeneral Kudusi Lamën në shenjë respekti të gjithë e kishin thirrur “Babush!”, përfshirë këtu edhe përfaqësuesit kryesorë të UÇK-së në Shqipëri e në Kosovë. Gjeneral Kudusi Lama ishte i vendosur që nëse NATO-ja s'do të intervenonte ushtarakisht kundër Serbisë, ai me ose pa lejen e qeverisë në Tiranë do të futej në Kosovë me divizionin e Kukësit dhe me mijëra rekrut nga Kosova, të cilët kishin qenë në Shqipëri.

Duke qenë Shqipëria një prapavijë e fuqishme shtetërore, institucionale dhe gjithëpopullore dhe e luftës në Kosovë, ishte bërë e mundur që UÇK-ja për rreth një vit e gjysmë të kishte luftuar pa ndonjë ndihmë të jashtme kundër ushtrive e policive serbe shumë herë më të mëdha e më të armatosura se ajo, gjë që kishte rezultuar me administrimin e një të tretës së Kosovës nga ana e UÇK-së.

## **Mbështetje edhe me kuadro profesionale**

Por, Shqipëria e kishte mbështetur UÇK-ën edhe me kuadro profesionale. Kuadrot ushtarake të nomenklaturës së vjetër dhe të re të Shqipërisë, e kishin ndihmuar UÇK-ën organizativisht, taktikisht dhe moralisht, kurse një pjesë e tyre edhe kishte marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime. Disa prej ushtarakëve të tillë kanë rënë dëshmor në fushat e luftës. Kolonel Tahir Sinani nga rrethi i Tropojës kishte rënë dëshmor në luftën e UÇK-së në Maqedoni, kurse Indrit Cara nga qyteti i Kavajës i cili kishte qenë me akademi të kryer ushtarakë, i ishte bashkangjitur UÇK-së duke ardhur nga Londra. Edhe Indrit Cara në luftime e sipër kundër forcave serbe kishte rënë dëshmor i Kosovës. Por, UÇK-së i ishin bashkangjitur edhe shumë luftëtar të thjeshtë nga Shqipëria.

Ushtarakë të tjerë të nomenklaturës së kaluar të Shqipërisë e kishin përkrahur UÇK-në që në nismën e saj, që kur ajo kishte qenë ende vetëm frymëzim dhe ide. Këta ushtarakë me dijet e tyre profesionale dhe me përkushtimin e tyre atdhetar i kishin inkurajuar ata djem e burra nga Kosova, të cilët në fillim të viteve të '90 e kishin themeluar UÇK-në. Ushtarakët e tillë nga Shqipëria, siç



kishin qenë Refik Kuca dhe disa të tjerë, kishin pasur fatin të jenë “nunët” e parë të UÇK-së.

### **Mbështetje e fuqishme nga shumë intelektualë dhe personalitete**

Lufta Çlirimtare e Kosovës dhe të UÇK-ja ishin përkrahur nga shumë personalitete të Shqipërisë, qindra intelektualë, politikanë, publicistë e gazetarë.

Njëri prej tyre ishte edhe intelektual i letrave shqipe dhe politikani i matur, Shaban Sinani, i cili me të dalë UÇK-ja në skenë e kishte konsideruar veten ushtar të saj. Ai me shkrimet e tij pro UÇK-së në gazetën “Zëri i Kosovës”, të botuar në Zvicër dhe të shpërndarë në disa vende të Evropës perëndimore, kishte bërë që shumë shqiptarë ta përkrahnin Luftën Çlirimtare të Kosovës dhe UÇK-në. Intelektualë të tjerë nga Shqipëria, të frymëzuar nga lufta e UÇK-së, kishin bërë qindra, në mos edhe mijëra, artikuj për Kosovën dhe UÇK-ën në mediat e shkruara.

Një personalitet tjetër nga Shqipëria për të cilin Naseri edhe pse nuk e kishte njohur nga afër kishte pasur respekt, ishte edhe Bedri Islami nga Shkodra me qëndrim në Gjermani, i cili pikërisht gjatë viteve të luftës në Kosovë ishte në krye të LPK-së, organizatës ilegale prej të cilës kishte lindur UÇK-ja. Për ta mbështetur shteti shqiptar sa më shumë luftën e UÇK-së, ai kishte organizuar disa takime me radhë midis përfaqësuesve kryesorë të shtetit shqiptar dhe atyre të UÇK-së. Për t'i sqaruar sa më shumë shqiptarët lidhur me luftën e drejtë të UÇK-së, ai ka bërë dhjetëra shkrime analitike të cilat botoheshin në gazetën “Zëri i Kosovës”. Për t'u përkrahur UÇK-ja nga kurbetçarët shqiptarë, për t'u fuqizuar fondi i saj “Vendlindja thërret”, dhe për t'i nderuar dëshmorët e Luftës Çlirimtare të Kosovës, ai së bashku me veteranin e çështjes shqiptare, Hasan Ukëhaxhën, ish-profesorin e dikurshëm të gjimnazit të Deçanit, e kishin thënë fjalën e tyre para mijëra përkrahësve të UÇK-së gjithandej Evropës perëndimore e më tej.

### **Mbështetje gjithëpopullore dhe institucionale**

Masat popullore të Shqipërisë, ishin ato që armët e rrëmbyera nga kazermat në vitin 1997, duke ia falur ose duke ia shitur ato me çmime të ulëta UÇK-ës e kishin furnizuar atë me armë. Armatosja e tillë e UÇK-së kishte qenë e një rëndësie të dyfishtë, sepse ajo, në njërën anë, kishte shërbyer si një “mbulesë” për atë pjesë të armatimeve që shteti shqiptar ia kishte dhënë UÇK-së, kurse, nga ana tjetër, e kishte ulur sasinë e armëve në duart e popullit në Shqipëri.

Mbi të gjitha, populli i Shqipërisë e kishte treguar solidaritetin vëllazëror

ndaj shqiptarëve të Kosovës, duke i hapur dyert dhe zemrat e tyre për afro 700 mijë shqiptarë, të cilët ishin deportuar nga Kosova në Shqipëri kryesisht gjatë muajve prill, maj e qershor të vitit 1999. Solidariteti i tillë ndërsqiptarë e kishte mahnitur tërë botën.

Për Naser Hanin dhe shumëkënd tjetër heroike kishte qenë sidomos kërkesa e kryeministrit të Shqipërisë, zotit Pandeli Majko, drejtuar qeverisë maqedone, që ajo qindra mijëra refugjatë nga Kosova, të cilët ishin vendosur në Maqedoni, të mos i largonte në katër anët e botës, por t'i lejonte që të hynin në Shqipëri.

Në spitalin ushtarak në Tiranë dhe në spitalet tjera të Shqipërisë, kishin marrë ndihmë mjekësore falas qindra ushtarë dhe civilë të plagosur nga Kosova, si dhe mijëra refugjatë të vendosur në Shqipëri.

Edhe policia shqiptare, përveç në disa raste të veçanta, të shumtën e herëve ishte treguar tolerante ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilët nëpër Shqipëri kishin lëvizur në të mirë të UÇK-së apo nga hallet e shumta që ata kishin pasur.

## **Prova e parë e bashkimit kombëtar**

Shqipëria, duke pranuar rreth 700 mijë refugjatë të luftës nga Kosova kishte bërë një udhë shumë punë: E kishte treguar veten para shqiptarëve të Kosovës së ajo kishte qenë dhe kishte mbetur vendi i tyre amë; e kishte penguar degdisjen dhe spastrimin etnik të refugjatëve shqiptarë në katër anët e botës; e kishte mundësuar kthimin e shqiptarëve të përzënë nga forcat serbe në Kosovë, si dhe e kishte bërë edhe “provën e parë të bashkimit kombëtar!”.

Prova e parë e bashkimit kombëtar, e realizuar në fatkeqësinë e luftës, tregonte se shqiptarët e Shqipërisë dhe ata të Kosovës, s'kishin qenë për njëri-tjetrin as më shumë e as më pak se vëllezër të një gjuhe, të një tradite, të një lëkure e të një kulture. Refugjatët nga Kosova kishin qëndruar për muaj të tërë në Shqipëri nga Tropoja e deri në Durrës, nga Shkodra e deri Gjirokastrë. Shqiptarët e Shqipërisë, me ndonjë përjashtim të rrallë, i kishin pritur njerëzisht e vëllazërisht shqiptarët e Kosovës, të cilët tragjeditë e luftës i kishin përjetuar më lehtë duke qenë midis vëllezërish e motrash kudo nëpër Shqipëri.

Kjo dëshmonte se shqiptarët e te dy anëve të kufirit shqiptaro-shqiptar, do të mund të jetonin bashkë në harmoni vëllazërore brenda një Shqipërie të vetme dhe të bashkuar, të aspiruar tanimë përmbi një shekull nga të gjithë shqiptarët.

## **Fitore e përbashkët Kosovë-Shqipëri**

Duke qenë lufta për çlirimin e Kosovës një luftë e drejtë, duke qenë UÇK-ja një ushtri e rregullt e cila nuk kishte bërë masakra ndaj civilëve serbë e malazez, duke qenë Shqipëria një prezantuese e denjë e çështjes së Kosovës në qarqet

ndërkombëtare vendimmarrëse, të gjitha këto bashkë edhe me krimet e ushtrive të Millosheviqit ndaj shqiptarëve, dhe bashkë me interesat gjeostrategjike e gjeopolitike të Fuqive të Mëdha të botës perëndimore, kishin bërë të mundur që duke filluar nga 24 marsi i vitit 1999 e deri me 10 qershor të atij viti NATO-ja t'i kishte goditur nga qielli caqet ushtarake serbe në Kosovë dhe në Serbi.

Natyrisht se Shqipëria duke qenë vendi amë i të gjithë shqiptarëve në Ballkan e jashtë tij, territorin dhe hapësirën e saj ajrore e kishte vënë në dispozicion të forcave të NATO-së, të avionëve të saj luftarakë, të cilët ishin nisur nga baza e “Avianos” në Itali dhe duke kaluar përmbi Shqipëri i kishin goditur caqet ushtarake të Serbisë.

Nga ana tjetër, në mbështetje politike dhe morale të delegacionit të Kosovës të kryesuar nga Hashim Thaçi në Rambuje e në Parsis, ishte gjendur ministri i jashtëm i Shqipërisë, zoti Paskal Milo me këshilltarët e tij, si dhe vetë shkrimtari i njohur shqiptar, Kadere dhe të tjerë. Të gjithë këta kishin bërë që delegacioni i Kosovës në konferencën e Rambujesë, të mos ishte ndier pa krahë në ato momente kyçe për fatet e Kosovës...

Për të gjitha këto Naseri gjykonte se Kosova fitoren e saj të luftës çlirimtare, e cila në qershorin e vitit 1999 kishte rezultuar me largimin e forcave ushtarako-policore serbe dhe me futjen e trupave të NATO-së në Kosovë, duhej ta konsideronte si një fitore të përbashkët me Shqipërinë. Pa Shqipëri nuk do mund të kishte as ushtri çlirimtare dhe as luftë çlirimtare në Kosovë. UÇK-ja pa Shqipëri, jo vetëm që s'do ta kishte avokaten e saj para faktorit ndërkombëtar, por ajo edhe nuk do të mund të furnizohej me armatime nga asnjë anë tjetër, sepse të gjitha vendet fqinje me Kosovën do të ishin kundër saj, dhe për rrjedhojë ajo do të asgjësohej që në fillimet e saj.

Më tej, Kosova pa Shqipëri do të përfaqësonte edhe një “pazar” të vogël dhe një çështje minore për t'u angazhuar bota për çlirimin e saj. Ata që e kishin ndihmuar çlirimin e Kosovës “pazarin e saj” e kishin llogaritur bashkë me atë të Shqipërisë. Ata kishin llogaritur Shqipëria + Kosova = bëjnë kaq banorë, kaq hapësirë në kilometra katror, kaq resurse ekonomike, kaq pikë gjeopolitike dhe gjeostrategjike e të tjera, dhe kishin vendosur ta godasin Serbinë e Millosheviqit.

Kishin qenë këto arsytet pse për Naser Hanin s'kishte pasuar asnjëherë Shqipëri të keqe, por vetëm Shqipëri të mirë. Kushdo që të kishte qenë në krye të Shqipërisë, Shqipëria kishte qenë gjithnjë Shqipëri. Brenda saj atdhetarët nga Kosova kishin gjetur gjithnjë strehë, pak bukë e pak kripë dhe një pushkë, qoftë edhe të ndryshkur, për ta luftuar Serbinë.

## ■ Kishte dashur t'i bashkohej UÇK-së

Më sa më kujtohet në pranverën e vitit 1998, Naseri, pasi që ishte takuar me veleshtarët e tij në Zvicër qëndroi një ditë edhe te unë në Cyrih. Pasi që në mbrëmje morëm pjesë në një tubim me shqiptarët në qytezën e Ucnah-ut lidhur me fondin “Vendlindja thërret” ku iu dha fjala edhe Naserit, dikur vonë u kthyem në banesën time në Cyrih. Por, derisa po bisedonim për tema të ndryshme Naseri më tha se kishte vendosur që të shkonte në Shqipëri, dhe së bashku me rekrutët të tjerë të futej në Kosovë për t'iu bashkuar UÇK-së. Kështu ai donte të vepronte jo vetëm për shkak të përkushtimit të tij për çlirimin e Kosovës, por edhe pse derisa disa shokë të tij të viteve të rinisë ishin vrarë në frontet e luftës, atij i ishte dukur sikur vetes i kishte “gjetur rehati”, duke qëndruar në Austri dhe duke u marrë me fondin “Vendlindja thërret”.

Duke i thënë se ai edhe në prapavijë të luftës nuk po bënte pak, u mundova ta bindë që mos shkonte në Kosovë, por ai s'u bind. Të nesërmen mbrëma u nisë me tren nga stacioni hekurudhor i Cyrihut drejt Vjenës për të udhëtuar pastaj drejt Shqipërisë, ku së bashku me të tjerë do të merrte rrugë drejt Kosovës. Derisa treni i dedikuar për Vjenë mori udhë, unë e përshëndeta Naserin, duke ia bërë me dorë.

Duke e pasur parasysh se ai do të futej në Kosovë thashë me vete: Ndoshta do vritet në luftë dhe nuk do ta shoh më kurrë!

## Zëri që po më fliste ishte i Naserit!

Pas disa ditësh pikërisht në përputhje me paragjykimin tim të keq, në lajmet e televizionit shqiptar ishte prezantuar një grup rekrutësh të UÇK-së, të cilët ishin vrarë në vijën kufitare Shqipëri-Kosovë nga ana e forcave serbe në pritë. Në mesin e rekruteve të vrarë ishte parë edhe një rekrut me pamje identike si të Naserit. I bindur se rekruti i vrarë kishte qenë Naseri ika në dhomën tjetër dhe fillova të qajë, sepse Naserin përveç se e kisha shok të ngushtë, atë edhe e kisha përcjellë nga dera ime para një jave.

Por, ajo që po më befasonte ishte se askush lidhur me rënien e Naserit në kufi s'po më telefononte, gjë që s'kishte ndodhur kur ishin vrarë shokët e tjerë. Meqë fillova të dyshoj nëse rekruti i vrarë ishte apo nuk ishte Naseri, të nesërmen shkova të shoku i tij i vjetër, te Sabit Veseli që të merrja vesh nëse ai kishte ditur gjë për këtë. Por edhe ai, pos që më tha se një rekruti i vrarë i ishte dukur si Naseri, nuk dinte asgjë më shumë.

Në natën e të nesërmes në banesën time cingëroi telefoni të cilin e kapa me frikë, sepse mendova se ndoshta dikush do të ma jepte lajmin e rënies së Naserit në kufi. Por, derisa e kapa telefonin ndodhi çudia! Zëri që po më fliste ishte i Naserit!

- Naser a je gjallë, ku je, - i thashë menjëherë. - “Gjallë jam, gjallë doktor, jam në Shqipëri. Po mos je mërzhitur ti me ato pamjet në televizion, sepse një rekrut i vrarë është dukur si të isha unë” - më pyeti ai mua. - E si s'jam mërzhitë kur ai djali i vrarë dukej krejt si ti. E edhe ai po më dhimbset, por ndryshe është kur s'e njeh. - Po ti, a për këtë punë më thirrë? - e pyeta unë. - “Po, për këtë punë të thirra, se e dija se do të kesh menduar se kam qenë unë”- ma ktheu ai. - Po, pikërisht ashtu kam menduar dhe bile edhe të kam qarë me lot, - i thash duke bërë shaka, dhe shtova - pra, dije se unë s'të qaj dy herë! Tani e pas edhe nëse vritesh s'të qajë më! “Mirë, mirë, por ti e di se jeta i ka të gjitha”, - mu përgjigj ai duke qeshur. - Po atje a do të shkosh, - i thashë duke menduar për në Kosovë. - “Jo, jo, tani për tani nuk shkoj. Më është thënë se s'duhet të shkoj. Pas ndonjë dite do të kthehem në Austri” - m'u përgjigj. Po erdhe këtej nga Zvicra patjetër të kthehesh edhe te unë, sepse dua të të shoh të gjallë edhe një herë!, - i thashë duke i dëshiruar natën e mirë.

### **Lufta Çlirimtare e Kosovës kishte filluar në vitin 1981**

Për Naser Hanin Lufta Çlirimtare e Kosovës e bërë nga UÇK-ja midis viteve 1997-1999, nismën e saj e kishte pasur në vitin 1981, kur rinia dhe populli ishin ngritur në demonstrata masive për bërjen e Kosovës Republikë. Vetë parulla “Republikë e Kushtetutë ja me hatër ja me luftë!”, e cila ishte bartur dhe thirrur gjatë demonstratave të vitit 1981, kishte treguar se rinia studentore dhe ajo e shkollave të mesme, herëdokur do t'i përvishej çlirimit të Kosovës me luftë të armatosur.

Që nga ajo kohë kishin kaluar mbi pesëmbëdhjetë vjet kur UÇK-ja në nëntorin e vitit 1997 e kishte bërë veten publike, duke deklaruar përfaqësuesit e saj se ajo kishte qenë një ushtri e rregullt, legale dhe legjitime për çlirimin e Kosovës me forcën e armëve. Ishin dashur mbi pesëmbëdhjetë vjet, tanimë nga viti i largët 1981, që rinia e Kosovës duke u ngritur e duke rënë, e kishte pjekur idenë e luftës çlirimtare. Vetë demonstrata e rinisë studentore e 1 tetorit të vitit 1997 në përkrahje të UÇK-së në Prishtinë, të cilës i kishte prirë rektori i Universitetit të Kosovës, profesor Ejup Statovci, tregonte se UÇK-ja bazën kryesore mbështetëse e kishte te rinia.

### **Kishte vendosur të kthehej në Maqedoni**

Në vjeshtën e vitit 1998, Naseri, duke qëndruar për disa ditë në Zvicër, u kthye sërish edhe te unë në Cyrih. U gëzova shumë që po e shihja sërish të gjallë, por nuk e dija se ai kishte qenë takimi ynë i fundit.

Gjatë këtij takimi Naseri me tregoi se pasi që s'ishte bërë puna që t'i bashkohej

UÇK-së në Kosovë, kishte vendosur që të kthehej në Maqedoni, sepse qeveria maqedone tanimë kishte vite që shqiptarët të cilët kishin qenë dikur pjesë e organizimit politiko-territorial të Iliridës i kishte amnistuar. Me këtë rast ai i përmendi disa individë të cilët kishin qenë pjesë e organizimit të tillë, dhe tanimë kishte vite që ishin kthyer në Maqedoni dhe s'i kishte ngacmuar kush. U befasova me vendimin e tij dhe i thashë: - Mos po ngutësh se “uji fle e hasmi s'fle”!. Ty veç ta ka mësyre njëherë se shërbimi sekret maqedon në vitin 1993 dhe kjo flet se ai shërbim mund të ta mësyjë sërish. Desha t'i them se ti vetë disa herë me ke thënë se herdokur ka me të vra shërbimi sekret maqedon, por duke e parë se ai s'po bindej i thashë: - Ti i di rrethanat në Maqedoni, por duhet të kesh shumë kujdes...!

Në mesditën e të nesërmes Naseri nga stacioni hekurudhor i Cyrih-ut mori rrugë drejt Austrisë prej nga do të udhëtonte për në Shqipëri, dhe prej andej në Maqedoni. Para se të ndahemi te stacioni i trenave në Cyrih, ai me njohu me njërin nga shokët e tij të fëmijërisë, me Ibini Kicën, një veleshtar që ishte për shumë kohë në Zvicër, për të cilin më tha se ishte shumë besnik dhe atdhetar, dhe me të cilin duhej të mbaja kontakte për ta ndihmuar luftën në Kosovë. Ashtu siç ma përshkroi Naseri Ibniun, ai ashtu edhe më doli, besnik, i përkushtuar dhe patriot.

## XIII. Kthimi i fundit nga Austria në Maqedoni

### ■ Kthimi i fundit si provokim i shumëfishtë

#### **Kaos e lashë, kaos e gjeta!**

Kthimi i Naser Hanit në vjeshtën e vitit 1998 në Maqedoni pas pesë vjet mërgimi në Austri, kishte qenë kthimi i fundit në Veleshtën dhe në Strugën e tij. Meqë me parat e shtëpisë së shitur në Veleshtë e kishte filluar ndërtimin e shtëpisë së re në Strugë, ai së bashku me familjen e tij të ngushtë ishte vendosur në një banesë me qira po në këtë qytet ku i kaloi vitet e fundit të jetës së tij.

Por, këtë kthim të tij në Maqedoni ai e kishte përjetuar si një provokim të shumëfishtë:

Shtypja etnike e shqiptarëve ç'prej se ai në vitin 1993 ishte vendosur në Austri nuk kishte ndryshuar aspak. Vetë kthimi në Maqedoni në prag të fushatës më të re elektorale të tetorit të vitit 1998 e kishte tensionuar pa masë, sepse duke qenë ai anëtar i PDSH-së ishte pritur edhe angazhimi i tij në atë fushatë etj. Ndonëse pas kësaj fushate zgjedhore blloku i majtë politik maqedon, sipas të gjitha gjasave, do të ikte nga pushteti, ardhja në pushtet e bllokut të djathtë politik maqedon, duke qenë ai edhe më aventurier se i majti, shqiptarëve nuk do t'u sillte asnjë të mirë.

Deri sa kishte qenë në mërgim ai ngarkesën e të qenit anëtar i një partie të veçantë se kishte ndër fare. Por tani që ishte kthyer në vendlindje, të qenit anëtar i PDSH-së herë pas here e kishte vënë në pozita të palakmueshme. Vetë fakti se partia e tij (PDSH-ja) ishte në koalicion zgjedhor, si dhe ishte pritur të ishte edhe në koalicion qeveritar me partinë e djathtë maqedone (VMRO/DPMNE-në)<sup>5</sup> tejet antishqiptare, kishte bërë që Naseri të mos ndihej mirë

---

<sup>5</sup> **VMRO** - shkurticë në gjuhën maqedone do të thotë: "Vnatresna Makedonska Revolucionerna Organizacija", shqip „Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedone“. Është themeluar në vitin 1912 nëpërmjet të transformimit të OFRMO-së në VMRO. Trashigimtare e krahut probullgar të OFMRO-së

në lëkurën e tij. Kishte dëshiruar të ishte si dikur gjatë viteve 1981-1991 një veprimtar i lirë, por, tani ishte bërë vonë për të qenë i tillë. Vetë situatat e turbullta në Maqedoni i kishin diktuar të rrinte aty ku ishte, anëtar i PDSH-së!

Kështu, Naseri i posakthyer në vendlindje ishte gjendur sërish midis ecejakesh intensive me qëllim të rivendosjes së lidhjeve të vjetra dhe krijimit të lidhjeve të reja, duke mos mundur ai kësisoj as të çmallej sa duhet me fëmijët, bashkëshorten, motrat dhe vëllezërit e tij, të cilët kishite vite që s'i kishite parë. I dëshpëruar nga rrethanat e tilla në Maqedoni i kishte thënë vetës: “Kaos e lashë e kaos e gjeta...!”.

### **Koalicione paradoksale me moral të dyfishtë**

Sidomos koalicionet e partive shqiptare me partitë maqedone ai i kishte përjetuar si një provokim të veçantë dhe si një sprovë me moral të dyfishtë.

Krerët dhe kandidatët e partive shqiptare kishin bërë premtime se në mandatin e tyre të ardhshëm do t'i vinin në vend të drejtat e shqiptarëve, ndërkohë që pikërisht partitë maqedone me të cilat ato bënë koalicione e pengonin vënien në vend të të drejtave të shqiptarëve. Partitë maqedone, duke u thirrur në sistemin shtetëror unitar të Maqedonisë, ishin shprehur para elektoratit të tyre kundër vënies në vend të të drejtave të shqiptarëve, ndërkohë që realiteti faktik fliste se pikërisht Maqedonia ishte shteti bietnik dhe për rrjedhojë edhe shteti biunitar më tipik në Ballkan. Edhe krahas paradokseve të tilla partia e majtë shqiptare, siç kishte qenë PPD-ja, duhej të bënte koalicion zgjedhor e qeveritar me partinë e majtë maqedone, siç ishte LSDM-ja, kurse partia e djathtë shqiptare, siç ishte PDSH-ja, ishte dashur të bënte koalicion zgjedhor dhe qeveritar me partinë e djathtë maqedone, VMRO-në.

Ndonëse Naseri e kuptonte se partitë shqiptare kishin qenë të detyruara në masë të konsiderueshme që të bënë koalicione të tilla me partitë maqedone, njëra më antishqiptare se tjetra, sepse shqiptarët ishte dashur të bëheshin pjesë e proceseve politike në Maqedoni, megjithatë, ai paradoksin dhe moralin e dyfishtë të koalicioneve të tilla e kishte përjetuar si atak në ndërgjegjen e tij.

### **“Politika sikur era...!”**

Kështu, në rastin konkret të zgjedhjeve të tetorit të vitit 1998, krerët dhe kandidatët e PDSH-së, ishte dashur që për hir të koalicionit zgjedhor me

---

dhe të VMRO-së, si dhe e KSM-së është VMRO-ja e themeluar rishtazi në Maqedoni në vitin 1990.

**DPMNE**- shkurticë në gjuhën maqedone që do të thotë “Demokratska Partija za Makedonsko Nacionalno Edinstvo”, shqip “Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedon”, e themeluar për herë të parë në vitin 1990. Të dy partitë e tilla janë vazhdimisht në koalicion zgjedhor dhe qeveritar.



VMRO-në dhe në kundërshtim me ndërgjegjen e tyre, të silleshin si “aleat” me krerët dhe kandidatët e kësaj partie antishqiptare, ndërkohë që edhe krerët dhe kandidatët e VMRO-së ishte dashur të shtireshin si “aleat” të krerëve dhe të kandidatëve të PDSH-së. Të njëjtat sjellje reciproke paradoksale kishin ndodhur edhe kur partia e majtë shqiptare, PPD-ja, kishte qenë në koalicion zgjedhor dhe qeveritar me partinë e majtë maqedone, LSDM-në, duke filluar nga viti 1991 e deri në vitin 1998. Në të dy rastet të drejtat e shqiptarëve, përveçse me ndonjë përmirësim të vogël kozmetik mbeteshin aty ku kishin qenë më parë, duke u kthyer kësisoj koalicionet e tilla partiake vetëm në luftë për pushtet!

Brenda moralit të tillë të dyfishtë të koalicionit parazgjedhor PDSH-VMRO ishte gjendur asokohe edhe Naseri i posakthyer në Maqedoni. Për t'u ndier sa më pak i ngarkuar me paradoksalitetin e koalicionit të tillë, ai, siç tregon edhe kushëriri i tij, Tahir Hani, kishte preferuar që të ishte vetëm një anëtar i thjeshtë i PDSH-së në Strugë, ndërkohë që fjala dhe mendimi i tij ishte dëgjuar e vlerësuar, jo vetëm në degën e PDSH-së për Strugën, por edhe në kryesinë qendrore të kësaj partie.

E tillë qenka politika i kishte thënë vetes Naseri. Ajo të bëka që armikut t'i thuash mik! E po nuk ka shkruar kot Fishta: **“Politika sikur era, mos ta sjell të Zoti kah dera, se me bo koma me t' rrshqitë nuk del gjo për me t' pritë....!”**

## **S`kishte marrë asnjë post politik**

Kishin qenë sidomos koalicionet me moral të dyfishtë të partive shqiptare me partitë maqedone, ato të cilat kishin bërë që Naseri i posakthyer nga mërgimi të kishte marrë pjesë në fushatën zgjedhore të tetorit të vitit 1998 me ndërgjegje të ngarkuar. Ai sërish kishte ndenjur e biseduar me të mirin, me më pak të mirin e me të “keqin”, siç kishte bërë gjatë gjithë jetës së tij. Sërish askujt s'ia kishte refuzuar miqësinë dhe bisedën. Nga informacioni i mirë apo i keq që merrte nga njëri e nga tjetri, ishte përpjekur të nxirrte përfundime se çfarë ishte dashur të bëhej për momentin. Por jo vetëm për këtë qëllim, por ai kishte ndenjur dhe biseduar me secilin edhe për shkak të karakterit të tij, sepse e kishte pasur të vështirë që tjetrin ta refuzonte, të mos e merrte në konsideratë e ta injoronte.

Por derisa dikur ndejat dhe bisedat e tilla me secilin i kishte bërë si veprimtar i lirë në të mirë të të gjithë shqiptarëve, tani që ai ishte anëtar i PDSH-së, i ishte dukur se të gjitha këto po i bënte për interesat e partisë së tij dhe për një elektorat të pjesshëm shqiptar, si dhe për interesat e tij individuale për të marrë ndonjë post politik... Ishte ndërgjegjja e tillë e tij ajo që kishte bërë që ai pas zgjedhjeve të fituara të PDSH-së në tetorin e vitit 1998, të mos pranonte asnjë post politik në nivel komunal ose edhe më lart, por të pranonte një post human, siç kishte qenë ai i drejtorit të Qendrës sociale të Strugës.

## **Më shumë se atdhetarë ishin inatçarë...!**

Para së gjithash ndërgjegjen e Naserit e kishin ngarkuar sjelljet paradoksale dhe me moral të dyfishtë të të dy partive kryesore shqiptare në Maqedoni, PDD-së dhe PDSH-së, të cilat ishin parë edhe gjatë zgjedhjeve të tetorit të vitit 1998.

PPD-ja e akuzonte koalicionin zgjedhor të posakrijuar PDSH-VMRO si koalicion i cili nuk do t'i shpinte përpara të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, por nuk e akuzonte për këtë gjë partinë maqedone të majtë, LSDM-në, me të cilën kishte qenë dhe kishte mbetur në koalicion zgjedhor dhe qeveritar deri më tani, edhe pse LSDM-ja për ato vite e kishte penguar realizimin e të drejtave të shqiptarëve. PDSH-ja e akuzonte koalicionin PPD-LSDM për mosrealizimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni që nga viti 1991 e këtej, por nuk e akuzonte partinë e djathtë maqedone, VMRO-në, me të cilën tani kishte bërë koalicion zgjedhor e qeveritar, edhe pse VMRO-ja në cilësinë e opozitës që nga viti 1991, po ashtu i kishte kontribuar mosrealizimit të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni.

Kështu, derisa partitë kryesore shqiptare ua kishin falur mëkatet partive kryesore maqedone për hir të koalicioneve zgjedhore e qeveritare, ato duke qenë parti opozitare në raport me marrjen e pushtetit kishin lëshuar kundër njëra-tjetrës akuza të rënda deri edhe me tone të ashpra, të cilat pastaj ishin bartur në mesin e shqiptarëve si urrejtje dhe përçarje në baza partiake. Puna kishte shkuar deri aty sa që partitë kryesore shqiptare s'kishin pranuar që të bënin as koalicione zgjedhore të pjesshme, në ato zona ku bashkimi i votave të kandidatëve të tyre do ta shtonte së pakut për dy numrin e deputetëve shqiptarë në parlamentin e Maqedonisë.

E tëra kishte folur se krerët dhe kandidatët e të dy partive kryesore shqiptare më shumë se atdhetarë kishin qenë inatçarë! Vetë inatet e tilla reciproke nuk kishin të bënin me të drejtat e shqiptarëve, por me egokarrierizmin, papjekurinë e tyre politike dhe me luftën për pushtet, ndërkohë që pushteti bashkë me shtetin do të ishte njëanshmërisht në duart e partive kryesore maqedone, pa marrë parasysh se cila prej tyre i kishte fituar ose do t'i fitonte zgjedhjet kësaj radhe. Kishin qenë pikërisht sjelljet e tilla paradoksale me inate të pakuptimta dhe moral të dyfishtë të partive shqiptare, ato të cilat Naserit ia kishin ngarkuar ndërgjegjen shumë, aq më tepër tani kur ai duke qenë anëtarë i një partie në njëfarë mase ishte bërë edhe vet pjesë e sjelljeve të tilla

## **Një kthim plot ankth ...!**

Vet përndjekjet e mëhershme dhe sidomos plani i shërbimit sekret maqedon për ta eliminuar Naserin fizikisht që në vitin 1993, kishin bërë që kthimi i

tij në Maqedoni në fund të vitit 1998 të ishte përcjellë ndër të tjera edhe me shqetësim e ankth! Sidomos bashkëshortja e Naserit ishte brengosur shumë sepse kishte menduar se shërbimi sekret maqedon, pikërisht tani, duke e shfrytëzuar rrëmujën e fushatës zgjedhore të vitit 1998, do të mund ta vriste Naserin pa marrë asnjë përgjegjësi. Por, brengën e tillë për Naserin e kishin pasur edhe të tjerët, motrat dhe vëllezërit e tij, si dhe disa nga shokët e tij të ngushtë. Pak a shumë të njëjtën brengë e kishte pasuar edhe Naseri për vetën e tij, por për të mos i brengosur të tjerët ai për këtë s'kishte folur me askënd.

Kështu, derisa në tetorin e vitit 1998 Naseri me disa shokë të tij gjendej në qytetin e Ohrit për të bërë fushatë elektorale, si dhe për ta parë nga afër gjendjen e shqiptarëve në këtë qytet, përfshirë këtu edhe gjendjen e shqiptarëve të konvertuar në turq dhe të shqiptarëve ortodoks të konvertuar në maqedonë, kishte ndodhur që disa qindra metra larg tij një grup maqedonësh të kishin shtënë me armë. Për Naserin kishte mbetur e paqartë, nëse kjo qitje me armë kishte qenë punë huliganësh, apo kishte qenë një paralajmërim i organizuar nga strukturat e shtetit, që ai t'i mbante duart larg nga qyteti i Ohrit dhe i Manastirit, qytete këto prej të cilave sidomos në dy dekadat e para pas LDB-së, shqiptarët ishin spastruar etnikisht në masë të konsiderueshme.

Edhe gjesti i tillë i qitjes me armë, kthimin e Naserit në Maqedoni e kishte përcjellë me dyshime, ankth e frikë.

Për fat të keq, koha tregoi se ata që kthimin e Naserit në Maqedoni e kishin marrë me frikë e ankth kishin pasur të drejtë...

## ■ “Zgjedhje të lira” me „xhaketa të fryra...!”

### “Çfarë demokracie bëhet me “kobure” në brez!”

Ndonëse me ndërgjegje të rënduar për shkaqet që u përmendën më lartë, Naseri për vet faktin se kishte qenë anëtarë i PDSH-së, ishte përfshirë në fushtën zgjedhore të tetorit të vitit 1998. Kështu, ai ishte gjendur gjithandej para simpatizantëve të PDSH-së, kuptohet gjithnjë i shoqëruar nga të tjerët, si dhe me xhaketën e tij në trup, në xhepin e brendshëm të së cilës e mbante revolen, që të vetëmbrohej në rast nevojë nga ndonjë sulm i kurdisur! Në të vërtetë, Naserit nuk i ka pëlqyer aspak që të mbante revole për t'u vetëmbrojtur pikërisht nga shteti, i cili ishte dashur që sipas ligjit ta mbronte secilin qytetar të saj, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, partiake apo religjioze të tij. Tekefundit, derisa Maqedonia do të ekzistonte si shtet, ai edhe ishte angazhuar politikisht në kuadër të PDSH-së, për një Maqedoni me barazi etnike dhe me të drejta të garantuara për të gjithë qytetarët saj.

Por, në kundërshtim me dëshirat e tij fisnike kishte qëndruar historia e masakrave dhe e shpërnguljeve të shqiptarëve nga ana e çetave militare maqedone dhe bullgare duke filluar që nga Kongresi i Berlinit e deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, ashtu siç kishte qëndruar edhe historia e shtypjes etnike e shoqëruar me shpërngulje dhe vrasje të shqiptarëve edhe gjatë LDB-së dhe në vitet e para pas saj, dhe së fundi kishte qëndruar edhe vet plani i fshehtë i shërbimit sekret maqedon për ta eliminuar atë fizikisht që në vitin 1993. Kishin qenë historitë e tilla ato të cilat kishin bërë që edhe Naseri si shumë të tjerë gjatë fushatës elektorale të vitit 1998, ta mbante revolen në xhepin e brendshëm të xhaketës së tij.

I dëshpëruar nga historitë e tilla të kaluara dhe nga situata aktuale e turbullt në Maqedoni, Naseri i kishte thënë vetës “çfarë demokracie bëhet në këtë vend kur je i detyruar të mbash revole në brez!”

### **Frika nga kurththet e njëra-tjetrës**

Por, më shumë se politikanët shqiptarë, fushatën elektorale të vitit 1998 me “xhaketa të fryra” e kishin bërë politikanët maqedonë të të dy krahëve politikë. Ata s’e kishin bërë këtë nga se kishin pritur t’u ndodhte gjë nga shqiptarët, por për shkak të kurththave të mundshme që e majta dhe e djathta maqedone mund t’ia kurdisnin krerëve politik të njëra-tjetrës. Në fakt kishte qenë historia e atentateve të fshehta që partitë aktuale maqedone kishin trashëguar nga partitë pararendëse të tyre, të cilat duke filluar që nga Kongresi i Berlinit e deri në prag të LDB-së ia kishin vlarë njëra-tjetrës me atentate të fshehta liderët kryesor, ajo e cila figurat kryesore të të dy partive maqedone i kishte detyruar që edhe fushatën zgjedhore e vitit 1998 ta bënin me “xhaketa të fryra!”.

Ndonëse shumë figura politike maqedone fushatën zgjedhore të fundvitit 1998 e kishin bërë duke mbajtur revole nën xhaketa, vetëm njëri prej tyre në stilin e Sheshelit në Serbi kishte shtënë me revole në ajër para simpatizantëve të tij. Kishte qenë ky njëri nga eksponentët kryesor të VMRO-së, Ljube Boshkovski, i cili pas atyre zgjedhjeve ishte nominuar Ministër i Punëve të Brendshme të Maqedonisë.

### **Një konflikt me policinë maqedone në Veleshtë**

Në ditën e votimit me rastin e zgjedhjeve të lira të mbajtura në tetorin e vitit 1998, në Veleshtë ishte futur një grup policësh maqedonë i njësisë speciale të Maqedonisë. Ata kishin ardhur atë ditë në Veleshtë për t’u përzier në procesin e votimit. Duke qëndruar pranë kutive të votimit dhe duke dhënë urdhra të prera, ata kishin ndërhyrë në punën e komisionerëve të procesit zgjedhor të pranishëm në secilën qendër të votimit. Vetë fakti se policia maqedone, përveçse

në Veleshtë, në asnjë qendër tjetër votuese nuk ishte përzier në procesin e votimit, kishte folur qartë se ajo polici atë ditë kishte ardhur në Veleshtë për t'u ngatërruar me veleshtarët, të cilëve u kishte dalë zëri për trima dhe kokëfortë!

Naseri, duke e parë se një grup i të rinjve veleshtarë ishte gati të ngatërrohej me policët maqedonë, kishte kërkuar nga policët që me marrëveshje ta lëshonin qendrën e votimit, përkatësisht që ata funksionin e ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike ta ushtronin në vende publike.

Por meqë policët maqedonë me propozimin e tillë s'ishin pajtuar, njëri nga të rinjtë e fshatit i kishte urdhëruar ata të dilnin jashtë qendrës së votimit menjëherë. Derisa komandanti i asaj njësie policore e kishte urdhëruar arrestimin e atij të riu, veç kishte filluar rrahja masive midis të rinjve nga Veleshta dhe policëve maqedonë, që kishte vazhduar më pas edhe në oborrin e qendrës së votimit. Por derisa policët maqedonë, duke e parë se ishin mundur, kishin vrapuar drejt makinave të tyre policore dhe kishin ikur, njëri nga policët kishte mbetur në vendin e ngjarjes, dhe nga frika se do të torturohej ia kishte plasur vajit.

Naseri për ta qetësuar policin maqedon të mbetur në oborrin e qendrës së votimit, i kishte thënë të mos frikohej sepse s'do t'i ndodhte asgjë, kurse para se ai polic të largohej e kishte këshilluar që të hiqte dorë nga profesioni i policit, sepse policia aktuale e Maqedonisë nuk ishte e gjithë popullit, se ajo ishte një polici e njëanshme, vetëm e maqedonëve, sepse brenda saj kishte fare pak shqiptarë, dhe si e tillë për shkaqe politike ajo i provokon shqiptarët duke të rrezikuar ty dhe të tjerët. Pas një kohe ishte marrë vesh se ai polic, vërtet kishte hequr dorë nga profesioni i policit.

## **Në krye të Maqedonisë VMRO-istët terroristë**

Zgjedhjet e vitit 1998, ashtu siç ishte pritur, e kishin sjellë në pushtet bllokun e djathtë politik maqedon, diç më pak dinak se ai i majti, por shumë më i egër se ai. Në koalicion qeveritar me partinë e djathtë maqedone VMRO/DPMNE-në, kishte qenë PDSH-ja e shqiptarëve, anëtar i së cilës ishte Naseri. Sa për veten e tij, atë e kishin urreyer njësoj si VMRO-istët e djathtë, ashtu edhe LSDM-istët<sup>6</sup> e majtë. Vetëm se VMRO-ja e djathtë në krahasim LSDM-ën e majtë, e kishte më të kultivuar dellin terrorist të pararendësve të saj historike, siç kishin qenë dikur që nga Kongresi i Berlinit e deri në prag të LDB-së krahët probullgarë të

---

<sup>6</sup> LSDM - shkurticë që do të thotë: „Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë“. Kështu quhet partia kryesore e majtë maqedone, e cila u krijua në vigjilje të pavarësisht të Maqedonisë në vitin 1990, si trshigimtare e krahut promaqedon të OFMRO-së dhe të VMRO-së si dhe e „Grupit Socialist Maqedon“, të krijuar në vitin 1903.

OFRMO-së<sup>7</sup> dhe të VMRO-së, dhe siç kishte qenë edhe KSM-ja<sup>8</sup> famëkeqe e udhëhequr nga oficerë të Bullgarisë.

Pararendëset e tilla të VMRO/DPMNE-së së tanishme për t'ia bashkuar Maqedoninë Bullgarisë, në periudhën kohore midis Kongresit të Berlinit dhe Luftërave Ballkanike, kishin vrarë me atentate të fshehta një sërë figurash markante të çështjes maqedone, përfshirë këtu edhe Goce Delqevin, Nikolla Karevin, Gruevin, Sugarevin, Uzinovin dhe shumë të tjerë. Por edhe pararendëset e LSDM-së së tanishme, siç kishin qenë krahu i majtë promaqedon i OFMRO-së dhe i VMRO-së dhe “grupimi socialist” i Nikolla Karevit, për ta bërë kombin dhe shtetin e pavarur të Maqedonisë, në periudhën kohore midis Kongresit të Berlinit dhe Luftërave Ballkanike, po me atentate të fshehta i kishin vrarë figurat markante të çështjes bullgare në Maqedoni, siç kishte qenë Serfimoski, Gavranovi, Matovi dhe të tjerë si këta, gjë që vërtetohet edhe nga historianët maqedonë në librin “Historia e popullit maqedonas”, e botuar në Shkup në vitin 1983.

Duke pasur parasysh se VMRO-ja e cila tani kishte ardhur në pushtet dellin terrorist të së kaluarës e kishte pasur më të kultivuar se LSDM-ja, si dhe duke pasur parasysh se VMRO-ja si edhe pararendëset e saj s'kishte hequr dorë nga synimi që Maqedoninë t'ia bashkoj Bullgarisë, Naseri e kishte lënë të mundur që VMRO-ja e tanishme strukturat e saj shtetërore monoetnike, ndër të tjera do të mund t'i përdorte për veprime terroriste kundër figurave politike shqiptare. Krejt kjo me qëllim që të shkaktonte në Maqedoni një luftë ndëretnike shqiptaro-maqedone, e cila pastaj do shpinte deri te ndarja e Maqedonisë në dy pjesë: Në “pjesën e Luanit” që do t'u takonte maqedonëve dhe që sipas VMRO-së do t'i bashkohej Bullgarisë, dhe në “pjesën e fakirit”, e cila do t'u takonte shqiptarëve dhe që do t'i bashkohej Shqipërisë.

Naseri kishte supozuar se VMRO-ja e dëshironte ndarjen e Maqedonisë edhe për vet faktin se eksponentë të shumtë të kësaj partie, që nga viti 1990 e këtej figurave politike kryesore të partive shqiptare shumë herë ua kishin përmendur ndarjen e Maqedonisë midis maqedonëve dhe shqiptarëve.

## **Lufta ishte e pashmangshme**

Kur ishte marrë vesh se VMRO-ja për kryeministër të Maqedonisë e kishte

---

<sup>7</sup> OFRMO - shkurticë që do të thotë: „Organizata e Fshehtë Revolucionare Maqedono-Odrinase“, maqedonisht “Tajna Makedonsko-Odrinska Revolucionerna Organizacija”. Kështu është quajtur organizata kryesore politike bullgaro-maqedone, e cila ka funksionuar midis viteve 1892-1912. Organaizata e tillë e ka pasur brenda vetes si krahuin probullgar, ashtu edhe krahuin promaqedon.

<sup>8</sup> KSM - shkurticë që do të thotë: „Komiteti Suprem Maqedon“. Kështu është quajtur organizata politiko-ushtarake bullgaro-maqedone, e cila midis viteve 1895-1940 u angazhua për bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë.

nominuar Ljubço Georgievskin, kurse për ministër të brendshëm Ljube Boshkovskin, dy nga eksponentët e saj më shovinistë, më antishqiptarë dhe më aventurier, për Naserin kishte qenë e qartë se lufta midis shqiptarëve dhe strukturave ushtarako-policore maqedone do të ishte e pashmangshme. Mendonte kështu sepse Ljubço Georgievski ishte aq antishqiptar sa që gjatë fushatës zgjedhore të vitit 1994 në Maqedoni, para elektoratit maqedon kishte deklaruar se po të vinte në pushtet “shqiptarëve do t’ua priste këmbët si gjelave!”, ndërkohë që Ljube Boshkovski, përveçse shprehej egërsisht kundër shqiptarëve, ai, edhe jepte shenja se kishte natyrë prej kriminel.

Por “hajri e sherri nuk dihet!”, kishte menduar Naseri. Pikërisht kur vijnë në pushtet politikanë të egjër dhe primitivë si Georgievski dhe Boshkovski, popujt e shtypur, në rastin konkret shqiptarët, nxiten edhe më shumë që të ngritën për ta fituar lirinë. Në fund të fundit kështu kishte ndodhur edhe me ardhjen e Millosheviqit në krye të Serbisë, i cili me egërsitë e tij i kishte nxitur shqiptarët edhe më shumë që ta themelonin UÇK-në dhe të luftonin për çlirimin e Kosovës nga Serbia.

Naseri duke e ditur se kush ishin Georgievski dhe Boshkovski, ai, pas ardhjes së tyre në poste kryesore të shtetit maqedon, ishte ndier i rrezikuar si për veten e tij ashtu dhe për shumë shqiptarë të tjerë, të cilët që herët ishin angazhuar kundër shtypjes etnike të shqiptarëve në Maqedoni.

## **Duke e lexuar dosjen e vet**

Në vitin 1999 Ministria e Brendshme e Maqedonisë në krye të së cilës kishte qenë Ljube Boshkovski, për disa muaj rresht ua kishte bërë të mundshme shqiptarëve dhe të tjerëve, që ata t’i merrnin kopjet e dosjeve të tyre sekrete nga kjo ministri, të cilat kishin përfshi periudhën e përndjekjeve politike që nga LDB-ja e deri në vitin 1991 derisa Maqedonia kishte qenë pjesë e Jugosllavisë. Në të vërtetë, lejimi i marrjes së dosjeve të tilla personale, ndër të tjera, bëhej me qëllim, që shqiptarët e përndjekur dhe të burgosur politikisht që nga LDB-ja e këtej, duke i lexuar dosjet e tyre të konfrontoheshin me ata shqiptarë të cilët si bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit kishin bërë kallëzime për ta.

Edhe Naseri nga kureshtja e kishte marrë kopjen e dosjes së tij të hartuar nga sigurimi shtetëror i Kosovës dhe i Maqedonisë brenda viteve 1981-1991, kur ai kishte qenë aktiv në demonstratat e atyre viteve për realizimin e Republikës së Kosovës. Atij as që i kishte shkuar ndërmend që të zihej me ata shqiptarë që kishin dhënë informata lidhur më të, por kishte dashur t’i dinte se kush ishin ata në mënyrë që në të ardhmen të ruhej prej tyre. Duke e lexuar dosjen e tij, ai ishte çuditur që brenda saj nuk ishte shënuar vetëm veprimtaria e tij politike, pjesëmarrja nëpër demonstrata e gjëra të tjera, por ishin shënuar edhe disa gjëra

nga jeta e tij private. Pastaj ai ishte çuditur kur kishte parë se kundër tij, nuk kishin raportuar vetëm ata prej të cilëve ai këtë e kishte pritur, por edhe ndonjë tjetër prej të cilit ai këtë e kishte pritur.

Vetë përbajtja e dosjes së tij kishte lënë të nënkuptohej, se nëse në Maqedoni një ditë do të kishte konflikte të armatosura midis shqiptarëve dhe forcave qeveritare maqedone, Naseri dhe kategoria e shqiptarëve të vlerësuar si “ekstremistë”, do të mund të vriteshin nga strukturat policore maqedone, sidomos tani kur strukturat e tilla do të ishin për katër vjet me radhë në duart e Georgievskit dhe të Boshkovskit, që të dy bullgaromëdhenj dhe antishqiptarë të përbetuar.

Nga ana tjerë, Naseri, duke e lexuar dosjen e vet kishte menduar sërish për ekzistimin e “listave të zeza” me emra shqiptarësh të cilësuar si të “rrezikshëm për shtetin”, të cilët strukturat sekrete të Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë, në rast të ndonjë konflikti të armatosur midis shqiptarëve dhe ushtri-policive maqedone, do t'i eliminonin fizikisht në fshehtësi të madhe.

## ■ Kishte vazhduar të jetonte me fatet e Kosovës

### Një këshill lokal për ta ndihmuar luftën në Kosovë

Naseri edhe pas kthimit në Maqedoni në fund të vitit 1998 e deri në qershor të vitit 1999 kur trupat e NATO-s ishin vendosur në Kosovë, kishte vazhduar të jetonte me fatet e Kosovës.

Kështu, me t'u kthyer në Maqedoni ai e kishte themeluar një këshill lokal i cili kishte grumbulluar ndihma financiare për luftën e çlirimtare të Kosovës. Sa më kujtohet ka ndodhur tri-katër herë që ndihmat financiare të mbledhura nga popullata lokale e fshatrave të Strugës, pasi që kishin arritur në Zvicër janë dorëzuar në fondin “Vendlindja thërret”, gjithnjë nga Ibni Kica dhe Qashif Hani të shoqëruar nga unë.

Duke pasur parasysh se strukturat maqedone të përndjekjes shqiptarët që e kishin përkrahur luftën çlirimtare të Kosovës edhe jashtë vendit i kishte mbajtur nën vëzhgim, kjo lë të kuptohet se sa e vështirë ka qenë që të mbledhësh ndihma financiare për luftën çlirimtare të Kosovës brenda Maqedonisë, siç kishte bërë Naseri me shokët e tij.

### Sigurimi i kalimeve të kryeministrit Thaçi

Siç tregon e dhe profesor Nuri Bexheti, ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pas kthimit të kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, Hashim Thaçi, nga Konferenca e Rambujesë dhe e Parisit në shkurtin dhe në marsin e vitit 1999, edhe Naseri bashkë me të tjerë ishte angazhuar për t'i



bërë të mundshme kalimet e tij të ilegale e gjysmëilagle nga Shqipëria për në Strugë dhe prej andej në Kosovë. Edhe pasiqë forcat e NATO-së ishin futur në Kosovë në qershorin e vitit 1999, Naseri deri në fillim të vitit 2001 kur kishte filluar lufta në Maqedoni, ishte kujdesur vazhdimisht për udhëtimet zyrtare të kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi për Shqipëri, duke kaluar ai nëpër territorin e Maqedonisë.

S'ka dyshim se edhe përkujdesja e tillë e Naserit për udhëtimet e Hashim Thaçit nëpër territorin e Maqedonisë, strukturave të caktuara shtetërore maqedone do t'u ketë bërë përshtypje të veçantë....!

### **Në ndihmë të refugjatëve nga Kosova**

Nga ana tjetër Naseri së bashku me shokët e tij kishte bërë të pamundurën për t'u dalë në ndihmë refugjatëve shqiptarë nga Kosova, të cilët ushtria serbe gjatë muajve prill e maj të vitit 1999 i kishte deportuar në Maqedoni.

Qeveritarët maqedonë, duke pasur frikë se mos ndonjë pjesë e shqiptarëve të Kosovës do të mbetej përgjithnjë në Maqedoni, pjesën më të madhe të refugjatëve i kishin vendosur në kampet e Bllacës 1 dhe 2 afër Kosovës, në mënyrë që me t'u krijuar rrethanat e para të volitshme t'i kthenin ata sa më shpejt në Kosovë. Në pjesë tjetër të refugjatëve e kishin vendosur në kampet e Stankovecit 1 dhe 2 dhe një pjesë tjetër në kampin e Qegranit afër Gostivarit. Gjithsejtë mbi 300 mijë refugjatë nga Kosova ishin vendosur në këto kampe.

Meqë kushtet jetësore sidomos në kampet e Bllacës por edhe në kampet tjera kishin qenë mizerabël, Naseri dhe shokët e tij kishin bërë çmos që ata t'i tërhiqnin nga kampet e Bllacës duke i vendosur në shtëpitë e shqiptarëve në Maqedoni. Ndonëse strukturat policore maqedone vendosjen e refugjatëve në shtëpitë e shqiptarëve e kishin penguar, megjithatë, Naseri dhe shokët e tij kishin arritur që një pjesë të tyre ta vendosnin në shtëpitë e shqiptarëve në Strugë e rrethinë.

### **Qeveritarët maqedonë nga ambasada në ambasadë**

Frika e mbetjes së ndonjë pjese të refugjatëve të Kosovës në Maqedoni kishte bërë që qeveritarët VMRO-istë maqedonë gjatë prillit dhe majit të vitit 1999, pothuajse tërë ditën ta kalonin nga ambasada në ambasadë në qytetin e Shkupit duke biseduar me ambasador të shumë vendeve të huaja, që ata t'i bindnin vendet tyre që të pranonin sa më shumë refugjatë nga Kosova. Kështu, dhjetëra mijëra refugjatë shqiptarë ishin vendosur në Turqi e deri në Amerikë, Kanada e Australi. Në të vërtetë po mos ishte presioni ndërkombëtar, këta qeveritarë albanofobë s'do ta pranonin qoftë edhe një refugjatë të vetëm nga Kosova në Maqedoni.

Naser Hani duke e parë prapaskenën politike të qeveritarëve maqedonë

lidhur me “eksportimin” e refugjatëve nga Kosova në katër anët e botës, i kishte njoftuar për këtë asokohe herë legalisht e herë gjysmë legalisht agjensitë e huaja të lajmeve, duke e shtuar kësisoj edhe më shumë urrejtjen e strukturave të shërbimit sekret maqedon kundër tij.

### **Kampe të ngjashme me kampet nazifashiste**

Duke pasur parasysh se qeveritarët maqedonë kishin urdhëruar që kampet me refugjatë nga Kosova të mbaheshin të rrethuara me tela dhe të ruheshin nga forca të shumta policore, si dhe duke pasur parasysh kushtet tejet të vështira jetësore në këto kampe, Naseri dhe shumëkush tjetër i kishin parë këto kampe të ngjashme me kampet nazifashiste të Luftës së Dytë Botërore. Ma kalimin e kohës në këto kampe ishte ndier edhe mungesa e të mirave më elementare për jetë, kurse provokimet e policisë maqedone ndaj refugjatëve kishin ardhur duke u shtuar. Kjo polici kishte ushtruar ndaj refugjatëve shqiptarë sharje, fyerje, kërcënime, dhunë dhe arrestime në baza nacionale.

Strukturat qeveritare maqedone për ta përkeqësuar sa më shumë jetën e refugjatëve nëpër kampe, e kishin sabotuar edhe punën e organizatave humanitare ndërkombëtare të cilat kishin ardhur në Maqedoni për t'i ndihmuar refugjatët me të mira materiale. Krejt kjo ishte bërë me qëllim që refugjatët e Kosovës të mos shihnin rrugëzgjdhje tjetër, përveç largimit të tyre sa më shpejt nga Maqedonia. Kishte qenë kjo arsyeja pse Naser Hani në majin e vitit 1999, para korrespondentit të njohur Harm van der Berg ndër të tjera kishte deklaruar, se “ne shqiptarët s'do ta harrojmë kurrë Bllacën...!”.

### **Ishte dashur tragjedia që Evropa t'i kthente sytë kah shqiptarët**

Por në kundërshtim me veprimet e tilla makabër të strukturave qeveritare maqedone, refugjatët nga Kosova të vendosur në kampet e Maqedonisë po i vizitonin dhe inkurajonin shumë kryeministra, kancelarë dhe politikanë evropianë e amerikanë. Kështu, shqiptarët për herë të parë në historinë e tyre e kishin ndier nga afër përkrahjen, dhe keqardhjen e Fuqive të Mëdha të Evropës, të cilat në të kaluarën ia kishin aneksuar dy të tretat e viseve të tyre, përfshirë edhe Kosovën, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Por, ishte dashur të ndodhte tragjedia dhe që UÇK-ja t'i kapte armët për liri, që Fuqitë e Mëdha të Evropës t'i kthenin njëherë sytë nga shqiptarët. Kishte qenë ky momenti kur Naseri i ishte kujtuar fjala e Ismail Qemalit, kur ai në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë kishte thënë se, “fatet e popujve të vegjël dalin nga dyert e tragjedive të mëdha!”.

## **Ishte dashur tragjedia për t'i parë bota virtytet e shqiptarëve**

Nga ana tjetër, vendosja e rreth 700 mijë refugjatëve nga Kosova në Shqipëri, kryesisht nëpër shtëpitë private të shqiptarëve dhe pjesërisht nëpër kampe, e kishte mahnitur botën, sepse për t'i strehuar 700 mijë refugjatë s'e kishte pasur të lehtë as Evropa shtatëqindmilionëshe e lërë më Shqipëria!

Por sërish kishte qenë tragjedia dhe lufta e drejt e UÇK-së ato që kishin bërë bërë që bota ta shihte këtë virtyt të rrallë të një kombi të lashtë, siç janë shqiptarët. Kishte qenë lufta çlirimtare e Kosovës ajo që kishte bërë që bota t'i vlerësonte, t'i përkrahte e t'i respektonte më shumë se asnjëherë tjetër shqiptarët, Kosovën dhe vetë Shqipërinë.

Kështu, edhe njëherë ishte vërtetuar se popullin që lufton për lirinë tij edhe bota e përqs dhe e ndihmon. "Gjumi u bënë mirë fëmijëve, por popujt që flenë vdesin!", kishte thënë dikur edhe Ismail Qemali.

## **NATO-ja si Aleanca Antifashiste e LDB-së**

Hyrjen e trupave të NATO-së më 10 qershor të vitit 1999 në Kosovë, Naseri e kishte pritur si një fitore mbi fashizmin serb. Vetë NATO-n ai e kishte krahasuar me "Aleancën Antifashiste të Luftës së Dytë Botërore", aleancë kjo e cila e kishte mposhtur asokohe nazifashizmin gjerman, japonez dhe italian, ndërkohë që NATO-ja e sotme po bënte të njëjtën gjë duke e mposhtur fashizmin serb të mbështetur nga Rusia. Edhe gjatë LDB-së pjesëtare të koalicionit të madh antifashist kishin qenë pothuajse të njëjtat vende e superfuqi, të cilat edhe tani ishin pjesëtare të NATO-s, me një dallim të vetëm se Rusia kësaj radhe nuk ishte pjesëtare e NATO-s, sepse ajo duke i shtypur popujt jorus brenda saj dhe duke e përkrahur fashizmin serb tanimë ishte fashistizuar vetë.

Por, ai intervenimin e NATO-s kundër qaceve ushtarake serbe në Kosovë dhe në Serbi e kishte pritur edhe me shqetësim, sepse policitë, ushtritë dhe paramilitarët serbë, me t'i filluar NATO-ja bombardimet, shqiptarët i kishin vrarë e masakruar me të madhe, si dhe i kishin deportuar në shifra kolosale në Shqipëri, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Krejt kjo me qëllim të shfarosjes dhe spastrimit etnik tërësor të shqiptarëve nga Kosova. Aq i theksuar kishte qenë qëllimi i regjimit serb për t'i spastruar shqiptarët etnikisht përgjithmonë, saqë policia dhe ushtria serbe shqiptarëve të përzënë për në Shqipëri, në pikën kufitare të Vërmicës nuk ua kishin ndalur vetëm letërnjoftimet dhe pasaportat, por edhe targat e traktorëve dhe të makinave të tyre. Kështu veprohej me qëllim që shqiptarët e përzënë të mos kishin më as argumentin më të vogël për ta vërtetuar se ata kishin qenë banorë të Kosovës, nëse në të ardhmen bashkësia ndërkombëtare do të kërkonte që ata të ktheheshin në Kosovë.

Në të vërtetë disa vende të Evropës perëndimore pjesëtare të Aleancës Veriantlantike, kishin hezituar që për shkak të Kosovës dhe të shqiptarëve t'i bombardonin caqet ushtarake të Serbisë. Por, kur SHBA-të ishin deklaruar se ato qoftë edhe pa vendet tjera do t'i godisnin caqet ushtarake të Serbisë, kjo kishte bërë që të gjitha vendet pjesëtare të NATO-së të ishin pajtuar që së bashku t'i goditnin caqet ushtarake të Serbisë. Duke e pasur parasysh rolin e tillë të SHBA-ve, Naseri ishte shprehur se shqiptarët në përgjithësi dhe sidomos shqiptarët e Kosovës, për jetë të jetëve duhet të janë falënderues SHBA-ve të cilat në momentin më kritik u dolën zot atyre.

### **Kush e kishte bërë Kosovën të madhe sa një kontinent!**

Po a do të ngrihej NATO-ja për t'i mbrojtur shqiptarët pa luftën e drejtë dhe të shenjtë të UÇK-së! Po a do ta kërkonin gjeneralët e NATO-s me shkopinë në duar fshatin Kleçkë në hartën e Kosovës, ndërkohë që ai fshat as që kishte qenë në hartë! A do të ndodhte kjo sikur të mos kishte UÇK dhe Shtab të Përgjithshëm të saj në atë fshat! Po kush e bëri Kosovën para botës të madhe sa një kontinent!, e kishte pyetur veten Naseri, duke u ndier krenar se në këto arritje të Kosovës dhe të shqiptarëve, edhe ai e kishte pasur gjurmën e vet!

Dhe si mos të ndihej krenar kur tanimë njëri nga shokët e tij, Hashim Thaçi, në emër të UÇK-së i kishte prirë delegacionit shqiptar në bisedimet e Rambujesë dhe të Parisit, ku ishin hapur rrugët që caqet ushtarake të Serbisë të goditeshin nga avionët e NATO-s, kur dy shokë e miq të tjerë të tij, Bardhyl Mahmuti dhe Jashar Salihu, duke qenë përfaqësues politikë të UÇK-së ishin marrë në konsideratë prej disa figurave kryesore të politikave ndërkombëtare, kurse Jashar Salihu edhe nga komandanti kryesor i NATO-s për Evropën, Vesli Klark-u!

Të gjitha këto kishin bërë që Naseri ta kishte ndier brenda vetës tërë krenarinë e gjeneratës së tij, të asaj gjenerate studentore, e cila midis viteve 1981-1991 kishte demonstruar rrugëve të Prishtinës për ta bërë “Kosovën me Republikë e me kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë!”.

### **■ Në Qendrën sociale të Strugës**

#### **Duke e zbatuar ligjin pikë për pikë**

Midis viteve 1998-2001 Naseri kishte qenë drejtor i Qendrës sociale të Strugës, detyrë kjo që i ishte dhënë nga partia e tij, PDSH-ja, e cila së bashku me partinë maqedone, VMRO-në, ishte në koalicion qeveritar. Kështu, kishte qenë hera e parë që ai ishte bërë drejtor i një institucioni, por kishte qenë hera e dytë që ai po

punonte në një zyrë, kjo pas punës disavjeçare në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, si dhe ishte hera e dytë që ai merrej me shpërndarjen e ndihmave financiare për njerëzit në nevojë, kjo pas shpërndarjes së ndihmave financiare për familjet e të burgosurve politikë në Kosovë gjatë viteve të '80 dhe në fillim të viteve të '90.

Fillimisht kishte pasur probleme me punëtorët maqedonë të Qendrës sociale të Strugës, sepse ata s'kishin pranuar që në xhaketat e tyre t'i bartnin "bezhat" dygjuhësh, si dhe që administrata e asaj qendre të ishte dygjuhësore, pra edhe në gjuhën shqipe. Por, Naseri duke e zbatuar me konsekuencë ligjin në fuqi, i kishte detyruar punëtorët maqedonë që ta pranonin si "bezhin" ashtu edhe administratën dygjuhëshe në Qendrën sociale. Kishte pasur probleme edhe me listën e familjeve të cilët merrnin ndihma sociale. Si punëtorët maqedonë, ashtu edhe ata shqiptarë, i kishin futur në listat e ndihmës sociale kryesisht familjet me të cilat ata ishin në lidhje familjare, miqësie e shoqërie, duke lënë jashtë listave shumë familje shqiptare, maqedone dhe sidomos rome, të cilat e meritonin ndihmën sociale sipas ligjit. Edhe këtë problem ai e kishte zgjedhur duke e zbatuar ligjin. Me kalimin e kohës si punëtorët maqedonë, ashtu edhe ata shqiptarë të Qendrës sociale, ishin mësuar me qëndrimin dhe punën parimore të Naserit. Edhe ata i kishin ndryshuar sjelljet e tyre, duke ua miratuar ndihmën sociale vetëm atyre familjeve të varfra të cilave ndihma sociale u takonte sipas ligjit.

Duke punuar në Qendrën sociale të Strugës Naseri i kishte kujtuar me mall ish-kolegët e tij të punës me të cilët kishte punuar dikur në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës. Por edhe në Qendrën sociale të Strugës, ai duke qenë parimor dhe i mirësjellshëm, kishte arritur të krijonte mjedis dhe atmosferë të ngrohtë. Drejtësia dhe natyra e tij tejet njerëzore, i kishin nxitur punonjësit e Qendrës sociale të Strugës, ta konsideronin Naserin drejtorin më të mirë që kishin pasur deri atëherë.

## **Midis brengash dhe dilemash**

Derisa gjatë viteve 1998/1999 Naseri në zyrën e tij në Qendrën sociale të Strugës ishte brengosur kryesisht për Kosovën, gjatë vitit 2000 ai ishte brengosur shumë për fatin e shqiptarëve në Maqedoni.

Pas luftës çlirimtare në Kosovë në vitet 1998/1999 dhe pas luftës çlirimtare në Luginën e Preshevës në vitin 2000, edhe në mesin e shqiptarëve në Maqedoni lufta çlirimtare ishte bërë temë e ditës, sepse tanimë ishte e bërë e qartë, se klasat pushtetore monoetnike maqedone, as që e kishin ndërmend që t'i korrigjonin padrejtësitë e ushtruara ndaj tyre me dialog të brendshëm dhe me rrugë paqësore.

Por, derisa shqiptarët kishin pasur argumente të shumta që realizimit të të

drejtave të tyre në Maqedoni t'ia mësynin edhe me luftë të armatosur, fuqitë vendimmarrëse të botës, si SHBA-të dhe vendet kryesore të Evropës, ishin deklaruar paraprakisht kundër ndodhjes së një lufte të tillë, sepse ato kishin dashur që Maqedonia të ekzistonte edhe më tej si shtet, ndërkohë që ndodhja e luftës së armatosur në këtë vend, do të mund ta çonte atë drejt ndarjes së brendshme midis shqiptarëve dhe maqedonëve dhe kësisoj Maqedonia nuk do të ekzistonte.

Me fjalë të tjera, tendenca e shqiptarëve që të drejtat e tyre në Maqedoni t'i realizonin edhe me luftë të armatosur, dhe tendencat e SHBA-ve dhe të Evropës për ta ruajtur Maqedoninë si shtet të pavarur me çdo kusht, kishin ardhur në kundërshtim. Kishte qenë kontradikta e tillë ajo që asokohe në masë të konsiderueshme e kishte vënë në pikëpyetje epilogun e luftës së armatosur të shqiptarëve në Maqedoni!

Brenga tjetër e Naserit kishte pasur të bënte me përvojën e hidhur të luftës në Kosovë, kur midis spektrit politik dhe ushtarak të Kosovës ishin krijuar përçarje e mospajtime të ndryshme, të cilat e kishin dobësuar kapacitetin luftarak të Kosovës në raport me Serbinë. Duke e pasur parasysh se përçarje dhe mospajtime të tilla do të mund të krijoheshin edhe midis krahut politik dhe ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, Naseri ato për shumëçka i kishte parë shumë më të dëmshme se në Kosovë.

Aspekti tjetër që e kishte brengosur Naserin kishte të bënte me vetë të kaluarën historike shumë të ngatërruar të Maqedonisë, ndaj të cilës që nga Kongresi i Berlinit e deri në prag të LDB-së kishin pasur pretendime territoriale dhe politike tri shtete ballkanike: Bullgaria, Serbia dhe Greqia. Kjo linte të nënkuptohej se këto vende edhe me rastin e ndodhjes së luftës çlirimtare të shqiptarëve, do t'i përzienin duart e tyre në punët e brendshme të Maqedonisë, në rastin më të keq duke e krijuar sërish një Aleancë Ballkanike antishqiptare dhe antimaqedone si gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Ballkanike. Kishte qenë kjo arsyeja pse Naseri mundësinë e luftës çlirimtare në Maqedoni e kishte parë më të koklavitur se luftën çlirimtare në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës.

Por, me gjithë rreziqet e dilemat e tilla ai kishte menduar se tanimë kishte ardhur koha që shqiptarët në Maqedoni ta thonin njëherë fjalën e tyre edhe me grykën e pushkës për barazi etnike dhe liri. Ndarja e Maqedonisë për të kishte qenë akti i fundit, i cili do të duhej të ndodhte kur atë do ta shihnin të arsyeshme edhe shqiptarët.

Duke i analizuar të gjitha këto, Naseri asokohe kishte thithur shumë tym duhani në zyrën e tij në Qendrën sociale të Strugës, ndërkohë që mendimet dhe brengat e tilla i kishte ndarë kryesisht me Xhevdet Nasufin, dhe me shokë tjerë në Maqedoni e në Kosovë.

## ■ Vizita e parë në Kosovën e lirë

### Vizitë që e kishte trazuar shpirtërisht

Diku rreth një javë pasi që forcat e NATO-s ishin futur në Kosovë, kurse forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kishin ikur në Serbi, Naser Hani e kishte vizituar për herë të parë Kosovën e lirë. Por vizita e parë në Kosovën e lirë atë për shumëçka e kishte trazuar shpirtërisht.

Duke e kaluar grykën e Kaçanikut ai po hynte në Kosovë pas rreth shtatë vjetësh, pesë prej të cilave i kishte kaluar në mërgim në Austri. Rugës drejt Prishtinës i kishte parë me sytë e tij reliket e luftës që kishin bërë shqiptarët për liri. Shtëpi të djegura e të rrënuara, rrugë të prishura të bëra gropa-gropa. Edhe shenjat e dhëmbëzoreve të tankeve dhe të mjeteve të tjera të motorizuara të ushtrisë serbe nëpër asfalte, kodrina dhe fusha kishin qenë ende të freskëta. Derisa makina kishte ecur drejt Prishtinës, shoferi dhe një shok i tij, duke e parë Naserin në kujtime, kishin heshtur. Në heshtje e sipër Naseri e kishte kujtuar atë ditë vjeshtore me diell të vitit 1990, kur ai një ditë para se të kthehej nga Kosova në Maqedoni, i mërzhitur kishte dalë te parku i Gërmisë, ku ndër të tjera e kishte pyetur veten se - “Cilën lamtumirë do t’ia linte ai Kosovës, mos edhe ai do t’i thoshte asaj “mirë u pafshim në liri!”, siç ishin shprehur asokohe shqiptarët të cilët po u hipnin autobusëve drejt vendeve të Evropës Perëndimore për të kërkuar azil.

### Duke e kujtuar njërin nga shokët e tij të rënë

Çuditërisht, fati kishte dashur që ai vërtet t’i kthehej Kosovës në liri, por jo në atë liri që klasa politike e Kosovës kishte pritur të ndodhte vetvetiu ose të pikonte nga qielli, por në atë liri që Kosovës ia kishte sjellë lufta çlirimtare, UÇK-ja, gjaku i mbi 2000 dëshmorëve dhe i mijëra martirëve. Ishin dashur të kalonin plot 18-të vjet nga viti 1981 që Kosovën ta shihte të lirë, ndërkohë që e ardhmja përfundimtare e Kosovës ende s’ ishte ditur plotësisht. Por një gjë kishte qenë e qartë Kosova me Serbi kurrë më s’do të binte në të njëjtin “shtrat!”. “Martesa e dhunshme” e Kosovës me Serbinë kishte marrë fund. Por, mbase Evropa këtë gjë s’e kishte kuptuar ende plotësisht....

Duke i kujtuar shokët e tij të rënë në luftë për liri, Naserit i ishte kujtuar sidomos figura emblematike e Fehmi Lladrovci me të cilin ishte njohur që herët. Por, bashkë me figurën e Fehmiut i ishin kujtuar edhe fjalët e liga, të cilat një shqiptar qëllimzi i kishte lëshuar në një gazetë kundër tij, derisa ai (Fehmiu) bashkë me bashkëshorten e tij, Gjevë Lladrovcin, bash si Azem e Shote Galica kishin luftuar maleve për çlirimin e Kosovës. Gjuha e thëngjilltë e

njeriut të keq, plot urrejtje, vrer e helm kundër themeluesve dhe komandantëve të UÇK-së, kishte bërë që Naseri të ofshante një herë dhe të thoshte ashtu pa zë: “Çmenduri , o çmenduri...!”.

### **Kosovës kishte filluar t'i vinte sërish era shqiptari!**

Kthimi masovik i qindra mijëra shqiptarëve në Kosovën e lirë të cilët gjatë luftës ishin deportuar në Shqipëri, në Maqedoni e në Mal të Zi, kishte bërë që Kosovës t'i vinte sërish era shqiptari! Duke iu referuar këtij fakti Naseri i kishte thënë vetes: “Kosova shpëtoi njëherë e përgjithmonë, gjaku i dëshmorëve nuk shkoi kot!”. Derisa e kishte kaluar kufirin maqedono-kosovar te gryka e Kaçanikut, ai ishte gëzuar që tani po e shihte kampin e Bllacës të zbrazur nga shqiptarët, por edhe ishte trishtuar duke parë në sipërfaqen e tij gjithfarë mbetjesh, si karroca të demoluara invalidësh, çanta e valixhe të ndryshme, copa të shqyera këpucësh, rrobash, batanijesh e çarçafësh, bashkë me mjete të ndryshme të improvizuara që kishin përdorur refugjatët për të mbijetuar.

Aty për aty kishte menduar se në kampin e Bllacës duhet të ngrihej një obelisk i lartë kushtuar vuajtjeve të pafundme të refugjatëve të Kosovës, por aty për aty i kishte ardhur edhe mendimi i kundërt, se ngritja e një obelisku të tillë për shkaqe politike s'do të lejohej nga qeveritarët maqedonë.

### **Kishte dashur të ngopej me Prishtinën**

Kur kishte arritur në Prishtinën e lirë, Naserit i ishin mbushur sytë me lot. Emocione të përziera, nostalgji, gëzim, mall e pikëllim i ishin bërë bashkë e ia kishin mbërthyer shpirtin. Prishtina sapo kishte filluar të merrte frymë lirisht. Ende shumë shitore, restorante e kafene kishin qenë të mbyllura. Përveçse në hotelin Grand, në qendër të Prishtinës, kishte qenë e vështirë të gjeje një vend tjetër për të pirë qoftë edhe një kafe. Nëpër rrugët e Prishtinës ishin parë në qarkullim kryesisht makinat e UNMIK-ut dhe të NATO-s. Vetëm tek-tuk ishte parë ndonjë qytetar shqiptar me makinën e tij. Prishtinës nuk iu kishin kthyer ende të gjithë banorët e saj të deportuar gjatë luftës. Ajo s'kishte zhurmuar ende sa duhet nga zërat e njerëzve të saj, siç kishte zhurmuar dikur kur Naseri kishte qenë studentë.

Meqë kujtimet për Kosovën i lidheshin kryesisht me ato që kishin të bënin me Prishtinën, ai kishte dashur që të ngopej fillimisht me këtë qytet, ku kishte studiuar, kishte demonstruar dhe ku kishte punuar deri në vitin 1990.

### **I kishte rënë në këmbë qarkut rrugor të demonstratave**

Pasiqë e kishte pirë një kafe në Hotel Grand Naseri për t'u çmallur me të



kaluarën e tij në Prishtinë, i kishte rënë në këmbë pikërisht atij qarkut rrugor të demonstratave të pranverës së vitit 1981 dhe të viteve në vazhdim. Por kësaj radhe pikënisja e tij s'kishte qenë më te udhëkryqi i parë afër mensës së studentëve si me rastin e demonstratave, por kishte qenë vetë sheshi qendror i Prishtinës, aty ku ishte ndodhur për momentin.

Duke i rënë mespërmes sheshit të Prishtinës, atij i ishin kujtuar kolonat e studentëve, thirrjet “Kosova Republikë”, përleshjet e studentëve me policinë, makinat dhe pizgauerët e policisë, tanket, kordonët policore, goditjet, lotsjellësi, shtëllungat e tymit, breshëritë e armëve, arrestimet e dhunshme të studentëve rrugëve, si dhe zhurmat therëse të avionëve të ushtrisë jugosllave, të cilët kishin fluturuar asokohe aq ulët mbi Prishtinë. Fakti se Naseri kësaj radhe sheshin qendror të Prishtinës po e përshkonte në kushtet e lirisë, dhe fakti se ai këtë shesh se kishte parë për shtatë vjet me radhë, këto kishin bërë që ai këtë shesh tani ta kishte përjetuar ndryshe: Disi si pas vdekjes!

Kur kishte kaluar pranë ndërtesës së dikurshme të Këshilli Ekzekutiv të Kosovës, ku ai kishte punuar, ishte ndalur për një çast. E kishte shikuar derën e madhe të Këshillit Ekzekutiv nëpër të cilën ai për disa vite me radhë kishte hyrë e kishte dalë. I kishte kujtuar shokët dhe shoqet e punës, kthesat e korridoreve dhe zyrën ku kishte punuar, afishet dhe traktet që fshehurazi i kishte fotokopjuar etj. Pas këtij çasti te udhëkryqi i radhës e kishte marrë rrugën tjetër kryesore përpjetë anash Fakultetit ekonomik ku kishte studiuar dhe sërish ishte ndalur për një çast. I ishte kujtuar dita e parë kur ai ishte bërë student i Fakultetit ekonomik. I ishin kujtuar shokët dhe shoqet e grupit, holi në hyrje të fakultetit dhe byfeja e studentëve aty pranë, ku ai tërë gëzim rinor kishte pirë diçka me shokë. I ishin kujtuar edhe sallat e ligjëratave dhe bile edhe vendi ku ishte ulur, si dhe i ishin kujtuar sidomos dy nga profesorët e tij të përkushtuar kombëtarisht, siç kishte qenë profesor Sami Peja dhe Hajrulla Gorani etj.

Pastaj kishte vazhduar rrugës përpjetë derisa kishte arritur te udhëkryqi pranë mensës së studentëve dhe sërish ishte ndalur për një çast. Duke ia lëshuar një sy mensës së studentëve, i ishte kujtuar momenti kur ai në mbrëmjen e 11 marsit të vitit 1981, bashkë me disa studentë të tjerë kishte dalë nga mensa te ky udhëkryq ku ishte tani, duke bërtitur “Duam Kushte!”, “Duam kushte!” etj. Më pas ia kishte lëshuar një sy edhe hyrjes së konvikteve aty pranë. I ishte kujtuar turma e madhe e studentëve në sheshin midis konvikteve më 26 mars, 1 e 2 prill të vitit 1981, e cila për të dalë te udhëkryqi i parë te mensa e studentëve dhe për të marshuar pastaj drejt sheshit të qytetit, ishte dashur të përleshej paraparakisht me kordonin policor, i cili kishte zënë pritë pikërisht te ajo hyrje.

Pastaj kishte filluar të ecte rrugës tjetër kryesore përpisht anash Institutit

Albanologjik drejt udhëkryqit tjetër të radhës, ishte kthyer në të djathtë pranë Fakultetit filozofik dhe kishte arritur në sheshin qendror të Prishtinës aty ku ishte nisur.

### **“Strehëz o strehëz...!”**

Më pas Naseri ishte nisur për ta vizituar motrën e tij, Lunikën, bashkë me Agniun dhe dy mbesat e tij. Kështu, ai pas shtatë vjetësh sërish ishte ndodhur para derës së po asaj banese ku kishte banuar dikur si studentë, ku kishte hyrë e kishte dalë si në shtëpi të vet, ku kishte ndenjur me shokë të idealit çlirimtar, ku kishte lexuar literaturë të ndalur, ku kishte përjetuar aq shumë gëzime, por edhe çaste të rënda sa herë që ndonjë shokë ishte vrarë në demonstrata.

Para se t'i binte ziles, ai ishte ndalur për një çast para derës së banesës. “Strehëz o strehëz!”, i kishte thënë asaj sikur ajo derë të kishte qenë një pergamenë i ndjeshëm dhe i gjallë. Pastaj i kishte rënë ziles, ndërkohë derën e kishte hapur e motra, Lunikja, e cila ishte gëzuar që pas kaq vjetësh e kishte parë Naserin sërish para derës së saj, si dikur moti kur ai kishte qenë student. Me ta dëgjuar zërin e Naserit te dera ishin shfaqur të dy mbesat e tij, tanimë të rritura, të cilat duke qenë njëra më e dashur se tjetra, e kishin përqaftuar atë duke e thirrur “Dajë, dajë...!”. Meqë kishte qenë ditë e diel në banesë ishte ndodhur edhe profesor Agni Dika. Edhe ai me ta dëgjuar zërin e Naserit kishte dalë te dera dhe ishte përqaftuar me të ashtu siç përqafohen vëllai me vëlla.

Dielli i asaj dite qershori të vitit 1999 kishte qenë në të perënduar, kur Naseri ishte ndodhur sërish në makinë duke marrë udhë drejt Maqedonisë, drejt Strugës dhe Veleshtës së tij. Kësaj radhe prapa po e linte Kosovën e lirë! Para po e priste Maqedonia perëndimore me shqiptarë ende të shtypur etnikisht! Dy botë të njëjta dhe të ndryshme njëkohësisht...!

## **XIV. Me Luftën çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni**

### **■ Në mbështetje të UÇK-ës në Maqedoni**

#### **UÇK-ja të gjithë shqiptarëve u kishte dhënë forcë e guxim**

Viti 2000 e kishte gjetur Serbinë në luftë me një grusht “Ushtri Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB-ën)”, gjë që dëshmonte se lufta e UÇK-së në Kosovë u kishte dhënë forcë e guxim të gjithë shqiptarëve për të luftuar për të drejtat e tyre legjitime dhe të natyrshme. Duke pasur parasysh se shqiptarët në Maqedoni ishin të shtypur njësoj si ata të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, kjo tregonte se edhe ata pas pritjeve të gjata për t'i zgjidhur të drejtat e tyre me rrugë paqësore, tani do t'i kapnin armët për liri e barazi kombëtare. Nga ana tjetër, pushtetarët VMRO-istë maqedonë, ç'prej se kishin ardhur në pushtet në fund të vitit 1998, e kishin intensifikuar shtypjen etnike ndaj shqiptarëve, duke e nxitur kështu ndodhjen e luftës së armatosur në Maqedoni.

Brenda rrethanave të tilla ishte krijuar Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK-ja) e shqiptarëve në Maqedoni, zëdhënës politik i të cilës kishte qenë Ali Ahmeti, i cili bashkë me Fazli Velin përfaqësonin dy figurat kryesore të saj. Meqë Ali Ahmeti dhe Fazli Velin kishin qenë anëtarë të LPK-së dhe veprimtarë të vjetër të çështjes shqiptare, Naseri i njihte që herët dhe kishte respekt për ta. Rajonet shqiptare në të cilat UÇK-ja gjatë gjysmës së parë të vitit 2001 kishte luftuar kundër forcave policoro-ushtarake monoetnike maqedone, kishin qenë ato mbi Tetovë, Kumanovë dhe Gostivar, si dhe ato të fshatrave shqiptare në afërsi të Shkupit, kurse rajonet shqiptare, të cilat s'ishin prekur nga lufta, kishin qenë ato të Kërçovës, të Strugës dhe të Dibrës.

Për Naserin dalja në skenë e UÇK-ës së shqiptarëve në Maqedoni po ndodhte si një rrjedhojë logjike e luftërave çlirimtare në Kosovë dhe në “Luginën

e Preshevës”, siç quhej asokohe nga ndërkombëtarët territori i Preshevës, Bujanocit dhe i Medvegjës.

### **Në prapavijë të luftës së UÇK-së në Maqedoni**

Naser Hani menjëherë pas daljes në skenë të UÇK-së në Maqedoni ishte pozicionuar në mbështetje të saj, gjë që edhe ishte pritur duke pasur parasysh të kaluarën e tij gjatë viteve të qëndresës aktive në Kosovë, dhe mbështetjen që ai i kishte dhënë edhe UÇK-së në Kosovë. Për ta mbështetur luftën e drejtë të UÇK-së në Maqedoni, Naseri ishte dashur ose t'i bashkohej asaj me armë në dorë, ose ta mbështeste atë në prapavijë. Midis alternativave të tilla, ai e kishte zgjedhur prapavinë, jo se i kishte munguar trimëria dhe guximi për ta kapur armën në dorë, por sepse ishin rrethanat në Maqedoni ato të cilat atë e kishin bindur se, ai do të ishte më i dobishëm duke qëndruar në prapavijë.

Kështu, duke qenë anëtarë i PDSH-së Naseri ishte angazhuar që të arrihej marrëveshja midis krahut politik, në radhë të parë midis PDSH-së, e cila që nga viti 1998 kishte qenë në koalicion qeverisës me VMRO-në, dhe krahut ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, në krye të të cilit kishte qenë Ali Ahmeti më shokë. Ai ishte angazhuar më mish e me shpirt për arritjen e marrëveshjes së tillë, sepse kishte qenë i vetëdijshëm se mosarritja e marrëveshjes së tillë brenda shqiptarëve në Maqedoni, për vetë specifikat e Maqedonisë do të ishte shumë më e kushtueshme se ndonjë veprim i tillë gjatë luftës në Kosovë.

Duke qenë në prapavijë të luftës çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni, ai e kishte sqaruar me fakte dhe argumente faktorin ndërkombëtar dhe agjensitë e huaja të lajmeve, se shkaqet kryesore pse UÇK-ja i kishte kapur armët për të luftuar kishin qenë shtypja etnike, padrejtësitë e shumta të ushtruara ndaj shqiptarëve edhe pas pavarësimit të Maqedonisë në vitin 1991 dhe në vitet në vazhdim. Duke e prezantuar para të huajve luftën e UÇK-së si luftë të drejtë, legjitime dhe legale të shqiptarëve në Maqedoni, ai u ishte kundërvënë krerëve të institucioneve monoetnike maqedone, të cilët luftën e UÇK-së e paraqitnin para botës si luftë jolegjitime, jolegale dhe terroriste.

### **■ Kupa që ishte dashur të derdhej...!**

Angazhimet e tilla të Naserit në prapavijë të luftës çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni, sipas të gjitha gjasave e kishin nevrikosur sidomos resorin e shërbimit sekret në Ministrinë e Brendshme të Maqedonisë, sepse Naser Hani, pasi që kishte punuar për vite të tëra për të ndodhur luftërat çlirimtare të shqiptarëve gjithandej, tani që një luftë e tillë kishte ndodhur edhe në Maqedoni, ai ishte

pozicionuar edhe më mjeshtërisht krah interesave shqiptare: Në njërën anë, ishte angazhuar për pajtimin e faktorit politik e ushtarak të shqiptarëve, kurse në anën tjetër po e demaskonte palën maqedone para faktorit ndërkombëtar.

Për të gjitha këto krerët e shërbimit sekret maqedonë kishin vlerësuar, se Naser Hani tanimë e kishte “mbushur kupën” dhe se kishte ardhur koha që kupa e tij të derdhej...! Por, kjo s’kishte qenë e vetmja arsye pse kupa e tij tani ishte dashur të derdhej!

## **Që të nxitej lufta totale dhe ndarja e Maqedonisë**

Personalisht besoj shumë se kryeministri Georgievski dhe ministri i brendshëm Boshkovski, gjatë luftës së vitit 2001 kanë kryer një seri veprimesh kriminale ndaj shqiptarëve, me qëllim që të ndodhte lufta totale ndëretnike dhe ndarja e Maqedonisë, ashtu siç e kishin llogaritur ata: Në “pjesën e madhe” të maqedonëve, “pjesën e vogël” të shqiptarëve.

Meqë faktori ndërkombëtar ishte kundër luftës totale dhe ndarjes së Maqedonisë, Georgievski dhe Boshkovski, u ishin kundërvënë figurave të caktuara ndërkombëtare deri edhe me deklarata të ashpra dhe fyese.

Ministri i brendshëm maqedon, Boshkovski, kishte dhënë dorëheqje nga “trupi koordinues” shumëpartiak pranë qeverisë maqedone, trup ky i cili kishte për detyrë ta zgjidhte me rrugë paqësore krizën ndëretnike në Maqedoni. Boshkovski dorëheqjen e tij kishte arsyetuar me faktin se ai krizën ndëretnike në Maqedoni s’kishte dashur ta zgjidhte me rrugë paqësore, por me rrugë ushtarake, që do të thoshte me luftime të mëtejshme midis maqedonëve dhe shqiptarëve.

Mëtej, Boshkovski, i mbështetur nga kryeministri Georgievski, kishte mobilizuar, armatosur dhe uniformuar me uniforma policore rreth 15 mijë “rezervistë” maqedonë në qytetin e Shkupit, një pjesë e të cilëve kishin biografi kriminale. Krejt kjo me qëllim që në luftë të angazhoheshin të gjithë maqedonët kundër shqiptarëve dhe të gjithë shqiptarët kundër maqedonëve.

Policia e rregullt maqedone e kombinuar me policinë e krijuar nga “rezervistët” maqedonë me biografi kriminale, kishin legjitimuar, rrahur e torturuar qindra civilë shqiptarë të pafajshëm gjithandej rrugëve automobilistike të rajoneve shqiptare të përfshira e të papërfshira në luftime, si dhe e kishte spastruar etnikisht qytetin e Manastirit nga shqiptarët, duke ushtruar dhunë e kërcënime, djegie shtëpish dhe dyqanesh të shqiptarëve.

Një veprimtari tjetër kriminale e policisë sekrete maqedone, kishte qenë edhe ajo rrëmbimit të fshehtë të rreth 50 civilëve shqiptarë dhe e vrasjes me atentate të fshehta të disa të tjerëve, midis prillit e qershorit të vitit 2001.

Synimi i udhëheqësve VMRO-istë maqedonë për ndarjen e Maqedonisë gjatë kohës së luftës së vitit 2001 ka qenë aq evident, sa që kryeministri maqedon Georgievski lidhur me mundësinë e ndarjes së Maqedonisë kishte zhvilluar një takim edhe me zotin Arben Xhaferi, kryetarin e PDSH-së, partisë që ishte në koalicion qeveritar me VMRO-në.

Por, se për çfarë ndarje të Maqedonisë e ka pasur fjalën Georgievski, këtë e tregon më së miri letra që Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Maqedonisë, që ajo ia ka drejtuar Akademisë së Shkencave të Shqipërisë lidhur me ndarjen e Maqedonisë. Sipas akademikëve maqedonë për t'u zgjidhur problemet ndëretnike në Maqedoni, kjo e fundit ishte dashur që Shqipërisë t'ia kthente Tetovën, Gostivarin dhe Dibrën. Kështu, këta akademikë kishin "harruar" se në Maqedoni shqiptarë autoktonë në trojet e veta kishte relativisht shumë edhe Shkup, Kumanovë, Kërçovë, Manastir e Ohër, bashkë me shumicën e fshatrave rreth e rrotull këtyre qyteteve të cilat kishin qenë të banuara pothuajse vetëm me shqiptarë.

Duke i pasur parasysh veprimet e lartpërmendura nuk dyshoj aspak se qeveritarët maqedonë gjatë luftës së vitit 2001, janë angazhuar me vetëdije për luftë totale ndëretnike dhe për ndarjen e Maqedonisë.

## ■ Duke i analizuar mundësitë e vrasjes së tij

Supozimi i ekzistimit të "listave të zeza" të hartuara nga shërbimi sekret maqedon me emra të shqiptarëve të cilësuar si të "rrezikshëm për shtetin", të cilët ky shërbim gjatë luftës midis UÇK-së dhe forcave qeveritare maqedone ishte pritur që t'i eliminonte fizikisht në fshehtësi, tanimë në gjysmën e parë të vitit 2001 ishte bërë më shumë se një realitet.

Rrëmbimi i fshehtë i Islam Veliut nga fshati Dollogozhdë, në prillin e vitit 2001, i Sulltan Mehmetit nga fshati Ladorishtë, në majin e vitit 2001, që të dy nga rrethi i Strugës, dhe i Ruzhdi Veliut, vëllait të veteranit të çështjes kombëtare, Fazli Veliut, nga fshati Zajas afër Kërçovës, si dhe rrëmbimi i disa civilëve të tjerë shqiptarë, bashkë me vrasjet me atentate të fshehta të disa shqiptarëve të tjerë, si në Shkup dhe në fshatrat Çollopek e Porojë afër Tetovës nga "njerëz të panjohur", ekzistimin e "listave të tilla të zeza", tanimë e kishin vërtetuar katërcipërisht.

Për Naser Hanin dhe për shumëkënd rrëmbimet dhe vrasjet e tilla pa lënë rrëmbyesit dhe vrasësit e "panjohur" as edhe gjurmën më të vogël, kishte qenë e qartë se ato po realizoheshin profesionalisht nga institucioni i caktuar i shtetit, përkatësisht ato po kryheshin për shkaqe politike nga policia sekrete maqedone

në kuadër të Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë. Meqë Naserit një vrasje e tillë e fshehtë veç i ishte parapërgatitur njëherë në vitin 1993, ai s'kishte pasur si mos ta linte të mundshme, se kjo polici tani mund t'ia mësynte atij sërish që ta rrëmbente ose që ta vriste në fshehtësi.

Por, Naseri s'e kishte lënë të mundshme që policia maqedone do t'ia mësynte atij në mes të ditës dhe në mes Strugës, sepse kësioj ajo do të haste si në qëndresën e Naserit ashtu dhe të shqiptarëve të rastit, dhe për rrjedhojë veprimin e tillë ajo s'do të mund ta bënte pa marrë asnjë përgjegjësi, siç kishte ndodhur me rrëmbimet dhe vrasjet e cekura më lartë. Por, Naseri e kishte lënë të mundshme, që policia sekrete maqedone do të mund ta rrëmbente ose edhe ta vriste në vend, vetëm nëse ai do të ndodhej i vetmuar dhe i paarmatosur (pa revolen e tij nën xhakëtë), diku në periferi të Strugës ose edhe jashtë saj, sepse vetëm brenda rrethanave të tilla kjo polici do ta kryente krimin e saj në fshehtësi dhe për pa marrë asnjë përgjegjësi para faktorit ndërkombëtar prezent në Maqedoni. Prandaj, që të mos kapej në befasi e të mos i ndodhte ndonjë e papritur, Naseri, gjatë luftës në Maqedoni s'kishte marrë udhë asnjëherë jashtë Strugës fare i vetëm, s'kishte dalë jashtë shtëpisë pa xhakëtën dhe pa revolen e tij në xhepin e saj të brendshëm, dhe s'kishte qëndruar i vetmuar natën vonë jashtë shtëpisë.

Më tej, Naseri kishte vendosur që nëse policia maqedone do ta ndalonte gjoja për ta legjitimuar, por në fakt për ta mashtruar e për ta rrëmbyer si shumë të tjerë, ai në vend të letërnjoftimit do ta nxirrte nga xhepi i xhakëtës revolen e tij dhe do të shtinte mbi policinë, me ç'rast do të vritej edhe vetë. Ai këtë veprim do ta bënte sigurisht, jo vetëm sepse kishte guxim dhe trimëri ta bënte një gjë të tillë, por edhe pse s'ka pasur rrugë tjetër. Ai e ka ditur fort mirë se edhe po ta lejonte legjitimimin dhe për rrjedhojë edhe rrëmbimin e tij, ai sërish do të vdiste në ndonjë burg sekret të Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë, por në mënyrë shumë më të tmerrshme se sa po të vdiste në vend nga plumbat që do t'i shkëmbente me policinë.

### **Kishte refuzuar të vendosej në Shqipëri**

Jani Koçi, juristi nga Tirana, të cilin Naseri e kishte njohur në Austri, duke e ditur se sa i rrezikuar kishte qenë Naseri gjatë luftës në Maqedoni, e kishin ftuar disa herë që ai të vendosej në shtëpinë e tij në Tiranë së bashku me familjen e tij.

Por, Naseri, as që kishte mundur ta merrte me mend, që pikërisht kur shqiptarët në Maqedoni i kishin kapur armët për liri, ai të ikte për ta shpëtuar kokën e vet duke u vendosur në Shqipëri.

Në një moment Naseri kishte dashur që bashkëshorten dhe fëmijët t'i vendoste

në Shqipëri, por bashkëshortja e tij s'kishte pranuar asesi që ajo të vendosej në Shqipëri duke lënë Naserin vetëm në Strugë.

Edhe unë, derisa në Maqedoni kishin filluar rrëmbimet dhe vrasjet sekrete të civilëve shqiptarë, i kam thënë Naserit disa herë me telefon: “vendosu për një kohë te nëna!” (d.m. th. në Shqipëri), por ai nuk e bëri këtë.

Në të vërtetë, Naseri gjatë luftës në Maqedoni kishte qenë dy-tri herë në Shqipëri, por jo për të qëndruar atje...!



## **XV. Vrasja e Naser Hanit me atentat të fshehtë**

### **■ Për t'i minuar bisedimet për paqe**

Tanimë ka argumente të mjaftueshme të cilat flasin se strukturat qeveritare monoetnike maqedone sidomos në qershorin dhe gushtin e vitit 2001, ishin përpjekur vazhdimisht që bisedimet për paqe midis saj dhe palës shqiptare të mbikëqyrura nga ndërkombëtarët, nëpërmjet të veprimeve kriminale të ushtruara ndaj shqiptarëve, t'i minonin duke i bërë ato të pamundshme dhe të dështueshme. Për arritjen e këtij qëllimi ishte angazhuar sidomos Ministria e Brendshme e Maqedonisë.

Besoj se pikërisht për t'i minuar bisedimet parapërgatitore për paqe, të cilat nën tryshninë e Sekretarit për Marrëdhënie të Jashtme të BE-së, zotit Javier Solana, të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së, zotit George Robertson dhe të OSBE-së, ishte planifikuar që të fillonin më 14 qershor të vitit 2001 në qytetin e Ohrit, strukturat e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë me 7 qershor kishin varur në gjumë disa civilë shqiptarë të pafajshëm në qytetin e Shkupit, të cilët sipas kësaj ministrie kishin qenë terroristë.

Po për të njëjtin qëllim, të minimimit të bisedimeve për paqe, pala maqedone më 11, 12, 13 dhe më 14 qershor e kishte prishur edhe marrëveshjen për armëpushim, kur forcat ushtarako-policore maqedone i kishin goditur papritmas njësitë e UÇK-së mbi Tetovë.

Po ashtu besoj se me qëllim të dështimit të bisedimeve për paqe të parashikuara më 14 qershor, policia sekrete maqedone më 12 qershor të vitit 2001 e kishte varur edhe Naser Hanin. Sipas të gjitha gjasave e kishte bërë këtë policia maqedone duke besuar se bashkëfshatarët temperamentë të Naser Hanit, veleshtarët, tani do t'i kapnin armët dhe kësaj do të hapej edhe një vatër e re lufte në Strugë dhe rrethinë, dhe për rrjedhojë edhe mbajtja e bisedimeve parapërgatitore për paqe me 14 qershor në qytetin e afërt të Ohrit do të bëhej e pamundshme.

Shtrohet pyetja pse pala maqedone ishte angazhuar për minimin e bisedimeve për paqe duke ushtruar krime ndaj shqiptarëve?! Po përse tjetër veçse për t'ia dhënë shansin ndodhjes së luftë totale ndëretnike dhe ndarjes së Maqedonisë ashtu siç e kishin paralogaritur qeveritarët maqedonë VMRO-istë.

### **Krime të njëpasnjëshme edhe në vigjilje të Konferencës së Ohrit**

Më gjithë shkeljet e njëpasnjëshme të armëpushimeve, rrëmbimeve të dhjetëra civilëve dhe të vrasjes me atentat të Naser Hanit, bisedimet paraprake për paqe, të planifikuara për datën 14 qershor në qytetin e Ohrit, nën tryshninë e faktorit ndërkombëtar ishin mbajtur. Bisedimet e tilla kishin rezultuar me vendimin e mbajtjes së Konferencës së Ohrit për rivendosjen e paqes në Maqedoni më 13 gusht të vitit 2001. Por, pala maqedone duke e ditur se në Konferencën e Ohrit, ishte dashur që nën tryshninë e faktorit ndërkombëtar shqiptarëve t'u njihet ca të drejta më shumë, si dhe duke e ditur se nëpërmjet të asaj konference opcioni i saj i luftës totale dhe i ndarjes së Maqedonisë po hiqej nga rendi i ditës, ajo nëpërmjet të veprimeve kriminale të mëtejshme ndaj shqiptarëve ishte përpjekur që sidomos mbajtjen e kësaj konference ta bënte të pamundshme.

Sipas mendimit tim ka qenë kjo arsyeja pse pala maqedone edhe në gjysmën e dytë të qershorit pas Vrasjes së Naserit dhe në gjysmën e parë të gushtit të vitit 2001 para mbajtjes së Konferencës së Ohrit, e kishte shkelur sërish njëanshmërisht armëpushimin midis UÇK-së dhe forcave qeveritare maqedone, kurse ministri i brendshëm maqedon, Boshkovski, një ditë para mbajtjes së Konferencës së Ohrit, përkatësisht më 12 gusht të vitit 2001 e kishte urdhëruar vrasjen nga ana e njësitit special të policisë maqedone edhe të dhjetë civilëve shqiptarëve në fshatin Luboten, në kufi me Kosovën.

Por, me gjithë veprimet e tilla të palës maqedone, në sajë të tryshnisë ndërkombëtare dhe konstruktivitetit të palës shqiptare, më 13 gusht të atij viti ishte mbajtur Konferenca e Ohrit për rivendosjen e paqes në Maqedoni. Nga konferenca e tillë kishte dalë një dokument kornizë në të cilin shqiptarëve në Maqedoni u ishin njohur disa të drejta më shumë, por që nuk janë aplikuar tërësisht edhe sot e kësaj dite.

### **Rrethanat e ditës kritike të vrasjes së Naser Hanit!**

Në pasditen e ditës së marte të 12 qershorit të vitit 2001, Naseri së bashku me bashkëshorten e tij i kishin nxjerrë fëmijët te bregu i liqenit në periferi të Strugës. Në të vërtetë, Naseri që kur ishte kthyer nga Austria në fund të vitit 1998, duke u marrë me shumëçka as që i kishte shkuar mendja të dilte te bregu i liqenit, por atë ditë ai s'kishte dashur që t'ua prishte familjarëve të tij, të cilët kishin dashur që edhe ai të ishte me ta.

Para se të nisej për të liqeni ia kishte lëshuar një sy xhaketës së tij. Njëherë kishte dashur t'ia shtinte krahët, por papritmas kishte ndërruar mendje. Kishte thënë me vete, s'po e marr se ata (policët maqedonë) së pakut në prani të fëmijëve nuk do të ma mësyjnë, sepse kësisoj edhe nuk mund t'i humbin gjurmët e tyre! Mosmarrja e xhaketës me revolen e tij brenda saj ishte **gabimi i parë tragjik**, të cilin Naseri e kishte bërë atë ditë.

Aty rreth mbrëmjes, Naseri me familjarët e tij ishin nisur nga bregu i liqenit drejt Strugës. Në qendër të Strugës ai e kishte takuar një shok me të cilin ishin ulur në një lokal aty pranë për ta pirë nga një kafe, ndërkohë që bashkëshortja dhe fëmijët ishin nisur drejt banesës. Qëndrimi në kafe dhe ndarja nga familjarët kishte qenë **gabimi i dytë tragjik** që e kishte bërë Naseri atë ditë.

Diku rreth orës 21 të mbrëmjes Naseri ishte nda nga shoku me të cilin kishte pirë kafe, dhe i vetmuar kishte ecur drejtë banesës së tij në periferi të Strugës. Marrja rrugë fare i vetmuar drejt banesës kishte qenë **gabimi i tretë tragjik** i tij.

Te tri gabimet e tilla i kishin plotësuar parakushtet e nevojshme që Naserit diku njëqind metra para se të arrinte te banesa e tij, t'i ishte zënë prita. Pas pak ishin dëgjuar disa të shtëna me armë që ishin zbrazur mbi Naserin nga “njerëz të panjohur!”, të cilët pastaj ishin zhdukur sikur t'i kishte lëshuar toka. Katër plumba të zbrazur mbi trupin e tij e kishin lënë atë të vdekur në vend.

Me t'u dëgjuar krismat e armëve bashkëshortja e Naserit, e cila edhe ashtu kishte jetuar me frikë se Naserin mund ta vriste policia sekrete maqedone, kishte dalë nga banesa dhe kishte arritur me vrap të vendi i ngjarjes, ku e kishte parë Naserin të vrarë dhe të vdekur, por jo edhe vrasësit e tij që kishin ikur në drejtim të panjohur.

Vetë zhdukja e shpejtë e vrasësve nga vendi i ngjarjes kishte folur qartë se ata kishin ikur me makinë. Vetë fakti se ikja e tyre nuk ishte penguar nga patrullat e shumta policore, të cilat për shkak të gjendjes së luftës kishin qenë të vendosura në të gjitha hyrje-daljet e Strugës, kishte dëshmuar se ata që e kishin vrarë Naserin kishin qenë të privilegjuar. Vetë privilegji i tillë pohonte se vrasja e Naserit ishte organizuar dhe realizuar nga strukturat policore monoetnike maqedone, pikërisht ashtu si edhe vetë Naseri e kishte pritur se mund të ndodhte.

## **Nën vrojtim 24-orësh**

Meqë për ta bërë atentatin ndaj Naser Hanit kishin mjaftuar vetëm disa minuta, kur ai kishte qenë i vetmuar dhe i paarmatosur, kjo dëshmonte se ai kishte qenë nën vrojtim të vazhdueshëm 24-orësh nga shërbimi sekret maqedon, derisa ai shërbim më në fund e kishte gjetur rastin e përshtatshëm për ta vrarë. Nuk ka dyshim se të gjithë civilët shqiptarë, të rrëmbyer dhe të vrarë gjatë

luftës së vitit 2001 në Maqedoni, kishin qenë paraprakisht nën vërtetim të vazhdueshëm 24-orësh nga policia sekrete maqedone, derisa ajo i kishte gjetur momentet e shumpritura për t'i rrëmbyer ose për t'i vlarë ata në vend pa lënë asnjë gjurmë.

Meqë rrëmbimet dhe vrasjet e tilla ishin kryer me mjeshtri dhe fshehtësi të përsosur, kjo flet se vërtetimet e tilla 24-orëshe të policisë maqedone ndaj viktimave shqiptare kishin qenë tejet të sakta dhe të suksesshme. Parapërgatitjet e tilla vërtetuese nuk ka dyshim se ishin bërë me paramendim, në mënyrë që rrëmbimet dhe vrasjet e tilla të mos zbulohen e të hetohen asnjëherë.

Kështu, deri me tani nuk është kryer, qoftë edhe një hetim i vetëm serioz lidhur me shqiptarët e rrëmbyer dhe të vlarë gjatë luftës në Maqedoni, dhe për rrjedhojë edhe pas dymbëdhjetë vjetësh pas luftës, nuk dihet asgjë për fatin e të rrëmbyerve në vitin 2001.

### **Policia maqedone në vendin e ngjarjes**

Vetëm pak minuta pas vrasjes së Naserit në vendin e ngjarjes ishte shfaqur policia ordinere maqedone me makinën e saj zyrtare, kuptohet për të lënë përshtypjen sikur ajo duke mos qenë e involvuar në vrasjen e Naserit, kishte ardhur aty për t'i kryer formalitetet e zakonshme policore në këso rastesh: Për të kuptuar se kush ishte vlarë, për t'i bërë fotografimet në vendin e ngjarjes, për t'i marrë shënimet e para lidhur me vrasësit e mundshëm etj. Por bashkëshortja e Naser Hanit, duke qenë e bindur se policia ordinere maqedone, e cila ishte shfaqur në vendin e ngjarjes, kishte qenë në bashkëpunim me policinë sekrete maqedone, e cila para pak minutash e kishte vlarë Naserin, ajo u kishte thënë atyre me zë të lartë e me sa kishte pasur fuqi: “Ikni nga këtu kriminelë!” , “Ju jeni vrasësit e burrit tim bashkë me ata që kanë ikur!”, “Ju jeni shokët e atyre që e vranë Naserin!”, “Shporruni që këtej, kriminelë...!”.

Dhe policët maqedonë kishin ikur duke kryer sipas tyre një udhë e dy punë: Ata kishin krijuar përshtypjen se vrasja e Naserit s'kishte qenë e planifikuar nga policia maqedone, si dhe e kishin vërtetuar vdekjen e sigurt të tij. Kjo e fundit për policinë maqedone e kishte rëndësinë e saj, sepse sikur Naseri po të mos kishte vdekur qoftë edhe për disa minuta, ai, nëse do ta kishte njohur ndonjërin nga vrasësit së pakut do ta përmendte emrin e tij, gjë që do të mjaftonte të kuptohej se “njerëzit e panjohur”, të cilët e kishin vlarë atë në pritë, kishin qenë pjesëtarë të policisë sekrete maqedone.

### **Trupi i Naserit nuk ishte obduktuar**

Trupi i Naserit nuk ishte obduktuar, siç ndodhë zakonisht e detyrimisht në

rast vrasjesh. Në të vërtetë policia maqedone e cila ishte paraqitur në vendin e ngjarjes, as që kishte tentuar që ta merrte trupin e Naserit për obdukim, ndonëse edhe sikur të kishte tentuar, këtë nuk do t'ia mundësonin asaj familjarët e Naserit, sepse vrasësit nuk mund të janë edhe vrasës edhe obdukuar!

Sidoqoftë mosbërja e obduksionit, Ministri së Brendshme të Maqedonisë ia kishte lehtësuar moshetimin e krimit të ushtruar ndaj Naserit.

## **Nata e dhembjes dhe e trishtimit të pafund**

Nata midis 12 e 13 qershorit të vitit 2001 për familjarët e Naserit kishte qenë nata e dhembjes, e pikëllimit dhe e trishtimit të pafundmë! Trupi i Naserit të vrarë ishte rrethuar nga fëmijët e tij, nga bashkëshortja, nga vëllezërit e motrat dhe nga miqtë e shokët e shumë. Shumë të njomë kishin qenë fëmijët e Naserit për ta parë atë të bërë shoshë nga plumbat e shovinistëve maqedonë. Lynkesta kishte qenë 12-vjeçare, Jashari kishte qenë 10-vjeçar, kurse Era kishte qenë 7-vjeçe.

Të gjithë kishin qarë me lot! Por çfarë t'i qanin më parë Naserit! Mos vitet e rinisë e djalërisë, të cilat i kishte kaluar në Kosovë nga demonstrata në demonstratë! Mos torturat çnjerëzore, që i ishin bërë dikur nga UDB-*ashët* maqedonë në burgun e Ohrit! Mos sytë e këqij, që për dekada të tëra e kishin ndjekur nga pas! Mos vitet e mërgimit që i kishte kaluar jashtë vendit! Mos mallin për fëmijët, që s'i kishte parë për vite të tëra! Mos përpjekjet e tij për më shumë se njëzet vjet për ta parë një Kosovë të lirë e të pavarur! Mos përpjekjet e tij për t'i parë shqiptarët në Maqedoni më të lirë e më të barabartë! Mos ëndrrën e tij të madhe për bashkimin kombëtar të shqiptarëve në një Shqipëri të vetme!

Ç'farë t'i qanin më parë atë natë Naserit?!

Mbase atë natë për asgjë s'ishte dashur askush ta qante Naserin. Ai i kishte kryer detyrat e tij ndaj popullit dhe atdheut, të cilat ishte dashur t'i kryente secili shqiptarë.

## **Një vdekje krenare dhe heroike**

Gërvishtjet e shumta në trupin e Naser Hanit kishin dëshmuar, se ai me vrasësit e tij para se të vritej kishte luftuar për jetë a vdekje! Po të ishte qyqar ai do t'u dorëzohej vrasësve të tij, të cilët do ta rrëmbenin duke e futur në makinë dhe më pas do ta vrisnin dalëngadalë, ashtu duke u gjasur me të e duke pirë raki.

Kishte qenë pikërisht akti i mosdorëzimit ai që vrasësit e tij i kishte detyruar që atë ta vrisnin në vend, duke e humbur ata kësaj shansin e

argëtimit të tyre makabër me të. Nuk ka qenë Naser Hani një zog të cilit policia maqedone do të mund t'ia hante mishin ashtu dalëngadalë si duke e pjekur atë në hell!

Kanë qenë pikërisht akti mosdorëzimit dhe për rrjedhojë edhe akti i vdekjes në vend, ato të cilat vdekjen e Naser Hanit e kishin kthyer në një akt burrërie, krenarie e heroizmi! Kush do që të vdesë si burrë, krenarisht dhe heroikisht, le të mësojë nga vdekja e Naser Hanit, kishte thënë shumëkush.

## **Varrim madhështor**

Një ditë pas vrasjes, ditën e mërkurë, më 13 qershor të vitit 2001, Naser Hani ishte varrosur në fshatin e tij të lindjes, në Veleshtë. Në kortezhin e gjatë mortor ishin bashkuar mijëra shqiptarë nga Struga dhe qytetet e tjera shqiptare në Maqedoni për t'i lënë atij lamtumirën e fundit, kësaj here pa marrë parasysh inatet personale dhe dallimet partiake, ashtu siç kishte dashur t'i shihte ata Naseri për të gjallë të tij.

Në krye të kortezhit mortor, i shtrirë mbi tabut të mbuluar me flamur kombëtar kuq e zi kishte prirë vetë Naser Hani, djali i Veleshtës, i Strugës dhe i gjithë shqiptarisë. Ai po i kthehej tokës për të cilën kishte vuajtur dhe ishte përpjekur aq shumë, që ta shihte të lirë dhe për të cilën edhe kishte rënë.

Në ditët në vazhdim qindra, në mos edhe mijëra shqiptarë i kishin ngushëlluar familjarët e Naserit. Një telegram ngushëllimi kishte ardhur edhe nga Kosova, nga Hashim Thaçi, asokohe kryeministër i Qeverisë së përkohshme të Kosovës. Por edhe një mal me ngushëllime kishte qenë pak për ta mbuluar dhembjen e madhe të familjarëve të tij.

Një varr i ri i mbuluar me kurora lulesh ishte parë që larg. Shumëkush e kishte pyetur veten, a kishte vdekur vërtet Naser Hani vetëm pse ishte vrarë!

Duke pasur parasysh se Naser Hani ishte vrarë duke qenë në prapavijë të UÇK-së, kjo kishte bërë që UÇK-ja pas luftës ta shpallte atë dëshmor i kombit!

## **■ Si kishte ndodhur vrasja dhe kush qëndronte pas saj**

### **Çfarë ishte folur në ditët e para pas vrasjes**

Në ditët e para pas vrasjes së Naser Hanit ishte thënë, se ngjarjen e kishte parë një grup fëmijësh, të cilët aty pranë kishin qenë duke luajtur me top; se ngjarjen e kishin parë edhe disa persona të rritur, të cilët më pas nga frika e kishin mbyllur gojën, dhe se ngjarjen e kishte parë edhe një grua e moshuar, e cila pas dy vjetësh kishte vdekur.

Po ashtu në ditët e para pas vrasjes së Naser Hanit ishte thënë, se vrasësit kishin qenë disa persona të panjohur, sipas disave me maska, sipas disave pa maska; se ata kishin qenë në një autobus, sipas disave me targa, sipas disave pa targa; se derisa Naseri kishte qenë duke ecur i vetmuar drejtë banesës së tij minibusi me vrasës i kishte shkuar prapa; se në momentin kritik kur Naseri ishte ndodhur rreth 100 metra para banesës së tij, vrasësit kishin dalë nga minibusi dhe ishin përleshur me të për ta futur në autobus, dhe, meqë këtij qëllimi s'ia kishin arritur, e kishin vlarë atë nga afër me armë zjarri dhe ishin zhdukur.

Kështu ishte folur në ditët e para pas vrasjes së Naserit, pastaj të gjithë ata që kishin folur papritmas ishin stepur. Me kalimin e kohës askush s'kishte thënë se ngjarjen e kishte parë me sy, por vetëm se kishte dëgjuar për të. Shihet qartë se Ministria e Brendshme e Maqedonisë ua ka mbyllur gojën të gjithë atyre që kishin folur fillimisht lidhur me vrasjen e Naserit.

### **Plagët që flisinin vetë!**

Por, nëse ato që ishin thënë në ditët e para pas vrasjes së Naserit kishin qenë thashetheme, katër plagët vdekjeprurëse të shkaktuara me plumba, dhe sidomos gërvishtjet e shumta që ishin parë në trupin dhe në fytyrën e Naserit kishin folur vet se si kishte ndodhur vrasja.

Ato dëshmonin qartë se Naseri para se të ishte vlarë, midis tij dhe vrasësve të tij kishte pasur përleshje trupore.

Vetë përleshjet trupore dëshmonin se vrasësit s'kishin dashur që Naserin ta vrisnin në vend, por kishin dashur që fillimisht ta rrëmbenin dhe pastaj ta vrisnin në fshehtësi.

Vetë përpjekja për rrëmbim fliste qartë se vrasësit kishin pasur një mjet automobilistik me hapësirë të mjaftueshme për ta futur Naserin brenda tij, sipas të gjitha gjasave një lloj minibusi me xhama të errëta për të mos u parë viktimat nga jashtë.

Vetë vrasja e Naserit në vendin e ngjarjes fliste qartë se vrasësit e kishin vlarë atë pasi që s'kishin arritur ta rrëmbenin, dhe sidomos nëse Naseri e kishte njohur ndonjërin prej tyre, me ç'rast vrasësit për ta ruajtur institucionin shtetëror, i cili ata i kishte angazhuar për ta kryer vrasjen, kishin shtënë me armë zjarri katër herë mbi Naserin, në mënyrë që ai si i vdekur të mos mund të dëshmonte gjë.

### **Kush qëndronte pas vrasjes!**

Me 13 qershor, një ditë pas vrasjes së Naserit, politikani shqiptar, Xhevdet Nasufi, asokohe Ministër i Drejtësisë i Maqedonisë, kishte guxuar të deklaronte

se pas vrasjes së Naser Hanit qëndronte Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë. Duke pasur parasysh se Xhevdet Nasufi dhe Naser Hani i takonin të njëjtës parti (PDSH-së), ishin nga fshati i njëjtë, si dhe kishin qenë shokë e miq të ngushtë, deklarata e tillë e Xhevdet Nasufit ishte jo vetëm e rëndësishme por edhe shumë e besueshme.

Pothuaj se të njëjtën gjë e kishte pohuar edhe kryetari i PDSH-së Arben Xhaferi në intervistën e tij dhënë VOA-së më 14 qershor të vitit 2001, në të cilën ai kishte thënë se “Naser Hani nga një grup ende i panjohur, me siguri i përbërë nga segmente sekrete shtetërore, u kidnapua dhe u vra!”.

Nga ana tjetër, si mediat e shkruara në gjuhën shqipe, ashtu edhe agjensitë e lajmeve ndërkombëtare, të cilat kur ishte vra Naseri kishin qenë në Maqedoni, kishin shkruar drejtpërdrejt ose tërthorazi se prapa kidnapimeve (rrëmbimeve) të dhjetëra shqiptarëve dhe të vrasjes së Naserit me atentat, qëndronte Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë.

Vetë biografia politike e Naser Hanit me përndjekje shumëvjeçare, dhe vetë plani i parealizuar i shërbimit sekret maqedon për ta likuiduar atë që në vitin 1993, dëshmonte se i njëjti shërbim sekret kësaj radhe ia kishte arritur qëllimit: E kishte bërë atentatin mbi Naser Hanin tamam ashtu siç mund ta bëjë institucioni i shtetit, profesionalisht e pa lënë asnjë gjurmë!

Vetë dosja sekrete e Naserit, e hartuar nga shërbimi sekret i Serbisë në Kosovë dhe shërbimi sekret maqedon brenda viteve 1981-1991, kishte dëshmuar tërthorazi se prapa vrasjes së tij qëndronin strukturat sekrete maqedone në kuadër të Ministrisë së Brendshme të këtij vendi.

Vetë Fakti se Naser Hasni s'kishte pasur asnjë kontest privat me askënd (nëse ndonjë të tillë nuk i ka montuar shërbimi sekret maqedon), fet se vrasja e tij nuk ishte bërë për konteste private dhe nga persona privatë, por nga institucioni i caktuar i shtetit për shkaqe politike.

Fakti se gjatë luftës në Maqedoni, edhe para se të ishte atentuar Naser Hani, ishin rrëmbyer pa lënë asnjë gjurmë rreth 50 civilë shqiptarë, si dhe ishin likuiduar në fshehtësi dhjetëra të tjerë, fliste qartë se të gjitha rrëmbimet dhe vrasjet e tilla, duke përfshirë këtu edhe vrasjen e Naser Hanit, ishin realizuar gjithnjë nga i njëjti kallëp institucional, në rastin konkret nga resori i policisë sekrete maqedone.

Vetë fakti se gjatë kohës së luftës në Maqedoni, në pushtet ishte partia e VMRO/DPMNE-së me prirje historike dhe tradicionale për rrëmbime dhe atentate të fshehta, fliste se edhe rrëmbimet e dhjetëra civilëve shqiptarë bashkë me atentatin e kryer ndaj Naser Hanit, nuk i kishte bërë askush tjetër përveç eksponentëve terroristë të kësaj partie brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë.



Dhe së fundi, vetë fakti se ministër i Punëve të Brendshme të Maqedonisë kishte qenë Ljube Boshkovski, i cili gjatë luftës në Maqedoni kishte treguar epshe të shfrenuara vrasare dhe kriminale ndaj shqiptarëve, dëshmonte se rrëmbimet e shqiptarëve dhe vrasjen e Naser Hanit, e kishte organizuar dhe realizuar pikërisht kjo ministri dhe ky ministër.

Kështu, lidhur me atë se kush qëndronte pas vrasjes së Naserit, “të gjitha rrugët të shpinin drejt Romës!”, përkatësisht drejt Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, drejt resorit të policisë sekrete të kësaj ministrie dhe drejt ministrit Boshkovski me shokë.

Ajo që deri më sot ka mbetur e mistershme dhe e panjohur është identiteti i vrasësve të Naser Hanit. Por, edhe për këtë ka ekzistuar dhe ekziston një dëshmitar kryesor. Ai është Ljube Boshkovski, ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë i kohës së luftës në këtë vend.

Personalisht nuk besoj se Naser Hani është vrarë nga ana e shqiptarëve, sepse po të ishte vrarë nga ana e shqiptarëve, Ministria e Brendshme e Maqedonisë për t'i përçarë shqiptarët sa më shumë, këtë do ta bënte publike menjëherë pas vrasjes së Naserit që në qershorin e vitit 2001.

## ■ Ministria dhe ministri që s'kishin pasur si ta hetonin veten

### Taktika e heshtjes dhe e moshetimit

Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë lidhur me vrasjen e Naser Hanit e kishte zgjedhur taktikën e heshtjes dhe të moshetimit.

Kështu, policia maqedone përveç dy-tri deklaratave të shkurtra se “në Strugë nga njerëz të panjohur ishte vra Naser Hani”, nuk kishte bërë asnjë hetim serioz lidhur me vrasjen e Naserit. Por, hetimi i vrasjes së Naser Hanit as që kishte mundur të bëhej, sepse duke qenë Ministria e Brendshme maqedone dhe ministri i saj Boshkovski autorë të saj, kjo ministri dhe ky ministër s'kishin pasur si ta hetonin veten.

Nga ana tjetër, edhe përpjekjet e ministrit të Drejtësisë të Maqedonisë, Xhevdet Nasufi, që të zhvilloheshin hetime lidhur me vrasjen e Naser Hanit kishin qenë të kota, sepse ato ishin sabotuar jo vetëm nga strukturat e Ministrisë së Brendshme maqedone, por edhe nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë të cilën ai e kishte udhëhequr formalisht, ndërkohë që të gjitha strukturat dhe hallkat e kësaj ministrie kishin qenë njëanshmërisht vetëm në duart e maqedonëve.

Por, jo vetëm Ministria e Brendshme maqedone e kohës së luftës, por edhe

të gjitha ministrinë e tjera të brendshme bashkë me ministrinë e drejtësisë maqedone të viteve të pasluftës, duke qenë nën diktatin e të njëjtës parti në pushtet, VMRO/DPMNE, lidhur me rrëmbimin e civilëve shqiptarë dhe lidhur me vrasjen e Naser Hanit dhe të civilëve të tjerë, deri me tani nuk kanë bërë asnjë hetim serioz.

Duke pasur parasysh se partia VMRO/DPMNE në pushtet, në korrikun e vitit 2006 e kishte marrë edhe zyrtarisht në mbrojtje ministrin e Punëve të Brendshme të kohës së luftës në Maqedoni, Boshkovskin, i cili kishte qenë asokohe në burgun hetues të Hagës, i akuzuar për krime lufte, kjo fliste qartë se brenda VMRO/DPMNE-së kishte pasur edhe shumë Boshkovska të tjerë. Fakti se policia maqedone edhe pas luftës së vitit 2001, në fshatrat rreth Tetovës dhe Kumanovës ka vlarë me armë zjarri dhjetëra të rinj shqiptarë, duke i akuzuar ata si terroristë, po ashtu flet se brenda krerëve pushtetarë të VMRO/DPMNE-së ka edhe Boshkovska të tjerë, të cilët nuk heqin dorë nga krimet e tyre ndaj shqiptarëve.

### **Boshkovski dhe Turçullovski para Tribunalit të Hagës**

Meqë ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë i kohës së luftës, Ljube Boshkovski, dhe shefi i njësitit të policisë speciale maqedone, Johan Turçullovski, ishin dyshuar për krime lufte, ata u ishin nënshtruar hetimeve në Tribunalin e Hagës, duke qëndruar në burgun e Scheveningen-it, Boshkovski midis viteve 2004-2008, kurse Turçullovski midis viteve 2005-2009.

Në të vërtetë shkaku fillestar pse Boshkovski dhe Turçullovski ishin dyshuar nga Tribunali i Hagës për krime lufte, kishte të bënte me vrasjen e gjashtë pakistanezëve dhe të një indiani në marsin e vitit 2002 në fshatin Luboten, vrasje kjo e cila ishte urdhëruar nga Boshkovski dhe ishte zbatuar nga Turçullovski së paku për dy qëllime: E para, për t'i njolllosur shqiptarët me fundamentalizëm islamik, kjo duke deklaruar sikur gjoja pakistanezët dhe indiani kishin ardhur në fshatin Luboten që bashkë me shqiptarët, të kryenin akte terroriste ndaj ambasadave të caktuara të vendeve perëndimore në qytetin e Shkupit, dhe e dyta, për ta marrë Boshkovski epitelin e luftëtarit të paepur kundër fundamentalizmit islamik, dhe kësajsoj ta përmirësonte imazhin e tij prej kriminelit para SHBA-ve dhe vendeve të caktuara perëndimore.

Por, meqë më pas ishte kuptuar se pakistanezët dhe indiani i shkretë s'kishin pasur asnjë lidhje me fundamentalizmin islamik, por kishin dashur që duke kaluar nëpër Maqedoni të arrinin në Greqi ku kishin shpresuar të gjenin punë, gjykata e Hagës e kishte urdhëruar arrestimin e Boshkovskit në prillin e vitit 2004 dhe të Turçullovskit në marsin e vitit 2005. Meqë Boshkovski kishte qenë

edhe nënshtetas i Kroacisë, ai ishte fshehur për një kohë në lokalitetin Bale të Kroacisë, ku ishte arrestuar nga autoritetet kroate dhe ishte dërguar në Hagë.

Akuza tjetër, e cila kishte rënduar mbi Boshkovskin dhe Turçullovskin, kishte të bënte me vrasjen e tre shqiptarëve civilë (në të vërtetë të dhjetë shqiptarëve) po në fshatin Luboten, me torturimin e njëqind të tjerëve dhe me djegien e 14 shtëpive të shqiptarëve më 12 gusht të vitit 2001 nga ana e policisë speciale të Maqedonisë, me ç'rast urdhërues i krimeve të tilla sërish kishte qenë Boshkovski, kurse zbatues Turçullovski.

Në korrikun e vitit 2008 gjykata e Hagës, jo për shkak të vërtetimit të pafajësisë, por për shkak të pamjaftueshmërisë së provave materiale, Boshkovskin e kishte liruar nga akuzat e lartpërmendura dhe nga burgu i Scheveningen-it. Në aeroportin e Shkupit “Aleksandri i Madh”, Boshkovskin e kishte pritur asokohe si një hero kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski.

Sipas të dhënave në mediat elektronike<sup>9</sup> Boshkovski në nëntorin e vitit 2011 është dënuar nga gjykata e Shkupit me shtatë vjet burg, sepse ai në zgjedhjet e qershorit të vitit 2011 kishte marrë para nga një donator maqedon nënshtetas i huaj, për t'ia shpërndarë ato elektoratit maqedon që ai ta votonte partinë e tij “Bashkimi për Maqedoninë”, të cilën e kishte themeluar në vitin 2009. Por, meqë donatori i tij kishte qenë agjent i policisë sekrete maqedone, Boshkovski ishte arrestuar pikërisht në momentin kur ai kishte qenë duke i marrë parat nga donatori i tij, i cili më pas në cilësinë e “dëshmitarit të mbrojtur” kishte dëshmuar kundër Boshkovskit në gjykatë.

Sipas të gjitha gjasave akuza për shpërndarje parash elektoratit maqedon ka qenë vetëm shkas, kurse shkaku i vërtetë i burgosjes së Boshkovskit ka mundur të jetë shantazhi që Boshkovski duke qenë konfliktuoz dhe i paparashikueshëm, ka mundur të ushtrojë ndaj disa figurave politike të VMRO-së, të cilat duke pasur poste udhëheqëse në kuadër të Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë, gjatë luftës së vitit 2001 kanë bërë krime ndaj civilëve shqiptarë, si me rastin e rrëmbimit, ashtu edhe me rastin e vrasjes së tyre me atentate të fshehta, siç kishte ndodhur edhe me Naser Hanin. Kështu, mbase për t'ia mbyllur gojën Boshkovskit lidhur me përgjegjësitë e mundshme penalizuese të VMRO-istëve të tjerë, ai është dënuar me shtatë vjet burg.

Sa i përket Turçullovskit, gjykata e Hagës e kishte dënuar atë në vitin 2008 me 12 vjet burg prej të cilave ai i ka mbajtur vetëm tre vjet. Turçullovski ishte dënuar sepse Boshkovski të gjitha fajet lidhur me krimet e përmendura më lartë, ia kishte hedhur Turçullovskit, sikur gjoja ai i kishte kryer ato pa dijen e

---

<sup>9</sup> <http://www.naslovi.net/2011-11-29/emportal/boskovskom-sedam-godina-robije/2993784>

Boshkovskit. Pas lirimit të Turçullovskit nga burgu i Scheveningen-it në vitin 2009, ai para kamerave televizive jep një deklaratë<sup>10</sup>, në të cilën veç sa nuk e falënderon Tribunalin e Hagës, i cili me gjithë krimet e mëdha që ai ka bërë ndaj shqiptarëve, megjithatë, e ka nxjerrë atë si “kimën prej tëlyenit”, me vetëm me tre vjet burg!

Fatkeqësisht, hetuesit e Tribunalit e Hagës ishin marrë vetëm me hetimin e krimeve të luftës të ushtruara nga Boshkovski dhe Turçullovskit në fshatin Luboten, por ata nuk ishin marrë me shumë krime të tjera që ata dhe strukturat e tjera të komanduara prej tyre, kishin kryer ndaj shqiptarëve gjithandej Maqedonisë perëndimore.

Hetuesit e Hagës në radhë të parë nuk ishin marrë me fatin e rreth 50 civilëve shqiptarë të rrëmbyer gjatë luftës në Maqedoni; me torturat, përzënien dhe djegiet e shtëpive të shqiptarëve në qytetin e Manastirit; me vrasjen e disa të rinjve shqiptarë në qytetin e Shkupit, dhe me vrasjet e kryera me atentate të fshehta, përfshirë këtu edhe atentatin e kryer ndaj Naser Hanit.

## **Krime që as nuk harrohen e as nuk vjetrohen**

Por mashtrohen ministrinë e njëpasnjëshme të punëve të brendshme dhe ato të drejtësisë maqedone, nëse mendojnë se krimet e ushtruara ndaj shqiptarëve gjatë luftës së vitit 2001 do të harrohen e do të vjetrohen një ditë! Përkundrazi, krimet e tilla, përfshirë edhe krimin e vrasjes së Naser Hanit, kanë për t'u zbuluar deri në detaje. Ato do të zbulohen në të ardhmen jo nga ana e drejtësisë maqedone, por nëpërmjet të luftës së mëtejshme të shqiptarëve në Maqedoni për barazi kombëtare dhe liri!

Meqë shtypja etnike ndaj shqiptarëve në Maqedoni ka vazhduar e po vazhdon edhe pas luftës së vitit 2001, kjo do të thotë se si lufta e mëtejme e shqiptarëve për liri dhe barazi, ashtu edhe zbulimi i krimeve të ushtruara ndaj tyre nga strukturat përkatëse maqedone do të janë të pashmangshme.

---

<sup>10</sup> <http://www.youtube.com/watch?v=k1CiuveC8sl&feature=related>

## **XVI. Reagimet publike lidhur me vrasjen e Naser Hanit**

### **■ Vrasje që ishte pritur me shqetësim**

Derisa Ministria e Brendshme e Maqedonisë lidhur me vrasjen në Strugë të Naser Hanit e kishte zgjedhur heshtjen dhe fshehjen e krimit të bërë nga ajo vetë, opinionin politik dhe publicistik shqiptar dhe ndërkombëtar s'e kishte ndjekur aspak shembullin e tillë. Përkundrazi, mediat elektronike dhe audiovizuale shqiptare dhe ndërkombëtare, lidhur me vrasjen e Naser Hanit kishin shkruar gjerësisht dhe me shqetësim të madh. Natyrisht, se shqetësimi i tillë nuk kishte të bënte me atë se në Strugë ishte vrarë një shqiptar dhe ishte bërë nami, në një kohë që në këtë botë vriten nga plumbat ose vdesin nga uria qindra në mos edhe mijëra njerëz çdo ditë, por shqetësimi kishte të bënte në radhë të parë me pasojat e mundshme të vrasjes së tij në raport me rrjedhat e mëtejshme të luftës në Maqedoni.

Kështu, mediat shqiptare dhe ndërkombëtare kishin alarmuar, se pas vrasjes së Naser Hanit do të mund të hapej edhe një vatër e re lufte në Maqedoninë jugperëndimore, sidomos kur i vrari, Naser Hani, kishte qenë një figurë politike, sa e njohur aq edhe e dhembshur nga popullata lokale, e cila ishte pritur që të reagonte ashpër! Më tej, shtypi shqiptar dhe ndërkombëtar kishte aluduar se rrëmbimet e shumta të civilëve shqiptarë dhe vrasja e Naser Hanit, do të mund të çonin deri te dështimi i bisedimeve për zgjidhjen paqësore të konfliktit midis palëve ndërluftuese, gjë që Maqedoninë do të mund ta shpinte drejtë luftës totale ndëretnike, me mundësi të përhapjes së saj edhe në vendet fqinje. Analistë politikë dhe publicistë të ndryshëm të medieve ndërkombëtare, ndonëse nuk ishin shprehur hapur, megjithatë, kishin lënë të nënkuptohej se rrëmbimin e civilëve shqiptarë dhe vrasjen e Naser Hanit e kishte bërë Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë për qëllime politike, përkatësisht për t'i dhënë rrjedha të tjera luftës në Maqedoni. Në shtypin shqiptar dhe ndërkombëtar

vihet në spikamë sidomos veprimtaria luftënxitëse e ministrit të Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Ljube Boshkovskit, i cili kishte dashur që krizën në Maqedoni ta zgjidhte domosdoshmërisht me rrugë ushtarake, përkatësisht më luftime të mëtejshme.

Lidhur me vrasjen e Naser Hanit qeveritarëve maqedonë u ishin shtruar asokohe pyetje të drejtpërdrejta edhe nga ana e figurave kryesore të politikës ndërkombëtare, të cilat ishin angazhuar për rivendosjen e paqes në Maqedoni. Jo pse atyre u ishte dhimbsur aq shumë Naser Hani, por sepse ata vrasjes së Naser Hanit në fund të luftës dhe para mbajtjes së bisedimeve për paqe në qytetin e Ohrit ia kishin kuptuar prapaskenën, e cila pohonte se pala maqedone s'kishte qenë për paqe, por kishte dashur luftë të mëtejshme kundër shqiptarëve.

Për t'i njohur lexuesit e këtij libri me publikimet e bëra lidhur me vrasjen e Naser Hanit më poshtë ato jepen një nga një. Fillimisht jepen shkrimet e bëra në mediat e gjuhës shqipe, dhe më pas ato në gjuhë të huaja. Këto të fundit jepen fillimisht të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe më pas edhe në origjinalin e gjuhës përkatëse. Për shkak të tendencave spekulative dhe antishqiptare, në këtë libër nuk jepen reagimet e medieve maqedone dhe serbe.

## ■ Shkrime në mediat shqiptare

1

**KOSOVAPRESS - TETOVË, 13 qershor 2001**

**“Dyshohet se vrasja e Naser Hanit është pjesë e planit të Trajkovskit për “mbrojtje nga shqiptarët”**

Mbrëmë rreth orës 21 e 30 minuta, nga forcat e sigurimit Maqedon në Strugë, është varur Naser Jashar Hani, bëjnë të ditur burimet e Kosovapress-it. Naser Hani, ish i burgosur politik, baba i tre fëmijëve nga Veleshta e Strugës, ishte njëri nga udhëheqësit e Partisë Demokratike të Maqedonisë, në qytetin e Strugës.

Siç duket, marrëveshja për armëpushim nga Qeveria maqedonase, po u ndihmon strukturave të shërbimit sekret maqedonas, që në mënyrë të organizuar të bëjë eliminimin e veprimtarëve shqiptarë.

2

**STRUGË (KosovaLive) 13 qershor 2001 11:45 PM**

Burime të *KosovaLive* nga qyteti i Strugës bëjnë të ditur se mbrëmë është varur Naser Hani nga fshati Veleshtë e Strugës.

Sipas familjarëve të tij, i ndjeri, pasi i ka rezistuar tentativës për kidnapim, është qëlluar para banesës së tij në Strugë me breshëri automatiku nga disa persona që kanë qenë në një furgon. Naser Hani ka qenë aktivist i partive shqiptare në Maqedoni.

Policia maqedone tani për tani, përveç konfirmimit të vdekjes së Hanit, nuk jep kurrfarë detale, por vetëm se “rasti ka ndodhur mbrëmë dhe janë duke u bërë hetimet”. Ka dy muaj që në Strugë janë kidnapuar dy persona të tjerë, Sulltan Mehmeti nga Ladorishta dhe një i ri nga Dollogozhda.

### 3

#### **Prishtinë, 13 qershor (QIK)**

Të martën në mbrëmje në Strugë është vrarë Naser Hani, një aktivist i PDSH dhe drejtor i Qendrës për mirëqenie sociale në këtë qytet. Zoti Hani është vrarë në orën 21.00 në momentin kur në drejtim të tij është hapur zjarr nga një automjet në lëvizje.

Burimet shqiptare ndërkaq, thonë se sulmuesit kanë tentuar të rrëmbejnë zotin Hani.

### 4

**Wed, 13 Jun 2001 14:50**

**neim.rustemi@idun.no**

#### **Vritet Naser Hani, me breshëri automatiku**

Mbrëmë rreth orës 21 e 30 minuta, nga forcat e sigurimit Maqedon në Strugë, është vrarë Naser Jashar Hani nga Veleshta. Sipas familjarëve të tij, i ndjeri, pasi i ka rezistuar tentativës për kidnapim, është qëlluar para banesës së tij në Strugë me breshëri automatiku nga disa persona që kanë qenë në një furgon. Naser Hani ka qenë aktivist i partive shqiptare në Maqedoni. Policia maqedone tani për tani, përveç konfirmimit të vdekjes së Hanit, nuk jep kurrfarë detale, por vetëm se “rasti ka ndodhur mbrëmë dhe janë duke u bërë hetimet”.

Naser Hani, ish i burgosur politik, baba i tre fëmijëve nga Velesha e Strugës, ishte njëri nga udhëheqësit e Partisë Demokratike të Maqedonisë, në qytetin e Strugës. Siç duket, marrëveshja për armëpushim nga Qeveria maqedonase, po u ndihmon strukturave të shërbimit sekret maqedonas, që në mënyrë të organizuar të bëjë eliminimin e veprimtarëve shqiptarë.

5

## **Intervistë me zotin Arbën Xhaferri**

**14 Jun 2001 19:35 UTC**

VOA- Zoti Xhaferri ju sot patët takim me Zotin Roberston dhe Zotin Solana. Çfarë u bisedua në këto takime?

...XHAFERRI-.....Nga ana ime hodha idenë e krijimit të një agjende të prioritetëve. Prioriteti i parë gjithsesi duhet të jetë armëpushimi i dyanshëm; prioriteti i dytë do jetë parandalimi i degjenerimit të sistemit, pas shfaqjes së fenomenit të njërive paramilitare që kidnapojnë apo vrasin, si ishte rasti me aktivistin tonë zotin Naser Hanin ku nga një grup ende i panjohur, me siguri i përbërë nga segmente sekrete shtetërore, u kidnapua dhe u vra. Pra, ne kërkojmë që të parandalohet degjenerimi i sistemit, format e krijimit të rezervistëve të ashtuquajtur që janë pjesë ndihmëse e strukturave ushtarake. Nga ana tjetër kërkuam prezencën sa më të fuqishme të NATOS në këto hapësira...

6

## **Materiale ekskluzive nga FAKTI - SHKUP**

**jetmir tetova-l at alb-net.com; 21 Qershor 2001**

## **SHOQËRIA MAQEDONASE PO MILITARIZOHET**

**Nga Emin Azemi**

Në Maqedoni terrori kundër shqiptarëve po institucionalizohet. Veprimi i papengueshëm i organizatave terroriste maqedonase tashmë është bërë publik edhe nga mediat e huaja. Terroristët maqedonas po përdorin metoda të ndryshme të veprimit. Fillimisht ata kanë vënë në dispozicion një makinë të fuqishme të propagandës psikologjike kundër shqiptarëve, që po përcillet edhe me akte të dhunshme e antiligjore, siç janë rastet e shumta të kidnapimeve të shqiptarëve eminent.

Nga dora gjakatare e këtyre terroristëve ditë më parë u vra Naser Hani, një aktivist i PDSH-së nga Veleshta. Arsyeja pse ai ka qenë cak i likudimit lidhet me aktivitetin e tij politik në rrethin e Strugës dhe atyre që u pengojnë aktivitetet patriotike të shqiptarëve zgjedhin mënyrat më bizare, siç vepruan edhe me Naser Hanin, duke ia shuar jetën para kohe. Të afërmit dhe miqtë e Hanit kanë dyshuar se kjo vrasje është politike, e porositur nga një qendër që komandon shfarosjen e shqiptarëve. Disa organizata joqeveritare ndërkombëtare kanë përmendur edhe mundësinë e përzjerjes së strukturave të caktuara policore në likuduimin e zotit Hani. Një prej atyre organizatave është edhe ajo me emrin "Todor Aleksandrov"



## **Listat e zeza për kidnapim dhe likuidim**

Paraqitja e vrasësve me maska, që në shënjestër kanë shqiptarët, u bë dukuri pas eskalimit të konflikteve të armatosura në Maqedoni. Vrasja e një biznesmeni shqiptar, para dy muajve, në restorantin “Llozana” në Shkup nga njerëz të maskuar dhe përsëritja e akteve të ngjashme makabre, këtyre ditëve, në Çollopek e Porroj të Tetovës, flasin për një plan mirë të organizuar të nëntokës maqedonase, e cila që me kohë ka përpiluar lista për likuidim të intelektualëve, politikanëve, gazetarëve, arsimtarëve shqiptarë. Nëse kësaj liste i shtojmë edhe një tjetër prej afro 50 vetave që llogariten si të kidnapuar dhe të zhdukur, atëherë lirisht mund të thuhet se përmasat e terrorit kundër shqiptarëve kapin dimensione rrëqethëse. Shqetësimi bëhet edhe më i madh kur organizatat dhe institucionet e shtetit ose janë të pafuqishme ose indiferente në pengimin e këtij terrori.

Të afërmit deklarojnë se nuk kanë njohuri se ku mbahen të kidnapuarit. Disa burime anonime policore thonë se të kidnapuarit nuk mbahen në ambiente legale të Ministrisë së Brendshme, por në banesa private, jashtë syve të opinionit dhe në rrethana tepër diskrete. Nuk dihet nëse të kidnapuarit janë gjallë, apo jo, për arsye se shumica prej tyre as që kanë kaluar nëpër procedurën normale të hetuesisë, kështu që supozimet se ata mbahen në mënyrë jolegale dhe ka të ngjarë të likuidohen, pikërisht nga formacionet paramilitare maqedonase, mund të jenë mëse të bazuara.

Situatën e bën më të vështirë edhe mobilizimi i afro 15 mijë rezervistëve të policisë, shumica e të cilëve janë të njohur në polici si njerëz me dosje kriminele. Aktivizimi i hajnave, të çmendurve, narkomanëve, vrasësve jo vetëm që e degradojnë autoritetin e organeve legale të Punëve të Brendshme, por të njëjtat i shndërron në ekzekutorë të një politike antinjerëzore. Në vend se qytetarët të gëzojnë mbrojtjen e policisë nga njerëzit e tillë, këta të fundit vetë e marrin ligjin në duar dhe zbatojnë rregulla të xhunglës. Prandaj, sot në Maqedoni është shumë vështirë të dallosh një polic legal nga një tjetër ilegal, i cili mban armë, legjitimacion, uniformë, sikur të ishte polic legal.

Pikërisht për këtë çështje është hapur debat në Trupin koordinues pranë Qeverisë së Maqedonisë, ku nuk kanë munguar edhe kritikata e drejtpërdrejta në adresë të ministrit të Punëve të Brendshme, Boshkovski, për shkeljen e procedurës në dhënien e armëve civilëve maqedonas. Në informatën e tij, që është kërkuar nga anëtarët e këtij trupi, kanë munguar elementet që e bëjnë një mobilizim të jetë sipas standardeve ligjore në fuqi.

Në radhë të parë është shkelur kriteri nacional, sepse të gjithë të mobilizuarit janë maqedonas, pastaj është shkelur kriteri i përshtatshmërisë së individëve,

sepse shumica prej tyre janë me dosje kriminele, si dhe është shkelur kriteri që përcakton rregullat se kur, ku dhe si mbahet arma, në çfarë relacioni duhet të sillet i mobilizuari dhe në çfarë raste përdoret arma.

Si pasojë e shkeljes së këtyre kriterëve ne sot në Maqedoni kemi raste të shumta të shkrepsjes së armëve në pikë të natës, si rezultat i qejfit që ka shkaktuar një birrë më shumë në dozën e kokës së hallakatur të të mobilizuarit.

## **Dorëheqjet bllokjnë punën e trupit koordinativ të qeverisë Pos Boshkovskit, është larguar edhe Goran Mitevski**

Në mbledhjen e fundit të Trupit koordinativ të Qeverisë, Ministria e Punëve të Brendshme ka ofruar vetëm informatë të pjesërishtme lidhur me listën e personave, për të cilët dyshohet se janë arrestuar nga ana e policisë, apo nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

Dorëheqjet në Trupin koordinativ të Qeverisë rrezikojnë bllokimin e punës së këtij trupi, vetëm një javë pas formimit të tij. Përpos ministrit të Punëve të Brendshme, nga Trupi koordinativ i Qeverisë, për shkaqe deri më tani të panjohura, dorëheqje ka dhënë edhe drejtori i Drejtorisë për siguri publike, Goran Mitevski. Në mbledhjen e ditës së martë të këtij trupi, në vend të ministrit Boshkovski është emëruar zëvendësi i tij, Refet Elmazi, kurse në vend të Mitevskit është emëruar Zoran Verushevski, drejtori i Drejtorisë për siguri shtetërore.

Një burim nga Trupi koordinativ dje na njoftoi se me këto dorëheqje, faktikisht është bllokuar puna e këtij trupi rreth çështjeve më të rëndësishme. Kjo për shkak se Boshkovski dhe Mitevski ende nuk kanë bërë të njohur se a janë tërhequr si individë apo si institucione. Sipas burimit tonë, marrja e vendimeve të mëtutjeshme nga ana e Trupit koordinativ do të ishin të kota, sepse zbatimi i atyre vendimeve do të ishte i pamundshëm pa dhënien e pëlqimit nga ana e ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Sigurisë publike.

Në mbledhjen e fundit, e cila edhe pse ka zgjatur më tepër se dy orë, nuk është shqyrtuar asnjë prej çështjeve kyçe, por vetëm disa çështje teknike. Njëri nga anëtarët ka propozuar, kurse trupi ka pranuar që për qartësimin e situatës së krijuar me dorëheqjet e dhëna të bisedohet me kryetarin dhe kryeministrin, sepse Refet Elmazi, si zëvendësministër nuk mund t'i marrë të gjitha kompetencat, pa autorizim nga ana e ministrit. Tani për tani, si rezultat i dorëheqjes së ministrit, mes tjerash, është bllokuar edhe formimi i forcave të përbashkëta ushtarake-policore të paralajmëruara dy javë më parë. Mbetet që në ditën e sotme të shqyrtohen mënyrat për tejkalim të situatës së krijuar brenda trupit koordinativ.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Refet Elmazi, për FAKTI-n dje deklaroi se edhe ashtu nuk ka ndër mend të marrë pjesë në punën e Trupit koordinativ. “Ministri Boshkovski deklaroi se jep dorëheqje për shkak të dallimeve në koncepte rreth tejkalimit të krizës. Ai haptas tha se është për zgjidhje ushtarake dhe se nuk pajtohet të rrijë së bashku me PDSH, PPD dhe LSDM, për shkak se ata dëshirojnë zgjidhje paqësore të krizës. Edhe unë e përkrah konceptin për zgjidhje paqësore të krizës, kështu që është e palogjikshme unë ta zëvendësoj Ljube Boshkovskin”,- tha zëvendësministri Elmazi.

Në mbledhjen e fundit të Trupit koordinativ të Qeverisë, Ministria e Punëve të Brendshme ka ofruar vetëm informatë të pjesërishtme lidhur me listën e personave, për të cilët dyshohet se janë arrestuar nga ana e policisë, apo nuk dihet asgjë për fatin e tyre. Anëtar i këtij Trupi koordinativ, zëvendëskryeministri Ixhet Memeti, i cili edhe e ka kërkuar informatën për fatin e rreth 50-të personave, për “Fakti”-n tha se, në përgjigjen zyrtare të MPB-së janë përfshirë informatat për vetëm një pjesë të këtyre personave, gjegjësisht për vetëm 20 persona ndaj të cilëve udhëhiqen procedura të ndryshme. Megjithatë, në mbledhjen e fundit kanë munguar informata për numrin më të madh të tyre, gjegjësisht për 34 persona të tjerë, me arsyetim se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur informatat për të gjithë personat e përfshirë në listë. Nga MPB kanë premtuar se do të përgatisin informata edhe për pjesën tjetër të personave të përfshirë në këtë listë sa më shpejt që është e mundur. “Në takimin e sotshëm përsëri do ta parashtroj këtë çështje, dhe shpresoj se shumë shpejt MPB do të ofrojë përgjigje për vendndodhjen e këtyre personave, dhe procedurat eventuale që udhëhiqen ndaj tyre”,- tha dje Ixhet Memeti.

Dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme, Ljube Boshkovski, nga posti i anëtarit në Trupin koordinativ të Qeverisë, Ixhet Memeti e vlerëson si hap të gabuar, i cili nuk i kontribuon realizimit të qëllimit për të cilin është formuar ky trup, gjegjësisht ballafaqimit të suksesshëm me krizën. Sipas tij, të papranueshme dhe të pabaza janë edhe arsyet, të cilat i ka paraqitur Boshkovski përë këtë dorëheqje.

## 7

### *Newsletter*

### **Bashkësia Shqiptare në Austri mbajti Mbrëmje përkujtimore dinjitoze për atdhetarin Naser Hani**

### **Newsletter**

Bashkësia Shqiptare në Austri mbajti të shtunën në Vjenë Mbrëmje përkujtimore kushtuar themeluesit të kësaj bashkësie, atdhetarit të shquar ndaj

të cilit më 12 qershor 2001 u ushtrua atentat në Strugë, Naser Hanit. Mbrëmja u hap me intonimin e himnit kombëtar dhe pastaj u ftuan të pranishmit që me një minutë heshtje t'i bëjnë nderime të ndjerit. Pastaj fjalën e mori bashkëpunëtori i ngushtë i tij, z. Abdullah Abdullahu, i cili në emër të Këshillit organizativ të Mbrëmjes përkujtimore foli për jetën dhe veprën e Naserit, duke theksuar se puna e të ndjerit i përfshinte dy dekada (1981-2001), në të cilat ai intensivisht u angazhua për çështjen kombëtare shqiptare, duke e vënë shpesh edhe jetën në rrezik për t'i realizuar qëllimet e tija të larta.

Të pranishëm në tubim ishin edhe anëtarë të organizatave të tjera shqiptare në Austri.

Kështu, në emër të Shoqërisë së Studentëve Shqiptarë në Austri „Societas Albania“, e rithemeluar ndër të tjerë, nga vetë Naser Hani, foli kolegu dhe bashkëveprimtari i tij, z. Nuri Bexheti, i cili duke i përkujtuar disa momente të jetës me Naserin, e solli edhe një herë atë para të pranishmeve në sallë, të tillë si edhe e njihnin – shumë të afërt, human dhe gjithnjë të qeshur: „Naseri me dëshirë të madhe i afronte të gjithë studentët në Vjenë dhe si i tillë na mungoi shumë pasi që u kthye në Strugë në vitin 1998“. Ai vuri në dije se i vrari në fjalë edhe përkundër asaj që e ndiente rrezikun që po i kanosej në Strugë, kishte thënë se nuk do të largohej, se nuk donte të jetë shembull për të tjerët për t'u larguar nga Struga në këtë situatë të rëndë që po mbretëronte.

Naser Hani ishte edhe themelues i Shoqatës së veleshtarëve në Vjenë dhe në këtë mbrëmje në emër të kësaj shoqate foli z. Hashim Istrefi. Duke e përkujtuar me nder bashkëvendësin e tij të çmuar ndër të tjera ai tha: „për të përmbledhur punën dhe veprën e Naserit do të duheshin shkruar libra të tërë“, dhe shtoi se „mungesa e fjalës, humorit dhe buzëqeshjes së Naserit në mesin e rinisë veleshtare, për të cilën ai ishte dhe do të mbetet idol, ka krijuar një zbrazëti të madhe, por edhe ka lënë gjurmë të pashlyeshme“.

Prej Fondit „Vendlindja thërret“, fond ky për të cilit Naseri ishte i autorizuar zyrtarisht, foli z. Nasuf Kamberi, i cili theksoi se me çfarë vendosmërie dhe dëshire punoi Naseri për të ndihmuar luftën në Kosovë.

Të veçanta ishin fjalët që ia kushtoi në këtë mbrëmje Naser Hanit miku dhe bashkëmendimtari i tij nga Shqipëria, z. Jani Koçi, i cili jo vetëm që përmendi se humbja e Naserit i kishte tronditur madje edhe të vegjlit që e njohën në Shqipëri, duke theksuar kështu afërsinë e tij me çdokënd pa dallim moshe. Por ai e theksoi edhe rëndësinë që kishte pasur Naseri gjatë luftës në Kosovë si ndërmjetësues në mes të politikanëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke u përpjekur çdoherë, siç tha ai „që ta ulë tensionin në mes të partive politike shqiptare“.

Nderimin e punës së tij dhe pikëllimin e thellë për humbjen fizike të tij e shprehën, përveç të pranishmeve, edhe shumë shokë dhe bashkatdhetarë të Naserit, si nga Prishtina, Struga dhe Veleshta, po ashtu edhe nga Austria dhe Zvicra përmes letrave ngushëlluese, ndërsa familja iu falënderua pjesëmarrësve me një letër.

Në fund, z. Januz Saliuka, udhëheqësi i këtij programi, që njëherit ishte shoku dhe kolegu i të ndjerit, e lexoi mesazhin e Mbrëmjes përkujtimore, i cili zotën se do të ecet në rrugën e Naser Hanit, në rrugën për liri, që është rrugë lavdie për të gjithë shqiptarët.

Pas përfundimit të Mbrëmjes përkujtimore pjesëmarrësit e shumë patën rastin të shënohen në Librin e ngushëllimeve.

Vlen të ceket se përveç dinjitetit të folësve në tribunë, si dhe të të pranishmeve në sallë, një faktor që dëshmoi nivelin përkatës për të nderuar punën dhe dinjitetin e atdhetarit Naser Hani ishte edhe ana teknike e kësaj mbrëmjeje, e përgatitur nga z. Tomorr Elez Kurtaj.

Përveç që u projektuan xhirime filmike, ku vetë i ndjeri fliste për çështjen kombëtare, apo fotografi nga jeta politike dhe familjare e tij, u projektuan edhe disa pjesë filmike nga varrimi i të ndjerit ku bashkatdhetarët që nuk mundën të marrin pjesë në varrim, patën rastin që për disa çaste t’iu bashkangjiten mijëra pjesëmarrësve të tjerë për ta ndarë dhimbjen me ta.

*Shkruar nga Penesta Dika*

## ■ Shkrime të përkthyer nga mediat ndërkombëtare

### ■ Shkrime të përkthyer nga gjuha angleze:

1.

**Nga Jolyon Naegle**

**Maqedoni: NATO-ja konfirmon rolin e saj jo-ushtarak, ndërsa vazhdon armëpushimi i brishtë**

**13 qershor 2001**

...Anëtarët e PDSH-së së Xhaferit sot e varrosën shokun e tyre aktivist, i cili u qëllua mbrëmë për vdekje nga vozitësit të cilët tentonin ta parakalonin. Policia është në kërkim të dy sulmuesve të cilët e qëlluan për vdekje Naser Hanin në qendër të qytetit të Strugës.

Hani ishte drejtor i Qendrës për asistencë sociale në Strugë, një qytet i përzier etnikisht në pjesën veriore të liqenit të Ohrit. Kjo vrasje paraqet rritjen e mëtutjeshme të dhunës që e ka kapluar sivjet Maqedoninë.

Struga, ndonëse më e tensionuar se sa zakonisht në këto javë, nuk ka qenë dëshmitare e asnjë përleshjeje që i ka kapluar regionet e Tetovës dhe të Kumanovës në veri, ose në sulmet antishqiptare të kryera përsëri javën e kaluar nga rinia maqedone në qytetet jugore të Manastirit (Bitolit) dhe të Resnës...

## 2.

**Muzi.com:News: Vritet aktivisti i njohur shqiptar nga maqedonë të armatosur; Forumi Kriza e Kosovës**

**Lateline News; 2001-6-13**

SHKUP, Maqedoni - Persona të armatosur vranë një aktivist të njohur shqiptar, duke rrezikuar ta prishin armëpushimin fragjil para bisedimeve me rastin e përfundimit të luftimeve disa mujore ndërmjet forcave shtetërore dhe të kryengritësve shqiptarë etnikë.

Naser Hani, 40-vjeçar, u qëllua për vdekje të martën në orët e vona nga një furgon që ishte duke kaluar pranë qendrës së qytetit jugperëndimor të Strugës afër një liqeni turistik ku bisedimet për paqe do të mbahen të enjten. Vdekja e Hanit është “edhe një tregues se sa e paqëndrueshme dhe kaotike është situata”, tha Ernat Fejzullahu, zëdhënës i Partisë Demokratike Shqiptare, partia më e madhe e cila e përfaqëson komunitetin e pashtuar etnik shqiptar.

Bisedimet për paqe do të mbahen edhe me gjithë këmbimet njëorëshe të zjarrit në orët e hershme të ditës së mërkurë ndërmjet policisë dhe kryengritësve të pozicionuar në istikame afër Tetovës, qytet ky i dyti për nga madhësia në Maqedoni. Sipas raporteve nuk ka pasur viktima.

Dhuna shpërtheu në Maqedoni në muajin shkurt kur militantët etnikë shqiptarë i rrokën armët për të drejta më të mëdha.

Autoritetet maqedone kanë zhvilluar disa ofensiva për t'i larguar kryengritësit nga istikamet e tyre, duke thënë se ata janë separatistë që tentojnë ta copëtojnë vendin.

## 3.

**World - Associated Press**

**Vritet aktivisti i njohur shqiptar nga maqedonasit e armatosur; Nga MERITA DHIMGJOKA, Korrespondente e Associaed Press-it; 16 qershor, 13 qershor 9:47 2001**

SHKUP, Maqedoni (AP) - Persona të armatosur vranë një aktivist të njohur shqiptar, duke rrezikuar ta prishin armëpushimin fragjil para bisedimeve me rastin e përfundimit të luftimeve disamujore ndërmjet forcave shtetërore dhe të kryengritësve etnik shqiptarë. Naser Hani, 40- vjeçar, u qëllua për vdekje

të martën në orët e vona nga një furgon që ishte duke kaluar pranë qendrës së qytetit jugperëndimor të Strugës, afër një liqeni turistik ku bisedimet për paqe do të mbahen të enjten.

Vdekja e Hanit është “edhe një tregues se sa e paqëndrueshme dhe kaotike është situata, “ tha Ernat Fejzullahu, zëdhënës i Partisë Demokratike Shqiptare, partia më e madhe e cila e përfaqëson komunitetin e pashtuar etnik shqiptar.

Bisedimet për paqe do të mbahen pa marrë parasysh këmbimeve njëorëshe me zjarr në orët e hershme të ditës së mërkurë ndërmjet policisë dhe kryengritësve të pozicionuar në istikame afër Tetovës, qytetit të dytë për nga madhësia në Maqedoni. Sipas raporteve nuk ka pasur viktima.

#### 4.

**Merita Dhimgjoka, Associated Press**

**Ndaj shqiptarëve janë përdorur me të madhe metodat e vrasjeve dhe të terrorit; Varroset aktivisti i njohur shqiptar**

**14 qershor 2001**

VELESHTË, Maqedoni (AP) - Duke dënesur dhe shqiptuar me zë fjalën shqipe “lavdi,” të mërkurën, qindra veta u mblodhën për ta varrosur aktivistin e njohur shqiptar, vrasja e të cilit rrezikon që t'i rrënojë bisedimet paqësore ndërmjet militantëve dhe qeverisë.

Njerëz të armatosur e qëlluan katër herë Naser Hanin të martën mbrëma pasi që ai kishte rezistuar gjatë përpjekjeve për ta kidnapuar në qytetin jugperëndimor të Strugës. Qyteti është pak milje larg liqenit turistik ku njerëzit kyç të krizës maqedone duhet të takohen të enjten për të biseduar për planin paqësor. Vdekja e tij e rrezikon armëpushimin fragjil i cili i ka ulur përlëshjet ndërmjet forcave qeveritare dhe shqiptarëve etnik. Ndërkohë, udhëheqësit perëndimor aluduan për mundësinë e intervenimit ushtarak.

Hani, 42-vjeçar, babai i tre fëmijëve, ishte angazhuar si ndërmjetësues mes militantëve etnik shqiptarë dhe partive politike shqiptare në qeverinë maqedone. Disa shqiptarë etnik të zemëruar nga vdekja e tij, këmbëngulin se masakrimet e tilla do t'a rrisin simpatinë për kryengritësit, të njohur si Ushtria Çlirimtare Kombëtare. „Nëse sulmet e këtilla vazhdojnë, dita kur ky vend do të eksplodojë do të ndodh së shpejti”, tha Avni Kica, ekonomist, i cili kishte ardhur në varrim me njerëz të tjerë nga fshatrat përreth Veleshtës, 110 milje në jugperëndim të Shkupit.

Në varrim, ishte gjithashtu edhe udhëheqësi kryesor politik i shqiptarëve etnik, Arben Xhaferi, i cili tha se ky sulm i rrezikon bisedimet afër liqenit turistik të Ohrit në jugperëndim të Maqedonisë. “Unë nuk besoj se bisedimet e nesërme do të jenë të suksesshme, “ tha Xhaferi.

Kortezhi i Hanit kaloi nëpër rrugët e pluhurosura të fshatit i udhëhequr nga një grup i madh nxënësish të shkollës së mesme të veshur me këmisha të zeza dhe pantallona të gjera në shenjë uniteti dhe zie. Para se të lëshohej kufoma në varr, turma bërtiti “ Lavdi ” - një fjalë shqipe për lavdinë, fjalë tradicionale e cila një kohë shqiptohej edhe në Kosovë gjatë varrimit të luftëtarëve, të cilët vdisnin duke luftuar për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Njerëzit dënesnin derisa trupi i Hanit i mbështjellë me flamurin shqiptar dhe me një flamur të gjelbër me simbolikë islamike u lëshua në varr, ndërkohë që arkivoli ishte ende me njolla gjaku.

Bisedimet e planifikuara paqësore do të mbahen edhe përkundër goditjeve me mortajë të kazermave ushtarake maqedone në periferi Tetovës, qytet ky i dyti për nga madhësia në vend. Njoftohet se në kazerma nuk ka pasur viktima, siç i thanë burimet anonime të “The Associated Press”-it. Armata u përgjigj me zjarr, kurse banorët vendas njoftuan se kishin dëgjuar ca detonime në orët e vona të ditës së mërkurë. Njoftohet se ka pasur të shtëna edhe në orët e hershme të ditës së sotme. Kryengritësit dhe policia po ashtu kanë shkëmbyer zjarr edhe afër fshatit Araçinë, rreth katër milje larg nga kryeqyteti Shkupi, na tha zëdhënësi Stevo Pendarovski.

Dhuna në Maqedoni u përshkallëzua në muajin shkurt kur militantët etnik shqiptarë i rrokën armët për të luftuar, si na thanë, për të drejta më të mëdha. Autoritetet maqedone kanë zhvilluar disa ofensiva me qëllim të zhvendosjes së kryengritësve nga istikamet e tyre. Ata thonë se janë separatistët ata që duan ta copëtojnë vendin

## 5.

### **WORLD/NATION WRAP**

#### **Varroset veprimtari i njohur shqiptar në Maqedoni**

**14 qershor 2001**

VELESHTË, Maqedoni (AP) - Duke dënesur dhe shqiptuar me zë fjalën shqipe “lavdi,” të mërkurën, qindra veta u mblodhën për ta varrosur aktivistin e njohur shqiptar, vrasja e të cilit rrezikon që ti rrënojë bisedimet paqësore ndërmjet militantëve dhe të qeverisë.

Njerëz të armatosur e qëlluan katër herë Naser Hanin të martën mbrëma pasi që ai kishte rezistuar gjatë përpjekjeve për ta kidnapuar në qytetin jugperëndimor të Strugës. Qyteti është pak milje larg liqenit turistik ku njerëzit kyç të krizës maqedone duhet të takohen të enjten për të biseduar për planin paqësor.

Vdekja e tij rrezikon armëpushimin fragjil, i cili i ka ulur përleshjet ndërmjet forcave qeveritare dhe shqiptarëve etnik. Ndërkohë, udhëheqësit perëndimorë



aluduan për mundësinë e intervenimit ushtarak.

Hani, 42-vjeçar, babai i tre fëmijëve, ishte angazhuar si ndërmjetësues ndërmjet militantëve etnikë shqiptarë dhe partive politike në qeverinë maqedone.

**6.**

**World-Reuters; Updated 8 :51 AM Et**

**Reuter (AP) The New York Times ABC NEWS. com**

**16 Qershor 2001**

Kryengritësit thonë se janë duke luftuar për t'i dhënë fund, si thonë ata, diskriminimit nga ana e shumicës sllave ndaj shqiptarëve etnikë në të gjitha sferat e jetës, të cilët përbëjnë rreth 30 për qind të popullatës dymilionëshe.

Shqiptarët duan që kushtetuta e re t'iu japë atyre statusin e të barabartëve. Policia thotë se aktivisti i shquar politik shqiptar, Naser Hani, u vra një natë më parë në qytetin jugperëndimor. Ata thanë se kishin pak detaje, sepse familja nuk kishte lejuar policinë të afrohet

**7.**

**New York Times, Nga CARLOTTA GALL**

**Shqiptarët në Maqedoni e fajësojnë policinë për dhunë**

**27 qershor 2001**

STRUGË, Maqedoni - Disa udhëheqës të shquar të komunitetit etnik shqiptar janë zhdukur në Maqedoni në vitet e fundit. Edhe këtu në pjesën jugperëndimore të vendit, një udhëheqës lokal politik shqiptar u vra. Forcat policore gjithnjë e më tepër po i frikësojnë shqiptarët, të cilët dominohen nga shumica sllave e vendit. Zyrtarët qeveritarë dhe vëzhguesit e huaj flasin për shenja gjithnjë e në rritje të elementëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilët janë duke armatosur dhe organizuar grupe paramilitare, dhe qëndrojnë prapa disa sulmeve kundër qytetarëve shqiptarë.

Disa zyrtarë kanë akuzuar vetë ministrin e brendshëm, Ljube Boshkovskin, se është duke i orkestruar sulmet dhe nxitur tensionet etnike. Këto tensione tani janë evidente në shumicën e komuniteteve në vendin që i numëron 1.9 milion banorë, ku më shumë se një e treta e tyre janë shqiptarë.

Në liqenin turistik të Strugës, policia ka filluar të patrullojë rregullisht. Në zonat përreth, shumë shqiptarë janë të zemëruar dhe të frikësuar në lidhje me zhdukjen e një afaristi dhe aktivisti të shquar politik, si dhe me vrasjen e politikanit lokal, Naser Hanit, 43-vjeçar. Miqtë e zotit Hani thonë se, ai vdiq kur disa persona të armatosur, derisa po tentonin ta kidnaponin, zbrazën një breshëri plumbash mbi trupin e tij dhe ikën. "Kjo është njëlloj sikur të hedhësh

benzinën dhe mjafton vetëm një shkëndijë dhe e gjithë kjo të eksplodojë “, tha në një intervistë Tahir Hani, kushëriri i viktimës dhe kryetar i Bashkisë së Veleshtës, fshati i lindjes së zotit Hani. “Nevojitet vetëm një shkëndijë dhe e tërë Struga të futet në luftë “. Kushërinjtë dhe kolegët e viktimës i fajësojnë pjesëtarët e policisë, të cilët qëllimisht i sulmojnë udhëheqësit lokalë dhe anëtarët e partisë kryesore shqiptare, Partisë Demokratike Shqiptare, e cila është në koalicionin qeveritar me dy partitë sllave dhe dy shqiptare, e me të cilat zoti Hani dhe disa të tjerë të zhdukur kanë pasur lidhje. Ministria e Brendshme thotë se është duke hetuar këtë rast ashtu si dhe rastet e tjera.

Disa zyrtarë të Ministrisë, si dhe disa raporte nga mediat sllavo-maqedone kanë thënë se, zoti Hani si dhe ca njerëz të tjerë të zhdukur, kanë qenë në njëfarë mënyre të lidhur me biznese të dyshimta, madje edhe me krime të organizuara, dhe se rivalët shqiptarë të biznesit qëndrojnë prapa kësaj vrasje dhe këtyre kidnapimeve. Regjioni i Strugës afër kufirit me Shqipërinë është i njohur për kontrabandë dhe për trafikimin e femrave, thanë zyrtarët. Por, kushërinjtë dhe politikanët shqiptarë deklarojnë krejtësisht ndryshe, kjo edhe të mbështetur nga ministri drejtësisë, Mehmeti, shqiptar, i cili para dy javësh ka paraqitur listën prej 56 shqiptarëve të arrestuar, ose të zhdukur nga ana e policisë. Në një mbledhje të komisionit të sapoformuar të krizave pranë qeverisë, ai kërkoi që Ministria e Brendshme të raportojë mbi vendndodhjen dhe rrethanat e arrestimeve të tyre.

Është raportuar për një numër të madh të shqiptarëve të arrestuar dhe të rrahur nga ana e policisë brenda tre - katër muajve, që nga koha kur kryengritësit etnikë shqiptarë të njohur si Ushtria Çlirimtare Kombëtare filluan rebelimin e tyre të armatosur.

Njeriu i parë që është zhdukur ishte Islam Veliu 37-vjeçar, i cili më 17 prill u raportua si i humbur. Ai ishte anëtar i Partisë Demokratike Shqiptare, i cili u zhduk në mbrëmje derisa po kthehej në shtëpi me makinën e tij nga qyteti perëndimor i Tetovës, dhe që nga ajo ditë nuk është dëgjuar më, tha kunati i tij, Lutvi Mahmuti, në intervistën e dhënë. Pastaj, Sulltan Mehmeti 38-vjeçar, pronar i një salle bingoje, u arrestua nga ana e policisë. Të afërmit e tij thonë se që nga ajo ditë nuk e kanë parë më atë, e as që kanë dëgjuar se ku gjendet ai.

“Është obligimi ynë t’i zbardhim këto raste“, tha Stevo Pendarovski, zëdhënës i Ministrisë së Brendshme, i cili është gjithashtu anëtar i komisionit të ri me qëllim të uljes së tensioneve. “Ne duhet ta rivendosim besimin e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, pavarësisht nga etnia e tyre “. Por, diplomatët dhe zyrtarët brenda qeverisë, si dhe administrata e presidentit janë të brengosur, që disa elementë brenda Ministrisë së Brendshme kanë pasur gisht në këto trazira,

nga se thuhet të kenë marrë pjesë për shembull në trazirat antishqiptare në qytetin jugor të Bitolit (Manastirit). Ministri i Brendshëm, zoti Boshkovski, gjithashtu është kritikuar për shpërndarje të qindra armëve rezervistëve sllavo-maqedonë brenda dhe rreth Shkupit, duke përfshirë këtu edhe disa ish-kriminelë, meqë kryengritësit po i afroheshin qytetit.

Për shqiptarët e Veleshtës, vrasja e zotit Hani është politike dhe është e drejtuar kundër gjithë tyre. “Mesazhi ishte shumë i qartë “na tha kryebashkiaku Hani. “Qëllimi është që të frikësohen shqiptarët nga kërkesat e tyre politike, që të mos ngrenë zërin dhe të mos veprojnë në Maqedoni“. Duke ndenjur në oborrin e shtëpisë të kushëririt të tij në Veleshtë, grupe njerëzish me milje larg përreth vinin për ta ngushëlluar familjen e të ndjerit.

Kryebashkiaku na tha, se zoti Hani ka qenë i involvuar ngushtë në politikë me qëllim të formimit të partisë së parë shqiptare pas pavarësimit të Maqedonisë në vitin 1991. Zoti Hani na tha se ai besonte që policia, ose njësitet speciale, që punonin për policinë, janë përgjegjëse për këtë vrasje, sepse vrasja kishte ndodhur vetëm dhjeta metra larg stacionit të policisë, dhe asnjë makinë s’ka mundur të kalojë dhe të ikë aq lehtë nëpër postbolloqet e policisë të vendosura në të gjitha rrugët që të shpijnë jashtë qytetit.

Sa i përket rastit të Sulltan Mehmetit, i cili ishte kryebashkiaku i fshatit të afërt me Strugën dhe ishte anëtar i Partisë Demokratike Shqiptare, një dëshmitar i kishte thënë vëllait të tij, Filizonit, se ai e kishte parë zotin Mehmeti në hyrje të Strugës kur atë e kishte ndalur dhe prangosur policia e armatosur rëndë. Vëllai i tij mendonte se zoti Mehmeti ka të ngjarë që të ketë qenë i dyshuar për kryengritje të armatosur në zonën e tij, sepse ai kishte bërë thirrje për një tubim në fshatin e tij me qëllim të qetësimit të situatës derisa luftimet zhvilloheshin afër Tetovës, qytet ky i dominuar nga shqiptarët. “Në kohën kur u mor, ai kishte qenë një udhëheqës i suksesshëm, por ai nuk kishte menduar fare për veprime militare“, thotë Filizon Mehmeti. “Po ta kishin kidnapuar përpara, sigurisht, që ata do të më kishin thirrur menjëherë. Mendoj se është policia sekrete e niveleve më të larta, ajo e cila është përgjegjëse “

8.

## **Raporti mbi praktikën e të Drejtave të Njeriut - 2001**

**Përpiluar nga Zyra për Demokraci, për të Drejtat e Njeriut dhe për Punë; 4 Mars 2002**

### **Respektimi i të Drejtave të Njeriut**

#### **a. Vrasje ose privim arbitrar nga jeta**

....Më 12 qershor, persona të panjohur e vranë aktivistin shqiptar Naser Hani

kur ai kundërshtoi përpjekjen e tyre për ta kidnapuar në Strugë, një qytet në afërsi të Liqenit të Ohrit, ku janë zhvilluar bisedimet për paqe. Deri në fund të vitit nuk është e njohur se janë zhvilluar hetime rreth këtij rasti...

## ■ Shkrime të përkthyer nga gjuha gjermane:

1

**Kosova-Info-Line; Shërbimi për informim me njoftime, raporte dhe komente aktuale nga dhe për Kosovën; Lajmet më të reja:**

**Bisedimet rreth planit për paqe në Maqedoni**

**Shkup, 14 Qershor 2001 (Ditari)**

**Luftime të reja**

...Në mëngjes rebelët dhe armata zhvilluan luftime të ashpra. Sipas njoftimeve të armatës, periferia e Tetovës në veriperëndim të vendit, është qëlluar me armë nga malet përreth. Policia dhe ushtarët janë përgjigjur me tanke dhe artileri.

Në jugperëndim të vendit është vrarë ndërmjetësuesi shqiptar Naser Hani...

2

**15.06.2001 Berliner Zeitung**

**Nato: Maqedonia duhet të jetësojë planin e paqes**

**Sekretari i Përgjithshëm Robertson për bisedime në Shkup**

**Shkup, 14 Qershor.**

NATO dhe UE (Unioni Evropian) kanë kërkuar nga qeveria maqedone konkretizimin dhe jetësimin sa më të shpejtë të planit të tyre për përfundimin e luftimeve me rebelët shqiptarë. Detyrë kryesore tani është që plani të shndërrohet në paqe reale, deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, George Robertson, i cili së bashku me koordinatorin për Politikë të Jashtme të Unionit Evropian, Javier Solana, arriti sot në Shkup...

... Në jugperëndim të vendit u vra negociatori shqiptar Naser Hani, i cili ndërmjetësonte midis separatistëve të armatosur shqiptarë dhe qeverisë maqedone. Ai është vrarë në mbrëmjen e së mërkurës në Strugë buzë liqenit të Ohrit, kur kundërshtoi përpjekjen për kidnapim. Në Ohër duhet të zhvillohen edhe bisedimet për paqen. (AP)...

## **UNHCR; Kolona e të ikurve nga Maqedonia nuk ka të ndalur Vrasja e një politikani shqiptar mund ta ashpërsojë gjendjen. Armëpushimi i brishtë.**

...Në mbrëmjen e të martës një politikani i shquar i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Naser Hani, u vra në qytetin jugperëndimor në Strugë. Partia në koalicion PDSH është njëra ndër dy partitë më të mëdha të pakicës shqiptare në Maqedoni.

Kjo vrasje mund ta ashpërsojë edhe më tej gjendjen e tendosur...

## **■ Shkrime të përkthyer nga gjuha italiane**

1

### **Aleanca e paqes në Maqedoni**

**Robertsoni në Shkup për ta mbështetur armëpushimin me shqiptarët; 13 qershor 2001**

#### **Shkup,**

Një i eksponent i partisë demokratike të shqiptarëve (PDSH), 58-vjeçari Naser Hani, është vrarë në qytetin e Strugës në Maqedoninë jugore. Hani është goditur nga disa persona civilë, të cilët ishin në një automjet transportues. “Sigurisht se kjo ka të bëjë me një atentat politik. Ndoshta kanë dashur që ta kidnapojnë atë” - supozon Garip Kaba, shef i PDSH-së në Strugë.

Naser Hani është gjetur i vdekur me plagë plumbash të zbrazur nga afërsia në kokë dhe në gjoks. Në trup i janë gjetur edhe shenja të shumta të keqtrajtimit. Struga gjendet në më pak se dhjetë kilometra nga Ohri, qytet ky ku që nga nesër do të ndodhë takimi i parë midis maqedonëve dhe shqiptarëve.

Kryqi i kuq e ka shfrytëzuar armëpushimin në Maqedoninë veriore për të evakuuar qindra persona.

2

### **Radiovatikani - Radio regjionale**

**Viti XLIV nr. 164 – Tekst i emetuar të mërkurën më 13 qershor 2001**

Në Maqedoni ka ardhur në shprehje plani i paqes i Boris Trajkovskit. Ai përmban çarmatimin e gueriles shqiptare nën mbikëqyrjen e NATO-s. Planin, i cili është përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, e përjashton secilin dëmtim territorial të Maqedonisë.

Derisa forcat ndihmëse humanitare kanë provuar sot që ta vënë në veprim ndihmën për popullatën civile të involvuar në konflikt, u hap lajmi për vrasjen

e një përfaqësuesi të Partisë Demokratike të Shqiptarëve, Naser Hanit.

Burri është vrarë në qytetin e Strugës, në Maqedoninë jugore. Sipas zëdhënësit për shtyp të partisë, kjo ka të bëjë me një atentat politik. Është ky një episod tjetër që hedh hije mbi planin e paqes të Shkupit, një ditë para se të arrijë në Maqedoni sekretari i përgjithshëm i NATO-s, George Robertson.

## ■ Shkrim i përkthyer nga gjuha spanjolle

**MUNDIALES; Santo Domingo, Republika Dominikane, 14.06.2001**

**Në Maqedoni vritet udhëheqësi shqiptar**

**Dhunë. Krimi ndodh një ditë më parë para se të fillojë dialogu për një armëpushim. AP/ Maqedonia**

Një grup vrasësish vranë aktivistin e origjinës shqiptare, një ditë para bisedimeve, të cilat kishin për qëllim përfundimin e luftimeve për muaj midis forcave qeveritare dhe rebelëve shqiptarë. Veprimi i parmbërshëm rrezikon të minoj armëpushimin fragjil midis palëve kundërshtare.

40-vjeçari Naser Hani, u vra në fshatin Strugë nga një makinë në ngasje e sipër, në një vend pak kilometra larg qendrës turistike pranë liqenit, ku sot udhëheqësit e Maqedonisë duan të takohen për të debatuar për një plan paqeje. Ernat Fejzullahu, zëdhënës i Partisë Demokratike të Shqiptarëve, përfaqësueses më të fuqishme të bashkësisë shqiptare, e karakterizon vrasjen e Hanit si „një shenjë të mëtejshme, se sa e pa sigurt dhe kaotike është situata“.

Bisedimet për arritjen e paqes vazhduan me gjithë gjuajtjet njëorëshe të mëngjesit të djeshëm midis policisë dhe rebelëve të fortifikuar në afërsi të Tetovës, qytetit të dytë për nga madhësia në Maqedoni. Lidhur me të vdekurit dhe të plagosurit nuk ka informacion...

## ■ Shkrim i përkthyer nga gjuha holandeze

**Nga redaktori ynë Harm van den Berg**

**STRUGA, me 3. maj 1999.**

*“Struga është bërë një qytet policor “*

*Në Maqedoni atmosfera midis shumicës maqedone dhe pakicës shqiptare po behët gjithnjë e më e tensionuar. „Nëse do të zgjasë aq sa në Bosnje, atëherë e tëra do të rrjedhë gabimisht .“*

Tarracat e kafeneve shqiptare janë plot, kurse ato të maqedonëve gjysmë të zbrazura. Sekretari i PDSH-së, Naser Hani ka zgjedhur një kafe në një rrugicë të mënjanuar. „Ne shqiptarët Bllacën (kampi gjithnjë i lagur në kufi me Kosovën,

Red.) nuk do ta harrojmë kurrë“, thotë Hani. Ai e cilëson politikën maqedone si proserbe. Sipas tij qeveria në Shkup ndaj problemit të refugjatëve ka qenë tërësisht indiferente. „Me më dëshirë sa më shpejt do t'i kishin hequr qafe“, thotë ai. Një anëtar i partisë, i cili po ashtu u bashkëngjijt pajtohet me të: „Ne nuk duam që t'i urrejmë ata (maqedonët, Red.), por kur ata nuk na duan neve, si mundemi që t'i duam ne ata?“. Burrat heshtin një copë herë.

„Indiferencën lidhur me atë se çfarë po na ndodh neve, ne e ndjejmë shumë fort. Dhe tani na lënë që të kuptojmë hapur, se ne nuk duhet të hymë më në kafenetë e tyre“, thotë Hani. Sipas tij, urrejtjen kundër popullatës shqiptare e ndezin „ish-komunistët“ në Strugë, Veleshtë dhe në vendbanimet përreth. „Ti i sheh ata në grupe të vogla të ulur pranë njëri-tjetrit. Ato janë mbledhjet ku ata merren vesh se si do të na trajtojnë neve. Pastaj ndahen ndër vete dhe formojnë diku tjetër sërish grupe të vogla. Dhe kështu shkon më tej“, thotë Hani. Atmosfera kërcënuese në qytet nuk i pëlqen fare, por ndonjë fatkeqësi të drejtpërdrejtë ai nuk e pret. „Të gjithë duan t'i kenë parasysh refugjatët. Fëmijët e tyre janë të traumatizuar, kanë parë vrasje masive. Prandaj ne do të jemi të durueshëm. Por, nëse do të zgjasë sa në Bosnje, atëherë do të rrjedhë tërësisht gabim.“

**NRC Handelsblad – Website, 3. Mai 1999**

## ■ **Shkrimet origjinale të medieve ndërkombëtare**

### ■ **Shkrimet origjinale në gjuhën angleze:**

1.

**Macedonia: NATO Confirms Non-Military Role As Shaky Cease-Fire Continues**

**By Jolyon Naegele**

**June 13, 2001**

...Members of Xhaferi's PDSH party today buried a fellow party activist who was shot dead in a drive-by killing last night. Police are searching for the two assailants who shot Naser Hani in the center of the town of Struga. Hani had headed the social welfare center in Struga, an ethnically mixed town at the northern end of Lake Ohrid. The killing represents a further spread of the violence that has plagued Macedonia this year. Struga, though tenser than usual in recent weeks, had witnessed none of the clashes that have struck the Tetovo and Kumanovo regions in the north, or the anti-Albanian attacks made again last week by Macedonian youths in the southern towns of Bitola and Resen...

2

## **Muzi.com: News; Macedonian Gunmen Kill Top Albanian Activist; Forum Kosovo Crisis**

LatelineNews: 2001-6-13] SKOPJE, Macedonia

Gunmen killed a top ethnic Albanian activist, threatening to undermine a fragile truce just a day before talks aimed at ending months of fighting between government forces and ethnic Albanian rebels. Naser Hani, 40, was shot late Tuesday from a passing van in the center of the southwestern town of Struga, near a lake resort where peace talks will be held Thursday, AP reported. Hani's death was "another indication how insecure and chaotic the situation is," said Ernat Fejzulahu, spokesman for the Democratic Party of Albanians, the largest party representing Macedonia's restive ethnic Albanian community. The peace talks remained on schedule despite an hourlong exchange of gunfire early Wednesday between police and rebels entrenched near Macedonia's second-largest city, Tetovo. No casualties were reported. Violence erupted in Macedonia in February when ethnic Albanian militants took up arms in a fight for broader rights. Macedonian authorities have led several offensives to dislodge the rebels from their strongholds, contending they are separatists bent on carving up the country.

3

**World - Associated Press - updated 9:15 AM ET**

## **Macedonia Gunmen Kill Top Albanian**

**Jun 16 Wednesday, June 13 9:47 AM ET**

By MERITA DHIMGJOKA, Associated Press Writer

SKOPJE, Macedonia (AP) - Gunmen killed a top ethnic Albanian activist, threatening to undermine a fragile truce ahead of talks aimed at ending months of fighting between government forces and ethnic Albanian rebels. Naser Hani, 40, was shot late Tuesday from a passing van in the center of the southwestern town of Struga, near a lake resort where peace talks will be held Thursday. Hani's death was "another indication how insecure and chaotic the situation is," said Ernat Fejzulahu, spokesman for the Democratic Party of Albanians, the largest party representing Macedonia's restive ethnic Albanian community. The peace talks remained on schedule despite an hourlong exchange of gunfire early Wednesday between police and rebels entrenched near Macedonia's second-largest city, Tetovo. No casualties were reported.

4



**Associated Press; Merita Dhimgjoka; Ethnic Albanian Activist Mourned; Against Albanians are largely used methods of killings and terror; Thursday, 14, June 2001**

VELESTA, Macedonia (AP) -- Sobbing and shouting the Albanian word for "glory," hundreds gathered Wednesday to bury an ethnic Albanian activist whose assassination threatened to undermine peace talks between militants and the government. Gunmen shot Naser Hani four times Tuesday night as he resisted efforts to kidnap him in the southwestern town of Struga. The town is a few miles from a lake resort where key players in Macedonia's ongoing crisis are set to meet Thursday to discuss a peace plan. His death threatened a fragile truce that has eased clashes between government forces and ethnic Albanians. Western leaders, meanwhile, hinted at the prospect of military intervention.

Hani, 42, a father of three, had acted as an intermediary linking ethnic Albanian militants to political parties in Macedonia's government. Some ethnic Albanians angered by his death insisted such slayings would only feed sympathy for the rebels, known as the National Liberation Army. "If such attacks continue, the day when this country will explode will come very soon," said Avni Kica, an economist who came to the funeral with others from villages around Velesta, 110 miles southwest of Skopje. Also at the funeral was a key ethnic Albanian political leader, Arben Xhaferi, who said the attack jeopardized the talks at the Lake Ohrid resort in southwestern Macedonia. "I don't believe tomorrow's talks will be a success," Xhaferi said. Hani's cortege wound its way through this village's dusty streets led by several dozen high school students who wore black shirts and slacks in a sign of unity and mourning. Before the procession snaked into the cemetery, the crowd shouted "Lavdi" -- the Albanian word for glory and the traditional word of praise once uttered in Kosovo at the burials of guerrillas who died fighting for the Kosovo Liberation Army. Men sobbed as Hani's body, draped in Albanian flags and a green banner with Islamic symbols, was lowered into the grave. The stretcher was still stained by fresh blood.

The peace talks remained on schedule even after mortars hit a Macedonian army barracks on the outskirts of the country's second largest city, Tetovo. No injuries were reported at the barracks, sources told The Associated Press while speaking on condition of anonymity. The army returned fire, and residents reported hearing several detonations late Wednesday. Shooting had been reported in the area earlier in the day. Rebels and police also traded gunfire near Aracinovo, barely four miles from capital Skopje, spokesman Stevo Pendarovski said. Violence erupted in Macedonia in February when ethnic Albanian militants took up arms in a fight they say is for more rights. Macedonian authorities have

led several offensives to dislodge the rebels from their strongholds, and say they are separatists who want to carve up the country.

5

**WORLD/NATION WRAP; Ethnic Albanian activist is mourned in Macedonia, June 14, 2001**

VELESTA, Macedonia (AP) - Sobbing and shouting the Albanian word for "glory," hundreds gathered to bury an ethnic Albanian activist whose assassination threatened to undermine peace talks between militants and the government. Gunmen shot Naser Hani four times Tuesday as he resisted efforts to kidnap him in the southwestern town of Struga. The town is a few miles from a lake resort where key players in Macedonia's crisis are to meet tomorrow to discuss a peace plan. His death threatened a fragile truce that has eased clashes between government forces and ethnic Albanians. Western leaders, meanwhile, hinted at the prospect of military intervention. Hani, 42, a father of three, had worked to link ethnic Albanian militants to political parties in Macedonia's government.

6

**World – Reuters; updated 8:51 AM ET Jun 16**

**Reuters | AP | The New York Times | ABCNEWS.com**

The rebels say they are fighting to end what they call discrimination in all walks of life by the majority Slavs against ethnic Albanians, who make up about 30 percent of the two million population. Albanians want the constitution rewritten to give them equal status. Police said that a prominent ethnic Albanian political activist, Naser Hani, was killed overnight in a southern town. They said they had few details because the family refused to allow police to approach.

7

**New York Times, By CARLOTTA GALL**

**Albanians in Macedonia Blame the Police for Violence**

**June 27, 2001;**

STRUGA, Macedonia - Several prominent ethnic Albanian community leaders have disappeared in Macedonia in recent months, and here in the southwestern region, where one local Albanian political leader was killed, the Albanians increasingly blame the police force, which is dominated by the country's majority Slavs. Government officials and foreign observers talk of increasing signs that elements in the Interior Ministry have been arming and

organizing paramilitary groups and are behind some of the violence against Albanian civilians.

Some officials have accused Interior Minister Ljube Boskovski himself of orchestrating attacks and stirring up ethnic tensions. Those tensions are now palpable in most communities in this country of 1.9 million people, up to one-third of them Albanians. In the lake resort of Struga, armed police officers have begun regular patrols.

In the surrounding region, many Albanians are alternately seething and fearful over the disappearances of a prominent businessman and a political activist, and the killing of a local politician, Naser Hani, 43. Mr. Hani's friends say he died when gunmen trying to kidnap him pumped a half-dozen bullets into him and fled. "It was like when there is a lot of gasoline spilled and it takes only one thing to happen and the whole thing blows up," Tahir Hani, a relative of the dead man and mayor of Velesta, Mr. Hani's home village, said in an interview. "It needs only a small thing and the whole of Struga would be at war." Relatives and colleagues of the victims blame members of the police for what they say is a conscious effort to attack local leaders and members of the main Albanian political party, the Democratic Party for Albanians, which is in the national government coalition of two Slavic and two Albanian parties, and with which Mr. Hani and the two missing men were associated. The Interior Ministry says it is looking into those and other cases.

Some ministry officials and reports in Macedonian Slav media have suggested that Mr. Hani and the missing men were somehow linked to shady business dealings and even organized crime, and that Albanian business rivals are behind the killing and the kidnappings. The Struga area, near the border with Albania, is known for the smuggling and trafficking of women, the officials point out. But relatives and Albanian politicians tell a different story, backed by the justice minister, Ixhep Mehmeti, an Albanian, who two weeks ago presented a list of 56 Albanians he said had been arrested by the police or disappeared. At a meeting of the newly formed government crisis committee, he requested that the Interior Ministry report on their whereabouts and the circumstances of the arrests.

Numerous arrests and beatings of Albanians by the police have been reported in the three to four months since ethnic Albanian rebels known as the National Liberation Army began their armed insurgency. The first man from Struga to disappear was Islam Veliu, 37, who was reported missing on April 17. A member of the Democratic Party for Albanians, he disappeared while driving home one evening from the western town of Tetovo and has not been heard

from since, his brother-in-law, Lutvi Mahmuti, said in an interview. Then Sultan Mehmeti, 38, the owner of a bingo hall, was apparently arrested by the police. His relatives say they have not seen him since, nor received any firm word of his whereabouts.

“It is our obligation to clear up all these cases,” said Stevo Pendarovski, a spokesman for the Interior Ministry, who is also a member of the new committee intended to defuse tensions. “We have to restore the trust of all Macedonians, regardless of their ethnicity.” But diplomats and officials within the government and the presidential administration are concerned that elements within the Interior Ministry may have helped stir up trouble - reportedly taking part, for instance, in anti-Albanian riots in the southern town of Bitola. The Interior Minister, Mr. Boskovski, has also been criticized for issuing hundreds of weapons to Macedonian Slav reservists in and around Skopje, including some former criminals, since the rebels advanced close to the city.

For the Albanians in Velesta, the killing of Mr. Hani was political and aimed against them all. “The message is clear,” said Mayor Hani. “It is to scare the Albanian people from pursuing political issues and to scare Albanians from speaking out and acting in Macedonia.” Sitting in the courtyard of his relative’s house in Velesta as groups of men from miles around arrived to pay their respects to the family, the mayor said Mr. Hani had been closely involved in politics since helping to found the first Albanian party after independence in 1991. Mayor Hani said he believed that the police, or a special unit working for the police, were responsible for the killing, because it had happened just yards from the police station and no ordinary car could have made such a clean getaway through police checkpoints on all of the roads that lead out of town. In the case of Sultan Mehmeti, who was mayor of his village near Struga and a member of the Democratic Party for Albanians, a witness told his brother, Filizon, that he had seen Mr. Mehmeti being stopped on a road into Struga by heavily armed police officers and handcuffed. His brother suggested that Mr. Mehmeti might have come under suspicion of organizing an armed rebellion in the area because he had called a meeting in his village to urge calm as fighting surged near the predominantly Albanian town of Tetovo. “At the time he was taken, he was very successful as a leader but was not thinking at all of military things,” Filizon Mehmeti said. “If they kidnapped him for money, they would have called me right away. I think it is the secret police, very high-level, who are responsible.”

[www.egroups.com/group/albanian-mk](http://www.egroups.com/group/albanian-mk)

**Mazedonien, die ehemalige jugoslawische Republik  
von März 4, 2002; Landberichte über Praxis der menschlichen  
Rechte Freigegeben durch das Büro der Demokratie, der  
menschlichen Rechte und der Arbeit  
RESPEKT FÜR MENSCHLICHE RECHTE**

a. Willkürlicher oder ungesetzlicher Entzug des Lebens

...On June 12, unknown gunmen shot and killed ethnic-Albanian activist Naser Hani as he resisted their efforts to abduct him in Struga, a town close to Lake Ohrid, where the peace plans were being discussed. There was no information about an investigation into this case at year's end...

**■ Shkrimet origjinale në gjuhën gjermane:**

1

**Kosova-Info-Line -Sonntag, 17. Juni 2001  
Informationsdienst mit aktuellen Meldungen, Berichten und  
Kommentaren aus und zu Kosova  
Die neuesten Nachricht: Gespräche über Friedensplan in  
Mazedonien; Skopje, 14. Juni 2001 (Tagesschau)  
Neue Gefechte**

...Am Morgen hatten sich Rebellen und Armee noch schwere Gefechte geliefert. Der Stadtrand von Tetovo im Nordwesten des Landes sei von den umliegenden Bergen aus beschossen worden, teilte die Armee mit. Polizei und Soldaten hätten mit Panzern und Artillerie zurückgeschossen. Im Südwesten des Landes wurde der albanische Mittelsmann Naser Hani erschossen...

2

**Nato: Mazedonien muss Friedensplan umsetzen  
15.06.2001 Berliner Zeitung  
Generalsekretär Robertson zu Gesprächen in Skopje  
SKOPJE, 14. Juni.**

Nato und EU haben die mazedonische Regierung aufgefordert, ihren Plan für ein Ende der Kämpfe mit albanischen Rebellen zu konkretisieren und rasch umzusetzen. Hauptaufgabe sei jetzt, aus dem vorhandenen Plan realen Frieden werden zu lassen, sagte Nato-Generalsekretär George Robertson, der am Donnerstag mit dem Außenpolitischen Koordinator der Europäischen Union, Javier Solana, in Skopje eintraf...

...Im Südwesten des Landes wurde der albanische Unterhändler Naser Hani

erschossen. Hani, der als Mittelsmann zwischen den bewaffneten Separatisten und der mazedonischen Regierung fungierte, war am Mittwochabend bei Struga am See von Ohrid erschossen worden, als er sich einem Entführungsversuch widersetzte. In Ohrid sollten auch die Friedensverhandlungen stattfinden. (AP)...

3.

**UNHCR Flüchtlingsstrom aus Mazedonien hält weiter an  
Ermordung eines Albaner-Politikers könnte Lage verschärfen.  
Brüchiger Waffenstillstand**

...Dienstagabend wurde ein Spitzenpolitiker der Demokratenpartei der Albaner (DPA), Naser Hani, in der südwestmazedonischen Stadt Struga ermordet. Die mitregierende DPA ist eine der zwei führenden politischen Parteien der albanischen Minderheit in Mazedonien. Der Mord könnte die Spannungen weiter verschärfen...

**■ Shkrimet origjinale në gjuhën italiane:**

1

**L'Alleanza paciere in Macedonia**

**Robertson oggi a Skopje per favorire il cessate il fuoco con gli albanesi; 13 giugno 2001**

**Skopje**

...Un esponente del Partito democratico albanese (Pdsh) Naser Hani di 58 anni, è stato ucciso nella città di Struga, nella Macedonia meridionale. Hani è stato colpito da alcuni civili che viaggiavano a bordo di un furgone: "Forse hanno tentato di rapirlo - ha riferito Garip Kaba, capo del Pdsh a Struga - sicuramente si è trattato di un attentato politico".

Naser Hani è stato trovato morto, raggiunto da colpi di pistola alla testa e al petto sparati da breve distanza. Sul cadavere sono stati riscontrati anche segni di percosse. Struga si trova a meno di 10 chilometri da Ocride, la città che dovrebbe ospitare da domani il primo vertice tra macedoni e albanesi per tentare di risolvere la crisi armata. La Croce Rossa ha approfittato della fragile tregua nel nord della Macedonia per evacuare centinaia di persone dai villaggi esposti al fuoco incrociato dei guerriglieri albanesi e delle forze macedoni...

**RADIOVATICANA - RADIOGIORNALE****Anno XLIV n. 164 - Testo della Trasmissione****di mercoledì 13 giugno 2001**

In Macedonia è in applicazione il piano di pace del presidente Boris Trajkovski. Esso prevede il disarmo della guerriglia albanese sotto la supervisione della Nato. Il piano, che ha avuto già il 'sì' della comunità internazionale, esclude qualsiasi violazione dell'integrità territoriale dello Stato macedone. Mentre oggi gli operatori umanitari tentano di convogliare nuovamente aiuti ai civili coinvolti nel conflitto, è giunta la notizia dell'uccisione - avvenuta ieri - di un esponente del Partito Democratico Albanese, Naser Hani. L'uomo è stato ucciso nella città di Struga, nel sud della Macedonia, a colpi d'arma da fuoco. Secondo un portavoce del partito si tratterebbe di un attentato politico. Un altro episodio, questo, che potrebbe gettare ombre sul piano di pacificazione delle autorità di Skopje, alla vigilia dell'arrivo domani in Macedonia, del segretario generale della Nato, George Robertson:

**■ Shkrim origjinal në gjuhën spanjolle****MUNDIALES; Santo Domingo, Rep. Dom. 14/06/2001****Asesinan a un dirigente albanés en Macedonia****VIOLENCIA. El crimen ocurre días antes del inicio de un diálogo para el cese de los combates. AP/Macedonia**

Un grupo de pistoleros mató a un activista de ascendencia albanesa, un día antes de las conversaciones destinadas a poner fin a meses de combate entre las fuerzas del gobierno y los rebeldes albaneses. El hecho, ocurrido anteanoche, amenaza con socavar una frágil tregua entre los dos bandos enfrentados. Naser Hani, de 40 años, fue asesinado desde un vehículo en marcha en el pueblo de Struga, a pocos kilómetros de un centro turístico junto a un lago donde los líderes de Macedonia esperan reunirse hoy para debatir un plan de paz. Ernat Fejzulahu, vocero del Partido Democrático de los Albaneses, el mayor representante de la comunidad albanesa, calificó la muerte de Hani como "otra indicación de lo insegura y caótica que es la situación". Las conversaciones de paz seguían en pie pese a un tiroteo de una hora registrado en la madrugada de ayer entre la Policía y rebeldes parapetados cerca de la segunda ciudad macedonia, Tetovo. No se informó de bajas...

■ **Shkrim origjinal në gjuhën holandeze**  
**Door onze redacteur HARM VAN DEN BERG**  
**„Struga is een politiestad geworden’**

**In Macedoni wordt de sfeer tussen de Macedonische meerderheid en de Albanese minderheid steeds broeieriger. „Als het zo lang gaat duren als in Bosnië loopt het helemaal mis”; STRUGA, 3 MEI.**

... De terrassen van de Albanese cafés zitten vol, de Macedonische zijn half leeg. DPA-secretaris Naser Hani verkiest een koffiehuis in een afgelegen straatje. „Wij Albanezen zullen Blace (het modderkamp aan de grens met Kosovo, red.) nooit vergeten’, zegt Hani... Hij betitelt de Macedonische politiek als „pro-Servisch’. Volgens hem laat het probleem van de vluchtelingen de regering in Skopje totaal onverschillig. „Het liefst willen ze ze zo snel mogelijk weer kwijt’, zegt hij. Een partijlid dat even aan is geschoven valt hem bij: „Wij willen hen (de Macedoniërs-red.) niet haten, maar als ze niet van óns houden, hoe kunnen we dan wel om hen geven?’ De mannen zwijgen een tijdje. „Die onverschilligheid over wat er met ons gebeurt, dat voelen we heel sterk. En nu laten ze openlijk merken dat we niet meer in hun cafés en restaurant moeten komen’, zegt Hani. Volgens hem stimuleren „de ex-communisten’ in Struga, Velesda en omliggende plaatsen de haat tegen het Albanese bevolkingsdeel. „Je ziet ze in kleine groepen bij elkaar zitten, dat zijn vergaderingen waar afgesproken wordt hoe ze ons zullen aanpakken. Dan splitsen ze zich op en worden elders weer kleine groepen gevormd, zo gaat het verder’, aldus Hani. De broeierige sfeer in de stad bevalt hem helemaal niet, maar direct onheil verwacht hij niet: „Iedereen wil rekening houden met de vluchtelingen. Hun kinderen hebben trauma’s opgelopen, massamoorden gezien. Daarom zullen we geduld hebben, maar als het net zo lang gaat duren als in Bosnie dan loopt het helemaal mis.’

*NRC Handelsblad - Website*

*3. Mai 1999*



## XVII. Kapitulli përmbyllës

### ■ Lajmi që më tronditi pa masë

Në natën e 13 qershorit të vitit 2001 u ktheva vonë nga puna në banesë kur me doli përpara bashkëshortja ime me lot në sy...

I shqetësuar e pyeta menjëherë: - Çfarë ka ndodh! - “E kanë vra Naserin”, më tha.

- Cilin Naser, i thashë, edhe pse nuk e kisha ndonjë shokë tjetër me emrin Naser. Ajo mezi i nxori fjalët nga goja duke thënë: - “Naser Hanin, shokun tënd!”.

- Naserin e kanë vrarë! Kush e ka vrarë?! - pyeta më zë të gjerrë instinktivisht! - “E kanë vra ata... ti e di kush...!”, u përgjigj ajo dhe shtoi se, “një shok i Naserit, Xhevdet Nasufi, ka deklaruar se prapa vrasjes së Naserit qëndron Ministria e Brendshme e Maqedonisë!”.

Për një moment u ndjeva si i mpirë dhe në kokë m'u paraqit një oshtimë e madhe sikur të isha pranë ndonjë lumi me rrjedhje të rrëpijshme nga lart-poshtë drejt një gremine! E tëra m'u duk e pabesueshme dhe e besueshme njëkohësisht. Fillova të ecja nga dhoma në dhomë, të hyja në kuzhinë e të dilja në ballkon, ashtu duke i ndezur cigaret njëren pas tjetrës pa ndërprerë. - Hej, i thashë vetes, - Naseri është vrarë...!

Pasi e mora vetën pak, fillova ta pyesja shoqen time: - Kur e kanë vrarë?, Si e kanë vrarë?, Kur e ke dëgjuar lajmin? etj. “Lajmin e kam dëgjuar sonte në mbrëmje në lajmet e radios Dojçe-Veles në gjuhën shqipe. Naseri është vrarë dje, më datën 12-të qershor rreth orës nëntë të mbrëmjes para banesës së tij në Strugë. Sot është bërë varrimi i tij”.

A u tha gjë se kush kishin qenë vrasësit? - E pyeta më tej.

“Në lajme u tha se Naseri ishte vrarë nga disa njerëz të panjohur!”, mu përgjigj ajo.

- E qartë, e qartë është gjithçka!, i thashë sime shoqeje. Naserin e ka vrarë

policia sekrete maqedone, ashtu siç i ka vrarë dhe rrëmbyer edhe disa shqiptarë të tjerë, por unë nuk bëra asgjë për ta shpëtuar!

“E si do ta shpëtoje, ti Naserin”!?, më pyeti ajo me habi.

- Është dashur të shkoja në Shqipëri, ta thirrja për ta takuar në Tiranë, dhe të mos e lija që të kthehej në Maqedoni, iu përgjigja unë.

- “Mos e akuzo veten kot se Naser Hani kurrë s’do ta pranonte një gjë të tillë. Të luftohet në Maqedoni për të drejtat e shqiptarëve e ai të ikte në Shqipëri, kjo s’ka mundur të ndodhë!, m’u përgjigj ajo me vendosmëri.

## ■ Libri të cilin e “shkrova” për një natë!

Natën e 13 qershorit kur mora vesh se ishte vrarë Naseri e bëra zgjuar i shtrirë mbi shtrat në dhomën e ndejës. Kisha nevojë të isha vetëm, ta kujtoja e ta kujtoja Naserin! Disa herë u ngrita nga shtrati dhe dola në ballkon. Piva e piva duhan! Doja të qaja por nuk mundja, kjo sikur të kisha dashur që t’ia mbaja fjalën Naserit kur i kisha thënë, “pra dije se unë s’të qaj dy herë!”, pasi që e kisha qarë njëherë gjatë kohës së luftës, kur kisha menduar se njëri nga rekrutët e vrarë të UÇK-së në kufirin Shqipëri-Kosovë kishte qenë ai.

Dikur iu dorëzova fantazisë dhe fillova ta nxjerrë Naserin parasysh, që nga momenti i parë kur e kisha njohur në verën e vitit 1993 në Vjenë, e deri para një jave kur e pata bisedën e fundit telefonike me të. Me doli parasysh Naseri i posardhur në Vjenë, njohja e parë me të, natyra e tij e qeshur, sytë që i bënin dritë, humori i tij pa dëm, mjediset ku ishim takuar në Vjenë, vizitat që m’i kishte bërë në Cyrih, bisedat që kishim bërë, kujtimet e tij të pranverës së madhe të vitit 1981 etj.

Të gjitha këto m’u përfutuan si copa të shkurtra të një filmi të metrazhit të gjatë.

Pastaj e nxora parasysh Naserin e vrarë, ashtu të shtrirë mbi një lëndinë me trupin e bërë shoshë nga plumbat e shovinistëve maqedonë. Duke përfytyruar kësisoj fillova ta këndoja pa zë me ato vargjet e njohuar të Fan Nolit: “Nëno moj ma çaj në Vlorë, ku të dha liri kurorë”!; “Na e vranë e na e shanë, na i thanë tradhëtor!”; “Nëno moj, larot ta vranë djaln që bashkë me Ismail Qemajlin...!”. Duke e ditur se kush ishin ata që e kishin vrarë Naserin fillova të flasë me vete: Eh laro, laro, shovinistë maqedonë ma keni vrarë shokun, por...!

Duke e rikujtuar më tej Naserin i thashë vetës: E pata shok të ngushtë Naserin e më duhet me e qitë një “pushkë” për të! E ç’pushkë do të qes unë për Naserin...! A shtrohen shovinistët maqedonë me maje të penës! E megjithatë, unë do t’ua mësyj atyre me maje të penës! Mbase me majën e penës sime do t’i gërvisht pak

këta shovinistë! Do ta shkruaj një libër për jetën dhe veprën e Naser Hanit. Do t'i demaskoj këta shovinistë. Do ta them hapur se cili institucion monotetnik maqedon dhe për çfarë qëllimesh e ka vrarë Naser Hanin, ashtu hajdutërisht me atentat të fshehtë! Duke menduar kështoj fillova t'i gjëja vetes pak ngushëllim!

Kështu, librin tim për Naser Hanin e "fillova" dhe e "mbarova" së shkruari brenda fantazisë sime për një natë të vetme, atë të 13 qershorit të vitit 2001. Por, jo e kisha mashtruar veten shumë! U deshën të iknin gati dymbëdhjetë vjet për ta parë dritën libri i asaj nate!

### ■ Epitaf mbi varr!

Por atë natë me fantazinë time unë shkova edhe më larg. Ia përfytyrova Naser Hanit edhe epitafin mbi varr: **"Edhe njëqind jetë po t'i kisha të gjitha për një Shqipëri të bashkuar do t'i jipja!"**. Por, jo sërish e kisha mashtruar veten keq. Ikën gati dymbëdhjetë vjet e unë jo vetëm që mbi varrin e Naser Hanit s'kam gdhendur ndonjë epitaf, por mbi varrin e tij ende, qoftë edhe një lule të vetme s'e kam vënë!

Mbase do të vijë një ditë kur unë mbi varrin e Naseri Hanit do të hedh lule të freskëta dhe do ta gdhend këtë epitaf! Nëse unë s'e bëj këtë, mbase dikush tjetër do ta bëj...

### ■ Lamtumirë!

Duke e përmbyllur këtë libër ndjem edhe i lumtur edhe i pikëlluar.

I lumtur sepse më dukët sikur kam bërë diçka të vogël për shokun tim të ngushtë dhe të shtrenjtë, Naser Hanin!

I pikëlluar, sepse fundi i këtij libri më detyron që unë t'ia lë atij lamtumirën time të fundit!

Natyrshet se unë kurrë nuk do ta përmbyll kujtimin tim për Naser Hanin, për njeriun të cilit si nëpër përralla me kuçedra e lugetër ia shkurtuan jetën shovinistët maqedonë, duke ia lënë fëmijët jetimë.

Me asgjë dhe as me këtë libër nuk mund t'i shpaguham Naser Hanit, i cili i deshi aq shumë njerëzit për lirinë e të cilëve edhe ra.

Përkundrazi, unë do të ndjem gjithnjë borxhli ndaj tij, si për atdhetarizmin e tij të kulluar, ashtu edhe për respektin e tij ndaj secilit, e edhe ndaj meje.

Kështu, gjatë gjithë jetës sime Naser Hanin do ta kujtoj me dhembje e pikëllim, por edhe me pietet e krenari të ligjshme që e pata shok e vëlla!

## XVIII. Copëza kujtimesh nga disa shokë të Naser Hanit

### ■ Mehmet Bislimi

#### Njeriu që nuk e kurseu as jetën për çështjen e madhe të atdheut!

Me Naser Hanin më lidhin kujtime të shumta. Ato fillojnë që nga pjesëmarrja në demonstratat e pranverës së vitit 1981, kur ai pas një viti u arrestua dhe u burgos. Duke mos pranuar asgjë para hetuesve maqedonë, pas disa muajsh në mungesë të fakteve u lirua. Por, edhe pas daljes nga burgu e vazhdoi veprimtarinë e tij atdhetare bashkë me ne të tjerët deri në fund të jetës së tij.

Kontaktet e Naserit me organizatën e LPRK-së ishin bërë edhe më të ngushta, sidomos pas daljes së Bardhyl Mahmutit nga burgu, diku nga fundi i vitit 1988, kur më ai ishte i formuar atdhetarisht e politikisht. Që nga ai vit e deri në fund të jetës së tij, Naseri mbeti një shok i yni, i cili veprimtarinë e tij patriotike e ndau me ne.

Duke qenë nëpunës në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, Naser Hani, sidomos gjatë viteve 1988-1990, me mjetet teknike të vendit të punës i ka shumëfishuar të gjitha traktet dhe afishet, të cilat LPRK-ja i kishte shpërndarë ilegalisht gjithandej Kosovës, si dhe ka marrë pjesë edhe në demonstratat masive të atyre viteve, të cilat kanë pasuar me arrestime, burgosje dhe vrasje të shokëve tanë.

Naseri, gjatë veprimtarisë së tij patriotike është shoqëruar dhe ka bashkëvepruar me shumë veprimtarë të çështjes kombëtare, si brenda ashtu edhe jashtë LPRK-së. Shokët me të cilët ai e ka ndarë më së shumti veprimtarinë e tij kombëtare kanë qenë: Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Sabit Veseli, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Fadil Vata, Tahir e Sylejman Hani, Guximtar e Atdhetar Labunishta, Fadil Bajrami, Murati, Agniu e dhjetëra të tjerë.

Një kujtim i veçantë, i cili me lidh me Naserin është ai fillimit të vitit 1993. Asokohe në emër të organizatës sonë (LPRK-së) kishim marrë për detyrë që të shkonim në Shqipëri, për t'i krijuar bazat tona lokale të furnizimit me armatim, duke e kaluar kufirin në këmbë te Struga. Për ta kryer me sukses këtë veprim

në u konsultuam me ish-të burgosurin politik nga Tetova, Beqir Berishën, i cili na këshilloi që lidhur me këtë veprimtari ta kërkonim ndihmën e dhëndrit të tij dhe të shokut tonë, Naser Hanit.

Ajo që nuk më hiqet nga mendja as sot është se Naseri duke parë se unë isha veshur hollë, e hoqi pallton e vet nga trupi dhe ma dha mua duke më thënë: “Merre, se në bjeshkë është shumë ftohtë, mund të ketë mbi një metër borë...!”. Kështu, unë me pallton e Naserit në trup i kalova atë natë bjeshkët me borë, derisa në mëngjes arritëm në Përrenjas të Shqipërisë. Ishte palltoja dhe bashkë me të edhe një pjesë e shpirtit të Naserit, ato të cilat gjatë asaj nate më më ngrohen e më dhanë forcë, që bashkë me shokë ta shqyeja borën e madhe që kishte rënë bjeshkëve e maleve.

Meqë në verën e vitit 1993 jeta e Naserit në Maqedoni ishte rrezikuar seriozisht nga shërbimi sekret maqedon, prandaj ai kishte ikur në Austri, ku qëndroi deri në vitin 1998. Në Austri ai krahas aktivitetit intensiv politik kishte dashur të arsimohej më tej, duke i regjistruar studimet postdiplomike në lëmin e ekonomisë në Universitetin e Vjenës.

Me të dalë në skenë Ushtria Çlirimtare të Kosovës me veprime konkrete në pranverën e vitit 1966, Naseri duke qenë bashkëthemelues i “Shoqërisë së Studentëve Shqiptarë në Austri”, i “Bashkësisë Shqiptare në Austri”, dhe i “Shoqatës së veleshtarëve në Austri”, me veprimtarë të shumtë si Abdullah Abdullahu e Januz Saliuka, me studentët si Fadil Tutuli, Nuri Bexheti e Ylber Hasani, si dhe me bashkëfshatarët e tij nga Veleshta me banim në Vjenë, te tri shoqatat e tilla i kishte vënë në shërbim të Luftës Çlirimtare të Kosovës, të UÇK-së dhe të fondit “Vendlindja thërret!”

Kështu, gjatë viteve të Luftës Çlirimtare të Kosovës Naser Hanin dhe shumë shokë të tjerë, si Xhevat Xhemailin, Shyqyri Bytyçin, Eset Beranin, Idriz Thaçin dhe shumë të tjerë, i kisha takuar nëpër tubime me bashkatdhetarët tonë në përkrahje të luftës çlirimtare dhe të UÇK-së gjithandej Austrisë, si në Vjenë, në Salzburg, në Linz etj.

Në fund të vitit 1998 Naseri, pas disa vitesh në mërgim, ishte kthyer në Veleshtën dhe Strugën e tij të dashur, në Maqedoni. Partia në të cilën ishte anëtarësuar (PDSH-ja) e kishte emërtuar drejtor të Qendrës sociale për qytetin e Strugës.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2001, kur kishte dalë në skenë Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK-ja) e shqiptarëve në Maqedoni, Naser Hani ishte vënë në mbështetje të saj, duke qëndruar në prapavijë. Ai gjatë gjithë kësaj kohe kishte punuar për arritjen e marrëveshjes midis faktorit politik dhe ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, kështu derisa më 12 qershor të vitit 2001 shërbimi sekret maqedon e vret me atentat të fshehtë.

Për të gjitha këto Naseri në kujtesën time do të mbetet një shokë i paharrueshëm dhe i shtrenjtë, i cili nuk e kurseu as jetën e tij për çështjen e madhe të atdheut.

## ■ Kolë Staka

### Një luftëtar i devotshëm i çështjes së Kosovës

Tri vjet pas mbarimit të studimeve në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës, Naser Hani me ndihmën e disa miqve punësohet në Sekretariatën Krahinor të Ekonomisë në kuadër të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, ku për disa vite e kam pasur jo vetëm koleg të punës, por edhe një shok me të cilin na bashkonin pikëpamjet tona politike. Pas suprimimit me dhunë të autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989, Naseri bashkë me kolegët e tij shqiptarë përjashtohet nga puna në gusht të vitit 1990.

Që si student i Fakultetit ekonomik të Universitetit të Prishtinës, Naser Hani, jo vetëm që ka ndjekur të gjitha ngjarjet e mëdha politike që kanë ndodhur në Kosovë, por edhe ka qenë pjesëmarrës i tyre. Ai, përveç pjesëmarrjes në pothuajse të gjitha demonstratat e viteve 1981-1990, ishte edhe pjesëmarrës i pothuajse të gjitha tubimeve dhe konferencave që atëherë organizoheshin në Prishtinë, ku bëhej fjalë për çështjet jetësore të Kosovës.

Në rrethin e shokëve dhe kolegëve ishte e njohur gatishmëria e tij proverbiale për të ndihmuar. Në fillim të viteve '90 Naseri së bashku edhe me shokë të tjerë nga Struga ishte mobilizuar për ta ndihmuar Kosovën materialisht, që ajo fillimisht ta mbante gjallë arsimin dhe jetën sociale që ishte në prag të rrënimit, dhe pastaj të krijonte rrethana edhe për veprimtari luftarake.

Me angazhimin e pakursyer të tij nga ndihmat e mbledhura në Veleshtë e Strugë, janë ndihmuar financiarisht të burgosurit politikë dhe familjet e tyre, janë siguruar pagat e arsimtarëve në disa shkolla të Kosovës, janë furnizuar me medikamente, ushqime e veshmbathje shumë skamnorë.

Nga të gjithë ata që e kanë njohur e ata nuk janë të pakët, Naser Hani vlerësohej si luftëtar i devotshëm i çështjes shqiptare dhe në veçanti i çështjes së Kosovës.

Në kujtimin tim Naseri do të mbetet një luftëtar i devotshëm i çështjes së Kosovës.

## ■ Xhevdet Nasufi

### Naser Hani, një kombëdashës i paepur

Kur më erdhi kërkesa për dhënie të opinionit personal për bashkëmendimtarin, bashkëveprimtarin dhe bashkëfshatarin tim, **Naser Hanin**, ndjenja e përgjegjësisë që mendimi të reflekttojë peshën dhe vlerën e një individi të

veçantë, për momentin ma preku thellë vetëdijen e trazuar, në njërën anë, dhe ndjenjën e krenarisë për Naserin, në anën tjetër, që jetoi dhe veproi në një kohë dhe moment historik me peshë, si për shqiptarët në Maqedoni, ashtu edhe për të gjithë shqiptarët kudo që janë.

Por, krahas këtyre dy përjetimeve dhe momente veçorie, është gjithsesi për çdo falënderim dhe lëvdatë edhe iniciativa e ndërmarr nga autori i këtij libri, Xh. Hasani, që edhe në këtë mënyrë ta pavdekësojë një figurë të çmuar të historisë tonë kombëtare, një frymë revolucionare të Veleshtës së Maqedonisë, e cila në figurën dhe personalitetin e Naser Hanit u portretua dhimbshëm me vrasjen dhe likuidimin e tij tragjik. Ideali patriotik dhe përkushtimi për kombin dhe shtetformësinë që ka pasur Naser Hani, e madhërojnë Veleshtën legjendare, familjarët dhe bashkëveprimtarët e tij kudo që janë.

Në mbrëmjen e 12 qershorit të vitit 2001, kur ma komunikuan lajmin për vrasjen e Naserit Hanit gjendesha në Shkup, në funksion të ministrit të Ministrisë së Drejtësisë në Qeverinë e Maqedonisë. Ishte ky një moment shokimi në apartamentin tim ku jetoja i vetmuar dhe i stërngarkuar. Ishte kohë lufte kur unë gjendesha midis shumë mendimesh, përpjekjesh dhe angazhimesh për një zhvillim pozitiv të ngjarjeve, që ëndrra shekullore e shqiptarëve për liri e barazi të realizohej, ashtu siç ishte edhe kohë dilemash e paqartësish të shumta për të nesërmen...!

Pikërisht brenda ngarkesash e përpjekjesh të tilla e mora lajmin për vrasjen e Naser Hanit, me ç'rast pikëllimi, dhimbja, asocimet dhe meditimet e kapluan tërësisht shpirtin dhe mendjen time, kjo aq më tepër kur para një kohe ishte rrëmbyer edhe veprimtari tjetër i çmuar i çështjes kombëtare, miku im i shtrenjtë nga Ladorishta, **Sulltan Mehmeti**.

Ishin këta dy bashkëpunëtorët e mi të pashembullt, të cilët ma kujtonin atë thënien popullore: **“Nuk bie rrëfeja në hithra”**, siç nuk kishte rënë edhe me rastin e atentimit të Naser Hanit. Me këtë thënie dhe filozofi popullore e ngushëllova veten edhe atë natë kur kuptova se ishte vra Naseri. Dora e zezë e ngritur historikisht kundër shqiptarëve kishte vepruar sërish, si shumë herë të tjera, duke goditur gjithherë mbi atdhetarët e dëshmuar dhe të njëmendët, siç kishte qenë Naser Hani.

Edhe pse ishim të gjeneratave të ndryshme, afërsia ime me Naserin ishte e natyrshme, ishte e ndërtuar mbi disa shtylla, të cilat ishin, janë dhe do të mbeten të pa shembura:

**Së pari** u lindëm dhe u edukuam në një ambient revolucionar të mirënjohur për mbarë shqiptarët kudo që janë, në Veleshtën zulmëmadhe, e cila që herët reflektoi përkushtim kombëtar dhe atdhetar. Në këtë ambient nuk ishte vështirë

t'i marrësh frymëzimet e para për pozitën e gjithëmbarshme socio-shoqërore të shqiptarëve, për diskriminimin e tyre, ashtu siç nuk ishte vështirë ta kuptosh edhe nevojën dhe angazhimin për liri e barazi.

Nevoja për liri dhe barazi ishte imediate për shqiptarët në Maqedoni, kurse realizimi i saj ishte dashur që fillimisht të përhapej nëpërmjet promovimit të idesë, që shqiptarët në Maqedoni të janë komb dhe popull shtetformues i institucionalizuar normativisht. Shtetformësinë e tyre, përveç shqiptarëve, e kanë realizuar të gjithë popujt e tjerë në kuadër të ish-Federatës së Jugosllavisë.

Nuk ka dyshim se mungesa e komponentit të shtetësisë, shqiptarët në Maqedoni i detyroi që t'i kapin armët dhe të luftonin në vitin 2001, luftë, e cila, pos jetëve të shumë luftëtarëve, e mori edhe jetën e Naser Hanit. Mjerisht, edhe pse shpresa ishte e madhe që fillimtranzicioni dhe lufta e vitit 2001 do ta përmbushnin plotësisht objektivin e të qenit të shqiptarëve popull shtetëformues, edhe këtë copëzim zgjidhjeje selektive që u arrit, Naser Hani nuk e përjetoi.

Por, edhe pse objektivi për të cilin u angazhua Naseri nuk u arrit plotësisht, angazhimi, insistimi, veprimtaria dhe në fund edhe martirizimi i tij nuk shkuan kot. Sot Kosova është e lirë, shqiptarët në Maqedoni marrin frymë pak më lirisht në sajë një biçim institucionalizimi të tyre si popull shtetformues;

**Së dyti**, me Naserin bashkëvepronim në të njëjtin formacion politik, në Partinë Demokratike Shqiptare, që në atë kohë u bë simboli më rrezatues në mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në Maqedoni, me një armatë aktivistësh mbarëkombëtarë, kultivues të denjë të traditës dhe të kulturës kombëtare, që ishte ndrydhur dhe anatemuar shekuj me radhë nga regjimet sllavo- komuniste, dhe

**Së treti**, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ideor, politik dhe aksional i ndërsjellë, që kam pasur me Naserin në Strugë e më gjerë, ishte aq i harmonishëm, saqë ai i kalonte linjat politike dhe u përcoll vazhdimisht edhe me shoqërime familjare, vikende të përbashkëta për nevoja komplementare. Vikendet javore i kalonim në bashkëshoqërim, bashkëveprim dhe analizim të pareshtur të të gjitha fenomeneve dhe mundësive për një përmirësim cilësor të pozitës së shqiptarëve, së pari në Strugë, e mandej edhe më gjerë. Është utopi të mendohet se asokohe nuk janë sjellë rreth nesh edhe individë me role të dyfishta si gjithmonë, por ishte kohë e ekzaltimit për ndjenjën e lirisë, dhe Naseri për këtë flijonte çdo gjë, me qëllim që të eliminohej një histori e gjatë padrejtësisht bashkë me tradhtarët.

Lufta e Kosovës dhe ajo në Maqedoni gjatë viteve 1998-2001, mua më gjeti në Qeverinë e Maqedonisë si anëtar qeverie, kurse Naserin si udhëheqës të



lartë partiak në PDSH dhe si funksionar vendor me rëndësi. Ishte obligim, por edhe nderë e kënaqësi që Naseri në këto momente historike me tërë qenien e vet ishte në funksion të idealit, të aktivitetit për mbarëvajtje të luftës, si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni. Për të ishte parësore puna për dhënien e ndihmës luftës në Kosovë, që pastaj të kalohej në fazën e sistemit të shqiptarëve të dëbuar nga Kosova në Maqedoni. PDSH-ja këtu e kishte rolin parësor. Me Naserin e komentoni faktin se si PDSH-ja si partipiente e re në pushtet, e gjeti vendimin që zëshëm e kishte publikuar paraprakisht Gligorovi dhe përfaqësuesit e tij, se në Maqedoni mund të vendosen dhe të pranohen për strehim vetëm 20.000 kosovarë të dëbuar. Përkundër kësaj, në Maqedoni u strehuan më shumë se 360.000 shqiptarë të dëbuar nga Kosova. Ishte edhe Naseri pjesë e një trupi madhor që i asgjësoi vendimet e tilla antishqiptare të qeveritarëve maqedonë, që jo vetëm se i eliminoi tabutë e tilla paralajmëruese dhe kobzeza, por paralelisht fillimndërtoi edhe standarde të reja nga të cilët përfituan në radhë të parë kosovarët gjatë luftës çlirimtare, por edhe të gjithë shqiptarët e, në veçanti, ata në Maqedoni.

Aktiviteti i Naserit asokohe karakterizohej nga largpamësia politike, e cila rezultonte nga cilësueshmëria e të qenit të tij atdhetar i përkushtuar i çështjes shqiptare. Naserin asokohe e karakterizonte edhe konspiracioni i lartë dhe kualiteti i të vepruarit të tij në ilegalitet të thellë, duke u mbrojtur në vijimësi nga pushtetet sllave.

Asokohe si anëtar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, kisha detyrim, por edhe mundësi, që të angazhohesha edhe për menaxhimin e politikave lokale, përfshi edhe Strugën, e cila duke qenë vendkalim kufitar më frekuentues me Shqipërinë dhe për shqiptarët në tërësi, ka pasur rëndësi të veçantë. Në kontributet për politikat pozitive në këtë drejtim shquhet edhe Naser Hani. Aktivitetet e tij politike e portretojnë atë si patriot të njëmendët në përpjekjet e pareshtura të tij për çlirimin e popullit të vet.

Për ne ishin të veçanta sidomos momentet e fillimit të bombardimeve të NATO-s ndaj caqeve luftarake të Serbisë. Kjo, sidomos kur me Naserin gjatë netëve të kthjellëta, duke qëndruar në ambiente të hapura të Strugës i shikonim dhe i dëgjonim avionët bombardues të NATO-së të cilët fluturonin drejt Serbisë, dhe kur ne bënim komente të cilat shkonin deri në ekzaltim, pasi që ishte bërë e qartë se përpjekja shekullore e shqiptarëve të Kosovës dhe e shqiptarëve në tërësi ishte pranë të qenit realitet, të cilin Naseri aq shumë e dëshoi dhe për të cilin u flijua edhe vetë. Për ne asokohe ishte përjetim i veçantë sidomos ndjenja e të qenit të shqiptarëve në koalicion me tërë botën e fuqishme demokratike.

Fillimi i luftës së viti 2001 në Maqedoni, Naserin e gjeti në pozitën e

udhëheqësit të sektorit për punë sociale në Strugë. Fillimet e kësaj lufte ishin objekt i komentimeve tona nga më të ndryshmet. Takimet e bëra, gjatë kësaj kohe në ambientet e të ashtuquajturit “Hotel Izgrev” mbi fshatin Kalishtë, shkonin si në drejtim të menaxhimit të të gjitha aktiviteteve që i impenjonte tani më lufta e filluar në Maqedoni, ashtu edhe në drejtim të hapjes së frontit të mundshëm të luftës edhe në Strugë dhe rrethinë.

Brenda angazhimeve dhe organizimeve për veprime të tilla ushtarake në Strugë, Naseri ishte bashkëpunëtori kryesor në përpjekjet për vlerësime reale të gjendjes. Ishte mendim i prerë edhe i tij, se planifikimi strategjik paraprak duhet ta determinonte qartësisht vendimin për veprim ushtarak edhe në Strugë. Nga ky këndvështrim dhe për këtë objektiv roli i Naser Hanit ishte i shumë i çmuar. Ishin kujtimet e tilla ato të cilat bënë që në mbrëmjen kobshme kur e mora lajmin e vrasjes së Naser Hanit të derdhja lot. Lufta nuk sjell tufa me lule, por ama ajo i promovon heronjtë e vet. Të tillë e promovoi edhe Naser Hanin, ashtu qetësisht, siç ishte edhe natyra e tij si njeri.

Edhe pse isha anëtar dhe zëvendëskryeministër i Qeverisë së Maqedonisë, përpjekjet e mia për zbardhjen e vrasjes së Naser Hanit brenda në institucione dhe me faktorët dhe institucionet e instaluar ndërkombëtare në Maqedoni (përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e Gjykatës ndërkombëtare për krimet e luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë) nuk dhanë rezultate. Ky fakt sinjifikues e ilustron pozitën e rëndë të shqiptarëve në këtë shtet, në veçanti, sa i përket pjesëmarrjes së tyre në strukturat e sigurisë së këtij shteti, si atëherë në kohë lufte, ashtu edhe sot.

Por hetimi dhe zbardhja e vrasjes së Naser Hanit nuk duhet të pushojnë asnjëherë edhe për një arsye të thjeshtë, se jo rrallë më shumë dhemb dora e zgjatur e krimit, se sa pasoja dhe pësimi, të cilat ranë mbi pishtarin e lirisë dhe barazisë, Naser Hani në këtë rast. Duke pasur parasysh se përpjekjet për zbardhjen e vrasjes së Naser Hanit, sot e kësaj dite s'kanë dhënë ndonjë rezultat, kjo dëshmon për një realitet të dhimbshëm të shqiptarëve në Maqedoni, se qasjet tona si shqiptarë në struktura dhe institucione me peshë sigurie dhe konspiracion shtetëror kanë qenë dhe kanë mbetur minore.

Dhe për fund them se kujtesa ime për fytyrën gjithnjë të buzëqeshur, për mendimin pozitiv dhe kombdashurinë e Naser Hanit nuk do të veniten asnjëherë. Të tillë janë, të tillë vdesin e të tillë mbeten përgjithmonë në kujtesën e njerëzve patriotët e vërtetë si Naser Hani.

## ■ Xhavit Haliti

### Një shok i shtrenjtë dhe i paharrueshëm

Naser Hanin, si edhe shumë shokë të tjerë, e kam njohur në vitin 1978, gjatë aktiviteteve të organizuara nga „grupi ynë“.

Naseri ka qenë student i ekonomikut, kurse unë i letërsisë dhe i gjuhës shqipe. Ka qenë angazhimi i përbashkët për çështjen e Kosovës që na ka bërë shokë. Fillimisht e njoha përmes një shoku nga Veleshta dhe pastaj u bëmë shokë dhe mbetëm shokë deri në fund. Ajo që më ka ra menjëherë në sy te Naseri ka qenë përkushtimi i tij për të drejtat e shqiptarëve, në përgjithësi, dhe të drejtat e Kosovës, në veçanti. Tjetra, që më ka ra në sy, ka qenë korrektësia me shokë dhe ndjenja e përgjegjësisë ndaj të tjerëve. Natyra e tij shumë entuziaste, shoqëruese dhe pajtimtare ka qenë e veçantë. Më i interesuar ka qenë ta kryejë një punë sado të vogël se sa të flasë kot.

Gjatë viteve të '70 së bashku me Naserin dhe të tjerët shpërndanim literaturë të ndaluar që vinte nga jashtë dhe nga Shqipëria. Më kujtohet se si gjatë vitit 1979 ne e morëm një kopje të traktit që ishte shpërndarë gjatë vizitës së Titos në Kosovë. Trakti kishte dy faqe. Mua ma dha atë Sylë Berisha i Dubovikut, që banonte në Prishtinë. Pasi e lexuam atë trakt me Naserin, vendosem që ta shumëzonim e ta shpërndanim. Por, me që asokohe aparatura shumëzuese (shaptilografë dhe aparate fotokopjuese) kishin vetëm institucionet shoqërore dhe shtetërore, për ta shumëzuar një trakt të tillë ishte dashur që të kishe një njeri të besueshëm (një bashkëmendimtar politik) brenda institucioneve, i cili do ta shumëzonte atë në fshehtësi. Naseri e kishte gjetur mundësinë e tillë dhe e kishte shumëzuar atë trakt në rreth 200 kopje, të cilat pastaj i shpërndamë nëpër shokë dhe që u lexua dorë pas dorë.

Naseri si edhe Fadil Vata nuk ka pasur asnjë pretendim për veten e tij. Në mesin e shokëve ai krijonte vazhdimisht atmosferë të mirë dhe motivuese. Asokohe ai ka njohur edhe shokë të tjerë si, Bardhyl Mahmutin, Ramadan Avdiun e shumë të tjerë. Një pjesë e shokëve të tij natyrisht se kanë qenë studentë nga Maqedonia, të cilët studionin në Prishtinë. Përmes Naserit njoha shumë shokë nga viset shqiptare në Maqedoni. Në fund të viteve të '80 Naseri bashkë me shumë të tjerë i ka kontribuar përgatitjes së lëvizjes studentore për t'iu kundërvënë ajo pushtuesve serbë, maqedonë e malazez, në Kosovës dhe në viset e tjera shqiptare gjithandej.

Për shkak të pjesëmarrjes në demonstratat e pranverës së vitit 1981, ai në tetorin e vitit 1982 u arrestua në Prishtinë, kurse më pas e transferuan në burgun e Ohrit në Maqedoni. Edhe përkundër torturave bizare që i ishin bërë gjatë hetimeve, ai nuk e kishte dekonspiruar asnjë shok. Kështu, duke mos i pranuar akuzat e UDB-ashëve maqedonë, ai e ka shpëtuar veten dhe disa shokë që mos të dënoheshin me burgim afatgjatë.

Pas daljes nga burgu Naseri u kishte thënë shokëve të tij nga Veleshta e Struga, se UDB-ja s'kishte nxjerrë prej tij as edhe një fjalë të vetme lidhur me shokët si: Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Muhamet Mahmuti, Riza Dema, Ibrahim Boqolli, Sinan Kastrati, Xhevat Ademi e të tjerë. Në të vërtetë, Naseri, kishte dashur që ne të tjerët, duke e ditur se ai s'e kishte thënë asnjë fjalë për ne, të mos binim pre e taktikave mashtruesve të UDB-ashëve, po të arrestoheshim e të hetoheshim, të cilët duke na gënjyer neve sikur Naseri apo ndonjë tjetër shok i yni gjatë hetimeve ka dëshmuar për këtë ose atë veprim të përbashkët, të na mashtronin dhe të na dënonin për vite të tëra.

Edhe pas daljes nga burgu Naseri është angazhuar vazhdimisht. Virtyti i tij veçantë ka qenë se ai ka ditur të gjejë gjuhë të përbashkët edhe me ata shokë, të cilët e kanë pasur ndonjë të metë. Naseri ka qenë një “katalizator” i mirë brenda Lëvizjes studentore për Republikën e Kosovës. Duke qenë i dhënë me mish e me shpirt për çështjen e Kosovës, ai është parë gjithandej, herë në Kosovë e herë në Maqedoni.

Pas vitit 1985 kur unë u largova në Zvicër Naserin për një kohë më se kam parë, por kam dëgjuar se ai ka qenë gjithnjë aktiv dhe ka bashkëvepruar me shokët tanë, asokohe të LPRK-së. Po ashtu kam dëgjuar se nëpërmjet të njoftësive ishte punësuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës në resorin e ekonomisë. Edhe nga vendi i punës e kishte ndihmuar organizatën tonë, LPRK-në, duke bërë fotokopjime të trakteve dhe të afisheve me mjetet teknike të vendit ku ka punuar etj. Më kujtohet kur pas vitit 1985 Naseri erdhi njëherë te unë Zvicër dhe më vizitoi mua. Temat tona të bisedave ishin ato të dikurshmet, të Prishtinës, kur kishim qenë studentë: Kosova, shqiptarët në Maqedoni, shtypja etnike, kundërvënja jonë etj.

Naseri të gjitha angazhimet e tij i ka bërë si veprimtar i lirë. Edhe pse ka bashkëvepruar me LPRK-në dhe më vonë LPK-në, ai, s'ka qenë asnjëherë anëtar i saj. Mendoj se edhe angazhimi i tij gjatë viteve të fundit si anëtar i PDSH-së në Maqedoni ka qenë më shumë formal. E tillë ka qenë natyra e tij.

Pas abrogimit të autonomisë së Kosovës dëgjova se ishte kthyer në Maqedoni, në fshatin e tij të lindjes, në Veleshtë. Edhe në Maqedoni ka vepruar vazhdimisht. E ka ndihmuar krijimin e partive politike, ka mbledhur dhe shpërndarë ndihma për të burgosurit politikë etj. Në vitin 1993 kishte ikur në Austri, sepse në Maqedoni ishte ndier i rrezikuar. Edhe në Austri ka bashkëvepruar me degën e LPK-së për Austrinë dhe me të tjerë, duke e ndihmuar UÇK-në dhe fondin “Vendlindja thërret”. Midis viteve 1996-1989 jemi takuar disa herë në Zvicër, ku kemi biseduar si ta ndihmojmë luftën në Kosovë e të tjera.

Pastaj kam dëgjuar se nga fundi i vitit 1998 ishte kthyer nga Austria në

Maqedoni. Pas ikjes së forcave serbe nga Kosova në qershorin e vitit 1999, Naserin e kam takuar sërish në Prishtinë. Si gjithnjë temat tona kanë qenë të njëjta: Kosova, pavarësia, të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni etj.

Gjatë luftës në Maqedoni, Naseri, duke qenë anëtar i PDSH-së, është përpjekur që të arrihej marrëveshja midis partive shqiptare dhe UÇK-ës etj. Duke lexuar e dëgjuar se policia sekrete maqedone kishte kindnapuar dhjetëra civilë shqiptarë, kurse disa edhe i kishte vrarë, e kam lënë të mundshme se edhe Naserit mund t'i ndodhnin gjëra të tilla.

Lajmi për vrasjen e tij m'u kumtua me telefon. Për një moment u ndjeva edhe vetë i vrarë! Në mendjen time Naseri do të mbetet një shok i shtrenjtë dhe i paharrueshëm.

## ■ Avni Kica

### **Përkulem para veprës se tij me respekt dhe nderim**

Të flas për Naserin nuk e kam të lehtë, sepse e kisha shok që nga fëmijëria, që nga bankat e shkollës fillore në Veleshtë dhe që nga bankat e shkollës së mesme në Strugë. Të flas për Naserin nuk e kam të lehtë, sepse fjala është për njeriun që e sakrifikoi jetën e tij, që edhe shqiptarët në Maqedoni të kishin më shumë të drejta, barazi e liri.

Në vitin 1979 kur unë i fillova studimet në Fakultetin ekonomik të Universitetit të Kosovës, Naseri ishte student i vitit të tretë i këtij fakulteti. Që asokohe në u shoqëruam vazhdimisht. Në takimet tona fillimisht spontane në holin e fakultetit, dhe pastaj edhe në banesën time në rrugën Aktash II nr. 52, Naseri gjithmonë i prekte temat e ndjeshme politike. Naseri thoshte se duhej të punonim sa më shumë politikisht me studentët nga Maqedonia, të cilët asokohe studionin në Prishtinë, dhe shtonte se duhej të kishim kujdes se UDB-ja na ndjek! Kur u burgosa në korrikun e vitit 1981 pashë se Naseri kishte pasur të drejtë, sepse UDB-ashët e dinin se ne ishim takuar shpesh, prandaj edhe më pyetnin vazhdimisht për Naserin se çfarë lidhje kisha pasur me të.

Gjatë viteve të '80 Naseri më sillte gazeta ilegale nga Zvicra dhe Gjermania, si p.sh: gazetën “Zëri i Kosovës”, “Liria”, “Shqipëria e re”, si dhe m'i sillte veprat e Enver Hoxhës, si p. sh: librin “Titistët” etj. Shihej qartë se Naseri kishte lidhje me grupet ilegale të atyre viteve, por unë nuk e pyesja për grupet e tilla për shkak të konspiracionit të thellë.

Naseri mori pjesë në të gjitha demonstratat e vitit 1981, siç qenë ato e 11 dhe e 26 marsit dhe ato 1 e 2 prillit. Më kujtohet se si atij në demonstratën e 1 prillit nga sasia e madhe e lotsjellësit, të cilin e kishte thithur, në një moment

iu zu fryma. Pasi e tërhoqëm për disa minuta nga turma e demonstruesve, ai e mori veten dhe sërish iu bashkangjiti demonstratës. Në verën e vjeshtën e vitit 1982 edhe Naseri u burgos dhe u hetua në burgun e Ohrit në Maqedoni. Duke i përballuar torturat e shumta, doli nga burgu pa e thënë asnjë fjalë, e cila do t'i dëmtonte shokët e tij të shumtë, me të cilët kishte bashkëvepruar për kohë të gjatë. Pas daljes nga burgu ai sërish vazhdoi me aktivitetet e tij në dobi të rezistencës së rinisë dhe popullit shqiptar për realizimin e “Republikës së Kosovës”.

Në vitin 1993 Naseri për shkak të përndjekjeve të rrezikshme që iu bënë në Maqedoni, u detyrua që të migronte në Austri, ku qëndroi deri në vitin 1998, dhe ku ishte vënë në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Pas kthimit nga Austria në Maqedoni në fund të vitit 1998, ai e përkrahu Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës (UÇPMB-në), dhe më pas edhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare të Shqiptarëve në Maqedoni (UÇK-në). Naseri i përkrahu këto luftëra, sepse ai e kishte atdhe Maqedoninë perëndimore, Kosovën, Preshevën, Bujanocin, Medvegjën, Ulqinin, Tuzin, Tivarin, Shqipërinë dhe Çamërinë! Për të gjitha këto unë përkulëm me respekt e nderim para veprës së Naser Hanit.

Më 12 qershor të vitit 2001 kur Naseri u vra me atentat të fshehtë, ne shokët e tij e humbëm shokun tonë besnik, Veleshta e humbi djalin e saj më të mirë, Kosova e humbi demonstruesin e saj të flaktë, Shqipëria e humbi besnikun e saj! Me humbjen e Naserit kanë humbur diçka të gjithë shqiptarët.

Ndjem krenar që Naserin e pata shok dhe udhërrëfyes të veprimtarisë sime politike. Për mua do të mbetet e paharrueshme largpamësia e tij politike, optimizmi dhe shpresa e tij e madhe se shqiptarët do të bashkoheshin një ditë.

## ■ **Ibni Kica, Dashmir Kaba, Imit Istrefi, Qashif Hani** **Në mendjet dhe zemrat tona do të mbetët përgjithmonë**

Unë, **Ibni**, me Naserin kam qenë bashkë që në bankat e klasës së parë të shkollës fillore në Veleshtë. Unë, **Dashmiri**, me Naserin i kam kaluar si vitet e gjimnazit në Strugë, ashtu edhe vitet e studimeve në Prishtinë. Unë, **Imiti**, me Naserin kemi qenë dajë e nip. Unë, **Qashifi**, Naserin e kam pasur kushëri. Por ne të gjithë në radhë të parë Naserin e kemi pasur shok të idealeve tona të përbashkëta.

Naseri pas kryerjes së studimeve mbeti në Kosovë sepse ai u punësua në Prishtinë, kurse ne si edhe shumë të tjerë morëm rrugët e kurbetit. Tani më ka rreth 30 vjet që jemi në Zvicër, por me Naserin nuk i shkëputëm lidhjet

asnjëherë deri në fund të jetës së tij. Sa herë ishim në pushimet vjetore në Veleshtë ne takoheshim me Naserin, ndërkohë që komunikonim me të edhe me telefon. Ajo që na bëri shokë të pandashëm me Naserin ka qenë angazhimi i ynë për të drejtat e shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni e gjithandej.

Duke qenë student në Prishtinë, Naseri me Dashmirin dhe me shumë të tjerë ka marrë pjesë në demonstratat e vitit 1981 për bërjen e “Kosovës Republikë”. Duke qenë komunikativ, i dashur dhe miqësor, që asokohe ai kishte krijuar një rreth shokësh të përkushtuar kombëtarisht, duke filluar që nga Kosova e deri në Maqedoni. Në mesin e shokëve të tillë patëm fatin që të ishim edhe ne. Në fund të vitit 1982, Naseri bashkë me Dashmirin dhe shumë të tjerë, u arrestua dhe u burgos në qytetin e Ohrit. Edhe përkundër torturave ekstreme që ishin ushtruar ndaj tij, ai, duke i refuzuar akuzat e UDB-ashëve maqedonë, pas dy muajsh u lirua nga burgu duke e shpëtuar kësioj veten dhe disa shokë të tij nga dënimet me burgje afatgjata.

Naseri ka qenë nxitës dhe organizator i shumë iniciativave. Kështu, ai gjatë tërë viteve të '80 dhe në fillim të viteve të '90, bashkë me shokët e tij nga Veleshta dhe rrethina, mblodhi ndihma financiare për familjet e të burgosurve politikë në Kosovë. Aq shumë i ka dashur shokët e tij me të cilët ka vepruar politikisht, sa që ishte i gatshëm ta sakrifikonte veten për ta.

Por, para se gjithash, Naseri i ka dashur shumë bashkëfshatarët e tij, veleshtarët. Duke qenë tolerant dinte të bisedonte me secilin. Me kalimin e viteve u bë një figurë e dashur dhe e respektuar për të gjithë në Veleshtë. Një Naser e pati Veleshta, dhe për t'i ardhur Veleshtës një tjetër si ai, kemi frikë se do të duhet të pritët shumë kohë. Aftësia e Naserit për t'i parashikuar rreziqet, të cilat mund t'u vinin shqiptarëve nga shovinistët maqedonë, ka qenë e madhe. Kështu, ai që në vitin 1987, rreth katërmëdhjetë vjet para se të ndodhte lufta e vitit 2001 në Maqedoni, na porositi që ta themelonim “Shoqatën e veleshtarëve në Zvicër”, në mënyrë që nëse shqiptarët do të sulmohen nga strukturat e dhunshme maqedone një ditë, veleshtarët të ishin të bashkuar dhe të gatshëm për ta dhënë kontributin e tyre.

Naseri në vitin 1990, pas pezullimit të autonomisë së Kosovës, është kthye në Maqedoni, duke i bërë veleshtarët edhe më unikë seç kishin qenë. Para unitetit të tillë të veleshtarëve policia maqedone i ka “thyer hundët” disa herë. Midis viteve 1990-1993 ai e ndihmoi krijimin e partive politike shqiptare në Maqedoni, duke e themeluar kësioj bashkë me ne degën e PPD-së për Strugë me rrethinë, edhe pse vetë nuk mori asnjë post politik. Po brenda këtyre viteve ai u angazhua edhe për realizimin e një “autonomie politiko-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni”. Meqë ishte angazhuar në resorin e mbrojtjes të atij mekanizmi për

Strugën me rrethinë, në verën e vitit 1993 nga strukturat përndjekëse maqedone ishte rrezikuar seriozisht. Kishte qenë kjo arsyeja pse ai në vitin 1993 u vendos në Austri, ku qëndroi deri në vitin 1998. Gjatë qëndrimit në Austri ai ishte bërë anëtar i PDSH-së, edhe pse gjithnjë ka vepruar si veprimtar i lirë.

Brenda viteve 1966-1998 ai me tërë qenien e tij ishte vënë në shërbim të Luftës Çlirimtare të Kosovës, të UÇK-së dhe të fondit “Vendlindja thërret” në Austri. Ndër ato vite ai na vizitoi neve disa herë në Zvicër, përkatësisht për të ndikuar që veleshtarët ta ndihmonin financiarisht Luftën Çlirimtare të Kosovës. Edhe pas kthimit të tij në Maqedoni, në fund të vitit 1998, Naseri e ka ndihmuar Luftën Çlirimtare të Kosovë deri në fund të saj në qershorin e vitit 1999. Për këtë qëllim ai e ka themeluar Veleshtë dhe rrethinë një “këshill lokal” për grumbullimin e ndihmave financiare për luftën në Kosovë. Ndihmat e tilla financiare të mbledhura nga ai këshill, pasiqë vinin në Zvicër janë dorëzuar në fondin “Vendlindja thërret” nga Ibni Kica dhe Qashif Hani.

Vrasja e Naserit me atentat të fshehtë në qershorin e vitit 2001 na ka tronditur të gjithëve pa masë. Hakmarrja jonë për vrasjen e Naserit do të jetë realizimi i idealeve të tij për liri e barazi të shqiptarëve në Maqedoni. Për të gjitha këto Naseri në mendjet dhe zemrat tona do të mbetet përgjithmonë!

## ■ Abdullah Abdullahu

### Idealet e tij do të rrojnë përgjithmonë

Ishte kohë e vranët, një paradite me riga shiu e një të diele të dimrit të vitit 1994, kur shqiptarët mërgimtarë në Austri kishin organizuar një protestë para Selisë së OKB-së në Vjenë (Austri), dhe kur unë me disa shokë kishim ardhur nga qyteti i Salzburgut (400 km largësi) për të marrë pjesë në atë protestë, që po mbahej në vazhden e protestave të shumta për sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar lidhur me çështjen e Kosovës.

Në sheshin e protestës m'u afrua një shqiptar i shoqëruar nga dr. Xhevat Hasani. Ishte një burrë zeshkan, i cili aq sa dukej i rryer po aq dukej për momentin edhe i lodhur. „Unë jam Naser Hani, eja të pimë bashkë nga një kafë“, më tha duke bërë me dorë drejt një restoranti aty afër. Reagimi i tillë i tij aq i çiltër dhe aq i drejtpërdrejtë më bëri përshtypje të veçantë. Derisa e tha emrin m'u kujtua se kisha dëgjuar për të, por s'e kisha pa asnjëherë. Kështu kuptova se edhe Naseri ishte vendosur në Austri për shkak të përndjekjes politike nga ana e regjimit maqedon. Që në takimin e parë më la përshtypjen e njeriut të qetë, zemërmirë por edhe të prerë. Në sytë e tij të zezë dhe të ndritur lexohej shumë lehtë gëzimi që ishim takuar dhe po bisedonim bashkë.

Pasi që biseduam për rreth një orë erdhëm në përfundim që unë ta lëshoja



Salzburgun dhe të vendosjes në Vjenë, në mënyrë që së bashku t'i rrekeshim një forme të re të organizimit të mërgatës sonë. Pas vendosjes sime në Vjenë, fillimisht në banesën e Gani Çollakut, babait të shokut tim të studimeve, Kadrush Çollakut, debatua për një rirreshtim të mërgatës shqiptare me theks të veçantë në qytetin e Vjenës. Më pas edhe me përkrahjen dhe këshillat e bacit Adem (Adem Demaçit), u morëm vesh që në Vjenë ta themelonim „Bashkësinë shqiptare në Austri“, e cila më pas u bë qendra kryesore e aktiviteteve tona në mbështetje të luftës për çlirimin e Kosovës.

Rreth këtij organizimi të ri ishin mbledhur veprimtarë të shumtë nga të gjitha trevat shqiptare siç qenë: Januz Saliuka nga Gjakova, Xhevat Balaj nga rrethi i Istogut, Nusuf Kamberi nga Gostivari, xha Abedin Abazi nga Zajazi i Kërçovës, Dilaver Jusufi nga Shkupi, Ejup Murseli nga Kumanova, Avdyll Gjoci nga Peja, Bafti Alija nga Ferizaji, Kadrush Çollaku nga Hasi i Prizrenit, Selman Thaqi nga Drenica, Avni Sadrija nga Brovina, Jani Koçi nga Tirana e shumë e shumë të tjerë. Marrë së bashku, të gjithë këta veprimtarë përbënin një bërthamë të fuqishme në funksion të propagandimit dhe të ndihmimit të luftës çlirimtare në Kosovë.

Dua të theksoj se Naser Hani me qetësinë, durimin dhe urtësinë e tij, rrezatonte në mesin e mërgatës frymën pajtimtare të bashkimit dhe shpresën e madhe të lirisë. Duke qenë i përkushtuar dhe i afërt me njerëz, vazhdimisht sillte kualitete të reja brenda organizimit të mërgatës, për ta orientuar e mobilizuar atë që ta ndihmonte çlirimin e vendit. Në të gjitha aktivitetet e organizuara brenda periudhës kohore 1996- 1998 në kuadër të „Bashkësisë Shqiptare në Vjenë“, duke filluar që nga procesi i integritit të shqiptarëve brenda shoqërisë austriake, e deri te organizimi i shkuarjes së vullnetareve në luftë për çlirimin e Kosovës, Naseri e ka pasur pjesën e tij të angazhimit bashkë me ne të tjerët.

Në fund të vitit 1998 Naser Hani u kthye në vendlindjen e tij në Maqedoni, në fshatin e tij të lindjes, në Veleshtë, me të vetmin qëllim që ta ndihmonte më tej avancimin e pozitës politike të shqiptarëve në Maqedoni. Më kujtohet si sot kur në shokët e tij organizuam për të një përcjellje vëllazërore, por nuk e dinim se ajo përcjellje do të ishte kujtimi dhe takimi ynë i fundit me shokun tonë të shtrenjtë, Naser Hanin, të cilin s'e pamë më, sepse ai në qershorin e vitit 2001 u vranga shërbimi sekret maqedon.

Edhe sot, pas kaq vitesh, sa herë që në shokët e Naserit takohemi këtu në vend të huaj, tanimë spontanisht e pa ndonjë obligim të caktuar, Naserin e kujtojmë me respekt, me dhembje dhe me mall të pashuar, por edhe me krenari të ligjshme që e patëm shok, që aq shumë na deshi e na respektoi, dhe që aq shumë e deshëm dhe e respekтуam.

Shpesh i kujtojmë fjalët dhe humorin e tij karakteristik me të cilin ai na

relaksonte në raste të veçanta, ashtu siç i kujtojmë edhe aktivitetet shumta që bëme së bashku gjatë viteve '90. Idealet e tij në mesin tonë do të rrojnë përgjithmonë.

## ■ Halit Naxhaku

### Prehu i qetë në Veleshtën tënde

Kam pasur nderin dhe kënaqësinë e veçantë, madje edhe ndjehem krenar dhe i privilegjuar që e kam njohur dhe e kam pasur shok të ngushtë Naser Hanin. Prandaj, çfarëdo që të them dhe shkruaj për të, do të jetë shumë pak për të mos thënë aspak.

Eh, Naser Hani, ky emër i veçantë, madje shumë i veçantë, i kishte të gjitha virtytet më të mira njerëzore e burrërore që mund t'i kishte vetëm një shqiptar si ai. I njerëzishëm, i buzëqeshur, i matur, i butë dhe i urtë, por edhe shumë i vendosur, i prerë dhe i rreptë në momente të caktuara kur e donte puna.

Dinte t'i zgjidhte shokët dhe miqtë e tij pa dallim moshe e profesioni. Shumë modest, zemërmadh e zemërbardhë ishte Naseri. Dashurinë e kishte për shokë e miq të vërtetë, urrejtjen e kishte për gënjeshtarë, batakçinj dhe armiq. I dhembshur pafundësisht, ai e pranoi detyrën e drejtorit të Qendrës sociale në Strugë, me qëllim që t'u ndihmonte skamnorëve, të ishte sa më afër tyre, t'i njihje sa më mirë dhe t'ua dëgjonte hallet dhe vuajtjet e jetës. Të tillë zemër kishte Naseri.

Kur e kërkonte nevoja, punonte ditë e natë dhe harronte të pushonte. Mbante të dhëna dhe shënonte gjithçka: Sa ekonomi private kishin shqiptarët, cila ishte fuqia e tyre ekonomike; sa kurbetçarë kishte Struga dhe rrethina; cila ishte fuqia e tyre ekonomike; sa intelektualë kishte Struga dhe rrethina; sa prej tyre punonin në arsim, ekonomi e shëndetësi; sa prej tyre ishin larguar nga vendet e punës për shkaqe politike; sa të rinj kishte Struga dhe rrethina; sa prej tyre ishin studentë, sa prej tyre ishin burgosur e larguar nga shkollat; sa vite burgu kishin bërë bashkarisht këta të rinj; sa prej tyre e kishin kryer shërbimin ushtarak, cilës gjini ushtarake i kishin takuar; sa prej tyre ishin vlarë dhe ishin kthyer në arkivole nga ish-armata jugosllave etj. Meqë nuk kishte kompjuter, të gjitha të dhënat i shënonte me dorë, pastaj i shkruante me makinë shkrimi të thjeshtë të atyre kohëve. Duke qenë shumë i kujdesshëm, shënimet e tilla s'ia jepte askujt, sepse kishte frikë se mund ta pësonin të tjerët.

Punonim së bashku duke e plotësuar vazhdimisht njëri-tjetrin për shumëçka. Midis nesh nuk ndodhi asnjë zënkë. Ishim të barabartë përpara çështjes shqiptare. Ajo na kishte lidhur e na kishte bërë shokë. Ajo na mbajti bashkë deri në fund të jetës së tij të shkurtër.

Naseri nuk e kurseu veten për asgjë. Me tërë kapacitetet e tij ishte në shërbim të çështjes shqiptare. Si shok ishte shumë besnik, i drejtë e i pahile. Si prind s'pati mundësi të dëshmohej, ngase dora vrastare e tinëzare ia shuajti jetën para kohe, pa e parë edhe këtë pak liri të pjesshme që kanë tani shqiptarët në Maqedoni.

Që herët e kishte kuptuar se luftërat e armatosura shqiptarët i kishin të paevitueshme. Kjo jo pse ndodhjen e tyre e donin shqiptarët që s'i kishin rënë askujt në qafë gjatë gjithë historisë, por sepse ato ua impononin atyre të tjerët, të cilët i kishin shkelur dhe po vazhdonin t'i shkelnin të drejtat e tyre.

Gjithnjë kishte qenë aty ku e kishte dashur puna. Duke filluar që nga pranvera e vitit 1981 u gjend në protesta e demonstrata, i ndihmoi familjet e të burgosurve politikë, u angazhua për njohjen e Universitetit të Tetovës nga ana e pushtetmbajtësve maqedonë. Si student ishte burgosur. Hetuesve maqedonë s'u kishte dhënë asnjë argument penalizues as për veten dhe as për shokët e tij. Pastaj u detyrua ta lëshonte Maqedoninë. Për disa vite u vendos në Austri. Pastaj u kthye sërish në Maqedoni derisa u vra tinëzisht nga shovinistët maqedonë, në qershorin e vitit 2001.

Prehu i qetë, shoku im Naser! Trupi dhe shpirti yt le të pushojnë në fshatin tënd, në Veleshtën tënde, që aq shumë e deshte dhe që aq shumë të deshti. Kujtimi im për ty nuk do të zbehet asnjëherë!

## ■ Ylber Hasani, Fadil Tutuli, Jani Koçi, Liri Ramadani Jemi krenarë që e patëm shok e vëlla

Naser Hanin e kemi njohur në Vjenë në vitin 1993 ku ishte arratisur në Austri për shkak të përndjekjes nga pushteti maqedon. Edhe pse më i pjekur e më i vjetër se ne, ai u soll si një bashkëveprimtar dhe shok i yni i barabartë. Ishte vetë natyra e tij e hapur dhe tejmase dashamirëse, ajo që nuk linte hapësirë për ndonjë barrierë.

Me kalimin e kohës ne pamë te Naseri “njeriun me shpirt të veçantë”, gjithnjë i gatshëm për ta ndihmuar secilin nga ne. Në mesin tonë ai gjithnjë krijonte atmosferë prej shoku e vëllai të vërtetë. Një veti tjetër e tij, e cila ka mbetur në kujtesën tonë, është se ai edhe me njerëz me të cilët nuk e kanë bashkuar mendimet apo qëndrimet politike, është sjellë me shumë korrektësi, takt e njerëzi. Në shumë raste kjo natyrë e sjellje e veçantë e tij, ka bërë që jo pak njerëz të mendonin ndryshe dhe t'i korrigjonin pikëpamjet dhe veprimet e tyre.

Edhe pse i arratisur nga vendlindja, i përmalluar për fëmijët dhe i ngarkuar me brenga, ai, e përvetësoi shpejt gjuhën gjermane, duke e kryer me sukses kursin gjuhësor të Universitetit të Vjenës për studentët e huaj, gjë që ia mundësoi t'i

regjistronte studimet postdiplomike në drejtimin e ekonomisë. Duke qenë edhe ne studentë, Naserin e njohëm për herë të parë në një bibliotekë studentësh të Universitetit të Vjenës. Prej atij momenti ne s'u ndamë prej tij deri në vitin 1998, kur ai u kthye në Maqedoni.

Gjatë viteve të qëndrimit në Austri e kemi parë Naserin që studentëve shqiptarë në Vjenë t'u fliste me dashamirësi, sikur t'i kishte ata vëllezër dhe shokë prej kohësh. Studentët shqiptarë, të cilët për shkaqe dhe vështirësi të ndryshme donin t'i braktisin studimet, Naseri bënte ç'mos që t'i inkurajonte, t'i motivonte dhe t'ua kthente vetëbesimin për t'i vazhduar studimet. Duke qenë vazhdimisht në kontakt me studentë të shumtë shqiptarë, ai po ashtu përpiquej ata që t'i orientonte drejt edhe politikisht, lidhur me zhvillimet, të cilat ndodhnin në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare.

Për t'i mbajtur studentët sa më pranë njëri-tjetrit, si për ditë të mira ashtu edhe për ditë të vështira, Naseri u bë njëri nga iniciatorët kryesorë për formimin e „Shoqatës së studentëve shqiptarë në Vjenë” me emrin “Societas Albania”, shoqatë kjo e cila me të njëjtin emër kishte ekzistuar edhe në vitet e '30 të shekullit të njëzetë. Në sajë të Naseri dhe të tjerëve, shoqata e studentëve shqiptarë në Vjenë u vu më pas në mbështetje të Luftës Çlirimtare të Kosovës.

Duke parandier zhvillime te reja në Kosovë, Naseri bashkë me të tjerët e inicioi edhe formimin e „Bashkësisë shqiptare në Vjenë”, nëpërmjet të të cilës u përkrah nga kurbetçarët në Vjenë e më gjerë Lufta Çlirimtare e Kosovës, UÇK-ja dhe fondi „Vendlindja thërret“.

Me të dalë në skenë UÇK-ja në vitin 1996 Naseri menjëherë u bë përkrahës i flaktë i saj. Na kujtohet se si ai pas secilit aksion të UÇK-së kundër stacioneve policore serbe në Kosovë ndjehej krenar, dhe na fliste neve me pasion se duhej të bënim gjithçka për ta përkrahur luftën e drejtë të UÇK-së. Po ashtu na kujtohet biseda e Naserit më njërin nga figurat kryesore të UÇK-së dhe këshilla e tij shoqërore dhe këmbëngulëse, që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në çfarëdo rrethane të mbijetonte, dhe ta vazhdonte luftën e drejtë për çlirimin përfundimtar të Kosovës.

Nga ana tjetër, Naseri na kujtohet edhe se si na fliste me përkushtim të veçantë për ngjarjet e viteve të '80 në Prishtinë, për demonstratat studentore të atyre viteve për ta bërë Kosovën Republikë. Vetë pjesëmarrja e tij në demonstratat e atyre viteve, bënte që ai t'i kujtonte ato me nostalgji. Duke i kujtuar ngjarjet e viteve të '80, ai besonte thellë se në mesin e popullit tonë, do të gjenden vazhdimisht djem e vajza, të cilët do të dinë t'u përgjigjen udhëkryqeve të historisë.

Por, Naserin e kemi parë herë pas here edhe të dëshpëruar. Kjo sa herë që individë ose grupe të caktuara shqiptarësh, më shumë zell ngjallnin huti e

përçarje në mesin e shqiptarëve kurbetçarë lidhur me UÇK-në dhe fondin e saj „Vendlindja thërret“. Të tillëve ai gjithnjë u jepte përgjigjën e merituar.

Edhe pse i arratisur, larg familjes dhe i brengosur, Naseri gjatë viteve 1993-1998 sa qëndroi në Austri na fali neve aq shumë gëzim dhe dashamirësi, përkushtim dhe atdhedashuri.

Jemi krenarë që Naserin e patëm shok edhe vëlla. Kujtimi ynë për Naserin, për këtë shok me shpirt të veçantë, do të mbetet në mendjet dhe zemrat tona përgjithmonë.

## ■ Ibrahim Bekteshi

### **Lufta për popullin shqiptar ende s'ka mbaruar**

Njëri nga shokët e ngushtë të Naserit isha edhe unë Ibraim Bekteshi.

Ndonëse Naseri ishte disa vjet më i vjetër se unë, ne u shoqëruam që herët dhe pothuajse se jemi rritur bashkë. Për mua si më i ri që isha, ishte krenari të rrija me Naserin sidomos gjatë viteve të '70 e të '80 kur ai ishte student i Universitetit të Prishtinës. Asokohe, Naseri sa herë vinte nga Prishtina në Veleshtë, na fliste për hallet dhe vuajtjet e popullit tonë në ish-Jugosllavi. Me theks të veçantë na fliste për rëndësinë e arsimit të popullit tonë, sepse, siç thoshte ai, duke qenë të arsimuar më lehtë do ta fitonim lirinë.

Sidomos gjatë vitit 1981 Naseri ishte aktiv në demonstratat studentore në Kosovë dhe më gjerë, veprimtari kjo për të cilën ai u burgos dhe u torturua ekstremisht në burgun e Ohrit. Edhe pas daljes nga burgu ai vazhdoi me organizime të ndryshme, takime, manifestime dhe shpërndarje të materialeve propagandistike. Ai na sillte neve libra dhe revista të ndryshme, si p. sh: revistën “Shqipëria e re”, gazetën “Lajmëtari i Lirisë; “Zëri i Kosovës”, “Zëri i Popullit” dhe gazeta, libra e revista të tjera. Naseri gjatë tërë viteve të '80 u angazhua për bërjen e Kosovës Republikë, duke krijuar kështu një rreth shokësh e miqsh patriot gjithandej. Ai Bëri shumë shokë e miq sepse ishte njeri i dialogut dhe kompromisit. Kur e merrje fjalën të dëgjonte deri në fund dhe pastaj e thoshte mendimin e tij.

Në fillimin e viteve '90 kur filloi rrënimi i ish-Jugosllavisë, Naseri u kthye nga Prishtina për të jetuar në Veleshtë, ku sërish u angazhua në veprimtari dhe organizime të shumta. Ai gjithnjë na thoshte se “pa luftë s'ka liri!”, prandaj edhe u angazhua në segmentin e mbrojtjes brenda organizimit shqiptar të asaj kohe në Maqedoni. Meqë organizimit të tillë UDB-ja maqedone i ra në gjurmë, ajo ndër të tjerë e vuri në shënjestër edhe Naserin, i cili me insistimin tonë u largua nga Maqedonia duke u vendosur në Austri. Me të arritur në Vjenë të Austrisë

nga udhëtimi të cilin e bëmë bashkë, ai shumë shpejt u angazhua në aktivitete të ndryshme. Dalja në skenë e UCK-së në Kosovë, Naserin e gjeti të angazhuar në përkrahje të saj dhe të fondit “Vendlindja thërret” në Austri, në Zvicër etj.

Aty kah fundi i vitit 1998 Naseri u kthye nga Austria në Maqedoni, dhe u fut sërish në rrjedhat e angazhimeve të vjetra e të reja në të mirë të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 1998, Naseri u emërua në postin e drejtorit të Qendrës Sociale të Strugës, ku ua zgjati dorën hallexhinjëve të shumtë shqiptarë dhe të tjerë. Ndonëse çlirimi i Kosovës nga forcat serbe në qershorin e vitit 1999 e gëzoi pa masë, ai, na thoshte neve se “lufta e popullit shqiptar ende s’ka mbaruar!”.

Por mbi kujtimet e mira për Naserin tanimë ka vite që ka rënë kujtimi i hidhur i datës së 12.06.2001, kur në mbrëmjen e asaj dite u hap si rrufe lajmi për vrasjen e tij nga forcat policore maqedone. Ceremonia mortore për nderë të Naserit u bë në vendlindjen e tij në Veleshtë, ku mijëra persona bënë homazhe dhe i dhanë lamtumirën e fundit: babait, vëllait, shokut dhe patriotit të rrallë Naser Hanit.

## ■ Një këngë për Naser Hanin

Në shenjë kujtimi me iniciativën e Mendih Qyrës është bërë një këngë për Naserin, tekstin e të cilës si poezi e ka shkruar Vahit Nasufi.

### Ndriço Diel mbi tokën time

Sa t’kam dashur sa të dua  
Mbi të gjitha oj liri,  
Mirë se erdhe edhe pa mua,  
Je parajsë për sytë e mi.

T’gjitha lulet e Pilavecit  
Le të çelin çdo kurorë,  
Në dritëhijet e kasnecit,  
Për Naserin tonë dëshmor.

Ndriço diell mbi tokën time  
Shkëlqej hënë si di ti,  
Fllad i lehtë nëpër agime,  
qiell i pastër përmbi Drini.

Ma hapni rrugën ta shikoj hënën  
Një rreze sonte sa më pëlqen,  
Dhe për një çast ta shikoj nënën,  
Zërin e shpirtit „Babi po vjen!“

Por Ju të mirët rrugën vazhdoni  
Marshoni shtigjeve pa u ndalë,  
Ndjejë mbrenda meje diçka po digjet,  
Vetëm Lynkestës ti them një fjalë...!

Kësaj poezie këngëtari ia ka shtuar edhe refrenet si më poshtë:

**„Flakë më digjet kraharori  
Tuj t`ëndrrue ty liri“**

**“T`gjitha lulet le të çelin,  
Për ditëlindjen e Naserit”.**

## **Fjala e redaktorit**

### **Libër që e pasuron spektrin e monografive**

Botimeve për zhvillimet e tri – katër decenieve të fundit në hapësirën shqiptare dhe bartësve të atyre zhvillimeve iu shtua edhe një libër i ri. Është ky libri i autorit Xhevat Hasani, «Një jetë në shërbim të lirisë», i cili i kushtohet Naser Hanit, veprimtarit të madh veleshtar të çështjes kombëtare, veprimtaria e të cilit fillon qysh në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar dhe përfundon në fillimin e këtij shekulli nga një vrasje e organizuar në Strugë prej pushtetmbajtësve maqedonë.

Autori me këtë libër e sjell një formë të re të shkrimit të monografisë. Ai i then të gjitha rregullat, të gjitha klishtët e shkruarjes së një monografie në kuptimin klasik të fjalës, duke e liruar librin nga dokumentet, shkresat e ndryshme, faksimilet, citatet, por edhe fotografitë, të cilat i përcjellin rëndom monografitë.

Libri i ka rreth 290 faqe dhe është i ndarë në tetëmbëdhjetë kapituj dhe shumë nënkapituj. Fillon me biografinë familjare, për të vazhduar me fëmijërinë e Naserit të kaluar në Veleshtë si të gjithë bashkëmoshatarët e tij dhe me rininë e hershme si nxënës gjimnazi, pastaj në studime në Prishtinë, ku i bashkohet aktiviteteve të studentëve dhe rinisë shqiptare, të cilave nuk iu ndahet deri në fund të jetës, të këputur nga katër plumba!

Burgosja, largimi për një kohë në Zagreb, për t'i humbur pak a shumë gjurmët, njësoj si pati bërë edhe veprimtari i madh i çështjes kombëtare, Ahmet Haxhiu, në vitin 1964, kthimi i sërishëm dhe punësimi në Prishtinë, ndihma organizatës ilegale – LPRK-së, që atë kohë ishte shumë aktive, largimi nga puna, kthimi i sërishëm në vendlindje, emigrimi në Austri, ku edhe ishte njohur me autorin Hasani dhe ku kishte dhënë një kontribut të madh, kthimi i sërishëm në



vendlindje, këtë radhë në Strugë, roli i tij i madh në dhënien e ndihmës refugjatëve nga Kosova, që në kohën e luftës në Kosovë kishin kaluar në Maqedoni, vizita në Kosovën e pasluftës, lufta në Maqedoni, roli dhe ndikimi i tij në afrimin e dy subjekteve shqiptare, UÇK-së dhe PDSH-së para Marrëveshjes së Ohrit, të cilën nuk e lanë ta pritte dhe në fund edhe vrasja e tij, janë kapitujt që e pasojnë njëritjetrit me ndërhyrje të shumta rreth zhvillimeve në gjithë hapësirën shqiptare në ish-Jugosllavi, duke mos e lënë mangut as Shqipërinë nën Dri, Shqipërinë në kufijtë administrativë, prej së cilës pa asnjë dyshim ishte ndikuar edhe Naseri, njësoj sikur e gjithë gjenerata e tij dhe tjerat para e pas saj.

Në më shumë se njëqind faqet e para autori, siç u tha, paraqet elemente biografike të familjes, duke përfshirë prindërit, vëllezërit, motrat, nipërit dhe mbesat dhe një rreth relativisht të gjerë shokësh, për të kaluar pastaj te rrethanat shoqërore e politike të kohës dhe të ndarjet e thella mes dy grupeve më të mëdha etnike që jetojnë në Maqedoni, mes maqedonëve si grup i parë i privilegjuar në të gjitha poret e jetës dhe shqiptarëve të diskriminuar, pa i përjashtuar as pjesëtarët e grupit tjetër etnik – romët, ndarje këto që ai i kishte vërejtur qysh si fëmijë.

Nga rrëshqitjet e shpeshta në rrethanat politike, në të kaluarën dhe aktualen, lexuesi e fiton përshtypjen shpeshherë se kryepersonazhi, humbi diku brenda fletëve të librit, ngeci diku në fraza, ngase «rrëshqitjet» e tilla shpeshherë të tejzgjatura dominojnë, por mu në kohën kur lexuesi mund të pyesë se ku mbeti kryepersonazhi, ai shfaqet i thellë, i urtë i vëmendshëm përmes një mendimi, përmes një sqarimi, tregimi etj..

Ai në libër nuk paraqitet i shkëputur nga ngjarjet. Atë autori e vënë në kontest të ngjarjeve, në rrjedhën e të gjitha zhvillimeve të kohës, në mes të shokëve të fëmijërisë, shokëve të rinisë, të kohës së gjimnazit në Strugë, midis studentëve në Universitetin e Prishtinës, e madje edhe në atë të Vjenës, ku i kishte filluar studimet postdiplomike, bashkë me mërgimtarët veprimtarë etj., jo si emra, por si grup, si kategori e organizuar shoqërore.

Sipas librit të autorit Hasani, Naser Hani nuk është vetëm bashkudhëtar i këtyre zhvillimeve, por është edhe njeri që ka ndikuar në rrjedhën e tyre, njeri që shumë ngjarjeve dhe zhvillimeve ua ka vënë vulën e vetë me shumë mund e punë.

Ai në këtë libër rrëfimin e vet përpiqet ta ndërtojë përmes kujtimesh nga bisedat, të cilat i kishte bërë me heroin e vet gjatë qëndrimit të të dyve në Vjenë dhe shoqërimit e veprimtarisë së përbashkët.

Autori shumë shpesh në fillim të përshkrimit të një ngjarjeje apo gjendjeje shkruan: “kështu mendonte Naseri”, “kështu thoshte Naseri” dhe këto dalin

shpeshherë edhe në fund të përshkrimit, por në një kohë tjetër: “kështu kishte menduar Naseri”, “si mendonte Naseri” etj. Kjo formë e paraqitjes së figurës apo veprimtarisë së Naser Hanit, le për të dëshiruar herë pas here, sidomos periudha gjatë viteve të 80-ta dhe fillimi i të 90-tave, gjë që nuk ndodh me periudhën e qëndrimit në Austri, ku autori paraqet, pos veprimtarisë kryesore të Naser Hanit, edhe detaje të kësaj veprimtarie. Njësoj ndodh edhe me periudhën e paskthimit nga Austria deri në momentin e vrasjes nga pushtetmbajtësit maqedonë, okupues të tokave shqiptare në gjithë Maqedoninë Perëndimore.

Për moszbardhjen e vrasjes së Naser Hanit autori Hasani, njësoj sikur edhe për vrasjen, në libër, i akuzon me të drejtë organet shtetërore të Maqedonisë. Vetë moszbardhja e kësaj vrasje është shumë indikative se vrasjen e veprimtarit Hani e kanë organizuar organet shtetërore të Maqedonisë, halë në sy të të cilave për rreth 30 vjet me radhë kishte qenë. Autori e tërheq vërejtjen se krimet as nuk vjetrohen e as nuk harrohen. Ato mbeten dhe herët a vonë.

Një vend të rëndësishëm në libër e zë edhe pasqyrimi i shtypit vendor dhe atij të huaj, të cilin autori , pos të përkthyer, e sjell edhe në origjinal.

Libri përfundon me kapitullin “Copëza kujtimesh nga disa shokë të Naser Hanit”, kapitull ky që e pasuron librin dhe e plotëson mozaikun e jetës dhe veprimtarisë së Naserit përmes kujtimeve të shokëve dhe të bashkëpunëtorëve, të cilët e kujtojnë me shumë respekt dhe flasin për të me pietet.

Për përfundim, autori, siç u pa edhe më lart, krahas figurës së Naser Hanit i trajton edhe rrethanat shoqërore, politike dhe historike të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në Kosovë, në Mal të Zi, në Preshevë, në Bujanoc e në Medvegjë, në Shqipëri dhe po ashtu edhe në mërgatë, të cilat dominojnë shpesh në libër, në formë të një kronike, sidomos në njëqindvjetëshin e fundit, gjatë të cilit ndodhën aq shumë ngjarje që ia ndryshuan pozitat shqiptarëve, me çka e pasuron spektrin e botimeve të këtij lloji.

**Ibish Neziri**

Buchs, janar 2013

## **Fjala e recensuesit**

### **Libër i frytshëm për lexuesin dhe studiuesin e historisë bashkëkohore**

Kohëve të fundit, historiografia shqiptare është pasuruar me mjaft monografi, jetëshkrime dhe biografi të ndryshme, të cilat pasurojnë një fushë të re të historiografisë, përkatësisht të historisë bashkëkohore (gjerm: Zeitgeschichte), të cilën e njeh historiografia evropiane dhe botërore, por fare pak ajo shqiptare.

Duke qenë bashkënjohës dhe njeri i afërt i Naser Hanit, Xhevat Hasani, na e paraqet një vëllim/jetëshkrim të veprimtarit veleshtas, Naser Hani/, i cili si veprimtar i denjë i çështjes shqiptare vritet nga shteti maqedon. Autori e fillon monografinë me një paraqitje të biografisë familjare dhe personale të Naser Hanit, që nga lindja e tij në Veleshtë afër Strugës (në Maqedoni), duke vazhduar më tutje të paraqesë rritjen dhe zhvillimin e tij fizik dhe intelektual. Më tutje ai vazhdon me angazhimin e Naser Hanit në strukturat atdhe- dhe populldashëse.

Duke qenë bashkëkohës i Naser Hanit, autori është njohës i mirë i jetës së tij. Ai përpiket të paraqesë në mënyrë mjaft të thuktë jetën dhe veprën e tij që nga fëmijëria, kur ai si fillorist kishte vërejtur dallimet që bëheshin në mes të kombeve në Maqedoni, dhe kishte filluar që t'i ndajë ato në formën e „fisit të parë, të dytë e të tretë!“. Duke i parë maqedonët si njerëz të zyrave, të shkresave, të lapsave, të letrave dhe të uniformave, të cilët kishin qenë edhe posedues pushtetesh dhe parash, ai këta njerëz i kishte quajtur të „fisit i parë“, siç i kishte ndarë figurativisht Naser Hani shtresimet kombëtare në Maqedoni, - ndërkohë që „fisi i dytë“, të cilin e përbënin shqiptarët, ishte populli që mezi mbijetonte me bujqësi, blegtori dhe kurbet. Dhe që në këtë moshë fëmijërore Naser Hani kishte filluar ta pyeste veten, se pse duhej që populli i tij të diskriminohej, të konsiderohej dhe trajtohej si popull i klasit të dytë. Duke qëndruar puna kështu,

shqiptarët ishin diskriminuar gjithmonë nga institucionet shtetërore jugosllavo-maqedone. Realiteti i tillë kishte ndikuar shumë në zhvillimin politik e patriotik të Naser Hanit.

Naser Hani, duke qenë i edukuar qysh në fëmijëri nga familja dhe rrethi i tij me tipare atdhedashurie, e vazhdon këtë mision edhe më tutje si gjimnazist në qytetin e Strugës dhe pastaj në vazhdimësi edhe në kohën e studimeve, të cilat ai i vijon në Universitetin e Prishtinës. Këtu, duke qenë në vazhden e demonstratave të vitit '81, Naser Hani bëhet një ndër veprimtarët e rëndësishëm të këtyre ngjarjeve. Autori një kapitull të tërë ia kushton ngjarjeve nga 1981 deri tek suprimimi i autonomisë së Kosovës (1989), duke ndriçuar veprimtarinë studentore rreth demonstratave, për çka Naser Hani pas këtyre demonstratave edhe burgoset në burgun e Ohrit, e deri te kthimi i tij në Maqedoni, pas një veprimtarie të vrullshme në Kosovë.

Autori në kapitullin 11 i përshkruan situatat pas kthimit të Naser Hanit nga Kosova në Maqedoni në vitin 1990 pas pezullimit të autonomisë së Kosovës dhe detyrimin e tij për egzil në Austri, gjithmonë duke i paraqitur edhe rrethanat historiko-politike të kohës, diçka që për lexuesin dhe studiuesin e historisë bashkëkohore është mjaft e frytshme, pikërisht për shkak të të dhënave të shumta me rëndësi historike, jo vetëm nga jeta e Hanit, por edhe për zhvillimet politike të kohës në përgjithësi.

Edhe në Austri nuk ndalet veprimtaria e Naser Hanit. Në kapitujt 12, 13, 14 autori paraqet rolin dhe kontributin e Naser Hanit për luftërat në Kosovë dhe në Maqedoni. Ai bëhet njëri nga organizatorët kyç të përkrahjes së këtyre luftërave, si kur kishte qenë në Austri, ashtu edhe kur ishte kthyer në Maqedoni në vitin 1998.

Në kapitullin e 15, autori trajton hollësisht vrasjen e Naser Hanit dhe qëllimin e vrasjes së tij. Naser Hani vritet gjatë një tentim kidnapimi me atentat të fshehtë nga ana e strukturave sekrete të qeverisë maqedone, e cila e shihte atë si pengesë kyçe në realizimin e shumë qëllimeve të saj, e një ndër këto qëllime ishte edhe dështimi i bisedimeve për paqe.

Mëtej, autori me mjaft guxim përshkruan edhe figurat të cilat kishin qëndruar pas vrasjes së Hanit. Monografia përmbillet me shkrimet e shumta që i kishin bërë mediat e huaja dhe vendore për vrasjen e Hanit, si një personalitet i rëndësishëm që kontribuoi për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në të gjitha territoret e ish-Jugosllavisë.

Si përfundim mund të thuhet që Xhevat Hasani në librin e tij, përpos që jep të dhëna mbi biografinë dhe jetën e Naser Hanit, ai paraqet edhe shumë të dhëna për pozitën dhe situatën e rëndë politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi

e posaçërisht në Maqedoni. Këto të dhëna janë pa dyshim mjaft të rëndësishme për çdo studiues të historisë bashkëkohore.

Autori duke na paraqitur jetën dhe peripecitë e patriotit Naser Hani, me këtë monografi pasuron historiografinë bashkëkohore shqiptare në përgjithësi me të dhëna të rëndësishme historike.

**Nuri Bexheti**

Prishtinë, janar 2013



### **Të dhëna për autorin**

Xhevat Hasani lindi më 14 shkurt të vitit 1953 në fshatin Buzes të rrethit të Opojës në Kosovë. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, në vitin 1968, kurse Shkollën e mesme të mjekësisë, në Prizren, në vitin 1972. Në vitin 1979 e ka kryer Fakultetin e mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasdiplomike i ka mbaruar më 1984 në Zagreb, kurse në vitin 1989 ka doktoruar. Për vite të tëra ka punuar si asistent e docent në Fakultetin e mjekësisë në Prishtinë. Për shkak të përndjekjeve nga regjimi serb në vitin 1992 është larguar nga Kosova. Aktualisht jeton në Zvicër. Ky është libri i tij i parë me karakter publicistikë.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

323.1(=18)(092)  
929(=18:497.7)Hani, Naser

Hasani, Xhevat

Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit  
/ Xhevat Hasani. – Prishtinë : Shoqata e të Burgosurve  
Politikë e Kosovës, 2013. - 287 f. ; 20 cm.

Parathënie : f. 13-14. – Të dhëna mbi autorin : f. 286

ISBN 978-9951-497-33-6

ISBN 978-9951-497-33-6



9 789951 497336